



TRADHËTIA DHE KOMPLITI I  
**SHAQIR FETAIT**  
NË KOHË PANDEMIE

Tiranë 2021

1k/ik larg



# **Tradhëtia dhe komploti i Shaqir Fetait në kohë pandemie**

Tiranë 2021

Boton:  
**1KlikLarg**

Biblioteka:  
**Thumbi**

Redaktor:  
**Andi Rakipi**

Recenzent:  
**Illir Ramadani**  
**Halid Sadiku**

Lektor:  
**Sonja Erebara**

Redaktor teknik & dizajn:  
**Illir Podrimja**

Tiranë 2021

**Tradhëtia dhe komploti i  
Shaqir Fetai  
në kohë pandemie**



## **Pse shkarkim dhe jo dorëheqje?!**

**(Sulejman Rexhepi u shkarkua?! Paska shkelur Nenin 58 të Kushtetutës, sipas Shaqir Fetait, i cili, me gjasë kurrë nuk e ka lexuar dhe as që e ka kuptuar këtë akt normativ më të lartë të BFI-së! Pse nuk iu kërkua dorëheqja por u shkarkua)**

**Shkruan Mr. Eset Shaqiri**

Qenkan mbledhur do burra të diskutueshëm dhe na e paskan shkarkuar H. Sulejman ef. Rexhepin, ndërkohë që ky, jo një herë ka kërkuar që të gjendet dikush nga mesi i tyre dhe ta zëvendësojnë, sepse i duhet pak pushim e privatci! Gjithnjë e kanë kundërshtuar, madje, vetëm të menduarit për dorëheqje ia kanë konsideruar si “tradhëti”!

U mblodhën “burrat e fisit” dhe e shkarkuan! Po kush janë këta “burra” që, duke marrur direktiva nga nëntoka anti-BFI, pranuan ta shkarkojnë njeriun i cili, në fakt, do të duhej të vetëdorëzohej, pak për shkak të moshës, pak për shkak të shëndetit dhe, mbi të gjitha, për ta freskuar me energji më të re Institucionin gjashtëshekullor islam të vendit.

Këta “burra” ishin shokët e Sulejman Rexhepit, bashkëpunëtorët e tij të ngushtë, anëtarët e Rijasetit të cilët votuan dhe miratuan gjithçka, madje edhe “shkeljen e Nenit 58”; janë miqtë e tij, që ngjasojnë në “nuse” që i kanë ndenjtur paluar e nusëruar Sulejman Rexhepit, kush tri dekada, kush dy e kush një dekadë. Në fund, ia qitën kararin: më hajër është shkarkimi se sa dorëheqja! Pse?

Sepse, dorëheqja, ushtron reperkusion moral edhe ndaj ekipit të tij! I pari ofron dorëheqje, tërë ekipi dorëhiqet! Por, ndonëse në dorëheqje, Kushtetuta i obligon që t’i përgatisin zgjedhjet e organeve, pa të drejtë për t’u futur në gara për zgjedhje! Vjen i treti dhe – ua nxerr të palarat në shesh. Kështu që, më mirë “shkarkim” dhe kapje të postit të tij nga ata që do ta shkarkojnë!

Me shkarkimin e të parit nga ana e ekipit të vet, në fakt ekipi amnistohet, del i shpëlarë nga çdo pisllek eventual që mund ta kenë bërë të gjithë. Por, këta “të gjithë” me shkarkimin e të parit, “automatikisht” dalin si trimat e dheut që e dëbuan “të keqin e vetëm” të BFI-së! Kështu, nën këtë epitet e fitojnë besimin e popullit dhe, për çdo vendim që do të marrin më vonë, do të gëzojnë besimin dhe legjitimitetin e popullit! Këtë lojë e dëshiron bashkëpunëtori më i ngushtë i Sulejman Rexhepi, Shaqir Fetai, prandaj dhe ua ka propozuar shokëve të vet “rrebelimin” e tyre dhe shkarkimin e “reisit” të tyre, akt ky që vjen direkt nga partitë në pushtetin aktual LSDM-BDI!

Kujt ia merr mendja se paska guxim Shaqir Fetahu të rrebelohet e të kërkoj shkarkimin e Sulejman Rexhepit? Po a ka më hipokrizi dhe më paftyresi se sa të ngritet edhe Mustafa Dauti të kërkojë shkarkimin e Sulejman Rexhepit?! Ta kërkojë Qenan Ismaili dorëheqjen e Sulejman Rexhepit?! Asnjëri prej tyre nuk do të guxonte ta ndërmernte një hap të tillë? Sepse, do t’i gozhdonte në kryq Sulejman Rexhepi! Do t’i detyronte në vetëvarje nga turpi! Sepse, ai ua ka ofruar dorëheqjen, ndërsa këta nuk ia kanë pranuar, madje ia kanë refuzuar me lot në sy! Vërtet, pse pas këtij “akti rrebelues”, të atyreve me të cilët, vetëm dy ditë mëparë e falën së bashku Fitër Bajramin, nuk reagoi fare Sulejman Rexhepi, por as “mbrojtësit” e tij?! Nuk ka reagime nga asnjëra palë, sepse e tërë kjo, erdhi si një

goditje e rëndë nga një armik i padukshëm! Janë si të trulllosur, janë duke bërë përpjekje për t'u këndellur dhe për ta kuptuar lojën e cila pa dyshim që do të dalë se është e shërbimeve sekrete të ndryshme.

Këta “burrat e dheut”, do ta “largojnë” Sulejman Rexhepin, do ta sjellin kipcin e tij (sepse bashkëpunëtorët e tij kurrë nuk do të mund ta tejkalojnë Sulejman Rexhepin, por, do të mundohen të jenë imitues të dobët të tij) dhe loja do të vazhdojë edhe më tej!

Prandaj shkarkimi “ka vlerë” në rastin konkret! Do ta largojnë duke u mbështetur “në procesverbalin e mbledhjes”! A ka më dobësi dhe më idiotizëm se sa të pranohet “ky justifikim” kaq banal që u sugjerohet nga nëntoka anti-BFI!

Çdo lojë që do ta luajnë tash e tutje veglat e dikurshme të Sulejman Rexhepit me në krye Shaqir Fetahun, e që do të jenë në të mirë të shërbimeve sekrete që me dekada e synojnë destabilizimin dhe shkatërrimin e BFI-së, do të duhej të merrte fund me gjyq, i cili, detyrimisht që do të duhet t'i zbardhë të gjitha aferat, skandalet dhe pjesëmarrësit në të! Kjo garniturë e përkohëshme e këtij skandal “rijaseti” duhet islamikisht të ndërgjegjësohet dhe qetë e pastër ta dorëzojë pushtetin tek ata që janë përbetuar në Zot se nuk ka zbrapsje deri në reforma rrënjësore në Institucionin që u përket myslimanëve të vendit. Epoka e këtij “Rijaseti” ka përfunduar! “Rijasetit” të ri puçist dhe komplotist u bëhet ftesë islamike për reflektim!

*(1Kliklart, 28.05.2020)*



## Misteret e shkarkimeve në BFI

**Këta myftinjë që e shkarkuan Sulejman Rexhepin, janë në një sprovë – në emër të Zotit dhe, vetëm për Zotin, të dalin nga nëntoka e rrezikshme ku janë futur dhe, së bashku me forcat progresive dhe reformuese të cilët, më se gjysëm dekadë ishin oponentë e kësaj “garniture”, ta çlirojnë këtë institucion nga prangat e interesave mesquine dhe t’ia rikthejnë po atë shkëlqim, dinjitet dhe identitet që e kishte ndër shekuj.**

### Shkruan Shaban Aziri

Ditëve të fundit në shumë portale e rrjete sociale të RMV-së u përfol martesë jo fortë e zakonit e Sulejman Rexhepit me një grua shumë më të re. Kjo ngjarje u përdor si shkas nga disa Myftinjë dhe “anëtarë të Rijasetit” për ta shkarkuar Sulejman Rexhepin nga posti i Kryetarit të BFI-së. Kjo martesë, përtej stigmatizimeve dhe ofendimeve të panevosjhme, kurrsesi nuk duhej të merrej si alibi për shkarkimin e tij nga posti i reisit sepse, është idiotësi të përzihesh në jetën private të njeriut, fundja edhe njëri edhe tjetri aktin martesor e kanë bërë me vetëdëshirë dhe me vetëdije të plotë.

Përtej kësaj, shkarkimi i Sulejman Rexhepit shpërfaq problemet e mëdha, strukturore e shumë shtresore që ka organizimi islam në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë dekadës së fundit. Shkarkimi i Sulejman Rexhepit është rasti më i mirë për ta stopuar një përvojë e cila Bashkësisë Fetare Islame gjatë dekadës së fundit po i ndodhë për të dytën herë me një skenarë identik. Më vitin 2005 në kohën kur Kryetarë i Bashkësisë Fetare Islame, H. Arif Emmini, u shkarkua nga posti i reisit largë selisë së BFI-së në të njëjtën mënyrë për shkaqe të cilat kurrë nuk u zbardhën. Po ky skenar u përsërit në mëngjesin e ditës 27. 05. 2020 ku disa myftinjë dhe “anëtarë të rijaseti” u tubuan në Gostivar dhe shkarkuan Sulejman Rexhepin nga “postin e reisit” dhe zgjodhën Shaqir Fetahun ushtrues detyre për kohë të caktuar. Edhe ky shkarkim u bë në bazë të një procesverbali ku nuk përmend asnjë arsye apo veprim i cili çon deri te shkarkimi. Nëse nuk stopohet, me gjasë kjo do t’i përsëritet edhe Shaqir Fetait, sepse që tani po hetohet oreksi i tij i sëmurë!

Një gjë dihet se autorë në skenarët e tilla nuk janë imamët, profesorët e Medresesë, profesorët e Fakultetit, as nëpunësit në BFI, por myftitë dhe “Rijaseti”. Pastaj, shkarkimet e tilla kurrë nuk u bënë në selinë e Bashkësisë Islame, aty ku është vendi, por në vende periferike largë opinionit duke shkarkuar dhe emëruar njëri tjetrin. Kjo dëshmon se sistemi i organizimit të jetës fetare është i kapur nga një grup personash të cilët kanë interesa të përbashkëta të cilët jo gjithnjë përfaqësojnë islamin, hoxhallarët dhe muslimanët e vendit. Ndërsa në rastin konkret, kjo kapje bëhet përtej grupit të Rijasetit, tani, me gjasë, duart në këtë lojë i ka të futur thellë edhe vetë pushteti politik, i cili kurrë nuk ka gjetur një paqe afatgjate në mes të pushtetit dhe BFI-së! Prandaj, e shoh të domosdoshme ndryshimin e sistemit organizativ të BFI-së me qëllim që të kapërcehen lidhjet direkte nëntokësore që nuk ia duan të mirën këtij Institucioni islam. Ky ndryshim do t’ia kthente natyrën e vërtetë jo vetëm institucionit, por edhe vetë klasës së hoxhallarëve. Një institucion i tillë do të ishte llogaridhënës, transparent dhe me përgjegjësi ndaj publikut.

Bashkësia Fetare Islame do ta gjenë qetësinë vetëm atëherë kur e vërteta e ndodhive të shpaloset në tavolinë, atëherë kur shpërdoruesit e pronës së vakëfit, zekatit, fitrit, haxhit të japin përgjegjësi para

drejtësisë, vetëm atëherë kur keqëpërdoruesit e fondeve të saj të ndëshkohet me masën e drejtësisë, vetëm atëherë kur BFI të çlirohet nga kjo klasë e veçantë klanore, mbi të gjitha politiko-partiake, të cilët janë bartës të pikëpamjeve që kanë bllokuar zhvillimin e brendshëm dhe të jashtëm të jetës fetare të këtij institucioni. Andaj, është hipokrizi dhe idiotësi për këta myftinjë të shkarkojnë të parin e tyre pa ia kërkuar përgjegjësinë për atë që i përmendin në arsyetimet e tyre sa banale aq edhe të poshtra! Natyrisht, arsyetime të detajuara nuk japin vetëm shërbimet sekrete policore. Të privojnë nga e drejta pa kurrfarë arsytimi, ta refuzojnë nënshpëtimin pa kurrfarë arsytimi! Prandaj, këtij shkarkimi po i vie era politike por, nuk po dihet akoma se nga ç'kanalizime nëntokësore erdhi kjo përzjerje politike në punët e brendshme të BFI-së!

Është e pandershme që “fajësia e Sulejman Rexhepit” të mos kërkohet edhe në mes të myftinjëve si anëtarë të “rijasetit”, të cilët i shërbyen me aq “dinjitet”, “profesionalizëm” dhe me aq dashuri reisit të tyre!

Megjithatë, këta myftinjë që na e paskan shkarkuar Sulejman Rexhepin, janë në një sprovë – në emër të Zotit dhe, vetëm për Zotin, të dalin nga ajo nëntokë anti-BFI ku janë struktur dhe të japin kontributin e tyre që, së bashku me forcat progresive dhe reformuese të cilët, më se gjysëm dekadë ishin oponentë e kësaj “garnitur”, ta çlirojnë këtë institucion nga prangat e interesave mesquine dhe t’ia rikthejnë po atë shkëlqim, dinjitet dhe identitet që e kishte ndër shekuj.

*(Botasot, 29.05.2020)*

## Të gjithë të përbalturit e Nenit 58

Nëse, për çdo shkelje në mbi 1000 ditë (sa ka drejtuar Sulejman ef. Rexhepi me BFI-në) të Nenit 58 të Kushtetutës së BFI-së, do të na duheshin arsyetim shkarkimi nga 5 fjali, atëherë i bie se do të na duheshin plotë 5000 rreshta dhe, nëse një faqe vordi zë 40 rreshta, atëherë do të na duheshin plotë 125 faqe arsyetim! Kush do t'i hynte kësaj pune sizifiane? Më mirë ta anashkalojmë dhe ta gënjëjmë Zotin! Na fal o Zot

Nga Azem Jonuzi

Sahanëlipirësit e Sulejman Rexhepit, më në fund, vendosën që ta vjellin tërë atë që e kishin hëngër me qëllim të shpëtojnë disi nga ai helmim i organizmit përmes detoksifikimit të stimuluar. E shkarkuan Sulejman Rexhepin sepse po ndjenin që, duke manipuluar në emër të tij, kishin ngritur aq të lartë kullën e haramit sa, rrënimi i saj ishte i pashmangshëm. Copa gjigante të kullës së këtij harami do të binin mbi myftinj të, mbi drejtorët, dekanët, udhëheqësit e sektorëve, këshilltarët, familjarët etj. dhe, për të shpëtuar nga kjo katastrofë e tmerrshme, në ndihmë “na erdhi” neni famoz i Kushtetutës së BFI-së – Neni 58! Pa dyshim, nuk dua të amnistohem as vetë dhe as kolegët e mi duke u përpjekur që fajin ta kërkoj vetëm te ata “organe” që u nënvizuan më sipër. Haramin e sponsorizuan edhe vetë ne, hoxhallarët, pasi që i vilnim taksat fetare nga myslimanët tanë dhe ua jepnim eprorëve tanë të cilët kurrë nuk kërkuan të dinë se ku përfundojnë këto taksa dhe as nuk na raportuan neve hoxhallarëve, madje, për të mirën tonë paska qenë që fare mos të interesohemi se çka po bëhet me djersën dhe gjakun e xhimateve tona. Sa keq e sa turp! A thua a do të na i falë ndonjëherë Zoti Fuqiplotë! Të gjithë e kemi ditur, të gjithë kemi kontribuar, pra, të gjithë kemi heshtur para këtij krimi e mëkati të paparë në historinë e fesë islame që e ushtruan në emrin tonë myftinj të tanë që deri dje ia puthnin dorën Sulejman Rexhepit, të cilit në fund ia ngulën thikë pas shpine, për interesa të tyre personale. Ajo çka i ka ndodhur myslimanëve te ne, në këtë nënqiell, nuk është shënuar në asnjë faqe të historisë së kësaj feje. Pranimi i kësaj të vërtete flet për vetëdijësimin dhe ndërgjegjësimin tonë, flet për sinqeritetin tonë, flet për faktin se ne drejtohemi nga myftinj që janë të aftë të të ngulin thikën pas shpine, të të tradhëtojnë për një kockë këlyshi. Megjithatë, dikush është kujdesur që të mbajë shënim për çdo mëkat, për çdo kontribut në mëkat dhe për çdo sponsorizim të mëkatit që e kemi bërë. Shyqyr që teknologjia ka avancuar shumë dhe, nuk duhet që ato shënime të ishin në letra e në dosje, sepse do të duhej valixhe e valixhe për t'i përthakuar të gjitha. Vetëm një USB mjafton për ta arkivuar turpin tonë! E evidentuar gjithçka në data e orë, në ditë e javë, në muaj e vite, me emër e mbiemër, secili çfarë ka bërë! Është ky Vullnet i Zotit dhe, këtij Vullneti nuk ka forcë që mund t'i dalë përpara, që ta zbrapsë! Me këtë Vullnet është e mundshme edhe ajo çka njeriut nuk ia merr mendja. Që nga fundi i prillit të vitit 2015 e deri më fund të majit të vitit 2020 kanë kaluar mbi 1800 ditë, prej të cilave mbi njëmijë ditë është shkelur Neni 58 i Kushtetutës së BFI-së; plotë 1000 e disa ditë rresht është mëkatuar nga ana e myftinjëve tanë, të cilët kanë vjedhur dhe kanë shitur vakëf, mbi 1000 ditë është ushtruar antihumaniteti, është provuar tallja me fenë islame, kemi mëkatuar duke u fshehur pas emrit të Zotit, Atij i qofshim falë! Dhe, në fund, u ndërgjegjësuam dhe publikisht e pranuan se Sulejman Rexhepi shkarkohet sipas Nenit 58 të Kushtetutës së BFI-së! Kurse, mbi 1000 ditë, në çdo orë të lume ne, hoxhallarët, nëpunësit, administrata, profesorët, të gjithë që kemi qenë të angazhuar në BFI, thjesht, kemi mëkatuar dhe kemi gabuar duke shkelur me dy këmbë mbi këtë Nen. Këtë e dimë edhe ne, këtë e di edhe Sulejman Rexhepi.

Prandaj pse fajtor qenka vetëm Sulejman Rexhepi dhe jo edhe vetë ne, bashkëpunëtorët e tij? Organet e BFI-së, sidomos myftinjët dhe anëtarët e “rijasetit” kishin filluar ta ndjejnë peshën e rëndë të mëkatit, zënien e frymës nga kjo peshë e mëkatit, trishtimit, hidhërimit të Zotit! Zoti i bëri rezil, na turpëruan për faqe të zezë. U damkosëm e u dogjëm si me gaca nga zjarri i Xhehenemit – u hidhëruam me reisin e myftinjëve tanë dhe e shkarkuam me Nenin 58! Por, nuk treguam se në cilën ditë, në çfarë rasti, me çfarë sebeci e kishte shkelur këtë Nen Sulejman Rexhepi? Ta lëmë të pazbardhur këtë rast, të panjohur e të paditur nga askush?! Ky është mëkati më i madh që e bëjnë këta “shpëtimtarë” të BFI-së e “vrasës” të Sulejman Rexhepit, sepse, e neglizhojnë faktin e pamohueshëm – asgjë nuk mund të harrohet dhe të fshihet nga Allahu i Gjithëdijshtëm, i Cili dikujt i ka dhënë mend që ta shpikë edhe një USB! Nuk e kemi më as atë tagër, as atë peshë, as atë vlerë dhe as atë të drejtë morale që edhe më tej të vazhdojmë e ballëlartë t’ua kërkojmë taksat fetare xhematit tonë! Duhet ta pranojmë turpërimin tonë por pse jo, të bëhemi në fund të sinqertë dhe, të kërkojmë që të na nxjerrë nga kjo baltë epike Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI të RMV-së.

*(1Kliklart, 5.06.2020)*

## Puçistët

**Pak ditë pasi u falë namazi i Fitër Bajramit dhe Reisi Sulejman Rexhepi e shpalli të vdekur “koronën”, përkatësisht fitoren mbi pandeminë Kovid-19, filluan të qarkullojnë lajme nëpër portalet sociale, ku të besueshme e ku jo, se “Reisi Sulejman Rexhepi qenka rimartuar në moshën 74 vjeçare me një grua më të re se ai për 50 vjet”!** Në dukje lajm sensacional, por në esencë një çështje private, qoftë edhe e Reisit Sulejman Rexhepit

**Shkruan Prof. Bajram Selmani**

Ajo që do të vijoi ishte një “hakmarrje” ndaj tij, prej bashkëpunëtorëve të tij për shumë vite, si duket të gjithë të interesit të Sulejman Rexhepit, sesa të institucionit ku edhe e realizonin marrëdhënien e tyre të punës e realizonin të ardhurat materiale. U mbledhën në një qytet provincë (Gostivar!), për ti bërë puç (goditje) “shefit të tyre”. Ndërkaq habit fakti sesi Reisi në fjalë, këtë puç jo vetëm që e pranoi me aq lehtësi, por në ditët në vijim do të ofroi edhe dorëheqje të parevokueshme prej pozitës së Kryetarit të BFI-së. Megjithatë logjika e legjislacionit, qoftë edhe e BFI-së, dikton diçka krejt tjetër. Takimi në qytetin provincë (Gostivar!), ishte i paligjshëm, nga çfarëdo këndvështrimi.

Nuk dihet kush e ftoi, sa anëtarë morën pjesë dhe në çfarë cilësie, a ishin shumica anëtarë të Riassetit, apo bëhej fjalë për puç në kuptimin e zakonshëm të fjalës, edhe ndaj Institucionit BFI e ndaj Kryetarit të saj. Në anën tjetër vetë Kryetari pas dy ditë dha dorëheqje, shtrohet pyetja para kujt, para “puçistëve”- deri dje bashkëpunëtorët më të afërt të Kryetarit, që për pak e për shumë bënë be, në fjalën e tij. Kjo do ti ngatroi punët edhe më tepër në vend që ato ti bëjë më të thjeshta, e të paraqiste një zgjidhje për Institucionin. Fjala vjen, në takimin në qytetin provincë u “zgjedh” edhe “ushtrues detyre”, gjoja që do të përgatit mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta (deri tani paskan qenë të parregullta!), për zgjedhjen e Kryetarit të ri BFI-së. Çështja është, puçistët a kanë të drejtë ligjore, ta pranojnë dorëheqjen e Kryetarit të BFI-së!

Po nëse Kryetari i BFI-së jep dorëheqje, atë duhet ta jep para organit që e ka zgjidhur, me këtë rast Riaseci i BFI-së. Organi që e ka zgjidhur, në afat të caktuar kohor duhet ta shqyrtoj dorëheqjen e ofruar, e pastaj të merr vendim për pranimin ose jo të dorëheqjes. Nëse pranohet dorëheqja i njëjti organ, merr vendim kush do ta drejtoj BFI-në, përkohësisht ose zgjedh Kryetarin e ri.

Pasi krejt kjo të kishte ndodhur, Kryetari i ri, punën e parë që duhet ta bëjë, është pranim-dorëzim i Kabinetit të Kryetarit. Konstatohet me dëshmitar gjendja financiare; dokumentacioni përcjellës lidhur me të, pastaj vijon me radhë procedurat e tjera për ri-rregullimin e dokumentacionit. Në të vërtetë, ndodhi e po ndodh ndryshe, hapësirë i jepet jo ligjore, vullnetit arbitrar të individëve të caktuar, që po thuaj se fare nuk janë të njohur për meritat ndaj institucionit BFI.

Mbledhje e një grup puçistësh, ka qenë praktikë ose dëshiron të bëhet praktik është një dilemë që se zgjidh dot!, që e “shkarkojnë” Kryetarin e tyre, për “shkaqe morale”, ani pse 24 orë më parë të gjithë i duartrokisnin. Po këto a nuk janë bashkëfajtorë së bashku me kryetarin e tyre. Po edhe nëse “shkarkohet” për çështje të dështimit e keqpërdorimit financiar, ato janë njësoi bashkëfajtor për zhatjet dhe keqpërdorimet në BFI. Po pse u deshtë puçi të ndodhë në provincë, e jo në qendër.

Ndoshta sipas puçistëve Institucioni do të udhëhiqet prej province, e jo prej qendre!?

Edhe diçka, pse tani ju morr mandati Kryetarit, dhe u tha se bile, “moti i kishte kaluar mandati i të qenit Kryetar”. Nëse këtë e dinte kryetari, duhet ta ketë ditur edhe Riaseti, edhe puçistët. Nëse po kur u bënë të vetëdijshëm për një fakt të tillë?!

Po rrugëzgjdhja ku duhet të kërkohet e ku duhet të gjendet. Nëse puçistët e shkarkuan për “shkak të opinionit të krijuar”, atëherë cili qenka ai opinion dhe kush e bëri atë opinion? Puçistët nuk kanë lidhje me këtë, përkundrazi, ata kanë bërë opinion për jetëgjatësinë e Kryetarit të Tyre!

Opinion i vërtetë për vite me radhë ishte i Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI. Ata ishin dinamoja lëvizëse për ndryshimin e frymës së besimtarëve se një ditë do tu kthehet dinjiteti i tyre, në besimin e tyre të devotshëm dhe një udhëheqësi e drejtë e vizionare që do të vihet në krye të tyre. Por puçistët edhe njëherë ranë para provimit për çështje morale. Ata jo vetëm që gënjejnë, por synojnë të bëjnë edhe plagjiat të ideve dhe meritave të huaja. Kjo çdo gjë mund të jetë por jo çështje besimi, përkushtim ndaj besimit.

LMR-BFI, është alternativa e vetme e zgjidhjes së problemeve, me vite të grumbulluara në BFI, nga çfarëdo këndvështrimi shikuar, përkatësisht si nga perspektiva e tanishme ashtu edhe e ardhshme. Te LMR-BFI, e kaluara e tashmja dhe e ardhshmja janë një e njëjta gjë. Sa më parë kuptohet, prej të gjithëve: edhe prej simpatizantëve edhe prej kundërshtarëve të saj, zgjidhja do të jetë më afër dhe zgjedhjet do të jenë edhe legale- transparente dhe të ligjshme. Besimtarët e fesë islame, do ta ndjen vetën të mishëruar me udhëheqësit e tyre, e jetës fetare do ti japin gjallërinë e merituar.

*(in 7.tv, 16.06.2020)*

## **Shaqir Fetai një bastard që refuzohet nga BFI-ja**

**Bashkësia Fetare Islame në RMV tashmë ka traditë në zgjedhjet e organeve të veta! Prijësi i saj zgjedhet konform Kushtetutës dhe rregulloreve përkatëse. Asnjëherë nuk ka pranuar dhe nuk ka duruar që të drejtohet nga “prijës” të caktuar nga UDB, e as nga “prijës” ta caktuar nga gjykatës maqedonasë. Nuk do ta pranojë e nuk e duron as një “prijës” bastard të tipit të Shaqir Fetahut të instaluar përkohësisht nga shërbimet e ndryshme antiislame**

**Shkruan Mr. Eset Shaqiri**

Rikolonialistët dështakë të fundit të BFI-së, të cilët dhunshëm erdhën në krye të saj derisa të kryen zgjedhjet e rregullta, po sillen sikur tashmë t’i kenë kryer këto procese prej nga duhet të dalin organet legale dhe legjitime të këtij Institucioni! Nga disa bashkëpunëtorë të deridjeshëm, sahanëlëpirës, u dëbua Sulejman Rexhepi dhe kinse qenkan marrur vesh që tash e tutje ta drejtojë BFI-në Shaqir Fetahu! Kush ka vendosur për këtë bastard? Kush është në fakt Shaqir Fetahu, i cili, imponimin e vet nga strukturat antiislame dëshiron ta paraqesë si çështje tashmë të kryer dhe të “vulosur” nga dhjetra individë që po vikan dhe po ia urojnë “reisllëkun”! Vetëm një bastard i pafytyrë do të pranonte zhvillimin e një “piari” të tillë! Krejt myslimanët e Maqedonisë së Veriut e dinë që, sikur edhe tërë bota të rreshtohet e të presë në radhë për t’ia uruar “reisllëkun”, Shaqir Fetahu, si pikë e parë, nuk është i zgjedhur nga askush, si pikë e dytë ai është i imponuar dhunshëm në drejtimin e këtij Institucioni deri në zgjedhjet e rregullta, se vetë Shaqir Fetahu, për shkak të biografisë së tij me shumë elemente kriminale, nuk mund të jetë reis dhe, si ushtrues detyre ai nuk e ka të drejtën e konkurrimit por vetëm të zhvillimit të procesit të zgjedhjes së reisit. Shaqir Fetahu tashmë njihet si sinonim i politikave kriminale që e falimentuan BFI-në.

### **Shaqir Fetahu abnormal**

Shaqir Fetahu është një prej bashkëpunëtorëve më të vjetër të Sulejman Rexhepit! Janë me qindra deklarata përmes të cilave ai vazhdimisht është mburrur me atë që është krah i djathtë i Sulejman Rexhepit. Sulejman Rexhepi nuk ka mundur të vepronte asnjë shkelje sikur mos ta kishte përkrahjen e Shaqir Fetahut, sikur mos ta kishte nxitjen, motivimin dhe ndihmesën e Shaqir Fetahut! Shaqir Fetahu nuk mund ta kamuflojë të kaluarën e tij duke e prezantuar veten si “reis” të cilin po e uron dhe përkrah mbarë bota! Shaqir Fetahu edhe në këtë rast po kryen vepër penale, sepse edhe po gënjën por edhe po i keqinformon të gjithë ata që po i pranon në zyrë, duke mos u treguar se ai është kuadër politiko-partiak i detyruar që të vihet në krye të një procesi përfundimi i të cilit varet nga rezultatet e zgjedhjeve të pritshme politike. Nëse partiakisht do të tregohet i suksesshëm mund t’i buzëqeshë fati e të vazhdojë “drejtues i dhunshëm” (si dikur drejtuesit e dhunshëm të politikave millosheviqiane në Kosovës), nëse jo atëherë vështirë se do të mbetet edhe imam në Çegran! Para një dilemë të tillë do të pranonte të gjendej vetëm një abnormal!

## **Shaqir Fetahu karrierist i verbuar**

Një njeri që mundohet t'i bëj Bajram vetes ai nuk është i sinqertë as me vetëveten e as me rrethin, prandaj ai do të konsiderohet si abnormal! Shaqir Fetahu u bë vegël e djallit si në përkrahjen ashtu edhe në largimin e Sulejman Rexhepit, kurse nuk e kuptoi se vegla e djallit nuk mund të jetë drejtues i një institucioni islam i myslimanëve të RMV-së. Bashkëpunëtorët e deridjeshëm të Sulejman Rexhepit, të cilët publikisht radhiteshin pas çdo paraqitje të tij publike duke dhënë përkrahje dhe duke i premtuar unitet, sot nuk mund të jenë pasues të tij. Ra kryeministri – bie tërë qeveria! Vetëm një karrierist i verbuar mund të mendojë se ka të drejtën e “udhëheqësit”, kësajsoj, duke e ofenduar rëndë tërë popullatën. Dhe, në këtë paturpësi, në këtë ofendim të poshtër që ia bën popullatës, a mund të pretendojë se ai mund të jetë “prijës”? Shaqir Fetahu duhet të përballet me drejtësinë, duhet të fitojë pafajësinë në sy të popullatës dhe tek pastaj të pretendojë që të konkurrojë në ndonjë post drejtues të organeve të BFI-së! Deri atëherë, ai do të ngelë e do të kundrohët vetëm si një karrierist i verbuar e i çmendur totalisht!

## **Të gjitha veprat penale të Shaqir Fetahut**

Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI, ka mjaft dokumenta, argumenta e fakte të cilat do ta kishin për ligjur të qenurit teolog e jo më të lejojë që Shaqir Fetahu, ky lojtar naiv politiko-partiak, të jetë në krye të Institucionit të BFI-së. Shaqir Fetahu është një barrë shumë e rëndë e mbushur përplotë me vepra penale! Shaqir Fetahu thotë se Sulejman Rexhepi shkarkohet sepse ka shkelur Nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së! Sa kohë e ka shkelur këtë Nen? Në sa pika e ka shkelur këtë Nen? Sulejman Rexhepi nuk e shkeli këtë Nen vetëm në Ditën e Bajramit që, sakaq, në vend të tij të vie “i emëruari” politik nga shërbimet antiislame! Shaqir Fetahu ka derdhur “lotë krokodilli” për tërë ato vërejtje që i nënvizonte vazhdimisht Lëvizje Myslimane për Reforma në BFI. Sa herë që është shkruar për keqpërdorimin e financave të BFI-së, për pasurim personal, natyrisht që është menduar edhe në Shaqir Fetahun, si përkrahës i drejtëpëdrejtë i këtyre veprimeve. Këtë fajësi Shaqir Fetahut ia njohin të gjithë myslimanët e vendit, kurse habit përpjekja e tij idiotike që të tallet edhe më tej me këta myslimanë, duke i injoruar me do përkrahje që vijnë si shenjë gëzimi që u largua Sulejman Rexhepi dhe jo se u zgjodh pasuesi i tij! Askush nuk pret prej Shaqir Fetahut që ai të jetë nikoqir i mirë me “të ftuarit e tij” dhe me të dirigjuarit partiak, por, të gjithë prej tij presin që sa më shpejt t'i përgatisë komisionet përkatëse të nevojshme për të siguruar një zgjedhje legale dhe legjitime të reisit të ardhshëm.

## **Shaqir Fetahu bastard i politikave dështuese**

Shaqir Fetahu edhe më tej është duke menduar se ka qenë pjesëtarë i një “strukture sekrete” e cila brenda dy dite ka arritur që ta çlirojë BFI-në nga Sulejman Rexhepi! Ai mendon se popullata myslimane e vendit është duke hëngër barë dhe nuk ka nga të angazhojë trurin për të kuptuar se çfarë ndodhi në të vërtetë. Shaqir Fetahu mendon se popullata myslimane e vendit kur do të kuptojë se është imponim politiko-partiak do të tërhiqet dhe, duke u rreshtuar në radhë për shprehje të urimeve e përsëhëndetjeve, do ta gëlltisë edhe këtë turp. Prandaj dhe, duke qenë kaq naiv dhe kaq i pacipë, ai shkon dhe organizon takim me gazetarët sa për t'i qerasur me bakllavë! Kur ata ia refuzojnë bakllavën dhe kur e pyesin se kur do të organizohen zgjedhjet, kur do të ketë përgjigje se pse u shkarkua Sulejman Rexhepi, ky përgjigjet se nuk do të flasë me “gjuhë rrugaçërie”, me “urdhëroni të ëmbëlsoheni me bakllavë” dhe se “po i analizojmë faktet dhe argumentet e pastaj do të dalim në opinion”? Do me thënë Shaqir Fetahu “shkarkon” e pastaj “analizon”, sjellje kjo tipike gruevskiane:



“burg e pastaj akuzo”! Përgjigje tipike e një bastardi të politikave të dështuara. Asnjë analizë për shkarkimin e Sulejman Rexhepit nuk është e plotë, e saktë dhe e realtë nëse në ato analiza nuk gjendet emri i Shaqir Fetahut si bashkëpunëtorë më i vjetër i Sulejman Rexhepit! Shaqir Fetahu mundet të “dalë i nderuar” vetëm nëse sa më shpejt vetëdijësohet, heq dorë nga vendime të ndryshme që pa dyshim do të trajtohen si vepra penale, sa më shpejt formon komisionet dhe e hap procesin e zgjedhjes legale dhe legjitime të Reisit. Ndryshe, do ta gëzojë historikisht epitetin e “pastruesit të dështuar të gjurmëve të krimit dhe të kriminalizimit të BFI-së”! Përgjegjësia penale do të jetë edhe më e rëndë, e papërballueshme madje për cilindo subjekt politik. Fuqinë politike, juridike, partiake, të Sulejman Rexhepit vështirë se mund ta ketë dikush! Megjithatë – Sulejman Rexhepi u dogj, me të u dogjën edhe të tjerët, sado që mendojnë se kanë fatin e feniksit!

*(Fol, 20.06.2020)*

## **Për një BFI të mirëfilltë**

**Cilado strukturë në BFI që mendon në reforma të domosdoshme, e ka patjetër të ulet dhe të merret vesh me Lëvizjen Myslimane për Reforma në BFI, për të mirën e institucionit dhe që, edhe popullata të rikthejë besimin në BFI**

### **Shkruan Mirdi Brao**

Si nënpunës fetar të këtij institucioni gjithmonë kemi pasur brengë mbarëvajtjen e punëve të përgjithshme që përmbledh në vete ky institucion. Me shumë kujdes kemi ndjekur zhvillimet dhe situatat nëpër të cilat ka kaluar BFI-ja duke mos përjashtuar këtu skandalet e njëpasnjëshme të tërë Rijasetit.

Ndodhi që të shkarkohej Reisi, Sulejman ef. Rexhepi, por nga kush u shkarkua dhe çfarë ndodhi më pas? U shkarkua nga miqtë dhe shokët e tij më të ngushtë që për vite me rradhë kanë qenë në shërbim të tij me degjueshmërinë dhe nënshtrimin absolut prej servilëve. U shkarkua nga ata anëtarë të Rijasetit që për vite me rradhë nuk patën guximin njëherë të vetme t'ia bënin një sugjerim apo një kritikë kryetarit të tyre që një ditë do ta shkarkonin në bazë të Nenit 58 të Kushtetutës së BFI-së. Kjo na bën të kuptojmë se këta anëtarë të Rijasetit që deri një ditë para shkarkimit të Reisit bashkë me Reisin hëngrën bakllava dhe festuan Bajramin, janë të vetmët fajtorë të çfarëdo shkelje të Nenit 58, sipas të cilit nen e akuzuan dhe shkarkuan tashmë ish-Reisin.

Çfarë duhet të ndodhë më pas?

BFI-ja ka ardhur në një situatë ku reformat janë të patjetërsueshme për t'ia rikthyer institucionit imazhin e duhur, për t'ia rikthyer kredibilitetin që pothuajse nuk ekziston fare dhe për t'ia rikthyer vlerën dhe peshën e vërtetë. Janë disa vite tashmë që në vendin tonë ekziston dhe vepron një Lëvizje për reforma në BFI e cila nuk ka rreshtur me veprimtarinë e saj permanente tani e 5 vite me rradhë. Themeluesi i kësaj lëvizje H. Afrim Tahiri, u largua nga BFI sepse nuk pranoi të jetë bashkëpjesëmarrës me myftinj të dhe anëtarët e tjerë të Rijasetit në zhvatjen dhe në shkatërrimin e BFI-së. Afrim Tahiri nuk pranon asnjë shkelje të Kushtetutës së BFI.

Sëkëndejmë, si një nga ata të cilët i hapën front në mënyrë publike krimin në BFI, si një ndër njohësit më të mirë të Kushtetutës së BFI-së – një nga përpiluesit e saj nëse nuk gabohet, jam i mendimit dhe, këtë mendim e kanë edhe shumë shokë dhe kolegë të mi, të cilët me siguri se do të dalin me deklaratat publike në ditët në vijim, pra jemi të mendimit se kjo strukturë aktuale e ka patjetër të ulet dhe të merret vesh me Lëvizjen Myslimane për Reforma në BFI, për të mirën e institucionit dhe njëherë e përgjithmonë të pastrohen punët që edhe popullata të rikthejë besimin në BFI dhe të kemi një BFI të mirëfilltë që do të ketë synim, në përgjegjësi, mirëmbajtjen e pasurisë shoqërore dhe mbarëvajtjen dhe organizimin e jetës fetare në vendin tonë. Përndryshe nëse dikush mendon se reformë në BFI është shkarkimi i Sulejman Rexhepit, atëherë kriza do të vazhdojë të thellohet!

Zoti qoftë me të drejtë dhe të sinqertit.

*(1Kliklart, 28.06.2020)*

## **BFI duhet të shpëtohet, Shaqir Fetai nuk mund të shpëlahet**

**Shaqir Fetain, këtë kreaturë të Sulejman Rexhepit, e ka uruar edhe Kofi Anan, edhe Bill Klinton, edhe Sollana, edhe Tramp, edhe Merkel, edhe Sarkozy, edhe Shumajer, edhe Brus Li, edhe Çak Noris, edhe ata që dikur Mulla Sulës i thonin uzurpator e Shaqir Fetait puthador, edhe të gjithë bre, por ama, që të gjithë e dinë se ai nuk është rezultat që vie nga zgjedhjet kushtetutare e as vullnet i besimtarëve, por nga çivria e nëntokës!**

### ***Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI***

Kreatura e Sulejman Rexhepit, Shaqir Fetai, një nga bashkpunëtorët që në fund ia ngul thikën pas shpine, po eksitohet deri në ejakulum shpirtëror duke pritë e përcjellë njerëz të gëzuar që më në fund, Bashkësia Fetare Islame, u lirua nga Sulejman Rexhepi.

Shaqir Fetai, natë e ditë është në shkelje të Kushtetutës së BFI-së, kënaqet që vijnë t'ia urojnë "postin" u.d. e ky u prezantohet rrejshëm si kryetar e rreiiiss! Shaqir Fetai, vdes, ama bukvalisht vdes për t'u dëshmuar pak si "rreisul ulema" i BFI-së! Nuk mund të jetë kurrë! Ai mund ta grabisë titullin, por ama kurrë nuk mund të jetë kryetar i nderuar i myslimanëve të Maqedonisë së Veriut!

Shaqir Fetai, duhet sa më shpejtë t'i japë fund shkeljes së të gjitha akteve normative të BFI-së, ndryshe, edhe sikur tërë OKB, tërë OSBE, BE, NATO, madje, 7 miliardët qytetarë të botës të rrin rresht e të vinë t'ia urojnë Shaqir Fetait "postin u.d." kjo assesi nuk e bën Reis!

Qejfet janë reagime subjektive, secili ka të drejtë vetes t'ia bej qejfet, por ama jeta institucionale, institucioni fetar i myslimanëve të vendit, nuk mund të shdërrohet në shtëpi ku secili vepron sipas qejfeve të veta!

Shaqir Fetai duhet ta ketë të qartë se Lëvizja Myslimane për Reforma këmbëngul në respektimin e Kushtetutës së BFI-së, anëtarët e saj nuk kanë për qëllim punësimet në BFI, por Reformat e domosdoshme që duhet të bëhen në BFI. Nëse bota e do një BFI e cila do të veprojë jashtë binareve të Kushtetutës, sikur mbarë bota të dëshironte një BFI sipas qejfeve të Shaqir Fetait, ai tashmë duhet ta ketë mësuar se përballë do ta ketë Lëvizjen Myslimane për Reforma e cila që nga fillimi është e qartë në qëllimin e saj dhe e përgatitur të vazhdojë drejt suksesit përfundimtar!

Për qejfe të veta Shaqir Fetai mund ta ketë në përkrahje mbarë botën, kurse Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI për synimet e veta ka ndihmën e Zotit Fuqiptotë.

***(Fokusi, 21.07.2020)***

## Shansi ose shansi i humbur

**Prej fundit të muajit Maj e deri tani, kaluan gati një muaj e gjysmë, ndërsa kryetari i përkohshëm i BFI-së u tha se ishte një shans që më në fund të filloi një punë e mbarë, në institucionin në të cilin besimtarët mysliman në mënyrë institucionale e të organizuar i realizojnë të drejtat e tyre individuale e kolektive, si për çështje besimi ashtu edhe ritualet rreth çështjeve të praktikimit të besimit islam**

**Nga Zenun Fejzulla**

Deri tani asgjë nuk duket në përmbushjen e zotimit, me të cilin në paraqitjen e parë u duk shumë shpresëdhënëse. Prej kohës kur u vetëshpall “kryetar” me mandat të përcaktuar e kufizuar, nuk është bërë qoftë edhe një lëvizje në drejtimin e organizimit të zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryetarit të Ri të BFI, përkatësisht nuk është thirr kurrfarë mbledhje e Riassetit, për aq sa ka mbetur legjitim (disa të tjerë edhe janë me precedencë penalo-juridike!); nuk është thirrur as kuvendi i BFI-së, si organ që bënë verifikimin e arkës dhe përputhshmërisë ligjore të BFI-së.

Kryetari i përkohshëm, me mentalitet province e dinakërie provinciale, deri tani njihej vetëm si Myfti i Gostivarit i zgjedhur në mënyrë të ligjshme, duke më shumë preferon që të mbahen zgjedhjet parlamentare, për të parë lavjerrësin e politikës se ka do të anoi më tepër, e pastaj të ndërmer nisma në “mënyrë të pavarur” për rifillimin e zgjidhjes së nyjës Riasset-BFI.

Nëse shansin, tani e ka shansin!, nuk e shfrytëzon ai do të jetë vetëm edhe një shans i humbur, për të bërë diçka në të mirë të BFI-së. Kryetari i përkohshëm, tani në këtë moshë ka një shans së paku njëherë të jetë vetja, duke u ndarë prej të kaluarës së vetë ku qëndronte herë majtas e herë djathtas, para ose mbrapa ish Kryetarit të vetë, të vë një gurë e të lë një gjurmë, duke u marrë me organizimin e zgjedhjeve si të anëtarëve të ri të Riassetit e të Kryetarit të Ri të BFI-së, me kushtetutën në fuqi sado që ajo ka mangësitë e veta.

Këtë e ka detyrë por edhe zotërim, prej ditës që mori detyrën e “përkohshme”; për më tepër është obligim moral, sepse karrierën e vetë të bujshme prej teologu dhe nëpunësi fetar e realizoi po në këtë institucion, e jo të manifesto drojë, në mos edhe frikë prej oponentëve si brenda BFI-së ashtu edhe ndaj LMR të BFI-së. Kjo “frikë” nuk është e arsyeshme, sidomos ndaj LMR të BFI, ngase të gjithë e duan më të mirën për BFI-në. Reisi ose Kryetari i përkohshëm duhet të niset prej asaj që bashkon, e jo prej asaj që ndanë. Me këtë do të rriten gjasat që të jetë një “kryetar” i suksesshëm në nismën e premtuar, sesa të jetë një disfatë dhe fiasko e plot për të dhe institucionin që kryeson, e për të cilin zotohet ta rimëkëmbë.

Në rrugën e përfolur e të premtuar, duhet ta përdorë e shfrytëzoi çdo mundësi e çdo shans si ai vetë por edhe duke krijuar çdo mundësi e çdo shans edhe për të tjerët, të cilët me vite kontribuojnë, për rimëkëmbjen dhe kthimin e dinjitetit të BFI-së. Besimtarët këtë e presin prej të gjithëve, mjafton që të ju krijohet mundësi që edhe ata të jenë pjesë e zgjidhjes, e të zgjedhin më të mirin e mundshëm.

*(Politesa, 4.07.2020)*

## Shaqir Fetahi e gënjen Ambasadore Amerikane në Shkup

*(Gënjeshtari është plafi i haramit (proverbë myslimane)*

Shaqir Fetahu duke u frikësuar nga ndonjë padi për shkeljet antiligjore dhe për mashtrimet publike që po i bën për çdo ditë, ka bërë një truk i cili është aq naiv sa, kësaj rradhe e ka ngulur si besharet në bahçe.

I vetëdihëm se po gënjen në ditë me diell, i vetëdihëm se mund të paditet penalisht për keqpërdorim të Institucionit, për prezantim të rrejshëm, i vetëdihëm se hedh firmë nëpër tituj të paqenmë dhe inekzistent, Shaqir Fetahi ka korrigjuar një gjë: nuk po i thotë vetes “Reisul Ulema” por, u.d. “reisul ulema”! Por, trukaxhiu naiv, para këtij titulli formal, veten e cilëson si “Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, u.d. Reisul ulema”!

Reisul Ulema është post shpirtëror, është post personal, mund ta quash veten si të duash, edhe kryeakademik, edhe kryeparlamentar, edhe kryeintelektual, edhe kryepeder, kryepizdë etj. etj. Askush nuk të pengon që ta quash veten si të duash, por ama, dije që bëhesh rezil, të tallin të gjithë, sepse, ta quash veten “kryetar i intelektualëve”, apo “reisul ulema”, duhet të dishë të paktën që posti Kryetar i një Institucion është post administrativ dhe, mbart përgjegjësi, ndërsa për qejf të vetin, për shërim të komplekseve të sëmurura, mund ta quash veten si të duash, madje edhe “reis”! Këtë truk idiotik nuk guxon t’ia hedhë Shaqir Fetahi me aq finokëri edhe Ambasadës Amerikane, respektivisht zonjës Ambasadore Kate Marie Byrns, e cila e di fare mirë se, një tip si Shaqir Fetahu, hajn e i korruptuar, që blenë “dekorata” (bashkë me hanëmingjen e tij!!!) nga “Universiteti i Floridas”, i cili pesë vite rresht e ndihmon hajninë, vjedhjen, korrupsionin, shkatërrimin e një institucioni të shenjtë, çdo urim i tij, është i një snobi, i një manipulanti, i një të bajatshmi! Në çfarë procesi zgjedhor kaloi Shaqir Fetahi që u zgjodh “kryetar”?! Kush e zgjodhi? Kush ia dha Menshurën? T’i thuash ndërkombëtarëve se je “kryetar” i pikur nga qielli, është, thjesht, tallje e një diktatorçiqi të bajatshëm e të kompleksuar deri në gjën!

Shaqir Fetahi ka vjedhur haxhin, Shaqir Fetahi kurrë në jetë të vetë nuk ka qenë me paratë e veta në haxh, prandaj, titullin “haxhi” e ka haram?! Prandaj, nëse mendon se mund të manipulojë me opinionin e brendshëm, mos të harrojë, ndërkombëtarët e kanë të skanuar si një karikaturë qesharake.

*(1Kliklarg, 4.07.2020)*

## **Afrim Tahiri: Postin “reisul ulema” e kanë degraduar deri në kopuk**

Me njërin nga njohësit më të mirë të problemeve të BFI-së në vend, z. Afrim Tahirin, zhvilluam një intervistë lidhur me problemet e fundit në këtë Institucion, sidomos pas ikjes së ish-reisit, Sulejman Rexhepit. Ikja e tij ngeli shumë misterioze, siç po ngelë misterioz edhe arsyetimi i ikjes së tij.

***Z. Afrim Tahiri, botërisht njiheni si një luftëtar i paepur i të vërtetës për BFI-në. Përpjekja e juaj pesëvjeçare për të ngadhnyer e vërteta, rezultoi me shkarkimin e Reis ul Ulemasë! Keni dyshime në këtë shkarkim?***

Absolutisht po! Ky nuk është shkarkim! Këtë e di edhe vetë Sulejman Rexhepi, sepse, shkarkimi është bërë jashtë të gjitha normave të Kushtetutës së BFI-së. Për këtë shkarkim kanë votuar edhe ata që nuk kanë të drejtë në bazë të Kushtetutës aktuale të BFI-së ndaj dhe, as për së afërmi nuk ka qenë i plotë forumi i një Institucioni me fuqinë e shkarkimit. Këtë e di edhe vetë Sulejman Rexhepi, prandaj, sot, në BFI nuk e kemi as të arkivuar, as të protokoluar as të publikuar tekstin e shkarkimit teatral, kurse dy ditë më vonë e kemi të arkivur, të protokoluar dhe të publikuar dorëheqjen e Sulejman Rexhepit? Çka është kjo lojë? Sulejman Rexhepi i nxori nga situata edhe një herë ata që ishin munduar t’ia ngulin thikën pas shpine, sidomos përmes arsyetimit të shkarkimit bazuar në Nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së!

Tani, nëse ngelë shkarkimi sipas Nenit 58, atëherë, që të gjithë bashkëpunëtorët e tij duhet të ecin si Sulejman Rexhepi dhe, në këtë rast do të vinte dikush që do t’ua zbardhte të gjitha aferat antiislame që i kanë kryer sa kanë qenë “unik në rijasetin e tyre”! Me qëllim që, mundësisht, mos të vie dikush tjetër dhe të hulumtojë krime të kryera, gjithnjë duke u bazuar në këtë Nen. Tani, këta “të gjysëm rijasetit” duhet të tregojnë: e larguan Sulejman Rexhepin apo ky dha “dorëheqje”! Sido qoftë, në të dyja rastet duhet të jetë ky përfundim: iku i pari, ikin të gjithë pasuesit e tij!

***Ky “gjysëm rijaset” siç thoni ju, tashmë e ka emëruar në postin e ushtruesit të detyrës, Shaqir Fetain, Myftiun e Gostivarit, i cili, me gjasë nuk po ka kohë të merret me aktivitetet imediate të BFI-së duke pritur e përcjellë mysafirë të ndryshëm që po ia urojnë postin?***

Çka po i urojnë? Cilin post? Kush e zgjodhi në atë post, si erdhi, a i kaloi të gjitha procedurat për të ardhur në atë post. A kështu na u zgjidhëka “reisi”? Jo, ai nuk është naiv, e di fare mirë që krejt kjo është tallje me njerëz por, po provon nëse ngelë në atë post dhe po shpëton edhe vetë!! “Miqte” e tij që ca për hatër, ca nga urdhëri e ca nga lajkat, e vizitojnë por, më të rëndësishmit e vizitojnë për të ditur se çka më tutje! Cili është aktiviteti i tij për të treguar se si ishte dikur e si do të jetë në të ardhshmen. Se si ishte dikur duhet ta shpalosë të kaluarën, ndërsa, si do të jetë në të ardhshmen duhet të ofrojë plaformë e program! Këto jo që nuk i ka por, e di fare mirë që nuk mundet t’i ketë, sepse, nuk i dihet, ai është në rolin e krijimit të komisioneve të nevojshme për kryerjen e të gjitha proceseve që do t’i jepnin fund epokës së Sulejman Rexhepit dhe të Shaqir Fetait bashkë me të manipuluarit e tij. Shaqir Fetai duhet të tregohet i suksesshëm në krijimin e komisioneve, në krehjen e dokumenteve dhe të arkivit të BFI-së, në hartimin e rregulloreve konform Kushtetutës së BFI-së dhe ta përfundojë procesin e zgjedhjeve të Kryetarit, për ç’gjë Kushtetuta aktuale parasheh, në via të trasha, kushte që duhet të plotësohen. Nëse Shaqir Fetai mendon se me aq lehtësi mund ta vjedhë postin e Reisit duke treguar afinitete në shlyerjen e gjurmëve të kimit që i ka kryer, atëherë e ka gabim sepse, nuk do ta

lejojnë nja njëmilion myslimanë të Maqedonisë së Veriut.

### ***Ju po kërcënoni?***

Jo, ndoshta u shpreha shumë sinqerisht! Është një punë kolosale që do të duhet për rikthimin e besimit të myslimanëve të Maqedonisë së Veriut në Institucionin e tyre. Ky besim do të rikthehet me Shaqir Fetait? Po besimi që na duhet nga ndërkombëtarët, si nga bota perëndimore ashtu edhe nga bota arabo-islame! Ka filluar të komunikojë e të manipulojë, duke harruar se ndërkombëtarët e dinë që këtu ka një “opozitë” e cila konsultohet dhe lutet që ta konfirmojë sinqeritetin e “letrave” të Shaqir Fetait! Shaqir Fetai duhet të jetë shumë i pastër, Shaqir Fetai nuk duhet ta ketë mbi kurriz as aferën e “qendrës tregtare” që do ta ndërtonte Banka Islame për Zhvillim e që në fund do të ngelte vakëf i Myftinisë së Gostivarit! Pse ikën prej tij Banka Islame për Zhvillim? Me këtë hipotekë Shaqir Fetai duhet të turpërohet, të rrijë në familjen e vet, e jo në krye të myslimanëve të vendit.

### ***Jeni në gjendje t’i argumentoni këto akuza kaq të rënda?***

Unë u lodha duke kërkuar debate publike! Ja, publikisht po i kërkoj Shaqir Fetait, ku të dojë ai, të dalim dhe të sqarohemi! Kushdo nga BFI-ja, që të gjithë, le të zgjedhin ku të dëshirojnë studion televizive, të dalim e t’i ballafaqojmë argumentet, t’i shpalosim faktet! Myslimanët e vendit e kanë të drejtën e Zotit që të dinë gjithçka që ka ndodhur brenda BFI-së; e kanë të drejtën që të dinë të vërtetën! Të flasim me argumente e dokumenta! Unë, sa kam qenë sekretar gjeneral i BFI-së, me të gjithë këta kam qenë mirë, i kam ndihmuar, kam bashkëpunuar miqësisht dhe shumë ngusht, atëherë, shtroj pyetje publike, pse i shmangen ballafaqimit publik me mua! Nuk ka kurrfarë arsye përveçse frikës nga e vërteta që do t’i “varrosë” që të gjithë!

### ***Po flitet se Shaqir Fetai në këtë post ka ardhur si “argat i Sulejman Rexhepit”, por edhe si i “dëgjueshmi i devotshëm” i Bashkimit Demokratik për Integrim, parti kjo që tashmë është në partneritet të kontrollimit të vakëfit të BFI-së?***

Unë pres që BDI-ja, nëse vazhdon të jetë parti në pushtet, të na e shtojë vakëfin, ta kryej obligimin e vet islam dhe jo ta pengojë, aq më pak ta shfrytëzojë! Nuk do të doja të besoja kurrë se mund të gjenden fakte të tilla që flasin se funksionarë të BDI-së janë bashkëpronarë të vakëfit me BFI-në! Nuk dua ta besoj as atë konstatim se Shaqir Fetai ka ardhur si “argat i Sulejman Rexhepit”. Thjesht, Shaqir Fetai me gjestet e veta po dëshmon për një kompleks shumë të rrezikshëm – karrierë me çdo kusht, qoftë kjo të arrihet edhe duke shkelur mbi fëmijë, mbi bukë e mbi Kuran! Në këtë synim nuk ka ndihmë nga Zoti, o pasha Zotin, jo!

### ***A e shihni veten ju kandidat për Reis të BFI-së?***

Për më tepër që kam luftuar dhe kam investuar shumë mund që e vërteta të triumfojë! A do të konkurroj unë për Reis! Më vjen keq por ky post është degraduar deri në kopukllëk, deri në hajn. Do të insistoj që ky titull të mos përdoret më, pikërisht për shkak të devalvimit të titullit sanksionuar sipas Nenit 58 të Kushtetutës së BFI-së! Reis i ulemasë!!! I cilës ulema, vëllezër! Kush nga ‘ulemate’ reagoi! Tani, i kësaj ulemaje dikush të pranojë të jetë “Reis”!

Këto pesë vite sa unë nuk isha brenda institucionit, jeni dëshmitarë se ku ka degraduar, kjo sikur më shtërngon të rikthehem. Shikoni se ku kanë degraduar imamlerët e hoxhallarët: në inkasanta të cilët duhet të kenë vetëm rolin e mbledhjes së taksave fetare dhe të dorëzimit të pazarxhinjtë që merren me ndarjen e taksave sipas përçindjes! Shikoni se si jemi tallur me postin “myfti”! Bota akademike myslimane nuk na e falë këtë tallje! Publikisht i pyes “myftinjtë” se a e dinë fjalën “myfti”, a e kuptojnë këtë fjalë a jo. A e dini se çka do të thotë ky titull! Turp që bie mbi tërë “ulemanë” nëse ekziston!

Kam vizion se si ta rikthej besimin shekullor ndaj BFI-së dhe secili mysliman ta ndjejë si shtëpi të veten ku mund të gjejë prehje absolute shpirtërore. Nuk dua të keqkuptohem, Kushtetuta e BFI-së ia garanton të drejtën çdo myslimani që të zgjidhet dhe të zgjedhë! Le të urdhërojnë të gjithë le të konkurrojnë, Komisioni do të jetë ai që do të përzgjedhë se kush i plotëson kushtet sipas Kushtetutës dhe sipas Rregullores për zgjedhjen e të parit të BFI-së, rregullore kjo që mungon!

Një gjë dihet, Kushtetuta aktuale fare mirë precizon se kush ka të drejtë të votojë për Kryetar! Jashtë kësaj Kushtetute - çdo gjë tjetër do të jetë manipulim dhe, mos dhëntë Zoti, hasmëri apo vëllavrasje! Askush nuk duhet të provojë që të tallet me këtë Shtëpi të të gjithë myslimanëve të vendit.

### ***Si të zgjidhet, pra, siç thoni ju, i pari i BFI-së dhe të jetë i pranueshëm e legjitim për të gjithë?***

Vetëm sipas Kushtetutës aktuale, të asaj Kushtetute të deponuar në organet e drejtësisë së shtetit dhe jo sipas Kushtetutës si rezultat i përpjekjeve të matrapazëve për të manipuluar zgjedhjet! Duhet urgjentisht të formohet sidomos një Komision për hartimin e Rregullores për zgjedhje të kryetarit të BFI-së, e cila duhet të bazohet në Kushtetutën aktuale të BFI-së! Hapet konkursi, konkurrojnë të interesuarit dhe, pas analizimit të programeve dhe synimeve të kandidatëve, bëhet zgjedhja nga anëtarët aktualë të Rijasetit. Nënvizoj – vetëm nga anëtarët aktualë dhe jo nga ata që vetëm mund të jenë problemi dhe jo zgjidhja! Jashtë asaj që parasheh Kushtetuta e BFI-së do të jetë lojë e zgjatur e armiqve të BFI-së dhe të islamit në vend!

***(Fol, 5.07.2020)***



## **Shaqir Fetait i duhet mish kurbanit apo para kurbanit?!**

**Shaqir Fetai mendon se sinqeriteti dhe devotshmëria shprehen përmes një pamje femnore të fotografisë së maturës, apo të fotos së librezës shëndetësore dhe se, me këtë pamje idiotike marrin fund të gjitha të bëmat e tij kriminale, merr fund sponsorisimi i krimit, përkrahja e krimit si dhe duartrokitja e krimit në BFI**

**Nga Jasir Jashari**

Shaqir Fetai që të tallet me opinionin, t'i thërrasë që të gjithë në përkrahjen e tij në stilin e “jevgut gjakovar”: u bo çka u bo, ta harrojmë e të afrohemë se jemi tanët!

Nën këtë inercion amoral të shpirtit të tij, ai shpall çmimin e kurbanit të sivjemë dhe apelon te të gjithë myslimanët e vendit që kurbanin, qoftë si kafshë, qofshë në para, ta donojnë për Medresenë Isa Beu, në Shkup si dhe për paralelet e saj të dispersuara në disa qendra në RMV!

Apatën Kurban Bajram myslimanët e Maqedonisë së Veriut në vitin 2018? Po në vitin 2019? Natyrisht që patën dhe, janë paguar në Bashkësinë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut me mijëra kurbanë (nga 120 euro) kurse janë dhuruar edhe qindra kurbanë qoftë në kafshë të imëta qoftë në kafshë të mëdha!

Po kështu, i njëjti ritual është kryer edhe me rastin e Kurban Bajramit të vitit 2019, siç është kjo praktikë që kur është ndërtuar kjo vatër arsimore islame në vend.

Por, Shaqir Fetai, si myfti i Gostivarit, si anëtarë i ish-Rijasetit, a mund të na betohet në Zot e në Kuran se që të gjitha ato kafshë janë blerë e janë therrur dhe se tërë mishi është shpërndarë te fukarat dhe është ruajtur për nevoja të nxënësve të Medresesë? Duhet të betohet pa problem, sepse është dashur të kërkojë raporte vjetore, qoftë edhe raport ekskluzivisht për kurbanë, sepse kjo është praktikë e domosdoshme, ndryshe, për çdo kriminalizim të kurbanit bëhesh palë me kriminelin!

Tërë bota e di, siç e di edhe ish-Rijaseti si dhe vetë Shaqir Fetai se, një numër i konsiderueshëm i kurbanëve për vitin 2018 është therrur dhe pak mish është shpërndarë për të varfër, më shumë për “gazetarë” që, si çdo vit, edhe atë vit, ka përfunduar vetëm në një friz të një “gazetari”! Tërë bota e di, siç e di edhe ish-Rijaseti, pra edhe Shaqir Fetai se, atë vit guzhina e Medresesë nuk ka funksionuar për shkak të renovimeve. Atëherë, le të na thotë Shaqir Fetai se çka ndodhi me mishin e kurbanit!

Po ku ngeli mishi i kurbanit të vitit 2019! Suma-sumarum, mishi i kurbanëve që nuk u shpenzua në guzhinën e Medresesë duhet akoma të jetë i magazinuar dhe duhet të jetë me bollëk, madje edhe të shpërndahet për të varfërit anekënd vendit. Apo, nuk gjendet asnjë copë për ilaç, sepse as nuk u blenë kurbanët dhe as nuk u therrën! Këtë duhet ta dijë Shaqir Fetai!

Nëse nuk është kështu, nëse ka mish, atëherë, pse Shaqir Fetai (u.d. kryetar dhe jo “kryetari u.d. reisi”) ky manipulant provincial dhe gënjeshtar i pafytyrë, apelon te myslimanët e vendit që të bëjnë pagesën e kurbanëve në BFI për Medresantët? Shaqir Fetai nëse do mish kurbanit, duhet ta ketë atë

me bollëk!

Le të tregojë se ku mbetën kurbanët e viteve paraprake që të ketë me bollëk kurbanë për sivjet. Ndryshe, fajin le ta kërkon te vetvetja!

*(Mileniumi3, 8.07.2020)*

## **Me zullumqarë, me rezila e me hajna të BFI-së nuk fitohet “kryeministri” shqiptar**

**Na ishte një traditë që, qoftë edhe formalisht, siguronte një “non paper” të nënshkruar nga liderët fetar se, gjatë zgjedhjeve, pavarësisht nëse kanë qenë lokale apo parlamentare, institucionet fetare nuk do të lejojnë që të bëhen pjesë e fushatave partiake. Kësisoj, deklarorin se do ta ruajnë autonominë e plotë të institucionit fetar dhe se nuk do të përzihen dhe nuk do të pozicionohen si institucione fetare në krah të partive politike nacionale apo edhe qytetare**

### **Shkruan Mr. Eset Shaqiri**

Bota demokratike, partitë me taban demokratik e qytetar, Institucionet fetare i konceptojnë si “shtëpi të shenjta”, të cilat nuk bën dhe nuk guxon të përdhosen nga asnjë subjekt politik. Në momentin kur do të ndodhë kjo, atëherë do të kemi celula ekstremiste me vizione politike-radikaliste të cilat mund ta rrezikojnë demokracinë si fjalë e fundit e mirëqenies dhe kulturës së shoqërisë së shëndoshë.

Së këndejmi, që nga pluralizmi politik në vend e këndeje, pothuajse në të gjitha zgjedhjet politike, partitë e vendit kanë insistuar që nga liderët fetar të ketë një kodeks të nënshkruar sipas të cilit komunitetet fetare do të rrinin larg e më larg fushatave politike, agjitimeve dhe bashkëpunimeve me partitë politike.

Sot, në krye të BFI-së nuk gjendet më Sulejman Rexhepi, ai u eliminua me marifete partiake dhe në vend të tij “e vunë një edhe dhjetë herë më BDI se të gjithë BDI-stat, Shaqir Fetain”! – siç u shpreh një kryetar i njëres nga partitë shqiptare të vendit.

Shaqir Fetai u dëshmuar se është karrierist i verbuar, se është i dhënur deri në çmendi pas postit “kryetar”, se si provincialist është i zhveshur tërësisht nga dinjiteti dhe nga morali njerëzor, vetëm e vetëm që ta ketë të garantuar këtë post, qoftë edhe për nja dy-tre muaj! Këtë sëmundje ia kanë kuptuar këta të BDI-së së sëmure kësj radhe deri në gjuhëzim politik, ndaj dhe e kanë caktuar si patericë partiake, duke shpresuar se, sado pak, do të arrijë të mbajë në këmbë ndonjë degë a nëndegë nëpër territore të myftinive të caktuar!

Disa “myfti ilegjitim”, të cilët ligji dhe aktet normative të BFI-së i njohin vetëm si koordinatorë të myftinive të caktuar (!!!), duke pritur garanci ligjore për shkak të manipulimeve në “emërtime profesionale”, janë lëshuar haptazi nëpër fushata partiake të Bashkimit Demokratik për Integrim.

Myftiu ilegjitim i Shtipit, i cili këtë territor nuk e viziton me muaj, madje as për Ramazan, kësaj radhe është në terren dhe kërkon prej hoxhallarëve të shpërndajnë materiale propagandistike të BDI-së nëpër xhematet e tyre, ndryshe, i kërcënohet me largim nga puna! Po kështu veprojnë edhe të delegjitimuarit dhe të ashtuquajturit Myftiu i Strugës, ai i Ohrit, i Manastirit, i Prilepit, i Velesit etj.

Që nga Shaqir Fetai, e deri te i fundit, që të gjithë janë të njohur dhe me “myhyr në ballë” si bashkëvjedhës dhe bashkëthuhajësues të vakëfit, janë të njohur si bashkëshitës të vizave të haxhit dhe të kurbanëve! Tani, BDI-ja pret që të zgjedhë “kryeministër” shqiptar me këta hajna e me këta zullumqarë, të cilëve, si kundërshtëpërlim u ka garantuar siguri ligjore! Nuk ka Ali Ahmet në botë që mund t’ia garantojë Shaqir Fetait postin e kryetarit të BFI-së si dhe të tjerëve zhveshjen nga

epiteti i njerëzve të kriminalizuar. Fuqia e popullatës myslimane kundër këtyre synimeve antiislame e antishqiptare është e barasvlefshme sa fuqia atomike. Kështu që, përzierja e BDI-së në BFI (por edhe e partive të tjera) si dhe dorëzimi i autoritetit dhe autonomisë së BFI-së në duar të BDI- së është gjesti më fatal që mund t'i ndodhë kësaj shoqërie dhe këtij shteti!

“Një shoqëri për të gjithë” do të thotë të drejta dhe mirëqenie shtetërore për të gjithë, por edhe obligime dhe detyrime shoqërore për shtetin. Ky do të ishte një shtet i së drejtës i cili do të funksiononte drejtë për të gjithë e jo sipas tekeve të honxho- bonxhove dhe dallkaukëve.

BFI-ja duhet të jetë apolitike dhe nuk guxon të pozicionohet në prehëra partiake. Partitë politike duhet të dridhen para autoritetit të BFI-së, të cilin, mjerisht, e kriminalizoi duke e dhënë për fajde. Dihet se cili është definicioni islam për fajdexhinjtë, për këta pazaxhinjë të autoritetit të Institucionit shekullor islam në RMV!

*(Fokusi, 10.07.2020)*

## Një këshillë urdhërore për Shaqir Fetain

**Shaqir Fetait nuk i ka hije që ta mohojë një ushtri të tërë teologësh që shkruajnë me emër e mbiemër për të bëmat e tij. Nëse ka ndonjë që shkruan me pseudonim, ai me siguri konsideron se Shaqir Fetai është cikërrimë për t'i dalë me emër e për të zhvilluar me të debat. Por ka nga ata që e thërassin për debat por ai fshihet në ...**

**Nga Mulla Nazmi Jashari**

O njeri me titull e post të pamenduar për ty e të uzurpuar nga ti e soji yt! Iu paske drejtuar me një “këshillë” të gjithë atyreve që shkruajnë me “emër të menduar”! Ndoshta ke dashur të thuash me “emër të rremë”, ë! Po unë, po nja dhjetra të tjerë autorë, me emër e me fotografi– të gjithë të dukemi të menduar? Apo nuk na njeh neve meqë edhe ne nuk të njohim ty. Jo, ty të njohim mirë e mirë, t'i dimë të gjitha të bëmat prej mynafiku dhe hipokriti, ta dimë tërë pjesëmarrjen tënde në kriminalizim të BFI-së, por, nuk të njohim ty si të denjë për t'u marrur me reforma të BFI-së, sepse je bashkëpjesëmarrës në shkatërrimin e BFI-së!

E di se çfarë mendon ti me reforma në BFI?! Vetëm shlyerjen e gjurmëve të krimit e të kriminalizimit që janë bërë në këtë Institucion plotë pesë vite me rradhë deri sa ka munguar “i zoti i shtëpisë”! Madje edhe caktimi yt i përkohshëm në këtë post është i kriminalizuar. Forma e caktimit është tipike e piratëve, e cubave, e narkomafisë... Shlyerjen e gjurmëve të krimit dhe kursimin e të gjithë kriminelëve në BFI-në aktuale ti na e prezanton si “durim”, për të vazhduar se, kjo na qenka “maturi për të mos gabuar, strategji për të zhvilluar proceset ngadalë, por sigurt dhe me pjekuri...”! Ti ke gabuar tashmë Shaqir Fetai, ti je rob i strategjisë së shkatërrimit të BFI-së, me vetë faktin që the se duhet të zhvillohen proceset ngadalë! Sa ngadalë? Për aq kohë derisa t'i shlyesh krimet që janë bërë në BFI në kohën kur ke qenë edhe ti anëtarë rijaseti? Ti mendon se je i pjekur për të zhvilluar reforma? Reformat nuk bëhen pa i dedektuar të gjitha dëmet e shkaktuara. Ti nuk ke as kapacitet, as forcë, as besim as dije për t'i dedektuar ato krime. Mbi të gjitha, t'i ke frikë për ta bërë një gjë të tillë. Prandaj, ec, ec, sa më shpejt se askush nuk ka kohë për të pritur deri sa të ndërgegjësohesh ti!

Me sa di opinioni i gjërë, ty edhe drejtuesi i Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI, H. Afrim Tahiri, publikisht të ka kërkuar debat që t'i kryqëzoni faktet dhe argumentat, të të bindë se nuk je i denjë as për emrin tënd mysliman! Po Afrim Tahiri, edhe ky të duket person me “emër të menduar”, apo të duket lubi para të cilit nuk je më i gatshëm të raportoshë duke nusëruar çdo muaj, për aktivitetet islame mujore!

Pra, ti nuk je as për debate, as për zhvillim të proceseve as për raportim nusërie të përmuajshëm, as nuk je për aktivitete islame thjesht, je i caktuar për shlyerje të gjurmëve të krimit, zhdukje të fakteve e argumentave që flasin për shitje e vjedhje të vakëfit, të fitrit, zeqatit, kurbanëve, haxhit.

*(Fol, 20.07.2020)*

## Dergja e rëndë e ka zënë Shaqir Fetain

**Si nuk i vjen turp Shaqir Fetait prej fëmijëve të vet, prej nipërve, prej farefisit të gjërë?! Të gjithë e dinë se ai u caktua si ushtrues detyre në krye të BFI-së deri në zgjedhjen e reisit të ri. Shaqir Fetai po prezantohet si “kryetar” dhe këtë po e bën fakt të kryer! Çdo lloj vjedhje është haram. Madje edhe posti i vjedhur është haram. A mund të urohët harami?**

**Nga Jasir Jashari**

Nuk ngeli shqiptar në botë që nuk u befasua nga largimi i Sulejman Rexhepit nga Bashkësia Fetare Islame në RMV. Tani, dikush po përpiket të manipulojë me këtë befasi. Po tenton që ta vjedhë këtë befasi dhe ta përkthejë si gëzim i myslimanëve për Shaqir Fetain që u caktua të udhëheqë me BFI-në? Nuk rriten kualitetet dhe cilësitë e njeriut përmes urimeve, aq më pak përmes urimeve në punët haram! Nuk është vepër e teologut, nuk është vepër e hoxhës, nuk është vepër e myslimanit të devotshëm vjedhja qoftë edhe e vetëm një fare të lulediellit!

Të urohesh për një gjë të vjedhur është moment shumë i vështirë, shumë i turpshëm, i mëkatshëm, sepse, paraprakisht duhet të gënjeshtë! Duhet ta gënjeshtë tërë botën se je zgjedhur kryetar e reis që pastaj të të vijnë urimet!

Kush e zgjodhi Kryetar Shaqir Fetain! Si u zgjodh Shaqir Fetai, në çfarë procedure zgjedhore kaloi Shaqir Fetai. Fare në fund, kur u bë zgjedhja e tij, në cilën ditë u votua, në cilën ditë ia kaloi programin komisioni zgjedhor i BFI-së. Kush ia dha Menshurën, në cilën xhami u krye kjo ceremoni? Kjo vjedhje e postit në këtë mënyrë nuk ishte cilësi e Sulejman Rexhepit i cili u shkarkua me Nenin 58 të Kushtetutës!

Kjo praktikë e Shaqir Fetait duhet të marrë sa më shpejt fund, sa më parë duhet të formohen komisionet e nevojshme dhe të nisë procedura e zgjedhjes së reisit. Le të zgjidhet kush të dojë, le t’ju gëzohet të gjitha urimeve dhe përsëndetjeve. Edhe për myslimanët duhet të jetë ditë gëzimi, ditë feste, sepse zgjedhja do të jetë legalisht, në mënyrë legjitime, me vota, me procedurë sipas rregullores zgjedhore. Kështu, siç “u zgjodh” Shaqir Fetai, në çdo moment, në çdo ditë, në çdo orë mund të ndodhë një “rizgjedhje” tjetër. Të dalë një grup kriminelësh, t’i kidnapojë myftinjtë veç e veç, t’ua kërkojë nënshkrimin dhe vulën në “deklaratën” ku shkarkohet Shaqir Fetai dhe përkohësisht caktohet të udhëheqë me BFI-në, për shembull, Stevo Bozharski!

Kjo përpjekje e Shaqir Fetait për ta mbjellë këtë praktikë në BFI është jashtëzakonisht e rrezikshme, është hapja e dyerve të së keqes në BFI dhe marrja fund e këtij Institucioni. Nëse ky është misioni i Shaqir Fetait, atëherë, myslimanët e vendit do t’ia caktojnë fundin edhe më të zi sesa ia caktoi ky Sulejman Rexhepit.

Shaqir Fetai për momentin duhet ta ketë misionin e zbardhjes të të gjitha të këqiave dhe haremeve që ndodhën në BFI, pavarësisht se në të gjitha mund të jetë i përfshirë edhe vetë ai. Shaqir Fetai duhet të tregojë se çka është bërë me kurbanat e viteve të fundit? A janë therrur a jo, ku përfunduan paratë e kurbanëve të myslimanëve që kanë paguar nëpër organet e BFI-së. Mish Kurbanit nuk është shpërndarë te të varfërit, mishi i kurbanëve të këtyre viteve nuk është shpenzuar në guzhinën e Medresesë! Ky mish duhet të jetë i magazinuar! Atëherë pse kërkon të paguhen kurbanët për Medrese, kur hala nuk

është shpenzuar mishi i dy viteve të fundit! Nëse u.d. kryetari i BFI-së nuk ka guximin ta bëj këtë, atëherë me të drejtë thuhet se i ketille nuk i duhet BFI-së! Ec Shaqir Fetai, ec sa më shpejt. Ik! Ik e mos e turpëro edhe familjen! Mos u bëj mashë e huaj!

*(Tetovasot, 21.07.2020)*

## **“Alimi” i turpëruar nuk flet, ai vdes duke qarë nga turpi**

**Një prej hoxhallarëve më të respektuar në vend, Mulla Nazmi Jashari, përmes një shkrimi shumë dashamirës, me titull “Një këshillë urdhërore për Shaqir Fetain”, i ishte përgjigjur një “këshillë” të Shaqir Fetait që e kishte përfunduar si mos më keq**

### **Shkruan Shaban Aziri**

Shaqir Fetai, përmes kësaj “këshillë” që ua nisë individëve me “emër të menduar” kishte përcjellë edhe një porosi: mos më ngacmoni se “çdo ngutje mund të jetë me pasoja të rënda. Kjo më pak i duhet sot Organizatës së madhe BFI e RMV. Në veçanti kur proceset t’i besojnë bartësit e jetës fetare”!

Në këtë “porosi” Shaqir Fetai na bën me dije se nuk ka ndërmend të ngutet, sepse gjithçka në BFI është në rregull: nuk ka as pasoja të vjedhjeve, as pasoja të shkatërrimit të raporteve ndërnjerëzore, as degradim të kësaj Organizate deri në bastore të rëndomtë, as pasoja të shkatërrimit të vakëfit, as pasoja të humbjes së besimit të qytetarëve myslimanë! Sepse, sipas Shaqir Fetait, ngutia nuk i duhet një Organizate të madhe si BFI e RMV-së! Që kur e konstatoi këtë të vërtetë Shaqir Fetai! Nëse e ka ditur edhe më parë se kjo Organizatë është e madhe, atëherë shtrohet pyetja se, pse duroi më shumë se pesë vite, madje pse e ndihmoi dhe ia dha përkrahjen ish Reisit! Apo, nëse e ka konstatuar tani, që kur e uzurpoi kolltukun e kryetarit të BFI-së, atëherë, pse nuk i ngutet, pse mendon se duhet të ketë durim në zbardhjen e të gjitha vjedhjeve, shkatërtimeve, imoraliteteve që kanë ndodhur për këto pesë vite e në të cilat protagonist më vete është edhe Shaqir Fetai.

Dhe, porosia e Shaqir Fetait përfundon me një tmerr, me një miopi legjendare, përfundon me një turp të cilën nuk e kuptojnë vetëm ata që e kanë humbur turpin që në djep!

Si guxon Shaqir Fetai ta gënjejë veten dhe, për më tepër, si guxon ta gënjejë opinionin e gjërë, dhe thotë se dikush atij ia paska besuar proceset (cilat procese?!), madje, këta procese ia paskan besuar “bartësit e jetës fetare islame”!!!

Kush janë ata që guxojnë të mendojnë se janë bartës të jetës fetare sidomos përderisa janë të bindur se janë prodhim me prejardhje “made in Sulejman Rexhepi”! Madje është fakt i pamohueshëm se “bartës të jetës fetare” i ka emëruar vetë Sulejman Rexhepi! Të gjithë këta sahanëlëpirës, të cilët Shaqir Fetai u thotë se janë “bartës të jetës fetare” e kanë degraduar jetën fetare deri në turpësinë më të thellë. Në mesin e këtyre “bartësve të jetës së turpët” ka qenë edhe vetë Shaqir Fetai!

Shaqir Fetain e caktuan argatët e politikës në një detyrë që nuk është asgjë tjetër përveçse roli i pastruesit të mëkateve të mëdha që i bënë për këtë gjysëm dekadë.

Vjedhësit dhe shitësit e vakëfit, falësit, përvetësuesit dhe tëhuajësuesit e vakëfit, zinaxhinjtë, demagogët, injorantët, mohuesit e porosive të shenjta kuranore, këta janë ata “bartës të jetës fetare” që ia kanë besuar proceset Shaqir Fetait, të cilit i duhet durim dhe kohë, deri sa t’i rehabilitojë të gjithë. Po faktet, dokumentat, argumentat e pamohueshme çka thonë? Shaqir Fetai është futur në një qorrsoak prej nga do të dalë edhe më i turpëruar, sepse proceset ka vendosur t’i shtyjë te para me bastardë! Ato procese u kanë hije vetëm hajnave dhe të pamoralshmeve.



Shaqir Fetaj mendon se sa më shumë të shtyhen proceset, sa më shumë durim, sa më shumë kohë, aq më lehtë do të shlyhen gjurmët e tij që mund t'i përkasin vetëm një kriminelit e asesi një "alimi" siç e pretendon veten ai!

*(Botasot, 27. 07.2020)*

## Kur gënjenë “ulemaja”

Gënjeshtër është nëna e të gjitha të këqive

si dhe njerë e mëkatit (proverbë arabe)

### *Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI*

Kur ulemaja gënjenë e futë në dalalet një dynja të tërë! Por, pse të gënjejë ulemaja? Cili është motivi kryesor që të gënjejë ulemaja? Ulemaja gënjenë vetëm kur përpiqet të shpëlahet nga mëkatet e mëdha! Nëse nuk sinjalizohet dhe nuk zbardhet fuqishëm gënjeshtër e ulemasë, atëherë tërë “bota laike”, personalitetet akademikë, diplomatët, liderët, parijs politike e fetare, dalin të jenë injorantë! Sepse, në parim, alemit e ka shumë të qartë se, gjithçka çka thuhet nga “ulemaja” është në përputhje me Kuranin dhe, kjo, apriori, e besueshme, e pranueshme dhe e përfunduar!

Së këndejmi, këtu mund të kërkohet dëshira kaq e flaktë e “ulemasë” së BFI-së për të gënjer. Një ditë do të bëhen all nga turpi, të cilën do ta përkthejnë si injorancë të tyre, sa për ta “larguar” nga vetja mëkatin e qëllimshëm.

“Ulemasë” i bëhet me dije që të pushojnë së gënjeri botën, sepse:

Shaqir Fetai nuk është i zgjedhur në asnjë post përveçse në atë të myftiut të Gostivarit;

Shaqir Fetai nuk është “kryetar i BFI-së”;

Shaqir Fetai nuk është “reisul ulema i BFI-së”;

Shaqir Fetai nuk është “u.d. reisul ulema i BFI-së”

Shaqir Fetai, nga shkarkuesit e Sulejman Rexhepit, është caktuar që t’i përgatisë zgjedhjet e reja për Kryetar të BFI-së, i cili duhet të ndodhë në një afat sa më të shkurtër!

Kush i mohon këto të vërteta dhe e informon ndryshe botën, ai është gënjeshtar, ndërsa “ulemaja” e pranon se është e krijuar dhe shumë e lumtur në shkeljet e veta që ia bën Kushtetutës së BFI-së!

Shaqir Fetai, me qindra dallavera, mezi ka arritur të regjistrohet në Regjistrin Qendror si “u.d. Kryetar i BFI-së – reisul ulema Shaqir Fetai”! Deri në të tjera rrethana e kushte, kështu duhet të prezantohet dhe të thirret Shaqir Fetai, myftiu legjitim i Gostivarit, dhe jo ta përfundojmë punën e zgjedhjes së “reisit” pa dhënë llogari askush për krimin dhe për kriminalizimin e BFI-së madje edhe nga vetë Shaqir Fetai nga posti i myftiut të Gostivarit.

Prezantimi rrejshëm është i sanksionueshëm me ligj, kurse përhapësit e lajmeve të rreme mund të paditen si fallsifikatorë.

Së këndejmi, Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI, e merr mbi vete që ta drejtinformojë “Imamin e Madh”, Shejhul Ez’heri, prof. dr. Ahmed Tajjib, (si dhe personalitetet e tjera të botës turko-arabe) i cili, nisur nga rrenat e “ulemasë së BFI- së”, bën një gafë e cila nuk i bën nder.

Nisur nga kjo rrenë, “Imami i Madh” e shpreh këtë urim për Shaqir Fetain: “I drejtohem zotërisë suaj

me urimet më të mira me rastin e përzgjedhjes suaj Kryetar i Bashkësisë Islame në Republikën e Maqedonisë së Veriut.”!!!

Kur u përzgjedhe Shaqir Fetai kryetar i BFI-së?!

Cili mysliman në Maqedoninë e Veriut i mbanë në mend proceset, procedurat dhe çastet e zgjedhjes së Shaqir Fetait për “kryetar të BFI-së”?!

**NUK KA ZGJEDHJE NË BASHKËSINË FETARE ISLAME TË MAQEDONISË SË VERIUT PA U ZBARDHUR TË GJITHA KRIMET DHE STRATEGJITË PËR KRIMINALIZIMIN E BFI-së!**

Le të jetë ky si një paralajmërim për institucionet e vendit dhe të atyreve ndërkombëtare që të jenë të vëmendshëm dhe të mos manipulohen nga gënjeshtarët dhe karrieristët verbuar që akoma vegjetojnë në BFI.

***(Botasot, 30.07.2020)***

## Kush po e legalizon radikalizmin dhe kriminalitetin në BFI

**Çdo gjë e jashtëligjshme që imponohet në emër të fesë është radikalizëm dhe kur radikalizmi bëhet i ligjshëm krijohet terreni për “terrorizëm fetar”! Nga prizmi i të drejtës penale kjo sjellje do të trajtohej si kriminalitet. Kjo është situata aktuale në BFI dhe, dikush po mundohet ta legalizojë tërë këtë krim**

**Nga Andi Rakipi**

A ka të drejtë që një grup individësh të cilët, pasi të sigurojnë përkrahje politike e ligjore, ose, nën presionin e shantazheve policeske, pasi të ndërmarrin veprimin e porositur, të depërtojnë në një institucion në emër të zgjidhjes së problemeve, ndërsa të etablohen si të përhershëm mbi ato probleme që i kanë shkaktuar vetë? Ose, çohet një grup kriminelësh, të cilët e kanë ndihmuar kriminalizimin dhe vjedhjen e BFI-së dhe, pas zhgënjimeve të tyre, e shkarkojnë ish-reisin dhe e caktojnë nxënësin e tij më besnik që t’i prijë Institucionit derisa të kryhen zgjedhjet për Kryetar të BFI-së. Pra, e caktojnë Shaqir Fetain si u.d. të kryetarit të BFI-së deri sa të zgjedhet zyrtarisht një kryetar i ri.

Megjithatë, Shaqir Fetait po ia ka anda që të quhet kryetar dhe reisul ulema i BFI-së. Pra, tashmë ky mjeran po e bën këtë punë të kryer dhe faktike! Uzurpimi i një institucioni fetar në këtë mënyrë është formë e radikalizmit dhe terrorizmit fetar. Ndaj, askush nga institucionet e vendit dhe ata ndërkombëtarë nuk guxon që ta pranojë këtë zgjidhje të problemeve në BFI, sepse do të llogariten si përkrahës të terrorizmit, radikalizmit dhe kriminalizimit të BFI-së. Krimineli në asnjë vend në botë nuk mund të merret e të trajtohet si zgjidhje e problemit! Shaqir Fetai, tashmë ka hetuar që ka gabuar rëndë, prandaj herë imponohet dhunshëm e në mënyrë të kriminalizuar si kryetar e herë si reisul ulema. Ai nuk është asgjë tjetër përveç si u.d. që duhet ta përgatisë protokolin e zgjedhjes së kryetarit të ri dhe, me këtë e ka djegur edhe mundësinë e konkurrimit të vet, sepse do të paraqiste konflikt interesi. Ai do të duhet të tërhiqet në postin e vet zyrtar e legal, myfti i Myftinisë së Gostivarit dhe, aty të priste kontrollin e organeve të reja e legjitime të BFI-së për ta siguruar pafajësinë në vjedhjen e buxhetit të BFI-së, në shitjen dhe vjedhjen e vakëfit si dhe në kriminalizimin e BFI-së.

Kjo që po i futë në huti institucionet ndërkombëtare të cilët duke mos i njohur mirë problemet e BFI-së po gënjehen e po manipulohen me tashme zgjidhje definitive të problemeve të BFI-së, paraqet tjetër vepër shtesë penale të Shaqir Fetait. Duke insistuar që me çdo kusht të ngelë përherë në atë post që po e pretendon, në fakt Shaqir Fetai po insiston që të mbyllet dhe të harrohet përjetë periudha e tij kur ka qenë puthadoras e sahanëlëpirës më besnik i Sulejman Rexhepit. “Me një të rame, dy të vrame”!

Shaqir Fetai si u.d. kryetar, duhet të ngelë në kujtesë si organizator i denjë e i shpejtë në organizimin perfekt të zgjedhjes së kryetarit legal e legjitim të BFI-së. Si reisul ulema, nëse ia do b... le të mbetet por, shumë shpejt mund të organizohen qindra imamë e t’i shprehen se nuk janë aq naivë që ta pranojnë një injorant për reis, aq më pak një shkelës të Kushtetutës dhe akteve juridike të BFI-së, duke e instaluar dhe zyrtarizuar dhunën dhe banditizmin në këtë Institucion.

Ndërkombëtarët kurrë nuk i drejtohen një personi pa ia ditur titullin, të cilin e sigurojnë nga “kabineti” i tij. Ata edhe mund të gënjehen por, kur e vërteta do të dalë në shesh, aty merr fund ai person për

institucionet ndërkombëtare. Fatmirësisht, e vërteta del çdo herë, sado që mund të vonojë.

Kush mund ta mohojë apo ta zhdukë të vërtetën se Shaqir Fetaj ka qenë bashkëpunëtori më i ngushtë dhe më besniku i Sulejman Rexhepit?

*(1Kliklart, 2.08.2020)*

## Me suksese të trilluara nuk shpëlahemi nga mëkatet

**Pse ka nevojë grupi i kryebanditit, Shaqir Fetai, për të gënjyer e trilluar aq shumë? Sepse mendojnë se, duke gënjyer e duke shpifur, duke trilluar e duke fantazuar, më lehtë mund të shpëlahen nga mëkatet**

**Nga Haxhi Isa Xhaviti**

“Nën organizimin e Kryetarit të BFI-së, Reisul Ulema, H. Hfz. Ef. Shaqir Fetai dhe Komisionit Qendror të Kurbanëve...” së bashku me të gjithë myftinitë paskan arritur që të shpërndajnë 50 ton mish kurban, tonelatë kjo që i paska tejkaluar të gjitha pritshmëritë e grupit banditesk të Shaqir Fetait.

**1.**

Tashmë u tha dhe u verifikua se Shaqir Fetai nuk është kurrfarë kryetari e kurrfarë reisi, por, bandit i thjeshtë i cili me dhunë shkelë të gjitha aktet normative të BFI-së dhe përpiqet të kap një pozicion prej nga më së miri e më së lehti mund t’i mbulojë gjurmët e banditizmit që i kreu me decenie në BFI.

**2.**

Shaqir Fetai, i sëmurë nga Koronavirusi nuk mund të jetë as organizator e as kordinator, por, thjesht, një pacient i cili në kushte shtëpie po mundohet ta tejkalojë këtë hall (këtë vërejtje nga Zoti Fuqiptotë) dhe të shërohet sa më shpejt.

**3.**

Çka është ky farë “Komisioni Qendror i Kurbanëve”? Kurbanët, pra lopët dhe dhentë, kafshët e blerë për t’u therrur paskan “Komision Qendror”!!! BFI-ja duhet të ketë komision qendror që vendos për çmimin e kurbanëve, komision qendror për mbikëqyrjen e therrjes së kurbanëve, komision qendror për caktimin e frigoriferëve e magazeve, frigoriferë ku do të ruhet mishit për nevojat e nxënësve të Medresesë, komision qendror për paketimin e mishit të ndarë për humanitet, komision qendror për kontrollimin e listave për shpërndarje të mishit në tërë territorin, komision qendror për shpërndarje dhe mbikëqyrje të këtij aksioni etj. Dhe, mbi të gjitha këta komisione duhet të jetë ai Komisioni Qendror i cili para Rijasetit do të raportonte mbi ecurinë e tërë aksionit. Kështu siç kanë filluar të raportojnë nëpër media akoma pa u përgatitur raporti, ashiqare po shihet se po rrejnë dhe se po përgatiten për vjedhje e grabitje të madhe edhe sivjet!

**4.**

Me suksese të trilluara dhe me përpjekje për ta përmirësuar imazhin e haramit me të cilën u shpërfaqën për plotë 6 vite me radhë, nuk do të mund të amnistohen nga nevoja imediate për të raportuar për ato vite kur i vodhën vakëfet, aksionet fetare si dhe kur e degraduan Institucionin fetar si dhe jetën fetare në çaste përfitimi përmes vjedhjes kolektivisht!

## 5.

Në lajmin paraprak thonë se në territorin e Myftinisë së Shkupit paskan shpërndarë 800 pako mish kurbani. Le të jenë këto pako nga 5 kg mish, do me thënë gjithësej 4 ton! Një ditë tjetër thonë se në këtë territor shpërndanë 15 ton mish. Tani, kush po gënjen, komisioni i Myftinisë apo “komisioni qendror”? 15 ton mish i paketuar në pako nga 5 kg do të duhej të paketohej në 3000 pako! Mendojnë se aq lehtë mund të besojë dikush se në territorin e Shkupit u shpërndanë 3000 pako me mish?!

## 6.

Gjithësej, në mbarë vendin, sipas “komisionit Qendror të Kurbanëve” (vetëm në BFI kafshët mund të kenë Komision Qendror”, qenkan shpërndarë mbi 50 ton apo mbi 50.000 kg mish kurbani? Do me thënë se qenkan therrur për aktivitete humanitare mbi 250 kafshë të mëdha, ose, mbi 1750 kafshë të imëta! Sa për informim të “Rijasetit” të Shaqos, ky numër kurbanësh të cilin e paraqitni ju, është tre herë më i vogël se numri i vitit të kaluar nën organizimin e Sulejman Rexhepit.

## 7.

Askush nuk po i pranon këta banditë, madje as kryebanditin e tyre Shaqir Fetain, të cilit, madje edhe më me vrull po i shahet fytyra dhe gjithçka tjetër që shkon me fytyrë.

## 8.

Për t’u shpërndarë 50 ton mish, apo 50 mij kg, në pako me nga 5 kg, do të duheshin të katën 10 mijë pako.

## 9

Sipas “Komisionit Qendror të Kurbanëve”, vetëm në Myftininë e Kumanovës qenkan shpërndarë 7 ton mish, kurse, në Kërçovë, Strugë, Ohër dhe Dibër qenkan shpërndarë gjithësej 7 tonë mish! Po për myslimanët dhe të varfërit e Manastirit, Prilepit e Shtipit nuk pat mish kurbani?!

## 10.

Mos të harrojmë të nënvizojmë edhe faktin se, tërë ky mish i shpërndarë për humanitet, është teprica

nga ajo që fillimisht është magazinuar për nevojat e Medresesë “Isa Beu”! Po çka u bë me mishin e magazinuar dy vite radhazi e që nuk u hëngër asnjë gram meqë Medreseja dhe guzhina e saj nuk funksionoi! Për këtë asgjë nuk u tha!

## 11.

Në bazë të statistikave, mbi 90 për qind e diasporës sonë kurbanët i kanë paguar në BIK, në Bashkësinë Islame të Malit të Zi, si dhe, në mos e gjitha diaspora, kanë paguar në xhirollogaritë e shoqatave të ndryshme.

## 12.

Kurbani paguhet nga myslimanët e vendit për nevojat e Medresesë dhe pjesa tjetër dhurohet për fukarenj, të varfër dhe për kategoritë që janë në nevojë.

Shaqir Fetai vendos që nga hisja e kësaj kategorie të ndahet një pjesë për infermierët e Gostivarit! Pse? Sepse u përkujdesën për ta shëruar nga koronavirusi? Nëse Shaqir Fetai ndjenë obligim moral që t’i qerese këto infermierë, le ta bëjë këtë nga pasuria e vet e jo nga djersa e myslimanëve të vendit, sepse askujt b... nuk i ha për Shaqon.

## 13.

Moti kan pas thënë se “ME RRENA NUK SHKOHET N’XHENET”, o “Komisioni Qendror i Kurbanëve”!

*(1Kliklarg, 4.08.2020)*



## **Një Fake news rreth Shaqir Fetait**

**Diku, në një portal sot ishte i publikuar një fake news rreth Shaqir Fetait, i cili mbante këtë titull “Pendarovski nuk e njeh Shaqir Fetahun si Reis, por si ushtrues detyre”, edhe pse, sipas këtij farë “lajmi” Shaqir Fetain “gjykata e paska njohur si reis”**

Tani, nuk po kuptohet se çka po pretendon “gazetari”: të dëshmojë se Kryetari i Shtetit, z. Pendarovski, nuk po i njeh institucionet e shtetit, për shembull, gjykatën, apo nuk po e pranon si “reis” Shaqir Fetain por si ushtrues detyre!

Pendarovski nuk është si ky farë “gazetari” që të bëjë gafë e t’i drejtohet pa e verifikuar ndonjë personi me titull inegzistent. Gazetari i fake news-it duhet të dijë se “reisin” nuk e zgjedhin gjykatat e Maqedonisë së Veriut porse ka procedura të veçanta se si zgjidhet reisi.

Krejt bota e ka dëgjuar deklaratën e Shaqir Fetait i cili e shqipton me gojë të vetë: “Vendosëm për shkarkimin e Sulejman Rexhepit nga posti i kreut të BFI-së. Deri në përgatitjen e kushteve për zgjedhje për kryetar, ushtrues detyre është Shaqir Fetahu. Ky vendim hyn në fuqi nga momenti i marrjes së tij. Shaqir Fetahu, myfti i Gostivarit...” Pra, Shaqir Fetai nuk ka kaluar në asnjë procedurë normale që është në përputhje me normativën e BFI-së për sa i përket zgjedhjeve të organeve të veta! Ai është caktuar për t’iu prirë procedurave të zgjedhjes së reisit të ardhshëm, kurse, normalisht, për t’u zyrtarizuar “titulli” i tij, emri i tij si dhe nënshkrimi duhet të deponohet në Regjistrin Qendror!

Le t’i referohet “gazetari” këtij institucioni shtetëror ashtu siç i është referuar drejt edhe Kryetari i Shtetit dhe, le ta shikojë se pse z. Stevo Pendarovski, i drejtohet Shaqir Fetait me ushtrues detyre dhe jo me “kryetar” e as me “reis”!

Me Fake News nuk mund të mbulohet e të hidhet në harresë se Sulejman Rexhepi u shkarkua se gjatë kohë ka shkelur Nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së! Po bashkëpunëtori i tij i ngushtë (Shaqir Fetai) çka ka shkelur që e bënte aq të lumtur e “dinjitoz” Sulejman Rexhepin? Opinioni duhet ta kuptojë këtë të vërtetë dhe tek pastaj të pranojë për Kryetar të BFI-së personin që do ta zgjedhin përfaqësuesit reprezentativ të myslimanëve të Maqedonisë së Veriut dhe jo gjykatat e shtetit!

*(1Kliklart, 5.08.2020)*

## Shkelësit e Nenit 58 tani po e shkelin tërë Kushtetutën e BFI-së

**“Nëse lejojmë që në këtë formë të na zgjidhet i pari i BFI-së, atëherë e legjitimojmë aktin e çdo grupi banditesk i cili ia mësynë që të zgjidhet reis si Shaqir Fetai! Jashtë formës kushtetutare nuk kemi as kryetar e as reis por, kryebandit”, thotë Afrim ef. Tahiri, drejtues i Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI të RMV-së.**

Shumë gazetarë të vendit janë të irituar skajshmërisht me sjelljet e u.d. kryetar i BFI- së, Shaqir Fetai. Gazetarët kërkojnë informacion nga Shaqir Fetai e ky mundohet t’i heshtë me bakllava! Shaqir Fetai i thërret gazetarët në konferencë për shtyp, nuk i brifon me asgjë të re, ndërsa i fton në sallë që të hanë bakllavë me të cilën i qeras BFI-ja!

Gazetarët kërkojnë të dijnë se kur do ta fillojë procedurën e zgjedhjes së Kryetarit të ri të BFI-së! Kërkojnë të dijnë nëse është konstatuar ndonjë shkelje e rëndë nga ana e Sulejman Rexhepit, për të cilin u tha se u largua për shkak ”të shkeljes së Nenit 58 të Kushtetutës së BFI-së”! Deri më tani, asnjë gazetarë nuk ka arritur që të nxjerrë diçka konkrete nga ai “stil” i shkarkimit!

Edhe përfaqësuesit e Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI janë për zbardhje të çdo gjëje që po ndodhë në BFI tash e pesë vite me radhë. Në faqen e tyre zyrtare kanë publikuar “apelin” për debat publik, të cilin do ta përsërisin çdo muaj, e të cilin ia drejtojnë Shaqir Fetait.

Ndryshe, Fetai në konferencën e fundit me gazetarët e vendit ka nënvizur se e preferon transparencën, se e premtonte transparencën dhe se gjithçka do të dihet pasi të analizohen gjërat, që do me thënë se, Sulejman Rexhepi e kanë shkarkuar me marrëveshje paraprake, pa kurrfarë analize e fakte!

Në pyetjen tonë deri te shërbimet e BFI-së se, kur Shaqir Fetai do t’i përgjigjet ftesës së “luftëtarit të paepur” për reforma në BFI, z. Afrim Tahirit, për debat publik e për zbardhje të argumentuar të të gjitha aferave që kanë ndodhur viteve të fundit në këtë Institucion, nga aty na thonë se, BFI-ja është Institucion serioz dhe se nuk preferon që të lejojnë reisul ulemanë që të provokohet prej gazetarëve dhe të tjerëve! “Ne tashmë e kemi të zgjedhur Kryetarin e BFI-së Reisul Ulema H. Hfz. Efendi Shaqir Fetain, i cili nuk guxon të provokohet as prej gazetarëve por as prej të tjerëve! Nuk ka debate publike, gjithçka këtu është transparente. Për më tepër, reisi ynë po shërohet nga Koronavirusi dhe, një njeri normal, nuk do të duhej ta ftonte në debat pacientin e sëmurë nga kjo pandemi”, na thonë nga shërbimet e BFI-së.

Nga ana tjetër, H. Afrim ef. Tahiri, njeriu që e shpалosi pafytyrësinë e një rijaseti të tërë, duke ua zbardhur hajnitë, korrupsionin, shkatërrimin e pronave të BFI-së dhe sërë veprimesh kriminale, insiston në transparencë reale e jo virtuale, duke shtuar se, pacientët e sëmurë vendin e kanë në institucionet shëndetësore ku ju duhet trajtim adekuat, dhe jo nëpër biruca nëntokësore ku thurren intrigat dhe skenaret banditeske. Nuk guxojmë të lejojmë që të shkelin Kushtetuta e BFI-së! Ai person, bashkëpunëtori më i lehtëuar i Sulejman Rexhepit, nuk guxon që ta shkelë natë e ditë Kushtetutën e cila nuk parasheh as u.d. kryetar e as u.d. reisul ulema! Askush nuk mund të caktojë forma se si mund të bëhesh kryepari i BFI-së! Për këtë qëllim duhet të ketë Rregullore konform Kushtetutës ekzistuese të BFI-së. Nëse nuk dinë dhe nuk munden, jam këtu që t’ua shpjegoj publikisht gjërat, të përballim më këdo prej asaj bande, madje qofshin të infektuar edhe me të gjitha epidemitë e mundshme. Është turp për ne hoxhallarët që të lejojmë që, në dëm të BFI-së dikush t’i shërojë kompleksët, apo të përpiqet që t’i shpëtojë përgjegjësisë shumë të rëndë, apo edhe t’i mjekojë frustracionet e karrieristit

të sëmurë”, thekson efendi Tahiri, për të shtuar: “Nëse lejojmë që në këtë formë të na zgjidhet i pari i BFI-së, atëherë e legjitimojmë aktin e çdo grupi banditesk i cili ia mësynë që të zgjidhet reis si Shaqir Fetai! Jashtë formës kushtetutare nuk kemi as kryetar e as reis por, kryebandit! A mos është kjo ndonjë mësyerje për ta shkatërruar tërësisht të vetmin Institucion fetar islam që e kanë myslimanët e vendit?”, pyet Afrim ef. Tahiri, drejtues i Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI të RMV-së.

*(1Kliklart, 7.08.2020)*

## Shaqir Fetai na u krekos si gjeldeti (1)

**Rreth një interviste të Shaqir Fetait botuar në “Hëna e re”, e cila gjasonte në një përçapje të fëmijës që sapo e ka kaluar “lijën e qenit”, i llastuar, me plotë dëshira iracionale e me fantazi. Shaqir Fetait i kërkohet debat publik ndërsa ai e gjenë mënyrën për të thënë diçka sa për ta përjetuar një çlirim mankthi që i vjen nga domosdoshmëria e sqarimit të shumë gjërave në opinion. Çdo përgjigje e tij në pyetjet e kurdisura meriton koment më vete. Ky do jetë një reagim në vazhdime**

**Nga Haxhi Isa Xhaviti**

Shaqir Fetai edhe më tej mundohet ta gënjejë opinionin e ngushte familiar të veten por edhe opinionin e gjërë të vendit. Për hire të kësaj “gënjeshtre të ëmbël” si dhe për hirë të dëshirave të tij patologjike që burojnë nga përpjekja e tij provinciale dhe diletanteske për një karrierë të bujshme (qoftë kjo edhe kriminale), Shaqir Fetai vazhdon që të jetë shkelësi më i madh i Kushtetutës së BFI-së.

Është diletantizëm i skajshëm të mendosh dhe të pretendosh se titujt akademik apo edhe profesional kanë titullin ndihmës u.d. Kjo është ngjashëm si të kemi titullar “u.d. kirurg”, apo “u.d. doktor shkence”, apo, “u.d. akademik” etj. Së këndejmi, si mund të ketë titull “ushtrues detyre kryetar i ulemasë”! Një ndërdyshje e tillë, mundet apo nuk mundet, mund të rrjedhe vetëm prej karrieristit të lajthitur.

Kushtetuta është akt më i lartë juridik që qëndron në themelet e një shteti apo të një Institucioni të veçantë me karakter kushtetutar. Aty lajthitje, diletantizëm dhe idiotizëm nuk mund të ketë. Prandaj dhe Kushtetuta e BFI-së askund, në asnjë fjali e nen nuk ka paraparë titull “u.d. reis”, sepse nuk e duron, sepse shpreh budallakinë e të çoroditurve dhe të injorantëve.

Natyrisht, në Kushtetutën e BFI mungon edhe titulli “u.d. kryetar”, prandaj praktikat e ngjashme të BFI-së, janë zgjidhur përmes “këshillit reprezentues”, apo komisioneve. Gjithësesi, nocioni “u.d. kryetar” edhe pse nuk njihet nga Kushtetuta e BFI-së, të paktën duket më normale, më e nënkuptueshme, sepse është si titull juridiko-administrativ i përfshirë nëpër akte juridike të institucioneve të ndryshme. Së këndejmi, Shaqir Fetahu në Regjistrin Qendror është i regjistruar “u.d. kryetar-reisul ulema Shaqir Fetai”, ndaj dhe, bënë shumë mirë që mos ta gënjejë opinionin e gjërë dhe miqtë e BFI-së, sepse u bëmë rezil.

Shaqir Fetait nuk i duket vetja asgjë si “u.d. kryetar”, sepse ai mendon se është “halis kryetar”, sepse e ka ëndërr të sëmurë dëshirën për të qenë kryetar i BFI-së. Fatkeqësisht, kjo ëndërr e tij do të zgjasë si të gjitha ëndërrat, dy-tre sekonda! Ai nuk mund të bëhet kryetar për dy arsye: sepse juridikisht është e pa mundshme, sepse një u.d. kryetar, i caktuar për t’i përgatitur zgjedhjet, nuk e ka të drejtën e vetëzgjedhjes dhe, një shkelës i kushtetutës ekzistuese, me shumë probleme shëndetësore e mendore, në prag të pensionimit, as që guxon të paramendojë kandidimin e vet për kryetar të institucionit.

Kjo për sa i përket lajthitjes dhe gënjeshtres së Shaqir Fetait që shihet që në kryetitull të intervistës. Po në titull?

Shaqir Fetai, tamam si një snob, si një pseudo-takvaxhi na thotë që uniteti duhet të ruhet si sytë e

ballit. Por, nuk e thotë cili unitet: ai, nën udhëheqjen e tij, apo ai që i respekton të gjitha shkeljet e tij?

Të jemi të gjithë unikë duke respektuar dëshirat karrieriste të Shaqir Fetait, pa çka që ai është shkelësi më i madh i Kushtetutës së BFI-së? Apo të jemi unikë në bindjet e Shaqir Fetait se anëtarë të rijasetit mund të jenë “macasi- kucasi” dhe se të drejtën e vendimëarrjes e kanë edhe koordinatorët, të cilët brenda natës emërohen “myfti”! Këtë unitet shkatërrimtar nuk guxon ta mendojë Shaqir Fetai, madje nuk guxon as ta veshe me petk fetar, sepse është kërkesë e djallëzuar.

*(vazhdon)*

***(1Kliklart, 13.08.2020)***

## “Hafiz intriganti” dhe injoranca e tij (2)

**Si përgjigjet Shaqir Fetai, ky hajgarexhi me jetën fetare, në intervistën e vet nga ato dhjetra që i ka pritur e që nuk ia nguli asnjë mjet informimi, rreth pyetjes se si ndodhi puna që ai “të bëhet i pari i BFI-së”**

**Nga Haxhi Isa Xhaviti**

Që në përgjigjen e parë Shaqir Fetai na prezantohet si prostitut mashkull, pa guxim intelektual e shpirtëror, pa diplomaci e pa personalitet për ta nxjerrë të vërteten në shesh. Ai që në start mendon se po komunikon me pula dhe, hë t’ua hedhim një grusht kollomoq pulave që po kokorasin kaq shumë! Gazetarët dhe mediat nuk duan “tagji” dhe rrena të fabrikua, por të vërtetën mbi një proces të cilin Shaqir Fetai nuk diti si ta zhvillojë por doli i tëri bllof!

Ai fjalinë e nisë: “Mendoj se opinioni i gjerë tashmë është njoftuar përmes komunikatave tona dhe konferencave për shtyp.”

Rrenë e madhe!

Çka ka kumtuar përmes komunikatave të veta Shaqir Fetai? Asgjë, veçse po rrenë. Ky rrenavec, nga frika e “babait të vet shpirtëror” vazhdon të rrejë dhe të shkelë mbi parimet e shenja të Islamit, ndërsa aq qejf ka që t’i drejtohen me titull “hafiz”. I duhet ky titull për kamuflim të djallëzive që i ka! Cilat konferenca për media i ka mbajtur ku i paska sqarur gjërat? Ky tash mundohet që t’i vë në lojë edhe mediat e gazetarët, madje tërë opinionin, ndaj nuk paska nevojë të dijë hiç më tepër Rijaseti, komuniteti i hoxhallarëve, teologët e vendit, myslimanët që ndajnë nga kafshata e gojës për të mirën e këtij Institucioni? Në konferencën e fundit më idiotik që mund ta mbajë një snob e një injorant, Shaqir Fetai aq shumë u bishtëroi gazetarëve sa këta ia injoruan bakllavanë që ky ua ofroi si korrupsion. Shumica e gazetarëve në vend e dinë këtë të vërtetë dhe jo intrigat e “hafiz intrigantit”.

“Kohëve të fundit u ndie nevoja që vërtet të ndodhin ndryshime në kreun e BFI të RMV, sepse u formua një ambient te besimtarët dhe te faktorët tjerë në BFI e RMV dhe u ndie nevoja për ndryshime, të cilat ne i emëruam si zhvillime të reja në BFI e RMV. Këtë proces e udhëhoqën vetë Myftinjtë e Myftinive të BFI të RMV dhe anëtarët e Rijasetit të BFI, ku me dy të tretat u vendos ky ndryshim.”

Në një fjali tri rrena pa krip:

Kohëve të fundit u ndie nevoja??? Kur, kohëve të fundit, vetëm pasi të jetë shkatërruar komplet BFI duke e grabitur dhe rrënuar gati gjysëm decenie! Po si nuk e ndietë këtë nevojë më herët, apo ju vinte lezet.

Zhvillime të reja në BFI??? Kështu i emëruat nevojat për largim të kryetarit të BFI- së, Sulejman Rexhepi? Ky ndryshim u vendos me dy të tretat e Rijasetit??? Po nëse ia kërkon gjyqi që t’i përgjigjet me emër e mbiemër dhe me sistematizim të vendit të punës për të gjithë ata që ia përbëjnë këtë dy të tretat e Rijasetit, si do të përgjigjet? Me “pasha nanën time” nuk e kam ditë, apo me “pasha Allahun kështu bënte edhe “zoti” im, Sulejman Rexhepi”?

Në këtë përgjigje mungon vetëm e vërteta: ndodhi ky proces se kështu u morëm vesh në “Darkën e fundit”, ne të Judës me ata të pushtetit!

Dhe, “hafiz intriganti” e përfundon përgjigjen e parë në intervistën e kurdisur duke nënvizuar se i ka hyrë menjëherë punëve për stabilizim të BFI-së në sfera të ndryshme! Ky farë mburraveci, ose është tërësisht injorant, ose po përpiqet të lajë mut me shurrë, sepse është shumë i ndërgjegjshëm për lojën ku është futur.

Për çfarë stabilizimi dhe për çfarë sfera të ndryshme mundohet të flasë kjo farë hanëmingje, kur dihet se, nga dita e kidnapimit të BFI-së e deri më sot, ditët i kaloi duke pritur e përcjellë “delegacione” që ia shprehnin përshëndetjet dhe urimet për një post të vjedhur që e shpërftyron komplet në gjelDET! Natyrisht deri sa nuk u sëmure nga Covid 19, për ta kaluar kohën pastaj në shërim shtëpiak. Dikush pyeti: “a mos ishte ky një ndëshkim nga Zoti”, për ta ndërmendur “hafizin”?!

*(vazhdon)*

***(1Kliklart, 13.08.2020)***

## Shaqir Fetai nuk po provokon mllef por urrejtje gjithëpopullore (3)

**Shaqir Fetai druan se ka krijuar një praktikë përmes të cilës kur të duan dy të tretat e Rijasetit, apo të imamëve të një territori të Myftinisë mund ta shkarkojnë atë, hala pa u mësuar mirë “të nusërojë”. Prandaj nuk e paskan shkarkuar anëtarët e Rijasetit por paska dhënë vetë dorëheqje Sulejman Rexhepi. Ç’turp e ç’haram**

**Nga Haxhi Isa Xhaviti**

Kushdo që e lexon me kujdes intervistën e Shaqir Fetait botuar në “HENA E RE”, do të vëreje se ai është një misionar me elementa të mercenarit me detyra të shumëfishta:

ta rehabilitojë të kaluarën ku kontribut kriminal të theksueshëm ka edhe Shaqir Fetai;

të këmbëngulë në atë se BFI-në nuk e ka gjetur si gërmadhë, Sulejman Rexhepin nuk e ka shkarkuar askush me shkeljen e kurrfarë neni porse, thjesht ai paska dhënë dorëheqje;

rreziku që i vinte BFI, që po ngjasonte në një anije që po përmytej, nuk ishte nga kapiteni pirat me tërë ekipin e vet anti-BFI, por nga valët e trazuar të detit për ç’gjë u desht të intervenohej me “dy të tretat” e Rijasetit të Sulejman Rexhepit, të cilat ia radhitën të gjitha sukseset dhe nuk ia nënvizon asnjë “mëkat”;

vetëlavdërimin dhe mburrjen duke e stolisur me lloj-lloj gënjeshtër, fantazirash dhe duke përvetësuar merita të të tjerëve, vetëm sa për ta krijuar iluzionin se tashmë në krye të BFI-së ka ardhur një alimet “alimi” dhe takvaxhi që secilit mysliman të Shkupit ia kujton “zhengër babën”.

Në pyetjen: “Si është BFI– si Myfti i Gostivarit dhe si është sot – si Kryetar i saj në detyrë”! Shaqir Fetai na mbytë me vetëlavdërim dhe me virgjërinë e tij përgjatë viteve sa ka punuar në BFI në poste të ndryshme, si dhurata absolutisht të pameritueshme por të dhëna nga Sulejman Rexhepi për lojalitet.

Sa i pafytyrë aq edhe imoral, sa i pacipë aq edhe gënjeshtar, Shaqir Fetai na helmon me elozhe që ia thurrë vetëvetes. Na paska qenë ndër themeluesit e FSHI-së! Me peshë si të Shaqir Fetait atëbotë kanë qenë të gjithë myslimanët e Maqedonisë së atëhershme.

Të gjitha të arriturat epike në Myftininë e Gostivarit në kohën e ish-myftiut dhe kryetarit e reisul ulemasë Hfz Arif ef. Emini, i përvetëson dhe i llogaritë si suksese personale. Ndërkohë që, kur erdhi në krye të Myftinisë e gjeti një prej organeve më të fuqishme dhe më të konsoliduar që ia kishte lënë efendi Emini.

Shaqir Fetai flet sikur të jetë ai gjithçka meritori në Myftininë e Gostivarit, në Medrese dhe në BFI, ndërkohë që faktorët e mëhershëm në organet e BFI-së as që e bënin hesap si hoxhë klasik. Pa Sulejman Rexhepin, edhe sot e kësaj dite Shaqir Fetai do të ngelte hoxhë klasik në fshatra të Gostivarit.



Shaqir Fetai përmend se paska kthyer tërë vakëfin e Myftinisë së Gostivarit, ndërkohë që ky denacionalizim ka qenë proces i paraparë me ligj për të gjithë organizatat fetare. Ku është merita e Shaqir Fetait këtu?

Po pse Shaqir Fetai nuk tregon se si e humbi vakëfin e garantuar dhe hejdie nga Banka Islamike për Zhvillim! Si e tradhëtuan dhe pse u tërhoq nga kjo marrëveshje kjo organizatë financiare ndër më të fuqishmet në botë? Këtu kontribut vetëmohues gjithësesi që ka Shaqir Fetai. Shaqir Fetai duhet të dijë se asnjë mësim islam nuk mëson se shejtani mund të rikthehet në melaqe. Zoti e ka përjashtuar atë!

Ajo çka të trishton në këtë përgjigje është mercenarizmi i Shaqir Fetait të cilin e kamuflon me misionarizëm të padefinuar qartë. Përgjigjen e përfundon me këtë fjali: “Në këtë shërbim u vendosën të gjithë Myftinjët dhe Koordinatorët e Myftinive dhe disa nga anëtarët e Rijasetit dhe morëm vendimin tanimë të njohur për opinionin, që u kurorëzua me dorëheqjen e ish-Reis’ul-Ulemasë”.

Këta banditë të manipuluar, më në krye Shaqir Fetain, a e morën vendimin për shkarkimin e Sulejman Rexhepit për shkak të shkëljes së komplet Nenet 58, pa specifikuar asnjë pikë të saj! Shkelja e të gjitha pikave të këtij neni do kohën e vet, do përkrahje institucionale, do miratim institucional, përfshirje të më shumë faktorëve. Dakord, e shkarkuan si e shkarkuan, atëherë ç’hyn këtu dorëheqja e Sulejman Rexhepit? E dini pse? Sepse Shaqir Fetai druan se ka krijuar një praktikë përmes të cilës kur të duan dy të tretat e Rijasetit, apo të imamëve të një territori të Myftinisë mund ta shkarkojnë atë hala pa u mësuar mirë “të nusërojë”!

Ky fat mund ta gjejë nga vetë imamët e Gostivarit të cilët kur do ta kuptojnë rolin e Shaqir Fetait si Myfti dhe, mund t’i kërkojnë llogari se ku kanë përfunduar paratë e xhematit të kësaj Myftinie “më të rregullt”. Ndërsa tani na del puna se BFI na qenka lodhur nga do “faktorë të jashtëm”, nga do valë të detit që do të mund ta përmbysnin këtë Institucion. Pra, nuk paska qenë fajtor Shaqir Fetai e soji i tij, por “valët e detit”! Turp! Zoti e ndëshkoftë edhe më shumë se sa të qenurit snob e injorant, i cili tashmë nuk po e ngacmon mllefin por urrejtjen gjithëpopullore!

*(vazhdon)*

***(1Kliklart, 14.08.2020)***

## **Kërko teube Shaqir Fetai, është më e vlefshme se të bëhesh kryetar (4)**

**Shaqir Fetai mos të hajë shumë e mos ta fajësojë administratën se paska shpërndarë dokumenta anakënd botës, por fajin për degradim të BFI-së ta kërkojë tek vetëvetja si organ i dikurshëm i BFI-së së kriminalizuar. Përpyekja për amnesti nuk është ekuivalent apo i barasvlefshëm me teuben para Zotit që i duhet Shaqir Fetait**

**Nga Haxhi Isa Xhaviti**

Në pyetjen e radhës, ndonëse gazetari ia kërkon sinjalet e para që mund të flasin për suksese të dukshme me ardhjen e Shaquas në maje të BFI-së, ai këtu preferon që ta arrijë majen e gënjeshtërs, duke ua shkërdhyer në këtë formë intelgjencën myslimanëve të vendit. Flet për suksese sikur këtu të mos ketë myslimanë normalë. Mundohet që rrenën ta zbërthejë si sukses të tij, për të rrëshqitur pastaj edhe në kohën e Sulejman Rexhepit kur ka rrejtur rrast.

Kur Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI thoshte se BFI është izoluar totalisht nga bota turko-arabe, ai ishte më i zëshmi në përpjekje për ta demantuar këtë konstatim të pademantueshëm. Kurse vetëm tani e vërenë këtë bllokim total dhe shenjat e qarta të deblokimit. Po cilat na qenkan këto shenja?

Shaqir Fetai e ka gënjer tërë botën se paska “ardhur” në krye të BFI-së! “Me ardhjen tonë”, thotë Shaqir Fetai! Në kontekst të rrjedhave në BFI “ardhje” ka kuptimin e përfundimit të procesit të zgjedhjeve apo të emërimeve! Kur u zgjodh Shaqir Fetai rrencaku? Kur u emërua Shaqir Fetai intriganti? Asnjëherë! “Dy të tretat” e Rijasetit të Sulejman Rexhepit shkarkun të njëjtin, ndërsa u përcaktuan për Shaqir Fetain u.d. kryetar deri në zgjedhje të kryetarit!

Shaqir Fetai e gënjen veten siç e gënjeu tërë botën. Vetën e gënjeu për shkaqe të sëmundjeve karrieriste, ndërsa e gënjeu botën sa për të treguar se BFI vazhdon të jetë Institucion i papërgjegjshëm.

Shaqir Fetai vazhdon me papërgjegjësi edhe në raport me Institucionin dhe myslimanët e vendit. Bota turko-islame e izoloi BFI-në edhe për fajin e Shaqir Fetait. Tani, urimet e botës turko-arabe që ia shprehin Shaqir Fetait, në fakt sinjalizojnë manipulimin e Shaqir Fetait duke e vulosur nënshkrimin e vet nën titullin “Kryetar i BFI, u.d. reisul ulema”! Nuk zgjidhet reisul ulema ndaj nuk mund të jetë u.d., por zgjidhet kryetari, meqë është u.d. dhe, sapo të zgjidhet kryetari ai me automatizëm e gëzon titullin shpirtëror “reisul ulema”! Kështu e di tërë bota turko-arabe që ka qëlluar pak më e menqur se Shaqir Fetai gënjeshtar.

Tani, Shaqir Fetai mendon se për shkak të kësaj “gafe të paqëllimtë”, meqë tërë bota e di dhe më ka uruar për kryetar, tani, nbyllni sytë, dhe mos më detyroni që të organizoj zgjedhje, se vjen ndonjë tjetër e nuk është mirë që sërish bota të merret me urime e përshendetje. Ja, me mua u krye kjo punë dhe, me lerni e mos më ngacmoni, më pranoni për kryetar të përjetshëm. Ja, këtë e kërkon Shaqir Fetai, sepse, me këtë lëvizje amnistohet Rijaseti, vetë Shaqua si dhe të gjithë banditët e tjerë si ky. Deri sa ka një opozitë të fuqishme nuk ka “pushtet” të qetë!

Tjetër! Shaqir Fetai paska gjetur një kolaps në buxhet, ndaj ka vënë restriksione të rënda me qëllim që të stabilizohen financat! Si stabilizohen? Duke e stimuluar vjedhjen? Duke e nëpërkëmbur djersën

e myslimanëve? Shaqir Fetai këmbëngulë në krijimin e traditës: “Të parit i lejohet vjedhja dhe pasurimi, ndihmuar nga stafi i tij dhe, për këtë mund të shpresojë në pleqëri të rehatshme, meqë sipas “traditës” atij nuk do t’i turbullohet lukthi”. Shaqir Fetai mos të bëhet filozof kot e kot, sepse të gjithë e dinë dhe e marrin për copë injoranti, por, le t’i bëjë gati dy rrogat e ardhshme për administratën e shkëlqyeshme dhe nëpunësit e BFI-së faji i vetëm i të cilëve është heshtja para krimeve dhe kriminalizimit të BFI-së.

Shaqir Fetai mos të hajë m... e mos ta fajësojë administratën se paska shpërndarë dokumenta anekënd botës, por fajin për degradim të BFI-së ta kërkojë tek vetëvetja si organ i dikurshëm i BFI-së së kriminalizuar. Përpjekja për amnesti nuk është ekuivalent apo i barasvlefshëm me teuben para Zotit që i duhet Shaqir Fetait.

*(vazhdon)*

***(1Kliklart, 14.08.2020)***

## Shaqir Fetai do të lajë shumë borxhe, pastaj do të ikë i turpëruar (5)

**Në një prej përgjigjeve të Shaqir Fetait në intervistën e kurdisur e të botuar në “HËNA E RE”, del sheshit edhe trishtimi i tij i vonshëm nga fakti që në BFI u instalua me insistimin, ndihmën dhe bekimin e BDI-së, të cilës familjarisht i kanë borxh**

**Nga Haxhi Isa Xhaviti**

Pse ky trishtim i Shaquas nga fakti që u damkos si “reis i BDI-së”. Ku do të ikë Shaqua tani pasi nuk ia ktheu reston BDI-së. Shaqua është interesxhiu më i madh që mund ta bëjë nëna. Është tepër i pafytyrë dhe mermer i ftohtë në momentet kur është në pyetje interesi i tij meskin. Këtë e ka dëshmuar tërë kohës sa ka qenë vasal i Sulejman Rexhepit.

Tanimë Shaqir Fetai ka tradhëtuar dhe i druan hakmarrjes së BDI-së e cila do ta djeg për këtë tradhëti. I lajthitur nga propagandat që thonin se BDI do të jetë humbëse në këto zgjedhje, Shaqir Fetai tërë kohës ka koketuar dhe është fërkuar me Aleancën duke e ndihmuar Alternativën. Zatën BDI pësoi humbje të madhe pikërisht në Çegranin e Shaquas dhe të familjes Fetai e cila komplet ka aderuar në BDI të cilës goxha ia kanë parë hajrin.

Përzjerja e BDI-së në instalimin e Shaqir Fetait si qyp në krye të BFI, na qenka normale! Shaqua thotë se qenka shumë normale në botën demokratike tendenca e partive politike për të ushtruar ndikim në institucionet fetare, por suksesi i tyre varet nga aftësitë tona për t'i penguar ato. Një teze kjo shumë e çoroditur dhe tepër amatoreske për të mos thënë idiotike!

Në botën demokratike, ku kultura demokratike shpreh kulturën e përgjithshme të një etnie, të një shoqërie apo të një komuniteti, përpjekja e cilësdo parti për të ndikuar në një komunitet fetar sanksionohet me mospërfillje të asaj partie dhe me përpjekje mbinjerëzore për ta përjashtuar nga shoqëria. Shoqëria demokratike në botë me përlësi është në shërbim të interesave të institucioneve dhe komuniteteve fetare, duke e dëshmuar këtë juridikisht dhe praktikisht. Pikërisht për këtë shërbim me përlësi institucionet demokratike kërkojnë me mirësjellje që, secili në vend të vet e me punët e veta. Në rast të përzjerjeve të gjërave pushteti demokratik godet mbi secilin, qoftë ky kryetar apo edhe “haxhi reis”!

Tani Shaqir Fetai, duke e ndërë ndëshkimin partiak për shkak të tradhëtisë, u përçon sinjale këtyre të BDI-së që të këqyrin e të mos harrojnë se, BFI-ja qenka institucion mbipartiak dhe as mos t'ia mësyjnë të përzihen e ta kërkojnë largimin e tij, sepse tashmë tërë bota e ka uruar dhe e ka pranuar si “kryetar të BFI” dhe me këtë legjitimitet botëror ka humbur peshën e vet organizimi i çdo procesi zgjedhor në BFI për sa i përket zgjedhjes së kryetarit të këtij Institucioni! Kështu mendon Shaqir axhamia, intriganti, i cili, duke qenë i njohur nga ligësitë e tij, gjithnjë ka qenë i injoruar dhe i marginalizuar në BFI.

Prandaj Shaqir intriganti përmbyllë këtë përgjigje me: “Kam bindjen se do t'ia dalim, sepse kemi organe të vetëdijshme për lëvizjen e rrugëtimit të BFI-së tash e në të ardhmen.” Ai këtë rrugëtim e projekton nën drejtimin e tij si punë të kryer. Ja pra, edhe një fakt që flet se Shaqir Fetai është shkelësi më i madh i Kushtetutës së BFI-së, ani pse është plotë 62 vjet! Ligjit nuk i kërcet nëse je i sëmure apo paske pasur shumë angazhime! Brenda afatit personi u.d. përgatit zgjedhjet dhe e dorëzon detyrën

me nder. Vetëm ky nder i ligjshëm i kërkohet personit u.d.: të jetë ekspeditiv dhe shumë korrekt e i disiplinuar në përgatitjen e zgjedhjeve. Ndryshe, “e bluan” ligji! Kurse Shaqir Fetain tek do ta bluaj ligji për prezantim të rrejshëm dhe për futjen në huti të krejt botës. Sëmundja e tij karrieriste nuk do të shërohet nga mekanizimi i këtij ligji, por, do të “bluhet”.

*(vazhdon)*

***(1Kliklart, 15.08.2020)***

## Shaqir Fetai si i “sëmuri për mend” (6)

**Katër-pesë pyetjet e fundit kanë të bëjnë me strategjinë, me platformën, me programin, me planin aksional, me idetë, me vizionet e Shaquas në aspekt të drejtimit të BFI-së? Po çka i duhet gazetarit dhe Shaquas këto pyetje kur dihet se nuk është kjo punë e tij por, thjesht, t'i përgatisë zgjedhjet për kryetarin e ardhshëm të BFI-së! Apo, u bë bytha e Shaquas të na tregojë nëse do të ketë apo jo zgjedhje në BFI**

**Nga Haxhi Isa Xhaviti**

Po ku di Shaqir Fetai se çka është strategjia! A e di ai se çka është plani aksional ditor, javor, mujor! A e di ai se çka është platforma e veprimit mbi të cilën bazohet një program racional? Po ku di dhija çka është tagjia!

Plan i Shaqir Fetait qenka kthimi i vakëfit dhe i Xhamisë së Prilepit! Po si? Duhet të ketë një strategji edhe për këtë gjë! Qenka turp për maqedonasit që e paskan shndërruar këtë xhami në tualet! Po cili është këtu turpi i Shaqir Fetait për humbjen e kësaj Shtëpie të Zotit?! Çka bëri Shaqir Fetai për këto 18 vite, si Myfti, për ta rikthyer këtë objekt? Cilët janë fjalimet e Shaqir Fetait nëpër mbledhjet e Rijasetit ku shihen shqetësimet e tij për ta rikthyer këtë Xhami! Cili është presioni i Shaqir Fetat si organ mbi Sulejman Rexhepin i cili është zotuar se do ta rikthejë xhaminë në po atë gjendje që ka qenë para vitit 2001! Qenka vetëm turp i maqedonasëve dhe jo kryekëput i Shaqir Fetait, a! Po a është problem vetëm kjo xhami në Prilep? Kjo në Prilep qenka e turpshme edhe për faktorin ndërkombëtar! Për të gjithë e turpshme, vetëm për Shaqir Fetain jo, i cili për rreth një deçenie e gjysëm ka qenë vasal palaço dhe budalla oborrar i Sulejman Rexhepit!

Shaqir Fetau paska ndërmend të angazhohet për të drejtat fetare nëpër kazerma, nëpër struktura policore, nëpër spitale, burgje, hapja të çerdheve për fëmijë etj! Po a mund të na thotë njëherë Shaqir Fetahu se cila është e drejta e nëpunësve fetarë nëpër vetë xhamitë e vendit? Cili është benefiti i të qenurit hoxhë në Maqedoninë e Veriut, pikërisht në kohën sa ka qenë Myfti Shaqir Fetai? Cili është autoriteti i hoxhës sot? Cili është dinjiteti i tij, cila është pesha e fjalës së tij; cila është pesha e vendimit të tij; cili është personaliteti i tij, sot, në kohën sa ka shërbyer si organ Shaqir Fetai! Thjesht, Shaqir Fetai nuk ka mundur ta konceptojë hoxhën jashtë të qenurit spiun, tradhëtar dhe shërbyes i rëndomtë dhe i detyrueshëm për atë që paguhet, paçka që paga është qesharake!

Në Maqedoninë e Veriut janë dhe funksionojnë dhjetra shoqata islamike si dhe shtëpi botuese që prezantojnë islamit e ndaj të cilave Shaqua, qoftë si myfti qoftë si “shkencëtarë”, kurrë nuk ka pasur kurrfarë vërejtje. Ndërsa thotë se Bashkësia Fetare Islame na qenka i vetmi subjekt kompetent për prezantimin e islamit dhe organizimit të jetës fetaro-islame në vendin tonë! Po këto shoqata e asociacione që merren po me të njëjtën punë, çka janë këto? Pse Shaqua deri dje bashkëpunonte më të gjitha ndërsa sot i duken si “mish i egër”! Për këtë gjë Shaqir Fetai ka një përgjigje, e cila, do ta kualifikonte në “intelektualët” më diletantë dhe më injorantë në botë! Ai thotë: “Ky prezantim është tejet kompleksiv sepse jetojmë në Ballkan dhe në Europë në nënqiellin e shkencës dhe ekonomisë, kulturës, artit dhe zhvillimeve të shumta. Andaj duhet të jemi të përgatitur mirë, si nga aspekti kadrovik po ashtu edhe nga ai institucional”! Fjali më idiotike a keni lexuar???

Dhe, në këtë aspekt ai rradhinë një numër institucioneve që do t'i themelojë në të ardhmen? Kush ai!? Shaqir Fetai? Në të ardhmen ai mund ta shohë veten vetëm eventualisht si Myfti i cili mund ta nxisë fonemimin e këtyre Institucioneve, si shenjë e ndryshimit të vetëvetes nga periudha kur i shërbente ekskluzivisht Sulejman Rexhepit! Për ta përmbyllur si komik pjesën e vet në një tragjedi të tmerrshme dhe, për ta bërë vetën për t'u guajtur me domate të qullavta, Shaqir Fetai thote: “do të jemi shumë kreativë me pjesëmarrjen tonë në konferenca të vendit dhe ndërkombëtarë, ku do t'i prezantojmë vlerat dhe mendimet tona rreth shumë çështjeve me të cilat ballafaqohet bota moderne. Për këtë kemi edhe aftësi kadroviqe, edhe profesionalizëm të vërtetë!” A i ka hije të flasë kështu Shaqir Fetait që e pretendon titullin shpirtëror “reisul ulema”? A është në vete ai se çka fletë! Deri kur Shaqir Fetai mund të mendojë se mund të tallet me myslimanët e vendit! Po si ia zë goja të thotë se kemi kapacitete të kontribuojmë në tejkalimin e problemeve me të cilat përballet bota moderne! Bota moderne për momentin po përballet me implikimin e qeverive të huaja e super të fuqishme në kontrollimin e çdo gjëje që është online! Si do ta pengonte këtë problem Shaqir Fetai me kuadrin e vet “një aradhë injorantësh”? Bota moderne, pra, ajo jo islamike, e ka shumë të qartë se vjedhja e vakëfit apo edhe kontributi me heshtje i vjedhjes së vakëfit, është një nga mëkatet më të mëdha në islam!

Shaqir Fetai në këtë intervistë në pjesën e programit të tij si “reis i ardhshëm” ka vjedhur plotë ide të huaja, ka vjedhur plotë pika dhe vizione nga Platforma e Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI si dhe nga strategjitë e udhëheqësit të saj, H. Afrim Tahirit, të cilat i ka botuar atëherë kur Shaqua i duartrokiste të sharkuarit në bazë të nenit 58! Ai vjedh sepse është mësuar të vjedhë, ndryshe nuk mund të funksionojë: ose të vjedhë, ose të kompilojë, ose të rritet mbi plagjiaturë “shkencore”! Kjo i “lejohej” vetëm “shkencëtarit” me tru të atrofizuar! Ai thotë se do ta riorganizojë “Hilalin”? Po pse? Çka nuk i pëlqen si funksionon kjo “organizatë humanitare”? Pse nuk e shprehu këtë shqetësim sa ishte Myfti? Ose, çka paska hetuar ai tani, derisa ka qasje në dokumentet e “Hilalit” për të cilën thotë se gjithësesi që duhet të riorganizohet?! Pse Shaqua nuk e tregon arsyetimin e kësaj domosdoshmërie të riorganizimit të “Hilalit”!

Dhe, krejt në fund, Shaqir Fetai shumë shkarazi flet për paralajmërimin e vet atij për zgjedhjen e Kryetarit të BFI-së? Nuk e ka të qartë fort këtë pyetje Shaqua! Prandaj, nuk është i qartë nëse kësaj pune duhet t'i hyhet pasi të ndërrohet Kushtetuta apo t'i hyhet me Kushtetutën aktuale! A e di Shaqir Fetai se nëse prekë në këtë çështje, fundi i tij do të ishte burgu! Po ku guxon ushtruesi i detyrës të merret me ndryshime të Kushtetutës! Ne po i themi që, edhe një herë, le t'ia hedhë një sy dokumentit se si është regjistruar në Regjistrin Qendror dhe tek atëherë le t'i qaset aventurave! Çdo punësim, çdo shkarkim, çdo largim nga puna, çdo ndryshim të akteve normative, të vendimeve paraprahe, të rregulloreve, statuseve, Kushtetutës – është vepër penale dhe e dënueshme me burg. Asnjë shkronjë të Kushtetutës ekzistuese, ndonëse jo fort e mirë, nuk guxon ta ndryshojë e ta shkelë Shaqir Fetai, sepse nuk është në tagrin e tij. Le ta dijë Shaqua se, është nën survejim profesional dhe shumë kompetent. Mos të thotë pastaj “o kuku çka i bana vetes”!

*(1Kliklart, 15.08.2020)*

## I vetëpëlqyeri që me intriga do të bëhet reis

**Shaqir Fetai nuk ka se çka të turpërohet nga fakti se ka qenë vasali më besnik i Sulejman Rexhepit. Këtë fakt nuk mund ta mohojë, siç nuk mund ta mohojë edhe faktin se me “Vehbi Dibra” e dekoroi Sulejman Rexhepi dhe jo BFI në RMV**

**Nga Jasir Jashari**

Shaqir Fetai mendon se i janë pjekur kushtet që të futet në proces të kapjes së titullit “reis i plotëfuqishëm i ulemasë së BFI-së”. Me lloj-lloj përpjekjesh e intrigash, me akte kriminele e antikushtetuese, Shaqir Fetai harron se portretizon profilin e vet prej imorali, ndaj dhe, si i tillë, nuk ka se çka të pretendojë, përveç të angazhohet në këtë moshë diku në periferi dhe, të presë edhe dy vjetë e të dalë në pension.

Personat që rastësisht do ta lexojnë biografinë e fishkët dhe tepër të varfër të Shaqir Fetait, do të shohin që ai, për kushtet e sotit, i plotëson kushtet për ndonjë imam me lutje deri te xhematet e të presë kush do të bëjë merhamet që ta angazhojnë!

Në biografinë e Shaquas mund ta lexoni edhe këtë fjali:

“Themelues i Institutit për profesionalizim të Kur’anit Famëlartë”.

A është i vetëdëshëm Shaqua se çka shkruan? A nuk po bën qufarllëk me këtë fjali a jo! Epo ky është fjalori i intrigantit, hipokritit e i injorantit!

Po ashtu, biografinë e vet Shaqua e përfundon kështu: “Është dekoruar me dekorata të ndryshme, këtu po ceken vetëm dy prej shumë tjerash: Dekorata “Vehbi Dibra”, dekoratë e BFI e RMV dhe dekoratën nga Akademia Internazionale e Shkencave Sociale në Palm Beach, Florida, SHBA.”

“Vehbi Dibra” nuk është dekoratë e BFI-së, por është dekoratë personalisht e Sulejman Rexhepit! Le të na thotë Shaqir Fetai, si organ i Mulla Sulës, në cilën mbledhje të Rijasetit, në cilën ditë, muaj, vit, u themelua ky çmim si mirënjohje më e lartë e BFI-së?

Për herë të parë u dha në vitin 2011, në Takimin ndërkombëtar të komuniteteve fetare islame të rajonit. Në përmbyllje të konferencës, u dekoruan më këtë çmim krerët përfaqësues të komuniteteve myslimane në rajon, kurse nga myslimanët e Maqedonisë së Veriut, i pari që u vlerësua me këtë çmim, në po këtë konferencë, ishte sekretari gjeneral i BFI-së, Afrim Tahiri.

Shaqir Fetai nuk ka se çka të turpërohet nga fakti se ka qenë vasali më besnik i Sulejman Rexhepit. Këtë fakt nuk mund ta mohojë, siç nuk mund ta mohojë edhe faktin se me “Vehbi Dibra” e dekoroi Sulejman Rexhepi dhe jo BFI në RMV.

Kurse “dekoratën nga Akademia Internazionale e Shkencave Sociale në Palm Beach, Florida, SHBA” ia siguroi Sulejman Rexhepi (siç ia siguroi edhe atij nga Tetova, dr. Qani Nesimit).

Dhe ky Shaqir manipulanti thotë se do ta stabilizojë financiarisht BFI-në, kurse vetë ka kontribuar



deri në destabilizim dhe vështirë se mund të stabilizohet ndonjëherë. Të paktën jo prej tij, sepse tashmë është dëshmuar se Shaqua ka ndihmuar që mbi financat e BFI-së të ushtrohet masakër!

Shaqir Fetai është masakruar i BFI-së. Le ta fusë në biografinë e vet edhe këtë element, sepse do t'i bëjë hajër!

*(Almakos, 17.08.2020)*

## “Treni bullgar” i Shaqir Fetait

**Ç'hall ka Shaqir Fetai? Ç'i duhet këtij ta instalojë “bugarski vozin” në BFI?! Shaqir Fetai thjesht, po e ndjenë fundin e kohës, ndaj ai, para se t'a thërrasë “Rijasetin”, për ta siguruar fillimisht kuorumin e pastaj edhe përkrahjen, ka filluar të bredhë poshtë e lartë si pula nëpër qoshet e oborrit kur i vie veza**

**Nga Sabit Ibrahim**

Shaqir Fetait i ka ngelur hatri shumë! Na është bërë vrerë! Ai ishte buzë vdekjes, i atakuar nga virusi vdekatar, u shërua, ndërsa asnjëri nuk i shprehu urata për shëndet, për shërim e për shpëtim nga ky virus. Me pas qenë Mulla Sula, të gjithë do të radhiteshin në radhë, grupe-grupe, me tekbiere, do t'i hynin në kabinet, kush duke u përlotur e kush duke qarë me zë. Shaqir Fetain nuk e vizituan as muftinjtë e as kordinatorët, as profesorët e as pastrueset, as hoxhallarët e as mutevelinjtë. Shkurt, nuk ia futi askush. Sa të pa sjellshëm!

Megjithatë, Shaquas nuk i ngeli hatri! Sepse është në po atë siklet të pulës kur i vie veza në maje të b...

Shaqir Fetai, duke u ndjerë i diferencuar si gjithnjë nga kolegët dhe “nëpunësit e tij”, duke e ndjerë faktin që, si gjithnjë, madje as në rolin e u.d. kryetar i BFI, nuk po e bënë hesap askush, ky tash ka nisur politikën e morbidit, t'iu rraset nën lëkurë atyreve të cilët mund t'ia prishin ëndrallat karrieriste. Shaqua vërehet sa te njëri myfti sa te tjetri, sa te njëri kordinator sa te tjetri, edhe atë, i pashoqëruar dhe takimet mundohet t'i mbajë në fshehtësi, pa e ditur askush. Metodë kjo tipike e intrigantëve.

Çka ka Shaqir Fetai që është në kaq siklet të madh? Pse nuk pajtohet me faktin që ai ka qenë i përgëdhelur e i përmbajtur verbërisht vetëm nga Sulejman Rexhepi, ndërsa të tjerët kurrë nuk e kanë llogaritur as për shok e as për mik, as për kolegë e as për “profesionist”, thjesht e kanë llogaritur si i përgëdheluri i “ekselencës së tij”, Sulejman Rexhepi.

Ç'hall ka Shaqa? Ç'i duhet këtij ta instalojë “bugarski vozin” në BFI?! Shaqir Fetai thjesht, po e ndjenë fundin e kohës, ndaj ai, para se ta thërrasë “Rijasetin”, për ta siguruar fillimisht kuorumin e pastaj edhe përkrahjen, ka filluar të bredhë poshtë e lartë, si pula nëpër qoshet e oborrit kur i vie veza.

Shaqua duhet ta thërrasë “Rijasetin”, të formojë komisione, si për zgjedhje ashtu edhe për hartim të rregullores për zgjedhje të kryetarit të BFI-së dhe të shpallë konkurs, fillimin e procesit të zgjedhjes dhe, të tërhiqet me nderë. Kjo nuk arrihet duke u shëtitur me “bugarski voz” siç po e bën Shaqir Fetai.

*(Kombetare, 18.08.2020)*

## Shaqir Fetai si Dr. Adhamudhi

**Nëse Dr. Adhamudhi në letrat shqipe ka ngelur që të njihet si personazh që simbolizon oportunitetin, diletantizmin dhe snobizmin origjinal, Shaqir Fetai do të ngelë si personazh që do të simbolizojë naivin, njeriun i cili ëndërronte që të bëhet i plotëpushtetshëm, njeri që për ta bërë zhgjëndërr këtë dëshirë ireale ia mësyu që të bëhet mjeshtër i intrigave. Dhe ky personazh do të njihet si Mr. Shaqua! Mbane mend këtë emër**

### Nga Dr. Zeqie Veseli

Në letërsinë shqiptare gjendet një personazh i ndërtuar nga Çajupi (në komedinë e tij “Klubi i Selanikut”), i cili, gjithandej në publicistikën shqiptare, edhe sot e kësaj dite, përdoret si sinonim i individit diletant, parazit e oportunist.

Intrigat dhe të qenurit gjithmonë pranë pushtetarëve, e bën dr. Adhamudhin personazh sa të rrezikshëm aq edhe injorant, sa grotesk aq edhe ironik, sa qesharak aq edhe neveritës. Dr. Adhamudhi, gjithnjë del nga situatat e palakmueshme duke u mbështetur në përkrahjen e parezervë të pushtetit, qoftë ky pushtet sulltanësh, mbretërisht apo edhe klerikësh ortodoksë. Falë kësaj mbështetje ai më tepër e bën jetën e një paraziti dhe të një oportunisti të pashembullt.

Dr. Adhamudhi në vend të vet imponohet si i patejkalueshëm, ndaj dhe mundohet që profesionin e vet, mësimet e veta diletanteske t’i shtrijë edhe jasht kufijve të vendit. A e keni parë dr. Adhamudhin tonë, Shaqir Fetain! Që kur e bëri puçin në BFI, a është dëgjuar më, sidomos nga 15 qershori e deri në konstituimin e Qeverisë së RMV-së? Nuk u dëgjua, sepse, si parazit që është, ai nuk mund të frymojë pa e injektuar partia mëmë e tij, BDI-ja! Ai mendon se, tani, meqë BDI sërish është faktor në Qeveri, tash do ta shihni se kush është Shaqua trimi! Sikur edhe 1000000 BDI të radhiten, Shaqua duhet të ecë, sepse BFI nuk është as organ dhe as filiale e BDI-së, sepse, BFI ka Kushtetutën e vet, ka rregulloret e veta dhe i ka aktet e veta të cilat në asnjë pikë nuk përputhen me BDI-në! Prandaj, dr. Adhamudhi i BFI-së këtë duhet ta ketë të qartë dhe sa më parë duhet t’i hyjë procedurës së organizimit të zgjedhjeve, pa taktizime dhe majmunllëqe të ndryshme. Mbi të gjitha, BFI-ja i ka teologët e vet, hoxhallarët e imamlerët që kanë ditur historikisht t’ua prishin pazaret idiotike të gjithë atyreve që kanë manipuluar në emër të fesë islame dhe në emër të kombit shqiptar.

Nëse Dr. Adhamudhi ka ngelur në historinë tonë, qoftë kjo edhe letrare, si personazh që simbolizon oportunitetin, diletantizmin dhe snobizmin origjinal, Shaqir Fetai do të ngelë si personazh që do të simbolizojë naivin, njeriun i cili ëndërronte që të bëhet i plotëpushtetshëm, njeri që për ta bërë zhgjëndërr këtë dëshirë ia mësyu që të bëhet mjeshtër i intrigave. Dhe ky personazh do të njihet si Mr. Shaqua! Mbane mend këtë emër!

Mr. Shaqua vuan nga miopia, kurse pandami i tij, dr. Adhamudhi ishte okulist i njohur! Dr. Adhamudhi profesionin e tij e ushtroi në Lozanë, në Misir, në Stamboll, në Selanik, kurse Mr. Shaqua “afinitetet e veta organizative”, meqë i rrumbullakësoi në Maqedoninë e Veriut, tani pretendon t’i shtrijë të njëjtat afinitete edhe në komunitetin tonë në Itali, në Austri, në Gjermani etj.

Kësisoj, Dr. Adhamudhi dhe Mr. Shaqua na dalin dy vllëzër siamezë, ndonëse në një distancë kohore prej një shekulli, megjithatë, në shpirt e në pamje, identikë, të njëjtë. Shyqyr Zotit që realiteti i tyre

është vetëm një fiksim i krijuesve letrarë, të cilët karakteret e tilla dinë t'i jetësojnë nëpër vepra të karakterit komik! Me u kënaqë duke qeshur!

*(1Kliklart, 26.08.2020)*

## Shaqir Fetai me trimëri prej Goliathi për të tradhëtuar miq e parime

**Sulejman Rexhepi, “babai shpitëror” i Shaqir Fetait, e kishte një ditë kur i mblidhte të gjithë teologët tanë që shërbejnë në diasporë, mbante takim të përbashkët! Tani Shaqir Fetai, mbanë takim sy më sy me teologët nga diaspora, sa për të shënuar ndonjë “aktivitet” dhe për të siguruar përkrahje për një post që po mundohet ta vjedhë**

**Nga Burim Muniri**

Shaqir Fetai ka zgjedhur strategjinë “hap pas hapi” të vjedhjes së postit kryetar të BFI-së! Ditë për ditë, nga pak. Në ç’mënyrë?! Duke pritur “mysafirë” në cilësi të “kryetarit” dhe duke liferuar informacione se “sot, kryetari i BFI-së, Shaqir Fetai...”! Sot, kryetar, nesër kryetar... përjetë kryetar! Majc!

Me këtë, Shaqir Fetai veçsa po e dëshmon vullnetin, gatishmërinë dhe “fuqinë” prej Goliathi, për t’u përballur me miqtë, me bashkëpunëtorët me të cilët deri dje besnikërisht i shërbeu Sulejman Rexhepit, me qëllim që t’ua dëshmojë afinitetet e tij për t’i tradhëtuar jo vetëm ata por edhe parimet e përgjithshme, në veçanti, parimet islame.

Shaqir Fetait vazhdimisht i thuhet që mos të rrejë se, nuk është “kryetar” por është ushtrues detyre kryetar i BFI-së, i cili, patjetër që do të duhet t’i nënshtrohet ligjeve të vendit, të cilët shumë qartë nënvizojnë se, ushtruesi i detyrës në afat prej gjashtë muajve duhet t’i kryej të gjitha procedurat për zgjedhje të kryetarit, apo të drejtorit, duke e përjashtuar veten nga garat, për shkak të konfliktit të interesit!

Një grup teologësh janë shumë seriozë në qëndrimet e tyre për ta paditur Shaqir Fetain, alias, Mr. Shaquan, pandamin e Dr. Adhamudhit legjendar, për prezantim të rrejshëm, për manipulim të opinionit dhe për përpjekje për ta uzurpuar një post në mënyrë jo të ligjshme. Të gjitha këto tre veprime të Shaqir Fetait paraqesin vepër penale!

Shaqir Fetai përmes bastardëve gebelsianë mundohet të informojë se po bën aktivitete shumë të rëndësishme, se po pret aktivistë kombëtarë e fetarë nga diaspora, ndërkohë që aktivistët fetarë e kombëtarë të vendit nuk po ia çokin! Pastaj, ky farë i vetëshpalluri “kryetar i BFI-së”, po u fliska atyre se si duhet të organizohen në diasporë dhe po ua shpaloskëka vizionin e tij si dhe programin për një BFI të ardhshme. Shaqir Fetai, këta aktivistë patriotë e fetarë edhe po i manipulon edhe po i rrenë.

U bënë tre muaj që kur Shaqir Fetai kumtoi shkarkimin e Sulejman Rexhepit për shkak të shkeljes së Nenit 58 dhe që kur mori përkrahjen e “kolegëve” të tij për t’i organizuar zgjedhjet për kryetar të ardhshëm. Ndërsa ky, si hajn i përkryer, ua vodhi këtë vullnet të sinqertë dhe ua përktheu si punë të kryer: përcaktimin kolegjial të përkohëshëm e mori si vendim përfundimtar që cakton Mr. Shaquan “kryetar të BFI-së”!

Në bazë të dispozitave ligjore të vendit, Shaqir Fetait i mbeten edhe tre muaj “free” për të thirrur qoftë edhe një mbledhje formale të Rijasetit, për ta caktuar mbledhjen e ardhshme në të cilën do të zgjidhet komisioni për hartimin e Rregullores për zgjedhje të Kryetarit të BFI-së, sepse, BFI-ja nuk e ka një rregullore të tillë.

Një jetë të tërë ta kaloshë si bandit, si hajn, si miratues i hajnive, si kodosh e karagjoz dhe në fund të tentoshë që të vdesësh si “reis” – kjo nuk dot t’i shkojë ndoresh Shaqir Fetait. Mr. Shaqua, pandami i Dr. Adhamudhit, duhet ta ketë të qartë se, numri i teologëve të vendit, të cilët janë tejngopur me veprime banditeske e të kriminalizuara, është gjithnjë e në rritje dhe, revolta e tyre sa nuk ka shpërthyer. Ata duan një kryetar legjitim, të zgjedhur prej tyre dhe prej përfaqësuesve legjitim të tyre, e jo kryetar gjyqësor, policor e partiak siç po imponohet axhamiu, Shaqir Fetai.

Shaqir Fetai ka edhe një hall! Në moshën 62 vjeçare do të vetëzgjidhet “kryetar i BFI-së”, sepse, kështu i thotë mendja e tij prej hajni! Duke qenë në krye të Institucionit do të gëzojë edhe paprekshmëri nga organet e drejtësisë për çdo veprim që ka bërë, që bën e që do të bëj! Ai ka lejuar, ka votuar dhe ka miratuar vjedhjen e pronave dhe të parave të vakëfit që u vodhën gjatë pesë viteve të fundit, nga koha kur Afrim Tahiri e la postin e sekretarit gjeneral të BFI-së! E ka frikën nga manipulimi me vakëfin e Gostivarit si dhe me mosrealizimin e një prej vakëfeve që do t’ua investonte dhe dhuronte Banka Islamike për Zhvillim. Prandaj Shaqir Fetai i shmanget debatit dhe takimit me Afrim Tahirin, me bartësin e idesë dhe projektit për reforma të thella në BFI. I druhet skuqjes para tij, i druhet qortimit prej tij, i druhet fakteve, dokumentave dhe argumenteve me të cilat mund ta përballë Afrim Tahiri. Gjatë këtyre tre muajve edhe vegjetimin në BFI Shaqir Fetai e ka pasur antikushtetuese, sëkëndejmi, me një shkelës të tillë të Kushtetutës së BFI-së, asnjë mysliman i sinqertë nuk e beson se H. Afrim Tahiri do të pranonte që të ulet në marrëveshje me një hajn, manipulant, kodosh e tradhëtar siç është Shaqir Fetai. Me të nuk ka bisedime e marrëveshje, me të ka vetëm ballafaqime nëpër organet e drejtësisë. Këtë e di edhe vetë Mr. Shaqua.

Kot e ka Shaqir Fetai, nuk mund të shitet si engjell kur të gjitha faktet dhe argumentet dëshmojnë se ai është një bastard i vogël i shejtanit, nëse jo vetë shejtani. E ka rastin historik që të ikë nga ky etiketim duke e kryer procesin e zgjedhjes së kryetarit të BFI-së dhe duke u tërhequr në pension! Me hajni e tradhëti Shaqir Fetai nuk mund të bëjë karrierë.

*(Opinione, 28.08.2020)*

## Mendjemadhësia e një rrencaku

**“Sindroma e Napoleonit” na qenka një kompleks i pashërueshëm që tërë jetën i përcjell personat që kanë përjetuar superioritetin e të tjerëve. Ky kompleks theksohet sidomos te personat shtatëshkurtër, “shkurtabiqët”, të cilët ëndërr e kanë që, qoftë edhe vetëm për një orë, t’u prijnë mendjendriturve, strategëve, gjigantëve për nga fama. Nga ky kompleks vuan Shaqir Fetai! Për t’i shëruar frustracionet e veta, kjo tip krijese inferiore, e përdor tej mase intrigën, rrenën por edhe kodoshllëkun nga i cili merr duartrokitje prej më “të fortit”**

### *Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI*

Në Institucionin e BFI-së, nëpër sektorë të ndryshëm, tërë ditën ndodhë që hynë e dalin persona të ndryshëm nga vendi e diaspora. Ka ndodhur kur edhe janë gostitur me çaj e me dreka, me ndonjë kafe a bakllavë, me lajthia e me fëstikë. Vizita e tyre mund të ketë qenë private apo edhe me pune, për të marrë ndonjë libër a dokument. Kanë hyrë e dalur lloj-lloj fuksi, lloj-lloj përhapësi i ideologjive që nuk i bëjnë nder as fese dhe as kombit. Kanë mbaruar punë dhe kanë ikur. E tërë kjo llogaritet vetëm si aktivitet personal i mysafirëve dhe assesi i Institucionit.

Sot, në kohën e okupimit naiv të BFI nga Shaqir Fetai, secilit që i pihet një çaj rusi në këtë Institucion, apo, secili që ftohet sa për ta mashtruar opinionin dhe për të krijuar iluzione se, “ja, ja, nuk po rreshtin vegjëlja duke ia uruar zgjedhjen kryetar Shaqir Fetait”, ky “hamam i Hyrës” menjëherë e publikon këtë “lajm senzacional”, sepse nuk po ia varë askush, e kjo po ia shton edhe më shumë “kompleksin e Napoleonit.” Shaqir Fetai duhet të skuqet pak nga rrenat e veta kur thotë se “mysafirët e çajit të rusit po mrekullohen nga zhvillimet e reja në BFI dhe se po kërkojnë që t’u ndihmojmë në organizim të jetës fetare edhe në diasporë”! Për çfarë zhvillime të reja e ka fjalën Shaqir Fetai?! I vetmi zhvillim është dëbimi i Sulejman Rexhepit, tallja me kolegët e deridjeshëm që tashmë me të drejtë po ndjehen si të mashtruar e të tradhëtuar nga Shaqir Fetai dhe, prezantimi i rrejtshëm si “kryetar” për ç’gjë po lutet natë e ditë që ta lëmë rehat dhe mbi këtë krim, mbi këtë vepër penale, të bëjë karrierë të paktën katërvjeçare. Sepse i duhet rroga e reisit për pension, dëshiron të sigurojë një pension më të madh se me rrogën e Myftiut. Ja pra, kjo është strategjia e vetme e Shaqir Fetait, i cili, ndonëse baba e gjysh, shumë merak e ka gënjeshtrenë, madje gënjenë pa iu skuqur fytyra asnjë sekond.

Nuk ka Institucion e faktor relevant ndërkombëtar që nuk i është drejtuar Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI për ta verifikuar “lajmin” se, “Shaqir Fetai u zgjodh Kryetar dhe reis i BFI-së” dhe, pasi njohtohen me të vërtetën, të gjithë ndjehen të zhgënjyer, ndjehen se kanë qenë në lojë dhe të manipuluar.

Thonë: rrena i ka këmbët e shkurta! Këto këmbë shkurtabiqi në trup të shkurtë mbajnë vertikalisht vetëm “Kompleksin e Bonapartës”! Këta nuk janë persona në nevojë që duhet ndihmuar, as të sëmurë, këta janë persona të rrezikshëm që veç dëm i sjellin shoqërisë.

Të thuash me një krenari prej manjaku se në takim të konsumuesve ditorë të çajit të rusit u biseduan për “frymën e re dhe për vizionin e ardhshëm që e pret BFI-në”, është tallje me dinjitetin e vizitorit të sinqertë. Sepse, kush është Shaqir Fetai që ta zë ngoje fjalën “vizion”, apo çka i duhet kjo fjalë? Për cilin vizion e ka fjalën ai, ku e prezantoi atë, kush ia pranoi, kush ia miratoi, ku u debatua ai vizion,

ku u shpalos... Shaqir Fetai të vetmin vizion e ka të zhduke gjurmët e krimit ku është i përfshirë ai dhe të vazhdojë me vjedhjen e pasurisë së BFI-së. Ky nuk është synimi i tij, pasuria e vjedhur është vetëm mjet për ta realizuar më lehtë synimin e tij! Ai synon kaosin në BFI dhe shkatërrimin e saj. Medet!

*(1Kliklart, 1.09.2020)*



## “Shaqir Fetai” dhe – gjithçka mbrapsht

Dy Myftinitë (e Shkupit dhe e Tetovës) që nuk po pajtohen me sjelljet karrieriste të Shaqir Fetait, “sulmohen” nga policia financiare (mbase me urdhërin partiak të Shaquas, për inat dhe sa për hakmarrje kundër “rrebelëve”), kurse “reisi” e viziton Myftininë e Manastirit për t’ia dhënë një “dekoracia” “Myftiut” Hamit Rasimi! A është normal ky njeri që funksionon krejt mbrapsht

Nga Haxhi Isa Xhaviti

“Reisi” i mendermethëshëm, Shaqir Fetai, me një karrierë si të Kuazimodës, ditë më parë kishte informuar opinionin e gjërë se së shpejti do ta vizitojë Myftininë e Manastirit (thuase i hante b... opinionit për lëvizjet e kota të Shaquas) me qëllim që ta shijojë bukurinë e qytetit të Manastirit si dhe të njohtohet me programin e Myftiut! Ja edhe një prononcim i Shaqir Fetait që dëshmon se i gjori nuk ka dy lidhje me lidërsip dhe nuk ka mend sa...

Që të dy këta myftilerë njihen fort mirë në mes vete. Që të dy të vetmin program e kanë pasur si t’i knaqin orekset grabitqare! “Reisi i zgjedhur” shkon për ta prezantuar programin e vet dhe për të kërkuar nga Myftinjtë që të zbatohet në përpikmëri programi i “reisit” dhe, jo anasjelltas! Por, çka do të prezantojë Shaqir Fetai i cili edhe vetë e di, si Zoti që është Një, se po e vjedh postin, se po lëshon rrënjë të pista në “reisllëk”, se nuk ka kurrfarë vizioni dhe kurrfarë programi. Fundja, një gjë e tillë nuk i kërkohet uzurpatorit, manipulatorit dhe intrigantit. Edhe në këtë rast “reis Kuazimoda” dëshmon që, vetëm bërtit “Shaqir Fetai” dhe – gjithçka mbrapsht do të shkojë!

Shaqir Fetai na paska thënë se “Xhamitë janë zyret tona”, sapo e paska marr përgjegjësinë “për të udhëhequr me Bashkësinë Fetare Islame në Maqedoninë e Veriut”!

Xhamitë janë Shtëpitë e Zotit, të destinuara për t’u falur dhe për t’iu lutur Krijuesit të Gjithësisë! Xhamitë nuk mund të bëhen zyre të hajnave, të manipulantëve dhe keqpërdoruesve të vakëfit, nuk mund të jenë zyre të munafikëve, shkelësit të besimit dhe amanetit të shokëve! E dyta, Shaqir Fetai po bëhet gjithnjë e më i qartë se, është në gjendje edhe të hedhë “bombën atomike” e t’i pëlcasë të gjithë shokët, miqtë dhe kolegët e deridjeshëm të tij! Ata i besuan që ky t’i prijë procesit të zgjedhjeve të Kryetarit të BFI-së dhe në asnjë moment nuk e caktuan si drejtues të këtij Institucioni. Këtë e nënvizon edhe vetë Shaqir Fetai, para mediave si dhe para shokëve që u pajtuan që ai të jetë vetëm në krye të procesit zgjedhor dhe hiç më tepër. Shaqir Fetai, kësisoj, po bëhet shkelësi edhe më i tmerrshëm i Kushtetutës ekzistuese të BFI-së dhe kjo po i shqetëson të gjithë ata që e shkelën këtë akt më të lartë juridik të BFI-së dhe që nuk dëshirojnë më për asnjë çmim që të vazhdohet me këtë gjest antimysliman e antiislam. Por, kjo po i pëlqen Shaqir Fetait, këtij shkelësi absolut të Kushtetutës si dhe të akteve të tjera normative të BFI-së.

Shaqir Fetai është dashur të bëjë pranim dorëzimin e detyrës, është dashur që ta shfletojë arkivin financiar, keqpërdorimet dhe dëmet në pronën e tundshme dhe të patundshme të BFI-së! Shaqir Fetai është dashur që të kërkojë që policia financiare ta krehë dokumentacionin e Myftinisë së Resnjës, të Prilepit, të Manastirit, të Gostivarit dhe jo “myftinjtë rrebelë” kundër tij! Të kërkonte aty ku vlojnë dokumentat që flasin për vjedhje të tmerrshme, të cilat i ka mbuluar, i ka përkrahur dhe i ka stimuluar edhe vetë Shaqir Fetai si antarë i Rijasetit. Mos ta luajë “melaqen e mullirit” kur dihet se vetëm thauj

“Shaqir Fetai” dhe – gjithçka mbrapsht! Zoti nuk i ndihmon këta tipa kaq të xhindosur e të djallëzuar. Këtij fakti po i bindet gjithnjë e më shumë edhe vetë “reis Kuazimoda”, mr. Shaqua, pandam i dr. Adhamudhit!

*(1Kliklart, 4.09.2020)*

## Dhjetë arsye për një thirrje urgjente të rijasetit

**Shaqir Fetai sillet si p... në tirqi nëpër myftini që udhëhiqen nga koordinatorë, duke u premtuar se do t'ua "konfirmojë" titullin myfti nëse e përkrahin në këtë situatë katastrofale ku e ka futur veten. Meqë i tradhëtoi të gjithë kolegët, të cilët unanimisht vendosën që t'iu prijë proceseve për zgjedhjen e reisit të BFI-së, tashmë mbi tre muaj nuk iu përgjigjet për mbledhjen e parë të Rijasetit**

**Nga Dr. Zeqie Veseli**

Janë një mal arsyesh që e detyrojnë Shaqir Fetain për ta thirrur mbledhjen e parë të Rijasetit. Ndër arsyet e fundit është që ta thërrasë për ta caktuar datën e zgjedhjes së reisit të BFI-së, sepse ai u përzgjedh nga kolegët e vet për këtë proces kaq shumë të rëndësishëm dhe, vendimtar, për Institucionin e vetëm islam në Maqedoninë e Veriut. Tashmë është konstatim i pamohueshëm se, Shaqir Fetai i tradhëtoi të gjithë, të gjithë kolegët e vet, se ua mori besimin dhe amanetin vetëm sa për të ardhur në pozita prej nga do t'i mohonte të gjithë. Me këtë gjest, në fakt Shaqir Fetai po i hap gropë vetes, nuk po e sheh se po e vulosë përjetë karrierën e vet prej teologu. Të punoshë në kundërshtim me parimet islame, absolutisht nuk e ke të drejtën të quhesh teolog por – shejtan!

Shaqir Fetai e ka shumë gabim nëse mendon se do t'i duhet që t'i shfrytëzojë plotësisht gjashtë muajt e paraparë me ligj për ushtruesin e detyrës. Ligji shumë qartë thotë se, brenda gjashtë muajve duhet të kryhet procedura e zgjedhjes së të parit të institucionit dhe, jo që ushtruesi i detyrës të rrijë gjashtë muaj e pastaj edhe nja gjashtë vite të tjera deri sa të përfundojë procesi i zgjedhjes.

Shaqir Fetai e vërtetoi atë konstatim të teologëve më të vjetër, të bashkëpunëtorëve të tij si dhe të eprorëve të më hershëm se, kemi të bëjmë me një karakter shumë të keq, pa personalitet dhe tepër tradhëtues!

Sot, mund të numërtohen qindra arsye se pse Shaqir Fetai është dashur të thërrasë mbledhjen e Rijasetit por, le të na lejohet që t'ia përkujtojmë të paktën dhjetë arsye:

Shaqir Fetai është dashur ta thërrasë Rijasetin që t'i raportojë për dëmin e madh financiar e pronësor që i është bërë BFI-së për këtë gjysëm dekadë, që kur Afrim Tahiri, sekretari gjeneral i BFI-së, e la këtë Institucion në duart e hijenave;

Shaqir Fetai është dashur ta thërrasë mbledhjen e Rijasetit me qëllim që të raportojë mbi raportet zero në mes të BFI-së dhe besimtarëve të fesë islame në RMV;

Shaqir Fetai është dashur ta thërrasë mbledhjen e Rijasetit për të përgatitur Raportin e domosdoshëm Kuvendit të BFI-së;

Shaqir Fetai është dashur ta thërrasë mbledhjen e Rijasetit për të shprehur pendesë dhe për t'i kërkuar falje publike opinionit të gjërë që për gjysëm dekadë e ndihmuan krimin dhe kriminalizimin e BFI-së;

Shaqir Fetai është dashur ta mbledh Rijasetin dhe të raportojë mbi situatën financiare të BFI-së si

dhe mbi shkatërrimin e burimeve financiare të BFI-së, si pasojë e keqmenaxhimit financiar të këtij Institucioni;

Shaqir Fetai është dashur ta mbledhë Rijasetin që kolektivisht të ngrisin aktpadi kundër të gjithë matrapazëve, hajnave dhe shpërdoruesve të financave të BFI-së;

Shaqir Fetai është dashur ta thërrasë mbledhjen e Rijasetit për të debatuar rreth shkeljeve që i janë bërë Kushtetutës së BFI-së;

Shaqir Fetai është dashur ta thërrasë mbledhjen e Rijasetit për të zgjedhur komisionin i cili do të hartonte Rregullore për zgjedhje të Kryetarit të BFI-së;

Shaqir Fetai është dashur deri më tani që t'i mbledhë anëtarët e Rijasetit (vetëm ata që i parasheh Kushtetuta aktuale e BFI-së ) dhe të caktohet Komisioni i cili do t'i prijë me përgjegjësi BFI-së dhe procesit të zgjedhjes së Kryetarit të BFI-së;

Shaqir Fetai është dashur ta mbledhë Rijasetin dhe të vendosë për datën e zgjedhjes së Kryetarit të BFI-së dhe dorëzimin e Menshurës;

Shaqir Fetai, nëse për asgjë tjetër, të paktën deri më sot, është dashur që ta mbledhë Rijasetin dhe t'iu drejtohet anëtarëve të saj duke e deklaruar paaftësinë e vet për të menaxhuar me BFI-në, për shkak të, mbi të gjitha, humbjes së besueshmërisë prej bashkëpunëtorëve të vet, si pasojë e matrapazllëqeve në zhdukje totale të gjurmëve të kriminalizimit të BFI-së.

Këto lëshime nga Shaqir Fetai nuk bëhen se ai nuk i di dhe se është naiv, por, thjesht, sepse ky është stili i bashkëpunëtorëve operativë! Kur të gjithë të lodhen kundër Shaqir Fetait, ai do të ndjehet i nevojshëm për t'ju dhënë apo edhe për t'ua "konfirmuar" postin. Me këtë rast, Shaqir Fetai do të pranohet si "prijës i mirë"! Por, kjo mbetet vetëm strategji, tashmë Shaqir Fetain të gjithë eprorët e më hershëm, bashkëpunëtorët e tij por edhe myslimanët e vendit e përceptojnë si një qenie të ligë, si një shejtan të llojit të vet! Myslimanët e Maqedonisë së Veriut kanë dëshmuar se me shejtana e me fuksa nuk janë të gatshëm të bashkëpunojnë! Kurrë!

*(Fokusi, 6.09.2020)*

## Halabakizmi

**Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI të RMV-së, tash e gjashtë vite ngre shqetësimin se pse mediat tona as nuk pasqyrojnë por as nuk analizojnë atë se çfarë po ndodhë me BFI-në dhe brenda BFI-së; tash e gjashtë vite ka kërkuar debate televizive, kryqëzime të fakteve dhe argumentave. Tash e gjashtë vite i ka lutur mediat e vendit, gazetarët që, mos të bëhen objekt talljeje duke thënë “gazetarëve ua mbyllim gojën me një kuti mish kurban”...**

### Shkruan Abaz Islami

Televizioni nacional shqiptar Alsat M, paska tentuar që ta thyej heshtjen e BFI-së rreth asaj se çfarë po ndodhë brenda këtij Institucioni. Fatkeqësisht, kontributin televiziv e nis me këtë konstatim zhgënjyes: “Bashkësia Fetare Islame mbetet i mbyllur për mediat dhe opinionin. Katër muaj pas largimit të Rexhepit, ushtruesi aktual i detyrës Shaqir Fetahu, heziton të përgjigjet në pyetjet e Alsat lidhur me organizimin e zgjedhjeve në BFI. Nga ky Institucion madje nuk përgjigjen as pyetjeve se cilat janë arsyt konkrete për shkarkimin e Rexhepit e as për keqpërdorimet eventuale të bëra.”

Në këtë konstatim janë dy-tre detaj në të cilat qëndron djalli dhe, nëse preken këto detaje, atëherë përmbysset gjithçka dhe e vërteta del në shesh! Nga kjo e vërtet tash e gjashtë vite rradhazi frikësohet dhe fshihet edhe Shaqir Fetai, si kryeintrigant, bashkë me “myhybët e vet”, të cilët, në fund, dëshmuar se paskan qenë ata dezertorë dhe puçista që një ditë do ta lidhnin Sulejman Rexhepin dhe “kalanë do t’ia rrëmbejnë nga brenda”! Kështu ndodhë, rëndom, nëpër filma! Por, në rastin konkret, në BFI, kemi të bëjmë me ngjarje të vërteta, me aktorë të gjallë, me veprime të përsëritura në vazhdimësi të cilat bijnë ndesh të gjitha parimeve fetare, morale, shoqërore. Sepse, këta veprime janë kriminale, veprime që kriminalizojnë Institucionin. Kur një institucion kriminalizohet atëherë i bie që të gjithë brenda tij janë të inkriminuar dhe, nga të inkriminuarit nuk mund të pritet as zbardhje të rasteve dhe as shpëtim të Institucionit. Këtë fakt të pamohueshëm e dijnë edhe mediat. Në krejt botën e kulturuar mediat, në raport me krimin, mbajnë anën e drejtësisë dhe, i bëjnë presion organeve gjegjëse që ta pastrojnë shoqërinë nga të inkriminuarit që mbajnë peng një të vërtetë, një institucion, një rast, apo edhe një shtet! Nëse nga të inkriminuarit që kanë intimiduar thellë në vepra penale kërkohet shpjegime, opinione dhe “analiza profesionale”, natyrisht që nuk kemi bërë asgjë tjetër përveçse u kemi dhënë rast që të amnistohen nga krimi i kryer bashkarisht. Nisur nga një logjikë shumë e çiltër e gazetarit të padjallëzuar të Alsat-it, ai paskësh shtruar edhe pyetje të natyrës “a kanë filluar hetimet për keqpërdorimet eventuale të fondeve të këtij Institucioni”, “si u mundësua që në vakëfin e BFI-së që ndodhet tek ish-higjierna komunale të ndërtohet ndërtesë e madhe dhe a është shitur ky vakëf.” etj. Natyrisht që gazetari do të hasë në injorim, në heshtje të pakuptimtë dhe në disa përgjigje banale që më tepër gjasojnë në reagim që shprehin frikë e tmerr. Nuk guxon të vazhdojë loja “ma mbaj bastardin sa nuk më ka mbetur mua në duar”! Qenka fajtor Sulejman Rexhepi dhe jo edhe Shaqir Fetahi dhe fetahat e tjerë të Rijasetit? Sulejman Rexhepi nuk do të mund të zhvillohej në kaq “problematik” nëse nuk do të ndihmohej apo, nëse do të pengohej nga Shaqir Fetai dhe nga anëtarët e tjerë të Rijastit të tij prej marionetave! Po flitet se Sulejman Rexhepi me kohë paska qenë i përgatitur që një ditë përgjegjësia mos të bie vetëm mbi të por të jetë kolektive! Nga zyrtari i arkivit të BFI-së ai tashmë i ka të siguruar të gjitha “vendimet” që janë sjellë nëpër mbledhje (!!!) të Rijasetit ku është vendosur për gjithçka! Në këtë rast është vepruar me vendim të Rijasetit! Po këta tipa që “dezertuan” nga harami, a nuk paskan qenë edhe vetë në haram a? Nuk ka shfaqësia pa

kërkim falje! Megjithatë, gazetari i Alsat-it arrinë që të nxjerrë një “përgjigje”! Dikush nga brenda BFI-së i paska thënë: “Është më se e vërtetë se tani kemi analizuar situatën e BFI-së. Në momentin kur do të vendosim, ne do u thërrasim të gjitha mediave, ku do t’i shpalosim mendimet tona në lidhje me këto çështje. Ne kemi thënë se do të jemi të hapur për të gjitha mediat, jo vetëm kështu nëpër prese të ndryshme. Jemi të gatshëm që të marrim pjesë edhe në emisione të juaja, intervista e kështu me radhë”! Në këtë përgjigje janë dy-tre elemente që duhet ta ngrisin peshë median shqiptare! Po pse a këta duhet ta analizojnë situatën? Kush ua ka kërkuar analizën? Ata aty janë për konstatime të fakteve të publikuara, për zbardhje të akuzave si dhe për nxjerrje të fajtorëve para drejtësisë, qofshin këta fajtorë edhe vetë “konstatuesit”! Nuk mundet që deri dje t’i duartrokasë Sulejman Rexhepit, t’ia “miklojë shpinën për fetar e kombëtar të madh”, ta lusë Zotin që t’i japë shëndet, ndërsa sot, ta mohojë dhe të pretendojë se pasi e largoi ky duhet të jetë zëvendës i tij! Shiko “trimërinë”?! Në momentin që do të vendosin ata dhe jo kur të interesohet media, do ta shpalosin “analizën” e tyre? Nuk ka në botë që kriminelit t’i lejohet të bëjë analizë dhe të shprehet kur të dojë ai vetë! Qenkan bashkëpunues të mirë me mediat! Nuk qenkan vetëm për press-a, por edhe për pjesëmarrje në emisione si dhe në intervista! Po në debate me oponentët, me ata që janë pronarë të së vërtetës në rastin konkret? U bëjmë thirrje të gjitha mediave të vendit, të cilat kanë nevojë për t’u sqaruar sa më profesionalisht, që kanë nevojë për fakte e për argumente, që kanë nevojë edhe për anën tjetër të medaljes, lirisht le të drejtohen te drejtuesit e Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI të RMV- së, sepse në mënyrë shumë objektive, pa kurrfarë tendence, pa më të voglin mundë për manipulim e akuza të pabaza, do t’ju shpalosim shumë tema interesante, probleme, fakte, dokumenta. Matrapazët nuk janë në pozita, madje as që duhet të lejohen, që të tallen me mediat tona! Mjaft më, në emër të respektit ta paluhatshëm ndaj Institucionit, u ledhatuan dhe u kursyen edhe halabakët që nën petkun fetar tash e gjashtë vite u tallën me islamin dhe e turpëruan çdo mysliman të vendit.

*(Tetovasot, 10.09.2020)*

## Shaqir Fetai ky halabak i pakonkurrencë

**Atë, për të cilin ke nevojë mos e gënje! Atë, prej të cilit dëshiron të varesh mos e manipulo! Atë, i cili të heton se po e gënjen, më mirë kërkoi të falur se sa të vazhdoshë ta gënjeshtë! Shaqir Fetai në Emiratet e Bashkuara Arabe paska shkuar me një valixhe gjigante me gënjeshtër dhe, prej aty, gënje arabët, gënje popullin këtu. Me gënjeshtër e me imagjinatë halabakësh nuk krijohet imazhi**

**Nga Haxhi Isa Xhaviti**

Shaqir Fetai na qenka në mes të Ebu Dhabit, në takimin ndërkombëtar të radhës të organizuar nga Këshilli ndërkombëtar i pakicave myslimane. Edhe kjo organizatë, si të gjitha organizatat e tjera ndërkombëtare, qoftë turko-arabe, qoftë perëndimore, janë njohtuar hollësisht nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI se kush është Shaqir Fetai, çka përfaqëson Shaqir Fetai, nëse jo halabakët që gënjeshtërës i thonë gjë e shenjtë dhe të vërtetën e mallkojnë deri në ditën e Kiametit, çka në të vërtetë është Shaqir Fetai, nëse jo puçist dhe uzurpator i ri i Institucionit të BFI-së, të cilën po e mban peng deri sa të zhduken të gjitha gjurmët e tij në kriminalizimin dhe në dështimin e BFI-së!

Arabët e kanë ftuar vetëm sa për ta testuar dhe sa për t'i verifikuar të gjitha të dhënat mbi këtë halabak, ashtu siç do ta fusin në skaner edhe organizatat perëndimore, së shpejti! Sepse, mbarë bota normale e di se Shaqir Fetai është përzgjedhur (nga shokët e tij të diskutueshëm) si ushtrues detyre sa për ta zgjedhur kryetarin e BFI-së pas shkarkimit të Sulejman Rexhepit dhe se, ai në asnjë mënyrë, ligjërisht, nuk mund të konkurrojë e as të zgjedhet për kryetar, sepse, një akt i tillë do të paraqiste konflikt interesi. Ligjërisht, kjo është e vërteta, kurse moralisht, krejt bota e di se Shaqir Fetai ka një kontribut të jashtëzakonshëm në kriminalizimin e BFI-së.

Shaqir Fetai gënjen pa fije turpi kur thotë se “Këshilli Botëror i Komuniteteve Myslimane hap dyert e bashkëpunimit me BFI-në”? Do me thënë u desht një Shaqir Feta që të ndodhë kjo mrekulli! Kë e gënjen ky farë halabaku që ia ka ënda ta thërrasin “kreu” apo “reisi”!

Shaqir Fetai duhet ta ketë të qartë se opinionin e vendit e di fort mirë që, më 9 maj të vitit 2018, Dekani Shaban Sulejmani, në emër të reisit të atëhershëm, në selinë e kësaj Organizate ka nënshkruar Dokumentin e anëtarësisë të rregullt në këtë Këshill botëror, në të cilën BFI e RMV-së është anëtare themeltare. Së këndejmi, çfarë është gjithë ky eksitim dhe tërë ky opus i gënjeshtërave nga Shaqir Fetai?! Si guxon ai të theksojë se delegacioni i tij qenka pritur me protokol të veçantë? Bëhet fjalë për Shaqir Fetain si mbret, si ministër, si kryepar i ndonjë asociacion organizatash botërore, apo, thjesht, si një gënjeshtar, manipulants dhe halabak! Na e tregon edhe emrin e Hotelit ku e paskan vendosur! Kjo dëshmon se ai, daljen jashtë Çegranit e percepton si arritje personale mbi “rëren” e Marsit!

Ndryshe, kjo organizatë ndërkombëtare debaton ekskluzivisht mbi probleme me të cilët përballen myslimanët, në veçanti me dukuritë që manifestohen në emër të islamit e që po e dëmtojnë shumë këtë fe. Sfidat më të reja janë luftërat kundër radikalizmit ekstrem, terrorizmit dhe islamofobia. Ndaj dhe, përfaqësuesit e kësaj organizate jo njëherë ia kanë tërhequr vërejtjen Shaqir Fetait që mos të ekzagjerojë “luftën e BFI-së” si dhe mos të përhapë nebulozë e mjegulla për angazhimin e BFI-së në këtë drejtim, duke ia theksuar vazhdimisht aksionin e këtoditshëm policor në Kumanovë ku u kap

një celulë e pjesëtarëve të ISIS-it.

Po ashtu, nga një kanal diplomatik rrjedh informata se si arabët kanë ngelur të zhgënjyer me Shaqir Fetain, i cili, asnjë fjalë nuk e tha për keqmenaxhimin e parave të BFI-së, ndihmat financiare të shteteve islame; kanë ngelur shumë të zhgënjyer nga nevoja patologjike e Shaqir Fetait për ta paraqitur veten “reis” dhe “kryetar të BFI- së”, ndërkohë që e dinë fort mirë se ai është shkelësi parekselancë i Kushtetutës së BFI-së, se është uzurpatori i pashembullt i BFI-së, me ndihmë të strukturave partiake e policore; kanë ngelur të habitur edhe me dëshirën prej manjaku për t’u fotografuar me dhurata e mirënjohje personale, të cilat, nëpër evente të tilla jepen me bollëk e në shenjë respekti personal. Shpjegimi ka qenë: “amani, një foto, t’i bind myslimanët e mi se sa më donë arabët, se si më japin “dekoracia”!

Ndryshe, nëpër evente të tilla, organizatori e parasheh edhe këtë gjest fisnik për të gjithë pjesëmarrësit, të cilëve, ose ua lë në raftin te koka e krevatit, në tavolina në dhomat e secilit, ose edhe para të pranishmëve në evente. Këto jepen për respektim të eventit, si shenjë falënderimi, dhe jo se janë të kategorisë që jepen për të arritura jetësore, apo për kontribute të veçanta!

Shaqir Fetai duhet të konsultohet me njerëz që e njohin protokolin, që e njohin diplomacinë.

Shaqir Fetai deri të premtën do të realizuaka shumë takime me delegacione ndërkombëtare! Haaha...

Ik, pirdhu, o selak, na turpërove në vend, po na turpëron edhe jasht. Shyqyr që të gjithë e dinë se ti nuk je dhe as që mund të jeshë pasqyrë e myslimanëve të Maqedonisë së Veriut. Je vetëm përfaqësues i një grusht genjeshtarësh, kriminelësh dhe shkatërrimtarësh të Institucionit shekullor të myslimanëve të vendit.

*(Mileniumi3, 15.09.2020)*



## Hipokrizia e rradhës e Shaqir Fetait

**Nëse Shaqir Fetai e mohon të qenurit anëtar i Rijasetit të Sulejman Rexhepit, me qëllim të arritjes së “pafajësisë së vet” atëherë, kush ia dha këtë të drejtë për t’u vetëquajtur “reis i BFI-së”?! Nëse jo Rijaseti atëherë shërbimet e ndryshme anti- BFI! Prandaj ekziston një përshtypje dhe një bindje e përgjithshme në opinionin tonë se, Shaqir Fetai është me mision të mbrapshtë**

Shaqir Fetai, njëri prej dallaverxhinjëve më të mëdhenj të BFI-së nga stafi i honxho- bonxhove, na paska realizuar një takim me “armikun historik të BFI-së”, ambasadorin e Maqedonisë së Veriut, z. Abdulkadër Mehmedin!

Nga ky takim njofton Shaqir Fetai në fb-un e vet, duke e mbushur me plotë fjali nga më idiotiket që dalin nga një snob provincial, të llojit:

“u realizua takimi shumë me rëndësi me Ambasadorin e RMV ne Emiratet e Bashkuara Arabe me seli në Ebu Dhabi”,

“njoftuam Ambasadorin me rrjedhojën e vizitës”,

“në të njejtën kohë këmbuem mendime dhe ide për mundësinë e bashkpunimit zyrtar”, “Ambasadori përsëriti proaktivitetin tonë”!

Dhe, mbi të gjitha, në këto “sintagma” të një “intelektuali” analfabet, gjendet edhe një fjali që flet tepër shumë për karakterin e dobët të Shaqir Fetait, për hipokrizinë e tij të pashembullt, për shpirtin e pederastit të një “teologu”, për fabrikuesin e gënjeshtreve dhe për njeriun që është në gjendje ta gëlltisë të kaluarën e tij!

Shaqir Fetai thotë: “Unë në emër të delegacionit dhe në emër të BFI shprehëm falenderimet tona për aktivitetet e tija në poste të ndryshme, në veçanti në postin aktual të Ambasadorit në EBA...”

Shaqir Fetai, në vend se të gënjejë, në vend se t’i bëjë fytyra ambasadorit Abdulkadër Mehmedit, të cilin dikur e trajtonte si “armik të BFI-së”, është mirë që t’i kërkojë të falur për rolin e vet tepër destruktiv në raport me ambasadorin përderisa ka qenë zyrtar i Ministrisë së Punëve të Jashtme të RMV-së.

Prej nga e gjenë forcën për t’i dalur para syve z. Abdulkadër Mehmedit, kur dihet fare mirë lufta e Shaqir Fetait, si anëtarë i Rijasetit, luftë kjo e zhvilluar mbi dhjetë vite kundër ambasadorit. Rijaseti, ku ka aderuar edhe Shaqir Fetai, asgjë nuk i ka interesuar, me asgjë nuk e ka “kushtëzuar” shtetin, madje kërkesë edhe më e fuqishme se kthimin e pronave, ka qenë pikërisht kërkesa për largimin dhe mënjanimin nga Ministria e Punëve të Jashtme të z. Abdulkadër Mehmedit. Shaqir Fetai mund t’i arsyetohet ambasadorit se ai nuk ka faj, se kështu dëshironte Sulejman Rexhepi dhe se anëtarët e tjerë të Rijasetit të gjithë ishin nën urdhërat e tij. Por ky arsyetim nuk ka kuptim, sepse, kur deshti Shaqir Fetai, kur iu shtuan apetitet e azhderit, pikërisht ky ishte ai që ia dredhi Sulejman Rexhepit.

Ja, po ia përkujtojmë Shaqir Fetait se kur ai ishte më i zëshëm në mbledhje të Rijasetit kundër ambasadorit Abdulkadër Mehmedit! Në mbledhjen e Rijasetit të mbajtur më 5 shkurt 2017 vendoset që të nesërmen t’i nisët një letër Kryeministrit z. Zoran Zaev, të cilin do ta urojnë për formimin e qeverisë së re, dhe, me këtë rast, për të dëshmuar se kjo qeveri do të jetë e gatshme për të bashkëpunuar me BFI-në, do t’i kërkojnë 11 kushte. Në mes tjerash, në këtë letër lëshuar më 6 shkurt 2017, Rijaseti i BFI-se, ku më i zëshmi ka qenë Shaqir Fetai, thuhet:

***“Duke qenë edhe ne sipjesë e kësaj shoqërie, mbi të gjitha sipjesë e forcave progresive që angazhohen me këmbëngulje për reforma gjithëpërfshirëse, ne si Rijaset kërkojmë që këto reforma të prekin edhe në sferën e interesave tona, prandaj kërkojmë:***

***Të bashkëkonsultohemi për postin e kryetarit të Komisionit për Marëdhënie me bashkësitë fetare dhe grupet religjioze,***

***Të bashkëkonsultohemi për postin e ambasadorit në MPJ të RM-së për shtetet e Lindjes së Mesme,***

***Masa adekuatë disiplinore deri në largim të ambasadorit aktual për Lindjen e Mesme në MPJ të RM, Abdylkadër Memedi, i cili vazhdimisht angazhohet në dëm të BFI në RM”...***

Kurse, në një letër tjetër, që është e formës ultimative, drejtuar deri te lideri i BDI-së,

z. Ali Ahmeti, e datës 4 janar 2017, thuhet:

***“Shkëlqesi,***

***Duke ju urrear shëndet dhe mbarësi në këtë fillimvit të ri, gjithashtu, Ju urojmë punë të mbarë dhe suksese në aktivitetet e reformave të përgjithshme që po i ndërmerret kjo Qeveri pjesë e së cilës jeni edhe ju, si subjekt politik shqiptar.***

***Në këtë vazhdë, Rijaseti i BFI-së në RM shpreson se këto reforma do t'i tangojnë edhe intereset shumë të rëndësishme për këtë Institucion.***

***Së këndejmi, zoti Kryetar, Reisul Ulema i BFI në RM, i obliguar nga Rijaseti, kërkon një takim zyrtar me Ju në të cilën do të merrnin pjesë edhe disa Myfti, respektivisht, anëtarë të Rijasetit, ndërsa edhe ju mund të shoqëroheni nga bashkëpunëtorët e Juaj. Në këtë takim me Ju do t'i shqyrtonim dy pika:***

***Mundësinë e marrjes së postit kryetar të Komisionit për Marëdhënie me bashkësitë fetare dhe grupet religjioze, si dhe***

***T'i mundësohet BFI-së që të propozojë deri tek Ju, largimin e Abdulkadër Mehmetit dhe propozimin e një emër për postin përgjegjës për shtetet e Lindjes së Mesme, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme në RM, pas të cilit emër do të qëndroni ju si subjekt politik.”***

Mjaftojnë vetëm këta dy dokumente që dëshmojnë për hipokrizinë e Shaqir Fetait, i cili ashiqare e gënjenë ambasadorin Mehmedin. Nëse Shaqir Fetai e mohan të qenurit anëtar i Rijasetit të Sulejman Rexhepit, me qëllim të arritjes së “pafajësisë së vet” atëherë, kush ia dha këtë të drejtë për t'u vetëquajtur “reis i BFI-së”?! Nëse jo Rijaseti atëherë shërbimet e ndryshme anti-BFI! Prandaj ekziston një përshtypje dhe një bindje e përgjithshme në opinionin tonë se, Shaqir Fetai është me mision të mbrapshtë!

***(Epoka, 16.09.2020)***

## “Reisi” matrapaz që ndotë qendra

**Shaqir Fetai, i vetëshpalluri “reis”, pa pikë turpi vazhdon që të manipulojë dhe të gënjejë njerëz me dinjitet e me personalitet se ai është “Reisi i BFI-së”! I njohur si matrapaz i pakonkurrencë futet nëpër Institucione islamike jashtëzakonisht shumë të rëndësishme, duke mos mbajtur llogari se me prezencën e vet të fëlliqur ai veçsa ndotë ambientet e tyre**

**Nga Sabit Ibrahim**

Fillimisht Mr. Shaqua, pandami i Dr. Adhamudhit, paska vizituar Qendrën për Organizimin e Garave Ndërkombëtare të Hifzit dhe Leximit të Kuranit Famëlartë. A i lejohet një antiislamisti të futet në një qendër të tillë? A i lejohet që një “hafizi” të punojë në kundërshtim me të gjithë mësimet Kuranore? A e brenë ndërgjegjja Shaqir Fetain i cili, duke qenë tashmë i njohur në vend dhe më gjërë si një pej matrapazëve më të tmerrshëm, të futet në një Qendër ku madhërohet, ose nxitet nxënia përmendësh e Kuranit Famëlartë? Me vizita të tilla, Shaqir Fetai nuk mund ta zbresë aurorën nga koka e tij që i shndërron si “të shenjtëve” që nuk lënë gjë të zezë pa bërë!

Shikojeni se sa i poshtër që është ky farë “reisi” i leshit! Iu paska dashur “diskutime të vazhdueshme” që, më në fund, të marrë vendim që edhe hafëzlerët e BFI të RMV- së të marrin pjesë në garat e vitit të ardhëshëm. Kush janë ata hafëza të BFI-së? Cili është kontributi i BFI-së për secilin hafiz që ka dalur në Maqedoninë e Veriut! Një herë tjetër do të shkruajmë se si hafëzlerët e rinjë duhet të shpenzojnë e t’i paguajnë “komisionet e BFI-së” për këtë titull të shenjtë! Dhe, këta hafizlerë janë të familjes së tyre, janë të myslimanëve të Maqedonisë dhe, aspak nuk janë të BFI-së! BFI-ja hala nuk e ka nxjerrë qoftë vetëm një hafiz!

Shaqua paska zhvilluar diskutime të gjata, do me thënë mezi i paska bindur nikoqirët që, edhe hafëzlerët nga Maqedonia e Veriut të ftohen në këtë event. Turp e mallkim mbi Shaqir Fetain për këtë gjest përmes të cilit mundohet t’i japë peshë vetes ndonëse nuk peshon më shumë se një mushkonjë pise!

Dhe, në shenjë të këtyre afiniteteve Shaqir Fetai e paska marrur një “Dekoratë të lartë ndërkombëtare të Dubai”! Çka është kjo dekoratomanë e Shaqir Fetait. Dekorata e lartë ndërkombëtare e Dubai! Mirënjohje të tilla nuk kanë asnjë vend të botës, prandaj nuk mund të ketë as në këtë shtet me një civilizim të lashtë! Mbase fare ndryshe quhet kjo mirënjohje por, ja që, Shaqir Fetait i pëlqen t’i bëjë karshillëk Sulejman Rexhepit, duke shpikur lloj-lloj “dekoracia”!

Shaqir Fetai më në fund, paska vizituar edhe Muzeun e Kohës së Pejgamberit Muhamedit a.s. i cili ishte mahnitës për vizitorët dhe të krijonte përshtypjen e afërsisë në kohën e Pejgamberit a.s. Si pati guxim Shaqir Fetai që të hyjë në këtë Muze dedikuar Pejgamberit a.s.? Le të na thotë Shaqua se, cili hadith ia lejon atij që të gënjejë, të shpifë, të vjedhë, të marrë myslimanë më qafë, të kontribuojë që të hidhen në rrugë e ta luaj rrolin e “melaqes së mullirit”, të bëhet palë me hajnat e vakëfit, si “rojtar i Kuranit” të bëhet pjesëtarë i “ushtrisë së djallit”!

Cili hadith i Pejgamberit a.s. ia lejon Shaqir Fetait që të kontribuojë në shkatërrim të BFI-së, shtëpi e një komuniteti pjesëtarë të Ummetit të Pejgamberit a.s.? Cili hadith e mëson Shaqir Fetain që ta shkelë Kushtetutën e BFI-së, t’i tradhëtojë shokët dhe t’i ik përgjegjësisë duke ia ngulur thikën

“mësuesit të vet” të mbrapshtë?

Cili hadith i Pejgamberit a.s. e mëson Shaqir Fetain që të uzurpojë tituj që nuk i meriton, të gënjejë e të thirret në emër të titujve të pamerituar?

Prandaj konstatohet se, shkelja e këmbës së Shaqir Fetait, si hipokrit e munafik, në Muzeun që i dedikohet Muhamedit a.s. është vetëm një njollosje e qëllimshme, është një ndotje e ambientit muzeal që flet për shenjtërinë e Vulës së Pejgamberisë, Muhamedit a.s.

Shaqir Fetahut duhet t’i përkujtohet hadithi: “Një njeri që mashtron, nuk është prej nesh”! Shaqir Fetai vizitën për në Emiratet e Bashkuara Arabe e përdori fund e krye për të mashtruar: mashtroi se është i zgjedhur “reis” apo “kryetar i BFI-së”, mashtroi se është përfaqësues i myslimanëve të Maqedonisë së Veriut, mashtroi se po flet me kompetencë, mashtroi se është përfaqësues i një intitucioni kushtetutar, sepse as nuk e respekton Institucionin dhe as Kushtetutën e tij. Prandaj – Shaqir Fetai nuk është i Ummetit të Pejgamberit a.s., është, thjesht, jo më shumë se një matrapaz, cilësi kjo që nuk i përket asnjë mysliman që është me tamam mysliman.

*(1Kliklarg, 17.09.2020)*

## Një vizitë private në shpenzime të BFI-së

**A e ka lluksin BFI-ja që t’ia shërojë frustracionet dhe t’ia plotësojë qejfet provinciale Shaqir Fetait? Ç’ju desht ky shpenzim që e bëri Shaqua. Vetëm ta gënjejë veten se e duan arabët?! Çka hyri në xhep të BFI-së nga kjo vizitë e kotë në Abu Dhabi ku u injorua tërësisht Shaqir Fetai, si miliona turistë e vizitorë të tjerë**

### *Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI*

Përgjithësisht, vizitat kanë karakter pune! Pushimet nuk e kanë këtë karakter, janë kohë e caktuar që mund të shfrytëzohet edhe për vizita të objekteve historike dhe të gjërave që i përkasin trashëgimisë kulturore të vendit të cilin e zgjedhë për t’i kaluar ca ditë nga pushimi vjetor. Zakonisht, të tilla pushime dhe vizita mbulohen me shpenzime personale.

Me vendim të kujt dhe me leje të cilit organ të BFI-së Shaqir Fetai vendosi të shkojë në Emiratet e Bashkuara Arabe, e cila vizitë më tepër e përmbushi nevojën katundareske të Shaqir Fetait, se sa që rezultoi me ndonjë sukses konkret që do të jetë në të mirë të BFI-së dhe, përgjithësisht, muslimanëve të vendit.

Shaqir Fetai do t’i rrëfeje anëtarëve të familjes se sa mirë ia ka kaluar, se si e thërrisnin arabët “reis”, se ka parë gjëra që nuk shihen as në ëndërr. ABU DHABI KISH QON VEND I BUKUR!

Shaqir Fetai nuk do të tregojë se u injorua tërësisht nga zyrtarët e shtetit. Për herë të parë ndodhë që një delegacion zyrtar i BFI-së të injorohet kaq në mënyrë të hapur si Shaqua me delegacionin e vet prej hoxho-bonxhove!

Thjesht, Shaqir Fetai na informon se ka qenë në një ekskursion privat por me shpenzime të BFI-së.

Shaqir Fetain dhe takimin me të e refuzuan të gjithë zyrtarët e shtetit, asnjë intervistë apo shënim televiziv mbi këtë vizitë të kotë. Shaqir Fetai nuk takoi ministër të vakëfit, ndonjë përfaqësues të ministrisë së arsimit, ndonjë zyrtarë të lartë shtetëror për çështje fetare. Sepse të gjithë kanë qenë të informuar se kush është Shaqir Fetai, kush ishte dikur, çka prezanton tani dhe cilat janë preokupimet personale karrieriste të tij. Prandaj e injoruan të gjithë.

Dhe, kështu, Shaqir Fetai, i sjellë në EBA nga shoqata joqeveritare, u lejua që si një vizitorë i rëndomtë ta shtyej kohën deri në kthim duke vizituar qendra e muze. Me rëndësi, fluturimin, shpenzimet personale si dhe mëditjet do t’ia mbulojë BFI-ja. Shaqir fluturaki, në tru e me trup!

*(1Kliklarg, 18.09.2020)*

# Shaqo

**(Letër publike drejtuar Shaqir Fetait, atij që po përpiqet për ta vjedhur postin e kryetarit të BFI-së në RMV, sa për t'i treguar se Bashkësia Fetare Islame nuk është institucion që u takon disa individëve e as klaneve, por një institucion shekullorë, një Akademi e myslimanëve të këtyre anëve dhe më gjërë)**

## Nga Abaz Islami

Shaqo, përmes kësaj letre dëshiroj që publikisht ta tërheq vërejtjen sa për të treguar se, ecurinë e proceseve zhvilluese të këtij Institucioni duhet marrur seriozisht dhe duhet aktivizuar fuqishëm promotorët me intensitet të lartë për të kompensuar humbjet e shumta që i përjetoi BFI për vite të tëra.

BFI nuk meriton të zvarritet me hope të zvarranikëve!

Që nga dita kur shokët e tu të caktuan si “ushtrues detyre” (flasim sipas dokumentit që e keni lexuar ditën kur keni shkarkuar Sulejman Rexhepin) nuk u morët me asnjë punë të vetme institucionale, por vetëm duke pritur dhe përcjellë badihavxhinjë në “përhajr” të një detyre që erdhi si “shpërblim” pas atij lojaliteti të tepruar ndaj Sulejman Rexhepit për vite me rradhë.

Bashkë me shokët e tu puçista, ti ndoshta pretendon se je “reisul ulema i BFI-së”, mbase edhe mund të keshë ndonjë dokument, gjithësesi të falsifikuar, nga ndonjë institucion shtetërorë të siguar, por ama pa dyshim që të mungon dokumenti bazuar në Kushtetutën aktuale të BFI-së. Prandaj, rreptësisht të ndalohet keqpërdorimi i Institucionin si dhe i postit i cili do t'i takojë dikujt tjetër, me merita, përmes zgjedhjeve korrekte dhe pa ndonjë hile.

Shaqo, mos mendo se opinionin dhe, në veçanti hoxhallarët, nuk i kuptojnë këto pështjellime dhe manipulime që po i bën sa për ta aktruar rolin e “reisit”. Duhet ta dishë se nuk të ka lindur Zoti të tillë, nuk të do si të tillë Zoti, sepse je intrigant i pashoq, je manipulant dhe karrierist i verbuar. Të tillëve Zoti nuk u jep forcë ekzekutivi sepse e ekzekutojnë nënën e vet, babain, fëmijët, mbarë familjen! Historia flet për raste të shumta të këtilla kur postin e kanë rrëmbyer shpirtkriminelët!

Mëse katër muaj, që nga shkarkimi i Sulejman Rexhepit (po ua kujtojë: shkarkimin e bëtë sipas NENIN 58 të Kushtetutës së BFI-së), ju nuk merreni me punën për të cilën i thirrret edhe gazetarët (menduat se me një copë bakllave mashtrohen ata) në selinë e BFI-së të shpalosni çfarë do lloj raporti financiar që tregon gjendjen faktike financiare të Rijasetit, nuk shpalosët asnjë keqpërdorim dhe keqmenaxhim, asnjë vjedhje e dëmtim të vakëfit. Nëse paska qenë gjithçka në rregull, pse nuk ia ktheni postin e rrëmbyer Sulejman Rexhepit?!

Ti dhe shokët e tu, nuk i shpalosni këta dukuri antiislame sepse edhe vetë jeni të përzier dhe të zhytur deri në cep të hundës. Madje edhe vetë gazetarët ta bënë me dije se, nuk ishin aty për t'u mashtruar (për të mos thënë për t'u korrumpuar me një copë bakllave), por ishin të ardhur të mësojnë të vërtetën se çfarë ke bërë ti me shokët e sojit tënd për plotë 5 vite (që nga 2015-ta) kur ne e ngritëm zërin brenda BFI-së.

Shaqo, mos shit poza, dil e trego se sa është e dëmtuar BFI përgjatë këtyre 5 viteve të fundit, apo nuk ke guxim se edhe ti je pjesë e atij klani?!

Sigurisht se nuk mundesh të thuash asgjë ngase, tri-katër ditë para shkarkimit të Sulejman Rexhepit, ti personalisht i drejtoheshe me “EKSELENCA JUAJ”, në zyrat e Myftinisë së Gostivarit!

Ti, bashkë me shokët e tu, që në momentin e parë tentove ta mashtroshë opinionin, (por ama jo edhe hoxhallarët) se kinse SHKARKUAT Sulejman Rexhepin dhe tani e tutje do bëni reforma në BFI! Për çfarë reforma e ke fjalën?

A e di se pjesë e reformës së BFI-së është edhe largimi yt si bashkëpunëtorë e krah i djathtë i atij që sipas Rijasetit tënd, kishte shkelur Nenin 58 të Kushtetutes së BFI-së?

Shaqo, ti bashkë me honxho-bonxhot e tu, por ama ti ishe më i zëshmi, në vitin 2015 keni ngritur gishtin kundër REFORMAVE në BFI dhe çuditërisht tani po pranon se qenkan dashur Reforma në BFI!

Shaqo, ke ngritur gishtin kundër të mirës që iu mendua BFI-së përmes Reformave, atëherë kur ne që në start u kuptua se krimi, zullumi, keqpërdorimet po duan të lëshojnë rrënjë nëpër disa myftini dhe, përgjithësisht në BFI.

Ti dhe ata të tutë, me ngritjen e dorës kundër reformave në të vërtetë keni mbrojtur hajninë dhe disa hajna në BFI që u pasuruan deri në kokë gjatë këtyre 5 vite të fundit! Në fakt, duke ngritur dorën kundër reformave keni përkrahur shitjen, keqpërdorimin, keqmenaxhimin, tjetërsimin e VAKUFIT!

Ti, Shaqo, me ata palaçot e tjerë, me ngritjen e dorës kundër reformave keni përkrahur keqpërdorimin e Kurbanëve, Haxhit, donacioneve të dhënë nga popullata jonë e nderuar që e do pa masë fenë dhe BFI-në, nga diaspora jonë e shtrejtë, ke përkrahur dhe ndihmuar keqpërdorimin e donacioneve që vinin nga vendet e rajonit, pastaj nga Turqia dhe më gjërë për 5 vite me rradhë;

Ti more Shaqo, (dhe jo vetëm ti) ke penguar ndërtimin e Qendrës Tregtare në qendër të Gostivarit e përkrahur si investim kapital nga Banka Islame për Zhvillim, kështu flasin ata që ishin të kyqur direkt në këtë projekt e deri tek ai që i ka udhëhequr marrëveshjet dhe bashkëpunimin me Bankën Islame për Zhvillim. Ndoshta po përpiqesh të arsyetohesh me lloj-lloj marifetesh të pabaza, por mos harro se ato truqe të paargumentuara i kanë të qarta edhe investitori, realizuesi, shumë ish-funksionarë të BFI-së dhe, mbi të gjitha, xhematet tona!

Nuk ka reforma në BFI me njerëz që heshtën edhe pse e shihnin krimin gjithandej. Dhe, nëse e shihni veten “reformatorë”, atëherë shtrohet pyetja: kush duhet të mbajë llogari për HUMBJET dhe Rrënimin që e pësoi BFI-ja gjatë këtyre 5 viteve?

BFI është e popullit dhe ajo mirëmbahet nga populli, ndërsa ne jemi vetëm se shërbëtorë dhe menaxhues të saj!

Prandaj, të tërhiqet vërejtja që të keshë kujdes se çfarë je duke bërë! Me intriga sot mund të përfitoshë diçka, por do të vijë dita që do mbetesh i turpëruar dhe fytyrë skuqur, natyrisht nëse do të keshë vetëm një gram ndërgjegje!

Ndaj të pandërgjegjshmëve në këtë botë nuk ka mëshirë askush, ndoshta në botën tjetër Zoti i mëshiron!

*(in 7.tv, 20.09.2020)*

## **Sulejman Rexhepi shkeli Nenin 58, Shaqir Fetai po shkelë tërë Kushtetutën e BFI-së**

**Shaqir Fetai është me mision të huaj! Shaqir Fetai nuk ka as personalitet, as dinjitet, as shpirt etik dhe as njerëzor! Ai ka detyrë, obligim dhe mision me të cilat e ka ngarkuar “punëdhënësi” i tij! Çdo njeri normal, tashmë do ta mbyllte këtë kapitull të deklasimit, të zbrërthimit dhe të përshkrimit të karakterit të tij të dobët! Ky karakter i dobët nuk mundet që të ëndërrojë lidërsnip! E ka të ndaluar nga Vetë Zoti**

### **Shkruan Shaban Aziri**

Shaqir Fetai, Myftiu i Myftinisë së Gostivarit dhe, aktualisht i vetëshpallur “ushtrues detyre i Kryetarit të BFI-së”, ai i cili lexoi publikisht pajtimin e disa “organeve” për ta shkarkuar nga posti kreun e BFI-së, duke e akuzuar se ka shkelur Nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së. Ky nen mund të përmblihet në një pikë të saj, e cila thotë se, Kryetari i BFI-së shkarkohet “nëse nuk i kryen obligimet për të cilat është zgjedhur”! Pra, nëse dhjetë vite Sulejman Rexhepi e ka shkelur këtë Nen, kurse, po kaq vite Shaqir Fetai ka qenë krah i djathtë i Sulejman Rexhepit duke e ndihmuar në aktet që i sanksionon ky Nen, sidomos pika 2, 3, 4, 5!

Pra, Sulejman Rexhepi do të mbahet mend si “kryetar” i cili u shkarkua sipas Nenit 58, nen ky që në një shoqëri të devotshme myslimane do të ishte ofendim të përfshihej në aktin më të lartë që rregullon jetën fetare islame.

Por, shkelës të këtij Neni janë që të gjithë organet dhe bashkëpunorët e ngushtë të Sulejman Rexhepit, tërë Rijaseti, prandaj, është hipokrizi nga akuzuesit që ta akuzojnë vetëm “eporin” e tyre. Mbi të gjitha, “këta shkarkues” edhe me rastin e “tallkinit” kanë shkelur rëndë Nenin 58, e cila, në pikën e fundit (ndonëse do të duhej të ishte nen më vete) thotë: “vlerësimi përfundimtar për revokim dhe shkarkim e bën Rijaseti i BFI-së”! Në rastin konkret, shkarkuesit e Sulejman Rexhepit ishin bashkëpunorët e tij të ngushtë! Më tepër janë prezantuar dhe mburrur se janë bashkëpunorët sahanëlpirës të Sulejman Rexhepit se sa anëtarë të Rijasetit!

### **Kushtetuta shkilet edhe gjatë “shkarkimit”, edhe pas “dorëheqjes”**

Të gjithë shkarkuesit e Sulejman Rexhepit, jo vetëm që janë shkelës të Nenit 58, por, në rastin konkret janë shkelës të tërë Kushtetutës. Shkelësi më i madh na del të jetë Shaqir Fetai, i cili, madje, për disa ditë me radhë u përpoq që ta falsifikojë “pozitën e vet”, t’i manipulojë institucionet përkatëse shtetërore, t’i manipulojë gazetarët dhe opinionin e gjërë. Fort ia kishte ënda që të prezantohet si “kryetar i BFI-së, ushtrues detyre i reisit”! Shaqir Fetai, në kundërshtim me të gjitha aktet normative të BFI-së, arriti që ta manipulojë (apo edhe ta korruptojë) Regjistrin Qendror dhe aty të riregjistrohet si “ushtrues detyre i kryetarit të BFI-së, reisul ulema)! Me këtë Shaqir Fetai shkeli tërë Kushtetutën e BFI-së dhe, përderisa dhunshëm do të qëndrojë në këtë institucion ai do të trajtohet ekskluzivisht si shkelës i pashpirt i kësaj Kushtetute me të cilën rregullohet jeta fetare islame në vendin tonë!

Më cilin nen, me cilën pikë të neneve, me cilën rregullorë, me çfarë akti normativ BFI-ja e ka rregulluar pozitën juridike “ushtrues detyre”? Në cilën nen apo në cilën pikë të neneve zgjidhen apo emrohen



organet me fjalën “më caktuan”?! Shkarkuesit e Sulejman Rexhepit e paskan caktuar Shaqir Fetain si ushtrues detyre deri në zgjedhjen e Kryetarit të BFI-së?! Shkelje flagrante e kësaj Kushtetute! Po si të veprohet si në rastin e BFI-së? Këta shkarkues, nga përgjegjësia penale i shpëtoi vetë Sulejman Rexhepi, i cili pas dy ditëve “ofroi dorëheqje”! Edhe në këtë rast “të gjestit fisnik” të Sulejman Rexhepit, nga ana e “rijasetit” të Shaqos kemi shkelje flagrante të nenit 64 të Kushtetutës së BFI-së, kështu që, deri sa nuk respektohet ky nen, moralisht edhe më tej mund të llogaritet si “reis” Sulejman Rexhepi! Ndoshta edhe ky është synimi i Shaqos, sepse ai fort mirë e di se nuk ka “rijaset” të definuar sipas kësaj Kushtetute për të vendosur mbi “dorëheqjen e Sulejman Rexhepit”, nëse ia pranojnë apo ia refuzojnë!

## **“Reisllëku” po e djeg Shaqir Fetain**

Është mohim i jetës organizative fetare nëse shkilet Neni 58, pa dyshim! Por, çka është shkelja e tërë Kushtetutës, siç po e shkelë Shaqir Fetai, nëse jo mision “i mistershëm”? Kriza “kryetarsh” BFI-ja ka pasur edhe më herët dhe, ndonëse që të gjitha janë zgjedhur jashtë lëndës kushtetutare, megjithatë, kolektivisht (!) sikur u krijua një praktikë që, deri te kryetari i ri, me BFI-në të drejtojë një komision i përkohëshëm, i cili, në afat më të shkurtë organizonin zgjedhje të Kryetarit! Këtë praktikë tashmë e njeh BFI-ja dhe, si e tillë ka rezultuar me mjaft sukses!

“Ushtruesi i detyrës” (Shaqir Fetai) ia dha vetes këtë post, duke menduar se, sakaq “rijaseti do të vendosë” që ai të ngelë Reis! Manipulim klasik dhe përpjekje idiotike që të mashtrohet opinioni i gjërë dhe të shkilen të gjitha aktet normative të BFI-së. Me ligjet e vendit, sipas Ligjit për marrëdhënie pune, por edhe sipas Kodit Penal, llogaritet vepër penale tejkalimi i kohës së “ushtrusit të detyrës” prej gjashtë muajve! Ushtruesi i detyrës organizon zgjedhjen pa të drejtë që të përfshihet edhe vetë në procesin zgjedhor, prandaj, Shaqir Fetait, këtij shkelësi më të madh të Kushtetutës në historinë e BFI-së kushtetutare, as që guxon t’i shkojë nëpër mend ky post!

## **Shaqir Fetai islamikisht lutet të mos dalë as në oborr të shtëpisë**

Le të supozojmë se, Rijaseti e paska edhe atë fuqinë ligjore që ta caktojë një person “ushtrues detyre” dhe, le të jetë ky person Shaqir Fetai. Shaqua, sipas të gjitha gjasave, kurrë nuk e ka lexuar Kushtetutën, prandaj edhe nuk i bëhet vonë nëse nuk e organizon jetën fetare islame sipas këtij Dokumenti më të lartë të BFI-së! Po ia përkujtojmë se, në rastin konkret, Shaqua si ushtrues detyre i Kryetarit (post ky jointitucional dhe jokushtetues, por politik e partiak), për çdo ditë është në shkelje të këtyre Neneve: neni 1-pika 3, neni 6, neni 7, neni 8, neni 9, neni 10, neni 11, neni 13, neni 23, neni 24, neni 25, neni 26, neni 27, neni 28, neni 30, neni 31-pika 3, neni 32, neni 35, neni 37, neni 38, neni 42, neni 43, neni 51, neni 56-pika 3, neni 58, neni 63, neni 64 etj.

Një funksionar i BFI-së, pavarësisht nëse është legjitim apo ilegjitim, me kaq shkeljesh të shumta e të rënda, jo vetëm që duhet të shkarkohet por edhe të lutet islamikisht që kurrë mos të dalë nga oborri i shtëpisë, sepse, është i turpëruar deri në kijamet!

Shaqua, që fort ia do zemra që të lavdërohet se e ka bërë “fet” Myftininë e Gostivarit, më në fund e dëshmoi veten se është i manipulueshëm, se dëshiron të bëhet despot, se ia do shpirti të bredhë nëpër

misione dhe se, ama bash hiç nuk do t'ia dijë se sa është shkelës i madh i aktit më të lartë juridik – Kushtetutës së BFI-së, e cila mbështetet në Kur'an dhe në Sunetin e Pejgamberit a.s. Sa turp për një hafiz si Shaqir Fetai.

*(Lajmpress, 23.09.2020)*

## **Kur të kriminalizuar mundohen ta vrasin edhe të vërtetën**

**(Reagim pseudoreagimit të BFI-së e cila në grahamën e vet të fundit mundohet të belbëzojë mbi emisionin tejet profesional të LAJM TV, me titull “BFI ka humbur vakëfin në zemër të Shkupit, kushton miliona euro?”)**

### *Shërbimi për informim pranë Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI të RMV-së*

Në faqen elektronike të shkretët të BFI-së, të shndërruar në një paçavurë apo, më butë, në një pano elektronike të reklamimit të debilizimit sa për ta kamufluar kriminalizimin e Institucionit, na qenka botuar një reagim diletantesk, si “dëshmi” se janë në rrjedhë të rastit që bëri bujë jashtëzakonisht të madhe në opinion.

Konkretisht, dikush nga BFI-ja qenka kujdesur për ta botuar një reagim sa për të thënë “hej, këtu jemi”! Kush janë ata që na e përkujtojnë faktin se akoma qenkan “gjallë”?! Mund të jenë narkomanë, pijanecë, bixhozgjinjë, puthadorë të ish-pronarit të shpirtit të tyre, para hijes së të cilit hala dhiejnë gjak nga frika!

Këta tipa i reagojnë kontributit televiziv të Lajm TV përgatitur mbi “Ibni Pajkon”, si ndërtesë që dikur ishte vakëf dhe sot, edhe pse ka kaluar procesin e denacionalizimit, praktikisht është pronë e humbur! Po e theksojmë “pronë e humbur” dhe, jo e shitur, askush nuk ka thënë që është shitur, por, është e humbur, nuk e gëzon pronari i vërtetë, BFI-ja!

Lajtmotiv i reagimit të debillave paska qenë vetëm sa të tentojnë t’ia “mbyllin gojën” Dr. Qerim Litës, një prej historianëve më të respektuar gjithandej trojeve etnike, i cili në këtë kontribut televiziv flet për historikun e “Ibni Pajkos” dhe shpreh shqetësimin e vet se pse akoma ky objekt nuk është në duart e “pronarit” të vërtetë! Ky shqetësim intelektual del nga heshtja e organeve kompetente të BFI-së, nga mosreagimi dhe debatet publike kundër shtetit lidhur me këtë pronë vakufore, flet për sensin e gjahtarit që, pavarësisht kohës, pret si derr i egër për ta gjuajtur prenë!

Doktor Lita dikur qenka paguar nga paratë e vakëfit për kontributin që e paska dhënë në BFI! Në BFI ekziston bindja se nuk duhet të paguhesh, por duhet të jeshë “erhap” për të vjedhur! Ose, mos shpalos dukuri të fëlliqt kundër BFI-së se dikur je paguar nga ky Institucion!

Në rastin konkret kemi përpjekjen e të kriminalizuarve, të hajnave, të bashkëpunëtorëve të shkatërruesve të BFI-së, për të treguar se si njëherë e një kohë dikush na u paska paguar në BFI për kontributin që e kanë dhënë pa hile!

A dëshirojnë këta të BFI-së që t’ua publikojmë dokumentat dhe faktet që flasin se si në pagimin e kontributit të Dr. Qerim Litës dikush ka vjedhur para të majme. Pra, puno Dr. Lita, vidh të tjerët! Qerim Lita ka dhënë kontribut për Vakëfin, Qerim Lita nuk e ka vjedhur dhe me asnjë cent nuk e ka dëmtuar Vakëfin! Po zotërinjtë e BFI-së që natë e ditë e kanë vjedhur BFI-në? Që i kanë duartrokatur vjedhjes së vakëfit; që i kanë shërbyer dhe që e kanë heshtur vjedhjen e vakëfit? Qerim Lita për momentin është një prej historianëve dhe intelektualëve më të respektuar dhe më të çmuar, kurse ju jeni zyrtarë më të korrumpuar, më pisa, më me biografi të zezë, më të kriminalizuar e më të gatuar për të frymuar përtej grilave, që ka dhe që ka pasur ndonjëherë një institucion, aq më pak një Institucion

fetar.

Pjesa tjetër e reagimit, vetëm sa i vërtetonte të gjitha ato fakte dhe të vërteta që i fliste kontributi televiziv, si pjesa narrative ashtu edhe pjesa e deklaratave me kompetencë të Dr. Litës.

Emisioni në fjalë tha: “BFI ka humbur vakëfin në zemër të Shkupit, kushton miliona euro?” Dhe, kjo e vërtetë nuk u demantua, sepse nuk ka se si të demantohet. Gazetarit si dhe tërë stafit të Lajm TV u lumtë për këtë shqetësim fetar e kombëtar, për këtë guxim intelektual për ta luftuar të keqen, qoftë ky që vjen nga shteti, nga institucioni fetar apo edhe nga individët kuazomelaqe që mundohen të shesin mjegull në ditë me diell!

*(Lajmpress, 23.09.2020)*

## Dikush duhet t'ia shkullë veshin Shaqir Fetait

**Këto ditë, përmes disa shkrimeve analitike, u bë interpretimi autentik i Kushtetutës së BFI-së, përmes të cilës u shqyrtuan disa probleme jetike për këtë Institucion. Tashmë myslimanët e vendit e kanë më të qartë problemin kushtetutar të BFI-së si dhe përpjekjet djallëzore të “teologëve” të diskutueshëm të cilët e kanë në gjakë “tregëtinë me mjegull”**

### Shkruan Mr. Eset Shaqiri

U tha se Shaqir Fetai dhe kompania e tij i thyen paralelisht dy kolonat më të rëndësishme që e mbajnë tërë peshën e BFI-së në vend. Në mënyrë jokushtetutare e larguan kreun e BFI-së dhe, me dëbim naiv, nuk llogariti në efektin domino që do të shkaktonte mbi kolonat e tjera që e mbajnë institucionin e vetëm fetar islam të myslimanëve të vendit, Rijasetit.

Aventurat e Shaqir Fetait nuk kanë të sosur! U dëshmuar se ai më tepër është i sëmurë për karrierë se sa që ka afinitete prej lidershipi. Në mbamendjen e myslimanëve të vendit do të ngelë sinonimi i “qurës në mjegull”, personi që vullnetarisht i qaset misioneve të huaja që këtij i duken “karrierë”!

Shaqir Fetai, ëndërruesi i natëeditshëm i postit të kryetarit të BFI-së, me gatishmëri prej njeriut të pamend pranoi që të futet në dhëmbzorin e gabimeve, mekanizëm ky që lind afera e idiotizma nga më banalet.

Në vend se të ngelë anëtarë i komisionit të vogël i cili për punë javësh do të duhej ta bënte BFI-në me kryetar të ri dhe me të gjitha organet e saj të nevojshme për të funksionuar lirshëm, Shaqir Fetai bëri presedanin, u vetëcaktua u.d. kryetar i BFI- së, post ky i panjohur në asnjë akt normativ të BFI-së, madje, me këtë “titull” u regjistrua edhe në Regjistrin Qendror Shtetëror, duke e bërë përgjegjëse në shkeljen e Kushtetutës të një Institucioni jashtëzakonisht të rëndësishëm të vendit. Kjo shkelje nuk do t'i shpëtojë trajtesës institucionale si vepër penale. Për shkak të mospërmbajtjes së kriterëve profesionale gjatë regjistrimit të personave juridikë, (nuk është kërkuar shpjegim kushtetutar, nuk është kërkuar procesverbali nga ky emërtim në postin inegzistent, nuk është kërkuar vendimi i organit më të lart kolektiv, as procesverbali i organit për këtë vendim etj.) sot drejtoresha e Regjistrin Qendror ka probleme të mëdha. Paramendoni sikur një idiot të kërkojë që të regjistrohet si drejtor me vendim të Zotit, apo, të regjistrohet si Udhëheqës i një firme që atë e bën të dërguar të Zotit! Shaqir Fetai parapëlqeu që të regjistrohet “u.d. kryetar i BFI-së” që do të thotë se, me automatizëm, ai u çregjistrua nga posti Myfti i Gostivarit, sepse nuk mundet të jetë ushtrues i dy posteve, sepse është konflikt interesi: Shaqiri si “reisul Ulema” ia cakton rrogën Shaqirit si Myfti, apo, për të dy postet Shaqir Fetai merr dy rroga, sepse, vetë është kadi e vetë myfti! Kjo lëndë gjithësesi që do të shqyrtohet nga Komisioni Antikorrupsion, si dhe nga Digasteri qeveritar për luftimin e korrupsionit!

Shaqir Fetai, e dëmtoi Rijasetin, sepse e la edhe pa një anëtarë, (minus myftiu i Gostivarit), e dëmtoi edhe Myftininë e Gostivarit, sepse e la pa myfti dhe, gati që gjashtë muaj edhe pa koordinator të Myftinisë! Shaqir Fetai, që nga momenti kur pranoi të regjistrohet si ushtrues detyre, ai e ka menduar mirë qëndrimin sa më të gjatë në këtë post në krye të BFI-së, por, nuk e ka menduar një gjë: e ka humbur të drejtë e vijësimit të të qenurit Myfti i Gostivarit (sepse do t'i duhet të shkojë sërish në rizgjedhje) dhe, për më keq, e ka humbur të drejtën e kandidimit dhe konkurrimit për kryetar të

BFI-së në zgjedhjet që duhet të organizohen pikërisht nga Shaqir Fetai. Sepse, ashtu thotë Ligji për marrëdhënie pune i vendit: personi u.d. nuk ka të drejtë të konkurrojë për ta kapur postin më të lartë në krye të të cilës vihet për një kohë si ushtrues detyre, sepse paraqet konflikt interesi.

Populli gjithnjë ka thënë: mos e synoni copën e madhe të bukës sepse mund t'ju ngelë në fyt! Fatkeqësisht kjo copë tashmë i ka ngelur në fyt Shaqir Fetait por, ajo që habit është neglizhenca e Shaqos që të intervenojë për ta nxjerrë apo për ta gëlltatur disi këtë copë. Për ta gëlltatur mbase mund t'i operohet fyti, për ta nxjerrë pastaj, mbase do t'i duhet t'i operohet zorra e trashë. Fatkeqësisht, në të dy raste mund të përfundojë invalid dhe i paaftë për të ushtruar ndonjë detyrë apo obligim.

Kjo që u tha më sipër mund të duket si një hipotezë morbide, por, ajo që është më se e vërtetë dhe e pamohueshme është fakti që Shaqir Fetai pa dyshim që do të japë llogari para drejtësisë (qoftë ajo e institucioneve shtetërore, qoftë e organeve dhe komisioneve të BFI-së) edhe atë për:

shkelje kushtetutare me rastin e caktimit të vetes si “u.d. kryetar”;

shkelje të Ligjit për punësim që nuk lejon ushtrim paralel dhe njëkohësisht të dy posteve që varen njëra prej tjetrës;

zvarritje të procesit zgjedhor me ç’rast ka bërë një sërë shkeljesh ligjore dhe ka financiarisht BFI-në;

përpjekje që përmes politikave përjashtuese dhe “vendimeve misterioze” të kontrabandojë postin e kryetarit të BFI-së dhe,

shkelje të Kushtetutës së BFI-së si dhe manipulim të organeve gjegjëse shtetërore. Mos të harrohet edhe një fakt që aktualisht është më i rëndësishmi – paralizimi total i BFI-së nën postin “u.d.”, post ky që nuk ka kurrfarë kompetencash dhe kurrfarë të drejtash të tjera përveçse të nënshkruajë listat ekskluzivisht të rrogave! Çdo ditë të lume Shaqir Fetai si “u.d. kryetar i BFI-së” është duke e dëmtuar dhe po i kushton tepër shumë BFI-së!

Pse e gjithë kjo dëshirë dhe gatishmëri e Shaqir Fetait për t’u tallur me BFI-në?

Shaqir Fetai nuk po kupton se, për këtë tallje kundër fesë islame në vend, tashmë ia tërhoqi vërejtjen edhe Vetë Zoti! Ai tashmë duhet të kuptojë se, si vetë Shaqir Fetai ashtu edhe BFI-ja, pa Afrim Tahirin, do të jenë nën incertoninë e rënies së lirë pingule, deri në shkatërrim total. E vetmja shpresë e rimëkëmbjes, e punëve të mbara, e daljes në selamet dhe e sukseseve të garantuara të BFI-së, ngelë Afrim Tahiri. Vetëm le të kthehet filmi në periudhën 2006-2011! Shaqir Fetai është demode, nuk është ai model tek i cili duhet të varet plaçka e pistë e jo më shpresa! Fatkeqësisht!

*(Tetovasot, 24.09.2020)*

## **A je normal o Shaqir Fetai, apo cilët janë kufijtë e abdallëkut të Shaqir Fetait**

**Meqë ra fjala, o Shaqir Fetai, ktheja BFI-së vakëfin te Komunaleci që e trafikuar dhe e kontrabanduuar me garanca partiake se nuk do të burgoseni për krime dhe për kriminalizim të BFI-së nga të gjithë ju që ekzaltoheni me gurin themeltar të “vakëfit historik” prej 29 metrave katëror**

**Nga Sabit Ibrahim**

I gjendur në mes çekanit dhe kurdhës, si kosa e topitur dhe e fishkur që cokatet e cokatet dhe në fund hidhet në pleh, sepse qëllon e ndryshkur, Shaqir Fetai nuk ka se çfarë të bëjë përveç t’i tundë bythët ndër xhemate të ndryshëm.

Sot, Shaqir Fetai ishte në Dibër. Ka zgjedhur strategjinë për të qenë sa më pranë popullit, thua ti se iu djeg xhani popullit për të. Nuk ndryshon për të mirë imazhi duke u solloratur si bythëpambuk ndër xhematë. Sepse, mund t’ia shpërtheshë nervat popullatës e të të hyjnë shqelma për hipokrizinë e padurueshme. Popullit mund t’i ofrohesh dhe të bëhesh mik e dashamirë me të, vetëm duke qenë i sinqertë dhe transparent! Duke treguar se si Shaqir Fetai u bë palë e atyreve që abuzuan me paratë edhe të xhematit dibran, si abuzuan me vakëfin e BFI-së, si abuzuan dhe vodhën ndihma të llojllojshme.

Shaqir Fetai u mrekullua me ndërtimet islame në Dibër, ndërsa asnjë fjalë miradie nuk e tha për ata që e islamizuan fuqishëm Dibërën, si Ruzhdi Lata i ndjerë, po ashtu edhe Ramazan Hasa. Shaqir Fetai dje paska qenë në Strugë ku paska përuruar gurëthemelin e “vakëfit historik”!!! A e di Shaqua injorant se kur një ngjarje merrë peshën e historikes? Kur ndodhë diçka për herë të parë, diçka gjigante, diçka madhështore, diçka që të jep emër e nder. Shaqir Fetai mundohet që me një kiosk, apo me një “trafikë” prej 29 metra katërorë ta mbulojë që mos të shihet turpi monumental i tij dhe i myhybëve të tij? Me këtë “trafikë” mundohet ta hedh pas krahëve aferën e vakëfit prej mijëra katërore “Ibni Pajko” që e ka humbur Rijaseti ku ai është anëtarë? A zihet dielli me shoshe, o Shaqo?! Ekzaltohet i shkreti nga një kiosk-vakëf ndërkohë që mendon se me këtë egzaltim do të amnistohet nga vjedhja, shitja, tjetërsimi dhe përvetësimi i qindra mijëra metrave katërore të vakëfit! Pa dyshim që Zoti mund të na bekojë për këta 29 metra katërore vakëf në Strugë, por a mundet t’i ikë Shaqir Fetai mallkimit të Zotit për shitje të vakëfit? Pstttt! Mos manipulo? Mos thuaj “vallai, kurrë nuk kemi shitur vakëf”! Sepse, në vend të denacionalizimit të pronës janë marrur miliona euro në letra me vlerë, me të cilat nuk janë blerë vakëf, por janë shpenzuar për rroga, për ahengje, për qejfe, kurse, t’i Shaqir Fetai, asnjëherë nuk e ngrite zërin për ta dënuar këtë krim, por, përkundrazi, i duartrokite dhe i gjykove denoncuesit publikë të këtyre dukurive të shëmtuara dhe të bëra haram prej Zotit Fuqiplotë.

Pse po vazhdon me rrena o “Kreu” i BFI-së! Ti më nuk je as myfti i Gostivarit. Zoti të bëri rezil! Ti nuk i pate në Strugë të gjithë “myftinjtë”, “elhamdulila, jemi komplet qind për qind, të gjithë myftinjtë”, sepse të mungonte myftiu i Tetovës. Apo ti atë nuk e llogaritë myfti, sepse nuk është zgjedhur si ti, dhe nuk e ka muraselen tënde. Po edhe ti je Myfti i Sulejman Rexhepit, o i ngratë, sepse ai e dinte se nuk je as për muteveli i xhamisë pa xhemat, sepse je shumë i ligë e i djallëzuar. Ti, në inagurimin e gurëthemelit të trafikës-vakëf i pate vetëm një myfti legjitim (atë të Kumanovës), një Myfti të diskutueshëm (atë të Shkupit) si dhe koordinatoret e myftinive: Strugë, Ohër, Veles,

Dibër, Prilep, Manastir si dhe përfaqësues nga Myftinia e Kërçovës, po ama të munguan shumë nga imamët e Strugës! Prandaj mos u mundo me i dhënë peshë vetes duke rrejtur, duke i emëruar rrejshëm koordinatoret me “myfti”. Mos u mundo që rrejshëm ta fryshë numrin e pjesëmarrësve prej xhemati, sepse, kësaj rradhe, struganët ta futën, të turpëruan, ta bojkotuan ty personalisht dhe “vakëfin historik”, sepse shumëfish më historik janë vjedhjet dhe mëkatet e juaja.

Struganët ju falënderojnë që, duke u munduar të shpërbleheni eventualisht me ndonjë sevap, duke hedhur nga një llopatë beton, ju mëkatarët e pranishëm, arritët ta hidhni pllakën e parë të kioskut prej 29 metrave katërorë. Allahu ju shpërbleftë por ama edhe ju ndëshkoftë për qindra mijëra metra katërorë që i humbët, që i hëngrët, që i vodhët, që i shitët, që i tjetërsuat e që i personalizuat. Meqë ra fjala, o Shaqir Fetai, ktheja BFI-së vakëfin te Komunaleci që e trafikuat dhe e kontrabanduat me garanca partiake se nuk do të burgoseni për krime dhe për kriminalizim të BFI-së nga të gjithë ju që ekzaltoheni me gurin themeltar të “vakëfit historik” prej 29 metrave katëror.

*(1Kliklarg, 25.09.2020)*



## **Deklarata e Shaban Sulejmanit, dekan i FSHI-së**

Derisa viteve `90 binte një kambanë gjithandej në Europë dhe në botë në përgjithësi, ndodhi ajo që ndodhi, vitet `90 ishin të përgjakshme. Pjesë e asaj strukture të shtetit Jugosllavi ishte edhe Maqedonia që më vitin `90-`91, BFI ishte e papërgatitur por, falë Zotit, që në krye të saj timonin e mori Kryetari i saj H. Sulejman Rexhepi dhe, punën e parë që bëri konsoludoi rradhët, puna e dytë ishte konsolidimi i jetës fetare. Ajo që mua më krijoi përshtypjen dhe që gjithnjë më ka ngazëllyer ishte interesi i tij që traditën kombëtare, të cilën e kishin trasuar brez pas brezi hoxhallarët e këtij vendi, dëshironte ta mbante në nivel dhe ta avansonte. Prandaj në atë vijë duke e ndjekur këtë ide ai e mishëroi dhe punën, për mendimin tim, më të madhe që bëri ishte institucionalizimi i gjuhës shqipe, sepse aso kohe ishte rëndë të flitej për një mënyrë të komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm në gjuhën shqipe. Ajo që bën të vë theksin e veçantë, meqë udhëheq Fakultetin e Shkencave Islame, ishte ideja e tij se si të avansohet mendimi islam. Falë Zotit që qendrat e studimit të islamit gjithandej nëpër botë ishin të hapura, edhe pse Jugosllavia ishte komuniste, ishte i dirigjuar mendimi, por me kthimin e kuadrove të reja, si vizionar, vërejti nevojën se do të duhet të ngjeshet një brum me ide dhe me gërshetimin e traditës së vendit dhe si të thuash të avansohet bindja, mësimi, ideja për fenë autoktone të vendit. Dhe këtë ide kah moti e ka pasur, që nga momenti i themelimit dhe të nxjerrjes së gjeneratave të reja nga Medreseja, dhe vërente se ka nevojë që të themelohet një Institucion i arsimit të lart në këtë vend. Pikërisht ngulmimi i tij, interesi i tij, vullneti i tij, në kuadër të BFI-së gjithandej, duke e promovuar idenë se do të duhej të ishte një Institucion i arsimit të lartë dhe më vitin 1997 vetëm filluam me mësimin e fesë dhe jo vetëm. Qenia njerëzore nuk do të ishte e tillë, siç thuhet në shkencën e fizikës se, materia substancë të vet e ka masën dhe vëllimin, një njeri pa intelekt të mirëfilltë dhe të ngjeshur dhe të ushqyer intelektualisht dhe kombëtarisht si dhe pa qenë i frymëzuar dhe i brumosur me frymë fetare, komponenta e intelektit dhe shpirtit u bë vatër e cila sot e kësaj dite prodhon kuadro dhe, qëllimi i tij ishte se pa fe nuk ka atdhe!

*(1Kliklart, 27.09.2020)*

## **Deklarata e Qenan Ismailit, “myfti” i diskutueshëm i Myftinisë së Shkupit**

Në momentin kur unë udhëheqi me institucionin Muftini e Shkupit që është institucion shumë i rëndësishëm për Bashkësisë Fetare Islame, dhe shumë normale që edhe prej brenda ndoshta paraqiten momente dhe persona të cilët janë skeptik për ngritjen profesionale të këtij Institucioni, por edhe nga ana tjetër edhe lëvizje dhe zëra të imputimeve negative të qarqeve të ndryshme, shumë i rëndësishëm ishte motivimi, energjia pozitive që e jepte Reisul Ulemaja që me të vërtetë gjithë atë plan strategjik që e përgatitëm, planin akcional, veprimet, angazhimet, përputhshmërinë tonë me ligjet e shtetit dhe, nga ana tjetër, në shërbim të jetës fetare, ai, Haxhi Sulejman Rexhepi ishte ajo fryma, ai inspirimi pozitiv, që ne si myslimanë në përgjithësi por edhe si Myftini, se si duhet të ngrisim pozicionin tonë. Besoj se atë çka e ka bërë për Myftininë e Shkupit, brenda këtyre viteve deri sa jamë unë në krye të kësaj Myftinie, e ka bërë edhe për Institucionet e tjera, kurse rezultatet shifën. Për atë shpeshë kam thënë dhe sërish po e them se, shumë e rëndësishme është që në momentet e vështira të keshë një krah shtytës, të fortë, të fuqishëm i cili të mbronë nga mbrapa që të ecësh dhe të çashë rrugën drejt anëve pozitive dhe të mirave në shërbim të jetës fetare.

*(1Kliklart, 27.09.2020)*

## **Deklarata e Dr. Qani Nesimit, Myfti i Myftinisë së Tetovës**

Haxhi Reisi ynë, Reisul Ulema Sulejman efendi Rexhepi, është një personalitet që e ka shoqëruar institucionin e BFI-së me decenie. Ai mund të përmendet për shumë gjëra! Dy janë shumë të rëndësishme: e para, ai e ka ruajtur autoritetin e institucionit fetar dhe, e dyta, e ka ruajtur kontinuitetin dhe vazhdimësinë e institucionit me të gjitha njësitë e saj që i ngërthen në vete. Kur i përmend këto dy elemente shumë të rëndësishëm, dua të theksoj se, ruajtja e vakëfit në Republikën e Maqedonisë së Veriut është rezultat i angazhimit të palodhshëm dhe i vendosshmërisë së tij. Interesimi shumë i rëndësishëm për kthimin dhe rehabilitimin e xhamive, qoftë në Ohër, qoftë në Strumicë, në Prilep, kudo tjetër, që këta xhami të marin formën e tyre dhe të jenë në shërbim, është një nga argumentet shumë të forta të qëndrueshmërisë, të stabilitetit dhe të këmbëngulshmërisë të Haxhi Reisit tonë. I nderuari Haxhi Reisi është një personalitet i cili nuk ka kursyer as kohën, as mundin, as angazhimin, as lëvizjen, asgjë prej tij, për të shërbyer në këtë Institucion që është shumë i rëndësishëm në mbrojtjen e vlerave fetare dhe kombëtare këtu, në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

*(1Kliklart, 28.09.2020)*

## **Deklarata e Shaqir Fetait, myfti i Myftinisë së Gostivarit**

Kryetarin e Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Reisul Ulemanë Haxhi Sulejman efendi Rexhepin, jo vetëm që e njoh më tepër se dy dekada e gjysëm, por edhe kam qenë bashkëpunëtor i ngushtë i tij në funksione dhe pozicione të ndryshme në Bashkësinë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Vërtet Kryetari Sulejman efendi Rexhepi ka qenë, është dhe do të ngelë një figurë markante e zhvillimit të mendimit islam, edhe si ide por edhe në aspektin institucional. Ardhja e tij në krye të BFI vërtetë paraqiti një kthesë të madhe në historinë e myslimanëve dhe BFI-së këtu në këtë nënqiell. Mendimi i tij i pastër, i çiltër dhe reformues bëri që organizimi i myslimanëve në këtë nënqiell vërtetë të jetë në nivelin e duhur konform kohës dhe rrjedhave të kohës në të cilën ka jetuar dhe vepruar me qëllim që islami të merr karakter të nivelit të lartë. Është një personalitet që qëllim kryesor e pati themelimin e institucioneve fetare arsimore, duke filluar nga Medreseja Isa Beu, pastaj degët e saj, por Kryetari i BFI-së, Sulejman efendi Rexhepi, dëshirë të madhe kishte që të hapë një institucion edhe më të lathtë fetaro-shkenor, kështu që arriti të themelojë dhe të ndërtojë Fakultetin e Shkencave Islame, nga i cili institucion vërtetë dalin kuader të mirëfillta për shpjegimin dhe prezantimin e jetes fetare islame. Sulejman Rexhepi është një personalitet me karizëm të fuqishme fetaro-shkencore por edhe kombëtare. Më kujtohet në momentet e para kur, me ardhjen e tij, automatikisht dha urdhërin dhe vendimin që të gjithë institucionet fetaro arsimor, duke filluar nga administrata e BFI-së, të vendoset barazia gjuhësore e këtij Institucioni, kështu, që në momentet e para menjëherë dha urdhër që krejt mësimi të zhvillohet në gjuhën shqipe, të shkruhet administrativisht gjuha shqipe, duke dhënë hapësirë të fuqishme që edhe në institucionet fetaro-arsimore por edhe në BFI, edhe nacionalitetet e tjera që i takojnë fesë islame, ta gjejnë veten e vet, dinjitetin e tyre fetaro-kulturor dhe kombëtar.

*(1Kliklart, 28.09.2020)*

## Shaqir Fetai mundohet të dekriminalizohet përmes humanizmit

**A mundet të dekriminalizohet individi absurd, si Shaqir Fetai, përmes një “dekoracia” që ia paska dhënë Forumi Ndërkombëtar Boshnjak!? Pse e përvetëson këtë mirënjohje (pra, jo dekoratë o dekoratoman i kompleksuar)? Cili na qenka kontributi personal i Shaqir Fetait për ta merituar këtë mirënjohje? Shaqir Fetai ka kontribut të hershëm në dëm të Myslimanëve (nuk dihet nga shkolla e mesme apo nga koha e studimeve në Sarajevë!!!) për të cilin “kontribut” për momentin dinë vetëm disa persona**

**Nga Nehat Rexhepi, medresant**

Një njeri i kriminalizuar, një njeri që ka manipuluar me kafshatën e të varfërve, të ngratëve dhe të atyreve që janë në nevojë, një njeri që e ka ndihmuar Mustafa Dautin në vjedhjen e ndihmave humanitare (sot pasuria e tij e patundshme vlerësohet në miliona euro); një njeri që e ka bërë kabullë vjedhjen e ndihmave financiare të tubuara për vëllezërit tanë nga Hasanbegu, Vlora, Shkodra, Tirana, një njeri që ka mbështetur dhe nuk e zbardhë vjedhjen, dëmtimin, tjetërsimin dhe përvetësimin e vakëfit, pra, një njeri i këtillë si Shaqir Fetai, a i ka hije “të merret” me humanitet! Po, në kuadër të përpjekjeve për dekriminalizim të vetes së vet, edhe i ka hije, por, ky aktivitet duhet të jetë vëllimmadhë, i shumtë dhe i përditshëm, njëzet vite me radhë, aq sa i ka bërë hizmet kriminalizimit të BFI-së! Sipas kësaj matematike të kësajbotshme, i bie që Shaqir Fetai do të vdesë i kriminalizuar, sepse e ka të vështirë që të jetojë edhe nja njëzet vite, jo që nuk ia ka ënda, por e ka shumë të vështirë që të mbajë barrën e kësaj të vërtete!

Së këndejmi, a i ka hije dhe, me çfarë fytyre prezanton Shaqir Fetai në një shoqatë që merret me humanitet duke u përkujdesur për personat me aftësi të kufizuara dhe që janë në nevojë?! A i ka hije që, nga përpjekja për dekriminalizim personal, të bëjë lajm? Në lajmin paçavurë thuhet: “Kreu i BFI H. Hfz. Shaqir ef. Fetai përshëndeti këtë përvjetor dhe punën e palodhshme të udhëheqësisë së kësaj Shoqate, si dhe premtoi mbështetje të rezervë për këtë Shoqatë e cila është në shërbim të personave me nevoja të posaçme.”

A kishte dëgjuar më herët Shaqir Fetai për këtë Shoqatë? Paska premtuar mbështetje pa rezervë? Këtë nuk do t’ia mundësojë Zoti Mëshirëplotë, sepse, Shaqir Fetai tregohet super-hipokrit! Çka ka bërë Shaqua për këtë Shoqatë? Pse deri më sot nuk e ka dhënë asnjë cent, ndonëse i pavarur financiarisht ka menaxhuar me një organ që ka pasur financa të bollshme? Kush e ka penguar nëse jo shpirti i vet i kriminalizuar? Ai nuk e ka pasur mendjen te njerëzit me nevoja të veçanta, por, te njerëzit me interesa të veçanta, kështu që, e ka të kotë përpjekjen për ta kamufluar kriminalizimin e vet përmes, kinse, humanitetit konkret! Konkrete do të ishte vetëm ikja e Shaqir Fetait tmerrësisht të turpëruar, kurse gjithçka tjetër rreth këtij farë individi me zero personalitet do të jetë absurde!

A mundet të dekriminalizohet individi absurd, si Shaqir Fetai, përmes një “dekoracia” që ia paska dhënë Forumi Ndërkombëtar Boshnjak!? Pse e përvetëson këtë mirënjohje (pra, jo dekoratë o dekoratoman i kompleksuar)? Cili na qenka kontributi personal i Shaqir Fetait për ta merituar këtë mirënjohje? Zero kontribut, për sa i përket interesit të boshnjakëve, kurse në dëm të tyre Shaqir Fetai ka kontribut të hershëm (nuk dihet nga shkolla e mesme apo nga koha e studimeve në Sarajevë) për

të cilin “kontribut” për momentin dijnë vetëm disa persona!

Ndërsa kontributi i Bashësisë Fetare Islame, konkretisht i Meshihatit të BIM-it, edhe më konkretisht, i Sulejman Rexhepit, tashmë është i evidentuar në analet e historisë! Dihet se si ish-kryetari i Meshihatit, Sulejman Rexhepi, doli personalisht te stacioni i trenit ku ishin bllokuar mbi 20 mij myslimanë të ikur nga Bosnja që po shkrumbohej nga forcat kriminale serbe! Me angazhimin e tij personal ia prishi ëndërrat Gligorovit për të hapur korridore për deportimin e boshnjakëve dhe, e urdhëroi Bashkësinë Fetare Islame, respektivisht, Shoqatën Humanitare “El Hilal” që t’i sistemojë që të gjithë myslimanët e dëbuar. Në këtë periudhë, Shaqir Fetai nuk ishte askund, mbase edhe fshihej nga turpi për të bëmat e tij deri sa ka qenë student në vatanin e boshnjakëve! Edhe për sa i përket ngritjes fetare e kulturore të Boshnjakëve, kontributi i Shaqir Fetait është zero! Zero! Me “Z” të madhe! Sepse kurrë nuk ka qenë në pozitë që të kontribuojë. Nëse në këtë “kontribut” ai mendon se ka merita si “anëtarë i Rijasetit”, atëherë, duhet të pranojë se kontributi i tij në kriminalizimin dhe në shkatërrimin e BFI-së si “anëtarë Rijaseti” është shumëfish më i madh se sa “aktiviteti humanitar” i tij.

Pasojat e të qenurit të tij “anëtarë Rijaseti” janë shumë më tragjike, janë shumë më antinjerzore dhe antiislame, se sa çdo “sevap” i tij që e paska bërë në rrafshin “humanitar”!

*(Politesa. 29.09.2020)*

## Shaqir Fetai një fuks i vogël nën çallmë

**(Përkitazi me shënimin gazetareks të TV Alsat M, lidhur me truqet antiislame të Shaqir Fetait, i cili, si duket tashmë ka mision për t'ia vënë flakën BFI-së dhe për t'i paraqitur myslimanët e vendit si “të egër”. Thika e Shaqir Fetait tashmë ka prekur në palcë të BFI-së)**

### *Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI*

Më në fund, Shaqir Fetai kishte vendosur për ta dhënë një deklaratë nusërie, në pozita të një njeriu mermer, akull të ftohtë pa kurruafër ndjenje dhe përgjegjshmërie islame. Në tërë atë që e tha, la të nënkuptohet se ai tashmë e ka vendosur, ose do të shkojë deri në shkrumbosje të BFI-së, natyrisht, sipas porosive të punëdhënësve të tij “të mistershëm” që nuk janë asgjë tjetër përveçse “kultivues të fuksave”, ose, nga pozita e të qenurit vegël, do t'i shkelë të gjitha parimet islame për të ngritur një institucion sipas parametrave të huaja antikombëtare dhe aintifetare.

Shaqir Fetai nënvizon se po i konsoliduaka radhët e BFI-së dhe se në këtë Institucion po u punuaka shumë, kurse për shkelësin e Nenit 58 tha se gjithçka shpjegohet përmes alineve të këtij neni dhe se kësaj nuk do t'i shtonte asgjë! Hipokrit më të madh dhe antiislamist më të përkryer nuk e bën më nëna!

Gazetarët shqiptarë, televizionet nacionale dhe lokale, bëjnë mirë që mos të merren më me të, sepse, është ofendim për vetë ata që të merren me një vegël të huaj! Veglat dhe fuksat, ngjashëm si limoni, nëse vyshken dhe nëse ndryshken, hidhen në plehëra, nuk trajtohen si “suvenir”! Ja se pse nuk përgjigjet Shaqir Fetai se, për ç'arsye u shkarkua Sulejman Rexhepi, cilat janë motivet e shkarkimit të tij?

Të gjitha shkeljet e Nenit 58 të Sulejman Rexhepit, janë bërë me miratimin e Shaqir Fetait. Prandaj mos ia kërkoni këtë përgjigje Shaqir Fetait, sepse, në momentin kur ai do të sqarojë konkretisht, do të dalë vetë djalli!

Shaqir Fetai do të bëhet shkaktar që do t'i iritojë myslimanët e vendit dhe do t'i acarojë deri në shkatërrim epik! Ruana Zot nga ndonjë e keqe! Shaqir Fetai nuk mundet që të ngrisë një Bashkësi Fetare Islame sipas qejfeve të tij të konstruktura laboratoreve të shërbimeve sekrete! Shaqir Fetai nuk është caktuar që të “konsolidojë” Rijasetin, Shaqir Fetait i kanë thënë shokët e vet që t'i organizojë zgjedhjet për Kryetar të BFI- së! Pa kryetar nuk ka “konsolidim të radhëve”, as “themelim të Rijasetit”! Nëse Shaqir Fetai këmbëngul në “BFI policore” atëherë, ekziston rreziku që të ngelim pa Institucion fetar, kurse Shaqir Fetai të mbahet mend si Neroni që i binte violinës derisa Roma digjej!

Shaqir Fetai duhet t'i shmanget proeksioneve të huaja nëntokësore dhe t'i kthehet kushtetutshmërisë së BFI-së, të hap procesin e zgjedhjeve të Reisit dhe, të ik miliona vite larg BFI-së, sepse po del që paska qenë fuksi më i tmerrshëm antikombtar e antifetar!

Shaqir Fetai nuk guxon të shkelë Kushtetutën, nuk është në pozita që të themelojë organe, as të

“konsolidojë radhët”, por, tashmë është dashur t’i kryej zgjedhjet e kryetarit të BFI-së. Mos të habitet nëse një ditë, edhe atë së shpejti, do të ndërgjegjësohen shumë imamë, teologë, shumë profesorë, shumë studentë, e shumë e shumë myslimanë e t’i dalin në protesta para BFI-së deri në shkarje të tij prej feje dhe në konvertim tjetërfarëshe, në fenë e punëdhënësve të tij. Shokët e vet publikisht ia caktuan një “mison të shenjtë”! Shaqir Fetai po i tradhëton shokët e vet!  
Bashkësisë Fetare Islame nuk i duhet një tradhëtar si Shaqir Fetai!

*(1Kliklart, 1.10.2020)*



## Humor i zi

**(Shaqir Fetai, si takvaxhi humoristik, u mundua të thotë diçka me rastin e fillimit të vitit akademik në FSHI, por, mjerisht, edhe një herë u dëshmtua se është njeri shumë i ligë, censor dhe retushues i historisë. Ai sinqerisht mendon se islami në këta troje fillon që kur ai i tradhëtoi shokët e vet dhe u vetëshpall “reis”)**

**Nga Haxhi Isa Xhaviti**

Shumë keq! Studentët e FSHI-së si dhe medresantët e Isa Beut, ngelën si të përjashtuar nga iniciaiva rinore-shkollore me rastin e zhvillimit të procesit mësimor. Tërë stafi i arsimtarëve të vendit, tërë ministria e arsimit, të gjithë drejtuesit e shkollave të arsimit të mesëm dhe të lartë, mbi tre muaj organizoheshin, planifikonin, sugjeronin, përcillnin konkluzione e përfundime se, shkolla duhet të fillojë sa më parë pas pushimit të stërgjatur veror. Dikush propozonin dhe këmbëngulen në fillimin online të shkollës e dikush tjetër për vijimin klasik të shkollimit. E vetmja që nuk e tha asnjë fjalë lidhur me fillimin e procesit mësimor ishin këta të BFI-së si dhe drejtuesit e vatrave të saj arsimore. Pse ndodh kështu? Sepse, drejtuesit rinushë të BFI-së në mendjet e tyre të shk... kishin karrierën personale, pas një mori aktiviteteve prej hajnash, prej antiislamistëve, prej dështakëve, prej fuksave, kurse koha ishte për t’u përcaktuar dhe sjellë vendime kolektive lidhur me procesin arsimor, konform protokollit të imponuar nga pandemia e koronavirusit Kovid 19. Askush nuk e pati mendjen as te Medresja e as te FSHI! Ka një arsye! Sepse, nëse inistojnë në mësim të rregullt dhe në vendosje nëpër konvikte, do të dështojnë, sepse nuk kanë tubuar asgjë nga burimet financiare siç janë fitri dhe zeqati, nga haxhi e nga kurbanët, madje edhe atë pakë e mlodhën, e zhvatën duke i sorollatur bythët nëpër Emirate e nëpër blerje e në korrupsion të votave eventuale nëse shkohet në zgjedhje të reisit të ardhshëm sipas dëshirave të qelbëta të Shaqir Fetait. Këtë synim e ka Shaqir Fetai. U pëlqen mësimi online, sepse, kështu nuk do të zbulohen dështakë dhe, do të ngelë ndonjë denarë për t’i fshirë mjerkat e hajnave.

Dhe, Shaqir Fetai e anashkalon shënimin e fëllimit të procesit arsimor në Medrese, dhe zgjedh që të prezantojë në këtë “event” organizuar nga FSHI-ja! Nuk po merremi këtu me sharllatantizmin e Shaqir Fetait gjatë fjalimit të tij peç një injoranti të pashembullt. Nuk po merremi me snobizmin dhe dilentantizmin, as me hipokrizinë e tij, sepse këtë po e flasin vetë komentuesit e “informatave” ku flitet për Shaqir Fetain.

Po pse e kishte zgjedhur këtë “event” për të folur pranë “intelektualëve” që prezantuan në “eventin” e FSHI? Për të vetmen arsye sa për ta minimizuar dhe për ta “devaluuar” atë deklaratën e vet televizive publikuar disa ditë me parë ku shihet se çfarë elozhesh i thurrë Shaqir Fetai Sulejman Rexhepit! Dëshiron që ta përgënjeshtrojë kontributin e Sulejman Rexhepit në hapjen e Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup! Zgjedhë që këtë djallëzi të tij ta shpreh sa më pranë Sulejman Rexhepit, gati në Sullare të Poshtme, për t’i treguar se ka mbaruar puna e tij! Kjo ishte “trimëria” e Shaqir Fetait! Nëse dikur Sulejman Rexhepi investoi pa dhimbje në zbardhjen e personalitetit të madh kombëtar e fetar, kontributin madhështor dhe devotshmërinë e para-paraadhësit të vet, Hafëz Bedriut, duke ia botuar edhe monografinë e tij, ky “reisi” i leshit, pra Shaqir Fetai, përpiqet që ta retushojë tërë historinë në këtë drejtim! Shaqir Fetai e kujton shumë mirë ditën kur ishte “bashkë me Dr. Muhamet Mustafën në Këshillin themelues të FSHI nuk paska arritur të gjejnë as pesë tituj”! Çfarë tituj o Shaqir Fetai? Po a nuk pat anëtarë të tjerë, a veç ju dy keni qenë? Pse po gënjen o Shaqir Fetai, po kush të ka bërë hesap

ty kur ndërtohej FSHI? Pse e vë veten pranë emrit të Dr. Muhamet Mustafës, sa për të thënë se edhe ti je i rangut të tij, ë? Po ti je kontribues më i madh i kriminalizimit të BFI-së dhe organeve të saj, kurse Dr. Muhamed Mustafa ishte kontribues në sferën e kulturës dhe letërsisë islame në gjuhën shqipe.

Nëse në deklaratat televizive, një javë para se ta shkarkojnë Sulejman Rexhepin, ia kishin taksuar të gjitha meritat Sulejman Rexhepit për themelimin e këtij Fakulteti, në këtë “event” ishin munduar që ta zerojnë fare, ta shumëzojnë me zero! U tha: “Për një fakultet të tillë Bashkësia Fetare Islame angazhohej vazhdimisht. Ajo e kuptoi imperativin e kohës dhe menjëherë ndërmori iniciativën për ndërtimin e Fakultetit të Shkencave Islame... Në të vërtetë nevoja për një fakultet të këtillë u paraqit menjëherë pas diplomimit të gjeneratës së parë të Medresesë “Isa Beu”, te të cilët ekzistonte dëshira e madhe për ti vazhduar studimet... Pas një angazhimi të mundshëm shumëvjeçar të BFI-së, leja për hapjen e Fakultetit të Shkencave Islame u morr në janar të vitit 1995, ku edhe në mënyrë solemne në Kondovë u vendos gurrëthemeli i këtij institucioni të lartë edukativo arsimorë. Viti i parë akademik filloi më 1997/1998.”

Në këtë të vërtetë mungon e vërteta më e madhe, të cilën Shaqua e mohon qëllimisht, si dikur “policët kujdestar të trurit” kur censuronin gjithçka që nuk i pëlqente “sistemit”! Islamikisht do të duhej që Shaqua ta pranonte se, jo BFI-ja, por, ekskluzivisht Sulejman Rexhepi është angazhuar me mish e me shpirtë për themelimin e këtij Fakulteti. Tjetër gjë është motivi i këtij themelimi? Nëse do Shaqua edhe ia tregojmë motivin e vërtetë që ridhte nga punëdhënësit (!!!) e tij parësor! Shaqir Fetai nuk paska qenë as mësimdhënë, madje nuk ka qenë as në Maqedoni kur ka nisur zyrtarisht iniciativa për FSHI-në! Pastaj, pse e fsheh faktin që Dekan i parë historik i këtij Fakulteti ka qenë pikërisht Sulejman Rexhepi dhe, mbi të gjitha, i takon atij që të flasë mbi historikun e kësaj vatre arsimore dhe jo Shaqir sharlatanit, i cili, të kaluarës së vet në BFI i frikësohet si djalli temjanit!

Pastaj, pretendimet e tij si të një abdalli, si të një megalomani sharllatan, duke shitur kopalla se, pikërisht studentët e këtij Fakulteti na e paskan njohtuar Europën dhe mbarë Botën me islamin dhe me kulturën islame, se mos me pas qenë ky Fakultet do ta merrte pusi krejt botën! Po ata gjeneratat të shqiptarëve të Maqedonisë e viteve ‘70- ‘80, madje edhe më herët, që i mbaruan studimet nëpër fakultetet islamike nëpër qendra të ndryshme të botës arabe, në Turqi, në Sarajevë? Po ata qindra studentë që studiuin nëpër qendra të ndryshme islamike, edhe përkundër se në Maqedoni po funksiononte FSHI?

Shaqir Fetai asnjë fjalë nuk e tha për rrethanat shoqërore dhe historike kur u krijua ky Fakultet. Natyrisht, sikur të mos ishte Partia për Prosperitet Demokratik (PPD) ky fakultet akoma do të ishte ëndërr dhe dëshirë në letër! Pastaj edhe lufta e UÇK-së i mbështeti për mur armiq të këtij Fakulteti! Po në cilin taborr ishte Shaqir Fetai?

Shaqir Fetai është aq i poshtër sa me të vërtetë mendon se, gjithçka islamike, ka nisur dhe ka marrë formë që nga koha kur ai i tradhëtoi shokët dhe u vetëmërtua si “reis”! A ka më ofendim për kuadrin teologjik të vendit se sa “kryetar” i intelektualëve myslimanë të vendit të jetë Shaqir Fetai! Ç’humor i zi ky!

*(1Kliklart, 3.10.2020)*

## Cili je ti, o Shaqir Fetai?

**Në opinion po qarkullojnë disa “bomba” që thyen copë-copë karaktere paraprakisht të lakuriqësuarra deri në palcë. Katër deklarata televizive që e madhërojnë Sulejman Rexhepin, katër deklarata televizive nga varrëmihësit e Sulejman Rexhepit. po fytyra ku ngeli?**

**Nga Andi Rakipi, Tiranë**

Mesazhi që përcillet përmes këtyre katër deklaratave të sahanëlëpirësve më besnikë të Sulejman Rexhepit dhe, ajo që do të pasojë fill pas nëntë ditëve pas këtyre deklaratave, prek absurdin e mossinqeritetit si dhe të hipokrizisë që reflektohet nga personat me karakter copë-copë.

Vetëm një fuqi e patundur kombëtare, vetëm një qendër ndërkombëtare për ligje fetare, vetëm një “shërbim misterioz” me fuqinë e “perëndive nëntokësore” mund ta imponojnë një ndryshim aq radikal në qëndrime dhe në besnikëri ndaj “padronit”! Nëntë ditë përpara, të diskutueshmit myftilerë të dyshimtë, si ai i Gostivarit, Shaqir Fetai, i Tetovës, Qani Nesimi, i Shkupit, Qenan Ismaili si dhe i papjekuri “dekan”, Shaban Sulejmani, i thurrën elozhe, e shkarravitën “palimpsestin autokton” për “pronarin e shpirtit të tyre”, Sulejman Rexhepin! Pas nëntë dite, këta katër, me ca hajdutë të tjerë që përbëjnë “ushtrinë e djallit” që ia ka vënë kazmën BFI-së, dolën para mediave dhe e shkarkuan Sulejman Rexhepin me konstatimin se ai ka shkelur Nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së!

Asnjë fuqi, asnjë qendër, asnjë institucion e organizatë ndërkombëtare nuk do të mund t’i grumbullonte këta puçistë klasikë dhe t’ua kërkonin që ta shkarkojnë Sulejman Rexhepin! Këtë do të mund ta bënte vetëm “shërbimi misterioz me fuqi të perëndive nëntokësore”. Thënë shkurt: vetëm shërbimi intelgjent në të cilën, ky grupth puçistësh aderojnë si elemente operative! Mund të jenë vetëm dy-tre persona që kanë aftësinë manipulative të djallit dhe synimin e degjenerimit të Bashkësisë Fetare Islame deri në kotec pulash të lagura nëpër shi! Të tjerët mund të jenë viktima të joshura nga liria dhe “karriera e begatë”!

Myslimanët e vendit u ndëshkuan që edhe një herë të humbin kohë të fascinuar duke përcjellë filmin me tematikë helmuese anti-BFI! Rolin kryesor – Shaqir Fetai, prototip i shkatërrusit më të pashpirt të BFI-së? Cili je ti, Shaqo?

Shaqir Fetai dhe tre puçistët e tjerë do të deklarohen me kënaqësinë më të madhe për Sulejman Rexhepin duke e ngritur atë në “figurë markante”, në “peshonalitet me një karizëm të paparë”, në një atdhetar e fetar të panjohur në historinë e kombit dhe të fesë të këtyre anëve. Kjo dashuri “e shenjtë” do të vazhdojë edhe për disa ditë me radhë, deri në ditën e Kurban Bajramit. Në ditën e nesërme do të vie “urdhëri i madhë” dhe, dy ditë më vonë, Shaqir Fetai do ta kumtojë shkarkimin e Sulejman Rexhepit dhe, qëndrimin nëntokësor të të dyshimtëve se janë përcaktuar që Shaqir Fetai të zhvillojë procesin e zgjedhjes së reisit të ri. Për këtë guxim mediatik Shaqir Fetai do të shpërblehet nga “shërbimet” që të vazhdojë e të sillet si “kryetar” e si “reis” sepse nuk do të munden t’i bëjnë askush asgjë! Cili je ti, Shaqo? Pse këtë karrierë bllanko? Ç’shërbime ke kryer më parë për këtë shpërblim të merituar prej “nëntokës”!

Shkelësit kolektiv të Nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së, gozhduan Sulejman Rexhepin që të shpëtojnë vetë nga akuza për bashkëpjesëmarrje dhe përkrahje në të gjitha aktete shkatërrimtare dhe të kriminalizimit të Bashkësisë Fetare Islame! Ata mund t’i shmangen të vërtetës mbase për disa vite, por ama, më në fund, do të duhet të dorëzohen e të gjykohen nga historia deri në turpërim fatal! Shaqir Fetai engjëll?! Cili je ti, Shaqo?

Kot që, Shaqir Fetai, si pjesëtarët e komunitetit të LGBT-së, shëtit bythët poshtë e lartë, futet nëpër xhami e merr pjesë nëpër evente për të cilat është absolutisht pa merita dhe, në emër të “kryetarit e të reisit” flet si “triumfus”, flet sikur të mos ketë ndodhur asgjë, flet duke u munduar që ta lulojë tërë atë krim që e ka bërë në BFI, flet si i “plotëfuqishëm”? Cili je ti, Shaqo? Shaqir Fetai është prototip i të guximshmit i cili, me përkrahjen e “shërbimeve të djallëzuara nëntokësore”, haramin e bën hallall! Të shkelësh Nenin 58 sipas Kushtetutës së BFI-së dhe, kokëllartë të futesh në xhami, në mesin e teologëve, në mesin e nxënësve e të studentëve të çiltër, është, thjesht, hallallëzim i haramit. Këtë është duke e bërë “reisi” i haramizuar. Cili je ti, Shaqo?

*(1Kliklarg, 5.10.2020)*

## “Dekani” analfabet i Sulejman Rexhepit

**Një profesor dhe një intelektual i mirë nuk do të fliste si Shaban Sulejmani, i shthurur në mendim, me një oratori të sakatosur, me fraza të pakuptueshme, askund të lidhura, me mendime bajate**

**Nga Dr. Zeqie Veseli, psikologe, Vjenë**

Një javë rresht në “Konakun” e Sulejman Rexhepit, Shaban Sulejmani kishte ngritur lloj-lloj intrigash e strategjishë për mënjanimin e Fahredin Ebibit, sepse iu dha rasti që, në një moshë relativisht të re, të nisë një karrierë të paëndërruar ndonjëherë. Sulejman Rexhepi fascinohej nga kjo aftësi intrigante e Shaban Sulejmanit!

Në BFI u përhap lajmi nga Muzemil Osmani, shefi i kabinetit të Sulejman Rexhepit! I lumtur e i gëzuar që u zgjodh një prej problemeve shumë të mëdha që po e mundonte tash e sa kohë Mulla Sulën! I mrekulluar deri në ekstazë, u dëgjua tek iu tregonte disa të punësuarve:

“Prej sot dekan i FSHI-së do të jetë Shaban Sulejmani, njëri prej profesorëve më të mirë që ka Fakulteti. Nga gëzimi nuk kam fjetur tërë natën”!

“E paskeni hëngër”, ia paska prituri njëri prej të pranishmëve!

“Pse? Nuk po të bëhet qejfi që një profesor tepër i madh ia shpreh lojalitetin deri në vdekje reisis tonë”, paska provokuar në mënyrë shumë naive shef Muzemili.

“Nëse ai është profesor i mirë, më i miri në FSHI, atëherë, futjani dryrin Fakultetit. Po çfarë profesori ai?”

“Mund ta keshë inat por ai është intelektual i kalibrit të lartë”, sërish kishte provokuar shef Muzemili! “Sa për intelektualizëm e zë e pëshurri në vesh”, kishte reaguuar shumë keq dhe në mënyrë rrugaçerie ai që nuk ishte pajtuar me këtë zgjedhje dhe me këto vlerësime nonshalante!

Dhe, ja ku doli e vërteta e zyrtarit “rrugaç” që i kishte reaguuar shumë ashpër shef Muzemilit! Një profesor i mirë, një akademik e një dekan, a do të pranonte të jepte një deklaratë aq të poshtër e cila do ta nxirret sheshit profilin e tij prej sharlatani, pavarësisht se në fund do të kërkojë të dijë nga autori i dokumentarit të Sulejman Rexhepit, nëse ishte i mirë a jo, do me thënë, “nëse dola intelektual apo m...”!

Një profesor dhe një intelektual i mirë nuk do të fliste si Shaban Sulejmani, i shthurur në mendim, me një oratori të sakatosur, me fraza të pakuptueshme, askund të lidhura, me mendime bajate që më tepër ofendonin hoxhallarë e teologë të brymosur kombëtarisht e fetarisht, se sa që madhëronin Sulejman Rexhepin. Shaban Sulejmani fliste për Sulejman Rexhepin sikur të ishte një “akademik plak”, sikur të kishte kaluar nëpër ato kohë plot me krajata, fliste për sensin e Mulla Sulës për zhvillim fetar sikur të kishte qenë krah i djathtë i tij! Në tërë atë tufë lavdëratash e elozhesh, ja që i rrëshqet një budallallëk me të cilin i ofendon të gjithë myslimanët e vendit! Shqip në BFI qenka folur pasi Mulla Sula qenka zgjedhur Kryetar! Po në ç’gjuhë paska folur Sulejman Rexhepi deri sa ka qenë hoxhë e referent në Myftininë e Shkupit Në ç’gjuhë kanë folur e kanë ligjëruar hoxhallarët e hershëm? Të gjithë në gjuhën maqedonase?! Një profesor i mirë dhe një intelektual i lartë nuk do të bënte gafe të tilla, sepse, pas perëndimit të periudhës antishqiptare maqedonase, doli dielli për shprehjen e nacionalizmit gjithëkombëtar shqiptar. Evidenca në gjuhën maqedonase mbahej edhe nëpër shkollat shqipe, edhe nëpër spitale, nëpër ambullanta, gjithadej! Shpërtheu shqipja! Jo se deshti trimi e patrioti Shaban Sulejmani (që atëherë ishte cullë) por, thjesht – shpërtheu shqipja!

“Më vitin 1997 filluam me mësimin e fesë dhe jo vetëm”, kështu thotë Shaban Sulejmani! Është një urrejtje dhe një ofendim i paparë që u shprehet të gjithë hoxhallarëve dhe teologëve që kur nisi Feja Islame në këto anë! Kjo dëshmon se Shaban Sulejmani nuk përqëndrohet në atë që thotë por në atë që duhet ta bëjë si intrigë e si lojë të ulët! Meqë, sipas Shaban Sulejmanit, Sulejman Rexhepi na qenka kaq i madhë, kaq madhështor, kaq me vlerë dhe kaq islamikisht i përkushtuar, atëherë pse u bë pjesë e lojës për ta larguar Mulla Sulën? Për hirë të islamit apo për interes të “nëntokës”? Ishte një LËVIZJE që plotë pesë vite po mundohej ta bindte Shaban Sulejmanin, ndërsa Shaban Sulejmanat dhe dudukët e tjerë po i luanin “çyçek”? Dhe vjen në fund detyrimi, pra, jo bindja e tij por detyrimi, që të bëhet palë që largon atë që i dha emër e titull! Sipas të gjitha gjasave ai do të detyrohet edhe në kërkim faljesh, deri në përrulje pa personalitet para Sulejman Rexhepit.

Prandaj po thuhet fuqishëm: me të tillë pisash nuk ka dhe as që mund të ketë Rijaset e aq më pakë BFI! Nuk mundet që të bëhet BFI-ja me largimin antikushtetues të Sulejman Rexhepit dhe me bashkëpunëtorët e tij brenda BFI-së në rolin e të virgjërës sepse që të gjithë e kanë hëngër!

*(1Kliklarg, 7.10.2020)*

# Shaqir Fetai tashmë ka prekur majat e turpit të shoqërisë dhe të shtetit tonë

**(Rreth truqeve të bajatshme dhe të turpshme të Shaqir Fetait me të cilat po mëton të realizojë dëshirën e tij të sëmurë, të bëhet “kryetar”)**

## Shkruan Sahadete Veliu

A mundet të ngritet “piari” i një injoranti dhe i një hipokriti duke u bazuar në gënjeshtër e në vetëkënaqësi? Jo, pra! Sado që po mundohet Shaqir Fetai që nga bajga të bëhet lule dhe t’i marrim erë, megjithatë ai ngelë, le të themi, krijesë me karakter të shëmtuar e të pëshirosur! Shaqir Fetai është, ka qenë, është dhe do të jetë vetëm glasë e Sulejman Rexhepit!

Këto truqe të të shndërruarit me marifet nga glasa në “tufë trëndafilash” Shaqir Fetai i publikon në fb-un zyrtar të BFI-së. Sapo ta hapësh, për këtë fillimjavë do t’i gjeshë disa përpjekje si shqelmimet e fundit të demit të therrur.

“Kryetari i BFI-së” priti në zyre krejt katundin e Çegranit, pastaj do të vijojë me katundin e Jellovjanit e me radhë për të përfunduar me katundin e Gollaguzicës, Muçibabës dhe të Gjylekarit! Sepse, na është bërë “kryetar”, me shumë aktivitete të cilat e pengojnë që të shkojë te katundarët, tash ata duhet t’i vijnë në zyre! Pis!

Jalla, na u çu në këmbë “kryetari” Shaqir Fetai dhe na paska shku me e taku “Zëvendëskryeministrin e Parë shqiptar”, Artan Grubin! Ky na del sikur të jetë i lindur në maj të këtij viti dhe drejt e në postin e “kryetarit” të BFI-së. Aq shumë është i pastër, siç e ka lindë nana. Nuk ka bërë kurrë mëkate, nuk di çka është mëkati, kurrë nuk e ka njohur Sulejman Rexhepin e lëre më t’i ketë shërbyer si rob Shaqir Fetai, prandaj dhe ky i di gjërat nga 27 maji e këndeje, sepse këtu u lind ai! Prandaj dhe nuk e di se zëvendëskryeministri i parë shqiptar i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut (duhet të theksohet edhe kjo, o bilmeza) ka qenë z. Imer Aliu dhe, është i pari që e ka refuzuar kryeministrin maqedonas antishqiptar (Gruevskin), që publikisht e ka ofenduar dhe që publikisht i ka thënë “kurrë më me ty në qeveri”. Kjo nuk i kujtohet Shaqir Fetait!

Shaqir Fetai, që ne krye të “informatës” gënjenë qëllimisht, sepse e di që shqiptarët më shume e lexojnë titullin dhe i kërcejnë lajmet! Të krijojë përshtypjen se ky farë bereqeti u takua me zv/ kryeministrin shqiptar! Artan Grubin e ka takuar edhe çuni im, madje gjashtëmbëdhjetë vite para Shaqir Fetait. E ka takuar në autobus, rrugës për në Tiranë, si tifozë të kombëtares që do të luante kundër Danimarkës. Me t’u kthyer çuni, për dy ditë, i kishte marrur të gjitha sjelljet e një rrugaçi të pistë: shahej, i paedukatë, i pakulturë, me çdo kusht përpiquej për ta imituar tashmë liderin e tij të ri, Artan Gubin, “kryeministrin e parë shqiptar” të “Shfercerave”! Tani ka përparuar, sepse, gjysmën e jetës ia ka kushtar patriotit dhe njërit prej prijësve më të dashur shqiptar, z. Ali Ahmetit. Të rrishë me këtë burrë të kobmit dhe të mos avansoshë, do të thoshë se je qenie e kotë! Por ama, për këtë periudhë derisa Artan Grubi i shërben dhe mësohet prej Ali Ahmetit, Shaqir Fetai ia ka fërkuar me shumë lezet Sulejman Rexhepit! Artan Grubi është prodhim i Ali Ahmetit, Shaqir Fetai është prodhim

i Sulejman Rexhepit – këtu përfundon rrëfimi!

Për punë “piari” Shaqir Fetai nuk tregon se si u pordh në oborr të shtëpisë kur u nis për në Shkup, gaboi, sepse edhe pordha ishte aktivitet i “kryetarit”! Por nuk e la pa e theksuar si aktivitet të qenurit spektator i rëndomtë para foltores ku fliste (pallavra për Shaqir Fetain) Komisari i BE-së për zgjerim dhe fqinjësi të mirë, Oliver Varhei, me rastin e dorëzimit të Raportit të Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2020. Këtë “aktivitet”, Shaqir Fetai e kishte titulluar me tamam, ashtu siç është e vërteta: Shaqir Fetai “ndoqi prezantimin e Komisarit Evropian”! Pra, arriti ta ndjek si përfaqësuesit e tjerë të komuniteteve fetare në vend. Flitet se Shaqir Fetai si student ka ndjekur në koncert edhe prezantimin e albumit të Zdravko Çoliçit. Shaqir Fetai ka ndjekur shumë “prezantime”, sidomos ato të Sulejman Rexhepit të cilat i kanë lënë aq shumë mbresa sa që, sot, ai detyrohet bukalisht ta imitojë Sulejman Rexhepin, duke dalur një kopje e zbehtë karikaturiale e tij!

Qershia mbi tortë! Si produkt i rrenave, i matrapazllëqeve, i intrigave si dhe i karrierës së sëmurë që po e kaplon si koronavirusi, është edhe ky “lajm” i mjerë: “Kreu i BFI H. Hfz. Shaqir ef. Fetai u zgjodh anëtar i Këshillit Botëror të Komuniteteve Muslimane” Diku nëpër lajm thuhet se ai u zgjodh “anëtarë i plotë”!!! A ka anëtarë të përgjysmuar, apo, çerek anëtar? Mos po do të thotë “anëtarë me të drejta të plota”?!

Po si u zgjodh anëtarë Shaqua?! Nuk po themi se pagoi lobimin e futjes së vet personal e privat në këtë organizatë! Le të supozojmë se u zgjodh “me merita”! U zgjodh sepse paska dhënë kontribut madhor në organizimin e Myftinisë së Gostivarit. E dinë anëtarët e kësaj organizate botërore se ku i bie Gostivari? Pse i jep kaq shumë rëndësi kësaj çështje Shaqua, madje kohëve të fundit gjithnjë e më shumë! Të votohet nga anëtarët e një organizate, ndërkohë që bojktohet dhe refuzohet, madje edhe si njeri, nga anëtarët e “organizatës së vet, rijasetit”! Pikërisht, Shaqir Fetai, tashmë ka hetuar se po i rrëshqet dhe nën këmbë, ndaj vazhdimisht ia do b... që të mburret se çka paska bërë në Myftini, do me thënë që, ju mund të ma pengoni realizimin e dëshirës që të bëhem reis, por ama titullin myfti nuk do të mund të ma merrni sepse kam punuar shumë në ngritjen e kësaj Myftinie! Le të na e tregojë programin e vet, pikat e programit mbi të cilat ka punuar, cilat pika i ka realizuar dhe çka konkretisht ka bërë vetëm Shaqir Fetai, kur ai gjithë kohës, mbi 18 vite, të gjitha të arriturat e BFI-së ia ka përshkruar si merita Sulejman Rexhepit! Tani, ka gënjyer atëherë, apo po gënjen sot?! Shaqir Fetai, shumë shpejt do të jetë lëndë e institucioneve të ndryshme shtetërore, gjithësesi, lëndë e Antikorrupsionit, lëndë e organeve përkatëse të gjyqësorit, të policisë financiare! Shaqir Fetai ka nisur që të gënjejë nëpër botë, ka nisur t’i gënjejë edhe organizatat e ndryshme botërore, ka nisur ta degradojë Bashkësinë Fetare Islame, ta devalvojë atë, ka nisur të jetë imazhi më i keq i shtetit të Maqedonisë së Veriut, ka nisur ta dëmtojë seriozitetin shtetëror të vendit, ka nisur t’i ofendojë të gjithë myslimanët e vendit, falë aftësive të veta dhe grupeve mafioze për t’i manipuluar disa organe (Apo t’i korruptojë!) përkatëse shtetërore. Shaqir Fetai, si shkelësi absolut i Kushtetutës së BFI-së, si nëpërkëmbës i të gjitha akteve normative të BFI-së, si planifikues i shkatërrimit të këtij Institucioni, përhap gënjeshtër se është zgjedhur “kryetar i BFI-së” dhe, falë kësaj gënjeshtre shumë të shëmtuar, falë edhe dokumentimit me “dokument” të falsifikuar, ai mund të thirret apo edhe të anëtarësohet nëpër organizata të ndryshme ndërkombëtare. Pra, meqë tani BFI na paska tjetër “kryetar” atëherë, me automatizëm, do të anëtarësohet në vend të Sulejman Rexhepit! Shumë shpejtë kërkesë e ndërkombëtarëve si dhe e personaliteteve dhe organizatave ndërkombëtare do të jetë shporrja dhe marginalizimi totalisht i Shaqir Fetait nga BFI-ja!



E meriton ky gënjeshtarë, ky matrapaz, ky rrumpallë, që të tolerohet madje edhe të prekë në Kushtetutën aktuale të BFI-së vetëm e vetëm që ai të arrijë të ngelë “kryetar” i BFI-së? Besimtarët e vendit nuk besojnë që këtu do ta ndihmojnë organet policore dhe të gjyqësisë dhe, me neglizhencën e tyre, të kemi një “kryetar policor” nonshalant, pra, ”kryetar” si produkt i ndihmës që vjen indirekt nga neglizhenca e organeve gjegjëse shtetërore. Shaqir Fetai tashmë ka prekur majat e turpit të shoqërisë dhe të shtetit tonë!

*(Politesa, 8.10.2020)*

## “Udhëzime” si ta fitoshë bekimin e Sulejman Rexhepit

**Eh, si ia solli Zoti Qenan Ismailit! Të turpurohet që dikur na paska qenë Myfti i Shkupit ndërsa me nostalgji ta kujtojë kohën kur ishte i angazhuar në OH “Kalliri i Mirësisë”, fakt këtë që e fshiu nga CV-ja e vet, sepse për këtë angazhim 15-vjeçar turpërohej nga Sulejman Rexhepi! Medet!**

### Shkruan Qefsere Ramani

Pas përfundimit të “myfillëkut” në Muftininë e Shkupit, nga ana e Prof. Rexhep Jusufit, kjo Myfni për disa muaj ngeli pa myfti. Reisi, Sulejman Rexhepi, u mundua shumë, kërkoi nga shumë persona që ta pranonin këtë titull por, asnjëri nuk pranoi. Nuk pranuan as miqtë dhe bashkëpunëtorët më të ngushtë të tij, sepse, që të gjithë e dinin se me çfarë problemesh gjigante përballët ky organ. Dhe, vjen në shprehje paradoksi. Armiku 15 vjeçar i Sulejman Rexhepit, ulet në sofër të përbashkët, dhe, duke ngrënë, pranon të bëhet “organ” i Sulejman Rexhepit dhe t’i shërbejë me “besnikëri” e me “devotshmëri”! Le të bëjë çfarë të dojë Sulejman Rexhepi, ia realizoj të gjitha planet dhe kërkesat, vetëm të bëhem Myfti! Qenan Ismaili, njëri nga urrejtësit më të mëdhenj të Sulejman Rexhepit, i etur për poste, i thyen të gjitha parimet miqësore dhe, vihet në shërbim të armikut të vet. Kjo as nuk ka ndodhur dhe as që është parë dikund! Sulejman Rexhepi, i cili publikisht përmes “Zërit të Amerikës” “shoqatën” e Qenan Ismailit (FRI-në) e pat quajtur “filieale të UDB-së” ndërsa drejtuesit e kësaj shoqate i quante “bashkëpunëtorë të policisë sekrete maqedonase”, sakaq, e bëri “filiale” të vetin!

Në sofrën e “Konakut”, aty ku ra ujdia, u morën vesh, i përgatitën projektet, planet akcionale dhe, iu qasën punës! A e kupton magjistrin i ikrave të peshkut, i valvulave të ajrit të troftës, se çka do të thotë projekt!

Tre vite rresht, para se teologu, magjistrin i turizmit dhe kulinarisë, Qenan Ismaili, të pranonte të bëhej “organ” i Sulejman Rexhepit, vazhdimisht shkruhej, trumpetohej e thuaj se si po kriminalizohet BFI-ja! Tre vite shkruhej se si synimi parësor ishte degradimi i tërësishtëm i vakëfit të Myftinisë së Shkupit, ndërsa, ky farë magjistrin, shkon dhe pranon të bëhet bashkëpjesëmarrës në këtë mëkat fatal për Myftininë e Shkupit dhe më gjërë! Për më keq, për faqe të zezë, Mr. Qnan Ismaili, në biografinë e vet që e ofroi, për hirë të Sulejman Rexhepit i cili nuk i duronte organikisht klerarkinë e shoqatës ku shërbene paraprkisht Qenani, shkon dhe e fshinë një fakt shumë të rëndësishëm, shumë human, shumë njerëzor! I vie turp të pranojë se ka punuar 15 vite në Organizatën Humanitare “Kalliri i Mirësisë”! E mohon këtë fakt për hirë të “planit aksional” për t’i shtuar dhe grumbulluar edhe më shumë problemet e kësaj Myftinie!

Sepse, kështu i kishte thënë “mentori i ri” i tij: sa më llugë Myftinia e Shkupit, aq më mirë për “rijasetin”!

Qenan Ismaili, tre vite më vonë, do të detyrohet që të bëhet palë me ata që do ta shkarkojnë Sulejman Rexhepin duke e akuzuar (me të drejtë) se e ka shkelur Nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së! Po Qenan Ismaili çka shkeli gjatë kohës sa ishte krah i djathtë i Sulejman Rexhepit?

Do të pranohej si pendesë, do të pranohej si vetëdijësim dhe reflektim, do të pranohej si person i pavarur dhe profesional, do të pranohej se ka pasur “plan aksional” Qenan Ismaili, vetëm nëse

publikisht do të dalë e të tregojë se çka u bë me ish-objektin e Myftinisë së Shkupit, çka po ndodhë me vakëfin “Ibni Pajko”, dhe, në veçanti, çka po ndodhë me pronën “Komunaleci” të Myftinisë së Shkupit e cila u uzurpua dhe aty dikush hodhi gurëthemelin e Hotel “Isra”, të BFI-së! Çka po ndodhë me këtë Hotel! Kush është pronari i vërtetë, cila është leverdia e Myftinisë së Shkupit. Kush po ndërton aty, me cilët para po ndërtohet, kush përfitoi etj. etj.!

Si duket, Qenan Ismaili u mërzi duke qenë nën urdhërat e atij i cili e akuzoi me kompetencë si “filiale e UDB-së maqedonase” dhe, më 27 maj të këtij viti vulosi vendimin për shkarkimin e tij!

Por, një javë më parë Qenan Ismaili kishte deklaruar se Sulejman Rexhepin e ka frymëzim për shtyerjen e punëve përpara! Tani, si do t’ia bëjë pa këtë frymëzim? Si do ta shtyjë pa atë dorë të Sulejman Rexhepit që e paska ruajtur nga mbrapa Qenan Ismailin? Si do ta ruaj prapanicën dhe si do ta sigurojë perspektivën pa Sulejman Rexhepin?

Vetëm këto dy brenga që mund t’i kuptohen Qenan Ismailit në tërë atë deklaratë! Po, i kuptohen edhe nja dhjeta budallallëqe, kuptohet tërësisht se është “fluturak”, se e ka kompleks vetëlavdërimin, se është i hutuar, se është i zbrazët në mendim, se nuk di çka flet, se është i thatë në mendime, ndonëse mbanë titullin magjistër i turizmit dhe kulinarisë! Ai, për më keq, del edhe “myfti” diletant! Nuk e njeh Kushtetutën e BFI-së, nuk e njeh rregulloren e Myftinisë, nuk i njeh organet, institucionet, shoqatat, organizatat e BFI-së dhe, si pasojë e kësaj injorance, ai tërë kohës Myftinisë i thotë “institucion”, ndërkohë që është organ, kurse Institucion fetar është BFI-ja!

Ja për shembull, ja se çfarë deklaratë televizive ka dhënë Mr. Qenan Ismaili: “Në momentin kur unë udhëheqi me institucionin Muftini e Shkupit që është institucion shumë i rëndësishëm për Bashkësinë Fetare Islame, dhe shumë normale që edhe prej brenda ndoshta paraqiten momente dhe persona të cilët janë skeptik për ngritjen profesionale të këtij Institucioni, por edhe nga ana tjetër edhe levizje dhe zëra të imputimeve negative të qarqeve të ndryshme, shumë i rëndësishëm ishte motivimi, energjia pozitive që e jepte Reisul Ulemaja që me të vërtetë gjithë atë plan strategjik që e përgatitëm, planin akcional, veprimet, angazhimet, përputhshmërinë tonë me ligjet e shtetit dhe, nga ana tjetër, në shërbim të jetës fetare, ai, Haxhi Sulejman Rexhepi ishte ajo fryma, ai inspirimi pozitiv, që ne si myslimanë në përgjithësi por edhe si Myftini, se si duhet të ngrisim pozicionin tonë.”

Është një periudhë e stërgjatur, e përbërë prej dy-tri frazave, që thurret nga 11 fjali të zgjeruara dhe të thjeshta! Ky defekt është karakteristikë e snobëve, e diletantëve, që për të dëshmuar se janë shumë të dijshëm, tollovisin fjali, i japin zor për fraza të gjata, të thonë sa më shumë fjali dhe mos të kuptojë asgjë receptori. Receptori duhet të mahnitet me “aftësinë” e ligjëruesit për të thënë shumë gjëra dhe, me këtë, të kompleksohet vetë receptori se është i papërgatitur dhe i paaftë për ta thithur tërë atë që e flet snobi! Kjo është karakteristika e ish-organit të Sulejman Rexhepit, Mr. Qenan Ismailit.

Në periudhën e dytë të kësaj deklaratë televizive të Qenan Ismailit radhitet këta “magaritarë”: “Besoje se atë çka e ka bërë për Myftininë e Shkupit, brenda këtyre viteve deri sa jamë unë në krye të kësaj Myftinie, e ka bërë edhe për Institucionet e tjera, kurse rezultatet shifen. Për atë shpeshë kam thënë dhe sërish po e them se, shumë e rëndësishme është që në momentet e vështira të keshë një krah shtytës, të fortë, të fuqishëm i cili të mbronë nga mbrapa që të ecësh dhe të çashë rrugën drejt anëve pozitive dhe të mirave në shërbim të jetës fetare.”

Pra, Qenan Ismaili mburret me rezultatet e arritura të Sulejman Rexhepit, të cilin e lavdëron dhe e mburrë si “fuqi” që të mbronë nga mbrapa! Sakaq, i harron të gjitha këto cilësi të Sulejman Rexhepit, që e bëjnë krenar Qenan Ismailin si “Myfti” i Shkupit dhe, e shkarkon Sulejman Rexhepin!

Një është e sigurtë: radhitet në krahun e shkarkuesve vetëm nga inati se pse u vu në lojë dhe pranoi të bëhet Myfti në kundërshtim me Kushtetutën, pa kompetenca dhe me synime për ta kriminalizuar deri në shkatërrim BFI-në!

Pra, njeri pa asnjë ditë përvojë punë në BFI, me 15 vite luftë frontale kundër BFI-së, që nuk e ka

njohur kurrë për kryetar të BFI-së Sulejman Rexhepin, kjo të ndodhë kur të pranoshë dhe kur të lutesh të të bëjë Zoti rezil dhe të refuzueshëm nga shoqëria, nga miqësia, nga shokët, nga familja, nga vetëvetja! S’ka më keq!

**(P.s.** Si autore e këtij shkrimi, jam ish-nxënëse e këtij “mësuesi fetar”, i cili dikur na mësonte pa kurrfarë metodologjie, pa kurrfare konspekti pedagogjik dhe pa kurrfare përgatitjesh profesionale. A nuk është ky një perversitet i llojit të vet? Tallje me shtresën më të çiltër që është në gjendje të regjistrojë në tru vetëm atë që ia ofron. Nga perspektiva e sotshme, jam e bindur se ky farë “mësuesi” na ka dezinformuar, na ka çorientuar dhe, këtë binje ma përforëcon fakti që ai ka pranuar titullin “myfti” për t’u radhitur në aradhat e “ushtrisë së djallit”! Unë, myslimane e këtij vendi, një njeri të tillë nuk e pranoj për myfti!)

*(Politesa, 9.10.2020)*

## Çka do të ndodhë në BFI

**Kur dëshironte Sulejman Rexhepi t'i disiplinojë të padëgjueshmit, ju thoshte: “Juve duhet me ua sjellë Afrim Tahirin që...”? Të gjithë pastaj dridheshin e rrinin sus? Pse kaq frikë nga Afrim Tahiri? Kush është ky? Çka është Afrim Tahiri! Vetëm një luftëtarë i devoshëm kundër të gjithë atyreve që e kriminalizuan dhe po e thellojnë krimin në BFI**

### Shkruan Andi Rakipi

Vazhdojnë veprimet antikushtetutare, antiislame e antikombëtare në BFI-në e uzurpuar nga Shaqir Fetai! Tërë kjo veprimtari po shoqërohet me apelin bizar: “Të jemi bashkë se do të na vie Afrim Tahiri e pastaj...”

Shaqir Fetai ashiqare po e shikon se po i rrëshqet dhe nën këmbë, ashiqare po e ndjenë se u bë gaz i botës, ashiqare e ka të qartë se një ditë edhe familjarët e vet do të gërditen prej tij. Shaqir Fetai nuk do ta ketë fundin e Sulejman Rexhepit, por, fatkeqësisht, do ta ketë edhe më të tmerrshëm, sepse nuk e ka moshën e lojës ftohtë- nxehtë, Shaqir Fetai do të përvëlohet fare!

Në Bashkësinë Fetare Islame, nuk po luhet vetëm “loja” e Afrim Tahirit, i cili ka programin e vet, ka platformën fetare e kombëtare, si dhe ka biografinë bilur të pastër. Strategjia e tij është të shpëtohet BFI-ja, të ringritet, të marrë pozitën e vet në shoqëri e në shtet, t'i kthehet pesha dhe roli që e meriton dhe që tashmë e kanë kontrabanduar, sidomos Shaqir Fetai, për interesa meskine.

Në Bashkësinë Fetare Islame sot për sot janë disa klane që luajnë lojëra të kota e të huaja, të padenja për një shqiptar e për një mysliman të mirëfilltë. Po luhet loja e Shaqir Fetait dhe e shërbimeve sekrete. Afrim Tahiri synon që nga BFI-ja t'i dëbojë të gjithë elementet antiislame e antishqiptare, ato elemente që BFI-në e duan vetëm sa për t'ia gllabëruar vakëfin, si dhe t'i stopojë të gjitha lojërat e pandershme që po luhet mbi kurriz të këtij Institucioni. Emërues i përbashkët i këtyre grupacioneve sektariane që po funksionojnë aktualisht në BFI është se janë të vetëdijshëm se i vetmi shpëtim i Institucionit është Platforma e Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI!

Në BFI, sot për sot, vepron klani që po quhen “spiunët” e Sulejman Rexhepit, klani tjetër antisulistë, vepron çerekklan i Shaqir Fetait, si dhe klani i karrieristëve të cilët po bëjnë gara se kush do të jetë më spiun i madh, kush ka afërsi më të madhe me elementet antiislam të pushtetit dhe kush do të takohet sa më shpesh me Zoran Zaevin! Jo vetëm Zaevi, por as gjyshi e stërgjyshi i tij, madje as katragjyshi i tij, nuk do të jenë në gjendje ta shpëtojnë BFI-në dhe ta ngrisin mbi tabanin antikushtetutar, vetëm sa për të dëshmuar se myslimanët e parapëlqejnë kaosin; asnjërit prej tyre nuk do t'i interesonte një BFI stabile dhe e fortë, siç do t'i interesonte, bie fjala, Afrim Tahirit, angazhimi i të cilit nuk bëhet për një vend pune e as për ndonjë post në BFI.

Sot në BFI, asnjëri klan nuk është në paqe të sigurtë njëri me tjetrin. Në BFI shumë shpejt do të krisin grushtat e shqelmat. Ka të atillë që duan rikthimin e Sulejman Rexhepit, ka të atillë që ngelën të zgënjyer nga intriga e Shaqir Fetait, nuk janë as për Sulën e nuk janë as për Shaqon, elementët e shërbimeve sekrete po insistojnë që BFI-ja sa më shumë të mbështetet dhe të varet nga këta shërbime policore. Dhe, krejt kjo lojë po i pëlqen pushtetit të “përfaqësuar” nga Shaqir Fetai, sepse, vetëm pushtetarët dalin fitues duke e thithur pikën e fundit të palcës së BFI-së. Medet, ku ka degraduar ky

Institucion!

Zoti është i Madh, pa dyshim! Ai nuk do të lejojë kurrë që myslimanët të mbesin pa Institucioni e vet. Ai do t'i urdhërojë që një ditë, shumë shpejt, të mblidhen dhe të vendosin që të ikin në të mirë të BFI-së, ashtu siç u erdhi “urdhëri i zi” që të mblidhen kriminelët dhe brenda ditës ta dëbojnë kryeparin e tyre! Zoti Mëshirëplotë thërret vetëm në rregullim e në harmoni. Kurse aty ku ka kriminelë e b...q... nuk ka harmoni. Prandaj këta nuk i shpëton askush, përveçse marginalizimi total dhe ndëshkimi që u takon sipas meritave. Ai i di punët më së miri dhe jo veglat e nëntokës! Të gjithë këta që po e synojnë shkatërrimin e BFI-së, me në krye Shaqir Fetain, janë kriminelë të pasardhësve të tyre, sepse edhe vetë këta e dinë që, kjo lojë e ndytë antiislame do t'u kthehet pasardhësve të tyre, nipave, stërnipave! Kush prek vakëfin do ta paguajnë me shëndet pasardhësit e tyre. Kjo është e vërtetë si Zoti Një!

*(1Kliklarg, 11.10.2020)*

## Shaqir Fetai u vizitua si kandidat për padi penale

**Dallaverxhiu i llojit të vet, Shaqir Fetai, i cili tashmë ka vendosur që ta shtyej projektin e huaj deri në vjedhjen e postit të kryetarit të BFI-së, sot, në fb-un e vet, informon se paska zhvilluar një “TAKIM BASHKPUNIMI ME DREJTORINE AGJENCISË TË ZBATIMIT TË DYGJUHËSISË PROF DR. YLBER SELA”!**

“Takim bashkëpunimi”?! Kush me kë të bashkëpunojë dhe, pse? Profesor Sela, sipas ligjit përkatës, duhet ta gjobisë Shaqon, sepse, ky, në një informatë prej disa fjalive, ka bërë dhjetra gabime gjuhësore, të denja për një analfabet!

Shaqir Fetai thotë: “(Prof. Ylber Sela) Së pari shprehu urimin për postin që kryej...” Cilin post? Pse nuk e tregon Shaqir Fetai? Nëse ia ka uruar postin e ushtruesit të detyrës, atëherë, Sela dëshmon se nuk e njeh Kushtetutën e BFI-së dhe, me këtë “urim” ka dëmtuar shumë rëndë Institucionin e BFI-së? Sepse aktet normative të këtij Institucioni nuk e njohin këtë “post”? Nëse e ka uruar si “kryetar” atëherë, Profesor Sela duhet të kuptojë se ka vizituar një Institucion ku është manipuluar, sidomos nga Shaqir Fetai, i cili, pa dyshim që është kandidati potencial për t’iu nënshtuar padive penale! Sepse, Shaqir Fetai kurrë nuk është zgjedhur në ndonjë post udhëheqës të BFI-së, kurrë nuk është emëruar dhe kurrë nuk ka kaluar nëpër procedura të rregullta për çfarëdo posti në krye të BFI-së. Në BFI ai sillet vetëm si “masë e dhunshme” alla- serbçe nga elementet shtetërore me disponim antiislam e antishqiptar! Ai është vetëm Myfti i Myftinisë së Gostivarit, i cili, edhe aty duhet t’i nënshtrohet sanskioneve të Ligjit për punë, sepse, i ka shkelur të gjitha normat e punës si dhe vijueshmërisë në vendin e punës.

Shaqir Fetai, tashmë i dëshmuar si “i forti” që me lehtësi gënjen institucione shtetërore e ndërkombëtare, përfundimisht është bërë qytetar i rrezikshëm. Institucionet kompetente të shtetit, më në fund, duhet të veprojnë, ndryshe, në analet e BFI-së do të regjistrohen, bashkë me elementet antiislame dhe antishqiptare, si bartës të projekteve për ta shkatërruar Institucionin e vetëm fetar islam në RMV.

*(Fokusi, 13.10.2020)*

## Shaqir Fetai po manipulon në emër të z. Ali Ahmetit

**Do të ishte jashtëzakonisht e mirëseardhur ndërhyrja e z. Ali Ahmetit në eliminimin e lojërave nëntokësore që po luhen në emrin e tij! Ali Ahmeti është dashamirë i madh i BFI-së dhe gjithnjë ka qenë për funksionimin e këtij Institucioni në kuadër të akteve normative të vetë Institucionit por edhe në kudër të ligjeve të shtetit.**

### Shkruan Afrim Tahiri

Po dëgjohen muhabetete nga brenda BFI-së se si Shaqir Fetai, tek po jep shpirt për t'u bërë kryetar ilegjitim i BFI-së, po manipulon në emër të liderit të BDI-së, z. Ali Ahmetit, i cili, gjithnjë sipas Shaqir Fetait, i paska thënë që sa më shpejt t'i emërojë në myftinjë kordinatorët e Myftinive të BFI-së dhe, të siguroj kuorum të Rijasetit për ta emëruar "kryetar"! Sikur të ishte kjo e vërtetë, do të përbente një problem jashtëzakonisht të madh, sepse, ia zhdokë kushtetutshmërinë si dhe vlerën institucionale vetë Bashkësisë Fetare Islame në vend. Sikur të ishte kjo e vërtetë do t'i jepte arsye të plotë një shqetësimi kombëtar, sepse, do të na dilte për herë të parë "një lider" që e parapëlqen anarkinë dhe zhvlerësimin e institucioneve shekullore fetaro- kombëtare.

Ne e dimë dhe besojmë shumë fort që Shaqir Fetai gënjen, se nuk është e vërtetë, se përpiket që përmes manipulimeve të ulëta ta njollosë z. Ali Ahmetin vetëm që të bëjë karrierë prej "reisi"!

Ne e dimë fare mirë që z. Ali Ahmeti e di shumë mirë situatën e brendshme në BFI, se është i brengosur, se ndjen shqetësim të veçantë dhe se fare nuk është për jetë jashtë normave ligjore të shtetit apo të institucioneve. Është më se e qartë që z. Ali Ahmeti e di fare mirë se cila është kompetenca e ushtruesit të detyrës së një posti, ashtu siç ia ka caktuar vetes Shaqir Fetai, duke i shkelur të gjitha aktet normative të BFI-së.

Nuk është në tagrin e Shaqir Fetait që të emërojë myftinjë, apo që të vetëzgjidhet në krye të BFI-së! Ligjërisht, ushtruesi i detyrës ka punë dhe angazhim deri në zgjedhjen apo në emërimin e Kryetarit nga organet kompetente që i njeh Kushtetuta e BFI-së dhe, pas kësaj, ai duhet të ecë apo të rikthehet në postin ku ka qenë.

Shaqir Fetai përpiket që të hap shtigje që do të shndërroheshin në autostrada të shkeljes së akteve normative, të vënies në praktikë të akteve anarkiste, si dhe të krijimeve të precedenteve të reja, pa dyshim, shumë ofenduese për traditën tonë, për jetë institucionale në suaza të normave juridike. A do ta pranonte popullata shqiptare e Maqedonisë së Veriut një lojë të këtillë në kurriz të BDI-së ashtu siç po mundohet ta luaj Shaqir Fetai në dëm të BFI-së?

Bashkësia Fetare Islame ka pasur praktika dhe, që nga viti 2005, madje edhe vetë z. Ali Ahmeti ka qenë i kyçur në zgjidhje të problemeve, bazuar ekskluzivisht në Kushtetutën e BFI-së dhe jo në teket e individëve. Praktikata e njëjta janë zgjidhur përmes komisioneve ad hoc që kanë pasur kompetenca vetëm të organizojnë zgjedhje të lira e të ndershme për ta bërë BFI-në me kryetar legal dhe legjitim.

Këtë lojë karrieriste që po mundohet ta luaj Shaqir Fetai, është jo e ndershme, jolegale, ilegjitime dhe, lojë që mund të shkaktojë revoltë të pakontrollueshme. Mbase këtë detyrë e ka Shaqir Fetai, por, në këtë lojë assesi nuk guxon të llogarisë në afërsinë eventuale që mund ta ketë me liderin e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, z. Ali Ahmetin, apo me bashkëpunëtorët e tij të ngushtë.

Shaqir Fetait ligjërisht nuk i ka mbetur më kohë për t'i organizuar zgjedhjet e Kryetarit të BFI-së, sepse, nuk ka as kuorum të organeve kryesore që kanë kompetencën e zgjedhjeve të organeve të



BFI-së por, mbi të gjitha, nuk ka as rregullore për zgjedhjen e Kryetarit të BFI-së! Nëse ia lejon “Maliqi”, Ligji nuk ia lejon mandatin e “ushtruesit të detyrës” më shumë se gjashtë muaj, ndërkohë që ky “titull” nuk parashihet në asnjë akt normativ të BFI-së!

Shaqir Fetai mund t’i manipulojë kordinatorët e myftinive duke ua premtuar postin e myftive në kundërshtëpëblim me votën e tyre që i duhet atij për t’u zgjedhur “kryetar” jo legal dhe ilegjitim. Çdo veprim i Shaqir Fetait përtej organizimit të zgjedhjes së kryetarit të BFI-së do të përbënte vepër penale dhe për këtë do të duhej të përgjigjej penalisht! Nëse ai mendon se “i kontrollon” gjykatësit që do të mund të ngrisinin procedurë kundër veprimeve të tij prej anarkisti, atëherë, në ndërgjegje do t’i ngelë një njollë e pashlyeshme deri në Ditën e Kijametit. Natyrisht, nëse ka ndërgjegje, por, gjithësesi që në analet e historisë së BFI-së do të ngelë vetë një Esat Pashë Toptani i dytë!

Çdo zgjidhje e njëanshme, pa përfshirjen e Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI, jo vetëm që do të jetë jolegjitime, por, do të jetë vetëm përpjekje për ta ngritur edhe më lartë përgun e problemeve që nuk do të na bënte nderë as si komb dhe aq më pak si njerëz të thirrur për të predikuar fe!

Prandaj, do të ishte jashtëzakonisht e mirëseardhur ndërhyrja e z. Ali Ahmetit me autoritetin e vet të padiskutueshëm në eliminimin e lojërave nëntokësore që po luhen në emrin e tij! Ali Ahmeti është dashamirë i madh i BFI-së dhe gjithnjë ka qenë për funksionimin e këtij Institucioni në kuadër të akteve normative të vetë Institucionit por edhe në kuadër të ligjeve të shtetit. Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI, të cilën e drejtoj unë, në emrin e qindra imamëve dhe teologëve që janë përkrahës të Platformës së kësaj Lëvizje, në emër të mijëra myslimanëve të vendit, lutet që të ndërhyjë z. Ali Ahmeti dhe t’i “prangosë” të gjitha ato duar të huaja që kanë depërtuar në BFI dhe që po mundohen ta turbullojnë e ta shkatërrojnë këtë Institucion, madje duke e njollësuar edhe vetë biografinë e liderit të BDI-së, z. Ali Ahmeti.

Lutemi dhe shpresojmë për nga e mira dhe e mbara! Amin!

*(Almakos, 16.10.2020)*

## “Shqiponja” e UDB-SË nga Çegrani

Këto ditë u publikua një dokument shkëputur nga dosja e ndonjë anëtari të “Myslmanëve të rinjë”, lëvizje kjo që drejtohej nga ish-presidenti legjendar boshnjak, Alia Izetbegović dhe bashkëpunëtorëve të tij. Dokumenti flet për Shaqir Fetain, pretendentin për “reis i BFI-së”, i cili, kur ka qenë student i Fakultetit të Shkencave Islame në Sarajevë, ka bashkëpunuar, sipas dokumentit, me UDB-në nën nofkën policore “ORAO”. Dikur “Albanews.tv” pat transmetuar se, në disa nga dosjet e inspektorëve dhe drejtorëve të lustruar janë gjetur disa nga emrat e hoxhallarëve dhe priftërinjve aktualë në Maqedoni.

Në dosjehet inspektorit të UDB-së për Gostivar, Temelko Boshkovski, si bashkëpunëtorë i UDB-së është gjetur emri i myftiut aktual të Gostivarit, Shaqir Fetahu, transmetonte Tetova1.

Dhe, këto ditë, në dhjetra portale është botuar një dokument i shkëputur nga ndonjë dosje e ndonjë boshnjaku në Sarajevë. Faqa e dosjes prej nga shkëputet fleta është 198, ndërsa në herën e 18 ku përmendet nofka policore “ORAO” (“Shqiponja”), jepen të dhëna konkrete mbi këtë bashkëpunëtorë i cili, sipas të gjitha gjasave, fatkeqësisht, na del të jetë pretendenti aktual për reis të BFI-së, Shaqir Fetai. Oficeri operativ para të cilit raporton Shaqir Fetai, është Stanko Dragović. Dëshmia është dhënë në prani të dy punëtorëve operativë të tjerë: Mile Milutinović dhe Elmaz Haxhispaqiq, në shtëpinë e bashkëpunëtorit me nofkën “Miki”.

Sipas dokumentit, me gjasë kjo deklaratë është ndër të fundit që e jep Shaqir Fetai, sepse së shpejti ai kthehet në vendlindje. Sugjerimi i oficerit dhe nëpunësve operativë është që t’ju sugjerohet shokëve në shërbimin amë në Maqedoni që ta kenë nën kujdes “ORAO-n” sepse është shumë vigjilent dhe tepër i gatshëm për të bashkëpunuar. Bashkëpunimi duhet të vazhdojë ndërsa i njëjti të përkrahët, të shtyhet në karrierë dhe mos të hiqet lehtësisht dorë nga ky bashkëpunëtorë!

Në dokument shihet se si Shaqir Fetai veç të tjerash, spiunon edhe një intelektualët e shquar të Kosovës, Nexhat Ibrahim, i cili, më vonë vite të tëra do të kalojë burgjeve të ish-Jugosllavisë! Po ashtu, Shaqir Fetai para operativëve të UDB-së dëshmon edhe për një deklartë të një studenti shqiptar të vitit të parë, me emrin Ramiz Alija nga Tetova. Në fund, udbashët konstatojnë dhe propozojnë në instanca të larta që, ta tërheqin Shaqir Fetain dhe mos të kërkojnë prej tij që edhe më tej ta përcjellë Nexhat Ibrahim, sepse si duket tashmë në sytë e tij është kompromentuar, sepse, nuk pranon të bisedojë me të.

*(Politesa, 17.10.2020)*

## “Bashkëpunëtor” i cilit shërbim është kreu i BFI-së?!

*(dokument që “rrodhi” në opinion nga UDB-a serbe)*

**Burimi:** bashkëpunëtori – Shakir Tefik Fetai (25 prill 1959) nga fshati Çegran – Gostivar, RS e Maqedonisë, student i Fakultetit të Shkencave Islame, Sarajevë.  
**Pseudonimi:** “ORAO”

**E pranuar nga:** oficeri operativ – Stanko Dragović

**Raport i datës** 10.09.1984, Sarajevë

Burimi njofton se, sipas detyrës së dhënë më 5 tetor 1983, ai disa herë është takuar me Nexhat Ibrahimini nga Prizreni, anëtar i këshillit të studentëve për jetësimin e lëvizjes “Mlladi muslimani”, por nuk ka arritur të nxjerrë asnjë informacion me rëndësi. Detyra e informatorit ka qenë që ta zbulojë se pse materiali propagandues që i kushtohet Ahatullah Homeinit, që është shpërndarë nëpër klasa në orët e mbrëmjes, nuk është pranuar dhe nuk është shpërndarë nga studentët dhe ka përfunduar në shportë. Burimi ynë thotë se studenti Ibrahimini sillet mirë, është i përzemërt, por se nuk flet asgjë për lëvizjen “Mlladi muslimani”. Ai është i bindur se Nexhat Ibrahimini dyshon te “ORAO” dhe prandaj nuk hapet në bisedë me të.

Më 4 shtator 1984 profesori i lëndës “Sistemi shoqëror dhe politik i RSFJ-së”, Hamdija Çemerliq, ka hedhur disa fletushka dhe material propagandistik, në të cilat lavdërohej Homeinin, duke i lënë nën karriget e klasës ku e kishte orën e parë. Kur ka hyrë në klasë të mbajë mësim, është befasuar që kërçit atë material e ka gjetur të mbledhur dhe të hedhur në shportë. Disa ditë më vonë bashkëpunëtori ynë “ORAO” ka vajtur në zyrën e profesorit (atë e konfirmon edhe vetë profesori Çemerliq) dhe i ka thënë se e ka zbuluar kur është emërtuar lëvizja “Mlladi muslimani” që t’i kontrollojë klasat dhe ta mbledhë gjithë materialin propagandistik dhe ta hedhë në shportë.

Burimi ynë thotë se “pastrues” të këtyre materialeve, që “mos të provokohen studentët”, janë: studenti i vitit të parë Ramiz Alija nga Tetova, i cili shpesh kishte deklaruar se më mirë do të dëshironte ta kishte emrin Enver Hoxha sesa Ramiz Alija, si dhe studenti i vitit të tretë të Fakultetit të Shkencave Islam, Senad Sokolović nga Travniku. Kur është pyetur Senad Sokolović se pse e ka pranuar rolin e hedhësit të atyre materialeve të rëndësishme për “Mlladi muslimani”, ai ka thënë: “Kjo është vepër e komunistëve dhe qafirëve. Ata duan të na ndajnë në “homeinistë”, si ushtarë të Homeinit, ndërsa ne jemi “ushtarë të Allahut”, që jemi betuar ta kemi shtetin tonë musliman dhe të mos jemi nën pushtetin e qafirëve, të cilët njëherë i kanë mbushur kovat me sy, që i kanë nxjerrë nga sytë tanë”.

### **ORAO**

**EVAULIMI** – të dhënat janë të vlefshme, sepse bëhet fjalë për komentimin e Senad Sokolovićit dhe dëshirën armiqësore të Ramiz Alisë.

**SHPJEGIMI** – Senad Sokolovići as pas tre “takimeve formale” nuk ka pranuar të bëhet bashkëpunëtor i yni.

**PROPOZIM** – “ORAO” të mos e ndjekë më aktivitetin e Nexhat Ibrahiminit, sepse duket që tashmë është komprometuar. Duhet të lidhemi me shërbimet tona në RSM dhe meqë “ORAO” për disa ditë

kthehet në vendlindje, patjetër duhet të jetë nën mbikëqyrjen e shokëve tanë maqedonas, të jetë në bashkëpunim me ata dhe t'i ndihmohet në karrierë, sepse është shumë bashkëpunues.

**DETYRAT** – Bashkëpunëtori “ORAO” ka marrë për detyrë që të imponohet me zërin e tij të ëmbël dhe sa më shumë të futet në mesin e lëvizjes radikale “Mlladi myslimani”, që gjithnjë e më shumë po ngre krye në Bosnjë, në Sanxhak, në Kosovë dhe në Maqedoni.

**MASAT OPERATIVE** – Deklarata duhet të shtypet në dy kopje, ndërsa një kopje duhet t'i dorëzohet njeriut të operativës Mirsad Isaković.

**NJOFTIM** – është hartuar në shtëpinë “MIKI” në praninë e punëtorëve operativë, Mile Millutinović dhe Elmaz Haxhipashiq.

**OFICERI OPERATIV** – Stanko Dragović

*(Almakos, 17.10.2020)*

(R)

Oglasio: saradnik - Bekir Terik Fetah (25 april 1989) iz sela Gegrane-Gostivar, SR Makedonije, student Fakulteta islamske nauke, Sarajevo  
Naslovnik: "ORAO"  
Priključeni operativni oficir - Stanko Dragovic

Izveštaj od 10. 09. 1984. Sarajevo

Izvor obavestava da se, prema dodeljenim zadacima 5 oktobra 1983 godine, više puta sastao sa Nedzatom Ibrahimijem, iz Prikurena, članom studentskog odbora sa osnivačkim Pokretu "Mladi Muslimani", ali da mu nije uspeo da izvuci ni jednu važnu informaciju. Zadatak informatora bio je da otkrije kako propagandni materijal posebnog Ajatolaha Homeinija, koje distribuiramo u učionicama u kasne noćne sate, studenti ne primaju i ne distribuiraju, i sve se završava u kosarima. Naš izvor kaže da student Ibrahim ponosa dobro, hrabro, ali da ne govori ništa o Pokretu "Mladi Muslimani". Uveren je da Nedzat Ibrahim sumnja u "Orao" i zato se ne otvara u razgovorima.

Dana 4 septembra 1984 godine, profesor predmeta "Društveni i politički sistem SFRJ", Hamdija Čemerlić, ubacio je pamflete i propagandni materijal, slaveni Homeinijevu licenat, ispod stolova u učionici gde imo prvi čas. Kada je usao u učionicu da predaje, iznenađio se kada je vidio da je sav propagandni materijal skupljen i bačen u kon. Nekoliko dana kasnije, naš saradnik (to potvrđuje i naš profesor Čemerlić) i rekao mu da je otkrio koga je imenovao Pokret "Mladi Muslimani" sa da kontroliše učionice i da skuplja sav propagandni materijal i baci u kosare.

Naš izvor nam kaže da su "čistaci" ovih materijala "da ne bi provokirali studente", su: student prve godine, Ramiz Alija iz Tetova, koji često izjavljivao da rado bi volio da koristi ime Eaver Hodža nego Ramiz Alija, kao i student trećeg godine Fakulteta islamskih nauka, Senad Sokolović iz Travnika. Na pitaje Senada Sokolovića često je prihvatio ulogu gostes besajući tako važne materijale sa "Mladi Muslimani", rekao je: "Ovo je sjelo komunisti i kafira. ZELE su udariti kao kominec, kao Homeinijevu vojnike, a mi smo samo "Allahovi vojnici" obavestiti da imamo našu muslimansku državu i da ne bude pod vlašću kafira koji su jedinom pučili kvate oči koje su izvadili iz naših očeva."

O R A O

**EVALUACIJA** - Podaci su vredni jer se radi o neprijateljskom komasiteru Senada Sokolovića i neprijateljskoj selji Ramiz Alije.  
**POJASHNENJE** - Senad Sokolović ni sakon tri "formalne sastanka" nije pristao da postane naš saradnik.

**PREKLON** - "ORAO" više se bi trebalo da preti aktivnost Nedzat Ibrahimija, jer izgleda da je već kompromitiran. Moramo se povezati i sa našim službama u SRM i, budući da se "ORAO" još par dana vraća se u svoju domovinu, mora biti pod nadzorom naših makedonski drugova, biti u saradnji sa njima i pomoći mu u karijeri, jer je veoma saradljiv.

**ZADACI** - Saradnik "ORAO" dobio je zadatak da se sastane svojim slekima glasom i da sto više prodre unutar radikalnog pokreta "Mladi Muslimani", koja sve više i više diže glavu u Bosni, Sandzak, Kosovo i u Makedoniji.

**OPERATIVNE MERE** - Injava treba da bude odstampana u dva primerka, a jedan treba da bude dostavljen operativcu Mirsadu Isakoviću.

**IZVEŠTAVANJE** - uradjeno je u kuzi "MIKI", u prisustvu obe posle oper. Mile Milutinović i Elmaz Hadzišpahić.

OPERATIVNI OFICIR - Stanko Dragovic

1.  
S  
Dragovic  
LPS

## Muslimanët në mes respektit si mit dhe pisllicit

**Shaqir Fetai ka mision të poshtë, prandaj duhet ta kryej detyrën që ia besuan!!!! Kush? E di vetë ai! Ai keqperdor respektin kombëtar e fetar ndaj mysafirrit. Myslimanët janë para proves: ta nuhasin pisllicitun e mysafirrit apo mos t'ia hapin fare derën**

### Shkruan Burim Muniri

Të vetmit teolog ne vend, Shaqir Fetait, iu publikua dokumenti që dëshmon për bashkëpunimin e tij me UDB-në jugosllave qysh kur ishte student në Sarajevë. Janë lakuar shumë nofka policore, është “dëshmuar” për shumë teologë si bashkëpunëtorë të shërbimeve serbo-sllave por, për herë të parë që publikohet një dokument është kjo për Shaqir Fetain, i cili, me çdo kusht po mundohet ta vjedhë postin e Kryetarit të BFI-së.

Shqiptarët dhe, përgjithësisht myslimanët, janë të shokuar nga kjo “bombë”, mbi të cilën me aq lehtësi po mundohet të shkelë Shaqir Fetai, duke lënë të nënkuptojë opinionin e gjërë se, aktualisht ai është nën trysni të papërballueshme: të mbyllet përjetësisht si një murg brenda katër mureve, apo ta çojë deri në fund “amanetin” e UDB-ë që nënkupton devalvimin dhe shkatërrimin në themel të BFI-së.

Si duket Shaqir Fetai qenka me 10 hektar fytyrë! Nuk i bën përshtypje dekonspirimi dhe komprometimi i tij, ai që moti është pajtuar me të jetuarit si fuks. Prandaj, me aq lehtësi futet në xhami, me aq lehtësi futet dhe imponohet në mesin e teologëve, shkon ballëllartë dhe i uron nipa e mbesa për fillim të mbarë të shkollimit pa mbajtur llogari se ata anëtarë të familjes për vite e vite do të jenë të shënuar si nipa apo mbesa të fuksit me nofkën “Orao” (Shqiponja).

Përkundër këtij qëndrimi misionarik të Shaqir Fetait, kolegët e tij, xhemati, intelektualët dhe gjithësecili, nuk e kanë obligim që ta nderojnë të pandershimin. Është obligim njerëzor e fetar që mos të rrihet pranë fëlliqësirës, prandaj, çdo hoxhë, çdo teolog, çdo mysliman i vendit e ka obligim që mos të shprehë më të voglin respekt ndaj Shaqir Fetait. Pas publikimit të dokumentit, gjithësecili që shoqërohet me këtë farë “beregëti” do të llogaritet si shoqëruar i ish-udbashit. Të tillët shqiptarët nuk i durojnë as në pleh, sepse është rrezik që nga ky pleh të kontaminohen arat tona pjellore.

*(Politesa, 19.10.2020)*

## Mynafiku me fytyrën një hektar

**“O ju që keni besuar! Mënjanoni shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë gjynah. Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frikë Allahun! Me të vërtetë, Allahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.”** (El Huxhurat, 12)

### Shkruan Durim Ganiu

Fjala mynafik i atribuohet spiunit! Spiuni është edhe më i keq se thashethemexhiu. Spiunimi është profesion, thashethemja është sëmundje. Profesionin vetëm shkon duke u përsosur, perfeksionuar dhe zgjeruar. Spiuni rrjetëzohet, ky është misioni i tij, prandaj, Krijuesi ynë si “vlerë” më të madhe të tij ia njuh afinitetion për ta hëngër mishin e vëllait të vet të vdekur. Kanibalë! Mundet edhe nekrofil! Nekro-kanibal!

Shaqir Fetai dy-tre ditëve të fundit, mundohet që të tregohet se sa promovues i hafëzlerëve të rinj që është. Po cila është merita e tij në daljen e hafëzlerëve të rinj? Pse nuk ka pikë dhembje, pikë mëshire dhe pikë trishtimi naj këtyre voglushëve që kanë kaluar nëpër tërë ato mynxyra dhe, si pis del dhe i prezanton ata, mburret me të arriturat e tyre, ndërkohë që, brenda ato dy vite sa është munduar “Rojtari i Kuranit”, Shaqir Fetai ka marrur më qafë një dyzinë njerëzish duke i spiunuar, sepse ai tashmë u dëshmuar se e ka këtë profesion.

Ai, fatkeqësisht, edhe vetë është “hafiz” dhe, kanibalisti nuk ka lënë gjë të keqe pa bërë, nuk ka lënë hajnie pa i duartrokitur dhe pa i ndihmuar, nuk ka lënë vakëf pa shkatërruar, nuk ka lënë devalvim e shkatërrim të vlerave të islamit pa e ndihmuar dhe pa e përkrahur, nuk ka lënë njeri pa marrur më qaf dhe në fund edhe babain e tij shpirtëror të cilit ia nguli thikën pabesisht! Mynafiku nuk reagon në mbledhje, jo nëpër tubime intelektuale, jo përmes fushatave ndërgjegjësuese, jo përmes komisioneve, jo përmes mbledhjeve të Rijaseteve, debateve e polemikave, por, thjesht, përmes tradhëtisë së denjë për spiunët që ia ngulonin kush kujt të mundet! Edhe hafiz edhe ta ujisë farën e keqe? Këtë e ka bërë Shaqir Fetai dhe sot, pa fije turpi del dhe “mburret” në emër të hafëzlerëve të rinj. Është ofendim për këta të rinj, të gjithë, një ditë, kur do t’i kuptojnë gjërat, do të bëjnë nga një mëkat duke e sharë flliqtë dhe me plotë gojë Shaqir Fetain i cili ka prezantuar në promovimin e tyre si hafëzlerë të rinj, si “Rojtarë të Kuranit”!

Është sifrat i munafikëve, i hipokritëve që personaliteteve të kota t’u drejtohet me “figurë markante”! Kujt nuk ia nguli thikën pas shpine e që paraprakisht nuk i tha “figurë markante”? Çdo lavdërim që e bën Shaqir Fetai duhet të merret me rezervë dhe të qortohet madje për atë lavdërim, sepse e ka me hile, e ka të mëkatshme!

Tërë ditës rrinë duke thurrur intriga, takohen nëpër zyre sekrete, bashkë shkojnë në ndonjë event dhe, pastaj, ia nisin para publikut të thurrit elozhe njëri për tjetrin!

Dy orë para eventin mblidhen, “myftinjë e kordinatorë” ilegalë e ilegjitimë, marrin dynjanë nëpër gojë, dhe, kur ta marrin mikrofonin në dorë, mbi pesë minuta nisin ta përshëndesin njëri tjetrin, duke u thirrur me dr e mr (ndonëse këto shkronja mund të jenë të emrave të kafshëve “derr” e “magar”), vetëm e vetëm që të dëshmojnë si një “organ” i përbashkët që duhen aq shumë sa edhe janë në

gjendje të përshendeten tërë ditën. Ndërsa të gjithë e dinë se nuk duhen, se janë mynafikë, se nuk durohen në mes vete, se nuk përkrahen, se të gjithë i frikësohen njëri tjetrit. Shaqir Fetai ka dëshmuar se është tip shumë i lig në kuptimin i djallëzuar, se është dorë e zgjatur e UDB-së dhe se në karrierë do të ngjitet përmes shërbimeve simotra të UDB-së.

Shaqir Fetai, tamam në stilin e UDB-së, tamam në stilin e nekro-kanibalit për të cilin flet ajeti 12 i sures El Huxhurat, tërë meritat e muhafidhit, tërë angazhimin vetëmohues të hafizit të ri, ia atribuon myftiut ilegjitim të Shkupit, Qenan Ismailit. Po cila është merita e këtij farë duduku në tërë këtë aktivitet të shenjtë? Po si nuk i vie turp Shaqir Fetait të lavdërojë njiun i cili e shkallmoi vakëfin e Shkupit! Pse nuk ia kërkon paratë e vakëfit të shitur, pse nuk i kërkon raport, madje, pse nuk ia lëshon policinë financiare që të shikohet se çka po bëhet me vakëfin e Myftinisë së Shkupit te ish-lokacioni i Komunalecit, por e lavdëron dhe e hyp në kupë të qiellit!? E pra, këtë mund ta bëjë vetëm Shaqir Fetai i dalur “teolog” falë mentorit të vet policor, Stakno Dragoviqi (Oficer operativ i cili e ka rekrutuar Shaqir Fetain në UDB me nofkën “ORAO” (Shqiponja)

Populli shqiptar kurrë nuk ka pranuar që t’i prishë eventet e veta (dasma e syneti, fejesa e morte) për faktin që në mesin e të ftuarve ka depërtuar edhe ndonjë fuks. E kanë njohur, e kanë pritur spiunin si misafir, e kanë gostitur dhe e kanë dëgjuar, ndërsa kur kanë folur, kanë pasur bisedat e veta të kodifikuara dhe të vështira për t’u deshifruar nga spiunët prezentë. Spiuni është lodhur nga alegoritë popullore, është ngritur dhe eventit familjar ka vazhduar. Kështu paska ndodhur edhe me Shaqir Fetain, alias “ORAO-n” në përrurimin e fundit të hafizit të ri, edhe pse dikush kishte qenë gati të shkoj dhe t’ia tekërlisë çallmën duke folur në mikrofon.

Këta tipa me fytyrë një hektar duhet të lavrohen me pllugje gjysëm metërshe, në vend se të ujiten duhet të pështyhen, ndryshe, nuk marrin vesh, janë mësuar me nënçmime e me injorime. Ata nuk dalin nga eventet pa “mësuar” diçka, sepse e kanë porosi, e kanë mision, e kanë të nevojshme për ngritje në karrierë. Prandaj Shaqir Fetait nuk i skuqet fytyra, sepse që moti e ka shitur për karrierë! Edhe i pafytyrë edhe me karrierë?! Kush ia ka premtuar e ka gënjyer, ia ka futur...

*(Politesa, 21.10.2020)*



## Si bretkoca te nallbani

**Shaqir Fetai kërkon që të provokojë, sepse kërkon që të rrihet shpulla, sepse kërkon që të dëbohet, sepse kërkon që të kërcënohet, sepse kërkon që të ndiqet si miu i gjirizit, që pastaj të ketë një alibi të madhe që të ecë i shoqëruar nga truprojet e Sektorit të VI, të MPB-së. Pse vetëm Sulejman Rexhepi të kishte truproje dhe jo edhe ky**

**Nga Ibush Loki**

A e keni dëgjuar me vëmendje fjalorin e Shaqir Fetait kur i drejtohet masës në cilësinë e “kreut të BFI-së”! Identik si Sulejman Rexhepi, sepse e ka baba shpirtëror, e ka model, një jetë të tërë e ka kopjuar, nuk është në moshën e gjetjes së individualitetit të vet, e ka pasur model kopjimi, prandaj, sa herë që flet na duket një kopje e zbehtë e Sulejman Rexhepit. Me një dallim – Sulejman Rexhepi ka qenë më i rrafshhtë dhe pa komplekse në të folur, ndërsa Shaqir Fetai, i kompleksuar deri në kode gjenetike, mundohet të flasë paksa si “më intelektual”. Për shembull, Sulejman Rexhepi fjalën “i madh”, “e madhe” e theksonte me një “a” të fortë nazale, kurse, po të njëjtat fjalë Shaqir Fetai i thekson me një “a” të pederastë, deri sa e thekson fjalën “i madh” tri herë i bie “a”-së, “i maaadh”, duke e shqiptuar me nuanca të një melankolie hipokrite.

Shaqir Fetait po i mungon vetëm një gjë për ta aktruar tërësisht babain e vet shpirtëror, Sulejman Rexhepin! Po i mungon mangupllëku i tij.

Tashmë, Shaqir Fetai, këmbëngulë se është i kërcënuar. Prandaj na paska qenë te Kryetari i Kuvendit të Maqedonosë së Veriut, z. Talat Xhaferi! I është ankuar se pasi i ka dalur dokumenti se ka qenë spiun i UDB-së nën pseudonimin “Orao”, tani e kërcënojnë vazhdimisht. Kush e kërcënon? Po dil thuaj se nuk kam qenë, se është trillim dhe, aq. Nuk e kërcënon askush! Po pse Shaqir Fetai mendon se ky dokument është ai që e zhveshi para opinionit si spiun! Është zbërthyer shumë herët, madje është folur sepse është konstatuar se e ka gjenetike! Le të na thotë Shaqir Fetai se kush e spiunonte hoxhën e tij prej të cilit e mësonte hifzin si fëmijë?!

Shaqir Fetai mund ta vizitojë edhe Trampin, edhe Bajdenin, edhe Putinin, edhe Rasmusenin dhe, prej të gjithëve të kërkojë truproje, madje t’ua kërkojë ushtritë, policitë, ta kërkojë NATO-n, të kërkojë prej Sheqerinskës Ushtrinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, prej Spasovskit ta kërkojë tërë strukturën policore t’ia vë në shërbim – krejt këtë e ka të kotë. Fizikisht mbase do ta mbrojnë e ruajnë Shaqir Fetain, si veshkën në dhjamë, por, a do të mund ta mbrojnë nga e vërteta se ai i ka shërbyer UDB-së? Edhe OBSH-në le ta kërkojë në ndihmë, kot e ka, asnjë institucion shëndetësor në botë nuk mund t’ia shërojë dhembjen dhe trishtimin që ia ka shkaktuar dekonspirimi dhe komprometimi i tij nën pseudonimin “Orao”!

<https://www.almakos.com/dokument-bashkepunetor-i-cilit-sherbim-eshte-kreu-i-bfi-se/>

<https://zeri.mk/bashkepunetor-i-cilit-sherbim-eshte-kreu-i-bfi-sedokument/>

<https://lajme7.wordpress.com/2020/10/25/dokument-bashkepunetor-i-cilit-sherbim-eshte-kreu-i-bfi-se/>

<https://fol.mk/bashkepunetor-i-cilit-sherbim-eshte-kreu-i-bfi-sedokument/>

Pra, Shaqir Fetai do të ketë truproje ashtu siç kishte edhe Sulejman Rexhepi! Po ky aq është i pacipë, aq nuk kupton se nuk është kurrnjëfarë faktori në BFI, se është i caktuar vetëm sa për ta kryer procesin zgjedhor të Kryetarit të BFI-së dhe, pas këtij procesi duhet të rikthehet atje ku ka qenë, nëse do të ketë fytyrë të rikthehet atje! Është si të gjithë qytetarët e rëndomtë dhe, nëse shteti u cakton truproje secilit qytetar, pavarësisht nëse është spiun apo jo, atëherë i bie që Maqedonia e Veriut duhet të ketë nja 900 mij truproje për qytetarë në pozicione e pozita të ndryshme!

Shaqir Fetai, pas publikimit të dokumentit të UDB-së, vendin e ka në oborrin e vet, brenda avllisë, dhe jo të kërkojë truproje, sepse, kështu na i paska pasur Sulejman Rexhepi! Po çka i duhen Shaqir Fetait truprojet, kush po e kërcënon, pse po e kërcënojnë, ç'të keqe na paska bërë Shaqir Fetai që i paskan hyrë ethet në bark; tani edhe i keq, edhe i zi, edhe shpirtprishtë edhe me truproje, plus dhe fuks i shërbimeve të huaja?

Shaqir Fetai prandaj futet ndër qytetarë, nëpër evente e raste, sepse kërkon që të provokojë, sepse kërkon që të rrihet shpulla, sepse kërkon që të dëbohet, sepse kërkon që të kërcënohet, që pastaj të ketë një alibi të madhe që të ecë i shoqëruar nga truprojet e Sektorit të VI, me motivacion se është shumë i rëndësishëm për shoqërinë maqedonase, se i ka shërbyer kësaj shoqërie dhe se tash e njëjta shoqëri duhet ta mbajë nën kujdes deri sa ky avancon në karrierë. Një ndihmë të tillë, kohë më parë e ka kërkuar nga Presidenti i shtetit por, meqë nuk ka pasur arsye të forta dhe bindëse, kërkesa e tij ka qenë e injoruar. Të njëjtën kërkesë ia ka shtruar edhe Kryetarit të Parlamentit, por, në kompetenca dhe në mundësi të tij mund të jetë vetëm sigurimi i truprojeve partiake dhe hiç më shumë! Edhe këtë e ka bërë “kabullë” Shaqir Fetai por ka kërkuar që të prezantohen si persona të “eminencës gri” që vijnë nga Sektori i VI i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Çka ka ky që ndihmën e kërkon nga truprojet institucionale dhe jo nga Zoti Fuqplotë, i cili nuk njeh as truproje, as “reisa” e aq më pakë fuksa!

*(Fokusi, 22.10.2020)*

## **BFI-ja si satelit më vete**

**Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI vite më parë ka nënvizuar që, reformat shpëtimtare të këtij Institucioni do të zhvillohen vetëm kur shteti do të dalë jashtë BFI-së. Pra, nuk bëhet fjalë për daljen e BFI-së nga kontrolli dhe përgjegjësia para organeve gjegjëse të shtetit, por, për ikjen e vetë shtetit nga BFI-ja**

### **Shkruan Afrim Tahiri**

Dikush në vend, me të madhe është duke punar që Bashkësia Fetare Islame të bëhet ndonjë sektor i parëndësishëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shtetit. Manipulimi me fenë dhe keqpërdorimi i fesë është mjeti më i mirë që mundëson masa të jashtëzakonshme dhe dislokim institucional të disa digastereve të rëndësishme të shtetit nën komandën e MPB-së, brenda institucionit fetar, themeluar për organizimin e jetës fetare institucionale! Dikush po përpriqet që ta përpushë prushin dhe ta ndezë e t'i shkojë flaka në hava!

### **Shteti brenda BFI-se i domosdoshëm por jo për zhatje e shantazh**

Problemet fetare, sikundër ato politike, duhet të izoloohen dhe të lokalizohen vetëm në kufijtë e Ballkanit! Pa i radikalizuar myslimanët dhe pa e prishur harmoninë ndërkonfesionale tek shqiptarët, problemi fetar nuk mund të lokalizohet në Ballkan. Prandaj, shërbime të ndryshme telegjente, nga më bashkëkohoret e deri te recidivat e UDB-së, kanë zbritur në Ballkan dhe po mundojnë të gjejnë një shtrat për destabilizimin e mundshëm ndërfeetar! Ky synim djallëzor e ka të vështirë që të realizohet derisa shqiptarët do të jenë syçelë në ruajtjen e vlerave shpirtërore dhe përderisa nuk do të bëhen palë e këtyre elementeve të huaj që nuk ia duan të mirën, mbi të gjitha, shqiptarëve!

Shteti i Maqedonisë së Veriut, duhet të refuzojë po aq sa shqiptarët dhe myslimanët e devotshëm, skenaret e huaja që parashohin funksionimin e një shteti multifetar me myslimanë të destabilizuar, me derdhje të shumë energjive në përpjekje për t'i kontrolluar dhe destabilizuar organet fetare të myslimanëve të këtushëm. Sepse, kjo pastaj do të duket si fillimi i një jete të re për një trup me plagë që do të kullojnë përjetësisht. Cili trup do të rritej e zhvillohej paqte e qete me një plagë të tillë?

Opozita e kësaj BFI-je të kapur e të kontrolluar tash e sa kohë nga shteti (Lëvizja Myslimane për Reforma) duhet që të nisë me sa më shumë debate e konferenca publike, t'i shtojë dhe t'i intensifikojë takimet me ndërkombëtarët, me faktorët relevant të vendit dhe, sa më qartë ta zbërthejë tërë këtë lojë të pandershme.

Roli i Shtetit aktual (pra, pushtetit) është i dyfishtë: e para, që ta kontrollojë sa më thellë BFI-në dhe ta destabilizojë deri në themele, prej nga pastaj do të arrihej synimi i nxjerrjes së shqiptarëve si fetarë të paretshëm, ekstremistë, radikalistë e terroristë të cilët duhet të shkatërrohen deri në farën e fundit, duke i justifikuar të gjitha masat, metodat dhe mjetet për “qetësimin” e këtij komuniteti dhe, e dyta, më pak e hetushme por po aq e rrezikshme sa e para: t'i dëmtojë maksimalisht burimet financiare të Institucionit, sidomos duke ia zhvatur vakëfin, përmes kyçjes së bashkëpunëtorëve të

tyre në hierarkinë udhëheqëse të Institucionit të BFI-së!

BFI-ja nuk është satelit më vete që sillet e lëvizë në hapësirën e kosmosit si t'i dojë qejfi asaj! BFI-ja është Institucion që funksionon në kuadër të një shteti, i cili ka ligje, ka akte normative para të cilëve nënshtrohen gjithkush e gjithçka! Shteti brenda BFI-së është i domosdoshëm, është i patjetërsueshëm, i detyrueshëm me qëllim që të ruhet pesha, funksioni, roli i këtij Institucioni në funksion të mirëqenies, paqes dhe harmonisë ndërkonfesionale. Shteti nuk duhet ta kundrojë BFI-në vetëm si vend potencial për lulzim të korrupsionit, kriminalitetit, ekstremizmit, bashkëpunimit me shërbime intelegjente, si vend ideal për zhvatje! Shteti nuk duhet të jetë në BFI vetëm sa për të konstatuar se paskan ndodhur një mori dukurishë antiligjore dhe sa për të qarë pastaj hall me ndërkombëtarët se me çfarë “miletit” jemi duke bashkëjetuar! Një BFI e destabilizuar është pasqyrë e shtetit të korruptuar deri në palcë! Shteti në BFI duhet të jetë garanca më e fuqishme se aty nuk do të tolerohet asnjë hap që nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe me aktet normative të BFI-së, sepse që të gjitha janë të deponuara në organet e drejtësisë për të dëshmuar se janë në harmoni me aktet normative dhe me Kushtetutën e Shtetit. Çdo devijim i të gjitha strukturave të BFI-së nga aktet e veta normative praktikisht duhet të trajtohen si shkelje e akteve normative të Shtetit! Ky duhet të jetë misioni i shtetit brenda organizatave fetare dhe jo vetëm konstatimi institucional i problemeve dhe distancimi prej tyre, duke manipuluar me “konstatimin” se, shteti duhet të jetë larg “komuniteteve fetare” si institucione!

## **Shteti në raport me BFI-në dikur dhe sot**

Edhe në kohërat më barbare për myslimanët e vendit, ka qenë më mirë për sa i përket raportit shtet-pushtet-institucion fetar!

Le ta marrim për shembull, periudhën e Mbretërisë SKS, konkretisht, më 8 dhjetor të vitit 1923 formohet Ministria për fe dhe, praktikisht, ingerencat që i ushtronte Ministria e drejtësisë mbi fetë e asaj kohe, do t'i kalojnë Ministrisë për fe, e cila, konkretisht, për organizimin e jetës fetare islame do t'i kishte këto kompetenca:

- Miratimin e vendimit për zgjedhjen e reisul-ulemasë, Ulema mexhlisin, muftinjtë, personelin dhe arsimtarët e shkollave të drejtësisë-sheriatit dhe të gjimnazeve të sheriatit.

(Me këtë akt, praktikisht mposhtej çdo përpjekje për nepotizëm, për amatorizëm, për korrupsion dhe për zgjedhje të organeve të Institucionit dhe organeve fetare kujt si t'i teket, jashtë ligjeve të kohës!)

- Miratim dhe lejim të konkluzioneve nga këshilli i vakëfit-mearifit mbi ndryshimin e rregullave dhe mbi ato ekzistueset për sa i përket disiplinës dhe pensionimit të nëpunësve të vakëfit-mearifit.

(Pra, nuk guxon që të funksionojë një Institucion ku shkilen natë e ditë parimet, rregullat dhe disiplina, si dhe nuk mund të ketë në një institucion fetar nëpunës të përjetshëm!)

- Miratim dhe lejim të konkluzivoneve të Kuvendit të Vakëfit-Mearifit, mbi nivelin e arsimimit fetar dhe ngritjes së shkollave, institucioneve arsimore si dhe të enteve humanitare, si dhe planin arsimor për mësimet fetare për shkollat e vakëfit-mearifit. (Në BFI-në aktuale janë të tmerrshme, deri diku edhe antifetare dhe antikombëtare, politikat arsimore të cilat, fatkeqësisht, kanë ngelur në duart e diletantëve dhe sharllatanëve të cilët nuk i njohin perspektivat ndërsa të sotmen nuk e kanë të qartë.)

- Miratimi dhe lejimi i vendimeve për të themeluar vakëf të ri!

(Pra, nuk bëhet fjalë për tëhuajësim, as për shitje, as për falje e as korrupsion për disa organe të shtetit. Thjesht, lejohen vetëm ato vendime që e shtojnë vakëfin! Çka po ndodh me vakëfin e BFI-së

në ditët e sotme kur shteti zgjohet dhe futet në Institucion vetëm kur është në pyetje zhvatja e vakëfit! A di dikush të na shpjegojë se çka po ndodhë në vakëfin, oborrin e dikurshëm të “Komunalecit”?

- Anulimi i të gjitha atyre vendimeve autonome të pushtetit qendror fetar që janë në kundërshtim me ligjet shtetërore.

(Shteti i Maqedonisë së Veriut, e ka pranuar dhe e ka verifikuar Kushtetutën e BFI-së dhe ka konkluduar se ajo është konform Kushtetutës dhe ligjeve të shtetit! Të vepruarit jashtë Kushtetutës së BFI-së dhe shkelja e shumë akteve normative të këtij Institucioni, a nuk është shkelje edhe të atyre akteve normative shtetërore me të cilat është e harmonizuar Kushtetuta e BFI-së?!)

### **Për shërbimet inteligjente: Shaqir Fetai nuk është zgjidhje por problem i BFI-së**

Shaqir Fetai, i cili në çdo sekond të ditës është duke e shkelur Kushtetutën e BFI-së, a nuk është kjo përkrahje dhe mbështetje nga shteti, nga organet përkatëse shtetërore të Maqedonisë së Veriut? Janë me dhjetra shkelje drastike që Shaqir Fetai i ka bërë krye më vete, i mbështetur nga ata organe shtetërore të cilat me dy këmbë janë të zhytur në korrupsion e zhvatje të BFI-së.

Myslmanëve të vendit nuk u duhen “organe fetare” të kapur apo lojalistë, të kriminalizuar apo të shantazhuar nga shteti. Myslimanët e Maqedonisë së Veriut me këtë qëndrim anti-Shaqir Fetai vetëm sa po dëshmojnë se janë digë e fuqishme që do ta pengojnë rrjedhën e lojës së shtetit në drejtim të shkatërrimit të BFI-së dhe të paraqitjes së tyre si element destabilizues dhe anticivilizues.

Shaqir Fetai nuk është zgjidhje! Shaqir Fetai është problem i BFI-së! Ai është bashkëpjesëmarrës në kriminalizimin e BFI-së, ai është miratues i të gjitha vendimeve në BFI që mund t’i gëzojnë vetëm shërbimet inteligjente të huaja. Shaqir Fetai mund të jetë i përgëdheluri i shtetit, por kurrë i dashuri i popullit, madje aq më pak si “Shqiponjë”!

*(Almakos, 26.10.2020)*

## Keqpëdorimi kriminal i pozitës imagjinare

**(Rreth botimit të një shkrimi që ka të bëjë mbi librin e djalit të Shaqir Fetait, e që botohet në faqen zyrtare të BFI-së të cilën e ka uzurpuar, si kusar, Shaqir Fetai. Kush i kryen këto vepra parakriminale nëse jo një individ me prirje despotike duke u mbështetur në forcat e sgrimit intelektual)**

**Nga Andi Rakipi, Tiranë**

Nëse merret parasysh karakteri i Shaqir Fetait, nëse merret parasysh veprimtaria e tmerrshme e Shaqir Fetait, në njërin anë dhe, në anën tjetër, nëse merret parasysh edhe ëndërra e një të riu për të avancuar në jetë, nëse merret parasysh i biri i Shaqir Fetait dhe titulli i temës me të cilën si duket paska magjistruar, atëherë, do të nxirret në sipërfaqe kompleksi i tmerrshëm i Shaqir Fetait. Ai e djeg të birin, ai e hedh në flakë, ai e lë cullak në breg, siç i lë këlyshët e vet dhelpra, vetëm e vetëm të maskohet edhe më tej veprimtaria e tij kriminale në kuadër të BFI-së.

Magjistër Sami Fetait i urojmë suksese dhe, ndiesi neutrale për sa i përket veprimtarisë së babait të vet, qoftë si shejtan-hoxhë qoftë si udbash! Fundja, djali nuk ka faj dhe nuk mbanë përgjegjësi për veprat e babait, qofshin ato edhe kriminale!

Ëndërr e Shaqir Fetait paska qenë që ta kapë për gushe BFI-në ndërsa në ndërkohë të publikohet një “punim shkencor”, i cili do të flasë për “rolin dhe suksesin e BFI-së në luftimin e kriminalitetit”, edhe pse do ta organizojë shkarkimin e Sulejman Rexhepit të cilit plotë 28 vite i shërbeu në emër të fesë. Shaqir Fetai nuk ia do të mirën të birin! Nuk e ka mësuar si duhet të bëjë dallimin në mes fesë dhe religjionit. Nuk ka religjion islam, ka Fe Islame! Fetë janë të shpallura prej Zotit, religjionet janë “të shpallura” prej njerëzve (filozofë, sektarë, manipulantë etj.) Është dashur ta mësojë djalin dhe të kërkojë që të debatojë me mentorët e tij që të kuptojnë edhe ata dallueshmërinë.

Shaqir Fetai, duke u nisur nga prirja udbashe, nuk e kupton se Feja nuk parandalon, por, aktin e keq e ka bërë haram, ndërsa instrumentat e shtetit janë ato që parandalojnë, të keqen, krimin dhe, tërë atë që në fe është haram! Ka të drejtë kur profsori ia tërheq vërejtjen tërthorazi “reis” dudukit (Shaqir Fetait) kur nënvizon se kjo temë magjistrature, si botim duhet të ketë këtë titull “Ndikimi i religjionit në parandalimin e kriminalitetit”, sepse erifi fletë me logjikën e shkencës dhe jo të UDB-së siç flet Shaqir Fetai.

Ndërkaq, propozimi i profesorit dhe i komisionit për ta botuar, meqë do t’u shërbejë gjeneratave të reja, themi që ia paskan futur kot! Po, mund të jetë literaturë deficitare sikur mos ta kishte të inkuorporuar kapitullin e pestë që trajton këto tema: “Mekanizmat e parandalimit të kriminalitetit, me theks të veçantë në rolin e BFI në vend, edhe atë: Bashkësia Islame në R.M.V. dhe lufta kundër kriminalitetit; Bashkësia Islame, institucion kompetent i jetës fetare në R.M.V.; Bashkësia Islame, shpjegues i vërtetë në front kundër sektarizmit dhe ekstremizmit në vend dhe jashtë vendit; Aspekti penalo- juridik në R.M.V. dhe qëndrimi i Bashkësisë Fetare Islame kundrejt pjesëmarrjes në luftërat e huaja. Në fund, në mbyllje, autori në mënyrë perfekte argumenton rolin e Bashkësisë Fetare Islame në R.M.V. në parandalimin, luftimin dhe çrrënjosjen e çdo forme të kriminalitetit që e rrethon shoqërinë tonë!”

Në mënyrë perfekte? Cila është ajo mënyrë? Ashtu siç ia ka shpjeguar babai i keq fëmijës së mirë? Pa këtë kapitull do të ishte më në rregull, sepse, këtë kapitull e përlligjin gjashtë tituj të tjerë të cilët u botuan muaj më para se të magjistronte i biri i udbashit! Gjashtë vëllime shkrimesh që flasin pikërisht për krimet dhe kriminalizimin e BFI-së prej tipave si Shaqir Fetai i cili, pikërisht për këto krime, duke u munduar që ta amnistojë veten nga faji që lahet vetëm me burg, organizoi shkarkimin e “babait të vet shpirtëror” nga froni prej nga ka bërë kërdrinë në kriminalitet. Si atëherë një institucion i kriminalizuar deri në gushë paska pasur mundësi që ta luftojë krimin dhe format e krimit! Po të ishte kështu, atëherë, pa dyshim e me keqardhje do të themi, i biri i Shaqës do të magjistronte jo në prezencë të babait të vet, i cili do të dergjej burgjeve! Por, le të supozojmë se paska ndodhur kështu, se edhe BFI-ja paska luftuar format e kriminalitetit! A nuk është krim mbi krimet të jeshë spiun, bashkëpunëtorë i UDB-së? Nëse për shumë persona në BFI ka pasur hamendësime se kanë qenë udbashë e bashkëpunëtorë të shërbimeve të ndryshme intelektuale, ky hamendesim bie posht për Shaqir Fetain, sepse tashmë për të shumë portale kombëtare botuan dokumentin! Plotë 28 vite udbashi brenda BFI-së kurse “profesori” nënvizon: “autori në mënyrë perfekte argumenton rolin e Bashkësisë Fetare Islame në R.M.V. në parandalimin, luftimin dhe çrrënjosjen e çdo forme të kriminalitetit që e rrethon shoqërinë tonë”!!!

Kujdes akademikë, mos i kompleksoni gjeneratat që po vijnë, mos bini nën influencën e një dreke apo të një darke të një udbashi që ju shpërfytyrohet në “engjell”! Mos nxirrni “vepra shkencore” me fakte të pavërteta. Në rastin konkret keni ndihmuar një pseudovepër e cila, me një kujdes më profesional nga ana e juaj do të mund të kishte dalur një vepër relativisht e mirë!

Një formë e krimit është edhe keqpërdorimi i “pozitës zyrtare”, keqpërdorimi i faqes zyrtare të BFI-së për suksese private familjare. Këtë keqpërdorim, pa dyshim, e lufton Feja Islame, mbase jo edhe religjioni i Shaqir Fetait! Allahu alem!

*(1Kliklart, 27.10.2020)*

## Një manipulim i paralajmëruar apo një pseudointervistë me matrapazin

(Dy fjalë rreth intervistës së paralajmëruar në ZHURNAL me mbititull “Fetahu flet ekskluzivisht për Zhurnal”, kurse të botuar sot, më 29 shtator 2020, me mbititull e titull: “Intervistë ekskluzive, u.d Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu: Uniteti duhet ruajtur si sytë e ballit”)

A ka më turp për një njeri serioz se sa të bëjë përpjekje të manipulojë jo vetëm mediat por edhe opinionin e gjërë! Se si e ka futur në lojë Agjencinë ZHURNAL këtë mund ta dinë vetëm të redaksisë, e cila mbase ka pasur qëllimin më të mirë për të hedhur dritë mbi një terr e mankth që po mbisundon në BFI tash e pesë muaj. Zhurnal, pa i ditë matrapazllëqet e Shaqir Fetait shkon dhe e paralajmëron intervistën si “ekskluzive për Zhurnal”! Do me thënë kemi të bëjmë me një manipulim të paralajmëruar si dhe me një matrapaz i cili fabrikon vetëm një frazë që ka arritur ta formatojë në fabrikatin e vet tashmë demode.

Si guxon Shaqir Fetai t’i premtojë një agjencie mediash se do t’i japë intervistë ekskluzive, ndërsa të njëjtën, ama bash të njëjtën, që nga titulli e deri në fund (hiq pjesën ku mundohet të na dëshmojë se nuk paska qenë spiun, madje në stilin e kalamajve: pasha Tome Axhievin nuk kam qenë!).

Shaqir Fetai, duke u nisur nga logjika se, kur opinionin i ha llokumat, pse mos ta hajë llokumin edhe Zhurnal, ia ofron për botim të njëjtën intervistë që e kishte botuar në revistën e BFI-së “Hëna e Re”, e të postuar edhe në FB-un e faqes zyrtare të BFI- së, më datën 12 gusht 2020.) Shaqir Fetai ia ka borxh një kërkim falje redaksisë së Zhurnali dhe, t’iu garantojë të gjithë mediave të vendit se nuk do të tallet më me esnafët e gazetarisë. Sepse, kjo është hera e dytë që ai tallet kaq keq. Herën e parë i thërret për t’ju thënë diçka ekskluzive kurse i ftonë të futen në sallë e të hanë bakllava, dhe, herën e dytë, tani, ia premtton ZHURNALIT intervistën e botuar këtu e një muaj e gjysëm më parë.

Ku është këtu ekskluziviteti! Çka tha diçka të re Shaqir Fetai? Apo, tërë hallin e kishte pasur që të tregojë se kurrë nuk ka qenë spiun! Po dokumenti? Sipas Shaqir Fetait na qenka e sajuar nga nëntoka e njëjtë që u munduan ta zbërthejnë si spiun Shaqir Fetain që më vitin 2013!

Ekspertët dhe njohësit e mirë të shërbimeve inteligjente thonë se, këto shërbime lëshojnë isharete sa për ta komprometuar spiunin “e bllombuar” nëse ai nis e mundohet të pavarësohet pa leje prej shërbimeve apo, nëse nuk e kryen ndonjë punë që ia kërkojnë. Botimi, qarkullimi, lëshimi “tinza” i dokumenteve nga dosjet policore është vetëm shantazh i vetë shërbimeve. Mund të jetë edhe tërheqje e vërejtjes nga ana e shërbimeve sa për të t’ia bërë me dije se ata të sollën në pozitë ata mund të të zhdakin! Sa i përket asaj se Tome Axhievi paska pas thënë se Shaqir Fetai nuk është spiun, është një përpjekje qyqare, një përpjekje si e skrranjës nëpër lluc që të dalë pak në breg e të thahet! Të gjithë ata që i shpalli Tome Axhievi spiunë, tashmë e kanë fituar pafajësinë nga Gjyqi i Strasburgut. Tome Axhievi ka pasur mision që t’i shpallë spiunë vetëm ata të cilët e kanë penguar sistemin e Nikolla Gruevskit, kurse ata që kanë qenë në rregull me atë sistem, i ka shpallur të pafajshëm!

Shaqir Fetai duhet të dijë edhe një gjë: spiunët që edhe më tej janë aktivë, nuk dekodohen, sepse bie tërë sistemi! Ndërsa mund të dekodohen vetëm ata që tashmë janë të “arkivuar”! Edhe diçka: të mundohesh e të kërkoshë ndihmë nga Tome Axhievi, të mbështetesh në një deklaratë të tij që e paska thënë në Dnevnik e në Kanal5, është më rënd e më keq se sa me ta ngulë...!

Kush i zë besë përpjekjeve të Shaqir Fetait për ta thënë të vërtetën pas manipulimit publik që ia



bëri Zhurnalit! E ka bërë edhe shumë herë! Kolegët e tij e mbajnë mend për gënjeshtar të paciptë, e mbajnë mend për tradhëtarë, e mbajnë mend për hajn, e mbajnë mend për sahanëlëpirës e puthadorë. E mbajnë mend për thurrës brilant të lavdeve kushtuar Sulejman Rexhepit, të cilin gjithmonë e ka quajtur, si i magjepsur, “kjo figurë markante”. Dhe, tani na paska diçka ekskluzive? E manipulon Zhurnalin sa për t’ia dhënë ekskluzivitetin e Tome Axhievit i cili na paska thënë se “tendencat e këtilla mbi Shaqir Fetain janë “spekulime të rrugëve”.

Mbase edhe është “për t’i besuar” Tome Axhievit por, jo edhe Shaqir Fetait!

Për fund, edhe një herë: Ose Shaqir Fetai të dalë e t’i kërkojë falje publike Zhurnalit për këtë manipulim që ia bëri, ose Zhurnali duhet të dalë e t’i kërkojë falje publike oponionit të gjërë që ia premtojë një intervistë ekskluzive me manipuluesin Shaqir Fetait!

Në ditën e ardhshme do të botohen shkrimet që u morën me përgjigjet veç e veç të Shaqir Fetait në intervistën e botuar në Revistën “Hëna e Re”, të cilën me truqe idiotike dhe duke e shkelur në besë gazetarin dhe botuesin e Zhurnal, e riboton edhe një herë ! Edhe një herë le të shihet botërisht se me çfarë rrencaku kemi të bëjmë!

*(1Kliklarg, 29.10.2020)*

## Shaqir Fetai përfundimisht u bind se po bojkotohet fuqishëm

Xhemati dëshiron të dëgjojë vaze e ligjerata nga imamët e vet e jo nga “bilbili i Temelko Boshkovskit”! Xhemati kërkon që të kënaqet me shpjegimet e hoxhës së vet mbi rolin dhe veprat e papërsëritshme, deri në Ditën e Kijametit, të të Dërguarit të Allahut xh.sh. Muhamedit a.s., dhe refuzon që të dëgjojë pallavra të hipokritëve të sojit të Shaqir Fetait

### Nga Haxhi Isa Xhaviti

Është bërë tashmë traditë që në Shkup të organizohet një event madhështor me rastin e Ditës së Lindjes së Vulës së Pejgamberisë, Muhamedit a.s. Sivjet, ky manifestim, fatkeqësisht u “organizua” nën kushte të një pandemie që ka kapluar tërë botën, Covidi 19!

Në Shkup u organizua në Xhaminë e Çairit që ka kapacitet për një numër të konsiderueshëm të xhematit! U mbajt menjëherë pas namazit të drekës. Xhemat i shumtë e fali drekën dhe, sapo e panë Shaqir Fetain tek futet në Xhami, sikur paraprakisht ta kishin vendosur, unanimisht e bojkotuan. Pas namazit, me keqardhje në shpirt u larguan nga manifestimi, sepse nuk pranonin që të dëgjojnë pallavra nga hipokritët! Të flasë Shaqir Fetai për të Dërguarin e Allahut xh.sh., Muhamedin a.s.?

Shaqir Fetai ngeli në xhami me një numër hafëzlerësh të rinjë që u pajisën me diplomën e hifzitet, me prindërit dhe të afërmit e tyre, me disa mysafirë, dhe krejt këta përbënin xhemat në numër deri prej 50-60 veta.

Në në të njëjtën mënyrë, të dezorganizuar skajshmërisht, pa kurrfarë koncepti e respekti për Ditën e Shenjtë të myslimanëve, për xhuma, kishin organizuar edhe në Gostivar, ku ky event mbahet për 17 vite me radhë. Atmosferë më e zyrtë e më e shkretë kurrë nuk ka qenë! Manifestimi u mbajt në Xhaminë e Kadrit. Edhe në këtë xhami, edhe në këtë ditë të xhuma, në event numri i pjesëmarrësve ishte tepër i vogël, si asnjëherë më parë. Këtë më së miri e ilustron edhe vetë fotografite nga këta evente. Shaqir Fetai mendon se ky event duhet të mbahet ekskluzivisht sa për të folur vetë ai si hajn i reisllëkut. E shfrytëzon këtë event për t’u matur me një prej imamëve të dikurshëm të Xhamisë së Jahja Pashës, Sulejman Rexhepi, të cilit i shërbeu një jetë të tërë dhe në fund ia nguli thiken pas shpinës; e shfrytëzoi këtë event sa për t’u “promovuar” si “i mirënjohur në Shkup për oratorinë e tij, ligjërimet e tija të thella dhe unikale, që nga koha kur shërbente në xhaminë e Jahja Pashës”! Ligjërimet të thella dhe unikale janë vetëm ato të Pejgamberit a.s. kurse të Shaqir Fetait janë kopalla me të cilat mundohet ta kamuflojë veten nga të qenurit bashkëpunëtorë i Temelko Boshkovskit. Tani, a ka më ofendim se sa njeriu i Boshkovskit të flasë për rëndësinë e Pejgamberit tonë, madje me një “ligjeratë unikale”! Unikal mund të ketë qenë vetëm në “këndimet bilbilore” nëpër zyret e Boshkovskit.

Prandaj, të enjten dhe të premten, u bojkotua masovikisht nga xhemati i vendit, sado që këtë mundohet ta justifikojë për shkak të koronavirusit. Koronavirus pati edhe kur u fal dreka e të enjtes si dhe namazi i xhumasë, të cilat namaze ishin përplot me xhemat, të cilët ikën sapo e dëgjuan zërin e “Orao-s”! Xhemati dëshiron të dëgjojë vaze e ligjerata nga imamët e vet e jo nga “bilbili i Boshkovskit”! Xhemati kërkon që të kënaqet me shpjegimet e hoxhës së vet mbi rolin dhe veprat e papërsëritshme, deri në Ditën e Kijametit, të të Dërguarit të Allahut xh.sh. Muhamedit a.s., dhe refuzon që të dëgjojë pallavra të hipokritëve të sojit të Shaqir Fetait.

*(1Kliklarg, 31.10.2020)*

## Demagogjia e Shaqir Fetait

**Demagogu në mesin e njerëzve i thyen kufinj të përshkrimit fiktiv të personazhit të zi nga e keqja, siç mund të jetë shejtani. Pra, në një farë forme, demagogu është vetë shejtani me pamje njeriu. I tillë ishte Shaqir Fetai përgjatë tërë një interviste dhënë disa javë më parë në MTV2 dhe publikuar vetëm këto ditë në faqen zyrtare të BFI-së**

**Nga Haxhi Isa Xhaviti**

Është bërë e padurueshme demagogjia e Shaqir Fetait, për më tepër pasi që i thotë vetes teolog, hoxhë, klerik. Kohë më parë, në MTV2, në emisionin OPEN, kishte dhënë një intervistë e cila ishte fund e krye demagogjike, përpjekje e paskrupullt e Shaqir Fetait për të gënjer, për të trilluar, për të qenë jashtë çdo kornize ligjore dhe përgjegjësie institucionale. Thjesht, fliste si dikur bashkëpunëtorët e shërbimit sekret, të cilët që në fillimet e para të bashkëpunimit mësohen për tri gjëra themelore: të zbukurojnë të shëmtuarën, të gënjejnë në opinion dhe, në pyetjet e drejtëpërdrejta të jenë sa më të tërthortë, duke llogotitur sa më shumë e për të mos thënë asgjë. Praktikisht, ky element spiunesk e ndiqte Shaqir Fetain përgjatë tërë intervistës.

Çka është demagogjia? Demagogji do të thotë mashtrim i masave të gjëra, duke i joshur me fjalë të bukura, e me premtime të rreme për t'i bërë për vete për qëllime e synime të caktuara nga punëdhënësi i vërtetë i demagogut.

A i ka hije demagogjia Shaqir Fetait? Demagogjia është ekskluzivisht sifet i shejtanit! Nëse opinioni do të ketë durim për ta përcjellë intervistën e Shaqir Fetait dhënë emisionit OPEN, sakaq do të konkludojë se para syve të vet, të mbërthyer brenda ekranit, e ka vetë Iblisin. Gazetarja, për çdo lavdatë, u mundua që të prekë ato tema me interes për publikun e gjërë, kurse Shaqir Fetai, u mundua që ta manipulojë gazetaren dhe opinionin e vendit, duke e bartur nëpër valët e përgjigjeve të djallëzuara, vetëm e vetëm për t'i dhënë bashkëbisedimit një orientim “paqësor” dhe plotë lavdërata.

Që nga përpjekjet monstruoze të Shaqir Fetait për ta bërë fakt të kryer “kreun e BFI”, përmes urimeve dhe “përkrahjeve” që i paskan ardhur e deri te përpjekjet e tij të djallëzuara për t'i përvetësuar idetë, angazhimet konkrete kombëtare e fetare, propozimet, vizionet dhe Platformën e Lëvizjes për Reforma në BFI, Shaqir Fetai na del një demagog i kulluar, një plagjiat e kompilator, një urith i nëntokës e një mi gjirizi, që e përlligj çdo model të devotshmërisë. Shaqir Fetai le të tregojë se si i gënjeu ndërkombëtarët nga bota arabe se kinse u zgjodh “kryetar i BFI”, pas së cilës rrenë pasuan edhe urimet e disa nga faktorët relevant të botës islame. Pasi u sqaruan nga ana e Lëvizjes për Reforma në BFI, që të gjithë faktorët nga bota islamo-arabe, kanë ngelur të zhgënjyer nga kjo hipokrizi e një mashtruesi të paskrupullt që dëshiron të bëhet “kreu i BFI”.

Le të tregojë Shaqir Fetai se si i besditi, si kreun e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë ashtu edhe kreun e Bashkësisë Islame të Kosovës, duke i lutur me dhjetra herë që t'ia nisin ndonjë urim përkrahje. Skuth e shkuar skuthit!

Në vazhdim gjithësesi që do ta analizojmë dhe do ta komentojmë në hollësi dhe gjërësisht intervistën,

sa për t'ia bërë me dije Shaqir Fetait se, ai nuk është duke jetuar më në kohën e punëdhënësve të tij si student, kur detyrë parësore e kishte nuhatjen dhe gjuajtjen e nacionalizmit shqiptar e boshnjak. Shaqir Fetai duhet të dalë nga lëvozhga e demagogjisë dhe të tregojë se kush e futi, si u fut, dhe cili është misioni i tij në tërë këtë lojë. Pa dyshim, misioni i tij mund të jetë i i gjithëçfarshëm, por aspak mision islamik. Ndaj Shaqir Fetai duhet të ikë sa më parë, sepse na ka ngelur për faqe të zezë dhe, me tërë të zezat e tij mundohet të na shesë moral e islam. Me demagogji? Me sifate të Iblisit? Kurrë!

*(1Kliklart, 6.11.2020)*

## A mund të shembëllejë në engjëll Shaqir Fetai i djallëzuar

**(Shaqir Fetai, që kur i futi në një aksion puçist miqtë e vet dhe pastaj i përbuzi duke i anashkaluar që të gjithë për shkak të oreksit djallëzor për t'u bërë “kreu i BFI-së”, e deri më sot, i ka dhënë vetëm dy intervista, me ç'rast ka dëshmuar se është ekspert i mësimit përmendësh të gënjeshtreve. Nuk thotë asgjë të re, e reja kërkon mendim, vizion, shkencë. Shaqir Fetai ia vlenë vetëm për gënjeshtër dhe për aktrim të devotshmërisë)**

**Nga dr. Zeqie Veseli, Vjenë**

MTV2, në emisionin “Open” kishte zhvilluar një intervistë me Shaqir Fetain, i cili, ndonëse u kishte premtuar ekskluzivitet dhe shpalosje të shumë gjërave, për fat të keq, i kishte gënjyer, zhgënjyer dhe mërziur së tepërmi me stilin e tij prej bashkëpunëtori të UDB-së. Dhe ky pastaj pretendon të bëhet reis? E ka seriozisht apo është premtim i shërbimeve policore që u shërbeu një jetë të tërë. E ka kot? I iku mosha, plus që truri i tij ka ngecur në kohën e bashkëpunëtorit të zellshëm të UDB-së.

Që në fillim, edhe gazetarja, duke qenë se i është premtuar, emisionin e fillon duke paralajmëruar se do të preken shumë çështje me interes për opinionin e gjërë, duke filluar që nga arsyetimi i largimit të Sulejman Rexhepit, e deri te zgjedhja e kryetarit të ardhshëm të BFI-së.

Shaqir Fetai e keqpërdorë hapësirën televizive për t'u vetëpromovuar si “reis” për ç'gjë e ka premtim nga UDB dhe, pikë! Ai madje edhe gënjenë kur thotë se tashmë është sqaruar çështja e largimit të Sulejman Rexhepit përmes dy “konferencave”, duke ua dhënë madje peshën e konferencave shkencore. A është normal ky farë spiuni apo mendon se opinionin që e ndjek nuk është normal dhe si i tillë nuk do të kuptojë se çka pallamudë Shaqir Fetai?!

Shaqir Fetai thotë se sa i përket kohëzgjatjes së funksionimit të tij si ushtrues detyre nuk e precizon Kushtetuta e BFI-së ndaj ai mund ta ushtrojë këtë “post” deri në infinit, edhe pse ai edhe për dy vite duhet të shkojë në pension.

Po le të na thotë Shaqir Fetai se në cilin nen, në cilën aline, në cilën faqe, në cilën fjali të Kushtetutës së BFI-së, madje në cilën akt normativ të BFI-së është paraparë posti “ushtrues detyre” i kryetarit të BFI-së! Kur bota e mbarë islame e kuptoi se çfarë loje të djallëzuar kishte luajtur Shaqir Fetai dhe në çfarë gafe i kishte futur, tashmë janë në gjendje ta përdorin vetëm si lolo të shërbimeve të tyre dhe si “mysafir” me ndonjë mision special. Të gjithë tashmë janë të bindur se Shaqir Fetai është i përshtatshëm vetëm për lolo, figura e të cilit shumë shpejt bajatoset.

Faktori relevant ndërkombëtar në Maqedoninë e Veriut e kuptoi shumë shpejt djallëzinë e Shaqir Fetait dhe, me prononcimet e tij shterpe, vetëm sa po e vërteton se është tej mase i keq ndaj dhe e kanë marginalizuar tërësisht. Madje, së fundmi, u mundua që ta keqpërdorë edhe tragjedinë e shkaktuar nga akti terrorist që u shkaktua këto ditë në Vjenë, dhe të imponohet si palë me ndërkombëtarët në rrafshin e luftimit të terrorizmit, por që në praktikë është dëshmuar shume i ligë.

Shaqir Fetai thotë si i mjerë se bota i paska dhëne përkrahje duke e uruar dhe duke e pranuar. Por, për çka e paska uruar? Në çka e përkrahin? Njeriu urohet, në rastin konkret, kur të zgjidhet një

person për kryetar pas një fushate të suksesshme, pas shume debateve e prononcimeve në media, pas shumë takimeve me opinion e me organe, pas një gare ligjore, legale e legjitime! E ka kaluar këtë proces Shaqir Fetai? Si nuk i vjen turp ta gënjejë opinionin dhe faktorët me relevancë në vend! Cili faktor, cila strukturë, cili shtet, cili individ e cila organizatë mund ta urojë e ta përkrahë Shaqir Fetain përveçse terroristëve, puçistëve, dhe “revolucionaristëve” që e synojnë kapjen e pushtetit me gjak apo me korrupsion! Prandaj Shaqir Fetai duhet të kuptojë se është tërësisht i marginalizuar dhe shumë i dëmshëm për islam, për shqiptarët dhe përgjithësisht për BFI-në.

Ky farë loloje mendon se është shpëtimtarë i BFI-së dhe me ardhjen e tij si “kreu i BFI-së” paska filluar lulëzimi i këtij Institucioni, e paskan pranuar shumë organizata islamo-arabe! Po nuk tregon se ku ishte më parë ky Institucion? Pse na paska qenë i bllokuar? Pse na paska qenë i dyshimtë për botën arabo-islame? Po në cilin moment ai e ka qortuar Sulejman Rexhepin, kur nuk ka thurrur elozhe për të dhe, në cilin moment është distancuar për këto 18 vite si anetar Rijaseti? KURRË!

Shaqir Fetai na rrëfen se paska një ftesë, por nga kush nuk tregon, për ta vizituar Arabinë Saudite! Megjithatë, këtij farë zotëriu problem i paraqet Covind 19, prandaj paska në plan që njëherë të kalojë kjo pandemi e pastaj ta vizitoje Arabinë! Po nese kjo pandemi zgjatë edhe nja dy-tri vjet? Në çfarë cilësie do ta vizitojë? Ky është i pacipë, prandaj të gjithë po ikin prej tij, madje më shumë se nga vetë Kovidi 19.

“Po ashtu kemi njohje dhe urime nga Shejhul Ah’zari”, thotë ky matrapaz që mundohet të manipulojë dhe të tallet me opinionin e vendit! Për çfarë njohje flet ky fare psikopati kur arkivi i BFI-së vërteton se nga ky Universitet i Egjiptit për dy-tre dekada janë shkolluar studentë myslimanë nga Maqedonia e Veriut, si bursistë të Universitetit, falë bashkëpunimit permanent të Az’harit me BFI-në.

Çuditërisht, Shaqir Fetai, pa pikë gjaku në shpirt, por i vetëdihëm shumë për mbrapshtinë që i ka bërë në jetë, mundohet të citojë një ajet kuranor që thërret në ndihmë kah e mbara dhe e mira dhe në ndalim nga e keqja. Po vetë Shaqir Fetai që, që nga bota studentore e deri me ditët e sotme që ka vepruar dhe që e ndihmon të keqen? Mendon se do t’i pritojmë që t’ia numërojmë të gjitha padrejtësitë që i ka bërë ndaj njeriut, ndaj islamit, ndaj Institucionit dhe ndaj myslimanëve në vend e më gjërë?! Listimi i ketyre veprave të tij djallëzore do të ishte kilometrike.

Kur Shaqir demagogu pyetet konkretisht se kur do të fillojnë reformat dhe kur do të shkohet në zgjedhje të kryetarit të ri të BFI-së, ai hidhet si zevzek, duke u përgjigjur se reformat po kërkuan kohë të gjatë dhe se për momentin e paska “reformuar administratën e BFI”-së! Këtu Shaqir Fetai e dëshmon sharlantantizmin e tij, e dëshmon idiotizmin dhe budallallëkun me birër! Cila është administrata e BFI? Çka paska reformuar në administratë. Cili është koncepti i tij për reformat në administratë? Kush e bën reformimin e administratës nëse jo i pari i administratës i zgjedhur në mënyre legale dhe legjitime? Pastaj, mendon ky që kryetari që do të zgjidhet do të vazhdojë me “administratën e reformuar të Shaqirit”? Ky po që na del fare abdall!

Po kur flet për planet e tij për të themeluar institucione në kuadër të BFI-së, sidomos për arkivin që do ta regullojë vetë ai siç e paralajmëron nga fiks ideja e tij e budallakaftë. Ai do që mos të lë gjurmë të veta kriminale në arkivin që do ta themelojë! Mendon se në atë arkiv do të mungojë dokumenti i tij policor me nofkën “ORAO” dhe këtu do mbyllet filmi? Epo tepër shumë paska qenë abdall e shkuar abdallit. Thotë pse mos të kemi një bibliotekë në metropolin e Shkupit, ndërsa kjo bibliotekë ekziston, me emrin Biblioteka “Isa Beu”, e cila, me votimin dhe miratimin e Shaqir Fetait është dislokuar nga Çarshia e Shkupit në objektin e FSHI në Kondovë! Kjo dëshmon se Shaqir Fetai, edhe kur ka qenë Myfti, edhe kur ka qenë krah i djathtë i Sulejman Rexhepit, b... nuk i ka hëngër as për BFI e as për jetën institucionale fetaro-islame. Shaqir Fetai flet se paska një “platformë” në të cilën e paska paraparë të ketë edhe një shtypshkronjë. E di ky fare bilmezi se çka do me thënë shtypshkronjë! E di ky farë shutraku se me çfarë kapaciteti do të ishte rentabël kjo veprimtari? A e di se sa tituj ka

botuar BFI që kur Shaqir Fetai është myfti i Gostivarit! A e di Shaqir Fetai se ku do ta blinte letrën, ngjyrat, ku do ta siguronte kuadrin për ta drejtuar këtë veprimtari? Cila do të ishte dobia financiare nga kjo veprimtari për BFI-në? Punë abdalli pra!

Shaqir Fetai ose manipulon ose demonstroi injorancën e vet kur thotë “kemi pesë medrese”! Tërë bota e di se në Maqedoni funksionon vetëm një Medrese (“Isa Beu”) e cila mbase i ka pesë paralele të dispersuara nëpër qendra të ndryshme!

Shaqir Fetai e paska kuptuar se BFI qenka institucion shumë i madh, me peshë shumë të rëndësishme, prej momentit kur kolegët ia paskan dhënë këtë detyrë. E para, kolegët i kanë dhënë detyrë që ta kryej në afat ligjor procesin e zgjedhjes së kryetarit dhe jo të shesë kopalla e demagogji, shejtanllëqe e idiotizma. Së dyti, po si myfti për 18 vite, ky si duket nuk e paska kuptuar peshën dhe shenjtërinë që e ka ky Institucion, prandaj është tallur me të, duke e vjedhur dhe duke e sabotuar me lloj-lloj truqesh të denja për një shejtan.

Shaqir Fetai thotë se nuk do të mund të bëjë asgjë pa ndihmën e gjithë kolegëve! Ai nuk ka kolegë, atë nuk e do dhe nuk e përkrah askush, aq më pak tani që e dinë se ka qenë udbash, me përjashtim të disa figurantëve që e dinë se vetëm me Shaqir Fetain e pabesë mund të jenë nga kordinatori “myfti”, duke e dëmtuar në kurriz vetë Institucionin e BFI-së.

Haramit nuk i kërkohet hallallëk. Asnjë mysliman nuk e dëshiron hallallëkun prej harami. Shaqir Fetai fund e krye është haram, prandaj, gënjenë katërcipërisht kur thotë se gjendja qenka relaksuar dhe se opinioni gjithnjë e më shumë po e përkrahëka. Opinioni dëshiron që Shaqir Fetai të ecë e mos të shesë demagogjira të poshtra.

Shaqir Fetai kërkon që mos t’i biem më qafë dhe mos ta ofendojmë. Po vetë Shaqir Fetai që i ofendon vlerat e kombit, që shpifë për ta, që propozon dhe ekzekuton fatin e tyre, tamam si një kriminel i poshtër! Ky mendon se nëse heshten këto veprime antinjerëzore të tij, ndërkombëtarët do të kenë tjetër perceptim për të? Ndërkombëtarët dhe faktorët e ndryshëm e dinë shumë qartë se ç’veprime antinjerëzore ka ndërmarur ai përgjatë shërbimit prej lakeu që i ka bërë. Kështu që as shejtanit nuk i ka hije të luajë rolin e enegjëllit.

Për Bashkësinë Fetare Islame është shumë i huaj dhe fare i panevojshëm dhe i padobishëm Shaqir Fetai.

Gazetarja insiston që Shaqir Fetai mos t’ia humbë kohën e çmueshme, mos të tallet me të por t’ia tregojë datën se kur do t’i organizojë zgjedhjet për kryetar. Edhe këtu Shaqir Fetai shpërfaqet në një demagog i pafytyrë, në një injorant por edhe në një lakmitar të postit të premtuar nga UDB qysh kur ishte student. Atij po iu dashka shumë kohë për këtë punë. Krejt koha e nevojshme është 30 ditë, hiç më shumë dhe nuk ka se çka të brengoset ky për më tej. Të gjitha përgjegjësitë, detyrimet dhe angazhimet do t’i kërkohen atij që do të vie nga këto zgjedhje (që nuk do të jetë Shaqir Fetai me biografinë e fëlliqtë që e ka).

Shaqir Fetai veprimin e vet të djallëzuar mundohet ta paraqesë si opsion! Po a nuk ishte opsion zgjedhja e tij për t’i shërbyer Sulejman Rexhepit plotë 18? Djallëzitë e veta Shaqir Fetai mundohet t’i shpërfaqë si opsion. Turp dhe trishtim!

Po kur flet për vakëfin? Njeriu që e humbi investimin vakufor më të rëndësishëm në Gostivar, edhe atë ekskluzivisht për punë korrupsioni. Po kur mundohet të flasë si “engjell” shejtani që më së shumti e ka ndihmuar të keqen në drejtim të dëmtimit të trishtueshëm të vakëfit? Shaqir Fetai ankohet që nuk e ka fuqinë e një Supermeni për ta zgjidhur çështjen e vakëfit, të denacionalizimit, por ama që e ka pasur fuqinë e Supermenit për ta shkatërruar, zhvatur e tjetërsuar vakëfin! Nuk do të ketë kohë të ankohet në Strasburg sepse do të përfundojë në burg me izë të Zotit. Ai e di pse!

Ta përmbyllim këtë analizë të kësaj pseudointerviste? Pse e bëmë këtë analizë? Thjesht për ta nxjerrë në pah një demagogji të tmerrshme, një lakmi djallëzore, një set gënjshttrash e pabesi, një

mossinqeritet dhe që, të gjitha këto tipare, e kanë emrin Shaqir Fetai. Dhe ky, çdo sekond që thirret në emër të myslimanëve të vendit, është turp, ofendim dhe nënçmim për vetë myslimanët. Atij i është rrasur mendja se është vetë engjëlli në mesin tonë ndërsa detyra jonë, e të gjithë myslimanëve është që ta demaskojmë dhe të tregojmë se është vetë shejtani të cilin duhet ta dëbojmë sa më larg neshë. Është detyrë dhe obligim islam për çdo mysliman që ta dëbojë shejtanin sa më larg njerëzimit.

*(Politesa, 8.11.2020)*



## **Të udhëzohet Shaqir Fetai e të mos ndeshet me dispozitat ligjore të vendit. Pensionimi mund ta zë në burg!**

**Më 27 nëntor Shaqir Fetai mbushë plotë gjashtë muaj nga ushtrimi i detyres, (si masë e dhunshme alla-serbçe), kryetar i BFI-së. Detyrë e vetme e tij për këtë kohë ka qenë që të shpallë konkurs dhe të përkujdeset për tërë procesin e zgjedhjes së kryetarit legal dhe legjitim të BFI-së dhe, vetë të kthehet në Myftininë e Gostivarit. Pas kësaj date Shaqir Fetai mund të ndiqet edhe penalisht për keqpërdorim të pozitës dhe për shkelje të ligjeve gjegjëse shtetërore**

**Nga Semiha Osmani, juriste**

Në analizën e fundit që ia kishin bërë intervistës së Shaqir Fetait dhënë në emisionin OPEN të RMV2, veç të tjerash lexova edhe një gjë që flet për një manipulim të paqartë: ose dikush e ka manipuluar Shaqir Fetain, ose Shaqir Fetai është duke manipuluar! Një ish-myfti të silltet në këtë derexhe është turp e mëkat! Në të dyja rastet, sipas dispozitave ligjore të Maqedonisë së Veriut, Shaqir Fetai mund të ndiqet penalisht dhe ta hajë burgun. Në këtë derexhe zakonisht përfundojnë ose naivët ose demagogët.

Nga intervista e Shaqir Fetait, kushdo që do ketë nerva për ta përcjellë me kujdes, do të shohë se si Fetai është shumë i vetëdihëm se duhet të ikë sa më parë pasi të zgjidhet Kryetari legal dhe legjitim i BFI-së. Megjithatë, nga ana tjetër, po ky Shaqir Fetai, na flet për planet e tij për ta reformuar BFI-në, na flet për planet dhe “platformën” e tij për t’i kryer këto “reforma”, për ta stabilizuar financiarisht dhe administrativisht këtë Institucion dhe, tek pastaj të shpallë zgjedhje për

kryetar, duke shpresuar se deri atëherë do

të mbledhë mjaft pikë për t’u vetëzgjedhur!

E para, Shaqir Fetai, sipas deklaratës së kumtuar nga goja e vetë, ai nga “kolegët” e vet, që ishin që të gjithë bashkëpunëtorë e puthadoraxhinjë të Sulejman Rexhepit, e kishin caktuar që të zhvillojë procesin e zgjedhjes së këtij kryetari! Ligjërisht, kjo është dashur të kryhet brenda 6 muajve dhe, aktet juridike të shtetit duhet të respektohen edhe nga ana e BFI-së, ndonëse si Institucion është i mëvetësishëm nga shteti. E dyta, nuk ka kurrfarë shtegu ligjor që një ushtrues detyre, pasi t’i shpallë zgjedhjet, të kandidojë edhe vetë ai për këtë post, sepse paraqet konflikt interesi që sanksionohet sipas dispozitave përkatëse ligjore të vendit. Kur e tërë kjo kihet parasysh, atëherë si guxon të manipulojë Shaqir Fetai e të thotë se paska në plan të kryej reforma në BFI, ta stabilizojë financiarisht dhe administrativisht dhe tek pastaj të largohet nga “kreu i BFI”, kohë kjo që kërkon minimum dhjetë vite. A është normal ky njeri a jo. Kolegët që mund ta manipulojnë sa për të siguruar “sponsorues” si Shaqir Fetain për ndonjë drekë apo darkë, është mirë që mos të tallen me të shkretin por ta udhëzojnë

dhe t'i shpjegojë se çka mund ta gjejë nëse përballet me ndonjë avokat "të sertë"!

Shaqir Fetai nuk guxon të humbë kohë por, duhet ta përfundonte procesin e zgjedhjes së kryetarit të BFI-së, të cilit pastaj i takon që t'i kryej të gjithë reformat e paraparë në platformën e tij me të cilën do të konkurrojë publikisht dhe do të zhvillojë fushatë të përcaktuar në rregulloren e domosdoshme (dhe që mungon) për zgjedhjen e kryetarit të BFI-së. Shaqir Fetai po menduaka se ky është ai i caktuari që duhet t'ia pastrojë terrenin, t'ia stabilizojë organet dhe institucionet dhe tek pastaj të na vie kryetari i BFI-së. Amani ju qoftë, kolegë jurista, udhëzoheni Shaqir Fetain se mund ta hajë shumë keq, madje në moshën kur duhet ta shijojë pensioni (sepse atij nuk po iu deshkan më shumë se edhe dy vite për pensionim). Mjaft më u manipulua dhe u kontribua në devalvimin, në talljen dhe në përlligjen e figurës së kryetarit reisul ulema të BFI-së. Mjaft më!

*(Epoka, 9.11.2020)*

## Shaqir Fetai erdhi dhe po ik duke shkelur mbi Kushtetutën e BFI-së

Më në fund, “rijaseti” i Shaqir Fetait, mbajti të vetmen mbledhje për këto gjashtë muaj që kur u krye puçi klasik mbi Bashkësinë Fetare Islame në RMV. Edhe me këtë rast u dëshmuar katërcipërisht se Shaqir Fetai me shokët e vet në tërë këtë krahurë të shkaktuar në BFI kishte mision të caktuar i cili duhej të rezultonte me përçarje, shkatërrim të unitetit të BFI-së, me skema djallëzore që mund të përfundojnë me pasoja të paparashikueshme për BFI-në dhe për myslimanët e vendit

### *Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI*

Shaqir Fetai erdhi duke e shkelur Kushtetutën e BFI-së dhe iku duke e shkelur të njëjtën! Shaqir Fetai duke u nisur nga motoja e tij se sa më keq për myslimanët aq më mirë për vetë atë, thërret një mbledhje të “rijasetit” në të cilën mundohet të bëjë petulla në ujë, duke ia përgatitur vetes terrenin për t’u zgjedhur reis!

Shaqir Fetai, duke e ditur se nuk do të ketë mundësinë e formimit të kuorumit të nevojshëm për “t’u zgjedhur” reis, shkon dhe i emëron për myfti të gjithë koordinatoret e Myftinive të BFI-së. Ky akt është në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e BFI-së, sepse, sipas nenit 31 të Kushtetutës, “Muftinia kandidon kandidatë të mundshëm për mufti, Rijaseti i BFI-së bën emërtimin e muftive, kurse Reis ul Ulema verifikon emërtimin dhe u lëshon Murasele. Mosdhënia dhe tërheqja e Muraseles obligon Muftininë në afat prej tridhjetë ditë të propozojë kandidatë të mundshëm për mufti.” Kurse, sipas nenit 65 “Funksonarët e emëruar japin betimin solemn para Reis ul Ulemasë”!

Këto dy nene bëjnë qartë me dije se, Shaqir Fetai nuk është ai që mund të zgjedhë myftinjë, si dhe nuk është ai i cili jep Murasele dhe para të cilit kryhet betimi!

Shaqir Fetai shkon edhe më tej në shkelje të Kushtetutës së BFI-së! Ai na thotë se paska “formuar rregullore” për zgjedhje, ndërkohë që aktet normative miratohen në Kuvendin e BFI-së!

Fatkeqësisht, tërë këto shkelje dëshmojnë dy gjëra: kjo strukturë puçistësh ose nuk kanë fare njohuri mbi Kushtetutën e BFI-së, ose tashmë, të dëshmuar si elementë të huaj, e bëjnë atë për të cilën porositen nga nëntoka që nuk ia do të mirën as BFI-së por as myslimanëve të vendit.

Lëvizja Mysllimane për Reforma në BFI është më se e bindur se, shumë shpejt, dikush do të përgjigjet para instancave të drejtësisë në vend, sepse, Kushtetuta e BFI-së nuk është leckë që mund të shkilet e të përbaltet aq lehtë nga Shaqir Fetai dhe shokët e tij, Kushtetuta e BFI-së është një amanet, është një premtim i dhëtur para Allahut Fuqiplotë, sipas të cilit premtim do të punojnë me përgjegjësi dhe përulesi të plotë të gjithë organet, të emëruarit dhe të zgjedhurit e BFI-së.

Kështu siç është vepruar në këtë mbledhje të Rijasetit, të datës 11 nëntor të vitit 2020, të thirrur nga Shaqir Fetai, do të vepronin vetëm shërbimet e huaja të cilat nuk ia duan të mirën islamit, unitetit fetar dhe mbarë myslimanëve të vendit.

*(Almakos, 11.11.2020)*

## PREMEMORIE

### për shpëtimin kushtetues të Bashkësisë Fetare Islame në RMV

Nisur nga fakti se Bashkësia Fetare Islame, Institucioni i vetëm fetar islam në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është kapur nga injorantë, nga sharlatanë dhe rrënues të këtij Institucioni, nga individë të shërbimeve të huaja e të nëntokës;

Nisur nga fakti se Bashkësia Fetare Islame ka ngelur një Institucion pa personalitet, pa integritet, pa rol e pa peshë në shoqërinë tonë;

Nisur nga fakti se Bashkësia Fetare Islame ka ngelur në duart e zhvatësve dhe të degraduesve, të shitësve e të

tëhuajësuesëve të vakëfit;

Nisur nga fakti se Bashkësia Fetare Islame kurrë nuk ka qenë kaq e depersonalizuar në sytë e myslimanëve të vendit, e lënur shkret nga myslimanët që gjithnjë e më shumë distancohen ngaqë këtë Institucion kanë filluar ta shikojnë si filiale partishë e shërbimesh intelegjente të huaj- një grup imamësh, teologësh, profesorësh, nëpunësish fetarë, intelektualë të fushave të ndryshme islame, kanë propozuar formimin urgjent të Këshillit për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së në RMV.

Duke qenë se Bashkësia Fetare Islame tashmë është nën regjimin e disa puçistëve klasikë të cilët synojnë t'i realizojnë interesat e tyre meskine gjithnjë duke e shkelur Kushtetutën aktuale të BFI-së, ku nga mosdituria, nga mosnjohja e këtij akti më të lartë të BFI-së, ku nga misioni i tyre parësor për ta degraduar sa më shumë Institucionin e vetëm fetar që e kanë myslimanët e vendit, ky Këshill tashmë është obliguar që ta interpretojë Kushtetutën ekzistuese në mënyrë sa më autentike dhe të japë kontributin e vet në stopimin e sa më shumë veprimeve antikushtetuese që po bëhen në BFI.

Ky Komision që në fillim ka konstatuar se, janë bërë shkelje flagrante të kësaj Kushtetute që nga shkarkimi i Reisit, H. Sulejman ef. Rexhepit, si:

Sulejman Rexhepi nuk është shkarkuar në mënyrë legale dhe legjitime;

Sulejman Rexhepi është shkarkuar nga një “organ” inekzisten, jokompetent dhe në mënyrë të falsifikuar;

Fjala “e kanë caktuar” që i atribuohet caktimit të Shaqir Fetait si ushtrues detyre Kryetar i BFI-së deri në përfundim të procesit të zgjedhjes së Kryetarit, është fjalë jokushtetuese. Askund në Kushtetutën aktuale nuk shkruan se një organ “caktohet” por, ose zgjedhet ose emërohet Shaqir Fetai “caktohet” si një organ inekzistent, si një “funksionar” që nuk e njeh Kushtetuta por asnjë akt tjetër normativ i BFI-së;

“Trupi shkarkues”, “Rijaseti” i Shaqir Fetait, që ka shkarkuar Sulejman Rexhepin është përbërë prej njerzve që nuk kanë të drejtë vote, siç janë koordinatorët e Myftinive por edhe nga drejtues të shoqatave, komisioneve dhe ish anëtar të Kuvendit të BFI, që Kushtetuta nuk i njeh si anëtarë të Rijasetit (shih Nenin 35 i cili thotë “Rijaseti i BFI-së përbëhet prej Reis ul Ulemasë, Sekretarit të Përgjithshëm të BFI-së, muftinjve, drejtorëve dhe dekanëve të institucioneve arsimore, kryetarëve të shoqatave të Bashkësisë Fetare Islame dhe dy anëtarëve të caktuar nga ana e Reis ul Ulemasë me përvojë në organizimin e jetës fetare në radhët e BFI-së.”)

Asnjë prej atyre personave të përfshirë në “rijasetin puçist” nuk janë organe, ndaj dhe nuk e kanë të drejtën e sjelljes së vendimeve në emër të organeve që i drejtojnë; Asnjë nga ata “myftinjë” nuk ka konsultuar organin e vet, me myftininë, nuk ka ofruar procesverbal; nga mbledhjet ku janë sjellë vendime unanime për tërheqjen e besueshmërisë ndaj Sulejman Rexhepit, nuk kanë propozuar shkarkimin e tyre, nuk është debatuar rreth këtij shkarkimi, për më tepër, asnjë nga këta “myftinjë” nuk ia kanë tërheqë vëretjen Sulejman Rexhepit për shkeljen e Nenit 58, për ç’gjë edhe do të dorëzohen para presionit të organeve të tyre që i përfaqësojnë e që po kërkojnë shkarkimin e Sulejman Rexhepit;

H. Sulejman Rexhepi shkarkohet me një “deklaratë” të vulosur nga vulat e nxjerra jasht zyreve të organit dhe të tubuar në ndodnjë zyre ku mund të kenë qenë të kërcënuar nën tytën e armëve. (Ndryshe, nxjerrja e vulës jasht zyre së organi dhe fallsifikimi i dokumentit me ato vula paraqet vepër penale!) Duke i vërejtur këto shkelje flagrante të Kushtetutës ekzistuese të BFI-së, duke i vërejtur falsifikimet si dhe nënshtrimin e bashkëpunëtorëve të vet para forcave të errëta e destruktive që asnjëherë nuk ia kanë dashur të mirën BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi, i gjendur në rrethana të papritshme të pabesisë dhe, i nxitur nga mëshira ndaj bashkëpunëtorëve të vet që t’i nxjerrë nga balta ku janë futur, më 29.05.2020 ofron dorëheqje që është protokoluuar me nr. 217/15-13!

Sipas Kushtetutës së BFI-së Neni 64, “Secili funksionar i BFI-së ka të drejtë të jep dorëheqje, dhe për të njëjtën vendos Rijaseti i BFI-së.”

Deri më sot, po bëhen gjashtë muaj, Rijaseti nuk është mbledhur për të vendosur lidhur me dorëheqjen e H. Sulejman ef. Rexhepit, as nuk është miratuar dhe as nuk është refuzuar, që do me thënë se, islamikisht dhe juridikisht, ai edhe më tej mbetet Kryetar i BFI-së, dhe mbanë përgjegjësi para Aktit më të lartë të BFI-së, para myslimanëve të vendit dhe, mbi të gjitha, para Allahut xh.sh.

Gjithashtu, Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së konstaton se, bazuar në nenin 65 të Kushtetutës “Funksionarët e emëruar japin betimin solemn para Reis ul Ulemasë”, dhe askund në Kushtetutë nuk thuhet se ky betim mund të bëhet edhe para ushtruesit të detyrës, kështu që:

Shaqir Fetait dhe bashkëpunëtorët e tyre puçistë rreptësisht ju ndaloheq që të “emërojnë” myfti vetëm sa për të falsifikuar organin më të lartë kolektiv “Rijasetin”, sepse:

- a) koordinatorët nuk kanë të drejtë të votojnë;
- b) koordinatorët nuk mund të shpallen myfti, sepse ata i emërton sipas procedurës dhe rregullores për zgjedhjen e myftive, vetë Reisul Ulema dhe,
- c) myftinjët pa muraselen e Reisul Ulemasë nuk mund të ushtrojnë detyrën emyftiut. Muraselen e jep ekskluzivisht Reisul Ulema Kryetari i BFI-së dhe jo ushtruesi i detyrës, “organ” ky i panjohur për BFI-në.

Marrë parasysh situatën e përgjithshme tejet të pavolitshme në të cilën gjendet aktualisht BFI-ja, marrë parasysh se për momentin ky Institucion fetar islam është futur në disa rrugë qorre, Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetushmërisë së BFI-së do të imponohet vullnetarisht si trup mbipalë, për të përafuar mendime, propozime, këshilla sa më të përafërta të të gjithë faktorëve relevant, duke u përpjekur të luajnë rolin e një ndërmjetësuesi apo lehtësuesi për ta nxjerrë në pozita sa më të lakmueshme, mbi të gjitha, Institucionin e BFI-së.

Këshilli (KMK të BFI në RMV) do t'i kontaktojë të gjitha palët relevante në vend të cilët do të jenë në përputhje me qëndrimet e Këshillit në mbrojtjen dhe në veprimin ekskluzivisht sipas Kushtetutës së BFI-së.

Këshilli do të jetë i hapur me të gjithë faktorët si dhe me mas mediat e vendit. Do të organizojë konferenca e takime shkencore, do të jetë shumë transparente dhe koperative me të gjithë faktorët e vendit, me mediat por edhe me faktorët ndërkombëtarë.

Meqë situata është gati jasht kontrollit, meqë jemi para një emergjence imediate, KMK do të jetë shumë aktive që në fillim të punës së vet, duke kërkuar përkrahjen, ndihmën, sugjerimet dhe këshillat e tërë komunitetit të teologëve të vendit.

Këshilli konstaton pa kurrfarë dileme se një veprim i këtillë është amanet i Zotit dhe detyrim fetar, por edhe gjest kombëtar e akt njerëzor.

Këshilli do të dalë me propozime konkrete, me sugjerime e me zgjidhje të paanshme për tejkalimin e mosmarrëveshjeve deri në përfundim të procesit zgjedhor dhe në zgjedhjen e Kryetarit të BFI-së.

Këshilli do të kërkojë, do të inicojë e do të ngrisë padi penale, do të kërkojë përgjegjësi morale e penale prej të gjithë atyreve që do të mbajnë anën e destruktivitetit dhe do të stigmatizohen si përçarës dhe vegla të shërbimeve antiislame në vend.

Na priftë e mbara dhe i Lutemi Zotit Fuqplotë që të na ndihmojë në këtë angazhim tonin vullnetar dhe shumë fisnik, pa kurrfarë interesi dhe pa kurrfarë synimesh mesquine. Për këtë e kemi dëshmitarë Vetë Allahu xh.sh.

*(Fol, 12.11.2020)*

## **Institucionalizimi i anarkisë dhe i radikalizmit në BFI**

**Aty ku shkilen dhe nuk respektohen aktet normative, duke filluar nga ligji më i thjeshtë e deri te Kushtetuta, aty pra kemi të bëjmë me anarki totale. Anarkia nuk është asgjë tjetër përveçse një buldozer që ia krijon terrenin radikalizmit dhe terrorizmit. Një terren i tillë, fatkeqësisht, për momentin është shndërruar Bashkësia Fetare Islame në RMV**

### **Shkruan Afrim Tahiri**

Në mbledhjen e fundit të çerek-rijasetit të BFI-së së “drejtuar” nga Shaqir Fetai, ish-myfti i Myftinisë së Gostivarit (sepse në zyren e vet ka munguar mbi 150 ditë!!!) u zyrtarizuan të gjitha shkeljet ligjore e kushtetuese që janë bërë në BFI, madje edhe u institucionalizuan shkeljet flagrante të të gjitha akteve normative. Nuk ka asnjë dyshim se, prapa këtij degradimi të të vetmit institucion fetar islam të vendit, qëndrojnë edhe struktura të caktuara partiake.

BFI-ja është partizuar deri në palcë, jo si subjekt me relevancë por, si objekt ku mund të zhvatet tërë pasuria milionëshe e saj. Fatkeqësisht, nëse subjekti politik është i bllokut mysliman, ai subjekt i ngulë thonjtë e vet mbi këtë Institucion vetëm sa për t’ia zhvatur pasurinë dhe për të siguruar ndonjë votë më tepër, kurse, nëse subjekti politik është i bllokut ortodoks maqedonas, mundohet t’i ngulë thonjtë e vetë sa për ta kontrolluar dhe për ta dirigjuar në drejtim të përçarjes dhe të sektarizimit të Institucionit, veprime këto që sjellin destabilizime dhe stigmatizime të shoqërisë dhe të Institucionit. Aktualisht, Bashkësia Fetare Islame, me lejen dhe dijeninë e pushtetit, po shndërrohet në një Institucion i cili tashmë ka legalizuar të gjitha format e mundshme të anarkisë, të radikalizmit e të terrorizmit. Këto teza dhe akuza të pamohueshme do të mund të përligjeshin nëse shteti, institucionet përkatëse shtetërore, nëse vetë pushteti, do të intervenonte urgjentisht si një “Roje e Kushtetutshmërisë” së BFI-së si Institucion që vepron në kuadër të shtetit, në përputhshmëri të plotë dhe duke i respektuar të gjitha aktet normative të vetë shtetit.

Mosreagimi i pushtetit kundër personave të papërgjegjshëm, kundër personave të dyshimtë, kundër personave tashmë të stigmatizuar si bashkëpunëtorë të shërbimeve të huaja, do të thotë pajtim me përpjekjet nëntokësore për ta destabilizuar komunitetin mysliman dhe për ta shkatërruar Institucionin e tyre të vetëm fetar.

Kujt i shkon kjo për shtati? Kujt i konvenon një Institucion i brishtë apo një shkatërrim fatal i tij? Natyrisht, vetëm atyre që e synojnë një qëllim të tillë sa për t’i fshehur gjurmët e krimit dhe të kriminalizimit të Institucionit.

Ata që në mbledhjen e fundit të çerek-rijasetit i shkelën të gjitha aktet normative, menjëherë në mbrëmje është dashur të lidhen dhe të dërgohen në burg. Të paktën, që të gjithë duhet të trajtohen si subjekt i dyshuar që mundohet ta institucionalizojë radikalizmin dhe terrorizmin në vend. Të bëshë zyrtarisht shkelje flagrante të akteve normative, mos t’i përfillësh nenet dhe alinetë e Kushtetutës ekzistuese, e cila është e deponuar dhe e pranuar edhe nga institucionet shtetërore të drejtësisë, flet për një rrebelim shumë të frikshëm dhe për një synim të realizimit të politikave retrograde që mëtonin t’i paraqesin shqiptarët si destabilizues, radikalistë e terroristë islamikë. Destabilizues, radikalistë e terroristë gjithnjë kanë qenë, janë dhe do të jenë vetëm bashkëpunëtorët e shërbimeve sekrete ruso-serbe. Ky “sekret” tashmë është publik, sepse vetëm ky shërbim inteligjent synon që shqiptarët të paraqiten edhe institucionalisht si “element i radikalizmit dhe terrorizmit”!

Nisur nga aspekti etiko-juridik, në mbledhjen e fundit të çerek-rijasetit të kurdisur nga Shaqir Fetai, BFI-ja që nga kjo mbledhje ka ngelur pa parimet e veta në të cilat mbështetej dikur, siç janë: drejtësia, transparenca dhe debatet para sjelljes së vendimeve në organet kolektive (shih Nenin 8 të Kushtetutës së BFI-së).

Në Kushtetutën ekzistuese të BFI-së ekziston edhe një kaptinë që flet për të drejtat dhe detyrat e komunitetit myslimanë si anëtarë të BFI-së. Në Nenin 9, në një prej pikave thuhet se anëtarët e këtij komuniteti, pra të gjithë myslimanët e vendit, duhet që “t’i përmbahen Kushtetutës, akteve normative dhe vendimeve të organeve të BFI-së”!

Është shumë e padrejtë që të kërkohet një gjë e tillë prej mysimanëve të vendit tashmë kur organet e Institucionit të vetëm fetar kanë shkelur me dy këmbë mbi çdo akt normativ të këtij Institucioni. BFI-ja nuk mundet dhe nuk ka të drejtë më të flasë në emër të mysimanëve dhe as të mendojë se mund të ketë ndikim pozitiv te ata. Myslimanët e vendit e kanë gjithë të drejtën e Zotit që të rrebelohen kundër këtij Institucioni të ngelur tashmë nën kthetrat e partive antiislamiste e të vetë pushtetit.

Fatkeqësisht, tërë kjo lojë është një uvertyrë katastrofale në institucionalizimin e anarkisë dhe të radikalizmit të këtij komuniteti, qoftë si shoqëri qoftë si institucion. E vetmja shpresë mbetet tërheqja serioze e vërejtjes nga ana e faktorit ndërkombëtar në vend, i cili tashmë është dëshmitarë i gjallë i tërë kësaj mbrapështie që po kurdiset në BFI, nën “patronatin” e Shaqir Fetait dhe shokëve të tij të diskutueshëm!

Po nënvizohen këto fakte që flasin për shfaqjen e mundshme në të ardhmen të dukurive jo humane e të rrezikshme dhe, po shprehet një përpjekje shumë e sinqertë për t’i shënjestruar shkaktarët e sotshëm që provokojnë perspektivë jofatlume. Dhe, me lutje të përrshpirtshme drejtuar Zotit Fuqiplotë që mos të ndodhë kurrë kurrfarë të keqe për shoqërinë këtu, nëse eventualisht mund të shfaqen të tilla dukuri, do të ishte e pandershme që të akuzohet shqiptaria, të akuzohet islami, të akuzohen myslimanët. Këta provokues të së keqes dhe të së ligës, këta të ashtëquajtur “rijaset” nuk përfaqësojnë asgjë prej islamit, prej shqiptarisë, prej myslimanëve. Thjesht, janë vegla të shërbimeve të huaja përderisa si puçista dhe uzurpatorë të Institucionit do të jenë duke shkelur Kushtetutën dhe aktet e tjera normative të BFI në RMV.

*(Shqipmedia, 13.11.2020)*



## Zgjedhje për reis apo për boss-in e mafiozëve

**(Lidhur me komunikatën e komisionit humoristik që ka vendosur ta kryej procesin e zgjedhjeve për Kryetar të BFI-së)**

### *Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetushmërisë së BFI-së*

Komunikata e publikuar në veb faqen zyrtare të BFI-së lidhur me zgjedhjet për Kryetar të BFI-së, fatkeqësisht e përligji tërë atë premtim të “kreut të BFI-së” që një ditë më parë ia premtuan përfaqësuesve të OSBE-së se do të organizohen zgjedhje të lira e të ndershme. Me të robëruarit dhe të pandershmit nuk mund të ketë zgjedhje, por, vetëm truk sa për të shpëtuar nga kriminaliteti që e kanë ushtruar brenda BFI-së. Komunikata në fjalë, sa ishte e turpshme aq ishte edhe e marrë, sa ishte amatoreske aq ishte edhe diletanteske! Një komunikatë tërësisht kundërthënëse dhe naive, që paraqet synime djallëzore të të mbaruarve dhe të të dështuarve, të cilët, mundohet që të krijojnë kushte sa të kapen vetëm edhe një herë për një fije kashte.

Komisioni humoristik që mëton të organizojë zgjedhje të lira e të ndershme duhet të tregojë se pse nuk e publikon fillimisht Kushtetutën e BFI-së, pse nuk e publikon Rregulloren! Pse nuk tregon se kush e hartoi, kur u hartua dhe a u miratua kjo rregullore nga Kuvendi i BFI-së, ashtu siç kërkon Kushtetuta aktuale e BFI-së. Nëse bëhet fjalë për Rregulloren e vjetër për zgjedhje të Kryetarit të BFI-së, atëherë, pse e kanë censuruar kushtin që thotë se, për Kryetar konkurrenti duhet të jetë mbi 40 vite por jo më shumë se 60 vite (apo po i krijoni terren Shaqir Fetait 62 vjeç)!

Komisioni humoristik të shkulë së qeshuri kur thekson edhe dy prej kushteve më idiotike, të cilat kanë të bëjnë me propozimin dhe me përkrahjen e kandidatit të mundshëm! Kryetari i ardhshëm nuk zgjedhet për këtë garniturë të dyshimtë e të diskutueshëm të “rijasetit”, sepse, Kryetari i ardhshëm mund të formojë tërësisht Rijaset të ri, prandaj, asnjë kandidati për Kryetar nuk i duhet të propozohet “të paktën prej një anëtari të “rijasetit” aktual si dhe, po i njëjti “të sigurojë përkrahjen e 1/3 të anëtarëve të “rijasetit”! Pra, lojë nonshalante e të frikësuarve nga cv-ja kriminale e disa personave të “rijasetit” që mundohen ta mbajnë peng edhe më tej BFI-në!

Kandidatët që i plotësojnë kushtet e parapara me Kushtetutë si dhe me Rregulloren e vjetër (sepse të re nuk ka) mund të konkurrojnë pa pengesa dhe, varësisht nga programi i tyre, të garojnë për të siguruar sa më shumë vota nga anëtarët e Rijasetit. Këto do të llogariteshin zgjedhje të ndershme dhe jo ato që i paralajmëron komisioni humoristik i “rijasetit” të Shaqir Fetait.

Komisioni për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së do t’i informojë edhe të gjithë faktorin ndërkombëtar në vend si dhe të gjitha faktorët kombëtar, për këtë fundlojë që po luhet padhimbshëm nga elementë të dyshimt mbi BFI-në e shkërmoqur deri në themel, mbi këtë Institucion që dikur ishte bastion i myslimanëve të devotshëm, ishqiqtarëve të paluhatshëm, i besimtarëve të shkëlqyer.

*(Kombetare, 13.11.2020)*

## Zgjedhje sipas Shaqir Fetait

**Nga brenda BFI-së po dalin muhabetete se Shaqir Fetai po përgatit zgjedhje për reis dhe këtë proces do ta kryej sipas zgjidhjes së tij: me përkrahje të pushtetit aktual, do me thënë, me mosndjekje për veper penale bazuar në këtë krim zgjedhor që do ta kryej, ai do të vetëzgjidhet pa më të voglën brengë se po rrenjosë një traditë të turpshme në BFI**

**Shkruan Halid Sadiku**

Shaqir Fetai, duke qenë nën presion të përditshëm nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI, për t'i kryer sa më parë zgjedhjet për reis të BFI-së, nisur nga fakti se prononcimi i parë i Shaqir Fetait shpjegon se kolegët paskëshin vendosur që organizimin e zgjedhjeve t'ia besojnë këtij farë myftiu, paska vendosur që t'i hyjë edhe kësaj aventure. Pa dyshim, zgjedhjet në BFI për Shaqir Fetain janë aventura e llojit të vet, sepse, realisht ky nuk njeh asnjë procedurë, ka dëshmuar se është shkelësi më i madhë i akteve normative në historikun e BFI-së. Prandaj dhe, paraprakisht është duke e kryer një krim të veçantë, duke shfrytëzuar injorancën e tij dhe mosnjohjen e akteve normative. Bëhet fjalë për emrimin krye më vete të koordinatorëve të myftinive në myfti! Kjo flet se, Shaqir Fetai nuk ua ka besën anëtarëve aktualë të Rijasetit, të këtyre që e ndihmuan në puçin dhe në komplotin e rëndë kundër ish-reisit, H. Sulejman ef. Rexhepit, ndaj dhe, koordinatorët që i kishte caktuar ky, sipas marrëveshjeve paraprake është duke i avancuar në myfti, edhe pse, edhe për këtë punë ka rregullore të veçantë, ka pëprcaktime kushtetutare, të cilat Shaqir Fetai, për interesa të veta meskine, i shkelë dhe nuk i përfillë aspak. Pra, Shaqir Fetai nga i caktuari për të drejtuar BFI-në deri në organizim të zgjedhjes së Reisit, përgatitet që të vetëzgjedhet dhe, këtë vetëzgjedhje ta kamuflojë me kinse “votim të Rijasetit”, natyrisht, komplet të falsifikuar! E drejtë e caktimit të myftive është e drejtë ekskluzive e Reisu Ulemasë, dhe jo e personit që ushtron post inekzistent dhe të panjohur nga asnjë normë juridike të BFI-së, “u.d. reisu ulema”! Shaqir Fetai duhet të organizoj zgjedhjet dhe të kthehet në pozitën e vet të më parshme, në myfti të Gostivarit dhe jo të bëjë për vete petulla në ujë! Sepse, do t'i ngelin në fyt! Shaqir Fetai me tradhëti e me komplot i priu lojës së largimit nga kreu i BFI-së të H. Sulejman ef. Rexhepit, dhe me tradhëti e me komplot po ia mësynë kapjes së këtij posti! Shaqir Fetai ka bërë shkelje flagrante të Kushtetutës së BFI-së, ndaj dhe, një person i tillë është rrezik që të vihet në krye të BFI-së. Shaqir Fetai ka dëshmuar se është servil i tmerrshëm i partive në pushtet, LSDM-BDI-së, ndaj dhe, fare nuk brengoset për faktin që është injorant absolut për sa i përket njohurive që ka për aktet normative dhe për drejtimit të BFI-së. Mbase edhe do t'ia arrijë qëllimit që, nën përkrahjen e këtij pushteti aktual maqedonas, do të instalohet në krye të BFI-së, por, duhet të përgatisë veten edhe për faktin tjetër se, me rënien e kësaj qeverie bie edhe ai vetë, bashkë me “rijasetin” e tij! Shaqir Fetai ka ngelë në histori si puçisti dhe komplotisti më i tmerrshëm në kapjen e pushtetit të BFI-së, ndërsa do të ngelë edhe si shembulli më eklatant i zgjidhjes katastrofale të “problemit BFI”! Shaqir Fetai ka vetëm një zgjidhje fatlume për veten dhe për myslimanët e vendit: të organizojë zgjedhje islamikisht të pastra për reisin dhe, të tërhiqet në strolullën e vet. Me këtë do të dëshmojë se vërtetë e ka pasur hall BFI-në. Në të kundërtën, nëse ia mësynë kapjes së BFI-së me këtë do të dëshmojë se ai hall e ka vetëm interesin e vet të poshtë.

*(1Kliklarg, 14.11.2020)*

## Kur ju flet eksperti i demagogjisë

**(Lidhur me pseudointervistën e Shaqir Fetait që dje (13.11.2020) e kishte incizuar në pikë të drekës, përgjatë ezanit, me qëllim që të emitohet në mbrëmje nga ana e Tv Uskanës)**

Shaqir Fetai, ky shkelës i paekzemplarë në historikun e BFI-së i të gjitha akteve normative të Institucionit fetar islam, që janë konform porosive kuranore si dhe të praktikës së Pejgamberit a.s., nuk guxon të përballet me mbrojtësit e kushtetutshmërisë së BFI-së dhe të debatohet rreth të gjitha planeve ogurzeza të tij për këtë Institucion. Sa herë që dëshiron të dalë në ekran televiziv, të shikojë se sa “i bukur” është e sa është “intelektual i kalibrit të madh” ai kurdisë, duke paguar, ndonjë televizion lokal (sepse, është i vetëdijshëm se në tv-të lokale edhe mundësitë për sharje e komente në fb janë më të pakta, kurse në tv-të nacionale ofendimet, sharjet, shfryerja e urrejtjes kundër tij është me bollëk).

Në këtë monolog të TV Uskanës Shaqir Fetai “verglati” për një orë vetëm rreth dy çështjeve: problemi financiar dhe ai i administratës, si e paska “ndalur” rrjedhën e parave të shenjta të myslimanëve të vendit si dhe rrjedhën e dokumenteve nga administrata e BFI-së!

Shaqir Fetai qenka dashur që të bëhet “kreu i BFI’së” e të kuptojë se BFI-ja ka probleme të theksuara financiare! Nuk e paska ditur më herët? Ndërsa islamikisht si dhe me Kushtetutë Shaqir Fetai ka qenë i obliguar që të dijë në çdo sekond mbi financat e BFI-së dhe të raportojë në bazë, prej nga ka vjelur të hyra financiare për BFI-në! Shaqir Fetai, si myfti, me Murasele të Sulejman Rexhepit, ka vjelur financa, ua ka marrur myslimanëve të territorit të Myftinisë së Gostivarit, fitra, zeqat, kurbanë, pagesa për haxh, por, a e di se ku i ka çuar ato para, a e di se si janë menaxhuar, a është interesuar ndonjëherë për djersën e myslimanëve të territorit të vet? Kurrë! Prandaj Shaqir Fetai na del kaq hipokrit! Sot, flet se nuk paska qenë puna mirë, por që sapo të zgjidhet ky farë mjerani në krye të BFI-së do ta rregullojë problemin!!!

Shaqir Fetai është shpërdoruesi direkt i parave të shenjta të myslimanëve të zonë së Gostivarit! Shaqir Fetai është dëbuesi kryesor i ndërtuesve të vakëfit që në emër të Bankës Islamike për Zhvillim dëshironin që kësaj Myftinie t’ia “falinin” një vakëf në vlerë prej 9 milion dollarëve! Shaqir Fetai përplotë 18 vite ka lejuar dhe kurrë nuk ka kërkuar më të voglën përgjegjësi për keqpërdorimin dhe keqmenaxhimin e parave të myslimanëve të Myftinisë së Gostivarit.

Shaqir Fetai është ekspert, është “shkollë e vjetër” e shpërdormit të parasë së shenjtë të myslimanëve që e japin në formë të fitrit, zeqatit apo të kntributeve të ndryshme islame.

Shaqir Fetai është manipulant i llojit të vet në mesin e myslimanëve, është hipokrit, mynafik, demagog dhe, së fundmi, edhe me dokument, dëmtues i kauzave të rëndësishme historike kombëtare e fetare. Shaqir Fetait i djeg se dokumentet e ish-administratës së BFI-së qenkan shpërndarë anembanë botës. Për çfarë dokumente po flet ky i shkretë! Madje dokumenteve i jep peshë arkivore? Asnjë dokument i kësaj natyre nuk ka dalur, sepse, nëse ka dalur atëherë atë e ka distribuar vetë “bashkëpatrioti” i tij. Shaqir Fetait i dhemb se si në opinion kanë dalur dokumentet që flasin për keqpërdorime financiare, që flasin për vjedhje epike që janë kryer nga banditët e llojit të vet, si dhe për moskokëçarje për këto vjedhje. Kanë dalur dokumente që flasin për keqmenaxhim financiar nga vetë Shaqir Fetai dhe nga shokët e tij. Akoma s’ka parë gjë Shaqir Fetai!

Prandaj, angazhimi i tij për mirëqenie financiare dhe për themelim të arkivit në kuadër të BFI-së janë vetëm përpjekje të një hipokriti dhe mynafiku për t’u vetëamnistuar nga një përgjegjësi kushtetuese për ç’gjë pa dyshim që do ta ket përjetë, si myhyr në ballë, mallkimin e Zotit Fuqiptotë.

**(Fokusi, 14.11.2020)**

## Dhëlpëria e Shaqir Fetait

Ushtruesi i detyrës caktohet personi që e ka të qartë se ngarkohet me përgatitjen e procesit zgjedhor deri në zgjedhje të drejtorit, kryetarit etj., duke qenë plotësisht i vetëdijshëm se vetëpërfundohet nga pjesëmarrja në garë për një post të tillë. Kështu thotë Ligji për Marrëdhënie pune. Shkelësit e ligjeve gjithkund në botë ndiqen penalisht

**Nga Sabit Ibrahim**

Shaqir Fetai, duke dashur që të ngelë brenda rregullave të parapara me Ligj për sa i përket ushtruesit të detyrës, pak “para akshamit” i shpalli zgjedhjet për Kryetar të BFI-së! Në hap bëri një gafë të pafalshme ligjërish, sepse, formoi “komision” për zgjedhje, e cila në fakt duhej të ishte për hartim të Rregullores për zgjedhje të Kryetarit të BFI-së, Kuvendi BFI-së duhej të debatonte, të intervenonte, ta plotësonte, ta ndryshonte, apo ta miratonte në tërësi! Shaqir Fetai, si u.d., duhej ta përfundonte procesin e zgjedhjes dhe jo komisionet fiktive! Shaqir Fetai dëshiron që t’i ik a) përgjegjësisë ligjore dhe, b) t’i mbyllë sytë dhe të shkelë mbi ligj duke u hedhur në këtë garë për kreun e BFI-së, ndonëse akoma është i akredituar në Regjistrin Qendror si “ushtrues detyre kryetar”! Edhe ushtrues detyre edhe kandidat për kryetar – tërë kjo paraqet konflikt të rëndë interesi!

**A ka insaf ky njeri**

Shaqir Fetai ka paguar disa TV e disa portale që mos të lëshohet asnjë shkrim, asnjë e vërtetë, dhe asnjë reagim që do ta demaskonte dhëlpërinë e poshtë të tij! Shaqir Fetai, pa pikë turpi u paraqitet hoxhallarëve dhe i bën për pesë lekë nëse kanë dhënë ndonjë mendim negativ nëpër facebook-at e tyre, qoftë mbi dukurinë qoftë mbi vetë Shaqir Fetain! Insiston që të fshihen, duke u premtuar se do t’i rehatojë në administratë të BFI-së. Premtim i rremë, i poshtë, sepse BFI-ja nuk ka kapacitet që të ketë administratë prej mbi 1000 teologëve aq sa janë aktivë nëpër xhami, të cilët, absolutisht, që të gjithë shprehin rezerva mbi sinqeritetin dhe burrinë e Shaqir Fetait. Ditën që është formuar “komisioni humoristik” i cili ka detyrë të caktojë kushte dhe datë për zgjedhje, po flitet se veçmë janë hedhur tre kandidatúra: ajo e Shaqir Fetait, e Shaban Sulejmanit dhe e Qani Nesimit, duke u përjashtuar kandidatúra e mundshme nga Shkupi – meqë për momentin Myftinia e Shkupit drejtohet prej një mytevelie e jo myftiu! Ky paskësh qenë propozimi i Shaqir Fetait! Çka synon Shaqir Fetai me këtë propozim djallëzor? Njëri nga kandidatët do të shantazhohet që në start, ndërsa po ashtu do të jetë i shantazhuar për shkakun e tij edhe “myftiu” i cili do ta votojë ose atë ose Qani Nesimin! Do të ngelin dy kandidatët!

Nëse ngelë në gara Qani Nesimi, edhe ky tashmë është “dekonspiruar” te tëhuajt si kandidat i Besës, ndërsa vetë ka premtuar gjithandej se kandidatë politikë nuk do të ketë dhe nuk do të lejohet asnjë parti që të ndikojë në BFI! Po vetë Shaqir Fetai si kandidatë i BDI-së?! Për të dalur nga ky kurth, tashmë Shaqir Fetai i ka dhënë goditjen fatale BDI-së, respektivisht, ndikimit të kësaj Partie në BFI! Është e vërtetë se kjo Parti dëshiron që të ketë kontroll dhe vëzhgim mbi këtë Institucion, jo ta partizojë, jo që të diktojë politika bdiste, por, thjesht, meqë e konsideron Institucion me relevancë fetare e kombëtare, si parti kombëtare, i takon që të shprehë brengat e veta për ndonjë devijim të mundshëm që do t’i kushtonte shtrenjtë si kombit ashtu edhe komunitetit ku në shumicë janë shqiptarët. Veç kësaj, natyrisht, BDI mundohet edhe për ndonjë përfitim partiak që konsiston ekskluzivisht në ndonjë votë, prandaj, ka shpresuar se do të ketë ndikim në caktimin e myftive të personave që kanë simpati për BDI-në! Këto plane tashmë Shaqir Fetai mendon se i ka prishur duke i caktuar për myfti të gjithë ata kordinatorë që më herët i kishte caktuar në ato pozita vetë ish-reisul ulema Sulejman ef. Rexhepi. Me Kushtetutën e BFI-së këta “myftinjë” rishtakë nuk kanë të drejtën e ushtrimit të postit pa e poseduar Muraselen nga Reisul Ulema i cili aktualisht i mungon BFI-së! Avancimin në myfti ua ka bërë duke e pasur garancë paraprakisht premtimin e tyre se do ta votojnë për “kryetar të BFI-së”! Sepse, pa këto avancime Shaqir Fetai druan se nuk do të mund të kthehet më as në pozitën e më hershme të Myftiut të Gostivarit. Me këto lëvizje Shaqir Fetai mendon se do të arrijë t’iu hedhë hi syve të ndërkombëtarëve duke i bindur se është kandidat i pavarur, pa kurrfarë përkrahje politike!

### **Më mirë nën vëzhgimin e BDI-së se sa nën kontrollin e UDB-së**

Bashkimi Demokratik për Integrim, respektivisht, strukturat e kësaj Partie, urgjentish duhet të kërkojnë nga strukturat e caktuara të pushtetit që të tërhiqen nga kjo lojë në të cilën e kanë futur Shaqir Fetain e shkretë. Bashkësia Fetare Islame është një Institucion jashtëzakonisht me peshë për myslimanët e vendit, të cilët, në shumicë absolute janë përkatës të etnisë shqiptare. I takon, partisë kombëtare, që është në pushtet, por edhe të gjitha partive të bllokut mysliman, që t’i kenë sytë nga ky Institucion, të brengosen, ta ruajnë, ta ndihmojnë, ta kenë nën vëzhgim permanent, jashtë të gjitha ndikimeve partiake, politike apo edhe të pushtetit. Partitë kombëtare, sidomos ato që janë në pushtet dhe, duhet të distancohet nga loja e Shaqir Fetait, duhet ta zhveshin nga të gjitha petkat kamufluese të shejtanllëkut, me të cilat ai mundohet ta paraqesë “devotshmërinë” e vet dhe, ta shpëtojnë këtë Institucion nga marshimi i çizmave të rënda armiqësore që shkelin pa kurrfarë insafi kushtetushmërinë dhe të gjitha aktet e tjera normative të BFI-së. Ndryshe, na mori pusi, na hëngër dreqi, BFI- në na e mori UDB-ja nën kontroll e nën diktat!

*(Kombetare, 14.11.2020)*

## Prishunia e Shaqir Fetait

**Para do jave UDB-ja ia nxori Shaqir Fetait një dokument prej ndonjë dosje policore që flet se ai paska qenë alet i UDB-së që kur ka qenë student në Sarajevë. Shaqir Fetai, në atë fletë dokumenti shihet se e paskësh spiunuar edhe patriotin dhe mendimtarin tonë më të madh në sferën e mendimit islam, Prof. Nexhat Ibrahim**

Prishunia e Shaqir Fetait shkon deri në atë shkallë sa ky e sulmon profesor Nexhatin. Në mënyrë tipike me metoda e UDB-së, e sulmon dhe dëshiron të dijë në mos ka rrjedhur ai dokument prej dosjes së Nexhat Ibrahimit.

Nexhat Ibrahim merr mundin t'i shkruaj letër interne, duke e përshëndetur me selam e duke i uruar që ta bëjë jetën ashtu siç e ka organizuar vetë ai. Nexhat Ibrahim i sqaron se e ka hall shëndetin e vet, se është shkëputur prej të gjithëve dhe se i është drejtuar Allahut xh.sh. që t'i lutet atij t'ia falë edhe kusurin më të vogël që mund ta ketë. Në këtë derexhe e gjenë Shaqir Fetai dhe e sulmon. Sulmi është mbojtja më e mirë, ë!

Dhe, Shaqir Fetai pastaj, e nxjerr në pah prishuninë e vet. Ia merr letrën interne dhe ia boton, ia boton vetëm sa për ta "bindur" opinionin e gjërë se, ja, Nexhat Ibrahim dëshmon se nuk e ka edituar atë dokument të UDB-së.

O pis, po Nexhat Ibrahim nuk punon në UDB! Dokumentin mund ta ketë lëshuar të qarkullojë vetëm UDB-ja, sepse mund ta kesh hidhëruar dikund! Dosje nuk mbanë Nexhat Ibrahim, madje as që ka mundur ta sigurojë diku nëpër UDB-në e Serbisë. Kjo as që i ka shkuar në mend ndonjëherë të nderuarit Nexhat. As që i intereson të dijë se kush e ka spiunuar, sepse, hakmarrjen e ka lënë në Zot. Lloji i Shaqir Fetait ia ka shkatërruar shëndetin, familjen dhe, tash, vetë spiunat me metoda e mënyra të ndryshme i kërkojnë të dëshmojë se nuk e kanë spiunuar.

Pse Shaqir Fetai nuk e kërkon një demant nga UDB-ja e Serbisë por nga Nexhat Ibrahim?

Sepse, ai e di fare mirë se kë e ka spiunuar, e vret ndërgjegja, e ka të papastër ndërgjegjen në raport me Nexhat Ibrahim dhe, duke menduar se Nexhati e ka dosjen në të cilën gjendet edhe emri i Shaqir Fetait, i kërkon të prononcohet "publikisht" se a ia ka publikuar atë dokument apo jo! Nexhati nuk do të gënjejë, gjithësesi që do të thotë se jo, sepse nuk i intereson më kjo gjë. Kjo u intereson vetëm spiunave, sepse ata as gjumi i natës nuk i zë nga frika se do të dekonspirohen një ditë.

Kurse profesori i nderuar, Nexhat Ibrahim, i shkruan Shaqir udbashit: "nuk kam as telefon, vetëm e vetëm që të jem i qetë e të merrem me vetveten dhe hallet e mia. Ka një kohë të gjatë që kam reduktuar në rreth të ngushtë edhe pritjen e miqëve, kolegëve, farefisit etj. E gjithë kjo që të mbroj veten nga shqetësimet. Pra, pranoni përshëndetjet e mia dhe vazhdoni të jetoni rehat."

Rri i qetë dhe jeto rahat Shaqir Fetai, se nuk e ka ndërmend të të hakmerret Nexhati, por ama UDB-ja nuk ta falë kurrë nëse i ke tradhëtuar në ndonjë moment. Kujtohu ku, Shaqo!

*(Bota, 16.11.2020)*

## H. Sulejman ef. Rexhepi për situatën aktuale në BFI akuzon pushtetin dhe BDI-në

**Për herë të parë, që kur u shkarkua në mënyrë jokushtetutare nga posti i Reisul ulemasë së BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi pranon të flasë dhe të rrëfejë para një trupi vullnetarësh të emëruar Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetushmërisë së BFI- së. Biseda është zhvilluar në drejtim të shpalosjes së parregullsive dhe shkeljeve kushtetutare që nga shkarkimi i tij e deri në përpjekjet për ta rizgjedhur “reisin e ri”**

**Shkup, 15 nëntor 2020** – Sot, Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetushmërisë së Bashkësisë Fetare Islame në RMV, organizoi një takim me Reisul Ulemanë H. Sulejman ef. Rexhepi, me të cilin zhvilloi një bisedë të gjatë dhe shumë të frytshme për sa i përket shfaqjes së problemeve në këtë Institucion dhe mënyrën e tejkalimit të tyre, gjithnjë në funksion të ruajtjes së unitetit të muslimanëve të vendit si dhe të autoritetit dhe integritetit të vetë Institucionit.

Takimi kishte për qëllim të hidhet dritë mbi fillet e problemeve, mbi shkaqet dhe shkaktarët e problemeve si dhe të ofrohen modalitete se si të zgjidhen ato pa e cënuar kushtetushmërinë e Institucionit si dhe të të gjitha akteve të tjera normative të tij.

Biseda u zhvillua mbi metodologjinë e pyetjeve të shtruara nga anëtarët e Këshillit dhe përgjigjeve të dhëna nga H. Sulejman ef. Rexhepi.

Reisul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, për hirë të ruajtjes së kushtetushmërisë së BFI-së pranoi që për herë të parë të flasë që kur u shkarkua në mënyrë jo të ligjshme dhe me metoda puçiste, gjithnjë sipas tij.

“Vetë fakti që Shaqir Fetai i jep vetes të drejtë dhe kompetenca joligjore që të emërojë kordinatorët në myfti, do të thotë që ai, as kur ngriti iniciativë për të më shkarkuar, nuk ka pasur kuorum, i cili tani i duhet për ta zgjedhur për reis”, u shpreh efendi Rexhepi që në fillim të bisedës, për të vazhduar pastaj e për të zbardhur një fakt shumë interesant, sa autokritik aq edhe objektiv. “Le të supozojmë se unë paskam shkëlur Nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së dhe për këtë më shkarkuan! Po ai Nen nuk është se mund të shkilet për një ditë apo për një orë, shkelja e atij neni duhet të jetë në kontinuitet dhe për vite të tëra! Po këta që më “shkarkuan” a nuk ishin bashkëpunëtorë të mi të ngushtë? Unë gjithnjë kam vepruar sipas vendimeve dhe qëndrimeve të shumicës së Rijasetit ku kanë aderuar edhe këta puçistë të padiskutueshëm. Në të gjitha veprimet e mia kam pasur përkrahjen e tyre, kam pasur përrurimet dhe përgëzimet e tyre, kam pasur duartrokitje prej tyre, kam pasur lavdëratat e gatishtëri që të vetëflijohen për mua, në të mirë të interesit të përgjithshëm dhe të Institucionit tonë në veçanti. Si u bë që, brenda ditës, brenda një paradite të “vetëdijësohen” disa vegla të shërbimeve të huaja, të tubohen në Gostivar dhe të më shkarkojnë sipas këtij Neni! Ata të gjithë kanë qenë krahu im i djathtë, në çdo veprim. Të shkarkohem unë sipas atij neni kurse këta të bëhen gati për të ma zënë postin, vështirë se do t’ju shkojë për dore”, shprehet H. Sulejman ef. Rexhepi

Në pyetjen tonë se pse dy ditë më vonë do të ofrojë edhe vetë dorëheqje, Reisul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi do të shprehet se, këtë hap e ndërmoi pas konsultave me persona mjaft të rëndësishëm të Partisë Bashkimi Demokratik për Integrim, Musa Xhaferi dhe Blerim Bexheti të cilëve u shpjegova se të gjithë mund të përfundojnë në burg për shkak të falsifikimit të atij “dokumenti” sipas të cilit gjoja më shkarkuan. Këta përfaqësues të Partisë më lutën që të ndërmarr diçka dhe ta bëj këtë gjë “fat

të kryer”, meqë ndodhemi në prag të zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare dhe, pasi të fitojë BDI-ja do ta marrë në dorë situatën e Bashkësisë Fetare Islame dhe se do të më rehatojnë edhe mua! Tani, nga ky takim i sotshëm, unë kërkoj publikisht që BDI-ja të ndërhyjë dhe ta pengojë këtë krim që po kryehet mbi Kushtetutën e BFI-së dhe mbi vetë Institucionin e myslimanëve të vendit. BDI-ja duhet ta ketë shumë të qartë se kjo çfarë po ndodhë për momentin brenda BFI-së është yndyrë e shërbimeve të huaja, në veçanti të shërbimeve ruso-serbe. Nuk mundet që shkelësit e Nenit 58 të më akuzojnë vetëm mua ndërsa vetë të bëjnë karrierë. Këtë karrierë ata mund ta bëjnë vetëm me lejen e BDI-së dhe më përkrahjen e shërbimeve intelgjente të huaja”, nënvizon efendi Rexhepi.

Po ashtu, Reisul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi apeloj te të gjithë myslimanët e vendit që ta pengojnë këtë masakër që po ushtrohet mbi Kushtetutën e BFI-së, ta pengojnë Shaqir Fetain dhe shokët e tij (Qani Nesimi, Qenan Ismaili, Shaban Sulejmani, Abedin Imeri etj.) që t’ua imponojnë porositë e shërbimeve të huaja duke ua caktuar për myftinj kuadrot të cilët as nuk kanë qenë të propozuar nga mexhlisi i xhemateve, as nga myftinitë dhe as të emëruar nga Rijaseti. Nuk mundet që njerëzit e shantazhuar të shndërrohen në “makinë votimi”, sepse ata nuk përfaqsojnë asnjë xhemat, asnjë organ, asnjë titull. Gjithësesi që tërë kjo lojë do të paditet dhe do të bllokohet nga organet e drejtësisë, sepse, pushteti aktual e ka shumë të vështirë që ta marrë mbi vete barrën e shndërrimit të BFI-në në një Institucion në duart e bashibuzukëve”, thotë efendi Rexhepi.

Në pyetjen se sa janë kredibilë personat aktualë që petendojnë të bëhen reisë, efendi Rexhepi nënvizon se i tërë procesi është jokredibil, antikushtetues dhe shumë i rrezikshëm, i cili do të krijojë praktika që turlifare kriminel, kur të ketë dëshirë e motive të dyshimta, të ngrisë iniciativë për t’u bërë “Reisul Ulema”! “Këta persona, si e para, kanë qenë bashkëpunëtorë të ngushtë dhe përkrahës me shpirt të personit që “paska shkelur Nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së”. Këta persona janë akuzuar si hajna, si antiislamistë e si antikombëtarë. Këta persona, fillimisht duhet që t’i demantojnë këto akuza, të demantojnë se kanë qenë bashkëpunëtorë të mi të cilëve u kam dhënë muralet dhe që më kanë përkrahur në “shkeljen e Nenit 58”! Pastaj, që të gjithë e dinë se këtyre personave u kam bërë revizion financiar dhe, saktësisht e dimë se sa kanë vjedhur dhe çka kanë bërë me paratë e myslimanëve. Nuk mundet që të më akuzojnë mua, të më shkarkojnë dhe me këtë të “pastrohen” nga unë duke hedhur kandidatura të veta për të ma rrëmbyer postin! Raportet nga ai revizion financiar i kam unë dhe, që të gjitha do të publikohen, një për një! Këta persona, nuk e plotësojnë kushtin kryesor – nuk dinë të lexojnë gjuhën e Kuranit e as ta flasin këtë gjuhë! Ky do të ishte një hendikep shumë i madh për perspektivën e Instituconit tonë, sepse, shumica e marrëveshjeve preferohen të bëhen jo në prezencë të shoqëruesve e përkthyesve, por direkt në gjuhën e Kuranit”, thotë H. Sulejman ef. Rexhepi.



“Kushtetuta e BFI-së nënvizon në mënyrë shumë precize se kush mund të japë interpretim autentik të Kushtetutës, me këtë Kushtetutë është i paraparë Prokurori i BFI-së, është Komisioni Disiplinor! Të gjitha këta organe anashkalohen, vijnë deri te “shkarkimi im”, sipas porosive të shërbimeve policore, kurse unë për hirë të interesit kombëtar, sepse këtë ma kërkoi vetë BDI-ja, pranova të viktimizohem dhe, në fund, na del se synimi paska qenë që ky Institucion të kalojë e të jetë nën kontroll të plotë të politikave të huaja, që nuk shprehin kurrfarë interesi, as fetar e as kombëtar! Nëse e tolerojnë këtë gjë myslimanët e vendit, me këtë kemi vulosur fundin e perspektivës sonë të lumtur. Edhe ndërkombëtarët duhet ta dinë këtë lojë të ndytë, sepse vetëm Një Zot e di se ç’ mund të bëjnë shërbimet e huaja në emër të Institucionit tonë! Tani, ja ku jemi, teologët e vendit kanë ngritur këtë Këshill dhe unë ju përgëzoj dhe ju përkah në këtë qëllim shumë fisnik dhe islam, që ka të bëjë me mbrojtjen e kushtetushmërisë së BFI-së. Ju priftë e mbara dhe paçit ndihmën dhe bekimin e të Madhi Zot”, përfundon Reisul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, në takimin informativ të organizuar nga Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetushmërisë së BFI-së, themeluar nga një numër i konsiderueshëm imamësh e teologësh të vendit, të cilët insistojnë që të shpalosen të gjitha problemet, të debatohet e të diskutohet me të gjithë aktorët dhe faktorët që mund të kontribuojnë në tejkalimin e kësaj sate me tendencë për t’u përshkallëzuar deri në atë nivel ku të gjithë do të dalim të turpëruar e të dëmtuar. Ne, si Këshill, kemi nënvizuar që në fillim se transparenca e veprimt tonë do të jetë moto kryesore dhe se, do të bëjmë përpjekje që të bashkëbisedojmë edhe me palët e tjera si brenda BFI-së ashtu edhe me subjektet politike e me intelektualë të ndryshëm, të vendit e ndërkombëtarë, me qëllim që të arrijmë deri te një situatë e denjë për një Institucion fetar islam.

*(Shqipmedia, 16.11.2020)*

## **Zgjedhjet në Bashkësinë Islame! Akuza për shkelje të Kushtetutës së institucionit**

Drejtnesit e rinj të Bashkësisë Fetare Islame, që e shkarkuan kryetarin Sulejman Rexhepi; dhe vetë erdhën në krye të këtij institucioni, aspak nuk e njohin Kushtetutën e BFI-së, pohon përpiluesi i Kushtetutës Afrim Tahiri.

“Brenda vetëm një javë ata mblidhen, pa asnjë vërejtje paraprake, pa komision disiplinor për të ia tërhequr vërejtjen Reisit, prokurori pa dhënë vlerësim në Rijaset, ata mbledhin Rijasetin. Me Kushtetutën e BFI-së, askush pos Reisit nuk ka të drejtë që ta mbledhë Rijasetin. Ata kanë bërë shkelje”, theksoi Afrim Tahiri – përpilues i Kushtetutës së BFI-së.

Tahiri thotë se posti “ushtrues detyre” nuk ekziston!

“Nëse e merrni Kushtetutën, askund nuk figuron posti “ushtrues detyre”, d.m.th nuk është kushtetues. Pra prej në start kemi gabim. Pastaj thuhet ushtrues detyre ‘caktohet’, në kushtetutë nuk njihet fjala caktim! Ka zgjedhje dhe emërim dhe jo caktim”, theksoi Afrim Tahiri.

Për gabimet e drejtnesve aktual, sipas Tahirit, Reis i BFI-së de fakto ende është Sulejman Rexhepi, sepse nuk është shkarkuar sipas procedurave që kërkon kushtetuta. “Nëse do të kishte ngritur iniciativë në gjykatë, 100% do ta kishte fituar lëndën”, potencoi Afrim Tahiri.

Tahiri thotë se Rijaseti aktual ka shkelur 17 nene. Ai po ashtu konteston edhe personat që kanë marrë pjesë në shkarkimin e Rexhepit, e që nuk janë legjitim për ta bërë këtë gjë. Për ta foli edhe vetë ish-kreu i BFI-së, Sulejman Rexhepi.

“Ata janë të gjithë tradhtarë. Të gjithë janë të lidhur me disa qendra të jashtme, disa vende të dyshimta, lidhje mercenare. Kush? Të gjithë këta që janë kandidatë”, deklaroi Sulejman Rexhepi – ish-kryetar i BFI-së.

Kërkuam qëndrim nga drejtnesit aktual të BFI-së, por tani për tani nuk morëm.

Sot në mesditë ka skaduar afati për dorëzimin e kandidaturave për zgjedhjen e Kryetarit të ri të BFI-së. Pas shqyrtimit të kandidaturave, është konfirmuar ajo e Shaqir Fetahut, ushtruesit të deritanishëm të detyrës së kryetarit dhe myftiut të Tetovës, Qani Nesimit. Kandidatura e imamet Muharrem Eminit nuk është konfirmuar për shkak të mospërmbushjes së kushteve. Zgjedhjet do të mbahen nesër në orën 10:30.

*(TV21M, 17.11.2020)*

## Defaktorizimi i BFI-së nga njerëzit e papërgjegjshëm

**(Disa fjalë rreth debatit televiziv në TV21, të zhvilluar në mes të reisul ulemasë Sulejman ef. Rexhepi, dhe ish-sekretarit gjeneral të BFI-së, Afrim ef. Tahirit)**

**Dr. Zeqie Veseli, Vijenë**

Mbrëmë, (16 nëntor 2020) opinioni i gjërë ka qenë dëshmitar i një tv debatit më të shikuar ndonjëherë në tv-të tona, i cili përçoi kulturë, klasë, edukatë e të vërteta të trishta nga të dy bashkëbiseduesit. Debatu u zhvillua në mes të dy “armiëve” të përbetuar: Sulejman Rexhepit dhe Afrim Tahirit.

Mbrëmë, u ulën heshtat në mes të dyve dhe e trajtuan një problem i cili për të dy personat është madhor dhe jetik për fatin e organizimit të jetës fetare islame në vend. Mbrëmë u demonstrua një kulturë e lartë e komunikimit, të dy “armiqtë” e patën një hall, një frikë për përpjekjet nëntokësore për shkatërrimin e BFI-së duke e dorëzuar në duar të dyshimta.

Afrim Tahiri dëshmoi se hall e ka mosrespektimin e akteve normative të Institucionit nga uzurpatorët dhe nga puçistët klasikë.

Afrim Tahiri i binte faktit që nuk ka institucion, nuk ka organizatë, nuk ka dikaster, nuk ka pushtet e shtet që mund të funksionojë pa u respektuar aktet normative. Efendi Tahiri në mënyrë kronologjike shpalosi të gjitha shkeljet që janë bërë që nga shkarkimi i tij prej pozitës sekretar gjeneral i BFI-së, që nga shkarkimi i Sulejman Rexhepit prej postit Kryetar i BFI-së e deri te përpjekjet për të emëruar një “reis” politik, që, sipas bashkëbiseduesit na vie direkt nga radhët e BDI-së.

Afrim Tahiri arriti që në mënyrë shumë profesionale të flasë mbi domosdoshmërinë e respektimit të Kushtetutës nëse dëshirojmë të kemi një BFI të shëndoshë, foli si një njohës i pakonstestueshëm i të gjitha akteve normative të BFI-së dhe të shkeljeve të tyre përgjatë procedurave dhe veprimeve të ndryshme që janë bërë dhe po bëhen në emër të islamit.

Afrim Tahirit nuk i interesonte nëse bëhet fjalë për “armikun” e tij Sulejman Rexhepin apo për dikë tjetër, ai, thjesht, në mënyrë shumë njerëzore shpjegoi edhe shkeljet e shumë neneve të Kushtetutës në shkarkimin e Sulejman Rexhepit, foli për veprat penale që janë kryer përgjatë këtij akti antikushtetues, duke shprehur habinë se prej nga kjo forcë, prej nga kjo gatishmëri e përkrahje për këtë destruktivitet kaq të fuqishëm të puçistëve klasikë që po mundohen ta rrëmbejnë BFI-në.

Këtë problem, nga ana tjetër, e shpjegoi në mënyrë shumë të qartë Sulejman ef. Rexhepi. Pa kurrfarë hipoteke, madje ai përmendi edhe emra konkretë se kush e zbrapsi nga intervenimi për mbrojtjen e Kushtetushmërisë së BFI-së dhe kush e solli deri në këtë derexhe katastrofale këtë Institucion.

Sulejman Rexhepi disa herë theksoi se si votues dhe simpatizant i BDI-së që më vitin 2002, si përkrahës e kontribues i ndryshëm për këtë Parti, nuk e ka merituar këtë lojë kaq poshtëruese për të, që, sipas tij, i erdhi nga BDI-ja, konkretisht nga funksionarë të lartë të kësaj Partie, Musa Xhaferi e Blerim Bexheti, dy miqtë e tij që, siç thoshte Sulejman Rexhepi i ka konsideruar si pjesëtarë të familjes së tij të ngushtë, si vëllezër. Përfundimisht, sipas bashkëbiseduesve, në këtë debat televiziv doli se, BDI-ja, udhëheqësit e saj, janë promovues, përkrahës dhe frymëzues të shkeljeve kushtetutare

në BFI dhe në përpjekjet përfundimtare për ta kapur këtë Institucion kaq jetik për myslimanët e vendit. Falë veglave të shërbimeve të huaja, kësaj ia arritën, por, ngeli i paqartë dhe e pazbardhur arsye e kësaj përpjekje nga ana e BFI-së.

Çka i duhet BDI-së që ta kap këtë Institucion dhe ta dorëzojë në duart e udbashëve?!

*(Kombetare, 17.11.2020)*

## Dështimi i një akademiku

**Sot muslimanët e vendit qenë dëshmitarë të një farse zgjedhore e cila më tepër pati për qëllim për ta nëpërkëmbur dhe poshtëruar integritetin dhe dinjitetin e paprekshëm të BFI-së. U zhvilluan garat për Kryetar të BFI-së nën kushte kriminale, duke u shkelur më së paku 17 nene të Kushtetutës së BFI-së**

**Nga Meriton Saliu**

Sot, në BFI u zhvilluan zgjedhjet aspakt të ndershme për kryetar të BFI-së për të cilin post kishin konkurruar dy Myftinjë, ai i Tetovës, Dr. Qani Nesimi dhe, ai i Gostivarit, Shaqir Fetai. Fitoi ky i fundit, me rezultat 18 me 3, ndonëse nuk kishte të drejtë as ligjore dhe as me Kushtetutë që të kandidohet e të konkurrojë, sepse, ishte në ushtrim të postit fiktiv “ushtrues detyre”, sepse kjo paraqet konflikt të pastër interesi.

U ngrit krejt “bota akademike”, së fundmi edhe dekanati i Fakultetit Filozofik pranë UT-së që ta përkrah profesor Qani Nesimin, i cili na paska qenë alamet shkencëtari, shkrimtari dhe pjesëmarrës në shumë tribuna shkencore të vendit dhe në ato ndërkombëtar. U shkruan dhjetra shkrime rekomanduese sa për njërin, sa për tjetrin kandidat, thuase lufta ishte drejtuar në tërheqje të votave të qytetarëve myslimanë. U zhvillua një fushatë mediale e turpshme.

Në fund, u turpërua Prof. dr. Qani Nesimi, me një institucion arsimor shtetëror dhe me një dyzinë intelektualë prapa vetes por, megjithatë e fitoi Shaqir Fetai i stigmatizuar si bashkëpunëtorë i hershëm i UDB-së.

Prof. Dr. Qani Nesimi u turpërua me këtë humbje të kurditur nga kolegu i tij, sepse nuk deshti të dëgjojë! Sikur vetëm pak ta dëgjonte ish-sekretarin gjeneral të BFI-së, z. Afrim Tahirin, sikur vetëm pak të vetëdijësohej nga ai tv-debat dhe të pranonte se qenka futur në një garë ku qenkan shkelur shumë nene kushtetutare dhe shumë akte normative të BFI-së, ai nuk do të turpërohej, por do të dilte i nderuar, duke abstenuar nga një garë antikushtetutare dhe duke kërkuar një proces zgjedhor kredibil. Një orë e gjysëm foli Afrim Tahiri duke shpjeguar se si duhet të zhvillohen zgjedhjet për kreun e BFI-së, se sa shkelje janë bërë, se si po përgatiten zgjedhje jofër, të pandershme dhe antiligjore, ndërsa akademiku vendosi që ta dëgjojë intuitën e vet, vendosi që t’i ketë parasyshë “letrat rekomanduese” të do anonimëve dhe, u fut në një garë e cila për të ishte si për një antinotar që i futet not oqeanit. “Bota e tij” akademike, doli sa qesharake aq edhe injorante! Menduakan se Reisi zgjidhet nga dekanati e nga preferencat e “intelektualeve” të fakultetit i cili është përplotë me analfabetë. Nëse do të ishin pak normalë me tru, nuk do të përziheshin në këto zgjedhje, sepse, paramendoni sikur hoxhallarët të këmbëngulin se kush të bëhet dekan i Fakultetit, madje në një palë zgjedhje antiligjore.

Afrim Tahiri nuk foli në tv-debat për vetëveten, nuk kërkoi që të kandidohet apo të votohet, por, sinjalizoi në një lojë të rrezikshme, në një lojë të pandershme, antimorale e antiligjore në të cilën një akademik i mirëfilltë nuk do të guxonte të futej.

Tani, akademiku i ka djegur të gjitha letrat e ankesave, nuk ka të drejtë të ankohet as për zgjedhje të parregullta, as se ishin antikushtetutare dhe as se ishin të padrejta sepse nga ana e Shaqir Fetait kishte konflikt interesi. Nuk ka të drejtë të ankohet, sepse me vetë pjesëmarrjen e Qani Nesimit në garë, në fakt ai i legjitimoi të gjitha shkeljet kushtetutare si dhe tërë procesin zgjedhor antiligjor. Akademiku në fjalë vetëm sa e ndihmoi injorantin që të bëhet Kryetar i BFI-së, qoftë kjo edhe për disa ditë!

*(Kombetare, 18.11.2020)*

## **Myslmanët e vendit ndjehen të braktisur nga “reisi” i falcifikuar**

**Bota e di se kush është Shaqir Fetaj, ky farë “reisi i falcifikuar”, kështu që, mirësjellja e botës, qoftë edhe përmes urimeve dhe përshëndetjeve, nuk është se e justifikon falcifikatorin. Thjesht, nëse mileti e pranon, bota e uron, por kjo uratë nuk e zbeh informacionin mbi falcifikatin konkret, i cili, përjetë i ngelë falcifikatorit në qafë si medalion i ndryshkur e i vjedhur katakombeve të lashta**

**Nga Sabit Ibrahim**

Një banor, i ri, i sapodiplomuar, pas disa viteve studime islamike, kthehet në vendlindje. Pasi u çmall me pjesëtarët e familjes, vendosi të dalë e të përshëndetet me gjithë katundin. E ku do të gjente vend më të përshatshëm se në xhami, në prag të faljes apo pas faljes së namazit. Qëlloi ditë e xhuma, edhe më mirë. Imami i xhamisë ishte paksa në moshë, me mjekër të gjatë e me flokë të bollshme e të thinjur që i kishin dalur nga çallma. I shkolluari e dëgjoi hutben, të cilin imami i xhamisë çuditërisht kësaj radhe e zgjati, ndonëse me një drithërimë të paparë më herët të zërit. Pasi u fal namazi, i riu u ngrit në këmbë dhe ia plasi në fytyrë:

Kisha vendosur që të përshendetem me të gjithë ju, duke filluar nga imami por, me këtë vaz që dëgjova, me këtë heshtje totale që mbretëroi deri sa fliste imami, në fakt të gjithë ju e miratuat vazin e imamit dhe, në njëfarë forme u futët në dalalet. Imamit t’i vie turp sepse, në ligjeratën e tij vetëm islam nuk pati, kurse ju që e dëgjuat me heshtje e me sy të përplotur, dëshmuat se nuk jeni në rrugë të mbarë!

U iritua masa dhe, të pezmatuar sa më s’ka, të gjithë iu turrën imamit të vjetër të xhamisë dhe, kush grushta, kush shqelma, e bënë për lëkurë dashi imamin. Unanimisht vendosën që, pa e pyetur askend, për imam ta caktojnë studentin e sapodiplomuar që e bëri këtë “revolucion” në xhami.

Pas një javë shërbime, imami i ri, i shkolluari, e vërejti që nuk do të mund ta shtyjej më gjatë, e vërejti që nuk mund ta zgjasë me kërkesat e përditshme të xhematit, i dukej se lodhej shumë, i dukej se po vdes për gjumë, sepse namazi i sabahut falej herët, namazi i jasisë falej shumë vonë, pas namazit ia krisnin bisedës, xhemati kërkonte të dijë më shumë, filluan të kërkojnë që t’ua shkollojë edhe fëmijët. U bë shumë e lodhshme. Në xhumanë e radhës, e pa në mes të xhamisë imamin e vjetër, i enjtur akoma e i maviosur fytyrës, kishte ardhur të falë xhumanë. Të riut iu kujtua dhe me një zë kumbus iu drejtua xhematit:

Vëllezër, a e shihni këtë mysliman këtu në mes, këtë ndriçues të mendjes sonë, këtë person që ua ka falur deri dje të gjithë namazet dhe ju ka prirë në rrugën e Zotit! Mbrëmë pashë një ëndërr, mbi kokë më zbritën tri melaqe dhe, njëra prej tyre më foli shumë gjatë për të. Unë po i bie shkurtë: duhet të merrni sa më parë hallallëk prej tij, sepse, ai, jo vetëm që na qenka njeri i shejtë por, edhe çdo qime të mjekrës, çdo fije të flokut ai e paska të shenjtë. Qenka një lloj evliaje për katundin tonë.

Pa një pa dy, xhemati u ngrit rrëmbimthi dhe, të gjithë u turrën kah imami i vjetër që t'i kërkojnë hallallëk dhe, në përshëndetje e sipër, të gjithë nisën t'ia shkulin, kush një qime, kush dy, kush një grusht qimesh nga mjekra, pastaj edhe qimet e kokës dhe, për dy-tre minuta, njeriun e bënë tullac. Nga tortura imami plak u çmend, kurse, imami i ri iku. Kurrë nuk u pa më. Thonë që u kthye në vendin ku kishte studiuar dhe ku e kishin mësuar që të bëjë ndryshime në mesin nga vjen dhe popullatën atje ta bëjë sa më terbiqe.

Ky rrëfim, me tërë porosinë e vet, i dedikohet Shaqir Fetait, të vetëshpallurit kryetar i BFI-së, apo të zgjedhurit “reis i falcifikuar” i BFI-së! I vetmi “reis” që i shkoi ndoresh të zgjidhet dy herë brenda gjashtë muajve! Çka fletë kjo?

Për momentin kemi një reis që privacinë e ndanë me opinionin e gjërë botëror, dhe, të gjithë druajnë se tani i ka ngelur që me këtë opinion ta ndajë edhe intimën e vet. Urimet dhe përshëndetjet, sado oficiale, janë gjë private që mund t'i ruash në një dosje personale, në shtëpi!

Futet njeriu tek nobelistët, futet njeriu tek faqet e kryetarëve të shteteve, tek Xho Bajdeni, futet njeriu te faqa zyrtare e OBSH, UNDP, te OSBE, te NATO, futet njeriu në faqet e gjenive të kohës, tek zbuluesit e risive, e deri te biografitë e të mëdhenjëve, por edhe te ato të Pejgamberëve! Askund nuk e hasë “praktikën” e turpshme të Shaqir Fetait. Publikimin e urimeve dhe përshëndetjeve, vizitat e kota e krejt të parëndësishme, politikat e jargosura e servile dhe shumë fyese të personave pa kurrfarë personaliteti! Nuk publikohen sepse nuk janë të arritura, nuk janë aktivitete, as informacione që duhet të ndahet me të tjerët. Kështu si ia ka nisur Shaqir Fetai nuk është çudi që shumë shpejtë të na informojë se, djali i tezes së shokut të fëmijërisë, i ka thënë djalit të hallës së komshiut të kushëririt të parë, që t'i bëjë të fala Shaqir Fetait.

Kjo “praktikë e turpshme” e Shaqir Fetait nuk është për opinion, sepse nuk e gjenë askund, në asnjë organizatë botërore, në asnjë faqe të personaliteteve me peshë botërore, që drejtojnë me botën e me fate të njerëzimit. Shaqir Fetai e torturon botën me informacione të tipit më idiotik “sot zgjedha shefin e ri të kabinetit”!

A ka ndonjë njeri në botë që mund ta mësojë Shaqir Fetain si të silllet, t'ia mësojë njerëzillëkun dhe protokolin e Institucionit i cili nuk konsiston vetëm në mbajtje të maskës, distancë dhe higjienë personale. Sepse, me gjasë, Shaqir Fetai nuk njeh protokoll tjetër, mbase për herë të parë me këtë nocion përballet tani, në kohë pandemie. Protokoli i Institucionit do të thotë, veç tjerash, të mësuarit: si të buzëqeshë, si të ulet, si të rrijë në këmbë, si të marrë pozë fotografimi, si të ecë, si të silllet, si të mendojë, ta mësojë bontonin e përgjithshëm, metodologjinë e veprimit, si t'i qasemi punëve, si të arrihen sukseset, si të mburremi, si të shprehim dhembje, si ta shprehim trishtimin, nervozën, dashurinë. Pra, protokoli është një gërshetim i edukatës dhe kulturës, metodikës dhe logjikës, filozofisë dhe konkretes. Protokoli është një akademi më vete për të cilën Shaqir Fetai kurrë nuk ka dëgjuar dhe jo më të jetë brenda saj!

Shaqir Fetai para gjashtë muajve e alarmoi krejt botën se u zgjedh kryetar e Reisul Ulema i BFI-së! Nën këtë mashtrim kaq eklatant, duke qenë e bindur bota se gënjeshtria nuk do të arrinte aq lartë, të gjithë ia uruan këtë “zgjedhje”. Tani, pas gjashtë muajve, po kjo “botë” sërish ia uron Shaqir Fetait zgjedhjen për kryetar e reis i BFI-së. Kur u vu bota në lajthitje: tani apo edhe para gjashtë muajve?! Kur e pati të saktë urimin “bota”, tani apo para gjashtë muajve? Kur gënjeu Shaqir Fetai, tani apo para gjashtë muajve!? Bota nuk do ta kuptonte këtë marri të Shaqir Fetait sikur ky mos të merrej gjashtë muaj duke i dhënë peshë dhe rëndësi vetes, duke ia kërkuar botës me zor që t'i shprehin respekt! Tani, të njëjtën gjë, edhe për nja gjashtë muaj të tjerë do ta hasim te Shaqir Fetai: ma uroi ky e ai, më paraqiti kënaqësi të veçantë ky urim e kjo vizitë, përjetova diçka si orgazëm nga kjo vizitë madhështore e nga shprehja e gatishmërisë për bashkëpunimi me mua...



Myslmanët e vendit, jo që u ndjenë të poshtruar, të fyer, të turpëruar por, tani po ndjehen edhe të braktisur nga “reisi i falcifikuar”, sepse, ky po merret me “imazhin” e vet. A mund të na thotë Shaqir Fetai se pse e ka këtë nevojë që të merret me imazhin e vet, çka në të vërtetë fshihet pas Shaqirit të vërtetë, pse kjo “strategji e sëmurë” për të dëshmuar se Shaqir Fetai adhurohet dhe duhet prej të gjithëve, nuk urrehet, sepse nuk ka bërë asgjë të keqe në jetë! Pse kjo dëshirë për t’u rrëfyer si njeri i mirë dhe jo i keq! Do me thënë se ekzistojnë dy lloj Shaqir Fetai: ky i miri dhe, eventualisht ndonjë i keq që ka marrur më qafë një katund, një qytet e një milet të tërë!

Bota e di se kush është Shaqir Fetai, ky farë “reisi i falcifikuar”, kështu që, mirësjellja e botës, qoftë edhe përmes urimeve dhe përsëndetjeve, nuk është se e justifikon falcifikatorin. Thjesht, nëse mileti e pranon, bota e uron, por kjo uratë nuk e zbeh informacionin mbi falcifikatin konkret, i cili, përjetë i ngelë falcifikatorit në qafë si medalion i ndryshkur e i vjedhur katakombeve të lashta!

Krejt bota e di se si u falcifikua Shaqir Fetai në krye të BFI-së. E di edhe vetë Shaqir Fetai, madje është shumë i vetëdëshëm. Erdhi në krye duke shkelur Kushtetutën e BFI-së, ndaj është shumë i vetëdëshëm se nuk do ta gëzojë gjatë “prestizhin”! Ai shumë shpejt, për interesin personal, absolutisht, meskin, do të duhet të kthehet aty ku ka shkelur Kushtetutën dhe të nisë të korrigjojë shkeljet. Një për një e deri te shkelja epike në kandidimin e vet për kryetar në ndërkohë që ai ishte “zgjedhur njëherë kryetar” (këtë e dëshmojnë qindra urime e vizita që i publikoi para gjashtë muajve)! Ai duhet të çlirohet nga të gjithë shkelësit e Kushtetutës, ndërsa Kushtetuta duhet të çlirohet nga të gjithë shkelësit e vet!

A mos do t’i ndodhë edhe Shaqir Fetait e njëjta gjë që i ndodhi personazhit të rrëfimit në krye të këtij teksti?!

*(Fol, 25.11.2020)*

## **Vetëm debatet dhe ballafaqimi i argumentave i jep fund gënjeshtërisë dhe manipulimeve publike**

**Duke pasur një konsideratë të thellë për të gjithë mediat e, në veçanti për mediat vizive në vend, Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së Bashkësisë Fetare Islame në RMV, apelon për një bashkëpunim sa më gjithëpërfshirës, me qëllim që ta ruajmë misionin e shenjtë të mediave tona – drejtinformimi**

### ***Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së***

Mediat tona, mbase, duke u nisur nga domosdoshmëria e respektimit të autoritetit, qoftë të një personi apo edhe të një institucioni, nganjëherë po bien pre e kësaj “edukate” dhe, po anojnë pa dashje e pa kurrfarë strategjie paraprake, kah përhapja e informacionit të rrejshëm dhe kah synimet e errëta për ta dëmtuar autoritetin!

Prandaj Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së i fton të gjithë mediat e vendit, në veçanti ato vizivet që, të japin kontributin në shpalosjen e së vërtetës, në shpalosjen e problemeve me të cilat tash e sa kohë po ndeshet Institucioni i BFI-së. Debatet televizive, ballafaqimi i fakteve, shpalosja e së vërtetës edhe të aktorëve të tjerë me mendim opozitar por edhe të atyreve që mbrojnë doktrinën konstitucionaliste të domosdoshëm për një Institucion të mirëfilltë, janë kontribute jetike për ta dëshmuar, së pari, profesionalizimin e medias vizive, dhe, mbi të gjitha, drejtinformimin.

Ne, si Këshill i Mbrojtjes së Kushtetutshmërisë së BFI-së, si trup vullnetar i inicuar dhe themeluar nga një numër relativisht i madh i imamëve dhe teologëve të vendit, kemi mbledhur fakte e informacione për shkelje flagrante të Kushtetutës së BFI-së nga “udhëheqësia aktuale” e këtij Institucioni, për veprime të përditshme antikushtetutare, për aktivitete imagjinare e sporadike, që çojnë ujin në mulli të huaj. Nuk e besojmë se mediat tona aq lehtë mund ta gëlltisnin kriminalizimin e këtij Institucioni! Me publikimin e informacioneve të njëanshme, të paketuara sipas dëshirës së shkelësve të Kushtetutës së BFI-së, nuk e besojmë se përmbushet misioni i shenjtë i mediave tona vizive.

Prandaj, Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së, apelon deri te medat vizive të vendit që, të bëjnë ç’mos që të dëgjohet edhe pala tjetër e cila ka qindra fakte e argumenta se BFI-ja si Institucion, nuk është në udhën e duhur. I ftojme të gjitha mediat nacionale dhe ato lokale që ta japin kontributin e vet kombëtar e fetar në rimëkëmbjen e këtij Institucioni fetar, i cili, për momentin po vuan nga mosnjohja e Kushtetutës së BFI-së, nga lakmia e sëmurë për shkelje kushtetutare si dhe për veprime jashtë të gjitha akteve normative të BFI-së. Kjo dukuri e rëndë mund të zbutet dhe të eliminohet fare, vetëm duke i dhënë fund prezantimit të personave me mentalitet demagogu si dhe matrapazëve që mendojnë se Institucioni dhe gjithçka tjetër, përfshirë edhe mediat, duhet të vegjetojnë rreth tyre. Gjithnjë ekziston edhe ana tjetër e medaljes. Jashtë kësaj logjike gjithçka është false, pra, e kriminalizuar!

Mediat e vendit duhet të kuptojnë se, të gjithë ata që i ikin debatit dhe përballjes së argumentave,

në fakt janë manipulatorë që mundohen ta keqpërdorin median për ta shitur “të vërtetën” e tyre të paketuar sipas strategjisë së brumosur guzhinave të huaja. Shpresojmë dhe lutemi për mirëkuptim!

*(Fol, 25.11.2020)*

## Fillet e korrupsionit të Shaqir Fetait

**Çfarëdo brengje, çfarëdo trishtimi apo shqetësimi, çfarëdo gëzimi apo lumturie që shpërthen nga Shaqir Fetai, duhet kuptuar vetëm si emocion i demagogut, i cili, që të gjitha i ka me hile. Shaqir Fetai tashmë është dëshmuar, me vullë e me nënshkrim se, është i ligë, se është i keq, sepse është zgjidhje e imponuar nga strukturat antiislamike e anti-BFI**

### Shkruan Sabit Ibrahim

Dy gënjeshtër të mëdha, që, për nga përmasat prekin tokë e qiell, e që i përdor Shaqir Fetai nëpër monologje televizive, janë: financiarisht BFI-në e gjeta të dërmuar, me mjete financiare për vetëm një muaj rrogë dhe, e gjeta me një administratë që shpërndante dokumente arkivore anekënd botës! Tani, sipas Shaqir Fetait, paska bërë para mjaftueshëm, dmth paska dalur nga kriza financiare dhe, paska bërë “reforma rrënjësore” në administratë. Në këtë shkrim do ta bindim se po rrenë dhe se rrencak më të pacipë nuk gjenë dot njeriu në këtë fytyrë të tokës!

Shaqir Fetai nuk e gjeti në krizë financiare BFI-në, por, Shaqir Fetai e shkaktoi krizën financiare, është pjesë e asaj strukture për të cilën Lëvizja më se gjashtë vite ka sinjalizuar se në BFI (në të gjitha organet e saj) po vidhet, po keqpërdoret fitri, zeqati, paratë e haxhit e të kurbanit, se nuk po raportohet dhe as që po kërkohet raporte, se BFI është shndërruar në një bahçe të madhe e pa zot ku hajnat ladrojnë siç ua do e zeza zemër! Shaqir Fetai me marifetet e tij antiislame i dehoi arabët nga Gostivari ku ishin të gatshëm të ndërtojnë vakëf në vlerë prej 9 milion dollareve; ai është praktikisht, kontribuesi më i madh i shkakimit të kësaj krize, të cilën sot e përdor si alibi për “rrebelim” kundër “babait të vet shpirtëror”, H. Sulejman Rexhepit.

Po si e paska tejkaluar tani këtë krizë? Nga i erdhën paratë? Kujt ia nguli, apo, janë paratë e akumuluar nga letrat me vlerë si dëmshpërblim nga qeveria për pronat e padenacionalizuara? Nëse janë letra me vlerë, Shaqir Fetai bën një veprim antiislamik nëse atë kompensim financiar të vakëfit të pakthyer e bën rrush e kumbulla për rroga. Ato para janë për ta shtuar vakëfin dhe jo për ta rehatuar Shaqir Fetain si reis i falsifikuar.

Shaqir Fetai paska bërë reforma administrative?! Kujt ia tregon këtë rrenë ai, a! Në administratën e BFI-së, gjegjësisht, të Rijasetit, janë të punësuar nja 12-13 vetë. Që të gjithë janë në punë! Por, nejtë, çka nënkupton Shaqir Fetai me “reforma në administratë” përveç improvizimit të lirisë për shkelje të rënda kushtetutare, deri në falsifikim të vetë pozitës së tij!

Po, ka bërë nja dy-tre ndërrime të vendeve të punës, veprim ky që flet për pazarllëqe të pista dhe për fillet e korrupsionit të thellë të Shaqir Fetait. Shaqir Fetai paska “themeluar” një sektor, për bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar (me BE, OSBE, me NATO-n), kuptohen në kundërshtim me Kushtetutën, sistematizimin e punës, të cilin sektor ia ka besuar Mustafa Dautit, njeriut më të pabesuar ndër myslimanët e vendit dhe ndër qarqet ndërkombëtare! Sepse, edhe zogjtë e Amazonës tashmë e dinë se çfarë vjedhesh të ndyta ka bërë derisa ishte në krye të OH HILAL, madje vjedhjet i ka kryer në emër të islamit e të humanitetit. Në vend të tij caktoi një tjetër edhe më të rëndë për nga veprat devijante, “anëtarin e rijasetit shkarkues” (kurrë pa qenë anëtarë!!!), qefliun e bastoreve, Fadil Ramadanin. Për këtë “reformë” të turpshme të Shaqir Fetait do të flasim një herë tjetër.

Le të ndalemi te “pika politike kontaktuese”, Mustafa Dauti! Sipas Kushtetutës së BFI-së zhvillimi i politikave të larta dhe prezantimi i tyre para opinionit, para faktorit relevant të vendit dhe atij ndërkombëtar, është obligim dhe detyrë ekskluzivisht e Reisul Ulemasë, i cili, mbase edhe herë pas here do të caktojë donjë këshilltarë të vetin për të prezantuar në ndonjë takim ku do t’i prezantojë qëndrimet e Rijasetit. Të keshë një “ministër të punëve të jashtme” në BFI do të thotë ta relativizoshë peshën e paretativizuar të Reisit. Këtë mund ta lejojë vetëm Shaqir Fetai, mbase nga frika se të huajt mund ta refuzojnë, meqë tashmë u dokumentua se ka qenë alet i Stanko Dragoviqit, oficer i UDB-së në Sarajevë, më vonë bashkëpunor i Temelko Boshkovskit, sipas porosive nga lart!

“Ministri i punëve të jashtme” i Shaqir Fetait, Mustafa Dauti, është njëri prej zhatësve kryesorë, njëri prej matrapazëve te paparë dhe njeri prej hajnave të pashpirt të BFI-së. Shaqir Fetai, pa dyshim që ka dorëzuar kontributin financiar të Myftinisë së Gostivarit në Rijaset, siç kanë dorëzuar edhe myftinitë e tjera! Dhe, kur e pushtoi falë përkrahjes politike dhe të pushtetit, u trondit kur gjeti financa vetëm sa për një rrogë të të punësuarve! Ku ngelën paratë?! Një prej hajnave më të mëdhenj të atyre parave dhe të aksioneve humanitare në mbledhje të ndihmave financiare për vëllezërit tanë në raste të ndryshme humanitare, ka qenë pikërisht Mustafa Dauti, i cili shënon “reformën e suksesshme administrative” të Shaqir Fetait!

A e ka pyetur Shaqir Fetai “ministrin e vet”, Mustafa Dautin se, prej nga tërë ajo pasuri e paimagjueshme për një administrator të Rijasetit të bëhet pronë e tij! Prej nga Mustafa Dauti vetura aq të shtrenjta, në vlerë mbi 300 mij euro! A e ka pyetur hajnin e përgëdhelur, Mustafa Dautin, prej nga arriti të bëhet pronarë i aq shumë çertifikatave të pronësive, të cilat, një i punësuar në BFI, me rrogën e vet, vetëm mund t’i ëndërrojë!

Le ta pyes Shaqir Fetai, “ministrin e vet të punëve të jashtme”, Mustafa Dautin se, si u bë pronar i:

- çertifikatës së pronësisë me numër 83667, sipas marrëveshjes për shitblerje të pronës së patundshme me numër 69/2018, të datës 6. 03. të vitit 2018, diku kah Sitimalli në Karposh;
- a është i rastësishëm emri i Mustafa Dautit në çertifikatën e pronësisë me numër 52987;
- ja, edhe një herë emri i Mustafa Dautit në çertifikatën e pronësisë me numër 83448;
- Mustafa Dauti është edhe pronar i çertifikatës së pronësisë me numër 92649;
- në Kapishtec Mustafa Dauti na del pronar i patundshmërisë me çertifikatë pronësie numër 9243;
- po ashtu, Mustafa Dauti na del edhe pronar i çertifikatës së pronësisë me numër 59452, të pasurisë së patundshme me numër 756/2019, nga data 22. 05. 2019;
- Mustafë Dauti na del edhe pronar i çertifikatës së pronësisë me numër 58518;
- në çertifikatën e pronësisë me numër 83667 na del pronar i patundshmërisë Mustafa Dauti;
- në çertifikatën e pronësisë me numër 93575, pronare e patundshmërisë na del bashkëshortja e Mustafa Dautit, Mynever Dauti, e punësuar gjithashtu në BFI.

Pra, Shaqir Fetai duhet ta konfiskojë këtë pasuri të arritur në mënyrë të paligjshme dhe duke e dëmtuar vakëfin e BFI-së dhe jo ta dëmtojë edhe më shumë duke shitur vakëf me qëllim që t’ia sigurojë rrogën Mustafa Dautit dhe sojtit të tij.

Mosreagimi i Shaqir Fetait do të thotë edhe korrupsion, qoftë ky pasiv apo edhe aktiv! Mund të thotë edhe “mundësi ideale” për të pasur një “këshilltarë” për zhatje dhe pasurim të paligjshëm që “fare lehtë” legalizohet! Apo edhe “kapital” për shantazhim të atyreve me të cilët ka bashkëpunuar ngushtë Mustafa Dauti! Reformë interesante administrative, ë?! Tipike “reformë” sipas recetave të shërbimeve të ndryshme intelegjente antiislame.

Pa dyshim, reformat administrative kaq shumë të nënvizuara nga Shaqir Fetai do të arrihen duke u detyruar Shaqua në kthim kah kushtetushmëria e BFI-së. Me këtë rast do t’i përmirësojë të gjitha

shkeljet, duke i rikthyer sërish “myftinjtë” në kordinatorë dhe duke i emëruar myftinjtë në bazë të rregullores për zgjedhje të myftinjëve. Këta që u zgjodhën me shkelje kushtetutare, pa dyshim që do të eliminohen që të gjithë, sepse votuan një të paligjshëm si puna e Shaqir Fetait, i cili do t’i eliminojë me qëllim që mos të shantazhohet asnjëherë prej tyre. Të gjithë do t’i ngulë, përfshirë edhe Mustafa Dautin, sepse ky është një projekt i njohur vetëm për Shaqir Fetain, i hartuar nga punëdhënësit e Shaquas!

**P.S.**

Meqë ra fjala për Mustafa Dautin, “ministrin e punëve të jashtme” të Shaqir Fetait, çka kërkon ky të takohet me ”rivalin” e përjetshëm të Shaqir Fetait për postin e reisit, Skënder Buzakun, dhe me spiunin e pondlaftë e të shpupluar të Sulejman Rexhepit, Ismet Bitiçin. Gjatë këtij takimi të realizuar këto ditë në një nga restoratët e Çairit u bë edhe këmbimi i disa letrave (dokumenteve)! Pritni afëra të reja!

*(Politesa, 26.11.2020)*

## Nga sot hipokrizia do të quhet Shaqir Feta

Do “alima” të mëdhenj, do “fetfaxhinj” cukla-cukla, do “sheriatlinjë” që shesin dinin në këmbim të një epiteti eksitues, do profesora që lejojnë t’u fëlliqet intelekti duke u futur vullnetarisht deri në maje të hundës në fëlliqësirë, sot e kryen detyrën e vet duke u vënë në shërbim të djallit, duke u tallur me mësimet kuranore e me traditën e Pejgamberit a.s., duke u tallur me akte normative që mbështeten në këto Mësime e në këtë Traditë

### *Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI*

Sot, që të gjithë, me përjashtime të mëdha, u lëshuan në veshjen e shejtanit me mini- fustan, vetëm për të na e zbukuruar e për të na e ndjellë epshin, lakminë, smirën! Elhamdulillah, askuj nuk i bëri përshtypje ky akt putan, kurse të devotshmit u irrituan jashtëzakonisht shumë nga lakejtë dhe jargaxhinjë që për një kockë këlyshi dinë edhe të servilosën.

Sot u munduan të na e zyrtarizojnë për Reis, Shaqir Fetain, i cili, absolutisht nuk është zgjedhje e shumicës myslimane të vendit por është produkt i aktiviteve të shërbimeve intelgjente të huaja për islamin, produkt i dofarë Stankove e Boshkove!

Që nga 27 maji i këtij viti e deri më sot, Shaqir Fetai në çdo sekond të Zotit ka shkelur Kushtetutën e BFI-së si dhe aktet e tjera normative të këtij Institucioni, ka lejuar të shkilen këto akte normative, ka frymuar me këto shkelje, ka hyrë në namaz me këto shkelje të Kushtetutës së BFI-së, e cila që në Preambulë, për moto veprimi ka vënë ajetin kuranor në shenjë betimi se me këtë Kushtetutë do të veprohet ashtu siç porositi Allahu xh.sh.: **“...Për çdo (ummet) Ne caktuam ligj e program...”** (El-Maide, 48).

Shaqir Fetai në historinë e BFI-së do të ngelë si sinonim i shkeljeve flagrante të Kushtetutës së BFI-së, do të ngelë si i vetmi mysliman i diskutueshëm që e këmbëu emrin e vet me fjalën hipokrit, do të ngelë si i vetmi “reis” që erdhi i përkratur nga forcat politike që nuk kanë asnjë pikë të përbashkët me islamin.

Shaqir Fetai, pa asnjë dyshim, po na del se do të jetë “reis” i LSDM-së dhe myteveli i BDI-së!

Shaqir Fetai, ndonëse është dëshmuar edhe publikisht se është shkelës i pamëshirshëm i Kushtetutës së BFI-së, u tolerua nga strukturat e drejtësisë dhe u ndihmua nga pushteti që të bëhet reis i cili do të rrenohet nga pesha e hijes së politikës.

Të gjithëve u erdhi pështirë kur Shaqir Fetai u betua se nuk do ta shkelë Kushtetutën e BFI-së si dhe aktet e tjera të BFI-së, ndërsa është dëshmuar si injoranti më i madh në vend që nuk ka lidhje dhe nuk e njeh fare këtë Kushtetutë.

Dhe ata (ai), njëfarë ish-myftiu, njëfarë njohësi i mirë i drejtësisë islame, e cila na e mëson në mënyrë decide se si të sillemi me shkelësit e “ligjeve dhe programeve” (El- Maide, 48), ia bën duanë, i lutet Zotit që t’i japë suksese të ligut në punën e tij si reis!!! E ku është i mirë dhe i suksesshëm Shaqir Fetai përveçse në shkeljen e Kushtetutës dhe të akteve normative të BFI-së që bazohen në Kuran dhe në Traditën e Pejgamberit a.s.? Në këtë punë të djallëzuar ai është treguar shumë i suksesshëm dhe kjo nuk na habit.

Habit fakti se si “shariatlinjtë” e Shaqos luten që në këto shkelje ta ndihmojë Zoti Shaqir Fetain! Fatmirësisht, ekzistojnë edhe shumë ajete, shumë hadithe, mijëra përvoja islame që dëshmojnë se shejtanllëqet dhe injorancën Zoti Fuqplotë kurrë nuk e ka ndihmuar dhe nuk e ka shpërblyer me asnjë sukses, përveçse me dështime, me humbje, me zhdukje deri në shfarosje.

*(Fol, 26.11.2020)*



## **Farsa e radhës e “reisit” të falsifikuar**

Sot u kurorezua tërë veprimtaria antikushtetutare e cila tash e sa kohë po zhvillohet në emër të islamit në vendin tonë. Fatkeqësisht, kësaj farse i dhanë dozë legalizimi anëtarë të pushtetit, madje edhe vetë kryeministri përmes përfaqësuesit të vet. E di tërë bota se Shaqir Fetaj erdhi në krye të BFI-së falë heshtjes së organeve të drejtësisë karshi shkeljeve brutale të Kushtetutës së BFI-së, me të vetmin qëllim për ta shprehur solidaritetin me të gjithë elementat antiislamike në vend.

Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së do të vazhdojë edhe më tej me aktivitetin e vet shumë të sinqertë dhe fisnik, do të komunikojë me të gjithë organet dhe institucionet e BFI-së, me të gjithë faktorët relevant të vendit dhe ndërkombëtarët, për ti dëshmuar të gjitha shkeljet kushtetutare të cilat kurorëzohen me betimin ereisit të falsifikuar se, këto shkelje dhe veprime antiislame, të cilat mund ta iritojnë tërë popullatën myslimane të vendit, do ta vazhdojnë edhe më tej, tashmë me bekimin edhe të pushtetit.

Shkeljet kushtetutare që gjeneruan një reis të falsifikuar nuk mund të mbulohen as edhe me prezencën e përfaqësuesve të bashkësive simotra të rajonit, të cilët, nuk mund ti dinë punët dhe raportet brenda BFI-së. Mosprezenca e ish-reisul ulemasë në ceremoninë e dorëzimit fals të Menshurës, mosprezenca e Myftiut të njëjës prej Myftinive më të mëdha të vendit, flet se ky akt i betimit nuk ka vlerë, nuk ka legjitimitet, dhe nuk mund ta legalizojnë as bashkësitë e tjera fetare dhe as pushteti, sepse, shumë shpejt do të dëshmohet se në BFI problemet do të shpërthejnë dhe do të dalin jashtë kontrollit pikërisht për shkak të përzjerjes së politikave të ndryshme destruktive.

Këshillit për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së i vie shumë keq që, në vend të një urimi vëllazëror për reisin e mundshëm në kuadër të legales dhe legjitimes, po i drejtohet opinionit të gjërë me këtë reagim për të shprehur zhgënjimin dhe kundërshtimin e pathyeshëm kundër shkelësve dhe legalizuesve të shkeljeve të Kushtetutës së BFI-së.

Me zhgënjim të thellë -

***Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së***

***(Fol, 26.11.2020)***

## Shkelësi i Kushtetutës së BFI-së është keqbërës

Është thënë, është argumentuar dhe dokumentuar se Shaqir Fetai, i trimëruar nga garancitë e institucioneve shtetërore të drejtësisë për paprekshmërinë e tij, është shkelësi flagrant që vazhdon edhe më tej ta shkelë Kushtetutën e BFI-së si dhe aktet e tjera të saj normative. Akoma pa kaluar 24 orë nga falsifikimi i tij si “kryetar” të BFI-së, e bën shkeljen e rëndë, pavarësisht se i është betuar publikisht Zotit Fuqiptotë se nuk do të shkel as Kushtetutën dhe as aktet normative të saj

### *Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI*

Shaqir Fetai, me trimërinë e motivuar nga garancitë në paprekshmërinë e tij nga institucionet shtetërore të drejtësisë, i bën karshillëk edhe të Madhit Zot! Nuk i frikësohet as Atij, fare nuk i bën përshtypje që dje Ia ka dhënë besën se do të jetë i disiplinuar dhe në vijë të akteve që dalin nga Kushtetuta dhe aktet normative të BFI-së që mbështeten në Kuranin Famëlartë dhe në Praktikën e Pejgamberit tonë, Muhamedit a.s.

Shaqir Fetai, ky reis i falsifikuar dhe i imponuar nga nëntoka e Stankove dhe Boshkove, tashmë praktikën e vet të deridjeshme në shkelje kushtetutare, e legalizon, e institucionalizon dhe guximshëm hapëron mbi Kushtetutën e BFI-së duke e shkelur atë sikur të ishte një leckë e parëndësishme.

Duke u stërkënaqur me nektarin e refuzimit të kësaj Kushtetute, duke e regjistruar veten si “ushtrues detyre Kryetar i BFI-së”, ai vazhdon dhe këtë kënaqësi ua shkakton edhe të tjerëve në BFI. E shton numrin e shkelësve të Kushtetutës! Ai frikësohet që të ngelë vetë, prandaj, insiston në krijimin e komunitetit shkelës të akteve kushtetutare të BFI-së.

Sot, Shaqir Fetai, i ashtuquajtur i reis, falë falsifikimit të disa “akteve antikushtetutare”, në Gostivar, në prezencë të përkrahësve të tij bashibuzukë, emëroi “ushtrues detyre Myfti i Myftinisë së Gostivarit”!!! Në këtë valle e futi Sabahudin Zendelin, i cili, edhe ky pranoi që të ecë gjurmëve të “reisit” të vet në shkejet flagrante kushtetutare.

Sipas Kushtetutës së BFI-së, por edhe sipas rregullores për zgjedhjen e myftinjëve, nuk parashihet me asnjë nen pozita “ushtrues detyre Myfti...”! Deri në plotësim të kushteve me Myftininë udheheq kordinatori! Këtë kështu e ka paraparë Kushtetuta e BFI-së, të cilën e kanë miratuar organe jetike për nga pesha dhe rëndësia e tyre në organizimin e jetës fetare islame në vend. Megjithatë, Shaqir Fetai më tepër është i angazhuar që të plotësohen kërkesat mesquine politiko-partiake se sa të kthehet në binare të shëndosha organizimi i tërë jetës fetare islame në vend.

Shaqir Fetai, ky masakruar i Kushtetutës së BFI-së, dje u betua në Zot se nuk do ta shkelë Kushtetutën, kurse sot e vazhdoi masakrimin e saj. Krijuesi ynë Fuqiptotë, këtij farë soji pafytyrësh ia bën me dije: **“... e çdo betim që do të bëni, me siguri që Allahu ka dijani për atë! Keqbërësit nuk do të kenë askënd që t’i ndihmojë.”** (270, El Bekare)

Pa dyshim, shkelësit e Kushtetutës së BFI-së janë, fundekrye, keqbërës! Mjer ata!

*(1Kliklartë, 27.11.2020)*

## Rrenat e përditshme të Shaqir Fetait

**Është traditë shqiptare që mysafiri të pritët me buk e krip e zemër. Me zemër të bardhë, t'i bëhet muhabet të rrastë, jo të gënjejhet e të vihet në lojë. Mysafiri nuk duhet të keqpërdoret si argument se sa po duhet e po respektohet faqeziu**

**Nga Haxhi Isa Xhaviti**

Shaqir Fetai është bërë për gjynah, për t'i fryrë ndonjë “xhinxhi”, sepse, i shkreti, vajti për lesh! Ngeli pa iman! Është e papranueshme që një “hoxhë” si Shaqir Fetai të gënjejë kaq shumë, rrena i është bërë sport i përditshëm.

Aktivitetet më të mëdha në BFI, në postin e falsifikuar të Kryetarit të BFI-së, i ka pritjet e lloj-lloj personaliteti të vendit e nga jashtë, të cilët i shkoqi duke i gënjyer. Asnjërit prej mysafirëve nuk ia merr mendja se një “reis” mund të gënjejë, ndërsa “reisi” është i detyruar që t'i gënjejë, ndryshe, do të ngelë pa kurrfarë aktiviteti të pritje-përcjelljeve.

Pritje-përcjelljet i ka sa për mastrubim shpirtëror, sa për t'i treguar rrethit të ngushtë familjar se sa shumë e duan njerëzit e botës, edhe pse si student e ka djegë një botë të tërë nën presionin e UDB-së. Kështu thotë dokumenti i botuar dhe për këtë, Shaqir Fetai hala nuk ka kërkuar demant nga UDB-ja. E ka ndërmend që të kërkojë demant se kurrë nuk ka qenë bashkëpunëtorë i tyre, por nuk po i del koha për këtë demant, sepse, për momentin kohë me bollëk ka vetëm për ta trashur rrenën. Cili është halli i Shaqir Fetait që të kërkojë me shkrim përkrahje nga Bashkësia Islame e Bosnjës dhe, në veçanti nga Fakulteti i Shkencave Islame në Sarajevë. Si argument se kur ka vegjetuar në këtë qytet nuk ka qenë bashkëpunëtorë i UDB-së në dëm të këtyre dy Institucioneve? Ka këndruar Shaqua si ORAO-Shqiponja, që çkeme të!

Shaqir Fetai mendon se sa më shumë mysafirë, sa më shumë përshëndetje e urime, aq më shumë do të harrohen shkeljet kushtetutare dhe kontrabandimi i postit “kryetar” i BFI-së, sa më shumë mysafirë, përshëndetje e urime, aq më shumë do të relativizohen dokumentet, faktet dhe argumentet që flasin për falsifikimin e këtij posti duke mohuar, shkelur, e nëpërkëmbur tërë Kushtetutën e BFI-së.

Shaqir Fetai nuk ka kurrfarë respekti për BFI-në, nuk ia përfillë asnjë nga aktet normative, nuk ia respekton asnjë nga nenet, tërë Kushtetutën, prandaj, si ta dojë BFI- në? Por, këtë urrejtje të pistë të tij ndaj Institucionit mundohet ta kamuflojë me pritje e përcjellje, me përshëndetje e urime të mysafirëve të kurdisur e të porositur.

Shaqir Fetai nuk e ka brengë shkeljen kushtetutare, brengë e ka një ditë t'i kalojë pa mysafirë, të cilët paraprakisht i organizon dhe i porositë që t'i vinë në zyre, të vjelë ide organizative, të mësohet se si t'ia nisë punës, sepse, sa për vetë atë, ai kokën e ka bosh në aspekt organizativ.

Si nuk turpërohet prej të pranishmëve duke i folur se si u zgjodh “reis”, se si e deshtën të gjithë, se si njerëzit e lutën të gjunjëzuar para tij e jo se ky deshti të bëhet “reis”!

Si nuk turpërohet duke u munduar për ta përhumur muhabetin e mysafirëve që mundohen të mësojnë ndonjë të vërtetë që po flitet poshte-lartë për ardhjen e tij si dëshirë partiake dhe jo si zgjedhje e myslimanëve të vendit.

Si nuk turpërohet që të mburret duke pranuar përshëndetje e urime për diçka për të cilën vetë ai është milion për qind i bindur se e ka falsifikuar dhe se e ka vjedhur si hajn klasik!

Si nuk turpërohet nga urimet e përshndetjet për një gjë për të cilën vetë ai është më se i bindur se nuk e meriton!

Si nuk skuqet nga turpi kur ia urojnë “reisllëkun” ndërkohë që është miliardë për qind i bindur se e ka të pamerituar, të vjedhur, të kontrabanduar dhe të falsifikuar.

Shaqir Fetai nuk duhet të vetëmashtrohet, duhet të dijë se, të gjithë ata që vijnë për ta uruar e përshëndetur, nuk vijnë se nuk e dinë se paska qenë “myhyb” i oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviqit dhe, me sugjerim të këtij, “myhyb” i më vonshëm i Temlko Boshkovskit, (shih botimin e fundit të Nafi Çegranit, një fotografi që flet sa një dosje) por, që të gjithë vijnë të përfitojnë diçka nga rasti, botim të ndonjë libri, ndonjë vend pune për djemtë, ndonjë benifit personal, ndonjë pagesë të sigurimeve të prapambetura, ndonjë drekë, a darkë, si rast për të shëtitur nëpër Shkupin e Gruevskit etj.

Shaqir Fetai duhet të kuptojë se, shumë shpejt do të bëhet personi më i urryer në vend, sepse, ka qenë i vetmi person që me aq afsh shpirtëror ka pranuar të futet në degradim, në partizim të BFI-së, ka pranuar të bëhet “reis i LSDM dhe myteveli i BDI”, ka pranuar të shkelë Kushtetutën e BFI-së dhe ta degradojë këtë Institucion deri në një hon të ktunihershi!

Shaqir Fetai shumë shpejt do të kërkojë të mëshirohet por, urrejtja ndaj tij si rrënues historik i këtij Institucioni, do të shkaktojë mallkim gjithnjë e më shumë. Do ta arrijë mallkimi i myslimanëve, pa dyshim! Do ta harrojë kohën e urimeve dhe përshëndetjeve, ngaqë do ta kaplojë faza e urrejtjes së tmerrshme. Ky është shpërblimi meritore për çdo matrapaz, për çdo gënjeshtar, për çdo shkatërrues e mohues të së vërtetës që bazohet në Kuran e në porositë e Muhamedit a.s.

Edhe hafiz edhe gënjeshtar – kjo mund t’i shkojë ndoresh vetëm Shaqir Fetait. Prandaj do të bëhet cak i mallkimit dhe i urrejtjes! Sa keq!

*(1Kliklarg, 1.12.2020)*

## Si t'i shërojë komplekset Shaqir Fetai

**Shaqir Fetai është person akarizmatik, i stigmatizuar, apo, me myhyr në ballë, që dëshmon për modelin më të keq të kreut të BFI-së. Shaqir Fetai e ka kompleks faktin që tashmë shquhet si i vetmi shkelës i kontinuitiv i akteve normative të BFI- së në historinë e këtij Institucioni. Integriteti i këtij Institucioni është ruajtur shumëfish më tepër nën krallëvën serbe se sa nën Shaqir Fetain e bënëzuar**

**Nga Andi Rakipi, Tiranë**

Shaqir Fetai ka zgjedhur një metodë tepër naive dhe të shpifur për ta imponuar veten si “personalitet” në shoqërinë tonë, e cila, është dëshmuar si kolektivitet i cili të lë të kullosh por që di të t'i thyej edhe turinj të hu gardhi!

Çdo takim të porositur e të kurdisur Shaqir Fetai e interpreton si “dashuri kolektive” ndaj zotërisë së tij! Sidomos, takimet me ndërkombëtarët mundohet t'i paraqesë si takime “për ta uruar reisin e dashur”, të cilëve “reisi u tha”, mysafirët e nderuar “u ndanë shumë të kënaqur me reisin dhe i uruan suksese”! Pra, në qendër të vëmendjes është “reisi i falsifikuar”, qëllimi i vizitës është “reisi i kontestuar”, rëndësia e këtij takimi ishte “reisi antikushitetar”, “reisi u tha ata u ndanë të kënaqur prej tij”...

A mund të jetë arsye shkuarja e Shaqir Fetait deri në ambasadën e Arabisë Saudite në Tiranë, vetëm sa për t'i marrur konsideratat e arabëve që “i paskan” për Shaqir Fetain “si reis”! Shaqir Fetai paska vizituar këtë ambasadë sa për t'ju thënë... ndërsa këta e paskan pritur sa për ta lutur që ta pranojë ftesën që të jetë “mysafir i Mbretit”!

Me të tilla komplekse Shaqir Fetai nuk mund t'i imponohet opinionit të gjërë, nuk mund të pranohet në masë si figurë e qëlluar, e dashur dhe karizmatike, sepse, nuk ka shqiptar në botë që nuk e dinë se Shaqir Fetai është shkelësi unikat i kushtetutshmërisë së BFI-së, se është reis i falsifikuar dhe si i tillë i imponuar nga qarqet politiko-partiake (LSDM-BDI) që tashmë kanë kontroll absolute mbi BFI-në. Shaqir Fetai me këto truce naive nuk mund të përmirësojë imazhin e vet për të cilën ka investuar që kur ishte student dhe vegël e oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviqit dhe, me sugjerim të këtij, “myhyb” i më vonshëm i Temelko Boshkovskit. Pikërisht për këtë fakt Shaqir Fetai duhet të jetë më i kujdesshëm dhe mos t'i bëjë lëndë për akuza publike personat e tjerë që detyrojnë ta pranojnë kur ju shkelë në prag të derës, sepse, pa dyshim që të gjithë kritikohen se pse kanë pranuar një person të dyshimtë dhe me një të kaluar të trishtë komuniste. Nuk ka të drejtë Shaqir Fetai që t'i përdorë këta personalitete, qofshin kombëtare qofshin fetare, vetëm e vetëm t'i shërojë frustrimet dhe kompelekset e veta.

Ka mjaft tipa nga komuniteti i vet me të cilët mund të takohet dhe të flasin turpshëm për veprimet e tyre që i kanë bërë dikur e që po i përsërisin sërish, duke menduar se, vetëm duke u ngjitur në karrierë mund ta gëzojnë respektin. Të pëshurrsha në një respekt të tillë!

*(IKliklart, 2.12.2020)*

## **H. Afrim ef. Tahiri: Stabiliteti i BFI-së dhe i myslimanëve të vendit varet nga kthimi në Kushtetutshmëri të Institucionit**

**Në vazhden e takimeve me faktorë të rëndësishëm të vendit që mund të kontribuojnë apo të ndikojnë në kthimin e pashmangshëm në kushtetutshmërinë e BFI-së, Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI në RMV, ka realizuar një takim pune mjaft konstruktiv me H. Afrim ef. Tahirin, drejtuesin e Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI të RMV-së, njërin nga përpiluesit e Kushtetutës së BFI-së**

Pa dyshim, KMK edhe me këtë rast ka kërkuar që të zbardhen, të evidentohen të gjitha shkeljet kushtetutare dhe të ofrohen propozime konkrete se si mund të dilet nga kjo krizë, nga këto skandale të pahishme antiislame, dhe të kthehemi në kushtetutshmëri duke ia rikthyer edhe integritetin Institucionit të vetëm fetar islam në vend, Bashkësisë Fetare Islame në RMV.

H. Afrim ef. Tahiri i mëshoi idesë që, nuk ka tejkalim të situatës pa u rikthyer në hapat fillestare që u hodhën në shkelje të Kushtetutës dhe të akteve të tjera normative të BFI- së. Efendi Tahiri fillin e skandaleve e sheh që në momentin e shkarkimit të ish-reisul ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepi, respektivisht, në tërë procedurën e shkarkimit, në mënyrën e shkarkimit si dhe në vetë aktin e këtij shkarkimi, i cili u krye falë skenarit dhe mbështetjes policeke të partive në pushtet, duke e falcifikuar tërë një proces pa pasur frikë nga pasojat e mundshme ligjore! Fundja, siç nënvizon Tahiri këtë konstatim e bëri fakt të pamohueshëm dhe e publikoi edhe vetë lideri i BDI-së, Ali Ahmeti.

“Është tërësisht imorale që strukturat që deri dje ia lëmonin shpinën Sulejman Rexhepit, që ishin në gjendje të vrasin e të vriten për Sulejman Rexhepin, që ishin në gjendje ta zvetënojnë personalitetin e vet duke i duartrokitur e duke u mburrur me Reisin e tyre, të cilin, disa ditë para shkarkimit, e kishin vlerësuar me epitete nga më të fuqishmet që i dedikohen një personaliteti të papërsëritshëm kombëtar e fetar, sakaq do ta shpallin si njeri të keq e të rrezikshëm për ta shkarkuar me nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së! Kush e konstatoi?”, pyet H. Afrim ef. Tahiri.

Me ndërhyrjen e faktorëve nga jashtë BFI-së, është shkelur Preambulla e Kushtetutës së BFI-së si dhe Neni 1 që thotë se, BFI duhet të jet autonome dhe e pavarur në organizimin e jetës fetare.

Tahiri nënvizon se procedura e shkarkimit bazohet në akte antikushtetuese sepse: “sipas Kushtetutës kush ka të drejtë të thërrasë mbledhje të Rijasetit? Kush ka të drejtë të udhëheqë me mbledhjet e Rijasetit? A është ngritur komisioni disiplinor, cili ka qenë mendimi i Prokurorit të BFI-së për gabimet e Reisit? Për këto as nuk është folur e as nuk është debatuar paraprakisht në organet e BFI-së. (Shih Nenin 8, Nenin 37 alinea 3 dhe 23 dhe Nenin 34 alinea 5)

Sipas Nenit 35 të Kushtetutës së BFI-së: "...Rijaseti i BFI-së përbëhet prej Reis ul Ulemasë, Sekretarit të Përgjithshëm të BFI-së, muftinjve, drejtorëve dhe dekanëve të institucioneve arsimore, kryetarëve të shoqatave të Bashkësisë Fetare Islame dhe dy anëtarëve të caktuar nga ana e Reis ul Ulemasë, si e drejtë e tij diskrecionale, e me përvojë në organizimin e jetës fetare në rradhët e BFI-së.", në mbledhje të Rijasetit me të drejtë vote mund të marrin pjesë vetëm ata që përfshihen në këtë nen dhe jo edhe të tjerë. Duhet theksuar se në rastin konkret, kur mungon Reisul Ulema, me automatizëm nuk mund të jenë pjesë e mbledhjes as Sekretari i Përgjithshëm të cilin Rijaseti e zgjedh me propozim të Reisul Ulemasë (Neni 37 alinea 3), si dhe dy anëtarët e caktuar nga Reisul Ulema. Kurse në aktin e shkarkimit, prapa komplotistit Shaqir Fetai ishin radhitur edhe individë që kurrë nuk kanë qenë anëtarë të Rijasetit, kishte individë pa të drejtën e votës, as për zgjedhje e as për shkarkim. Veç kësaj pati edhe individë që në asnjë mënyrë nuk mund të trajtohen si anëtarë të Rijasetit por, thjesht, si "organe" të kontrabanduara si psh. "përfaqësuesi" i Myftinisë së Shkupit i cili në krye të Myftinisë ka ardhur në kundërshtim me nenin 30 të Kushtetutës dhe si i tillë, është i kontestuar, pastaj Kryetari i Kuvendit të BFI-së, si dhe kryetar shoqatash jasht mandateve të parapara në statutet e shoqatave! Pastaj, antikushtetuese ishte edhe protokolimi dhe qëndrimi i "rijasetit" ndaj dorëheqjes së ish-reisul ulemasë! Neni 64 i Kushtetutës thotë: "Secili funksionar i BFI-së ka të drejtë të jep dorëheqje, dhe për të njëjtën vendos Rijaseti i BFI-së", fatkeqësisht, Rijaseti nuk doli me ndonjë vendim, thekson H. Afrim ef. Tahiri.

Efendi Tahiri tërë këtë lojë e konsideron si tallje flagrante me Institucionin e BFI-së! Dhe, këtë tallje, sipas efendi Tahirit, mund ta bëjnë njerëz të shitur e të pamoralshëm si dhe injorantë që nuk kanë fare lidhje dhe që nuk e njohin Kushtetutën e BFI-së, qoftë këta nga brenda apo edhe nga strukturat jashtë BFI-së! "Ndryshe", pyet Afrim ef. Tahiri, "si ka mundësi që ta bëjnë gabimin fatal duke e "caktuar" ushtrues detyre kryetar i BFI-së, Shaqir Fetain, Myftiun e Gostivarit? Kushtetuta e BFI-së për postin e të parit njeh vetëm fjalën "zgjedhje". Për pozita të tjera njeh edhe fjalët "emërim" dhe "punësim", kurse fjalën "caktim" e njeh vetëm në një të drejtë ekskluzive të Reisul Ulemasë (Neni 35) ku flet për të drejtën e tij për të caktuar dy anëtarë të Rijasetit me përvojë në organizimin e jetës fetare në rradhët e BFI-së! Në një situatë të jashtëzakonshme, në luftë, në kriza të thella shoqërore, mbase edhe grupe ilegalistësh mund të caktojnë prijës të tyre por, në kushte normale, në kushte kur veprimtaria e Institucionit mund të mbështetet në Kushtetutën e vet, të caktohet ushtruesi i detyrës, kjo pastaj është puç klasik! Veç kësaj, le të na thonë këta të "Rijasetit" të ri, le të na thotë ky farë "reisi" i kontestuar dhe i falsifikuar, në cilin nen të Kushtetutës, në të cilën "përbetohet", mund ta gjejë fjalën "ushtrues detyre"?", ngre shqetësimin intelektual H. Afrim Tahiri.

Ish-sekretari gjeneral i BFI-së, H. Afrim Tahiri, nuk beson se shkeljet kushtetutare ishin vetëm si pasojë e injorancës, por, thjesht, ishin këshilla të porositura nga struktura të caktuara si të pushtetit ashtu edhe të "partisë myslimane" (BDI-së) në pushtet! Sipas tij, pa qenë i garantuar me paprekshmëri nga organet e drejtësisë, pa qenë i trimëruar nga segmentet e caktuar të pushtetit, Shaqir Fetai nuk do të guxonte ta bëjë atë gaf i cili e kthen lakuriq te gafi i parë! Në gafin e parë, shkarkimin e bëri me njerëz inkopetentë, ndërsa në gafin e dytë, këta njerëz inkopetentë dhe pa të drejtë vote, i ngriti krye më vete, nga pozita e kordinatorit në myftinj të myftinive, vetëm e vetëm që vota e tyre të jetë e ligjshme në rast se do të votonin për të gjatë zgjedhjeve për reis! Kjo shkelje kaq flagrante dhe kaq e poshtër nuk mundet të bëhet pa një mbështetje të fuqishme të politikës dhe të partive në pushtet që e inicoi këtë lojë fatale për BFI- në, konstaton H. Afrim Tahiri. "Me këtë rast, Shaqir Fetai, i trimëruar nga politika partiake, shkeli tërë Rregulloren për zgjedhjet e myftive. Neni 31 i kësaj Kushtetute për zgjedhjen e myftiut e përcakton këtë procedurë: "Muftinia kandidon kandidatë të mundshëm për mufti, Rijaseti i BFI-së bën emërtimin e muftive, kurse Reisul Ulema verifikon emërtimin dhe u

lëshon Murasele.”, thotë efendi Tahiri për të vazhduar: “Shkelje kushtetutare Shaqir Fetai bëri edhe në Myftininë e Gostivarit, e cila, ndonëse i plotëson të gjitha kushtet për të pasur myfti legjitim e legal, Shaqir Fetai e përsërit gabimin e pafalshëm duke e caktuar edhe aty “ushtrues detyre myfti i Gostivarit”! Neni 30 thotë: “...Në muftinitë ku nuk ka kuadër sipas kushteve të parapara, emërohet kordinator.” Ky është një turp i denjë vetëm për ata që kanë në plan degradimin dhe shkatërrimin e tërësishtëm të BFI-së si Institucion jashtëzakonisht i rëndësishëm për myslimanët e vendit”, thotë efendi Tahiri.

Ndërsa për procedurën e organizimit dhe të mbajtjes së zgjedhjeve, H. Afrim ef. Tahiri thotë se, në aspekt formal, ndonëse gjithçka duket mirë, në aspekt Kushtetues është kryer një masakër e tmerrshme. “Reisi i cili do të betohet në Kushtetutën e BFI-së, bën shkelje të paimagjinueshme për trurin e shëndoshë. Ndaj, sot tërë bota që nuk ia bëjnë qejfin Shaqir Fetait, konstatojnë se ai është “reis i jashtëligjshëm, i kontrabanduar dhe i falsifikuar”, nënvizon efendi Tahiri.

Sipas tij, me këtë rast, në procedurë e në aktin e zgjedhjes, krahas shkeljes së Preambullës dhe neneve 1 dhe 8, janë shkelur edhe këto nene: 41, 42 dhe 49 alinea 4, të Kushtetutës së BFI-së. Efendi Tahiri thotë se u përfol se u përpilua një Rregullore për zgjedhjen e Reisul Ulemasë, por nuk u fol se Kuvendi i BFI-së pati ndonjë mbledhje ku u miratua ndonjë Rregullore! Rregulloret janë akte normative që pa votimin e Kuvendit të BFI-së nuk mund të jenë të plotfuqishme. Pra, BFI sot udhëhiqet nga një “Reis” i ardhur pa Rregullore dhe i kontrabanduar!

“Nëse e analizojmë listën votuese të hartuar personalisht nga Shaqir Fetai (sipas direktivave që i janë dhënë), kemi një pasqyrë të tmerrshme falsifikimi! Shaqir Fetai në kundërshtim me Kushtetutën, jashtë sistematizimit, krijon “sektore” dhe emëron “drejtorë” të cilët i fton në votim, kurse disa drejtorë të sektorëve të tjerë jo! Sipas Kushtetutës së BFI-së, është e përcaktuar fare qartë se kush ka të drejtë të jetë anëtarë i Rijasetit. Në ditën e votimit të falsifikuar nga Shaqir Fetai kemi një listë të përcudshme të votimit:

- 5 “myfti” të emëruar në kundërshtim me Kushtetutën: i Shkupit, i Shtipit, i Dibrës, i Kërçovës dhe i Manastirit.
- në atë listë ishin të përfshirë me pa të drejtë edhe i propozuari i ish-reisit – sekretari i BFI-së, si dhe dy anëtarët e caktuar nga ish-reisi.
- Kryetarët e shoqatave janë subjekt më vete, kanë statutin e vet si dhe organet që zgjedhin drejtuesit e vet. Hilali dhe Ilmije që moti drejtohen pa kryesi të zgjedhura nga kuvendet e veta, pra janë vetëeliminuar nga e drejta e votës!
- Drejtorët e sektoreve apo udhëheqësit e agjencive, komisioneve nuk janë anëtarë Rijaseti. Por çuditërisht disa drejtor sektorësh i kemi në listë e disa jo! Psh. në listën e Rijasetit e kemi përgjegjës-in-shoferin e shërbimit të varrimit, kurse nuk i kemi drejtorët e drejtorive të finansave, të vakefit etj.

Meqë shumë folëm lidhur me nenin 35 të Kushtetutës, le të përfundojmë se, sipas tij, në listë mund të përfshihen vetëm ata që u theksuan më sipër sipas Kushtetutës së BFI-së, gjegjësisht vetëm ata që janë të zgjedhur apo të emëruar. Ndërsa në listën e Shaqir Fetait kemi shumë persona që janë të punësuar e assesi nuk mund të llogariten si të zgjedhur apo të emëruar prej “reisit”. Pra, sipas Kushtetutës dhe Rregullores, i pari i Institucionit votohet nga të zgjedhurit apo të emëruarit konform akteve normative të BFI-së, dhe jo nga shoferët.

Sipas efendi Tahirit, Shaqir Fetai me këto shkelje flagrante të Kushtetutës së BFI-së që bazohet në Kuranin e Madhërishtëm si dhe në Traditën e Pejgamberit a.s., jo që nuk ka të drejtë të vetëmërtohet “reis”, por duhet të radhitet në mesin e atyreve që shkelin mbi parimet islame. “Në krye të BFI-së aktualisht kemi një zgjedhje të përkohëshme partiake, i cili me patjetër duhet të jetë rob i politikës, partisë. Nëse këtë robërim nuk e dëshmon në zgjedhjet e pritshme apo të jashtëzakonshme politike,



atëherë, ai do të ndërrohet dhe hidhet në rrugë, pikërisht si shkelësi më i madh i akteve normative në historikun e këtij Institucioni të vetëm fetar islam në vend.

H. Afrim ef. Tahiri tërheq vërejtjen se, pa kthimin e punëve në binaret e kushtetutshmërisë së BFI-së, nuk do të ketë qetësi, do të ketë luftë opozitare të pakompromis, duke e njohtuar në çdo moment tërë opinionin e gjërë të vendit si dhe ndërkombëtarët, “sepse, bëhet fjalë për një rrezik me përmasa të paparashikueshme që i kanoset vendit dhe shoqërisë sonë nga nëpërkëmbja e integritetit të Bashkësisë Fetare Islame në RMV”, përfundon efendi Tahiri.

Si Këshill, si trupë vullnetarësh për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së, njoftojmë se në vazhdim do t’i marrim edhe sugjerimet dhe këshillat e imamëve, të cilët, grupe-grupe insistojnë që të intervistohen dhe të japin kontributin e tyre në tejkalimin e kësaj situatë tepër të nderë. I ftojmë të gjithë personalitetet e vendit, teologë e intelektualë në përgjithësi, të na paraqiten, sepse, çdo kontribut i tyre në këtë drejtim do të llogaritet i jashtëzakonshëm.

*(MkAlb, 3.12.2020)*

## Për Shaqir Fetain rrena është “din dhe iman”

**(Rreth një interviste që Shaqir Fetai, “reisi” i kontrabanduar, i kontestuar dhe i falsifikuar, ia kishte dhënë gazetarit Destan Jonuzit për gazetën (tv) KOHA, publikuar në formë të shkruar më 3 dhjetor të vitit 2020)**

**Nga Sabit Ibrahim**

Shaqir Fetai me bisht të kapur në derë, me dy hapa në një valle për të cilën nuk është i denjë as të lëvizë ritmiksht, i gjendur para situatave që të veprojnë e të flasë ashtu siç do t'i thonë ata që e dirigjojnë dhe e kontrollojnë, është e pamundur që përgjatë paraqitjeve të veta spontane në opinion të mos gënjejë pa fije turpi. Shaqir Fetai, shumë shpejtë do të mundohet të dalë në pozita të burrit e të pranojë publikisht se ka hyrë në valle të huaj, në krye të valles dhe që po i kërcejnë sipër të gjithë si pasojë e ritmit dhe hapave të pinguinit. Ata që e njohin “vallen e pinguinit” e kuptojnë se në çfarë presioni dhe sikleti është Shaqir Fetai. Është punë e tij, e befshin shoshë në valle!

Që në krye të intervistës Shaqir Fetai e dëshmon edhe një gjë: për hirë të lojës që i duhet ta çojë deri në fund (sepse është i shantazhuar) ai pranon dhe detyrohet të gënjejë, madje të kënaqet duke gënjer, ndonëse i thahen buzët dhe merr pamjen e një diabetiku! Thotë se po e tepron pak me intervistat televizive por po e kërkuan shumë manekenin. Po ama, nuk thotë se pranon të zhvillojë vetëm monologje televizive kurse prej debateve televizive ik si p... i mërdhifët!

Në këtë intervistë në pyetjen se a ta ka uruar “postin” edhe ish-reisul ulemaja, Shaqir Fetai mundohet që ta gënjejë tërë opinionin e gjërë. Thotë: “Nga ish-Reisi ende nuk kemi ndonjë paraqitje...”! Paraqitjen e Sulejman Rexhepit e lexuan krejt bota shqiptare, madje, pas shkarkimit të ndihmuar nga të gjitha strukturat policore të shtetit, ai për herë të parë u rrëfye para Këshillit për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së, pas së cilës pasoi edhe emisioni debatim në TV21M. Në të dy rastet e zbërtheu lojën e pushtetit dhe të instalimit politikisht të Shaqir Fetait në “krye” të BFI-së! Shaqir Fetai mendon se ky fakt do të mund të devalvohet duke e injoruar! Për herë të parë u shpalosën të gjitha përpjekjet e Shaqir Fetait që duke shkelur nene e nene, aline të shumta si dhe rregullore, me ndihmë të pushtetit, të vie në krye të BFI-së dhe, këtë fakt nuk arriti ta demantojë për asnjë moment. Prandaj, gënjenë Shaqir Fetai kur thotë se “Nga ish-Reisi ende nuk kemi ndonjë paraqitje”...

Në pyetjen e gazetarit Jonuzi, “Kur jemi te politika, zgjedhja juaj është shoqëruar me zëra se ka ndikim politik. Sa politika ka ndikim në BFI?”, Shaqir Fetai mundohet që rrenën ta tjerë edhe më fort. Edhe hoxhë edhe kaq gënjeshtar? Apo, tashmë e ka shitur zuzën dhe, edhe gënjeshtren e bën kabull! Edhe vetë përfaqësuesit më të lartë të subjektit politik BDI kanë pranuar se qëndrojnë prapa Shaqir Fetait dhe se vetë ata kanë kërkuar nga Sulejman Rexhepi që mos të tollovisë punë në prag të zgjedhjeve të jashtëzakonshme, sepse, edhe ata në fillim kanë menduar se kjo lojë është e huaj, e shërbimeve inteligjente të huaja. Del puna që paska qenë lojë e shërbimeve të huaja në bashkëpunim me pushtetin dhe, që pasojat të jenë sa më të vogla, e kanë lutur që të pajtohet përkohësisht me zgjedhjen partiake që BFI-në ta vënë nën kontrollin e vet përmes njeriut të tyre, Shaqir Fetait. Dhe ky farë dylberi mundohet ta bindë krejt botën se ai paska ardhur si rezultat i veprimeve autonome dhe të anëtarëve të Rijasetit! Veprimet kanë qenë të këtyre anëtarëve dhe jo të shërbimeve sekrete, apo të

Ali Ahmetit, por, Shaqir Fetai nuk guxon ta mohojë faktin që “anëtarët e Rijasetit”, nuk kanë qenë të gjithë anëtarë dhe, shumica prej tyre nuk ka pasur të drejtë vote. U lexua një dokument i fallsifikuar për të cilin, Shaqir Fetai mund të përfundonte në burg, sikur mos të ndërhynte struktura të BDI-së duke i premtuar Sulejman Rexhepit se pas zgjedhjeve gjithçka do të zgjidhet sipas ligjeve të vendit. Tani u pa puna se të gjitha “ligjet” e vendit u vunë në shërbim të Shaqir Fetait duke e trimëruar në aktin më antiislamit të “fituar” ndonjëherë në këta troje.

Shaqir Fetai gënjen edhe kur thotë se “Ne kemi deklaruar se kjo shtëpi është e të gjithë pjestarëve të islamit”, sepse, e vërteta është që ai ka deklaruar se BFI-ja u përket të gjitha partive politike. Pra, me këtë ai ka legjitimuar të drejtën absolute që secila parti e bllokut mysliman apo jomysliman të llogarisë se brenda BFI-së ka BFI-në e vet, sepse, BFI-ja nuk mund të jetë vetëm e partisë së Shaqir Fetait, BDI-së. Sepse, nëse BFI qenka e të gjithë partive atëherë të gjithë partitë kanë të drejtë të llogarisin se BFI-ja është e secilës prej tyre. Me këto “strategji kreative të Shaqir Fetait” BFI-ja ka marrur fund!

Shaqir Fetai përgjigjet se “ne prandaj jemi këtu që të marrim një rrugë më të shëndoshë”! Po në cilën rrugëtim udhëtoi Shaqir Fetai bashkë me babain e vet shpirtëror, Sulejman Rexhepin? Ai me ashk mburret se i ka shërbyer plotë 18 vite si mufti dhe se ka qenë dorë e djalhtë e tij. Do me thënë se, për 18 vite paskan qenë në dalalet dhe se për këtë “rrugë të zezë” duhet ta hajë vetëm Sulejman Rexhepi ndërsa Shaqir Fetai të dalë i terun? Shaqir Fetai pislkun e vet mundohet që t’ia hedhë tërthorazi pjesëtarëve të islamit në vend, duke thënë: “besimtarët meritojnë të jenë një pasqyrë e pastër islame”! Besimtarët gjithnjë janë të sinqertë, por, le të tregojë Shaqir Fetai se sa BFI-ja e tij ka qenë pasqyrë e pastër islame? Fatkeqësisht, kjo pasqyrë gjithnjë ka qenë e avulluar dhe e pistë nga afshi i Shaqir Fetait duke luajtur lojëra dhe skenar të huaja nëntokësore.

Shaqir Fetai tani e paska një BFI e cila nuk merret me skandale të ndryshme! Le ta numërojë Shaqir Fetai vetëm një skandal të BFI-së së kaluar në të cilën ai nuk ka qenë pjesëmarrës i drejtëpërdrejtë, miratues dhe përkrahës i zjarrtë! Hipokrizia e Shaqir Fetait shkon aq largë sa ky mendon se tani kemi një BFI “pa skandale”! Nuk ka BFI me Shaqir Fetain brena e cila nuk ka skandale! Në fakt, Shaqir Fetai ka nisur një “BFI të re” duke u bazuar në skandale të përminutshme, të përorshme, të përditshme! Shaqir Fetai ka vendosur që ta shkatërojë BFI-në dhe mos ta kemi ose, ta kemi një BFI sipas porosive të politikave ditore të pushtetarëve. Nëse e garanton këtë Shaqir Fetai, edhe pushteti do t’ia garantojë një “qeverisje të qetë” Shaqir Fetait. Për shembull, le të pranojë Shaqir Fetai çmimet e vakëfit të “denacionalizuar” me letra në vlerë ashtu siç i ka paraparë pushtetit dhe, “qeverisja” e Shaqir Fetait do të zgjasë me vite e me vite. Dhe, sakaq, Shaqir Fetai do të bëhet me para, prej një BFI që kishte financa vetëm për një rrogë, tashmë ka arritur edhe t’i ngrisë rrogat, pa vendim, pa miratim të organit gjegjës, pa pasur kurrfarë të drejte, sepse kur e ka kryer këtë krim, ai as që ka qenë reis! Shkatëro BFI-në se ke mbrojtje pushtetin (LSDM-BDI)!

Shaqir Fetai ndjehet aq i fuqishëm me këtë pushtet sa i jep të drejtë vetes që të tallet edhe me Zotin Fuqiptotë, ta gënjejë si një mynafik, si një i pabesë. Shaqir Fetai e shtrembëron të vërtetën në ditë me diell duke thënë “tani kemi një BFI e cila nuk merret me skandale të ndryshme, nuk prodhon efekte negative, por tani kemi marrë rrugën e kultivimit të vlerave fetaro-islame ashtu siç i kemi kompetencat tona.” A ka skandal më të rëndë se sa t’ia shkërmoqësh e t’ia dërmoshë shtyllën kryesore në të cilën mbështete BFI! Shaqir Fetai nuk ka moment që nuk i shkelë të gjitha aktet normative të BFI-së si dhe Kushtetutën, vetëm e vetëm që mos t’i shkelë porositë e marrura nga faktori politik në pushtet, atyreve që ia kanë marrur peng shpirtin! Një njeri i pashpirt si Shaqir Fetai vetëm shkatërrimin e BFI-së e ka kompetencë dhe hiç më shumë!

Gazetari Jonuzi, me mjeshtri shtron pyetjen provokative “Me sa kuptuam, gjatë punës suaj do të angazhoheni për rikthimin përpos dinjitetit të Hoxhës, edhe rikthimit të besimit të besimtarëve në

institucionin që drejtoni?”, ndërsa Shaqir Fetai në vend se ta korrigojë një perceptcion të tillë, ai pallamudë gjëra që nuk kanë lidhje me pyetjen. Jep ca përgjigje që nuk janë në të mirë të profesionit hoxhë, por, në të mirë të “intelegjencës” së tij që nuk është më e madhe se e qurës në mjegull! Sa për dijeni të Shaqir Fetait, hoxhallarët e Maqedonisë janë me dinjitet, janë të respektuar e të dashur, ndërsa të përjashtueshëm janë vetëm soji i Shaqir Fetait pa dinjitet e pakurriz. Shaqir Fetai thotë se shteti ynë është sekularist. Shaqir Fetai thotë se kemi bërë para për rroga të pandërprera dhe se dikur paska pasur vetëm për një muaj. Dhe, budallain mos e vet, se t’kallzon vet’! Thotë Shaqir Fetai: “Shteti momentalisht ndihmon simbolikisht”! Pse me e ndihmu shteti Shaqir Fetain simbolikisht?! Për çfarë kjo ndihmë nëse jo si gjest i mirë për një marrëveshje të arritur në mes të Shaqir Fetait e pushtetit! Apo ndoshta, paratë që nuk pranonte t’i marrë Sulejman Rexhepi sepse e degradonin vlerën e vakëfit, tash po i merr Shaqir Fetai dhe, në vend se t’i harxhojë duke blerë vakëfe të reja, ai i ndanë për rroga! Dhe ky qenka një rrugëtim i mirë e kreativ i Shaqir Fetait?! Pa dyshim që ky rrugëtim vetëm që ta thyen qafën e të lë pa din e pa iman!

I falen të gjitha rrenat paraprake mbi të cilat u ndërtua kjo intervistë! Shaqir Fetai ta kallë frikën kur me djallëzi mundohet t’i ikë përgjigjes në pyetjen e gazetarit se sa “Shaqir Fetai është pro-amerikan”! Këtë pyetje gazetari e shtroi në formatin televiziv, ndërsa në formatin e shkruar kjo pyetje shtrohet ndryshe “Reisi Shaqir Fetahu është me lindjen apo perëndimin?”

**Shih linkun:**

**[https://m.facebook.com/story.php?story\\_fbid=449101319828030&id=113481260056706](https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=449101319828030&id=113481260056706)**

Binduni vetë, pyetja nuk ndërrohet për fajin e gazetarit, por për fajin e udbashit dhe pro-jugosllavit Shaqir Fetai.

Shaqir Fetai nuk denjoi që, qoftë vetëm një herë të thotë nëse është pro-amerikan! Foli dy-tre minuta ndërsa i vinte tmerr që të pranojë nëse është pro-amerikan apo jo. Jam, pro-perëndimor, thoshte Shaqir Fetai, ashtu siç paskan qenë properëndimor dikur edhe rilindasit tanë. Pra, Shaqir Fetai është pro-perëndimor (pak francez, pak gjerman, pak italian, pak skandinav, pak baltik, e pak portugjez, pak bullgar e pak rumun etj.), dhe askund nuk nënvizon se është pro-amerikan. Prandaj në intervistën e shkruar është ndryshuar kjo pyetje. Apo, këtë pyetje ka insistuar që ta ndërrojë Shaqir Fetai, sepse mbase nuk ia nxjerr goja fjalën “pro-amerikan”!

Ky është kulmi i skandaleve që ka bërë Shaqir Fetai, pas kësaj gjithçka që do të bëjë do të trajtohet vetëm si budallallëk i një karrieristi të verbuar që, për karrierë shkel mbi familje, mbi Kuran, mbi bukë, madje, po pati bythë, edhe mbi Amerikë. Kjo përgjigje, as mish as peshk, i ka irituar edhe të kryesisë së BDI-së, të cilët tashmë po mendojnë se si do të nxirren nga kjo situatë në takimin e pritshëm me struktura nga ambasada amerikane në Shkup!

**(1Kliklart, 4.12.2020)**

## **Pushteti dhe karriera e Shaqir Fetait**

**I shërbeu pushtetit që nga bangat shkollore, tani pushteti do të shpëlahet me Shaqir Fetain. I erdhi koha që ta ndihmojë në karrierë, më të dëgjueshmin, më efektivin, më atraktivin dhe më kreativin e pushtetit. Shaqir Fetai vërtet që nuk është normal**

### **Shkruan Donika Fatahu**

Në tërë botën demokratike, të zhvilluar e të civilizuar, agjentët e shërbimeve sekrete, bashkëpunëtorët, i pensionojnë shumë herët, në vendet e bllokut ish-socialist spiunët në pleqëri nisin të bëjnë karrierë. (Pse mos ju duket Shaqir Fetai i ri me moshën e vet 62 vjeçare i cili në kushte normale nuk do të mund të punësohej as rojtar nate)!

Le ta analizojmë pak Shaqir Fetain, këtë të sëmurin për karrierë, i cili, ndihmën e pushtetit për të bërë karrierë fetare, (sepse ai kështu mendon se mund të shpëlahet nga mëkatet e shumta) mundohet ta kamuflojë me publikimin e urimeve dhe përshëndetjeve. Paramendoni sikur të bëhej praktikë që secili kryetar a drejtor t’i publikonte urimet me rastin e festave të fundvitit!

Kush nuk ia uron Kërshëndellat dhe Vitin e Ri Shaqir Fetait nuk është as Shqiptar por as Maqedonas! Keni mëshirë Shaqir Fetain dhe urojeni, sepse, çka do të publikojë ai si formë e “aktiviteteve të përditshme”, nëse jo këto urime festive, në vazhden e publikimit të urimeve se u “zgjodh” reis?

Vërtet si u zgjodh reis Shaqir Fetai? Me aftësi? Me gjenialitet? Me nevojë imediate të myslimanëve që e vlerësonin si më të dijshtmin e kombit? Jo! Shaqir Fetai u zgjodh si pasojë e përcaktimit të pushtetit dhe të shërbimeve inteligjente që deshtën ta avancojnë në karrierë si shenjë falënderimi që shërbeu aq gjatë në këto shërbime. Shaqir Fetai këtë nuk mund ta mohojë!

A mund ta mohojë se Shaqir Fetai për plotë 18 vite si Myfti i shërbeu Sulejman Rexhepit! Nëse Sulejman Rexhepi është akuzuar me akuza nga më të rëndat, Shaqir Fetai kurrë nuk iu vu në mbrojtje, por, me mburrje thoshte se kam qenë krah i djathtë i kësaj figure markante të kombit e të fesë, të cilin, në fund, në vend se ta pensiononin, ia ngulën thikën në shpinë. Shaqir Fetai nuk e kupton se ky do të jetë edhe fundi i tij!

Megjithatë, Shaqir Fetai po mundohet t’i marrë disa masa sporadike sa të vie te masat konkrete! Për shembull, një prej masave të cilën ia sugjerojnë shërbimet sekrete ruso- serbo-maqedonase është edhe publikimi i të gjitha urimeve, gjest ky më qesharaku që mund t’i ndodhë një “lideri”! Gjene vetëm edhe një të dytë si Shaqir Fetai në këtë aspekt! Është i detyruar sepse, kështu e kanë këshilluar: le të duket se të do masa, se të do popullata, se të do mbarë bota, madje edhe “Ali Hadri “ i Deçanit, edhe “dy motrat medicinale” të Muçibabës, edhe “rroktarët e bullicave: të Gjylekarit, edhe “rojtarët e laknave” të Radivojcit, dhe jo vetëm shërbimet sekrete! Po pse ta dojë bota Shaqir Fetain?

Me çka e meritua ka atë dashni të botës?

Shaqir Fetai nuk ka botë tjetër – e vetmja botë e tij është UDB-ja!

Shaqir Fetai nuk u bë “kryetar” i BFI-së sepse e deshti dikush, apo se dha kontribut që gjithësesi do të rezultonte me “reisllëkun” e tij! Shaqir Fetai e uzurpoi këtë post, sepse kështu i thanë ata të pushtetit, i thanë që t’i shkelë të gjitha aktet normative të BFI-së sepse do ta ketë mbrojtjen e pushtetit, paprekshmërinë e tyre.

Shaqir Fetai nis e sot e falsifikoi postin e vet, e kontrabandoi, e kapi duke u bërë shkelësi më i madh i Kushtetutës dhe i akteve normative në historikun gjashtëshekullore të këtij Institucioni. Këtë fare mirë e di edhe vetë ai dhe, ky fakt do t’i bëhet kancer, ndaj dhe merret me “leksikonin e adoleshentëve”, duke krijuar “përkujtimore” me publikimin e të gjitha përsëndetjeve dhe urimeve nga më bajatet dhe nga më qorret! Pushteti tashmë është duke e ndërë gabimin e hapit jo të menduar mirë. Ndaj dhe, po e këshillojnë Shaqir Fetain që të nisë dhe të dëshmohet si konstitucionalist, si njeri i akteve normative, i Kushtetutës. Do të nisë së pari me shkarkimin e njerëzve që i llogarit si vegla të Sulejman Rexhepit e që çdo ditë janë me urdhër të prokurorisë nëpër polici financiare. Pse a hoxhallarët vetëm hajna qenkan? Me këtë epitet do t’i sajdisë Shaqir Fetai! Nuk qenkan edhe shkelës të akteve normative për ç’gjë do të duhej të merreshin edhe organet e drejtësisë? Apo, nuk paditen me këtë gjë, sepse që të gjithë trajtohen si të paditur që mund të shkelin edhe akte normative, ndërsa qefi ua ka që të paditen si hajdutë ekspertë!

Njerëzit e Sulejman Rexhepit do të largohen si hajdutë dhe, ky do të jetë hapi i parë në “respektimin e Kushtetutës” dhe në fitimin e besueshmërisë së myslimanëve të vendit. Kjo besueshmëri do t’i duhet shumë fort, prandaj, hapi i dytë, edhe ky sugjerim i pushtetit, do të jetë largimi i atyreve që u zgjodhën me pa të drejtë “myftinjë”, duke shkelur çdo akt normativ të BFI-së por që ia kryen punën shërbimeve sekrete duke e votuar Shaqir Fetain si “kryetar”!

Fare në fund, sugjerim i strukturave intelektuale të pushtetit, të cilat kurrë nuk ia kanë dashur të mirën BFI-së dhe as që do t’ia duan ndonjëherë, është që ta trashë nepotizmin! Shaqir Fetai tashmë është i kompleksuar deri në veshë! I ka frikë të gjithë të punuarit në BFI, prandaj, nëpër vende kyçe do të nisë të punësojë familjarë të vet, apo të miqve të tij me të cilët do të mund t’i shantazhojë më lehtë. Disa gostivaras janë në gjendje që t’ia fërkojnë Shaqir Fetait vetëm e vetëm mos t’ia nxjerrin djemt, gratë, motrat, vajzat nga puna! Me punësimin e shefit të kabinetit, me caktimin e “ushtruesit të detyrës mufti” Shaqir Fetai u dëshmuar si “dhëndër i devotshëm”! Nepotizmi do të jetë një armë shumë e fuqishme në dorën e Shaqir Fetait për t’i disiplinuar të gjithë ata që fare lehtë mund t’ia bëjnë po atë gjellë të cilën Shaqir Fetai ia bëri Sulejman Rexhepit.

Shaqir Fetai duhet të dijë vetëm një gjë profetike të popullit shqiptar: “Atë çka do ta mbjellësh atë do ta korrësh”! Në këtë “bereqet” Zoti Fuqplotë nuk e pyet as pushtetin e Shaqir Fetait por as të Zajevit e të Ali Ahmetit. Gjithçka kthehet në këtë dynja. Gabimi trashanik do të “urohet dhe përsëndetet” me ndëshkim edhe më trashanik. Mos të thotë pastaj Shaqir Fetai: “Më falni se, vërrteetë nuk e paskam ditur”! Myslimanët nuk ndërhyjnë në punët e Zotit por, vetëm bëjnë – AMIN!

*(1Kliklarg, 6.12.2020)*

## **Shitet vakëfi i Shkupit për t'u paguar ekipi gostivaras i Shaqir Fetait**

**Shaqir Fetai është shumë i vetëdëshëm se, në formën siç erdhi në pushtet, në të njëjtën formë edhe do të dëbohet nga pushteti. Prandaj ka filluar që të kërcënohet e të shantazhojë përmes “myhybve” të vetë injorantë. Strategjia e tij është që t'i largojë të gjithë ata që e ndihmuan ta falcifikojë pozitën e vet përjetë të pamerituar. Shaqir Fetai nuk e ndërron pozitën e të qenurit “ORAO” për reis. Hala nuk i ka ardhur koha për të “fluturuar”, si Qenan Ismaili në vallet kapur për krahësh me pijanecë, spiunë e zinaxhinjë**

### **Shkruan Samedin Musliu**

Në një pyetje të gazetarit gjatë një interviste me ish-reisul-ulemanë, Sulejman ef. Rexhepi, të botuar ditë më parë në disa portale, pyetje kjo që kishte të bëjë me gabimet e ish-reisit si pasojë e mosvëmendjes apo si pasojë e gabimeve të qëllimshme, Sulejman ef. Rexhepi përgjigjet: “Gabime bëjmë që të gjithë, dikujt i kushtojnë me karrierë e dikujt me jetë, dikujt me fytyrë e dikujt me ngritje në detyrë! Dua të them që, edhe unë kam gabuar porse, betohem në gjithçka që gabimet e mia dalin të jenë vetëm si pasojë e mosvëmendjes sime, sepse, kam pasur besim të paluhatshëm në bashkëpunëtorët e mi. Për shembull, gabim trashanik dhe shkelje kushtetutare e imja është emërimi i Qenan Ismailit për Myfti të Shkupit. Kam qenë i parespektuar, qëllimisht më kanë vënë në lojë, me tendencë për ta vjedhur njërin nga organet më të rëndësishme të BFI-së! Betohem në Zot që nuk e kam ditur që Qenan Ismaili nuk ka asnjë ditë përvojë punë në BFI, ndonëse për t'u bërë Myfti kusht është që të ketë së paku pesë vite përvojë pune. Zotëria e fshehtë këtë fakt, e shkelë normën kushtetutare dhe, si mjeshtër i hajnisë, e vjedh titullin “myfti”! Në këtë ndytësirë unë jam treguar i pavëmendshëm dhe, natyrisht që e konsideroj gabim flagrant, jo sjelljen e Qenan Ismailit, por pavëmendshmërinë time...”

### **Qenan Ismaili – vjedhësi i postit të “myftiut”**

Prandaj, sot, Qenan Ismaili, parapëlqen të jetë drejtor shkolle, të jetë drejtor televizori, të jetë gazetarë, parapëlqen të jetë spiker, të jetë punëtor humanitar, të jetë mjek, virusolog, të jetë gjithçka ku ai mund të ndjehet rehat! Pra, atij i intereson rehatllëku i vet, të cilin është në gjendje ta arrijë edhe përmes krimin! Vepër penale është genjeshtra, avansimi me gënjeshtër, vjedhja, dhe prezantimi i rrejshëm. Këto ditë Qenan Ismaili, në një xhami të qytetit ishte përgjigjur në pyetjet e gazetarit lidhur me koronavirusin Kovid 19, me masat e myftinisë rreth ruajtjes së shëndetit të qytetarëve.

Qenan Ismailit me javë të tëra i shtrohen disa pyetje që kanë të bëjnë me zhvillimin e jetës fetare në territorin e Myftinisë, por ai i ik, sepse, nuk ndjehet rehat aty! Me dhjetra pyetje i shtrohen se çka u bë me dhjetra vakëfet? Çka u bë me objektin e ish-myftinisë së Shkupit, çka u bë me objektin “Ibni Pajko”, çka po bëhet me kompleksin e godinave të ish-Komunaleci, pse kaq lirë dhe pse s’po reagohej me keqpërdorimin e parave të vakëfit të denacionalizuar në formë të letrave me vlerë?

I bëhet pyetje Qenan Ismailit se pse e shkelë Kushtetutën, pse flet hoxhallëk e thirret në “tituj shkencor” kur të gjitha i ka të blerë me para! A dëshiron që t’i publikohen edhe këto fakte?

A mund t’i shkojë lutja në vend “hoxhës” apo “myftiut” i cili hedh valle dhe përdridhet bashkë me të pamoralshmit, me pijanecët, spiunët e zinaxhinjtë.

Është pyetur edhe për realizimin e premtimeve kur e vodhi postin “myfti”, çka u bë me kartelat e premtuara, me lëshimin e rrogave për çdo imamë në bankë, çka u bë me rritjen e rrogave të tyre, me siguracionet e tyre, me kontributet pensionalo-invalidor? Nuk ka përgjigje Qenan Ismaili në të tilla pyetje, sepse, ia ka zënë bishtin dera e po kuis si foshnja kur dënesë.

### **Planet e Shaqir Fetait për ta minimizuar peshën dhe rolin e Myftinisë së Shkupit**

Ja pse nuk e deshti Sulejman Rexhepin i cili pavëmendshëm e bëri “myfti”; ja pse e tradhëtoi “bekuesin” e vet dhe u rreshtua pas njeriut me të gjitha të këqijat e mundshme, por i cili nuk ka kurrfarë kontributi në “karrierën” e Qenan Ismailit.

Madje, nuk i bëri as konkurrencë në “reisllëk” duke bërë që për herë të parë në historinë e BFI-së ta lë Myftininë e Shkupit pa kurrfarë rëndësie, pa kurrfarë roli dhe pa kurrfarë peshe! Të ishte dikush tjetër myfti, thuase do të kishte shansë Shaqir Fetai të bëhej “reis”?! Do të rrotullohej krejt globi, do t’i ndërronin vendet tokë e qiell dhe, reisllëku do t’i ngelej Shkupit, por, me Qenan Ismailin “myfti” Shkupi gjason si një geto e mbytur në pisllekun e një rrugice të një mëhale të një metropoli mesjetar! Myftinia e Shkupit është myftini me më pak vakëf të denacionalizuar, ose, me më pak realizime të mjeteve materiale të lëshuara nga qeveria si shumë për vakëfin që nuk mund të denacionalizohet si pasojë e interesit të përgjithshëm shoqëror.

Pse tani i lejohet Shaqir Fetait që t’i pranojë ato shuma të kontestueshme, të cilat deri dje nuk janë pranuar! Pse e lejon Shaqir hajnin që t’i rrëmbejë ato para dhe t’ua ngrisë rrogën punëtorëve e t’ua sigurojë rrogat duke e lavdëruar pushtetin si shpëtimtarë dhe jo Myftininë e Shkupit!

Qenan Ismaili dëshiron të shpëtojë nga revidimi dhe abrogimi i vendimeve të marrura në kohën e Sulejman Rexhepit në të cilat ka plotë shkelje kushtetutare. Qenan Ismaili është më se i bindur se Shaqir Fetai, shumë shpejt do t’i hyjë edhe mohimit të shumë vendimeve të ish-reisit të cilat bien ndesh me Kushtetutën e BFI-së, sepse, Shaqir Fetai i duhet që të shpëtojë nga akuzat se është shkelësi më i madh i akteve normative në historikun e BFI-së. Qenan Ismaili i druhet këtij “rrebelimi” të Shaqir Fetait dhe të dalë sheshit se ai është bërë “myfti” në kundërshtim me të gjitha aktet normativ të BFI-së, prandaj edhe ia fërkon shpinën duke menduar se Shaqir Fetai nuk do ta marrë këtë si vardisje dhe lëpirje, si një skile e vjetër.



Nuk e ka dert Qenan Ismaili nëse e largojnë apo jo nga “myftillëku”, për të me rëndësi është që të arrijë të zhvatë ndonjë shumë parashë derisa është në këtë post. Pse, ku nuk zhvati ky? Çka bëri te “Kalliri i Mirësisë”? Po te FRI-ja?! Cilës shtëpi botuese me renome i vodhi para! Sa ishin: 40 mij apo 80 mij euro! Të publikohen këto fakte?! Shumë rëndë për myslimanin e devotshëm, por fare të lehta për atë që është mësuar të vjedhë nga një denarë e deri në postin e “myftiut”!

Shaqir Fetai përmes disa “myhybëve” të vetë injorantë, luten që të lihet i qetë se, shumë shpejt do të marrë masa kundër të gjithë atyreve që kanë vjedhur nga paratë që i ka siguruar Ismet Ademi, kundër të gjithë atyreve që janë pozicionuar në BFI si pasojë e shkeljeve kushtetutare.

Shaqir Fetai është më se i bindur që qeveria-pushteti aktual është më e rëndësishme se çdo organ i BFI-së. Ai një qime të Zajevit nuk e jep për tërë Myftininë e Shkupit. Pis mashkull i feminizuar!

*(Lajme7, 10.12.2020)*

## **BFI nuk ka për momentin, BFI po i ngjanë një filiale të partive në pushtet**

*Të gjithë pranojnë se në BFI ka pasur dhe ka shkelje të rënda kushtetutare, por të gjithë e heshtin këtë fakt*

**Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI në RMV këto ditë ka realizuar takime me pothuajse 90 % të drejtusve të organeve të BFI-së, lidhur me mbledhjen e fakteve dhe argumentave që kanë të bëjnë me shkeljet e Kushtetutës dhe akteve të shumta normative në BFI.**

Konstatim i përgjithshëm është se kjo dukuri antikushtetutare në BFI funksionon tash e një kohë më të gjatë por që ka kulmuar që nga momenti i shkarkimit të ish-reisit e deri në ditët e sotme. Sipas tyre, këto shkelje janë trimëruar nga një faktor politik i cili vazhdimisht ka asistuar, përmes mënyrave të ndryshme, në shkeljen kushtetutare, duke e garantuar paprekshmërinë institucionale deri në zgjedhje të Shaqir Fetait për reis, si i përzgjedhuri absolut i pushtetit aktual.

Që të gjithë drejtuesit e organeve të BFI-së pohojnë se, në ditën e votimeve për kandidatin për Kryetar të BFI-së, kanë qenë nën presion të një situatë të tensionuar nga prania e më shumë se 100 personave të sigurimit të cilët kanë agjituar për Shaqir Fetain në shkelje të çdo neni a akti normativ të BFI-së.

Kjo është një arsye që nuk pranojnë të flasin publikisht, sepse, ndjehen fajtorë dhe aktorë në shkeljen e të gjitha akteve normative të Institucionit të BFI-së! Nuk janë në gjendje ta fajësojnë vetëm Shaqir Fetain, pasi që, në rrugëtimin e tij të imoralshme deri në zgjedhje për kryetar të BFI-së që të gjithë janë bashkëpjesëmarrës në shkeljen e Kushtetutës dhe të rregulloreve të ndryshme.

Njëri prej përfaqësuesve të një organi jashtëzakonisht të rëndësishëm për BFI-në madje shkoi aq larg sa nënvizoi se që të gjithë tashmë janë peng të strukturave të BDI-së, sepse, nëse do të ankohe mi publikisht për këto shkelje, atëherë mund të paditemi nëpër organet e drejtësisë të vendit si shkelës të akteve normative që janë të deponuara dhe nën mbrojtjen e organeve të drejtësisë.

Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë i ka të evidentuara të gjitha bisedat me këta drejtues të organeve të BFI-së dhe, për ta ruajtur konfidencialitetin si dhe për t'i ruajtur nga masat ndëshkuese eventuale ndaj tyre, në këto fakte mund t'ia ofrojmë vetëm faktorëve ndërkombëtarë të cilët mund t'i verifikojnë edhe vetë konstatimet tona në biseda të drejtëpërdrejta me të gjithë me ata që kemi bashkëbiseduar.

Drejtuesit e organeve të BFI-së duhet të ndihmohen që të shpëtohen nga këto presione politiko-partiake, sepse po mbillet një traditë e tmerrshme në BFI. Askush nuk ka të drejtë më që të refuzojë apo të mos bëhet pjesë e kalkulimeve politike të partive të tjera. BFI nuk ka për momentin, BFI po i ngjanë një filiale të partive në pushtet. Nesër do të jetë filiale e partive të tjera! Kjo dukuri e tmerrshme duhet të ndalet sa më parë. Dhe, kjo mund të ndodhë vetëm në eliminim të të gjitha akteve të ndërmarra në kundërshtim me Kushtetutën e BFI-së dhe kthim sa më të shpejtë në kushtetutshmerinë e BFI-së.

*(Fokusi, 10.12.2020)*

## Në cilën ditë pa hajër BFI-ja nga Shaqir Fetai?!

**Shaqir Fetai, me begraundin prej udbashi, e ka shumë të vështirë që t'i lëvizë dy gurë e ta shtyjë përpara BFI-në! Shtytës nuk e ka interesin islam të vendit por, i ka udbashët në shenjë mirënjohje për tërë ato veprime antiislame që i ka bërë, që po i bën dhe që do t'i bëj në të ardhshmen**

### Shkruan Bledar Rashidi

Shaqir Fetai është shumë i ri për nga truri (sepse aq e ka kapacitetin intelektual) për të njohur historira të “lashta” si kjo e historisë së vet personale, për të kuptuar se, edhe udbashë më të sertë se ai kanë qenë të respektuar e të nderuar ndër popullatën shqiptare: pak nga frika, pak nga ngacmimi gjenetik (ata që janë spiunë në gjen), pak nga nevoja për ta trashëguar profesionin spiun, pak nga shpresa se duke qenë në bythë të spiunit e të udbashit do të jeshë më i respektuar e më i nderuar, pak nga shpresa se të qenurit pranë udbashit të lehtëson zgjidhjen e ndonjë halli, problemi, apo nevoje familjare etj.

#### 1.

Le t'ia përkujtojmë Shaqir Fetait historinë e fundit, nga 1945 e kënde! U desht të likuidohen aradhat kombëtare, çetat më të pastra të kombit, luftëtarët e papërsëritshëm në historinë kombëtare, vetëm e vetëm të zbatohen urdhërat e komisarëve partizanë deri në çlirimin antifashit të rajonit dhe, pastaj, do të bëhet mirë për të gjithë. Dhe, këto likuidime, linçime e eliminime janë realizuar falë kontributit të udbashëve proserbë. Pastaj, dyzet e pesë vite e ndërtuam Jugosllavinë për të na e ladruar nënën neve shqiptarëve, ndërsa në kryesi patëm edhe shqiptarë. Madje kryetari i fundit i Jugosllavisë ishte Sinan Hasani. “Shpëtimtarët e kombit dhe të fesë” një Zot e di se ku përfunduan, ngelën pa nam e nishan, ndërsa në kohën e pushtetit të tyre, i thurrnin këngë e lavdi, i thurrnin drama e filma, i thurrnin poezi e romane. Një komb i tërë ishte në funksion të udbashëve që na i kishte ngritë në krye të detyrave më të larta “kombëtare”!

#### 2.

Thonë, historia përsëritet pahetueshëm! Tani kemi në krye të “çallmave” një farë Shaqir Fetai i cili me pempele, me legjitimacion, me dokument, na doli se ka qenë spiun i UDB-së nën pseudonimin ORAO që nga bankat e fakultetit, edhe pse ka dokument që flet për angazhimin tij edhe në bankat e shkollës së mesme si “misionar” i UDB-së, sepse këtë e kishte gjenetike!

Shaqir Fetai, që kur e bëri puçin e parë, që kur duke falcifikuar dokumente uzurpoi postin e kryetarit të BFI-së, duke qenë skajshmërisht i kontestueshëm, sepse u kontrabandua nga subjektet politike që mbajnë pushtetin; Shaqir Fetai që kur vendosi të shkelë të gjitha aktet normative të BFI-së vetëm e vetëm ta zbatojë urdhërin e udbashëve, që të kapë pozitën e kryetarit të BFI-së, që kur erdhi në krye të kësaj pozite me falsifikime e me përkrahje të organizmave nëntokësore antikombëtare e antifetare

- e deri në ditën e sotshme, u strapacua duke qenë në rolin e portirit të institucionit
- prit e përcjell njerëz. Qe tetë muaj Shaqir Fetai na bombardoi me lajme spiuneske, kë ka pasur sot në zyre, kë ka pritur e kë ka përcjellë. Aktivitet tipik ky i një udbashi klasik.

3.

A ka parë BFI-ja ndonjë hajër nga ky farë “reisi” dhe, cila është ajo ditë që mund të veçohet nga këta 240 ditë i të qenurit zyrtarisht misionar i shërbimeve sekrete!

4.

Pse e bën këtë veprim Shaqir Fetai! Çka e motivon në këtë veprim! Çka synon Shaqir Fetai me këtë veprim “domaqinllëku” e që në fakt është “strategji udëbëeske?

Shaqir Fetai po vuan se si e tradhëtuan ata të sektorit të UDB-së në Sarajevë? Po vuan se pse ia publikuan, çka deshtën me atë faqe që ia publikuan, hala nuk e ka të qartë se ai mund të jetë vetëm udbash i përjetshëm e asesi argat i shërbimeve të tjera sekrete.

5.

Shaqir Fetai mendon se duke u vizituar çdo ditë nga delegacione të ndryshme, fare të parëndësishme, fare snobiste e diletanteske, nga delegacione krejt të kota, të porositura e të ftuara (natyrisht, edhe nga misonarë që kanë synim të gërryejnë në menalitetin dhe trurin e Shaqir Fetait), mendon se do të arrijë që të dëshmojë se sa shumë duhet, se sa shumë respektohet, se sa shumë nderohet, ndaj nuk mundet që një i nderuarqak i madh të jetë edhe udbash! Pra, Shaqir Fetai aktivitetin e vet me decenie në UDB mundohet ta kamuflojë përmes këtyre vizitave.

Veç kësaj, Shaqir Fetai, duke u sjellë si një qurë në mjegull, duke mos ditur se çka, si dhe ku të veprojë, e ka “shpikur” këtë aktivitet të humbjes së kohës shumë të shtrenjtë, duke bërë lajme të bajatshme e të poshtra që i shet për aktivitete.

6.

Paramendoni, Shaqir Fetai e bën lajm edhe hyrjen në kabinetin e tij të punëtorit të vet, të një profesori, të një prodekani! Po deri tani në zyren e tij ka hyre me dhjetra herë edhe një punëtorë tjetër, bie fjala, Mahmuti dhe kurrë nuk ka shkruar një lajm! Nuk është ky diskriminim, jo, por, është mburrje prej titullarëve që po e vizitojnë. Sepse, një portir e shofer mund të mashtrohet e ta vizitojë një spiun, por jo dhe një “doktor shkence”!

Ja, të tilla filma shikon Shaqir Fetai! Madje është zhytur në të tilla filma sa e ka të vështirë të dalë. Kur një ditë do të dalë nga ato filma dhe do të përballet me realitetin, do të çmendet. Dhe, duke qenë i çmendur do ta arsyetojë mungesën e çdo plani veprimi (plani akcional) javor, mujor apo vjetor! Po ta kishte një plan veprimi, nuk do të merrej me të tilla filma me skenar nga UDB-ja.

7.

BFI-ja nuk ka chans që të shohë një ditë të bardhë e të hajrit nga Shaqir Fetai, sepse, ky ka tjetër mision, jo ta drejtojë BFI-në por ta bindë mashtrueshëm opinionin se kurrë nuk ka qenë udbash.

8.

Kur jemi këtu, patjetër që duhet të nënvizohet një lajm i shkërdhymë që doli këto ditë lidhur me vdekjen e udbashit shqiptar, shkrimtarit dhe publicistit Nafi Çegrani, bashkëfshatarit të Shaqir Fetait.

9.

Të gjithë udbashët u gëzuan nga lajmi se “paska vdekur” Nafi Çegrani, pra, edhe çegrnasi Shaqir Fetai! Pse ky gëzim kaq i madh i udbashëve për vdekjen e Nafi Çegranit?!

*(Opinione, 12.12.2020)*

## **Kush është reisi? Si përkthehen nenet kushtetuese në “projekte” të Shaqir Fetait**

**Shaqir Fetai e zgjedh Kërçovën për t’u tallur me xhematin e sinqertë, por, Allahu Fuqiptotë bënë që Shaqir Fetai të turpërohet mu te këta myslimanë! Fatmir Deharit, kryetarit të Komunës, ia uron postin e reisit, kurse detyrimeve dhe obligimeve kushtetutare u thotë “projekt”. Shaqir Fetai përfundimisht i ka shitur drunj të dhe u ka hypur skijave**

**Nga Vehbi Myrtezani**

Shaqir Fetai e paska filluar një projekt (!!!) të vetin shumë, shumë, shumë interesant, të cilin e paska titulluar projekti “Pranë xhematit – pranë besimtarëve”! Këto idiotizma i shkojnë për shtati vetëm kapacitetit “intelektual” të Shaqir Fetait. Besimtarët, në fakt, janë vetë xhemati. Fjala xhemat i atribuohet besimtarit. Nuk mundet që jo besimtarët të përbëjnë xhemat, të paktën jo në xhami! Nejse, llapsuzet gjuhësore i tolerohen Shaqir Fetait sepse, aq ky e njuh gjuhën shqipe. Përkushtimin profesional më tepër e ka pasur për gjuhën serbe se sa për gjuhën shqipe dhe këtu duhet të mirëkuptohet. Por, si t’ia mirëkuptojmë rrenat! Kur po rrenë Shaqir Fetai: më 19 qershor kur iu drejtua xhematit të Xhamisë së Larme në Tetovë se, tash e tutje do të jemi pranë xhematit dhe pranë besimtarëve! Për çdo xhuma ai është në mesin e një xhemati të vendit. Kurse, këtë xhuma kumtoi se “Sot, edhe zyrtarisht, filluam projektin “Pranë xhematit, pranë besimtarëve”, “projekt” ky që përfshin vizitën e myslimanëve të qyteteve të ndryshme të vendit!

### **Kur Shaqir Fetai demonstroi arrogancë në mesin e xhematit**

Po pse e zgjedhi pikërisht Myftininë e Kërçovës për ta kumtuar këtë gënjshtër të madhe?! Le të na thotë se sa Shaqir Fetai e ka respektuar vullnetin e myslimanëve të Kërçovës, sa i ka respektuar propozimet e tyre për kandidatët potencialë për Myfti të Kërçovës! Jo që ka qenë pranë këtij xhemati, por, fatkeqësisht, e ka injoruar si “shkau jasinin”, triumfalisht ka shkelur këtë Myftini, pasi ua ka mohuar të drejtën për ta zgjedhur vetë ata përfaqësuesin e tyre në Rijaset, u demonstroi edhe arrogancë!

Pse po rrenë Shaqir Fetai se ky është një projekt! Apo Shaqir Fetai nuk e di se çka do të thotë projekti, nuk e di se si konceptohet projekti, nuk e di se si zhvillohet projekti, nuk e di se si përfundon projekti. Në fakt, Shaqir Fetai nuk di se si shkruhet projekti! Po pse i thotë projekt vizitave të xhematit të vendit? Sepse, Shaqir Fetai nuk e njuh Kushtetutën, nuk e ka lexuar dhe nuk e di këtë akt më të lartë juridik të BFI-së. Shaqir Fetai nuk e di se vizita e xhemateve të vendit është obligim, detyrim i kategorisë kushtetutare për vetë Reisin.

Pika 10 e nenit 44 të Kushtetutës së BFI-së flet për detyrat dhe obligimet e Reisul Ulemasë përgjatë zhvillimit të këtij funksioni. Kjo pikë nuk flet për projekte, siç i pordhë mendja Shaqir Fetait por, nëse është “reis” ai duhet të dijë se reisi, veç të tjerash “viziton regjionet në të cilët jetojnë pjesëtarët e fesë islame; që të njihet drejtpërdrejtë me gjendjen dhe propozon masa për zhvillimin dhe avansimin e jetës fetare”!

Shaqir Fetai po dëshmon se më tepër ia ka qejfi të punojë sipas dëshirës së vet prej diletanti se sa sipas obligimeve, detyrimeve dhe punëve që dalin nga Kushtetuta e BFI-së si dhe nga aktet e tjera normative të BFI-së.

### **Shaqir Fetai ia uron reisllëkun Fatmir Deharit!!!**

Se Shaqir Fetai ka dhe do të ketë probleme që do ta kualifikojnë atë si diletant dhe si rrencak, dëshmon edhe vizita e tij që ia paska bërë Fatmir Dehari, Kryetarit të Komunës së Kërçovës. Mbase e ka pasur nga emocionet sepse, po takohet për herë të parë me një patriot të mirëfilltë, apo e ka pasur nga frika e tmerrshme se si udhëbash po takohet me një luftëtarë të pathyeshëm të UÇK-së?

Sido qoftë, Shaqir Fetai, në fb-un e vet shkruan: “Z. Fatmir Dehari shfrytëzoi rastin që të na urojë për zgjedhjen e tij në krye të institucionit përfaqësues të muslimanëve të vendit!”

Mirë e ka Shaqir Fetai dhe, kur i ikë mendja del edhe i sinqertë! Shikuar nga perspektiva partiake, të gjithë funksionarët e BFI-së, të tubuar në Shaqir Fetah, janë të zgjedhur reisë dhe në krye të institucionit përfaqësues të muslimanëve të vendit. Kështu mendon Shaqir Fetai dhe kështu shkruan, nëse di të mendojë dhe të shkruajë!

*(Kombetare, 12.12.2020)*

## Cirkuzantët që zhonglerojnë me parimet islame

**Në fillim të këtij muaji, i ashtuquajhuri “myfti” i Shkupit, i ndier inferior, i pa peshë, pa kurrfarë rëndësie në tërë organin kolektiv të BFI-së, në Rijaset, bën një përpjekje që t’ia bëjë qejfin vetes se është “reis nën hije”! Mastrubim psikik i një të atrofizuari në tru, ishte ky gjest i Qenan Ismailit**

**Nga Saqip Sadiki**

Qenan Ismaili, i vetëquajhuri “myfti i Shkupit”, titull këtë që e merr pasi e mashtrroi Sulejman Rexhepin, paska qenë në Manastir, te “homologu” i vet! Tashmë është konfirmuar edhe nga ish-Reisul Ulema Sulejman ef. Rexhepi se Qenan Ismaili e ka gënjyer atë, i ka tradhëtuar parimet islame, si dhe qëllimisht ka shkelur Kushtetutën e BFI-së. Të tallesh me parimet islame nga të cilat nxirren edhe rregulloret që rregullojnë organizimin e jetës fetare islame, ky është një mëkat i pafalshëm, është sjellje antiislame me ç’rast e humb të drejtën e të qenurit pjesëtar i këtij komuniteti e jo më të behesh drejtues i tij!

Tani, ky farë “myftiu” duke e kuptuar se e fëlliqi punën, mendon se do ta kompensojë sado pak këtë fëlliqësi duke e paraqitur veten si “zot më vete” dhe, duke shkuar në Manastir, për t’ia uruar “myfillëkun”, homologut të vet në matrapazllëqe e në manipulim, Amit Rasimovskin.

Edhe Amiti, ngjashëm si Qenani, kanë arritur titullin “myfti” në mënyrë shumë të pandershme duke shkelur rregulla të parapara në Kushtetutën e BFI-së. Në kushte normale, as njëri e as tjetri nuk do ta meritonin këtë titull, sepse, që të dy janë të njohur si matrapazë.

Qenan Ismaili e fshehu faktin që nuk kishte asnjë ditë përvojë pune në Bashkësinë Fetare Islame (ai tërë jetën e vet ka punuar kundër këtij Institucioni), kurse për të arritur te titulli myfti, kusht është që të ketë të paktën pesë vite përvojë punë në këtë Institucion.

Amit Rasimovski ishte koordinator i Myftinisë së Manastirit. Për t’u bërë myfti ai duhej të shkonte në procedurë të rregullt, të paraparë në Kushtetutën e BFI-së për zgjedhje të myftinjëve, që do të thotë se, duhej të propozohej nga organi i Myftinisë së Manastirit, të kishte kundërkandidatë, propozimet nga Myftinia të vinin në Rijaset, të votoheshin dhe më i votuari Muraselen ta merrte nga Reisul Ulema. Amiti as nuk u propozua, as nuk u votua, as nuk u dekretua (sepse nuk kishte nga kush! Muraselen nuk e jep “organi” i paparaparë në Kushtetutë) por u “caktua” nga kryemanipulanti dhe kryematrapazi Shaqir Fetai, sepse i duhej vota e tij për t’u “zgjedhur”, gjegjësisht, për ta falcifikuar zgjedhjen e tij në krye të BFI-së!

Tani, sjellja e “myftiut” të Shkupit, Qenan Ismailit dëshmon se, edhe ky, jo që nuk e njej Kushtetutën e BFI-së por as që e ka lexuar qoftë edhe formalisht, sa për të thënë. Ndryshe, nuk do ta pranonte si “homolog” njerin e zgjedhur në mënyrë antikushtetutare. Këta të dy mund të jenë “homologë” vetëm në mënyrën e zgjedhjes jashtëkushtetutare në krye të Myftinive respektive, të Shkupit dhe Manastirit.



Tani, Qenan Ismaili ka gjithë të drejtën e vet që të thotë: nuk jam vetëm unë që jam zgjedhur në mënyrë antikushtetutare! Ja ku e kemi, edhe Amitin e shkretë. Ka edhe të tjerë minjë gjirizi, si këta dy “efendilerë”, të mbajtur nën dyzgjina të udbashit Shaqir Fetai.

A thua, në kushte normale, nëse BFI-ja do të drejtohej nga një reis i mirëfilltë, që për asnjë çmim nuk do t’i shkilte parimet e shenjta kuranore dhe as aktet normative të BFI- së, këta dy “myftinjë dylbera” a do të mund të drejtonin me Myftinitë respektive? Ua merr mendja se do të mund të gëzonin epitetin “myfti efendi?! Jo, për më të madhin kijamet. Minjtë bëjnë dasëm vetëm kur mungon maçoku!

*(Lajme7, 13.12.2020)*

## “Monologjet vaginale” të Shaqir Fetait

Ata që e njohin Shaqir Fetain, e dinë fare mirë se ai gjithnjë i ka dashur intervistat, madje edhe ka paguar intervistë televizive, sepse, Shaqir Fetai është i bindur se vetëm përmes ekranit televiziv mund ta dëshmoshë “intelektin” të cilin ky farë “alimi” e ka të trullafhtë, si kjo e imja! Nuk pranon të dalë në debate, qofshin edhe në të mirë të tij, sepse, e di se do të dalë i dobët, i akullt, i pistë, si ai sendi

Nga Vlora Krivca

I kam ndjekur disa intervista televizive të Shaqir Fetait, të vetëquajturit “reis” i BFI- së! Të gjitha janë shabllonistike, të njëjta, me pikë e presje, të thata, demagogjike, snobiste dhe, mbi të gjitha, janë do përpjekje për të dëshmuar se sa “i mençur jam”! I përcjell me porosi të babait tim që mburret se është mik me Shaqir Fetain. Më vjen keq për babain tim! Dhjetra bote me raki ka pirë në jetën e vet dhe sot mundohet me na shitë moral përmes Shaqir Fetait të pamoralshëm! Ju garantoj që e imja është me e mençur me e urtë dhe më “burrneshë” se sa “feministi”, Shaqir Fetai!

Në një shkrim kam lexuar se rrena është “dini dhe imani” i tij! Aq ia ka qejf bytha të gënjejë sa, ta shpifë çdo hoxhë që ekziston në botë! Edhe hoxhë edhe kaq rrencak?! Së fundmi, kishte kurdisur edhe një intervistë idiotike në “Tv Globi” (kështu ka qejf Shaqir Fetai, intervista nëpër tv lokale, sepse dëshiron të jetë prezent në çdo televizion), për ta shitur veten si e virgjër në vesh!

Shaqir Fetai thotë se po pret analizat e institucioneve shtetërore që më pastaj të kuptojë se pse e tradhëtoi Sulejman Rexhepin, të cilit i shërbeu që kur ishte këlysh! Shkarkimi duhet të vijë si pasojë e analizave të thella dhe gjithëpërfshirëse, e jo, në fillim të shkarkohet, pastaj të bëjmë analiza dhe t’i publikojmë arsyet se pse e shkarkuam Sulejman Rexhepin. Si ajo plaka e keqe që, pasi e hëngër mirë e fort, u ngrit për ta mbyllur derën se pati frikë që do ta zë dikush me këmbët përpjetë! Ky është Shaqir Fetai, i cili, me politikë ta përzinë aq fort sa, tërësisht del injorant, del abdall, del i hutuar si qura në mjegull, apo, si kjo e imja kur përgjaket nga ciklet mujore.

Subjekti onkret politik, lideri partiak, del dhe publikisht thotë që i ka dërgu të fala Sulejman Rexhepit pas njerëzve të partisë që mos ta kontestojë gjestin puçist të Shaqir Fetait, deri sa të kalojnë zgjedhjet dhe ta zgjedhim “kryeministrin e parë shqiptar”! Nuk i duket kjo politikë Shaqir Fetait? Brenda natës “dikush”, një dorë e zezë i mblodhi Shaqir Fetain me kasapët e vetë dhe, vendosën që t’ia ngulin thiken Sulejman Rexhepit! Dhe, Shaqir Fetai doli i ngulur si vagina kur niset për “në gjah”! Pas Shaqir Fetait jo që qëndron politika e një partie, jo që qëndrojnë institucionet shtetërore të drejtësisë por edhe një qeveri e tërë, një pushtet që ia ka ënda ta kontrollojë vakëfin përmes butakut, Shaqir Fetai! Shaqir Fetai mundohet të flasë diçka e del i trullafhtë, siç thashë më sipër, si kjo e imja pas mastrubimit!

Shaqir Fetai, në intervistat e veta të kurdisura, më asocon në shfaqjen dhe në veprën “Monologjet e Vaginës” të Eve Ensler, të botuar më vitin 1996, atëherë kur lëvizja feministe në botë kishte marrur formë dhe përkrahje të padiskutueshme.

Edhe Shaqir Fetai, pikërisht si kjo vepër, intervistën (të gjitha intervistat i ka të njëjta, shabllon) e koncepton në pesë nivele, në pesë cikle, në pesë lexime-interpretime.

Kapitulli i parë i “Monologjet e Vaginës”, titullohet “Qimet” dhe flet mbi anën estetike të vaginës! Që në fillimin e intervistës (në të gjitha intervistat) Shaqir Fetai e mbështjell, e bën lëmsh leshi muhabetin, duke e përzier e zier, me plotë pislleqe që nuk i kanë hije një teologu, sepse janë plot me demagogji, me gënjeshtër, e me pordha të ftohta. Shaqir Fetai flet dhe nuk e rruan fare (vaginën) për atë se çka flet!

Kapitulli i dytë titullohet “Përmbytja” dhe flet për humbjen e funksionit kolegjial, kur organet (femëror-mashkullor) flasin në mes vete dhe kuptohen mirë. Tani ai sendi i femrës merr kuptimin e vendit, të vendit ku nuk shkohet fare! Shumë shpejt edhe Shaqir Fetai do ta marrë këtë kuptim! Shumë shpejt do të braktiset, sepse, sa herë që po flet po gënjen. Nuk po tregon se aty ku ka gisht politika, aty ka edhe marrëveshje, ka allësh-verëshe, ka tregëti të zezë! Nuk po tregon se është shndërruar në një vend ku po vijnë e po urinojnë të gjithë ata që kanë probleme me prostatë. Shaqir Fetai ia futë si kau pelës kur mundohet të tregojë se si e paska gjetur kacën e BFI-së vetëm me një rrogë dhe se pastaj paska siguruar për gjashtë muaj kështu që tani nuk paska problem për rroga, madje edhe ua paska rritur nëpunësve të vetë. Nga muaji maj kur Shaqir Fetai me kasapët e vetë bënë masakër mbi aktet normative të BFI-së e deri më sot kanë kaluar shtatë muaj! Pra, ku i mori paratë për plus një muaj?! Po si paska bindje se pas Vitit të Ri do të stabilizohen financat e BFI-së! Ky zhargon është si i kurvës kur i flet kurvës, duke i dhënë fllad bythës. Po kur flet për reforma në administratë që e paska stabilizuar shumë fort?! Me spiunë, me kurvarë, me pianica, me pederastë, me diploma të blera, me hajna, me bashkëpunëtorë të shërbimeve sekrete?! Kjo është administrata e Shaqir Fetait, administratë që nuk po i nxirrëka dokumentet jashtë BFI-së?! A e di definicionin e administratës, administratorit, Shaqir Fetai? A e di se cila është detyra e administratës? A e di Shaqir Fetai se të gjitha dokumentet e BFI- së duhet të jenë transparente për myslimanët e vendit? Nëse merret me drogë, me vjedhje të vakëfit, me terrorizëm, me shit-blerje të armëve, atëherë mund t’i mbajë “sekret” dokumentet! Ndryshe, myslimanët e vendit kanë më shumë të drejtë të dinë se sa Shaqir Fetai për atë se çka ndodhë brenda Institucionit të myslimanëve të vendit, të cilin Shaqir Fetai e ka shndërruar në skenë personale për “Monologjet Vaginale” të tij.

Monologu vazhdon me kapitullin e tretë “Unë isha aty”! Po ku ishte Shaqir Fetai për këto tri dekada? Kujt ia fërkonte bolet dhe i joshte felet e veta, duke u shitur si krah i djathtë i babait të vet shpirtëror? Po si nuk e paska ditur Shaqir Fetai se çka po bëhet me financat e BFI-së? Ka kërkuar ndonjëherë raport? Ka raportuar ndonjëherë? Ia ka tërhequr dikujt vërejtjen si organ, si mbledhës i kontributeve të myslimanëve të Gostivarit? Çka është trullavë Shaqir Fetai si ajo shoqja pasi të ngopet me futje- nxjerrje të rrasta! Pse Shaqir Fetai nuk pranon e nuk thotë “Unë isha aty”, si Vagina që zhvillon monolog pa kurrfarë problemi. Monologjet e Shaqir Fetait po dalin si tepër të pederasta, as femër, as mashkull! Duhet ta pranojë Shaqir Fetai që ishte aty, plotë tridhjetë vite nëpër organe të ndryshme të BFI-së.

Me rradhë vie kapitulli me titull “Zogu i vogël që ia doli”! ORAO që ia doli! Sado “xhuxh” që edhe smokit në shtëpi i ha kullandrisur me kollare, megjithatë ia doli! Një të kërcyer e thikën në shpinë! Kriminel deri në palcë, ndërsa botën dëshiron ta bindë se është vetë “engjëlli”! Ia doli Shaqir Fetai, pak me përkrahje partiake, pak me përkrahje të pushtetit, pak me djallëzinë që e ka vlerë të kodit të vet gjenetik, pak me shpërblim nga shërbimet intelgjente të huaja, pak me shkelje të të gjithë akteve normative të BFI-së dhe, ja ku na u bë “reis”! Reis në moshën 62 vjeçe, ndërsa edhe dy vite duhet

të ikë në pension, ndërsa flet për plane e “projekte” të cilat askund nuk i ka publikuar, por që për realizim i duhen edhe nja 100 vite. Për shembull, Shaqir p... thotë që do ta bëjë BFI-në Institucion kreativ! Flet tamam si ajo sendja kur të trulloset pas “shoqit”! BFI Institucion kreativ? BFI-ja ka Kushtetutën e vet, dhe është themeluar ekskluzivisht për ta organizuar institucionalisht jetën fetare islame, në kuadër të normativës dhe rregullave islame që vlejshëm tash e 16 shekuj, dhe jo që të jetë kreative, sepse nuk është OJQ!

A e keni parë se si shitet Shaqir Fetai, do me thënë, se si mundohet ta shesë “imazhin” e vet prej “Shën Mërie”? Tamam si një zog i vogël që ia del, ia del të dalë nga moçali në të thatë. Megjithatë, ngelë pis, i baltosur nga moçali, sepse është i vogël dhe nuk guxon të futet në ujë e të lahet. Shaqir Fetai mendon se, të gjithë shpendët e botës e kanë prejardhjen nga ky zog që një ditë na u bë ORO. Si vetë Shaqir Fetai!

Kapitulli i fundit i kësaj vepre titullohet “Vagina ime është e neverikosur”! Tamam si Shaqir Fetai në fund të intervistës. Ka fundi i intervistës këndellet dhe e kupton që ka folur plotë një orë por nuk di se çka ka folur. Kjo e neverikos, por, e gëzon fakti që ka qenë në “monolog” dhe jo në debat, sepse do ta mërdhifnin si këtë timen kur bien temperaturat nën 10 gradë! Shaqir Fetai nuk duhet të neverikohet por, sa më parë që ta pranojë se është p... i fëlliqtë aq më të lehtë do ta ketë pensionimin. Ai duhet ta pranojë se është p... i fortë që ka guxim të shkelë Kushtetutën e BFI-së, të gjitha rregulloret, aktet e saj normative dhe, për t’i bërë syri, sepse, mbrapa e ka atë që pret t’i rrëshqasë si thiu në akull dhe t’i futet thellë e më thellë. Nuk ia falë as BDI-ja e as LSDM-ja, tashmë të stërvitura mirë për të rrëshqitur e përplasur diku sa më butë. Si te Shaqir Fetai, de!

*(Lajme7, 16.12.2020)*

## **Policia ndëshkon dasmorët, ledhaton Shaqir Fetain**

Qeveria mendon për të mirën e qytetarëve. Ka shtrënguar masat duke prekur edhe në gëzime apo pikëllime familjare. Nuk ka tubime masive, as në dasëm as në mort. Nuk ka tubime masive as në urim e as në pikëllim, as në sport e as në kulturë, as në rrugë e as në parqe. Ndryshe, nuk do të mund të luftohet pandemia. Është konstatuar shkencërisht se, një prej masave është edhe distanca fizike. Në tubime, në dasma, në ngushëllime, e në sebepe, nuk ka distancë fizike. Prandaj i ka ndaluar të gjitha tubimet, madje edhe i ka sanskionuar. Nuk ka as dasma dhe asgjë. Nuk janë të pakta rastet kur policia e shtetit ka ndërhyrë, madje edhe ka gjobitur dasmorë të cilët nuk respektojnë masat.

Por, a e ka parë, madje, a e ka përcjellë policia e shtetit “reisin” e falsifikuar, Shaqir Fetain, i cili madje edhe ua bën publike tubimet e miqve në kabinetin e tij. A vlejné këto masa edhe për Shaqir Fetain, apo, bashkëpunëtorët e shërbimeve sekrete përjetë mbeten të beneficuar. A e ka parë policia e shtetit fotografinë e Shaqir Fetait me nja 60-70 hoxhallarë nga Tetova që iu futën që të gjithë në zyre për t’ia uruar vjedhjen me sukses të postit të reisit!

Policia nuk duhet të punojë me dy kuti! Nuk duhet që ta tolerojë më të gënjejë e të manipulojë, duhet të dijë se Shaqir Fetai nuk është i besueshëm, tjetër flet e tjetër vepron. Nëpër intervista thotë se angazhohet për distancë fizike të xhematit nëpër xhami, ndërsa në zyren e tij mund të futen edhe njëqind për një herë, vetëm le të vijnë që ta urojnë. Sepse, Shaqir Fetai mendon se duke e uruar masovikisht, do të çlirohet nga ajo brengë shpirtërore, e patjetërsueshme, e përjetshme, për faktin që është shumë i vetëdëshëm për vjedhjen, falsifikimin dhe uzurpimin e postit reis me ndihmë partiake e të pushtetit.

Se, pushteti gjithnjë i ledhaton “njerëzit e vet” dëshmon edhe ky kollazh me fotografi me të cilët ilustron ky tekst. Turp për shtetin dhe për Shaqir Fetain që dalin në breg të rrenës me kënaqësinë më të madhe.

Nëse dikur Sulejman Rexhepi e shpallte të vdekur Koronavirusin, Shaqir Fetai po e ngjallë masovikisht. Nëse ish-reisi paska dhënë një deklaratë aksidentale (ndonëse si ai mendojnë mijëra shkencëtarë në botë), çka është duke bërë Shaqir Fetai përveçse po kontribuon në përhapjen sa më të shpejtë të Koronavirusit. Organet gjegjëse të shtetit mjaft e ledhatuan Shaqir Fetain, sepse ky është një tip që ta kërkon gishtin e mesëm e ta rrëmben tërë krahun!

*(Kombetare, 17.12.2020)*

# Shaqir Fetai shpend grabitqar mitik

(Shqetësime si refleksi i natyrshëm pasi të dëgjohet intervista demagogjike e plotë

rrena e Shaqir Fetait, dhënë televizionit lokal “KOHA”)

**Nga Besart Asipi**

Edhe një “monolog vaginal” i Shaqir Fetait, në një televizion lokal (Tv Koha), në të cilën ky far “reisi i falsifikuar” mundohet të na shesë bole për veshkë. Si asnjë herë më parë Shaqir Fetai ishte pak snob, pak demagog, pak rrenc, pak matrapaz, pak “i sinqertë”, pak “engjël”, pak djallë. Gjithçka nga pak por aspak njeri, ashtu siç dëshiron dhe porosinë e Madhi Zot.

Shaqir Fetai edhe kësaj rradhe merr mundin për ta mbrojtur “administratën” e vet që e paska bërë. Edhe ata që na qenkan hoxhallarë të mirë në fakt janë munafikë me vetë faktin që pranojnë të punojnë me Shaqir Fetain, alias ORAO, dhe me të zgjedhurit e tij që njihen si munafikë, hajna, kurvarë, zinaxhinjë, pederastë në shpirt, spiunë, bashkëpunëtorë të UDB-së e me nofka policore “Orao”, “Cigo”, “Humanitarac”, “Osa”, “Orient” etj. Dikund lexova një fakt të tmerrshëm: “Kurrë në historinë e vet BFI-ja nuk ka pasur spiunë më shumë se sot”. Shaqir Fetai tashmë BFI-në e ka shndërruar në filiale të UDB-së.

Duke shpresuar në fuqinë e kësaj strukture, duke besuar në frikën patologjike gjenetike që e kanë myslimanët e këtij nënqielli nga kjo strukturë policore, Shaqir Fetai është i bindur se besimtarët do t’i nënshtrohen kësaj frike dhe me urdhër policor të gjithë do të kontribuojnë financiarisht për ta nxjerrë nga kriza financiare dhe për ta “stabilizuar financiarisht BFI-në”!

Shaqir Fetai pikërisht në këtë strukturë mendon kur thotë se tashmë në BFI ndjehet “një frymë e re”! Fryma e re me të degjeneruar! Këta do t’ia kthejnë besimin myslimanëve të vendit për BFI-në.

Në këtë intervistë Sulejman Rexhepi na del menaxhues i mirë. Në veprat e mira dhe të hajrit të Sulejman Rexhepit, Shaqir Fetait ia ka ënda ta përfshijë edhe veten, duke e përdorur shumësin e vetës së tretë: “në kohën e paraardhësit tonë “kemi” arritur suksese të mëdha, “kemi” bërë punë madhore, “ne” themeluan medrese, FSHI etj. Nuk është e qartë akoma se pse Shaqir Fetait i parapëlqen që ta theksojë aq shume gënjeshtërin “ne kemi pese medrese”, apo shpreson se një ditë kjo gënjeshtëri do t’i shpaguehet duke marrur para nga qeveria për “pese medrese”! Shaqir Fetai duhet të jetë i saktë, nuk guxon të manipulojë e të shpenzojë në emër të 5 medreseve, sepse është vetëm një e vërtetë: në Maqedoninë e Veriut funksionon vetëm një, Medreseja “Isa Beu” e dispersuar në pese qendra të vendit.

Sa herë që Shaqir Fetai pyetet se a ka pasur dore politika në zgjedhjen e tij, nis e belbëzon si i hutuar, për t’i ardhur goja kur fletë për oqeanet e pashterrshme! Pse Shaqir Fetai ka kaq shumë nevojë për një pyetje të tillë tashme e konsumuar deri në pakuptimësi? Pse ka nevojë t’i përgjigjet Shaqir Fetai një pyetje të tillë e cila gjithnjë e nxjerr rrencak duke e lënë si mutin në shi!

Vetëm politika, vetëm strukturat intelegjente, vetëm marrëveshjet partiake do të kishin fuqinë e tubimit të bashkëpunëtorëve dhe vasalëve të vetë, brenda natës. Shaqir Fetai me bashkëvasalët e vet kurrë nuk e këshilluan Sulejman Rexhepin, ashtu siç urdhërojnë ajetet kuranore që me aq lezet i thekson Shaqir Fetai nëpër intervista, pse nuk e udhëzuan kah e mbara, pse kurre nuk e luten Zotin për të, pse

refuzuan pese vite thirrje për reforma në BFI duke e madhëruar Sulejman Rexhepin dhe punën e tij, pse katër musketirët e shërbimeve intelektuale kishin dhënë deklaratat fantastike për personalitetin e Sulejman Rexhepit gjatë përgatitjes së një dokumentari, dy ditë para se ta eliminonin me puç e falën bashkarisht Bajramin e Ramazanin! Si ndodhi që brenda dy netëve të ndërgjegjësohen aq shume dhe aq masivisht sa, brenda mengjesit, “krejt spontanisht” u mblodhën dhe e shkarkuan Sulejman Rexhepin, duke falsifikuar vula e anëtarë rijaseti. Kush do ta arrinte këtë “sukses”, kush do ta kishte guximin për një falsifikim të tillë, pa përkrahje politike si dhe të pushtetit, duke i shkelur të gjitha aktet normative të Institucionit. A thua çka do të kishte ndodhur në Austri, në Gjermani, në Francë, në Angli, në “shtetet e demokracionit” të Shaqir Fetait, po të shkileshin në mënyre kaq flagrante aktet normative të një Institucioni, qoftë ky i nivelit të një ojq-je. Më e pakta do të përfundonin në burg për shkak të keqpërdorimit të pozitës dhe detyrës. Atë çka ka bërë Shaqir Fetai në një shtet normal do të duhej të kalbej në burg.

Kur pyetet Shaqir Fetai se cili është programi i tij, strategjia e tij, qëllimi dhe synimet e tij, ai fillon e eksaltohet duke interpretuar ajete kuranore, të cilat i harroi deri sa i shërbente verbërisht Sulejman Rexhepit. Fatkeqësisht, sot vetë Shaqir Fetai po e nëpërkëmbë këtë vlerësim duke dëshmuar se hafizllëkun e paska pasur vetëm si kamuflazhë të hedhur mbi djallëzitë e tij që për momentin po manifestohen vetëm si rrena bajate. Shaqir Fetai nuk mund ta arrijë faljen e të Madhit Zot duke u perpjekur që përmes rrenave të bëjë ndonjë veper të mirë dhe të arrijë ta shlyej ndonjë mëkat të pafalshëm deri sa ka qenë ORAO. Ky shpend trajtohet gati si i pavdekshëm, në momentin e ngordhjes së saj, ajo merr fuqi dhe sërish hidhet në veprimtarinë e vet prej Shqiponje. Prandaj, jo rastësisht e pagëzuan me ORAO, kanë mundur ta pagëzojnë si të tjerët me “Hafuz”, “Sheriat”, “Vezir” etj. Por, jo, ky në një moment duhej të ringjallej! Ja ku e kemi, me të gjitha karakteristikat e egra të një shpendi grabitqar. Zoti e marroftë, siç po e marron përditë e nga pak.

*(Politesa, 18.12.2020)*

## Djali fshihet në detaje

**Shikuar sipërfaqësisht, Shaqir Fetai na del si një injorant që duhet të udhëzohet e të këshillohet kah e mbara, por, nëse i analizojmë detajet e veprimeve të tij, do të konkludojmë se bëhet fjalë për një satana të veshur me lëkurë qengji. Le ta analizojmë pak nga këndvështrimi i zërthimit të detajeve**

**Nga Haxhi Isa Xhaviti**

Mbi tre dekada Shaqir Fetai na i paska shërbyer Sulejman Rexhepit, duke e lutur që ta pranojë e ta konsiderojë përjetë krah i djathtë i tij! E ka sprovuar disa herë Sulejman Rexhepi lojalitetin e kësaj “melaqe” dhe, çuditërisht, gjithnjë i ka dalur besnik e adhurues, tamam si putist i devotshëm. Pas Shaqir Fetait janë radhitur edhe të tjerët, sepse ky ka qenë shembull se si respektohet dhe si dëshmohet lojaliteti ndaj Sulejman Rexhepit i cili gjithnjë ka ditur edhe ta shpërblejë këtë “nënshtrim”! Madje, Shaqir Fetai çdo herë e ka ndërjerë si pengesë ish-sekretarin gjeneral H. Afrim Tahirin për ta adhuruar Sulejman Rexhepin ashtu siç di vetëm Shaqir Fetai. I është dukur si pengesë, si person që nuk e toleron adhurimet dhe lojalitetin prej servili siç e praktikonte Shaqir Fetai.

Ndaj dhe, sipas një debati televiziv ku sqarohet Sulejman Rexhepi, veç tjerash dëshmon edhe për angazhimin e pazezervë të Shaqir Fetait për ta larguar Afrim Tahirin si dhe miqtë e tij që kanë pirë kafe me efendi Afrimin. Sulejman Rexhepi mendon se Shaqir Fetai e ka xhelozuar tepër shumë Afrim Tahirin ndaj dhe i ka sugjeruar që ta heq atë, ndërsa të mbahet, madje ky edhe ta trashëgojë armikun e Afrim Tahirit dhe të tërë BFI-së, Mustafa Dautin!

Sikur të ishte akoma në BFI Afrim Tahiri si dhe miqtë e tij që u dëbuan nga puna sepse kanë pirë kafe me Afrimin, Shaqir Fetai edhe koqet e veta t’i kishte gëlltitur nuk do të mund ta luante lojën e shërbimeve të huaja inteligjente për ta futur nën kontrollin e tyre Bashkësinë Fetare Islame. Sepse, Afrim Tahiri është dëshmuar disa herë se nuk i intereson pushteti, se nuk i nënshtrohet partive, as politikës, as personave të fortë politik e policor. Të gjithë e mbajnë mend debatin televiziv të Afrim Tahirit në AlsatM me ish-zv/kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, z. Musa Xhaferi për sa i përket vakëfit si dhe përpyekjeve të politikës për t’u shtrirë në BFI!

Të gjithëve u kujtohet se cili ishte qëndrimi i Afrim Tahirit ndaj kryeministrit, ndaj kryetarit të shtetit, ndaj shërbimeve e organeve në varësi të këtyre faktorëve. Afrim Tahiri nuk ka pranuar që të bëjë politikë me asnjë parti por as me organet shtetërore. Ndërsa Shaqir Fetai në intervistën e fundit thotë se është i detyrar të bashkëpunojë me partitë politike si dhe me organet e larta shtetërore, sepse kthimi i pronave të vakëfit si dhe akreditimi i medresesë varet nga ky bashkëpunim, e jo vënien e politikës anti-BFI para aktit të kryer!



Afrim ef. Tahiri, ndonëse shumë i ri, gjithnjë e ka ditur se vasaliteti ndaj partive dhe organeve të shtetit është i dëmshëm për këtë Institucion dhe se, shteti vetëm sa duhet të informohet për detyrimet e saj ndaj BFI-së. Nëse nuk i merr parasysh këto detyrime atëherë, pasojnë ankesat te institucionet dhe faktorët relevantë ndërkombëtarë, e deri në shprehje të padëgjueshmërie qytetare ndaj organeve shtetërore. Kjo duhet të jetë politika e BFI-së dhe jo servilizmat partiake, bashkëpunimi i kushtëzuar me organet e shtetit, apo pranimi i spiunimit si detyrë parësore.

Shaqir Fetai është dashur të punojë si urithi nëntokë. Të ndikojë në largimin e Afrim Tahirit, në largimin e miqve që preferonin të pijnë kafe me Afrim Tahirin, e që, në procese gjyqësore e kanë si dëshmitarë, dhe, në një prej proceseve Shaqir Fetai duhet të dëshmojë se nuk është rrencak! Këtë provim do ta japë duke dëshmuar se nuk ka propozuar për largimin e miqve të Afrimit pse kanë pirë kafe me të, por, sepse nuk kanë qenë në punë pesë ditë brenda vitit. Para se do të dëshmojë prej tij do të kërkohet që të betohet në Kuranin Madhështorë se do ta dëshmojë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën! E pastaj do t'i publikohet incizimi ku ai jep "fetvanë" për largimin e personit që me metoda policore është fotografuar duke pirë kafe me H. Afrim ef. Tahirin!

Dhe, pasi ia arriti këtij qëllimi, pasi u njohtua me të gjithë bashkëpunëtorët e shërbimeve sekrete në BFI, nuk e pat të vështirë për ta zbatuar planin e këtyre shërbimeve, ta mbledhë sojin, honxho-bonxhot e vet dhe t'ia bëjë puçin Sulejman Rexhepit. Natyrisht, duke u përkrahur në të gjitha shkeljet kushtetutare, në të gjitha aktet normative të BFI-së. Sepse, ndryshe, nuk do të zbatohet plani nëntokësor.

Nuk ka ndodhur në botë, në asnjë institucion, në asnjë shtet, në asnjë organizatë që, të mblidhen nëpunësit dhe ta shkarkojnë të parin! Ministrat që nuk janë të kënaqur me kryeministrin, japin dorëheqje! Nëpunësit që nuk janë të kënaqur me të parin e organizatës apo të institucionit, nuk e shkarkojnë të parin por japin dorëheqje, vetëlargohen në shenjë pakënaqësie. Vetëm Shaqir Fetai kërkon që të shkarkohet Sulejman Rexhepi, në vend se të japë dorëheqje e të largohet në shenjë pakënaqësie me ndonjë veprim të Sulejman Rexhepit. Jo pra, nuk ka qenë ky qëllimi i Shaqir Fetait, ai nuk ka qëllime, por ka detyra nga shërbimi sekret për të kryer punë konkrete!

Ka pasur intelektualë e akademikë të cilëve, sapo u ka dalë nofka policore, nga turpi dhe nga dëshpërimi i skajshëm, ka zhytur kokën në govatë me raki dhe, brenda muajit ka vdekur. Tjetri nuk ka dalur as deri në derë të oborrit, një tjetër është i pekur nga disa sëmundje të këqia, ndërsa vetëm Shaqir Fetai, ndonëse i doli nofka policore si udhëbues (ORAO), këtij i shtohet sevdaja edhe më shumë që të bëhet "reis" dhe të vizitohet e të urohet nga krejt bota. Edhe unë do ta uroj: urime Shaqir Fetai, edhe pse u dëshmove si udhëbues arrite të bëhesh "prijës" i hoxhallarëve të vendit, pra, përmes teje UDB-ja serbe t'i mbajë në grusht të gjithë hoxhallarët e vendit.

E realizoi misionin e nëntokës Shaqir Fetai, sepse, ky ishte synimi dhe qëllimi i nëntokës, kurse Shaqir Fetai e pati detyrim jetësor. Ndryshe, do të largohej me dorëheqje dh do ta bënte përrallë Sulejman Rexhepin, duke e justifikuar dhe arsyetuar dorëheqjen e vet. Do ta kishte më të lehtë se sa të përtypet e të gëlltitet nga sikleti i pamundësisë për ta arsyetuar shkarkimin dhe puçin ndaj Sulejman Rexhepit.

Me këtë puç Shaqir Fetai e dëshmoi se nuk i intereson BFI-ja, të cilën mundohen ta kontrollojnë shumë “organizata”. Për ta bërë sa më të nënshtrueshme, ai vetë ishkelë të gjitha aktet normative dhe tërë Kushtetutën e BFI-së! Ky veprim është hyrje në një anarki totale që shkaktohet për t’u instaluar një diktaturë të egër, deri në veprimtari terroriste.

Ishalla me këtë vështrim kemi dhënë sado pak kontribut në zbërthimin e detajeve prej nga e kemi nxjerrë djallin këmbëkryq mbi “çallmën” Shaqir Fetait.

*(1Kliklart, 18.12.2020)*

## Mutacioni i aktiviteteve pandemike në BFI-në e Shaqir Fetait

**Gjashtë muaj rresht Shaqir Fetai u ekzaltua me urime e përshëndetje të porositura sa për ta mbuluar tradhëtinë që ia bëri BFI-së! Tradhëti është edhe imponimi dhe mbjellja e një praktike jointucionale. Për shembull, ushtrues detyre! Tani që është bërë i “plotëfuqishëm” ky aktivitet do të zgjasë një vit, sepse, si do t’i “institucionalizojë” të gjitha ato shkelje kushtetutare, si rezultat i “mësimeve partiake”**

### Shkruan Astrit Gashi

Janë nja 200-300 veta, hajde, le të jenë edhe 500 veta, qe 1000, që deri më sot i kanë shprehur urimet dhe përshëndetjet farse për Shaqir Fetain i cili u instalua në BFI si “reis”, falë angazhimit perfid të koalicionit qeveritar LSDM-BDI! Mbi 80 për qind të këtyre urimeve dhe përshëndetjeve të myslimanëve të vendit dhe nga jashtë ishin me porosi të Shaqir Fetait, ashtu siç bëri edhe në variantin e par të instalimit të tij në BFI jashtë të gjitha akteve normative të këtij Institucioni.

Shaqir Fetait i duhen këto lëvizje, sepse, ai është i bindur se me këtë gjest do të arrijë që ta zvetënojë bindjen se ai është i paligjshëm, pa legjitimitet, i kontrabanduar, i kontestuar dhe i instaluar nga lojërata e pandershme të partisë “myslimane” në pushtet, por që vjen si porosi e recidivave të UDB-së. Komentet negative, janë shumëfish më tepër në numër se sa ata që ia shprehin urimet dhe përshëndetjet e porositura, janë shumëfish më të ashpra, më ofenduese, më reale, më objektive dhe më meritore. Shprehur në përqindje, nuk janë më shumë se sa 0.5 për qind e myslimanëve të vendit. E madhe është urrejtja e mbi 99.95 për qind e myslimanëve të vendit që e shprehin ndaj Shaqir Fetait. Për më tepër, Shaqir Fetai me këtë lëvizje idiotike nuk mund ta relativizojë profesionin e tij parësor prej udhëbashi nën pseudonimin “ORAO”!

Sikur çdo ditë, të vijnë e ta urojnë nga nja 1000 myslimanë, prap nuk do të mund ta shlyej këtë njëllë e cila nuk mund të prodhojë simpati, por, urrejtje të pakufizuar. Shaqir Fetai është vetëm çështje kohe kur do të fillojë ta ndjejë këtë peshë të papërballueshme të urrejtjes masovike të shqiptarëve dhe myslimanëve të vendit. Ekzibicionet e tij prej hipokriti, zhonglimet e tij prej demagogu, salltat e tij prej palaçoje, nuk mund t’ia kamuflonjë asnjë djallëzi Shaqir Fetait.

Shaqir Fetai po ndjenë se po shterron avazi i urimeve dhe përshëndetjeve të porositura. Tani ka shpikur një model të ri të këtij “aktiviteti”, sepse, ai gjithnjë e më tepër po këndellet dhe po vetëdijësohet se ka bërë gabim, mëkat dhe haram të madh me shkeljet kushtetutare si dhe të akteve normative të BFI-së. Ky fakt po e mundon, ky fakt po e vret përditë e nga pak, po e dërmon e po e shkatërron së brendshmi. Prandaj ngushëllim gjenë në shtimin e kësaj djallëzie: nuk është i djallëzuar vetëm Shaqir Fetai, por edhe të tjerët. Kanë filluar t’ia kërkojnë borxhet, qoftë si mjete materiale, qoftë si premtime. Kanë filluar të nxjerrin kokë kërcënimit ndaj “reisit” rrencak, i cili, nuk mund t’i durojë, prandaj e stimulon vazhdimin e urimeve dhe përshëndetjeve të cilat shërbejnë si lëkurë qengji për veshjen e ujkut!

Kohëve të fundit, ka inicuar përshëndetjet dhe urimet “kolegiale” të myftive shprehur ndaj “reisit”! Tani, ky epizod përfundoi dhe, këto urime dhe përshëndetje duhet të marrin tjetër dimension: të urohen dhe të përshëndeten “kolegialisht” “myftinjë e zgjedhur dhe të emëruar”, nga Shaqir Fetai. Sepse,

me këtë lëvizje Shaqir Fetai mendon se do të justifikohen shkeljet procedurale dhe kushtetutare që i ka bërë me këto “emërime të myftinjëve”! Pra, Shaqir Fetai pret që të falet, të urohet dhe të bekohet për këtë djallëzi, për këto lëvizje joinstitucionale, jo legale dhe ilegjitime. Myftia ilegjitim i Shkupit përshëndet “myftinë” e Manastirit, po i njëjti përshëndet edhe u.d. myfti i Gostivarit? A e mban në mend Shaqir Fetai se ku ka pasur u.d. myfti në historikun e BFI-së, apo, a mund të na gjejë se në cilin akt normativ nënvizohet ky “post”? Shaqir Fetai bën shkelje të rënda kushtetutare dhe pastaj inicon “aktivitete” që të përshëndeten këto shkelje nga bashkëpunëtorët e vetë, duke menduar se kësisoj harami parcializohet, shpërndahet te të gjithë dhe më pak do të peshojë në shpirtin e Shaqir Fetait. Po ashtu, shkeljet kushtetuese të Shaqir Fetait aplaudohen edhe nga “kryetari i përjetshëm i Shoqatës inegzistente të ulemave të injorancës”, i cili shkon dhe e përgëzon këtë gjest skandaloz të Shaqir Fetait, duke ia uruar gjestin antikushtetues me rastin e “caktimit” u.d. të myftiut të Gostivarit.

Gostivari i plotëson të gjitha kushtet që të ketë Myftiun e vet legjitim, por, ja që Shaqir Fetai nuk mund të funksionojë pa shkelje të Kushtetutës së BFI-së.

Së fundmi, për të zgjatur sa më shumë hipokrizia dhe demagogjia e Shaqir Fetait, do të kërkohet që edhe myftinjët dhe organet e ndryshme të BFI-së, të enden në mes vete duke ia uruan njëri-tjetrit zgjedhjen e Shaqir Fetait për “reis” të tyre.

A nuk ju gjason ky idiotizëm i Shaqir Fetait në një pandemi me një kompleks viral që po frymon brenda BFI-së, e me tendencë të arrijë një mutacion të paparashikueshëm, i cili do ta bëjë një botë të tërë që të na injorjnë e të na përbuzin si faktorë shumë të rrezikshëm që duhet të dalin farësh!

Shumë keq, një Shaqir Feta, me një CV shumë të diskutueshëm e të trishtueshëm, të lejhet që të tallet me myslimanët e vendit! Shumë shpejt do t’i japë vetes “fuqi faraonike”, duke shkelur gjithçka që i del para, sepse, që të gjithë i ka ilegjitim. Legjitimiteti do t’i duhet nga legjitimët, prandaj, për t’i tërhequr ata kah vetja, në formë centrifugale, do t’i duhet ajo “forcë faraonike” me një përmyllje e një fund tragjikomik për të gjithë myslimanët e vendit. Zoti mos e bëftë atë çfarë ka në mendje e në plan Shaqir Fetai, ish-studenti i Stanko Dragoviqit, epror i UDB-së.

*(Opinione, 21.12.2020)*

## Softueri demode i Shaqir Fetait

**Software quhet bashkësia e programeve kompjuterike dhe të dhënat e tjera që përmbajnë instruksione që i thonë kompjuterit se çfarë duhet të bëjë. Thënë thjesht, i bie si UDB-ja e ngulitur në trurin e bashkëpunëtorit të vet që nuk di të bëjë asgjë pa instrukcionet spiuneske që i merr të përditësuara**

**Nga Haxhi Isa Xhaviti**

Shaqir Fetai, “reisi” i kontrabanduar, i falsifikuar, partiakisht i instaluar dhe praktikisht i kontestuar, i shterri të gjitha televizionet lokale dhe, iu desht që ta “themelojë” një televizion personal të cilën e kishte emërtuar me “TV IKRE”! Ky “televizion” startoi me intervistën që një moderator e kishte bërë me Shaqir Fetain! Në fakt, bëhet fjalë për të njëjtën studio të cilën BFI-ja e ka më shumë se një dekadë. Zakonisht, kjo studio incizonte emisione fetare, sidomos për muajin e Ramazanit si dhe me rastet e ditëve festive islame, të cilat pastaj i emitonte në etër përmes kanalit të vet në facebook e youtube!

Shaqir Fetai, meqë shquhet si i pafytyrë, ekspert në vjedhje dhe në plagjiaturë, rrencak e fuks, nuk e ka për dert që t’i drejtohet opinionit me fjalët “themeliam një kanal televiziv”, dhe, edhe ky “televizion” starton me Shaqir Fetain në BFI, si “çdo gjë tjetër” madje edhe si vetë BFI-ja që po starton me instalimin e tij si një sexi lojalist i shërbimeve të ndryshme.

Po ku di Shaqir Fetai se çka do të thotë “kanal televiziv”, ku di ai se si themelohet ky kanal, kush e ka të drejtën e themelimit, në çfarë frekuencash emetohet ai kanal, ku e ka të instaluar antenën-përçuesin! Shaqir Fetai në këtë aspekt është injorant i thellë dhe, sakaq, e tradhëton edhe softuerin që e ka të vjedhur dhe të instaluar në mënyrë false.

Ajo çka pallamudë në atë intervistë është çështje më vete! Shaqir Fetai do të imponohet si “dijetar”, si “filozof”, si “i moralshëm”, si “takvaxhi”, si “menaxher” ndërsa nuk kupton se sa herë që folë e tradhëton intelegjenca e tij e thatë, e pajujtur, prej demagogu, diletanti, intelegjencë e tipit të stërvitur për të përbulluar përjetimin e çdo gjë të keqe në të mirë të strategjisë së “stërvitësit”!

Shaqir Fetai, së pari, fetarisht e ka të ndaluar që të përshëndesë islamikisht, apo që të lutet për myslimanët e vendit dhe më gjërë, pa u penduar në emër të Allahut dhe pa kërkuar falje prej Tij, për tërë atë veprimtari që e ka ushtruar që nga viti 1983 nëdëm të myslimalnëve, të familjeve myslimane, në dëm të islamit. Ai duhet të bëjë teube e pastaj t’ju drejtohet myslimanëve, të dëshmojë se është kthyer kah Kibla dhe se ka hequr dorë nga të qenurit hipokrit e mynafik.

Shaqir Fetai që në fillim të intervistës dëshmon se vazhdon me zejen e hipokritit! Qenka një projekt shumë i madh dhe një nismë e madhe “kanali televiziv TV Ikre”, në të cilën ka incizuar dhjetra intervista e ligjerata fetare përgjatë një dekade e gjysmë sa ekziston ky “televizion” dhe që i ka të emetuar si në facebook po ashtu edhe në kanalet e Yotub-es së BFI-së! Apo, Shaqir Fetai është i bindur se në Maqedoninë e Veriut për myslimanët gjithçka fillon me të. I druhet të kaluarës, nuk do ta përmend të kaluarën, mundësisht lutet që t’i bijmë “delete” dhe asgjë mos të kujtojmë nga e kaluara, sepse, sakaq do të na dalë para syve Shaqir Fetai, djalli vetë i kamufluar në engjëll, i cili, një ditë u çorodit fare dhe, duke shkelur çdo akt normativ, duke tradhëtuar e duke u përkratur nga strukturat

e veçanta të pushtetit, do të instalohet në krye të BFI-së, me qëllim që ta nisë “ngritjen e vetëdijes tek popullata myslimane në vend (sepse atij ia kanë prezantuar këtë popullatë si primitive, si të pamoralshme, si injorante), ta prezantojë islamit në frymën burimore, në frymën e kohës, vendit...” Shaqir Fetai, i bindur se ky “kanal televiziv” që do të emetohet përmes facebook-ut dhe yotub-es, “do të kontribuojë për shpjegimin e islamit, në shërbim të dijës, shkencës, paqes, tolerancës, të afrimit të njerzve, të humanizmit të ambientit ku jetojmë, me qëllim që të jemi subjekt kreativ”! Shaqir Fetai na flet si për një instrument me përmasa botërore, si një projekt të organizatave më të fuqishme në botë, flet për një nismë të një epoke të re, flet tamam si i përhanë, si një somnabul që mendon se po ec në hënë apo në mars dhe se i ka ngeur vetëm edhe një hap që të ngjitet në “arsh”! Kaq të vetëpëlqyer, kaq narcis, kaq të vetëdashuruar nuk e gjenë njeriu në fytyrë të tokës! Shaqir Fetai kohve të fundit, sa herë që lutet nga gazetarët që të flasë për gjendjen aktuale të BFI-së dhe për planet e tij, ai nis e flet i shkëputur tërësisht nga grimca intelektuale që mund ta ketë diku në kafkën e tij boshe! Flat e përzier, llapanguzë e pallamudë, sikur të jetë kompetenti i vetëm i këtij Institucioni, duke ofenduar myslimanë, duke menduar se tani me të do të nisë moralizimi i shoqërisë, duke menduar se tani me të do të nisë daveti, do të nisë shpjegimi i islamit, duke folur për “strategjitë” që i përzier me program e me plan konkret. Ai nuk di se çka është strategjia, çka është programi, çka është plani akcional. Ai nuk e di se nëse do të kishte strategji, do ta prezantonte edhe planin e vet vjetor, i cili, sikur të ekzistonte do të duhej ta kishte edhe planin akcional i cili do ta zbërthente tërë atë program, në ditë, në javë, në muaj. Ditët e para, javët e para, muaji i parë iku, u fshi nga plani akcional! Çka përfshinte ky muaj i planit akcional që u hartua mbi programin vjetor të Shaqir Fetait?! Urime dhe përshëndetje! Dmth e ka planifikuar që më parë edhe këtë plan idiotik të urimeve dhe përshëndetjeve. Bota e qytetëruar, tipat e këtillë i lidhë me këmishë çmendie dhe nuk i lë në krye të vendit!

A e keni dëgjuar të marrin se si flet, sikur të ishte nga dita e djeshme në këtë Institucion! Ka vegjetuar brenda këtij institucioni tash e tri dekada, ndërsa tani e ka kuptuar se BFI-ja është një organizatë shumë e maaadhe dhe me ndikim shumë të maaadh! Se për çfarë ndikimi e ka fjalën, se në cilin ndikim mendon, këtë e di vetëm Shaqir Fetai dhe instruktorët e tij! Shaqir Fetai thotë se BFI-ja duhet të ketë një zhvillim racional, një zhvillim të thellë, që do të jetë në shërbim të popullatës myslimane. Çfarë zhvillimi i ka dhënë BFI-së Shaqir Fetai për këto tri dekada sa ka vegjetuar brenda saj! Për këto tri dekada kujt i ka shërbyer Shaqir Fetai që tani duheshka t’i shërbejë popullatës myslimane? Thënë shkurt, idiotizma të këtillë ka në tërë intervistën të cilin duket sikur po e jep para togut të ekzekutorëve dhe, sikur të jetë intervista e fundit e tij: plotë frikë, plotë pasaktësi, plotë pasiguri, plotë budallallëqe, plotë injorancë.

Hipokrizia dhe tallja me myslimanët e vendit janë dy elementat e Shaqir Fetait që dominojnë përgjatë tërë kësaj interviste. Kushdo që do ta dëgjojë këtë intervistë dota kuptojë se cili është misioni i Shaqir Fetait, cili është kapaciteti i tij intelektual, cilat janë vlerat e tij njerëzore dhe, nëse e përcjell vetë Shaqir Fetai me pak koncentrim, do të vetëkonstatojë se bën mirë që sa më pak të dalë në opinion se po e shkakton gazin e botës duke qenë në rolin e palaços diletant.

Sa herë që e dikton veten se po flet përhanë, se po reflekton idiotizmin e vet, sakaq i kthehet Kuranit Famëlartë dhe citon ndonjë ajet kuranor.

Nga njëqind hatme në ditë t’i bëjë ky farë hafizi, nuk do të arrijë që ta kamuflojë prishurinë e tij, zemren katran, gatishtërinë e tij për t’i shërbyer edhe djallit (partisë, pushtetit) përveç Zotit. Sa herë që e përmend Kurantin bie ndesh me sjelljet praktike të tij, me synimet djallëzore të tij, me veprimet kundër akteve normative, kundër Kushtetutës së BFI-së që e organizon jetën fetare institucionale konform porosive kuranore dhe parimeve islame. Tani me myslimanët e vendit, por edhe faktorët e ndryshëm e kanë shumë të qarë se Shaqir Fetai tjetër gjë fletë tjetër gjë vepron dhe, në të dy rastet është shumë i rrezikshëm. I rrezikshëm në kuptimin jo se është i fuqishëm apo i fortë, por, i djallëzuar

dhe me prapavija të errta për myslimanët e vendit dhe për perspektivën e fesë islame në këtë nënqiell. Shaqir Fetai, për t'u treguar se sa "inelektual i madh" është, ai nuk e lë pa përmendur edhe emrat e filozofëve të shekullit XIX, sepse, ato emra i ka mësuar dhe jo se ka lexuar veprat e tyre. Shaqir Fetai ëndërron që ta marrin për "babanë e intelegjencies së kombit"! Le t'ia citojmë këtu një filozof, Sokratin, i cili ka thënë: "Unë jam njeriu më i mençur në botë, sepse unë di një gjë, e di që nuk di asgjë"! Shaqir Fetai di gjithçka, sepse kështu i kanë thënë të paraqitet ata që e instaluan duke shkelur nëpër akte normative e nëpër parime islame.

Kockën e thithin të gjithë, më tepër për argëtim se sa për ta shijuar, në fund e hedhin, sepse është rrisht i qenit!

<https://www.almakos.com/dokument-bashkepunetor-i-cilit-sherbim-eshte-kreu-i-bfi-se/>

<https://zeri.mk/bashkepunetor-i-cilit-sherbim-eshte-kreu-i-bfi-sedokument/>

<https://fol.mk/bashkepunetor-i-cilit-sherbim-eshte-kreu-i-bfi-sedokument/>

<https://lajme7.wordpress.com/2020/10/25/dokument-bashkepunetor-i-cilit-sherbim-eshte-kreu-i-bfi-se/>

*(Epoka, 23.12.2020)*

## **Pak për ateizmin në BFI-në e Shaqir Fetait**

**Kujdes! Nuk bëhet fjalë për BFI-në ateiste por, për ateizmin që ka depërtuar dhe që po manifestohet në BFI-në e kapur nga banditët të cilët ia arritën që, të ndihmuar nga dy partitë majtiste në pushtet, të kryejnë puçin klasik dhe ta ushtrojnë një anarki totale të denjë për ateistë që ëndërr e kanë diktaturën. Edhe ateistët kanë “zotin” e tyre - liderin**

**Nga Shenoll Salihi**

Kjo që po zbardhet përmes këtij teksti është sa e turpshme po aq edhe e dhembëshme, por, ateizmi në Bashkësinë Fetar Islame në Republikën e Maqedonisë së Veriut tashmë është ulur këmbëkryq! Dy partitë më të mëdha në pushtetin aktual për nga filozofia politike janë, pa dyshim, ekstremisht të majta dhe, si të tilla, historikisht, më së shumti iu kanë penguar institucionet fetare, sepse, në konceptin e tyre bazë veprimi është ateizmi. “Zot” janë liderët e partive, masa nuk duhet të besojë në fe (sepse është opium), por në parti, atë çka e bën lideri i partisë atë nuk mund ta bëjë “Zoti”!

Në fakt Zoti nuk lejon lëvizje puçiste, siç u bë kjo me Shaqir Fetain në BFI! Sepse, puçizmi shkatërron të gjitha vlerat, shkatërron një të kaluar të tërë, mohon gjithçka nga e kaluara dhe, çdo gjë nis nga puçistët, nga Shaqir Fetai. A e keni dërguar këtë mahlukat sesi prononcohet nëpër media – si “shpëtimtar” i BFI-së në të cilën punoi plotë tridhjetë vite për të ardhur deri te kjo shkallë e ateizmit. Majtistët e duan ateizmin, sepse, te majtistët “zoti” është “lideri” i cili, ulur në fronin e tij duhet që të gjithë të vinë, të rreshtuar, dhe t’ia puthin dorën, ta urojnë e ta përgëzojnë. Deri sa t’ua marrë zemrën dhe deri sa të marrë formë diktatura, pastaj, u turren turmës si derri i egër i plagosur shkarazi.

Edhe pse partitë në pushtet janë të majta, ekzistojnë disa organizma që me veprimin e tyre shquhen skajshmërisht të djathta. Në socializëm të djathtë angazhohen për ta ruajtur dhe kultivuar majtizmin. Janë të djathtë, sepse “punojnë” për të mirën e shtetit që e karakterizon majtizmi. Pra, janë në shërbim të pushtetit e të shtetit. Nuk është policia, sepse policia është për rend dhe siguri për të gjithë dhe në çdo kohë. Nuk është ushtria, sepse ushtria ruan kufijtë e shtetit, por, është shërbimi intelektual kombëtar! Maqedonia e Veriut është shtet i Kombit maqedonas dhe i popujve të tjerë që jetojnë aty. Njëjtë si dikur kur ish-Jugosllavia ishte shtet multietnik dhe multikonfesional por që UDB-në e kishte në shërbim të politikave serbe që më se një shekull kishin punuar për një puç shekullor dhe për një anarki totale, ku do të ketë masakrime, vrasje, pastrime etnike, vetëm e vetëm të realizohet plani i UDB-së ku, për fatin e tij të keq, i kishte rënë hise të kontribojë edhe Shaqir Fetai.

Po çka i duhet majtistëve intitucioni fetar?

Thjesht për t’u shndërruar në një mekanizëm propagandistik i cili rrufeshëm do të punonte në të mirë të partive të majta. Djathtistët mendojnë për të mirën e popullit, kurse majtistët mendojnë për të mirën e partisë, sepse, populli mund të ekzistojë edhe pa djathtistët, partia nuk ekziston pa majtistët.



Majtistët kërkojnë dhe gjejnë aleatë që do të punojnë për të mirën e këtij koncepti politik të cilit palla nuk i ha për popull. Majtistët edhe institucionet fetare i vënë në funksion të majtizmit, sepse janë aleta besnike të Partisë. Zhvishen fare lehtë nga të gjitha vlerat më të çmueshme të tyre, në të mirë të Partisë, sepse vetëm kështu dëshmohet lojaliteti ndaj liderit. Ndërsa Institucionet fetare duhet ta ushtrojnë devotshmërinë ndaj Zotit, ndaj Krijuesit të çdo gjëje. Aty ku zhbëhet kjo devotshmëri në të mirë të adhurimit të vlerave partiake, aty kemi ateizëm.

Shkilen të gjitha aktet normative, shkilet një Kushtetutë e tërë, zhvishet morali, me përlje kthehen nga djalli, duke i shndërruar të gjitha organet e institucionit fetar në shtabe partiake, në oda e bujtina të liderit partiak.

Djathtistët kujtojnë edhe për të mirën e institucioneve fetare, u ndihmojnë financiarisht, ua kthejnë pronat e nacionalizuara si pasojë e politikave të gabuara të dikurshme majtiste, ndërsa majtistët, ua rrëmbejnë, i shantazhojnë me këtë pronë, u kërkojnë hise nga ajo pronë, u kërkojnë vendpunësime për militantët partiakë.

Në këtë derexhe ka rënë Bshkësia Fetare Islame e Shaqir Fetait! Në këtë derexhe e kanë sjellë partitë e majta në pushtet. Në Bashkësinë Fetare Islame është instaluar ateizmi që po kamuflohet me “hafizllëkun” e Shaqir Fetait. Edhe hafiz edhe udbash?! Ky është “djathtisti” i zgjedhur nga majtistët. Majtistëve nuk i intereson as kombi dh as feja, por, ideologjia.

Shaqir Fetai puçin e fillon me lutje drejtuar Zotit por me pozicionin e të qenurit ulur në prehër të ideologëve majtistë. I pëlqen kjo Shaqir Fetait dhe jo se i kupton ideologjitë! I pëlqen që t’ju shërbejë më të “fortëve”. E më të fortë se UDB-ja e dikurshme nuk ka pasur. Por, ja që shkoi në rrotë të s’ëmës...

*(Kombetare, 24.12.2020)*

## Kriza e pushtetit

**Pushteti i pacënueshëm i drejtësisë është ai garanci e fuqishme e bashkëjetesës në harmoni në mes të shoqërisë dhe të gjitha pushteteve të tjera. Vetëm prishja e këtij balanci sjell krizën e pushtetit. Dhe krizat e tilla kurrë nuk përfundojnë pa largimin-ikjen e pushtetit. Historikisht, lëvizjet janë ato që ngadhënjëjnë mbi çdo pushtet me krizë identitare**

### Shkruan Afrim Tahiri

Këndvështrimet prej të cilave u qasemi fenomeneve, mënyra e qasjes, sasia e informacionit, pasojat e shkaktuara dhe të trashëguara nga fenomenet, dhe një sërë elementesh të tjerë, bëjnë që, vëllimi i trajtesave të jetë shumëfish më i madh se sa vëllimi i trajtesave të “shkarravitura” për bartësin apo shkaktarin e fenomenit. Sëkëndejmi, zhurma e bartësit të fenomenit është absolutisht shurdhuese në raport me zhurmën që ngritet në përpjekje për ta eliminuar fenomenin. Ç’është e vërteta, në shoqërinë tonë shumë shpesh ngatërrohet fenomeni me dukurinë, sepse, në fakt dukuritë edhe kur shkaktohen ato bëhen me qëllim që të marrin epitetin e fenomenit, si diçka e natyrshme, si diçka që nuk është në fuqinë tonë, ndaj dhe, si diçka që detyrimisht duhet të ndodhë!

Fundloja e dukurisë që “mëton” të marrë trajtat e fenomenit, arrihet përmes krizës identitare të “kujdestarëve” të së mirës së përgjithshme, përmes humbjes së fillit të së mirës. Kjo krizë identitare i hap udhë krizës së pushtetit dhe – këtu pastaj fillon lufta e domosdoshme e vënies së një rendi të ri, të një pushteti të ri, të një force racionale e cila do të di të përballet, ta eliminojë dhe t’i sanojë të gjitha pasojat e asaj krize të pushtetit.

Kriza e pushtetit nuk mund të vie pa vënë dorë mbi drejtësinë. Kur të kapet drejtësia, kur të gjitha dispozitat ligjore, të gjitha ligjet, të gjitha kodet, të gjithë gjyqtarët e prokurorët do të lidhen si “tespih” në dorën e “mbretit”, kokrrat-rruzat e të cilëve ndërrohen me një gisht, atëherë në zyren e pushtetarit instalohet “liria absolute” e veprimit diktatorial, pushtet ky i cili, pahetueshëm, e konsumon, e shpenzon, duke e sjellë në buzë të çmendisë pushtetmbajtësin.

Kriza e pushtetit, pra, vjen me kapjen e pushtetit të drejtësisë! Kjo bëhet për ta vjelur pushtetin-shoqërinë pa dhënë përgjegjësi-raport para askujt! Qëndrimi më i gjatë në pushtet farkëton dhe e bën të pathyeshëm lakminë për pushtet mbi thesarin e shtetit. Në ndërnie frymon edhe bindja racionale se tani erdhi koha për ikje nga pushteti. Kur ndodhë kjo ikje? Vetëm atëher kur pushtetmbajtësi nis e bindet se, ky pushtet që e ka lodhur, do të duhet t’ia kthejë borxhin, t’ia kompensojë këtë lodhje, duke i hapur dyert e thesarit të përgjithshëm. Pushtetmbajtësi nuk ik nga pushteti pa e sakatosur thesarin e shtetit, ndërsa kjo “sakatosje” është proces i gjatë, është si sharrimi i krahut - dhembja e trishtë të plandë gjysëm të vdekur kur të hasë sharra në kockë!

Pra, kriza e pushtetit, kriza e një ideologjie, kriza e një pune të shenjtë, shfaqet në momentin kur shfaqet edhe oreksi për vetëshpagim, kur të pjell djalli në tru e të bindë se, tani ka ardhur koha që t’i shijoshë përfitimet nga të qenurit në pushtet dhe nga drejtimi i gjatë i tij. Vetëshpagimi bëhet në mënyrë konkrete, “jo në natyrë” por, në të mira materiale që dalin nga thesari i shtetit, nga pasuria e përgjithshme, nga ajo që më së shumti u takon atyreve që u shërben si pushtetar.

Këtu pastaj zënë fill revoltat gjithëpopullore, zënë fill lëvizjet, të cilat nuk shuhën përderisa nuk merr

fund keqmenaxhimi me pushtetin dhe përderisa nuk kryhen reformat e thella dhe gjithëpërfshirëse. Shoqëria sërish duhet të jetojë, e lumtur, e respektuar dhe me dinjitet. Pushteti i pacënueshëm i drejtësisë është ai garanci e fuqishme e bashkëjetesës në harmoni në mes të shoqërisë dhe të gjithë pushteteve të tjerë. Vetëm prishja e këtij balanci sjell krizën e pushtetit. Dhe, krizat e tilla kurrë nuk përfundojnë pa largimin-ikjen e pushtetit. Historikisht, lëvizjet janë ato që ngadhëjnë mbi çdo pushtet me krizë identitare.

*(Botasot, 27.12.2020)*

## Letër të hapur kolegëve të mi hoxhallarë

Fjala hoxhë ka kuptimin e klerikut të myslimanëve që kryen shërbimet fetare në xhami! Që nga ky fakt nënkuptohet se misioni i hoxhës është i shenjtë, ndërsa vetë hoxha krijesë shumë e nderuar të Allahut xh.sh. dhe së këndejmi, edhe te komuniteti mysliman! A ka gjë më të shenjtë se sa t'i kryesh shërbimet fetare, të cilat bazohen ekskluzivisht në Fjalën e Allahut xh.sh. në praktikën e Vulës së Pejgamberisë, Muhamedit a.s. si dhe në të gjitha parimet, normat dhe porositë islame.

Po sot, çka është hoxha? Hoxha i periudhës post-osmane dallon nga hoxha i periudhës post-komuniste. Hoxhallarët e parë i kemi të shumtë dhe që të gjithë shtojnë, rrisin, shumëfishojnë krenarinë tonë për atë që i patëm! Hoxhallarët e periudhës post-komuniste sikur kanë pësuar një mutacion! Më me ëndje i shërbejnë pushtetit se sa fesë, më tepër i shërbejnë ideologjisë se sa islamit, më tepër parapëlqejnë të shërbejnë nëpër zyre të shërbimeve policore se sa në xhami.

Të qenurit hoxhë sot, është të qenurit personazh i urreyer, personazh negativ, personazh i humorit, i hajgares, dhe, për më keq, i talljes. Prandaj nuk dua të jem hoxhë, prandaj më vjen turp të tregoj se jam hoxhë, prandaj e urrej çdo hoxhë!

Vetëm hoxhallarët lejojnë që dikush të tallet me Shtëpinë e Zotit, të lejojë që ajo të shndërrohet në magazetë birrash, ose, për më keq, në nevojtoare publike!

Vetëm hoxhallarët lejojnë sot që islami të njolloset si veprim terrorist, ekstremist, i rrezikshëm etj. Më vjen turp të vesh petkun e hoxhës dhe të them se jam hoxhë sa herë që e kujtoj, bie fjala, Shaqir Fetain! A mund të jetë hoxhë, soji i Shaqir Fetait, i cili i ka të gjitha predispozitat që t'i shërbejë pushtetit, t'i shërbejë armiqve të islamit, t'i shërbejë kriminelëve, të jetë i gatshëm të tradhëtojë, të jetë i gatshëm të tallet me të gjithë hoxhallarët, të jetë i gatshëm ta perfeksionojë rrenën, hajninë, demagogjinë, hipokrizinë!

A mund ta dua sot një hoxhë kur, secili prej tyre më duket si Shaqir Fetai dhe kur në secilin prej tyre e shoh nga një spiunçiq të UDB-së.

Nuk dua të jem hoxhë më, e urrej çdo hoxhë, do të ishte mirë që një murtagjë e rëndë (diçka edhe më rëndë se Covid 19) t'i zë dhe t'i zhdukë fare të gjithë, sepse, si t'i respektoj e t'i dua këta hoxhallarë që lejojnë që Institucioni i tyre të shndërrohet në bastion të horrave, të honxho-bonxhave, në çerdhe në udbashëve, në jatak të të pamoralshmëve, në kopsht ferrash ku lulëzon vetëm krimi, korrupsioni, rrena, pisllekë, hajnia!

Nuk dua të jem edhe më tej hoxhë e të sabotohem prej shërbimeve inteligjente duke m'i luhatur para hundëve incizimet porno me personazh hoxhallarë, si ta respektoj apo si të jem hoxhë kur shërbimi sekret i thotë, ose dil kundër të parit tënd ose ta shpërthejmë "bombën" që e nxjerr gruan tënde lakuriq në zyre, derisa t'i e pret jasht duke i fërkuar duart në shenjë të gëzimit se po përparon në karrierë?

Nuk dua të jem hoxhë jo, do të heq dorë nga petku i hoxhës, sepse, nuk dua të identifikohem me spiunin, as me të pandershmin, as me rrencakun, as me hajnin! Kështu nuk kanë qenë hoxhallarët. Sistemi komunist ndikoi në një mutacion të hoxhallarëve i cili ka nevojë për një vaksinim urgjent, ose për një shuarje farësh të të gjithë hoxhallarëve post-komunistë!

Propozoj për të mirën e islamit, që t'i shtohet kënaqësia Allahut Mëshirëplotë, vullnetarisht të heqim dorë nga ky mision, të kalojnë nja 3-4 gjenerata dhe, tek pastaj, duke e rikujtuar përherë kohën tonë kur hoqëm dorë nga hoxhallëku, të nisin e të dalin hoxhallarë të pastër, me një biografi të pastër ashtu siç i lindi nëna myslimane.

A mundem të pajtohem me këta hoxhallarë që u shërbejnë eprorëve të vetë myftinjë të cilët janë aq injorantë sa, bëre e ua dhe në mëngjes tri dele, në mbrëmje ta kthejnë vetëm një, sepse një e hanë tinëz e tjetri ju humbë!

Bashkësi Islame nuk ka me Shaqir Fetah. Me Shaqir Fetah nuk ka as myftinjë të denjë për këtë titull. Me myftinjë të padenjë për këtë titullin nuk ka as hoxhallarë (edhe ata hoxhallarë të devotshëm do të njollosohen prej tyre, prandaj nuk do të ketë fare hoxhallarë). Me hoxhallarë të njollosur, të shatazhuar e injorantë nuk ka muslimanë. Prandaj, hoxhallarët e sotshëm, më në krye Shaqir Fetain, me lehtë vihen në shërbim të ideologjisë, partisë dhe shërbimeve intelegjente, se sa në shërbim të jetës fetare islame.

Meqë realisht jam i penguar që ta ushtroj profesionin hoxhë, heq dorë publikisht, zhvishem nga petku i hoxhallarve, nuk tregoj se cili jam, sepse pastaj do t'ju jap shkas të më quani njërin prej jush. Prandaj, do të pëlqej të ngeli anonim, duke e pritur ndëshkimin e Zotit për këtë dorëzim timin para edepsëzave, dinsëzave dhe sojsuzave me të cilët identifikohesha deri në këtë çast.

Zot, më fal mua për këtë pendesë kaq të vonshme, dhe mos i fal kolegët e mi hoxhallarë, sepse gabimet e tyre janë të qëllimshme dhe detyrë të marrura nga djalli.

*(Këshillou, 27.12.2020)*

## **Ku po gabon Afrim ef. Tahiri**

**Shaqir Fetai e ka injoruar Kushtetutën dhe aktet e tjera normative të BFI-së, e ka injoruar Rijasetin dhe Kuvendin, jo se nuk e njeh Kushtetutën, apo statutet e institucioneve dhe asociacioneve të BFI-së, por, thjesht, sepse u urdhërua nga LSDM-BDI, nga pushteti aktual, kurse Shaqir Fetai e ka profesion shpirtëror që t'i zbatoj me ndershmërinë më të madhe të gjitha urdhërat e pushtetit, madje që nga viti 1983**

**Nga Andi Rakipi, Tiranë**

Drejtuesi i Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI, Afrim ef. Tahiri, shpesh është dëgjuar tek thotë se, drejtuesit aktual të dhunshëm të BFI-së nuk e njohin, nuk e dinë, apo edhe nuk e kuptojnë Kushtetutën, madje e thotë me plotë kompetencë! Ndryshe, nuk do të kishte kaq shkelje drastike të kësaj Kushtetute si dhe të akteve të ndryshme normative të BFI-së. Në aparencë ky konstatim i tij mund të jetë edhe i saktë. Por, nëse pranohet ky konstatim si i saktë, atëherë kemi të bëjmë me injorantë e jo me bashkëpunëtorë të lloj-lloj shërbimesh, kemi të bëjmë me analfabetë e jo me anarkistë, kemi të bëjmë me abdallë e jo me dhunues, kemi të bëjmë me servilë e jo me spiunë! Është më se e vërtetë se, Shaqir Fetai me banditët e vet e uzurpuan BFI-në duke ia ngulur thikën njeriut që më së shumti i kishin shërbyer, njeriut që e kishin duruar edhe kur ua kishte sharë gratë e nënat; duke ia ngulur thikën njeriut që i kishin kërcyer e luajtur belidens në ahengje private, në përgëzime e në urime.

Është e vërtetë se i kanë shërbyer njeriut që e ka njohur nen për neni Kushtetutën e BFI-së, i ka ditur të gjitha vendimet e aktet normative, që do me thënë se, nuk kanë pasur shansin që mos t'i dinë edhe bashkëpunëtorët e vetë servilë. Sepse, gjithçka që ka ditur reisi, është dashur që të dinë edhe këta, sepse ndryshe si ta kopjojnë, si të “përdëftojnë” se edhe ata janë të një kalibri me reisin e tyre. Sepse, t'i shërbeshë fytyrës markante dhe mos ta dishë Kushtetutën kjo nuk ka mundur të bëjë vaki. Jo për hirë të reisit të tyre, por, për hirë të bythës së vet për ta shpëtuar nga rastet kur do të jenë skajshmërisht të pandershëm. E kanë ditur Kushtetutën, sepse Kushtetuta sanksionon, prandaj këta është dashur të dinë edhe rrugdalje dhe mos të preken nga sanksionimet të parapara në aktin më të lartë normativ të BFI-së.

Të mendosh se Shaqir Fetai nuk e njeh, nuk e di, apo nuk e ka lexuar kurrë Kushtetutën, atëherë e amnistion nga afërsia e tij me pushtetin, me partinë si dhe me shërbimet intelegjente të cilat, për lojalitetin jetësor, në fund, e avansuan në karrierë.

Shaqir Fetai e njeh fort mirë Kushtetutën, por e ka injoruar në momentin kur i kanë garantuar BDI-LSDM-ja si dhe UDB-ja se nuk do të lejojnë kurrfarë sanksionesh që i parashih Kushtetuta e BFI-së, e cila, është e pranuar, e garantuar nga organet e drejtësisë që nga momenti kur është deponuar në këto organe. Në botën e civilizuar, në botën demokratike, jo vetëm institucionet por edhe ojqtë përgjigjen para drejtësisë nëse i injorojnë aktet e tyre më të larta, qofshin kushtetutat apo statutet e veta, sepse, shteti i pranon të njëjtat dhe merr garanca se do të punohet ashtu siç shkruajnë ato akte të tyre normative dhe se do të sanksionohen sipas neneve përkatëse. Sanksionimi nga ana e Institucionit apo ojqtë është me largim nga puna, me dëbim të shkelësit të normativës, ndërsa sipas akteve

normative të shtetit, mund të sanksionohen me burgim, me kusht, apo në të holla!

Nuk ka shtet normal në botë që e lejon marrjen e pushtetit të institucionit apo ojq- ve përmes falsifikimit, përmes gënjeshtërisë, përmes amnestisë së vetëvetes nga përgjegjësia duke e neutralizuar të parin të cilit i kanë shërbyer me vite e vite, si Shaqir Fetai.

Kushtetuta e BFI-së parasheh që të paktën një herë në vit të mbledhet Kuvendi si dhe Rijaseti dhe të debatohet dhe të miratohet buxhet si dhe t'i miratohet llogaritë përfundimtare, të debatohet dhe të zbulohet anomali që me votim të përgjithshëm duhet të sanksionohen, të propozojnë e të ofrojnë projekte për miratim që do të jenë në të mirë të avancimit të jetës fetare islame, të propozojnë dhe të miratohet themelime të institucioneve dhe të sektoreve. Nëse Sulejman Rexhepi, ish-reisi shkarkohet nga Shaqir Fetai se ky paska shkelur nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së, atëherë, çfarë kanë bërë anëtarët e Rijasetit nëpër mbledhje të tilla? E kanë duartrokatur? I kanë dhënë miratimin? Përkrahjen? Solidarizimin për ta “dëshmuar unitetin” e organeve më të larta të BFI-së? Ky solidarizim eventual në shkeljen e këtij Neni është vetëm krim dhe asgjë tjetër. Për krimin nuk jep përgjegjësi vetëm ekzekutori por, edhe propozuesi, miratuesi, pjesëmarrësi, bashkëpunëtori...

Po si u gjet bashkëpunëtori më i gjatë dhe më i ngushtë i Sulejman Rexhepit, Shaqir Fetai, që ta injorohet Kushtetutën dhe, në vend se të ndëshkohet, ai ta kapë timonin drejtues të “anies” që Shaqir Fetai konstaton se, kohëve të fundit, po rrezikonte të fundoset! Nëse Shaqir Fetai ka konstatuar se Sulejman Rexhepi po e fundos “anijen”, (BFI-ja fundoset duke vjedhur, duke uzurpuar, duke korrumpuar, duke e ushtruar nepotizmin, krimin etj.), pse këtë rrezik Shaqir Fetai nuk e paraqiti fillimisht në organet e BFI-së, në opinion e pastaj edhe në polici si dhe në organet e drejtësisë? Pse të marrë guxim Shaqir Fetai dhe të veprojë ngjashëm si paraardhësi i tij që paska shkelur nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së?

Shaqir Fetai e ka injoruar Kushtetutën dhe aktet e tjera normative të BFI-së, e ka injoruar Rijasetin dhe Kuvendin, jo se nuk e njeh Kushtetutën, jo se nuk i njeh statutet e institucioneve dhe asociacioneve të BFI-së, por, thjesht, sepse e pati urdhër nga LSDM-BDI, nga pushteti aktual (ashtu siç vërteton publikisht edhe vetë Sulejman Rexhepi), kurse Shaqir Fetai e ka profesion shpirtëror që t'i zbatoj me ndershmërinë më të madhe të gjitha urdhërat e pushtetit, madje që nga viti 1983 kur për këtë profesion u stërvit mirë e fortë nga UDB-ja serbo-jugosllave.

Pra, Afrim Tahiri nuk guxon as të mendojë se Shaqir Fetai dhe soji i tij nuk e dinë Kushtetutën, madje mund ta dijë përmendësh, sepse i duhet të referojë te shërbimet inteligjente se si është e organizuar Institucioni ku ai e kamuflon profesionin e spiunimit. Shaqir Fetai i kreu të gjitha shkeljet kushtetutare dhe aktet e ndryshme normative të BFI-së sepse këtë ia sugjeruan LSDM-BDI si dhe UDB-ja me qëllim që premtimi i tyre të bëhet lehtësisht i realizueshëm. E ata i kishin pas premtuar se do ta bëjnë “reis”! Asnjë mysliman në vend nuk ka nevojë për një “reis” udhë-e, e as për “reis” të pushtetit antiislamist. Vetëm Shaqir Fetai, po! Së këndejmi, ai ka fuqinë që të bëjë çfarë t'i dojë zemra dhe jo se është injorant dhe nuk e di Kushtetutën. Deri te veprimet e tij të pista, ai ka nevojë edhe që të “pranohet zyrtarisht”, prandaj i porositë këto vizita, këto urime e përshëndetje. Hajt se, shumë shpejt keni për t'ia dëgju këngën “pticopjevaçit”!

*(1Kliklart, 29.12.2020)*

## Injoranti dhe shërbëtori

**Shaqir Fetai nuk e njeh Kushtetutën, sepse, nëse e pranon se e njeh, ndërsa shkeljet kushtetutare në ngjitjen e karrierës së tij kanë qenë aq drastike sa, përgjegjësia para organeve të drejtësisë do të ishte fatale për të dhe për karrierën e tij. Vetëm një injorant total, një njeri që nuk e njeh Kushtetutën dhe që nuk i ka lexuar kurrë rregulloret e zgjedhjeve, mund të bëjë gafe të tilla amatoreske siç i bën Shaqir Fetai**

### Shkruan Afrim Tahiri

Këto ditë lexova një shkrim të Andi Rakipit, i cili në analizat e mia rreth ndodhive në BFI paska dedektur një gabim timin, i cili, në njëfarë forme po i bënka nderë Shaqir Fetait, sepse unë me tepër po e paraqitkam si diletant se sa si shërbëtor të politikave ditore në interes të karrierës së tij. Nuk e vë në dyshim kapacitetin e analizave të intelektualit Andi Rakipi, mund të ketë plotësisht të drejtë por, ja që unë edhe më tej mendoj se Shaqir Fetai dhe suita e tij nuk e dinë, nuk e njohin dhe nuk e kuptojnë as Kushtetutën dhe as aktet normative të tjera të BFI-së.

Mund të kuptohet edhe gabimisht qëndrimi im nëse këmbëngul se ky soj që po e “drejton” BFI-në nuk e njeh Kushtetutën, mundet që ky qëndrim i imi ta amnestojë nga trimërimi me të cilën mund ta ushqejnë pushteti aktual por edhe pushtetet e tjera të nëntokshme Shaqir Fetain dhe bashkëpunëtorëve të tij të trashëguar, që të gjithë, nga Sulejman Rexhepi për shkak të vuajtjeve të papërballueshme për kohën kur i shërbeu “besnikërisht”. Megjithatë, unë edhe më tej këmbëngul se këta nuk e njohin aktin më të lartë të BFI-së, nuk e kanë lexuar kurrë dhe as që u intereson ta dinë. Sepse, ata janë madhorë, janë të vetëdijshëm, kanë kaluar fazën e avanturave puberteske dhe se, e dinë fare mirë se, çka do të thotë të shkelësh një akt normativ.

Shaqir Fetai bashkë me bashkëpunëtorët e tij të trashëguar nga Sulejman Rexhepi e dinë fare mirë se mund të dalin para përgjegjësisë, se mund të përgjigjen para organeve të drejtësisë, se mund të ndiqen penalisht nga organet e drejtësisë, nëse sot jo, nesër gjithësesi që po. Rënia e pushtetit, për të cilin Andi Rakipi mendon se pushteti i ka sjellë në krye të BFI-së Shaqir Fetain dhe suitën e tij, nënkupton rënie me automatizëm edhe e “organeve” të tyre, por, nëse në politikë rënia është me e butë, tek bashkëpunëtorët dhe nënshtruesit e politikave ndëshkimi është i pafalshëm. Sepse, askush nuk i ka thënë që ta kruajnë me partitë politike, sidomos kur je institucion fetar. Këta nuk e njohin Kushtetutën, nuk e kanë lexuar kurrë, sepse ka pasur kush përgjigjet kushtetutshmërisht në vend të tyre (Sulejman Rexhepi), këtyre u ka interesuar karriera, u ka interesuar ta demonstrojnë të fortin duke qenë pjesë e politikës, duke qenë pjesë e partive politike. Tani krejt bota e di se Shaqir Fetai është “reis-prodhim i BDI-së, sepse këtë e ka pohuar edhe ish-reisi, por, tërthorazi, edhe lideri aktual i BDI-së, z. Ali Ahmeti. Këtë nuk mund ta mohojë as Shaqir Fetai, i cili, një ditë, për shkeljet kushtetuese do të përgjigjet se nuk e ka njohur dhe për të gjitha shkeljet që i ka bërë, i ka bërë sepse ka qenë i detyruar nga Ali Ahmeti dhe ish-partia e tij e cila “e ka detyruar që të shndërrohet në shtab partiak”!



Po pse pikërisht Shaqir Fetain? Jo, sepse e kanë shantazhuar se na paska qenë (unë i kam dyshimet e mia) ish-udbash, por, pikërisht sepse nuk i ka njohur aktet më të larta juridike të BFI-së. Ata që i kanë njohur nuk i kanë hyrë kësaj aventure.

Shaqir Fetai e ka për mburrje nëse i thua udbash, e ka për mburrje nëse i thua shërbëtor i BDI-së, e ka për mburrje nëse i thua bashkëpunëtor më i ngushtë i Sulejman Rexhepit, por ama e ka vdekje t'i thuash injorant që nuk e njeh Kushtetutën. Kurrë nuk ka marrur mundin që ta lexojë e ta njohë, sepse nuk i intereson, më lehtë deri te pushteti arrihet duke qenë pjesë shërbyese e partisë, sepse e njëjta Parti e ka përgëdhelur dikur Sulejman Rexhepin. Për të tilla përgëdhelje vuan Shaqir Fetai dhe jo për njohje të Kushtetutës.

Unë e ftoj publikisht në debat, le të zgjedhë cilindo televizion, le të jetë ky debat masiv, i ndjekur në të gjitha mediat shqiptare dhe ndërkombëtare, e sfidoj për një debat në një hapësirë gjigande, le të jetë ky stadium me njëqind mij vetë dhe, të dalim e të flasim për njohuritë mbi Kushtetutën e BFI-së.

Shaqir Fetai i ka ikur ballafaqimit në një odë tet a tet e lëre më debatit publik!

Shaqir Fetai nuk e njeh Kushtetutën, sepse, nëse e pranon se e njeh, ndërsa shkeljet kushtetutare kanë qenë aq drastike sa, përgjegjësia para organeve të drejtësisë do të ishte fatale për të dhe për karrierën e tij. Vetëm një injorant total, një njeri që nuk e njeh Kushtetutën dhe që nuk i ka lexuar kurrë rregulloret e zgjedhjeve mund të bëjë gafe të tilla amatoreske siç i bën Shaqir Fetai. Ai nuk i bën sepse është trim, sepse ka mbështetje partiake, sepse ka mbështetje të pushtetit aktual, ai i bën sepse është tërësisht injorant.

Dhe, në tërë këtë lojë injorante qarqeve antiislamiste u konvenon që për drejtues të BFI-së të kenë në krye injorantë, mosnjohës të Kushtetutës së BFI-së, sepse kjo do t'ju duhet për më vonë, kur do të nisnin ta shantazhojnë Shaqir Fetain. Mos qofshim nën lëkurën e tij. Kanë për t'ia zbritur saxhin mbi kokë. Një njohës i gjërave nuk lejon që të bëhet lolo, nuk do të pranonte të bëhet "dvorska budalla", por, do të mburrej me afinitetet e veta prej devotshmërie, sepse një i tillë ka nevojë më tepër të dalë i pastër para Zotit se sa para pushtetit që ia kërkojnë budallallëkun!

*(Kohanews, 30.12.2021)*

## Iku një vit plot me komplete e tradhëti

**“Lufto në rrugën e Allahut! Ti je përgjegjës vetëm për veten tënde. Nxiti edhe besimtarët, se mbase Allahu e pengon fuqinë e jobesimtarëve! Allahu është më i fuqishmi dhe më i ashpri në dënime.”** (En Nisa, 84)

**Shkruan H. Sulejman Rexhepi**

Duke i shfletuar dhe duke i sistemuar dokumentat që kanë dalë nga puna ime 24 vjeçare si Kryetar i Bashkësisë Fetare Islame në RMV, sakaq hasa në një dokument të qershorit të vitit 2008, të dalur pas mbledhjes së Rijasetit, kishte fjali, si qëndrime unanime se, të gjithë këta të BDI-së ishin marksistë-leninistë që cak e kanë shkatërrimin e BFI-së! Marksistët-leninistët, nuk e pranonin fenë dhe institucionet fetare, nuk i pranonin mësimet dhe Librat e Shenja, marksistë-leninistët nuk pranonin as përkatësi kombëtare. E mbaj mend një anketë të “Zërit të Rinisë” së Shqipërisë, në kohën e Remzi Lanit (kryeredaktor), kur 90% për qind e shqiptarëve, në pyetjen se “çka jeni ju” ishin përgjigjur “komunistë”! Idelogjia marskiste-leniniste kishte arritur shqiptarin ta zhveshë nga përkatësia e vet etnike. Kishte krijuar një “komb të ri”! Një komb që nuk duhet t’i përkulet “bestitnyve dhe besimeve të kota” por “liderit ideologjik” që ishte më i fortë se “Zoti” i fetarëve që, sipas dogmave marksiste-leniniste, nuk janë asgjë tjetër përveçse llumi dhe ajka e analfabetëve dhe manipulantëve të një kombi! Po! Përfundimisht e pranoj se i kam njohur këto qëndrime të marksistë-leninistëve, i kam të qarta synimet e tyre atëherë, i kam të qarta edhe synimet e sotshme që kanë përjetuar mutacion të tmerrshëm në raport me Institucionet fetare dhe nëpunësve fetarë, të cilët i konceptojnë në shtab partiak dhe në militantë të partisë, ndryshe shndërrohen në pikado të partisë ku ushtrohet çdo ditë “preciziteti partiak” (etiketimi, linçmi, eliminimi)!

Gjatë shfletimit dhe sistemimit të këtyre dokumentave hasa edhe në mjaft dokumenta kritikë, në shkrime ultimative, në kërkesa të kushtëzuara, në reagime mjaft ofenduese për BDI-në! Tani, unë po ta ndihmoj partinë, e ti po e dëmton BFI-në?! Ndjem krenar që të paktën, servilizmi im partiak (gjithnjë i kushtëzuar!!!), nuk më ka nënshtruar, nuk ma ka thyer boshtin kurrizor, nuk më ka përkulur, nuk më ka shndërruar në rob të Partisë. Paska dokumente që ma rrëqethin mishin e më bëjnë të ndjem krenar për qëndrimet e mia absolutisht në të mirë të BFI-së, në të mirë të organizimit të jetës fetare institucionale. Paskam shkresa ku qartë ua paskam bërë të ditur strukturave të caktuara të BDI-së se më tepër e ndihmojnë shtetin se BFI-në, më shumë e ndihmojnë Kishën dhe, më shumë e dëmtojnë BFI-në, kurse luftën për të ardhur në pushtet e bënë me të tjera komunikata, me të tjera apele dhe, fund e krye me ushtarë myslimanë të vendit.

Kur i shfletoj dhe i sistemoj këta dokumenta, çuditërisht më shtohet bindja dhe pajtohem me konstatimet e gjenive të kombit se, me konfliktin e kontrolluar të vitit 2001 nisi në mënyrë zyrtare nënçmimi dhe urrejtja institucionale kundër shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut si dhe i të gjithë myslimanëve të tjerë, të cilët, për të pasur të drejta, duhet të mundohen që të bëhen popull “20 për qind”. Deri në këtë përqindje nuk guxojnë as të mendojnë për ndonjë të drejtë etnike! “20 përqindëshi” është vula e diskriminimit etnik shqiptar, është formë e apartheid-it të instaluar më vitin 1948 në Afrikën e Jugut. Meqë aty jetonin “të bardhët”, “të zinjët”, “indianët” dhe populli ”me

ngjyrë” (mullatët), sipas apartheid-it, të drejtë absolute politike kishin vetëm “të bardhët”! Si në Maqedoninë e Veriut ku jeton kombi maqedonas, “20 përqindëshi”, “indianci”, “talebanci”, ndërsa pjesa dërmuese e tyre janë militantë të BDI-së (po, e votojnë edhe pjesëtarë të kombit maqedonas)! Nacionalisti i verbuar, Todor Petrov, thoshte se shqiptarë nuk ka më shumë se 15 %, këtë frikë e ka BDI dhe pushteti, ndërkohë që kurrë nuk hasa në përkrahje se popullata myslimane në Maqedoninë e Veriut janë shumicë dhe, këtë komunitet në shumicë e përbëjnë shqiptarët. Nuk hasa në përkrahje sepse druanin që t’ia prishnin disponimin nacionalist Todor Petrovit, i cili ka qenë një udhërrëfyes për antishqiptarizmin në këtë nënqiell.

Hasa edhe në letra interne, në relata, që ua kam nisur funksionarëve të lartë të BDI- së përmes të cilave ju kam thënë se, unë, Sulejman Rexhepi, Reisul Ulema i BFI-së, ju ndihmoj dhe ua jap përkrahjen nëse ju i plotësoni kërkesat, kushtet tona! Kushtet, natyrisht, kanë qenë të natyrës dhe jetës fetare, (akreditimi i FSHI-së, i Medresesë, sigurimi i ndonjë leje për xhami, kthimi i Xhamisë së Shtipit, rindërtimi i Xhamisë së Prilepit kthimi i tërë vakëfit etj.)

As që më ka shkuar në mend se ky qëndrim i imi parimor në raport me pushtetin, ku ka aderuar edhe BDI-ja (ndërsa kjo ka qenë bisht në të gjitha pushtetet) një ditë do të keqpërdoret në dëm dhe në shkatërrim timin! Nuk më ka shkuar në mend se Zoran Zaev i cili që nga 2014 më luste ta afroj me Ali Ahmetit për të bashkëpunuar dhe koalicionuar, do të lodhet aq shpejtë sa që të ket nevojë të shpëtoj nga unë! E kam të freskët kujtimin e takimit të përbashkët që kisha me kryeministrin Zaev dhe me kreun e BDI-së Ali Ahmeti, takim i realizuar në prag të zgjedhjeve presidenciale, takim në të cilin mua m’u premtuan 17 pika në dobi të BFI-së, kurse unë, ua bëra me dije se në interes të integritimit të vendit tim, ardhmërisë së këtij vendi të cilit i takoj, padyshim se do të kontrubuoj. Në fund të takimit, Ali Ahmeti kërkoi nga unë t’ia shtri dorën, të njëjtën e kërkoi edhe nga Zaevi!

Mirpor, në vend të realizimit të premtimeve, m’i militarizuan partiakisht bashkëpunëtorët e mi, brenda natës i mblodhën dhe prej tyre e kërkuan shpëtimin prej meje, sepse, gjithnjë e më shumë po ua rëndoj situatën politike. Kjo rëndesë ishte ekskluzivisht nga kërkesat e mia për ta përforcuar BFI-në përmes denacionalizimit të tërësishëm dhe për ta avancuar jetën fetare islame! E, unë i shkreti, e kisha fshirë nga mendja se, marksistë-leninistët kurrë nuk e kanë pasur raportin e mirë me fe dhe me institucione fetare.

Më tradhëtuan mua, i tradhëtuan bashkëpunëtorët e mi dhe po e shkatërrojnë BFI- në! Përzirja partiake e politike në BFI, garantimi i paprekshmërisë nga institucionet e drejtësisë dhe, përkrahja e luftës pakompromis në shkeljen e Kushtetutës si dhe të akteve të ndryshme të BFI-së, nuk është asgjë tjetër përveçse një “hyxhym” t’i dilet ballë kërkesave të “Rijasetit tim” përmes të cilit kërkjoja të drejta absolute fetare në shtetin tim. Tani me po atë “Rijaset timin” po frenohen të gjitha aktivitetet fetare, po stimulohet një cirkuziadë e turpshme, shteti po lirohet nga presionet shumë nacionaliste dhe ekstremiste të Sulejman Rexhepit! Pra, i keqi paskam qenë unë dhe jo Rijaseti i këtij pushteti! Nuk ka dyshim se Allahu do ta ndëshkojë zullumqarin, Ai është i drejt, nuk bën dallim mes zullumqarëve, pra, ndëshkimin do ta marrin që të gjithë zullumqarët.

Nga përvoja ime jetësore, unë tani po shoh se si po i afrohen BFI-së do re të zeza, do tornado të tmerrshme, do shira mitike, dhe, nga kjo situatë apokaliptike e lagur dhe e rrahur do të dalë edhe BDI-ja. Struktura e saj e instaluar në këtë Institucion, e ndjenë përfundimin e vet të trishtë! Secili e përjeton atë për të cilën është angazhuar në jetën e vet: dikush si tradhëtarë, dikush si spiun, dikush si kasap, dikush si diskriminues politik, dikush si “zhongler fetar”... Ishalla – me iman!

Është krejtësisht strategji e gabueshme kjo e përshëndetjeve dhe urimeve sa për ta friksuar “të plagosurin” apo, të paktën për ta bindur se sa shumë e paskan dashur bashkëpunëtorin tim më të përgëdhelur! Kam menduar se, po, ai është prodhimi im! “Hoxhallarët” nuk më dashkan mua ndërsa po e duakan prodhimin tim? Le ta gëzojnë duke e humbur titullin hoxhë! Sepse, doli puna që ai paska

qenë nxënës dhe prodhim i Stanko Dragoviqit, kurse unë duke u nisur nga ajo si fliste dhe si sillej, kam besuar se është mirë ta ndihmoj dhe të jap kontributin tim nga pozita e të parit të BFI-së, siç kam ndihmuar shumë hoxhallarë, madje edhe në çështje të tyre familjare! Ta uroshë e t'i përulesh "klyshëve" të eprorëve të UDB-së, Dragoviqëve, është baraz me ftesën e përsëritshme që i bëhet kijametit.

Asnjëherë nuk reagues partitë e bllokut mysliman kur, për shkak të kërkesave të mia krejt normale për denacionalizim të plotë, për ndërtim të Xhamisë që e dogjë në Prilep, për kthim të Xhamisë në Shtip që e kthyen në kishë, akuzohesha publikisht si person jotolerant, si ekstremist e i rrezikshëm për shtetin dhe shoqërinë si dhe me lloj- lloj etiketash të pandershme por dhe minues i bashkëjetesës ndërkonfesionale. Kurse dëshirat e mia, urimet dhe porositë e mia, gjithnjë kanë qenë përplot me humanizëm. Habitem kur shof se shumë hoxhallarë po dhe profesorë universitarë flasin dhe kërkojnë të mos festohet ose urohet ndonjë festë ndërkombëtare, festa e ndrrimit të moteve, nga ana tjetër, zyrtarë të politikës po dhe të BFI-së, përfshihen në liturgji fetare. Hoxhallarë dhe teologë, po edhe Dr.Musa Musai, si një ish anëtar i Rijasetit të dikurshëm, duhej të kishin reaguar kur Xhelal Bajrami si zv.ministër, gjatë një ceremonie gurëthemeli dhezi qirinj dhe u bë pjesë e liturgjisë kishtarë! Ose së paku të kishin reaguar kur Sekretari i Përgjithshëm i BFI-së, Irsal Jakupi, përmes dhezjes së qirinjeve u bë pjesë e liturgjisë së festës hebreje së sakrificës dhe përkushtimit – Hanukkah. Fatkeqësisht, sjellja dhe veprimet në kundërshtim me parimet islame, kaluan pa reagime. Ndërkoh reagojmë për festa që nuk kanë të bëjnë dhe nuk lidhen me religjione, madje reagojmë edhe kur ia urojmë njëri-tjetrit! Gjithnjë kam kërkuar të urojmë, të shprehim urata e dëshira për çdo njërin me të cilin bashkëjetojmë. Sëkondejmi, uroj që viti 2021 të jetë vit i realizimit të çdo dëshire jetësore, me plotë shëndet dhe shumë suksese për secilin qytetar të shtetit tonë dhe të mbarë botës. Uroj mirëqenie, bashkëjetesë dhe ndëshkim komplotistëve e tradhëtarëve. Uroj me shpirt që Viti që po vie të jetë vit i ndërgjegjësimit tonë si shoqëri dhe të mësojmë të dallojmë të mirën nga e keqja, bereqetin nga plehërat, miqësinë nga servilizmi. Urime të pakufishme edhe për festat e botës krishtere. Zoti shëndet e mirëqenie për mbarë njerëzimin.

*(Fol, 31.12.2020)*

## **BFI-ja e Shaqir Fetait nisi “vitin e mbrapshtë”**

**Shaqir Fetait i duhen hajnat, i duhen rrencakët, i duhen tradhëtarët, i duhen spiunët, i duhen të korrumpuarit, sepse prej tyre e siguron përkrahjen, paprekshmërinë dhe rehatinë e vet. I duhen të prishurit, sepse, ndryshe si do të dëshmohet prishunia e vet! Një i mirë, nuk do të bënte asnjë dakik me një të prishur! Ose do të ikte vetë ose do ta dëbonte të prishurin. Një të prishuri i konvenon të rrijë me një të mirë, sepse do ta përdorte si kamuflim të prishunisë së vet. Punë shejani, a**

**Shkruan Mevlan Limani, psikolog**

Në një intervistë, fund e krye, komike, Shaqir Fetait thotë se, jemi duke i pritur rezultatet e policisë financiare, pastaj të bëjmë analizat tona në Rijaset dhe, pastaj të dalim me fakte konkrete pse e larguam Sulejman Rexhepin. Shaqir Fetait thotë se “nëse ka fakte do t’ia rrëfejme popullit, nëse jo – nuk ka fakte”. Fakt është se pa analiza e shkarkuan Sulejman Rexhepin! Fakt është se Shaqir Fetait erdhi dhunshëm, erdhi politikisht i përkrahur dhe i këshilluar! Por nuk e bën fakt të kryer ikjen e tij nëse nuk gjenë fakte për shkarkim të arsyeshëm të paraardhësit të vet! Kjo flet se, Shaqir Fetait, këtë ngritje të pamerituar në karrierë, këtë katapultim partiak në postin e “reisit” e ka si premtim nga shërbimet sekrete, dhe, madje shqyr që e ngjitën në këtë detyrë, ndryshe, edhe portir në wc publike ta caktonin, aty do të rrite. Nuk i kthehet fjala shërbimeve sekrete, sidomos jo UDB-së njëherë.

### **“Reformatorët” e Shaqir Fetait**

Këto janë dy fakte që flasin se si u ngjit Shaqir Fetait në karrierën e vet. Kuptohet, nuk e ka të lehtë, janë fakte që po e brejnë së brendshmi, janë fakte që po ia dërmojnë ndërgjegjen, janë fakte që i janë bërë mankth në gjumin e natës. Pradaj, Shaqir Fetait ka nevojë aq shumë për urime e përshëndetje, madje që të gjitha i regjistron në faqen zyrtare të BFI-së, ngjarjet personale, lojërat e personalizuar i paraqet si “aktivitete të BFI-së”, duke bërë lloj-lloj “lajme të rrejshme”, nga ai lloj i më banaleve! Këtë e di edhe Shaqir Fetait por, ja që ka nevojë për përkrahje, për zbutje të shqetësimeve të brendshme, për ta gënjyer veten pak. Njeriu i uritur, buzë vdekjes, urinë e shuan me mishin e vet, duke e bindur vetëveten se po ha bukë që ia kanë gatuar “perënditë”. Frojdistët do t’i thoshin “masturbim kanibalist”, seksologët do ta trajtonin si sadomazoizëm!

Shaqir Fetait është në këtë derexhe shpirtërore! Nuk ka urim, nuk ka përshëndetje, sikur edhe tërë bota të ngritet e të presin radhë për të hyrë në “laboratoriumin eksperimental” të tij, nuk do të mund ta mbulojnë dy fakte: ai erdhi si udbash, me guximin dhe këshillin e ngjitjes në karrierë duke i shkelur të gjitha aktet normative, të gjitha nenet, madje tërë Kushtetutën e BFI-së. Madje i mësoi edhe të tjerët për ta shkelur Kushtetutën e këtij Institucioni, duke i rehabilituar nga kriminelë ordinerë në “reformatorë” të Shaqir Fetait. Scenario e UDB-së edhe kjo! Spiunët të udhëheqin me një institucion fetar?! Aty gjithçka mund të ketë, vetm fe jo!

### **Lojërat kutërbuese të Shaqir Fetait**

U publikuan qindra fakte e argumenta që flasin se si, Shaqir Fetai, në çdo hap, që nga “tradhëtia e madhe” e deri më sot, ka shkëlur në çdo sekond e minut dhjetra nene, aline, vendime, e akte të ndryshme normative të BFI-së! Shaqir Fetai sillet tamam si një bashibuzuk, tamam si një njeri i paprekshëm, e i sukseshëm në aktivitetet spiuneske, sepse ka pas vete një shërbim të tërë që jo rastësisht quhet “shërtimi intelegjent” dhe, kur ky shërbim te jetë një miks i shërbimeve ruso-serbe-maqedonase, atëherë, efekti antishqiptar e antimysliman arrinë kulmin e synimeve të mbrapshta! Nga kjo detyrë Shaqir Fetai nuk guxon të lëvizë, qoftë edhe nëse i rrezikohet shëndeti. Nuk guxon t’i takojë asnjë nga ata që mund t’ia tërheqin vërejtjen e ta këndellin për lojërat në të cilat është futur! Ai duhet të takohet vetëm me ata që i porosin të vijë tek ai, apo ata që shprehin dëshirë për të ardhur tek ai. Nuk i duhen për shërbime, as për bashkëpunim, as për miqësim, thjesht, i duhen vetëm për urime dhe përsëndetje dhe, pastaj, në të sëmës!

Shaqir Fetai ka shkatërruar një Institucion shekullor. Janë të kota përpjekjet e tij për të gënjer se shumë shpejt do të bëjë që të lulëzojë ky Instiucion! Pse kush e pengoi tash e tetëmbëdhjetë vite, ose, kush e pengoi tash e një vit të lulëzojë! Bashkësia Fetare Islame po thahet e po venitet nga lojërat kutërbuese të Shaqir Fetait. Shaqir Fetai po zhvillon traditën tashmë të mbjellë prej tij se si shkilen aktet normative, si shkilen ligjet, si shkilet Kushtetuta e një institucioni i cili duhet të rrenohet në themel! Shaqir Fetai kë do e bën myfti, kë do e bën anëtarë rijaseti, kë do e avancon, kur t’i dojë qejfi themelon drejtori, sektore, institucione; vetëm Shaqir Fetai ka të drejtë të punojë pa miratim të buxhetit të Institucionit, pa shënimin e llogarisë financiare, pa raportime para Kuvendit dhe pa miratime të strategjive, programeve dhe të projekteve në Kuvend të BFI-së, vetëm atij i lejohet të shpenzojë sa t’i dojë qejfi për kafe, çajëra, lëngje, dreka e darka për të gjithë ata që e urojnë dhe e përsëndesin. Vetëm Shaqir Fetait i lejohet madje edhe porositet që të ushtrojë shkelje kushtetutare, ndërsa të vizitohet e të urohet nga pseudogjykatës të sojit të vet; vetëm Shaqir Fetait i lejohet që të ofendojë tërë një strukturë udhëheqëse, organet dhe krysinë e një shoqate (“Hilal”) e cila ka statutin e vet dhe që sipas këtij akti ka të drejtën absolute në veprimtarinë dhe në rritjen e vet autonome, ndërsa Shaqir Fetai, si një Faraon, ua emëron drejtuesit; vetëm Shaqir Fetai ka të drejtë që ta mohojë propozimin e mexhlisit të xhematit dhe, propozimet për mufti t’i fusë nën plaf e për myfti ta emërojë atë që do vetë (rasti me Kërçovën); vetëm Shaqir Fetait i lejohet që të caktojë “ushtrues detyre myfti” (rasti në Gostivar)! Paramendoni sikur t’i shkente në mend dikujt, si Shaqir Fetait, që të zgjedhë “ushtrues detyre artist” (sepse edhe na paska qenë gllumac shoçi), apo “ushtrues detyre shkrimtar”, apo, “ushtrues detyre futbollist”, apo, “ushtrues detyre këngëtar”, apo, “ushtrues detyre kritik”, apo, hahaha, “ushtrues detyre mjek, kirurg, ortoped, stomatolog, internist...”!

Shkeljet kushtetutare dhe këto caktime qesharake “të një shkencëtari diletant” i lejohen vetëm Shaqir Fetait, sepse, ka garanca në paprekshmërtinë e vet për çkado që do të veprojë me BFI-në! Një person normal, me një karrierë njerëzore, me të arritura me djersën e ballit (pa gjakun e të tjerëve që i ka marrur më qaf që nga viti 1983), do të kërkonte një interpretim autentik nga Gjykata Themelore Shkupi II, ku është deponuar Kushtetuta e BFI-së dhe e cila ka kompetenca për intervenimin në çdo shkelje të akteve normative, të çdo organizate në vend? Le të shihet njëherë nëse i ka kryer Shaqir Fetai të gjitha këto shkelje kushtetutare apo ka vepruar konform akteve normative të BFI-së të deponuar në këtë Gjykatë!

Ose, le ta ngrisë vetë Shaqir Fetai një komision shariatlinjesh apo, në përgjithësi, me personalitete nga jurisprudenca, dhe le t’i bindë që të dalin me qëndrime shkencore se Shaqir Fetai nuk ka bërë asnjë shkelje kushtetutare! Ky gjest do të ishte më i lakmueshemë se sa gjesti i tij që, përmes përsëndetjeve dhe urimeve, të bëjë përpjekje që të “justifikohen” të gjitha veprimet e tij idiotike, për të mos thënë kriminale.

## Çka i duhet Shaqir Fetait “operativa” aktuale e Myftinisë së Kumanovës

Shaqir Fetai, nëpër do pseudointervista të tij nuk përton që t’i frikësojë “armiqtë” e tij duke thënë se policia financiare ka hyrë në BFI dhe po i kreh tërë dokumentat! Pse Shaqir Fetai ka nevojë të hedhë krip syve! Pse nuk kërkon Shaqir Fetai, për shembull, kjo polici financiare të koncentrohet vetëm në punët e Myftinisë së Shkupit, apo, në Myftininë e Kumanovës, e cila, ndonëse vlerësohet si Myftini më e varfëra nga të gjitha myftinitë e mëdha dhe organizatat fetare në vend e në rajon, megjithatë nëpunësit e vet operativë i ka nga më të pasurit në rajon e në Europë! Apo me këto fakte i shantazhon myftinjtë ekzistues të emëruar nga Sulejman Rexhepi!

Si është e mundur që mos të dihet se ku përfunduan 57 milion denarë nga decentralizimi i pronës në Myftininë e Kumanovës. Le të supozojmë se nga kjo shumë, njëzet për qind kanë ardhur në Rijasetin e BFI-së, që i bie diku rreth 11 milion e 400 mijë denarë! Çka u bë me 45 milion e tjerë që ngelën në Myftininë e Kumanovës?! A e di Shaqir Fetai? A e di Rijaseti? A e di mexhlisi i xhematit të Myftinisë së Kumanovës? A mos përfunduan te rroga dhe kontributet shëndetësore- pensionale të imamëve të Kumanovës? Shaqir Fetai e di shumë mirë se tërë godina e Myftinisë së Kumanovës u ndërtua nga turqët dhe, turqët nuk lanë as më të voglin borxh që ta pagujë pastaj Myftinia e Kumanovës, e cila, me njëqind mijë truqe arriti që të sigurojë edhe nga Arabia Saudite ndihmë prej 400 mij euro, nga të cilat disa mijëra euro u derdhën në arkën qendore të BFI-së! Ku ngelën të tjerat? Ku u tretën rreth 50 milion denarë (mbi 800 mijë euro) që ishin në këtë Myftini? U rritën rrogat e imamëve të Kumanovës? U përmirësua standardi i hoxhallarëve të Kumanovës? U ble ndonjë vakëf, u shtua ndonjë institucion? Jo! Fatkeqësisht, të gjitha këto para përfunduan te personat operativë të kësaj Myftinie, të cilët, bëjnë jetën e “grofit”; me shtëpi e vila te hatashme, me oborre mbretërore, me makina superluksoze, sikur të ishin trashëgimtarë të pasurisë së hatashme nga paraardhësit e tyre! Të gjithë njihen, të gjithë madje janë trajtuar si të mjerë, ndërsa sot janë absolutisht më të pasurit në rajon.

Shaqir Fetait i duhen hajnat, i duhen rrencakët, i duhen tradhëtarët, i duhen piunët, i duhen të korruptuarit, sepse prej tyre e siguron përkrahjen, paprekshmërinë dhe rehatinë e vet. I duhen të prishurit, sepse, ndryshe si do të dëshmohej prishunia e vet! Një i mirë, nuk do të bënte asnjë dakik me një të prishur! Ose do të ikte vetë ose do ta dëbonte të prishurin. Një të prishuri i konvenon të rrijë me një të mirë, sepse do ta përdorte si kamuflim të prishunisë së vet. Punë shejani, a!

*(1Kliklart, 3.01.2021)*

## Fati i palaços – anonimiteti i përjetshëm

Nëse një komunikolog, nëse një redaktor i rehur, për më tepër, një psikolog që e njih mirë komunikologjinë, simbolikat dhe artin, dhe, nëse ky personalitet prej shkencëtari e shfleton numrin e fundit të revistës së BFI-së së kthyer mbrapsht, numër ky dedikuar Shaqir Fetait, sakaq do të konstatojë se, njeriu vuan nga sindroma e anonimusit që do të dalë në sipërfaqe. Palaço që një jetë të tërë bën me artistë por që nuk e njih askush për shkak të makiazit! Bota e artit njih edhe përjekje të palaçove për t'u bërë artistë të vërtetë e të njohur, por, kanë përfunduar në qesharakë, sharlatanë fëmijësh! Anonimiteti i tyre është fati jetësor i tyre. Vetëm në anonimitet mund të dalin të sukseshshëm, të përkrahur e të duartrokatur, të përshëndetur e të uruar.

Në 64 faqe të “Hënës së Re” janë të shtrirë 78 fotografi të Shaqir Fetait! Shaqir Fetai ka qenë plotë 18 vite myfti i Gostivarit, ka qenë profesor, ka qenë gjithçka, që nga hafëzi e deri te bashkëpunëtori i djallit e i të birit, në media nuk i ka as 18 fotografi! Përnjehërë 78! Do me thënë se, mbi 70 delegacione e kanë vizituar që kur e caktuan forcat politike të pushtetit për “reis” të BFI-së! Këta delegacione përfaqësojnë vetëm “miqësinë e ngushtë” të Shaqir Fetait, ka nga ata që përfqësojnë dëshirën e sëmure për të pirë një kafe me “më të madhin e vendit”, ka nga ata që vuajnë për një lavd, për një fotografi, për një përshëndetje me “të madhin”, për një “informatë”. Pra, këta 70 “delegacione” nuk përfaqësojnë popull, nuk përfaqësojnë komunitet, nuk përfaqësojnë opinion pozitiv. Sepse, në ndërkohë, që nga përjekja e Shaqir Fetait për të dalë nga anonimiteti, në opinion kanë dalur 162 shkrime, analiza, komente, vështrime, mbi “fenomenin Shaqir Feta alias “ORAO”) të cilët, në total, janë lexuar nga mbi 1 milion lexues! Ky është opinionimi, ky është mendimi, kjo është pasqyra për Shaqir Fetain, i cili po bëhet motivues, frymëzues i miliona e miliona komenteve të lexusve të shkrimeve që po botohen mbi djallëzitë e Shaqir Fetait.

Palaçot nuk i njih askush, porse, gjithnjë janë atraktivë, janë të dashur, të respektuar, sepse e kryejnë me ndershmëri punën e tyre. Nuk i njih askush, nuk i kontakton askush, mund të rrinë të gjithë me të, por që mos ta njohin se kush është ai në botën e vet profesionale. Një jetë të tërë mund ta çojnë në anonimitet dhe gjithnjë të respektuar për punën e palaços që e kryejnë! Në fund, kur të mësojnë njerezit se personazhi-palaço kush ka qenë në të vërtetë, seç i kaplon një mallëngjim, një borxh për duartrokitje edhe më të mëdha, e ndjejnë një padrejtësi ndaj tij i cili, tërë jetës i ka argëtuar i veshur nën petkun dhe makiazin e komikes!

Shaqir Fetai ishte më i respektuar në anonimitet, më i nderuar, më i lavdëruar! Sapo shprehu dëshirën për të ikur nga ky anonimitet, doli sheshit diletantizmi i tij, amatorizmi, kompilacioni, plagjiatura, doli sheshit ai shejtan që e kishte pasur së brendshmi, doli sheshit Shaqir Fetai i vërtetë, me të gjitha namet dhe nishanet që i paska pasur.

Dëshira pataologjike për të dalur nga anonimiteti, mund të shoqërohet edhe me dhunë, me rrena, me shpifje, me matrapazllëqe, me anarki. Shembuj se si personat e tillë përfundojnë në diktatorë ka përplotë në historinë tonë kombëtare si dhe në historinë botërore. Siç ka edhe plotë shembuj që flasin se si kanë përfunduar ata diktatorë, cili ka qenë fundi i atyre diktatorëve, me çfarë “selami” janë përcjellë!

Një artist profesionist i dështuar kurrë nuk mundet të matet me asnjë personazh të cilitdo palaço, qoftë ai edhe amator. Artisti i dështuar e ka irituar dhe nervozuar një opinion të gjërë spektatorësh të skenës, kurse një palaço amator, të paktën ka argëtuar një komunitet i cili e ka përshëndetur me duartrokitje frenetike palaçllëkun e tij prej artisti.



Kjo është filozofija që duhet ta kuptojë sa më parë Shaqir Fetai, sepse, nuk ka pushtet, nuk ka forcë politike në botë që do të detyrojë masën ta duartrokasë të dështuarin! Koha është të ndërgjegjësohet Shaqir Fetai dhe jo ta jetojë famën e rikthimit në origjinën e profesionit prej bashkëpunëtori nën pseudonimin ORAO. Në anonimitet jeta është më e ëmbël se në ilegalitet!

*(Botapress, 5.01.2021)*

## Kush më parë do të sigurojë karrige në OKB: Kosova apo Shaqir Fetai

**Për momentin, ndonëse pavarësinë e Kosovës e kanë përshëndetur dhe uruar mbi 100 shtete të botës, Kosova e ka problem që ta sigurojë një karrige në OKB, sepse, po e mohon Serbia me aleatët e vet si dhe po angazhohet në pengimin e njohjeve të reja**

### *Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI*

Shaqir Fetain na e paskan uruar, do me thënë, na e paskan njohur shumë shtete të botës. Duke e ditur se ai ka mision serb në BFI, nuk është çudi që Serbia, e cila tashmë e ka njohur Shaqir Fetain, do të angazhohet për sa më shumë njohje me qëllim që t'a sigurojë një karrige në OKB!

Shaqir Fetai përfundimisht po tregohet se është një skuth shumë i keq, se është njeri shumë i rrezikshëm, se është karrierist i verbuar se, për karrierë të vet nuk i intereson as turpi, as harami, as gjynahi, as protokoli e as diplomacia. Sepse, në këto aspekte ai është tabulla rasa, ndërsa plotë me angazhime e detyra nga Dragoviqët e UDB-së. Urimet dhe përshëndetjet personale të drejtuesve të asociacioneve fetare islame në dasporë, të shtrirë nëpër shumë shtete, nuk do të thotë apriori se Shaqir Fetait ia sollën përkrahjen e shteteve prej nga vijnë.

Urimet dhe “përkrahjet” e ambasadave që funksionojnë në Maqedoni, e nëpër shtetet përreth, nuk do të thotë se apriori Shaqir Fetai siguroi përkrahjen dhe njohjet e shteteve gjegjëse. Do të ishte budallallëk i skajshëm nëse Shaqir Fetai mendon kështu, ndërsa ky sinqerisht mendon kështu. Prandaj duhet të kihet sa më shumë kujdes kur të komunikohet me këtë duduk, sepse ky të merr më qafë. Është i stërvitur që ta aktojë “abdallëkun”!

Vizitat apo edhe urimet në forma të shkuara, të nënshkuara e të vulosura, nuk kanë kurrfarë domethënie përveçse një mirësjellje diplomatike që përçon mesazhin e gatishmërisë për të vazhduar bashkëpunimin në mes të ambasadës, organizatës apo asociacionit me BFI-në; një ftesë zyrtare Shaqir Fetait për ta pranuar vazhimin e bashkëpunimit që është ngritur shumë më herët para se të lindë Shaqir Fetai, madje para se ai të jetë në kikirika të Afrikës!

Delegacionet e qendrave islamike, të cilët kësaj radhe erdhën në atdhe për shkak të festave të fundvitit që i kanë nëpër shtetet ku veprojnë: në Itali, Norvegji, Austri, Gjermani, Kroaci, etj. Shaqir Fetai nuk guxon t'i përkthejë si njohje të shteteve prej nga vijnë këta përfaqësues të myslimanëve tanë. Ndryshe do të konsiderohej ky si manipulim, si aventurë, si idiotizëm e Shaqir Fetait. Nëse Shaqir Fetai nuk është i këtillë atëherë si guxon të urdhërojë një titull të tillë si: “SHUMË SHTETE UROJNË KRYETARI E BFI-së”! Nëse nisemi nga kjo logjikë, atëherë, ndër shtetet e para që e ka njohur Shaqir Fetain është Serbia sepse nga ky shtet urimi ka arritur më 18 nëntor të vitit 2020, madje po atë ditë kur u publikua lajmi se Shaqir Fetai “u zgjodh reisul ulema”!

Shaqir Fetai, me gjasë, është në garë me Kosovën se kush do të sigurojë njohje më shumë dhe cili i pari do të arrijë të ulet në karrigen e OKB-së. Pa dyshim, me ndihmën e oficerit të vet, Stanko Dragoviqit, do t'ia arrijë Shaqir Fetai që të ulet në atë karrige. Ja, sapo t'i mbarojë urimet dhe përkrahjet nga studentët, nxënësit, edukatorët, deputetët, ministrat dhe, në fund, në aksion do të jetë

Stanko Dragoviqi i UDB-së i cili i paska çuar selam Shaqir Fetait se nuk do ta lë në baltë. Me rëndësi, përkrahjen e shteteve kryesore ia siguroi, kanë ngelur vetëm edhe do shtete që nuk janë as në hartë. Ç'turp i tmerrshëm i ka katandisur myslimanët e Maqedonisë së Veriut me këtë abdall!

*(1Kliklarg, 6.01.2021)*

## A ka dinjitet stafi akademik i FSHI-së

Këto ditë u publikua një informatë që thoshte se, Fakultetin e Shkencave Islame të Shkupit e paskësh vizituar “reisi” i LSDM-BDI-së, Shaqir Fetai, i cili ua paska mbajtur një “ligjeratë” stafit akademik mbi nevojën për të qenë sa më kreativë, mbi nevojën për të ndryshuar metodologjinë e mësimdhënies konform kriterëve të shekullit XXI e budallallëqe të tilla!

Dhe stafi akademik i FSHI-së jo vetëm që e ka pritur këtë farë “burri” por edhe ia ka dëgjuar pordhët e tij, të cilat janë në funksion të kamuflimit të profesionit të tij prej të qenurit nxënës i përjetshëm i oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviqit!

Një botë e tërë është dëshmitar se Shaqir Fetai u ka ardhur “reis” dhunshëm, si zgjedhje dhe si imponim i partive në pushtetin aktual maqedonas. Për pasojë, janë shkelur të gjitha aktet normative të BFI-së, është shkelur një Kushtetutë e tërë e këtij Institucioni! Shaqir Fetai nuk është për hajër aty, nuk është zgjidhje e hajrit por e sherrit, e devalvimit, e njollosjes, e shkatërrimit të çdo organi të BFI-së. Kush e shkel Kushtetutën e BFI-së, kush tallet me organet dhe institucionet e BFI-së, ai nuk është hajri i islamit, por, sherrri i të gjithëve.

Po a ka dinjitet stafi akademik i FSHI-së a jo?! Të gjithë akademikë që presin nxënësin e Dragoviqit! Çfarë borxhi i kanë që ta presin? Fundja, a pritet një nxënës i përjetshëm i shërbimeve? Është turp, është inat. Apo, nuk e priten të gjithë, e priten vetëm ata pseudodoktora e pseudomagjistra, me tema të blera e të kompiluara, plagjiatura e amatoreske! Shumë shpejtë do të zbulohen edhe këta skutha që fshihen pas temava e titujve të blerë, do të publikohen fakte e argumente që flasin se çfarë “ushrohet” nëpër zyre drejtuesish të kësaj vatre arsimore. Sepse, duhet të ndahet shapi prej sheqeri. Duhet të tregohet se kush e nderon nxënësin e Dragoviqit, “reisin” e LSDM-BDI-së e kush e refuzon në mënyrë akademike!

Shaqir Fetai mjaft luajti me “devotshmërinë e vet” prej hipokriti, mjaft i njollosi profesorët, “thirrësit”, teologët, politikanët, gjykatësit, diplomatë e ambasadorë, sepse, ai fort mirë e di se nuk është “lule për t’i marrur erë”, por që kutërbon në fëlliqësirat e një mashtruesi, një gënjeshtari, një trukaxhiu.

Në inbox na ka ardhur një letër e një turko-shqiptari, që flet se si, vite më parë, për të kaluar radhën në doganën e Turqisë, në aeroport, Shaqir Fetai aktrroi topallin duke e tërhequr këmbën zvarrur e duke bërëtitur “hasta, hasta” dhe, kur paska dalur “në breg”, i paska thënë Sulejman Rexhepit: “ama ua ngula turqve”! dhe, këtë bisedë dhe këtë pamje e ka përcjellë biznesmeni turko-shqiptar! Do ta botojmë edhe letrën e tij!

*(Lajme7, 12.01.2021)*

## Shkeljet dhe masakrimi i Kushtetutës së BFI në RMV

Në inbox-in e faqes zyrtare të Këshillit për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së, kanë arritur qindra letra e kërkesa në cilat është shprehur kryesisht interesimi për t'ua shpjeguar të gjitha shkeljet kushtetutare që i ka bërë Shaqir Fetai, me rastin e zhvillimit të aventurës së vet në korniza të skenarit partiako-politik që kishte synim degradimin e BFI-së. U shkel vetëm një herë Kushtetuta – kush garanton se ky gjest nuk do të përsëritet dhe nuk do të bëhet praktikë e BFI-së! Dikush u angazhua që mos të ketë kurrë BFI stabile, me përvojën e vet shumëshekullore. Tani e tutje kemi “BFI”-në e Shaqir Fetait dhe honxho-bonxhove të vet

### *Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI*

Viti 2020 në historikun e Bashkësisë Fetare Islame të RMV-së do të ngelë si vit nga më të mbrapshtët. U suspendua Kushtetuta e këtij Institucioni, u rrënuar përdhe, u deligjitimua, u defaktorizua, u deinstitutionalizua e u depersonalizua nga faktorë antiislam! Ngjarjet që e shoqëruan përgjatë vitin që e lamë pas, janë ndër ato ngjarje të mëkatshme për të cilat, gjithësesi që ia vlenë të ketë ndëshkime drejtësie, morale e islame. Nuk mund të pranohen për myslimanë të denjë ata që me veprimet e tyre u pajtuan që të shkelin Kushtetutën e BFI-së e cila rregullon jetën fetare islame. Nuk ngeli gjë e keqe që nuk u ushtrua mbi këtë Institucion. Organet e drejtësisë si dhe organet gjegjëse shtetërore që janë kompetentë të përcjellin punën kushtetuese të çdo institucioni të nivelit kushtetutar, të cilët kushtetutat e veta i kanë të deponuara në Gjykatën Themelore Shkupi II, nuk reagues fare por, duke qëndruar si të verbër e nemë, lejuan që BFI-ja të devalvohet deri në një kotec rrebelësh që mbijetojnë vetëm duke shkelur akte normative e duke shkatërruar Institucionin.

Që nga aventura e disa segmenteve të pushtetit në bashkëpunim me disa kukulla brenda BFI-së e deri te zgjedhjet ilegjitime ku u zgjodh një “reis” kontravers, i delegjitimuar, i degraduar, i kontestuar, sepse ishte i falsifikuar, e deri më sot janë bërë qindra shkelje të Kushtetutës së BFI-së. Në këtë analizë të thellë jemi përqëndruar vetëm në ato shkelje që u kryen nga momenti i shkarkimit të ish-reisul ulemasë e deri në zgjedhjen e atij reisi që më tepër është imponim politik-partiak se sa përfaqësues legjitim i organeve dhe, përgjithësisht, i masës muslimane të vendit. Ky është indeksi i të gjitha shkeljeve të “teologëve” anarkistëve që ia bënë Kushtetutës së BFI-së!

### **I - Shkelja e autonomisë së BFI-së, devijimi i qëllimit të vetëm**

Bashkësia Fetare Islame është organizatë e vetme e cila organizon jetën fetare të muslimanëve në RMV. *“BFI vazhdon të veprojë si bashkësi fetare e pavarur në Republikën e Maqedonisë dhe këtë e dëshmojë me sjelljen e Kushtetutës së Bashkësisë Islame në vitin 1994.”* *“BFI veprimtarinë e vet e mbështet në Kur’an, në Sunnet, në Kushtetutën e saj dhe në aktet normative që dalin nga e njëjta si dhe në Ligjin për pozitën juridike të kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz.”*<sup>2</sup>

Bazuar në deklaratat e disa funksionarëve të BFI-së, deklaratave publike të ish-kreut të BFI-së si dhe deklaratave publike të kreut të BDI-së, bëhen të qarta ndërhyrjet e politikës dhe pushtetit në vendimet e BFI-së. Me këto ndërhyrje, u shkel mbi autonominë dhe pavarësinë e Institucionit të vetë

fetar islam në vend.

Neni 1 i Kushtetutës së BFI-së, thotë: **“BFI është autonome dhe e pavarur në organizimin e jetës fetare, në edukimin dhe arsimimin fetar, në vakëfet, veprimtarinë administrative-financiare si dhe në veprimtaritë tjera që dalin nga kjo Kushtetutë.”**

Ndërhyrja e një faktori të jashtëm i cili nuk ka asgjë të përbashkët me qëllimet e BFI-së, bën që rrjedhimisht ky Institucion të devijojë edhe parimet esenciale por edhe në qëllimet që përcaktohen në Kushtetutë.

Neni 6 thotë: **“Qëllimi i BFI-së është ngritja e vetëdijes fetare, organizimi i kryerjes së ibadeteve si dhe format e tjera me të cilat shprehen ndjenjat dhe jetësimi i Islamit të muslimanët.”**

Devijimi i qëllimeve sjell në keqpërdorimin e kapaciteteve të Institucionit si dhe shpenzimeve të të mirave materiale të BFI-së për qëllime të tjera.

Neni 13 thotë: **“Pasuria e BFI-së shërben ekskluzivisht për realizimin e qëllimeve të saja.”**

Ndërhyrjet e faktorëve jashtë BFI-së në sjelljen e vendimeve në BFI, përkoi me kohën kur BFI ishte në pritje të realizimit të të drejtave të saja ligjore, në kohën kur asaj i ishin premtuar pika të caktuara në dobi të zhvillimit të institucionit. Pjesa dërmuese e pikave kishin të bëjnë me kthimin e pronave të saja përmes denacionalizimit. Me ndërhyrjet e jashtëme, BFI pësoi në aspektin organizativ. BFI ngeli pa disa organe, ndërkohë që u kap nga organe të egra për BFI-në. Shkeljet kushtetutare dëmtojnë rëndë institucionin, ndikojnë në humbjen e autoritetit, humbjen e besimit të besimtarët, rrënimin e unitetit etj. Shkeljet gjithnjë bëhen në dobi të ndonjë grupi të caktuar, të një grupi i cili nuk ka për qëllim të vërtetën. Ndryshe, nuk kanë asnjë arsye për ta shkelur Nenin 8 të Kushtetutës i cili është kryekëput i mbështetur në parimet islame:

**“BFI veprimtarinë e vet e mbështetë në parimet e:**

- drejtësisë,
- transparencës,
- debateve para sjelljes së vendimeve në organet kolektive,
- konsultave në kryerjen e punëve,
- zgjedhjeve, emërtimeve, përgjegjësi dhe shkarkimeve të funksionarëve.”

Gjatë vitit 2020, sikur ky nen nuk ekzistonte fare. Pati vendime të përshpejtuara, të gabuara, antikushtetuese, mbledhje të fshehta, vendime të dirigjuara.

Neni 9<sup>3</sup>, i cili, mes tjerash na flet edhe për të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të BFI-së, ka mjaft pika të rëndësishme për zhvillimin e organizimit të BFI-së, siç janë:

**“-Pjesëmarrja aktive në organizimin e jetës fetare.**

- të shërbehen me pronën e BFI-së në përputhshmëri me aktet normative dhe rregullat e Sheriatit.
- Të informohen për punën e organeve dhe të institucioneve të BFI-së.
- t'i përmbahen Kushtetutës, akteve normative dhe vendimeve të organeve të BFI-së,

3 **“Të gjithë anëtarët e BFI-së, me këtë Kushtetutë, janë të barabartë, pa dallim përkatësie kombëtare, race ose gjinie, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përgjithshme, si dhe për punësim në radhët e Bashkësisë Fetare Islame. Të drejtat e anëtarëve të BFI-së janë: - Shfaqja dhe praktikimi i Islamit në jetën personale, familjare dhe shoqërore. - Rregullimi i jetës familjare si dhe arsimimi dhe edukimi në frymën e mësimave slame. - Pjesëmarrja aktive në organizimin e jetës fetare. - Shfrytëzimi i shërbimeve të organeve dhe institucioneve të BFI-së në kryerjen e detyrave dhe arsimimin e tyre. - Të shërbehen me pronën e BFI-së në përputhshmëri me aktet normative dhe rregullat e Sheriatit. - Të propozojnë kultivimin sa më të mirë të jetës fetare. - Të informohen për punën e organeve dhe të institucioneve të BFI-së. - Për mbrojtjen e të drejtave të tyre t'u drejtohen organeve të BFI-së. - Festat fetare t'i festojnë sipas rregullave të Sheriatit dhe traditave islame. Detyrimet e anëtarëve të BFI-së janë: - t'u përmbahen rregullave, zakoneve dhe traditave islame në përditshmërinë e tyre, - t'i përmbahen Kushtetutës, akteve normative dhe vendimeve të organeve të BFI-së, - të japin kontributin e tyre të përgjithshëm material dhe kontribute të caktuara për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e BFI-së, - të paguajnë anëtarësinë e rregullt, - të mbrojnë dhe ruajnë pasurinë dhe pronën e BFI-së, - të mbrojnë vlerën, interesin, unitetin dhe autoritetin e BFI-së.”**

*-të japin kontributin e tyre të përgjithshëm material dhe kontribute të caktuara për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e BFI-së,*

*-të mbrojnë dhe ruajnë pasurinë dhe pronën e BFI-së,*

*-të mbrojnë vlerën, interesin, unitetin dhe autoritetin e BFI-së.”*

Mirëpor, organet e BFI-së që i shkelin parimet islame, Kushtetutën dhe aktet e tjera normative, pengojnë pjesëmarrjen aktive të besimtarëve dhe me këtë edhe e humbin të drejtën për të kërkuar nga ata që të respektojnë dhe t'i kontribuojnë Institucionin.

## **II - Shkeljet e Kushtetutës me rastin e shkarkimit të Reis ul Ulemasë**

Me rastin e shkarkimit të Reisu ul Ulemasë – Organ i BFI-së, Rijaseti i cunguar dhe i falsifikuar u mblodh në Gostivar. Ky lloj Rijaseti, as nuk u konvokua e as nuk u udhëhoq nga Reisul Ulema. Askush për asgjë nuk kishte dëgjuar më heret se, kundër dikuj ka ndonjë vërejtje apo se është filluar ndonjë proces përmes Komisionit disiplinor dhe Prokurorit të BFI-së! Thjesht, dikush i mblodhi vetëm disa anëtarë të Rijasetit<sup>4</sup>, të cilëve iu bashkangjiten edhe të tjerë që nuk kishin të drejtë pjesëmarrje në mbledhje, dhe shkarkuan Reis ul Ulemanë. “Ndërgjegjësimi” i përnjëhershëm, si rezultat i ndikimit të faktorëve nga jashtë BFI-së, ashtu sikurse u tha edhe më herët, ka shkaktuar shkeljen e Preambullës dhe disa neneve të tjera, por tani do të ndalemi në nenet që kanë të bëjnë me “mbledhjen e shkarkimit”.

Mbledhja u mbajt në Gostivar, dhe jo në Shkup ku është edhe selia e BFI-së. Neni 3 thotë:

***“Selia e BFI-së është në Shkup.”***

Mosdebatimi para sjelljes së vendimeve, jotransparenca... në veçanti në rast të shkarkimeve, është në kundërshtim të plotë me Nenin 8. Një shkelje e këtillë padyshim që argumenton se në rastin konkret kemi të bëjmë me ndërhyrje nga jashtë BFI-së.

Neni 35 i Kushtetutës përcakton qartë se nga kush përbehet Rijaseti i BFI-së:

***“Rijaseti i BFI-së është organ i cili vendos për çështje islamike.***

***Rijaseti i BFI-së përbëhet prej Reis ul Ulemasë, Sekretarit të Përgjithshëm të BFI-së, Muftinjve, drejtorëve dhe dekanëve të institucioneve arsimore, kryetarëve të shoqatave të Bashkësisë Fetare Islame dhe dy anëtarëve të caktuar nga ana e Reis ul Ulemasë me përvojë në organizimin e jetës fetare në radhët e BFI-së.”***

Në mbledhjen e Rijasetit të falsifikuar dhe ilegjitim që u mbajt në Gostivar, në “vendimin” e shkarkimit të Reisul Ulemasë firmat e tyre i hodhën kordinatorë, drejtorë të sketorëve, kryetarë shoqatash pa mandate, madje edhe të atillë që nuk patën asnjëfarë cilësie!

Edhe sikur përbërja e Rijasetit të ishte në përputhshmëri me Nenin 35, Muftinjtë nuk janë organe, as drejtorët apo dekanët e institucioneve arsimore nuk janë organe, sikurse nuk janë as kryetarët e shoqatave të BFI-së, sëkëndejmë, ata në Rijaset duhet të përfaqësojnë qëndrimet e organeve, institucioneve dhe shoqatave që përfaqësojnë, dhe jo të vendosin sipas diktateve të huaja për BFI-në.<sup>5</sup> Sjellja e këtillë e anëtarëve të Rijasetit është në kundërshtim me nenin 8, 9, si dhe ndikon në uljen e peshës së organeve, institucioneve dhe shoqatave. Moskonsultimi, mospërfshirja, ndikon në

4 Kurse disa anëtarë të Rijasetit as nuk ishin të ftuar. Se Rijaseti kishte zhvilluar mbledhje këtë e mësuan nga mediat!

5 Jo rastësisht përpiluesit e Kushtetutës nuk kanë paraparë që drejtuesit e këtyre organeve, institucioneve dhe shoqatave të mos jenë organe. Ata të emëruar nga Rijaseti dhe të autorizuar nga Reis ul Ulema mund të udhëheqin punët e organeve. Një person ekziston mundësia për të gabuar, për shkaqe nga më të ndryshmet, por jo e tërë Muftinia, institucioni, shoqata.

realizimin e qëllimeve të BFI-së për të cilat na flasin nenet: 6<sup>6</sup> dhe 7<sup>7</sup>, si dhe ndikon negativisht në të hyrat e BFI-së për të cilat na flet Neni 11<sup>8</sup>.

Mbledhja e Rijasetit, mund të konvokohet dhe të udhëhiqet nga Reisul Ulema, kështu thotë pika e fundit e Nenit 37: **“Mbledhjen e Rijasetit të BFI-së e konvokon dhe e udhëheq Reis ul Ulemaja, në raste të veçanta atë e konvokon me kërkesë të 1/3 të anëtarëve të Rijasetit.”** Si dhe pika 5 e Nenit 44: **“- konvokon dhe udhëheq seancat e Rijasetit dhe kujdeset për zbatimin e vendimeve të tij.”** Kurse me rastin e mbledhjes në Gostivar, kurrë nuk u bë e qartë se kush e konvokoi mbledhjen e Rijasetit! Policia, partia apo pushteti!

“Vendimi” për shkarkimin e Reisul Ulemasë u bazua në “procesverbal të mbledhjes” që nuk ishte mbledhje Rijaseti, më pastaj u thirrën në Nenin 36<sup>9</sup> i cili nuk ka të bëjë fare me shkarkim! Vetëm nga një mbledhje e përgatitur prej strukturave që nuk janë të udhëzuara me organizimin e BFI-së, mund të dalin aq shumë gabime trashanike. Përveç në këtë Nen, puçistët në “vendim” e vet u thirrën edhe në Nenin 58 të Kushtetutës, i cili thotë:

**“Të zgjedhurit, të emruarit dhe të punësuarit në BFI, duke u nisur nga Reis ul Ulemaja e deri te muezini, mund të revokohen dhe të shkarkohen nëse organet dhe institucionet e BFI-së konstatohet se:**

- nuk i kryen obligimet për të cilat është zgjedhur, emëruar.
- qëndrimi dhe puna e tij është në kundërshtim me normat islame dhe aktet normative të BFI, -punon kundër dispozitave dhe vendimeve të organeve kompetente të BFI,
- keqpërdor pozitën në dëm të interesave të BFI-së,
- pa sukses i kryen punët dhe obligimet e tij,
- pa aftësia për kryerjen e punës së vet, sëmundja, moshja, vdekja ose vet dëshira e largimit,- në rast se burgoset mbi gjashtë muaj,
- përgjegjësia disiplinore dhe materiale përcaktohet me rregullore të veçantë,
- vlerësimi përfundimtar për revokim dhe shkarkim e bën Rijaseti i BFI-së.”

Është e qartë se për t’u thirrur në këtë Nen, paraprakisht duhej të ishin shteruar procedurat paraprake.

6 **“Qëllimi i BFI-së është ngritja e vetëdijes fetare, organizimi i kryerjes së ibadeteve si dhe format e tjera me të cilat shprehen ndjenjat dhe jetësimi i Islamit te muslimanët.”**

7 **“BFI qëllimet e veta i realizon përmes: - mësimit dhe kultivimit të vlerave islame, - themelimit dhe mirëmbajtjes së xhamive, mesxhideve, qendrave islame, teqeve dhe mektebeve. - themelimit dhe veprimit të institucioneve edukativo-arsimore, - themelimit dhe veprimit të institucioneve shkencoro- kulturore, -themelimit dhe mirëmbajtjes së bibliotekave, hanikaheve, arkivave, muzeve, instituteve dhe institucioneve të ndryshme, - themelimit dhe mirëmbajtjes së varrezave, - themelimit dhe veprimit të institucioneve bëmirese, - themelimit të vakëfeve, mirëmbajtjes dhe mbrojtjes së pronës së BFI-së, - promovimit të së mirës dhe luftës kundër së keqes, - organizimit të veprimtarisë botuese, - kultivimit dhe bashkëpunimit tradicional me të gjitha bashkësitë islame, institucionet, asociacionet dhe organizatat e ndryshme në botë, të cilat kultivojnë vlera islame. - bashkëpunimit me bashkësitë tjera fetare, organizatat joqeveritare dhe organet shtetërore në vend, dhe -përmes çdo veprimtarie fetare, kulturore, shkencore, shëndetësore dhe socio-ekonomike për avansimin e popullatës muslimane.”**

8 **“Pasuria e BFI-së fitohet prej: - të hyrave nga vakëfet dhe pasurive të tjera të tundshme dhe të patundshme të organeve dhe institucioneve të BFI-së dhe prej të ardhurave që vijnë prej tyre, - zeqatit, sadakatul-firitit dhe të dhënurave të tjera fetare, - të hyrave të rregullta dhe të dhënurave të tjera vullnetare të cilat i dedikohen BFI-së, - dhuratave dhe testeve (vasijeteve) që dhurohen, - fondeve të ndryshme dhe të hyrave nga ato, - të hyrave nga veprimtaritë e organizatave dhe institucioneve të themeluara nga BFI, - të hyrat nga shërbimet fetare dhe administrative dhe - donacionet, sponsorimet nga organizatat dhe asociacionet qeveritare dhe joqeveritare si dhe nga të dhënat e tjera.”**

9 **“Fushëveprimi i Rijasetit të BFI-së në vend dhe jashtë: - Organizimi i jetës fetare, - Zhvillimi i njohurive edukativo-arsimore, kulturoro-shkencore dhe informative. - Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve islame. - Strukturën organizative dhe veprimtarinë e organeve të BFI-së. - Bashkëpunimi me organizatat dhe institucionet islame në botë. - Puna juridiko-administrative dhe financiaro-ekonomike.”**



Drejtuesit aktual të BFI-së pranojnë se, ende nuk kanë konstatime të shkeljeve eventuale që kanë ndikuar në shkarkimin e ish-reisul ulemasë. Komisioni disiplinor por, edhe prokurori i BFI nuk janë mbledhur dhe nuk janë marrë me vlerësimin e punës së Reisul Ulemasë. Rijaseti asgjë nuk tha mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale e cila përcaktohet me rregullore të veçantë! Nuk ka dyshim se, mungesa e fakteve, por edhe mungesa e guximit, bëri që në këtë mbledhje të Rijasetit të falsifikuar, pas gjitha shkeljeve të rënda që u bënë, të bëhet edhe shkelja e radhës: të shkarkuarit të mos i jepet e drejta për t'iu përgjigjur akuzave eventuale ose për ta ankimuar “vendimin”! Neni 62 thotë: **“Reis ul Ulemaja përgjigjet para Rijasetit të BFI-së.”**

Krejt në fund, vendimet që merren në Rijaset, duhet të dekretohen nga ana e Reisul Ulemasë. Neni 44 alinea e fundit thotë: **“- dekretin vendimet e marrura nga Rijaseti i BFI-së.”** Vendimi i sjellë në mbledhjen e Rijasetit të falsifikuar, nuk u dekretua, s'këndejmë, ai vendim nuk ishte asgjë më tepër se një puç i realizuar me skenar të pregatitur nga jashtë BFI-së, i realizuar nga aktorë të brendshëm.

### **III - Shkeljet e Kushtetutës me rastin e ‘caktimit’ u. d. Reis ul Ulemasë**

Me rastin e “caktimit” të u.d.Reis ul Ulema janë shkelur disa nga nenet që u përmendën me rastin e shkarkimit të Reis ul Ulemasë si dhe disa nene të tjera.

Kushtetuta e BFI-së për postin e të parit njih vetëm fjalën “zgjedhje”. Për pozita të tjera njih edhe fjalët “emërim” dhe “punësim”, kurse fjalën “caktim” e njih vetëm në një të drejtë ekskluzive të Reisul Ulemasë (Neni 35) ku flet për të drejtën e tij për të caktuar dy anëtarë të Rijasetit me përvojë në organizimin e jetës fetare në radhët e BFI-së! Mirëpo, kur kemi të bëjmë me një mbledhje të konvokuar nga faktorë jashtë BFI-së, të njëjtët caktojnë se kush duhet të caktohet u.d.Reis ul Ulema. Ky lloj Rijaseti i mbledhur në Gostivar “krijoi” organ antikushtetues. Neni 23 thotë:

**“BFI ka organet dhe institucionet e veta.”**, Neni 24: **“Organet e BFI-së janë:**

- **Muftinia,**
- **Rijaseti i BFI-së,**
- **Reis ul Ulema dhe**
- **Kuvendi i BFI-së.”**

Kurse neni 39 thotë:

**“Reis ul Ulema është organ i BFI-së.**

**Reis ul Ulema është lider fetar – Kryepar i BFI-së, i cili e përfaqëson unitetin fetarë të pjesëtarëve të Islamit në vend dhe jashtë.”**

Me “caktimin” e u.d. Reisul Ulemasë, në vend të një organi të BFI-së, rrjedhimisht do të ndodhin shkelje të tjera. Fakti që dikush pranon një pozitë antikushtetutare, i njëjti nuk do të mbante llogari e as që do të brengosej për shkelje të mëtutjeshme të Kushtetutës.

U.d. Reisul Ulema, si një organ i panjohur për Kushtetutën, fillon të merret me punët me të cilat Kushtetuta e obligon Reisu ul Ulemanë, më konkretisht Neni 44<sup>10</sup>, kurse Kushtetuta e BFI-së është

10 **“Reisul -Ulema: - përfaqëson Bashkësinë Fetare Islame në vend dhe jashtë;- jep murasele (autorizim) për kryerjen e punëve fetare, pa të cilën tërheq kontest të legjitimitetit; - emëron dekanët, drejtorët dhe mësimdhënësit të institucioneve arsimore të BFI-së dhe mësimdhënësit e lëndës së mësim-besimit në shkollat publike.- organizon dhe mbikëqyr punën e shërbimeve profesionale të BFI-së.- konvokon dhe udhëheq seancat e Rijasetit dhe kujdeset për zbatimin e vendimeve të tij;- ndërmyet dy mbledhjeve të Rijasetit, kryen punë të domosdoshme që janë në kompetencë të Rijasetit dhe për këtë informon Rijasetin në seancën e radhës. - nënshkruan aktet e Rijasetit;- nënshkruan aktet për punësim në BFI;**

**- ndan shpërblime për të arritura të veçanta në avansimin e jetës fetare;- viziton regjionet në të cilët jetojnë pjesëtarët e fesë islame; që të njihet drejtpërdrejtë me gjendjen dhe propozon masa për zhvillimin dhe avansimin e jetës fetare; - lejon pushimet e muftive, dekanëve, drejtorëve të medreseve, drejtorëve dhe kryetarëve të institucioneve,**

shumë decide! Neni 56 thotë: **“Punët fetare, fetaro-arsimore, adminstrativo-financiare të BFI-së i kryejnë personat e zgjedhur, të emëruar dhe të punësuar.”** Pra, të drejtën për punët e caktuara i kanë ata që janë të zgjedhur, emëruar ose punësuar, dhe jo edhe një i “CAKTUAR”! Sjellja e u.d. Reisul Ulemasë, për rreth gjashtë muaj na dëshmoi se ai u mor me aktivitetet antikushtetutare që shkonin në dobi të tij dhe mentorëve të tij, në dëm të BFI-së.

#### **IV - Shkeljet e Kushtetutës me rastin e dorëheqjes së Reisul Ulemasë**

Pas mbledhjes së Rijasetit ilegjitim të mbajtur larg selisë së BFI-së, në të cilën BFI-së dhe kreut të saj iu bë puç klasik, nëpunësit fetar të BFI-së, besimtarët dhe i mbarë opinionimi më i gjërë ishin në pritje të reagimit të ish-Reisul Ulemasë. Pritej që në bazë të Neni 44 i cili mes tjerash i mundësonte tërheqjen e muraseleve Muftinjve devijantë, i mundësonte pengimin e realizimit të vendimeve për të cilat flet alinea 12 e po të njëjtit nen: **“të pengojë ekzekutimin e vendimeve të organeve dhe të institucioneve të BFI nëse konstaton se të njëjtat janë në kundërshtim me ligjin dhe parimet islame dhe të njëjtat t’i kthejë në rishqyrtim, kurse vendimin përfundimtar e sjell Rijaseti i BFI-së.”**

Krahas kësaj, Neni 40<sup>11</sup> i mundësonte që të thërrasë mbledhje me të gjitha organet, institucionet, organizatat dhe shoqatat e BFI-së, përmes të cilës do të kontribuonte në kthimin e Institucionit në binaret kushtetuese. Fatkeqësisht, dy ditë më vonë, Reisul Ulema do të ofroj dorëheqjen e tij, për të cilën më vonë do të deklarohet se ka qenë rezultat i ndërhyrjes së një subjekti politik, me çrast, për të dytën herë brenda dy ditëve shkelet mbi autonominë e BFI-së!<sup>12</sup>

Duhet nënvizuar se edhe me rastin e kësaj dorëheqje, Rijaseti nuk ngeli pa shkelur Kushtetutën e BFI-së. Neni 64 thotë: **“Secili funksionar i BFI-së ka të drejtë të jep dorëheqje, dhe për të njëjtën vendos Rijaseti i BFI-së.”** Kurse Rijaseti nuk u mbledh për të vendosur!

#### **V - Shkeljet e Kushtetutës me rastin e emërimit të Muftinjve dhe një u. d. Muftiu**

Në prag të zgjedhjeve për Reisul Ulema, u mbajt një mbledhje e Rijasetit në të cilën katër kordinatorë u emëruan në pozitat e Muftinjve. Tre prej tyre ishin edhe pjesëmarrës në mbledhjen e mbajtur në Gostivar ku votuan shkarkimin e Reisit dhe “caktimin” e u. d. reisit. Kuptohet, Neni 35 që flet për përbërjen e Rijasetit, nuk i përfshinte edhe kordinatorët e Muftinive! Fakti që Rijaseti në prag të zgjedhjeve pa procedura të parapara me Kushtetutë emëron Muftinjë, lë të nënkuptohet se, u. d. Reisul Ulema tanimë kishte nevojë për vota të Muftinjve dhe jo të kordinatorëve!

Çfarë thotë Kushtetuta lidhur me emërimin e Muftinjve? Neni 30, thotë: **“Me Muftininë udhëheq Muftiu. Kryeimami emërohet nga Reis ul Ulemaja me propozim të Muftinisë. Muftiu dhe Kryeimami, duhet të jenë me arsimim sipëror islam dhe me përvojë pune së paku pesë vjet në radhët e BFI-së. Në Muftinitë ku nuk ka kuadër sipas kushteve të parapara, emërohet kordinator.”**

*shoqatave të cilat janë në mbikqyrje të Rijasetit;- ka të drejtë të pengojë ekzekutimin e vendimeve të organeve dhe të institucioneve të BFI nëse konstaton se të njëjtat janë kundërshtim me ligjin dhe parimet islame dhe të njëjtat t’i kthejë në rishqyrtim, kurse vendimin përfundimtar e sjell Rijaseti i BFI-së. - dekretin vendimet e marrura nga Rijaseti i BFI-së.”*

11 **“Reis ul Ulema, sipas nevojës ka të drejtë të thërrasë mbledhje me të gjitha organet, institucionet, organizatat dhe shoqatat e BFI-së.”**

12 Ndërhyrje të ngjashme në vendimet e BFI-së nga i njëjti subjekt politik pati disa herë edhe gjatë vitit 2005. Anëtarë të Kuvendit të BFI janë dëshmitarë se si u mbledhën dhe si u dërguan në Strugë për të zgjedhur zv.Reisu ul Ulema!

Kurse Neni 31, thotë: **“Muftinia kandidon kandidatë të mundshëm për Mufti, Rijaseti i BFI-së bën emërtimin e Muftive, kurse Reis ul Ulema verifikon emërtimin dhe u lëshon Murasele. Mosdhënia dhe tërheqja e Muraseles obligon Muftininë në afat prej tridhjetë ditë të propozon kandidatë të mundshëm për Mufti. Muftiu përgjigjet vetem para Reis ul Ulemasë. Muftiu është personaliteti më i lartë në territorin e Muftinisë dhe e përfaqëson ate në territorin e vet.”**

Është e qartë se Muftinia udhëhiqet nga Muftiu, ose nga kordinatori nëse Muftinia nuk i plotëson kushtet e parapara për t’u drejtuar nga Muftiu. Por çuditërisht, në kundërshtim të plotë me nenet 30 dhe 31, në krye të Muftinisë së Gostivarit u emërua u. d. Mufti! Me këtë rast kemi disa shkelje të rënda! Kushtetuta e BFI-së nuk njeh pozitën u.d. Mufti, ai nuk mund të udhëheq me Muftini. Nëse Rijaseti i BFI-së do të konstatonte se Muftinia e Gostivarit nuk i plotëson kushtet e parapara për Mufti, duhej që të emëronin kordinator dhe jo u.d. Mufti. Marrë parasyshë se nga Rijaseti nuk u tha se ajo Muftini nuk i plotëson kushtet, është dashur që Muftinia e Gostivarit të propozojë kandidatët e mundshëm për Mufti, kurse Rijaseti të bënte emërimin e njërit prej kandidatëve për Mufti! Rijaseti i BFI-së nuk ishte njohtuar me një vendim të këtillë dhe as nuk u bë e qartë se çfar u ishte propozuar nga Muftinia e Gostivarit. Bazuar në takimet tona me faktorë brenda BFI-së, një shkelje e këtillë e Kushtetutës po bëhet me qëllim të përgatitjes së terrenit që pozitën e Muftiut ta fitojë u. d. Muftiu, në fakt emërimi antikushtetutar u bë sa për të mos shpërthyer ndonjë pakënaqësi më e madhe në Gostivar. Këtij gjesti të “reisit” të kontestuar i thonë angazhim për “titull të konservuar”!

Neni 31 na e bën të qartë se për postin e Muftiut vendosin tre organe të BFI-së: Muftinia, Rijaseti dhe Reisul Ulema. Muftinia propozon, Rijaseti emëron, Reisul Ulema verifikon. Në emërimin e tre Muftive është konstatuar se nuk ka pasur propozime nga Muftinitë (Manastir, Dibër dhe Shtip), pra këtu së pari dalin shkelës Muftinitë, më pastaj Rijaseti i cili Muftinive ua imponon të parin e tyre! Ngase po ky Nen thotë: **“Muftiu është personaliteti më i lartë në territorin e Muftinisë dhe e përfaqëson ate në territorin e vet.”** Shkelje e dyfishtë bëhet në rastin e Muftinisë së Kërçovës e cila për dallim nga të tjerat, ka pasur propozimet e veta për postin e Muftiut, por Rijaseti nuk ua ka përfillur dhe ka emëruar në postin e Muftiut një propozim që vie nga subjekt jasht BFI-së, madje edhe në kundërshtim me nenit 30 i cili mes tjerash flet për kriteret: **“Muftiu dhe Kryeimami, duhet të jenë me arsimim sipëror islam dhe me përvojë pune së paku pesë vjet në radhët e BFI-së.”** Pra Kushtetuta kërkon që, jo vetëm Muftiu, por edhe kryeimami të ket së paku pesë vjet përvojë pune në radhët e BFI-së, kurse i caktuari në krye të Muftinisë së Kërçovës, nuk e plotësonte këtë kriter. Me vendimet e këtilla, Rijaseti ilegjitim përveç shkeljes së neneve 30 dhe 31, si një organ me përgjegjësi për organizimin e jetës fetare që duhet të kujdeset edhe për veprimtarinë e organeve të tjera të BFI-së, me këtë rast ka bërë shkelje edhe të disa neneve të tjera, në veçanti janë shkelur Neni 36<sup>13</sup> alinea 1 dhe 4 dhe Neni 37<sup>14</sup> alinea 7 dhe 9.

13 **“Fushëveprimi i Rijasetit të BFI-së në vend dhe jashtë:**

- Organizimi i jetës fetare,
- Zhvillimi i njohurive edukativo-arsimore, kulturoro-shkencore dhe informative.
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve islame.
- Strukturën organizative dhe veprimtarinë e organeve të BFI-së.
- Bashkëpunimi me organizatat dhe institucionet islame në botë.
- Puna juridiko-administrative dhe financiaro-ekonomike.”

14 **“Rijaseti i Bashkësisë Fetare Islame:**

- propozon, zgjedh dhe shkarkon Reis ul Ulemanë,
- cakton numrin e Muftinive dhe bën emërimin e muftive.
- emëron Sekretarin e Përgjithshëm me propozim të Reis ul Ulemasë.
- zgjedh anëtarë të komisionit disiplinor dhe prokurorin publik të BFI-së.

Në anën tjetër, edhe u. d. Reisul Ulema, duke u vënë në rolin e Reisul Ulemasë, që sipas Kushtetutës verifikon emërimet dhe jep murasele, si dhe me të drejtë për të penguar ekzekutimin e vendimeve nëse të njëjtat janë në kundërshtim me ligjin..., ai pajtohet me të gjitha shkeljet – me gjasë që të gjitha shkeljet kanë qenë të diktuar, ai i dekreton që të gjitha! Këtu pra mes tjerash shkelet Neni 44 alinea 2, 12, dhe 13.

Gjithashtu shkelet edhe Neni 65 i cili thotë: ***“Funksonarët e emëruar japin betimin solemn para Reis ul Ulemasë, kurse Reisul Ulema betimin solemn e jep publikisht.”***

Ndodhi që të emëruarit dhanë betimin para u.d. Reisul Ulemasë! U betuan para një organi të paqenë dhe që vet nuk kishte dhënë ndonjë betim solemn!

## **VI - Shkeljet e Kushtetutës me rastin e emërimit të drejtuesve të sektorëve dhe shoqatave**

Nga kur BFI filloi të drejtohet nga një organ i pa qenë - u.d. Reisul Ulema, në BFI janë dhuruar poste sipas tekeve dhe diktateve, ndonëse organet, institucionet dhe shoqatat kanë rregulloret ose statutet e tyre.

Rasti konkret është me Shoqatën Humanitare “HILAL”, e cila që nga viti 2017 ka funksionuar jasht mandatit. Sikur “HILAL” të respektonte statutin e vet, do të duhej të zhvillonte zgjedhjet e veta dhe të zgjedhte kryesinë e vet. Megjithkëtë, “Kryetari”, edhe pse pa mandat, ishte pjesëmarrës në mbledhjen e shkarkimit të Reisul Ulemasë, dhe caktimit të u.d. Reisul Ulemasë! Në vend se të merren masat e duhura kundër tij, u.d. Reisul Ulema atë e shpërblen me një pozitë të re. E emëron si drejtor sektori për marrëdhënje me jashtë, “drejtori” kjo e cila nuk figuron në sistematizim të BFI-së. Neni 56 mes tjerash thotë: ***“... Të zgjedhurit, të emëruarit dhe të punësuarit në BFI janë të barabartë me të gjitha të drejtat dhe obligimet. ...Të zgjedhurit, të emëruarit dhe të punësuarit e BFI-së në sistemin e unifikuar financiar trajtohen të barabartë me të gjitha të drejtat dhe obligimet sipas rregullorës së sistematizimit.”*** Praktikisht u dëshmuar se nuk ka barabarësi, dikush sanksionohet për

---

*- formon komisione dhe këshilla të përhershme dhe të përkohshme.*

*- verifikon mandatet dhe shpall zgjedhjet e rregullta dhe të parakohshme.*

*- kujdeset për jetën e përgjithshme fetare dhe veprimtarinë e BFI-së të mbështetur mbi parimet e Sheriatit dhe në përputhshmëri me sistemin juridik të BFI-së.*

*- organizon dhe autorizon kuadrin fetar në diasporë.*

*- mbikëqyr punën e organeve, enteve dhe institucioneve.*

*- miraton plan-programet e institucioneve edukativo-arsimore si dhe programet dhe tekstat e mësim-besimit.*

*- angazhohet për mbrojtjen e të drejtave fetare të muslimanëve.*

*- themelon ente dhe institucione.*

*- sjell vendim për themelimin e vakëfit.*

*- sjell vendim për ndërrimin e pasurisë së vakëfit, në bazë të propozimit të organit gjegjës, nëse është në pajtueshmëri me rregullat e Sheriatit.*

*- vendos për ankesat e organeve më të ulta të BFI-së.*

*- i propozon Kuvendit planin vjetor financiar dhe llogarinë përfundimtare për miratim.*

*- organizon grumbullimin e mjeteve nga zeqati, sadekatul-fitrit dhe të hyrave të tjera.*

*- është organizator kryesor dhe i vetëm në realizimin e kryerjes së Haxhit dhe Umrës.*

*- emëron, ndërron dhe shkarkon anëtarët e Rijasetit.*

*- lejon rregullat e tarikateve, mbikqyrë punën e tyre dhe verifikon zgjedhjen dhe emrimin e shehlerëve.*

*- lejon botimin e literaturës Islame.*

*- në kushte të jashtëzakonshme kryen edhe detyra të organeve të tjera.*

*Rijaseti i BFI-së mban mbledhje së paku njëherë në muaj.*

*Mbledhjen e Rijasetit të BFI-së e konvokon dhe e udhëheq Reis ul Ulemaja, në raste të veçanta atë e konvokon me kërkesë të 1/3 të anëtarëve të Rijasetit.”*

ndonjë shkelje ose pa u konstatuar shkelje, kurse dikush shpërblehet edhe kur bën shkelje nga më të rëndat, madje shpërblehet me vend pune të krijuar në kundërshtim me sistematizimin!

Në anën tjetër, edhe pse Neni 54 i Kushtetutës thotë se: **“Puna dhe veprimtaria e organeve, institucioneve dhe shoqatave të BFI-së përcaktohet me statut ose rregullore të punës së tyre.”** Rijaseti, ose u.d.Reisul Ulema i jep të drejtë vetes të emërojë kryetar të Shoqatës HILAL,<sup>15</sup> kurse kryetari, respektivisht kryesia e Shoqatës, sipas Statutit të Shoqatës, zgjedhet nga Kuvendi i saj!

Shkeljet e tjera lidhen me personin e zgjedhur në krye të Shoqatës dhe nevojën që i njëjti të shpërblehet me këtë pozitë dhe ta bëjë anëtarë Rijaseti. Bëhet fjalë për një person i cili më 6.12.2017 u zgjodh kryetar i Kuvendit të BFI-së, kurse mbledhjen e fundit me Kuvendin e mbajti më 28.06.2018. Kjo flet për shkelje të rëndë. Falë moskujdesit të tij, kurrë më nuk u mbledh Kuvendi i BFI-së! Nga takimet tona me faktorë brenda BFI-së, mësojmë se nga fundi i viti 2019, kishte ofruar dorëheqjen e tij nga pozita e të parit të Kuvendit të BFI-së, meqë pritej të emërohet në pozitën e zv.drejtorit të Komisionit për pozita juridike të kishës, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze-Organ i pavarur i administratës shtetërore. Bëhet fjalë për person i cili pa qenë anëtarë Rijaseti, u bë pjesë e mbledhjes së Rijasetit dhe u firmos në dokumentin e shkarkimit! Është e qartë se Rijaseti vendosi ta shpërblejë për rolin e tij në suspendimin e Kuvendit të BFI-së dhe për pjesëmarrjen e tij në mbledhjen e Rijasetit, pa qenë kurrë anëtarë Rijaseti!

## VII - Shkeljet e Kushtetutës si pasojë e suspendimit të Kuvendit të BFI-së

Kushtetuta e BFI-së thotë se BFI ka organet dhe institucionet e veta.<sup>16</sup> Neni 24 thotë: **“Organet e BFI-së janë: - Muftinia, - Rijaseti i BFI-së,- Reis ul Ulema dhe - Kuvendi i BFI-së.”**

Kurse praktikisht vërtetohet se 2020 ka qenë një vit shkatërrues i organeve të BFI-së. BFI ngeli pa Reisul Ulema, me Rijaset antikushtetues,<sup>17</sup> me Muftini të dezorganizuar<sup>18</sup> dhe me Kuvend të suspenduar.

Se BFI-së nuk i ka ngelur as hija e një institucioni që parasheh Kushtetuta, mjafton këtu të sjellim disa nga nenet që flasin lidhur me Kuvendin e BFI-së:

Neni 45: **“Kuvendi i Bashkësisë Fetare Islame është organ më i lartë juridiko-finansiar.”**

Neni 49: **“Kuvendi i BFI-së:**

**Në mbledhje të përbashkët me Rijasetin e BFI-së miraton Kushtetutën e BFI-së, ndryshimet dhe plotësimin e saj.**

**- miraton plan-programin vjetor dhe raportin e punës së Rijasetit të BFI-së.**

15 I propozuar nga subjekt politik, pjesë e pushtetit.

16 Neni 23

17 Antikushtetues për nga përbërja. Rijaset pasiv që krahas të tjerave shkel Nenin 37, pikën ku thuhet: **“Rijaseti i BFI-së mban mbledhje së paku njëherë në muaj.”** Viti 2020 iku me vetëm tre-katër mbledhje të Rijasetit, kurse me shumë aktivitete antikushtetutare dhe qeshare. U dëshmuar se çfar hapësirë u jepet pritjeve dhe urimeve në llogari të obligimeve të domosdoshme.

18 Mes tjerash shumica e Muftinive shkelin mbi nenin 29 alinea 5: **“Mexhlisi i xhematit është kuorum i gjërë konsultativ i Muftinisë.”** Vetëm dy-tre Muftini që mblidhen ndonjëherë, shumica e Muftinive Mexhllisin e xhemateve e mbledhin vetëm gjatë zgjedhjeve të organeve kolektive, dmth, në çdo katër vite! Të gjitha Muftinitë e BFI-së shkelin Nenin 32 alinea 1: **“Muftinia mban mbledhje të rregullta më së paku një herë në muaj.”** Vetëm disa nga Muftinitë mbajnë mbledhje nga tre-pesë here brenda vitit, disa të tjera nga një mbledhje, disa Muftini nuk kanë mbajtur asnjë mbledhje gjatë vitit 2020!

- miraton planin financiar dhe llogarinë përfundimtare të Rijasetit të BFI-së,
- verifikon miratimin e planeve financiare dhe të llogarive përfundimtare të Muftinive të BFI-së.
- miraton rregulloren për punë të Kuvendit të BFI-së si dhe akte të tjera normative të BFI-së.”

Neni 50: **“Kuvendi i BFI-së punon në seanca. Seancat e Kuvendit të BFI-së mbahet më së paku një herë në vit. Në mbledhjen e parë konstituive Kuvendi zgjedh kryetarin dhe nënkryetarin e vet. Me seancat e Kuvendit të BFI-së udhëheq Kryetari i Kuvendit të BFI-së.**

**Kryetari i Kuvendit është i detyruar të konvokojë seancë të Kuvendit të BFI-së me kërkesë të Reis ul Ulemasë, Rijasetit të BFI-së dhe me kërkesës të 1/3 së anëtarëve të Kuvendit të BFI-së.”**

Pra Kuvendi si një organ juridiko-finansiar para të cilit Rijaseti miraton plan-programin vjetor dhe raportin e punës së Rijasetit, miraton planin financiar dhe llogarinë përfundimtare të Rijasetit etj., suspendohet, dmth, puna e institucionit BFI me të gjitha organet, institucionet dhe shoqatat zhvillohet jasht binareve juridiko-finansiare. Kjo flet për shkelje të shumëfishta të të gjitha neneve të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë e BFI-së në tërësi! Megjithëkëtë, do të mundohemi t’i sjellim disa nga nenet e shkelura – nga organet e tjera të BFI-së, si pasojë e suspendimit të Kuvendit të BFI-së.

### **-Muftinia**

Neni 32 i cili flet mbi Muftininë, mes tjerash thotë: **“- zbaton vendimet e Rijasetit dhe të organeve më të larta të BFI-së,- propozon Rijasetit buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të Muftinisë,- paraqet raport dhe program vjetor për punën e vet para Rijasetit të BFI-së.”**

Muftinia si organ themelor i Bashkësisë Fetare Islame,<sup>19</sup> duhet të zbatojë vendimet e Rijasetit dhe organeve më të larta, respektivisht Kuvendit të BFI-së, ngase Muftinia i propozon buxhetin dhe llogarinë përfundimtare Rijasetit, kurse Kuvendi është ai organ i cili Verifikon miratimin e tij.<sup>20</sup> Sëkëndejmi, të gjitha Muftinitë e BFI-së aktivitetet e tyre i zhvillojnë në kundërshtim me Kushtetutën e BFI-së dhe Ligjit.

### **-Rijaseti**

Pika e fundit e Neni 36 që flet mbi fushëveprimin e Rijasetit thotë:

**“- Puna juridiko-administrative dhe financiaro-ekonomike.”** Kurse Neni 37 alinea 7, 9 dhe 16 thotë:

**- kujdeset për jetën e përgjithshme fetare dhe veprimtarinë e BFI-së të mbështetur mbi parimet e Sheriatit dhe në përputhshmëri me sistemin juridik të BFI-së.**

**- mbikëqyr punën e organeve, enteve dhe institucioneve.**

**- i propozon Kuvendit planin vjetor financiar dhe llogarinë përfundimtare për miratim.**

Gjatë vitit 2020 Rijaseti ka dëshmuar se nuk kujdeset për veprimtarinë e BFI-së mbi parimet e Sheriatit dhe sistemit juridik të BFI-së, nuk ka mbikëqyrë punën e organeve e as ka plan të miratuar financiar.

Neni 38 mes tjerash thotë: **“Rijaseti ka shërbimet e veta profesionale.”**, situata e krijuar na bind se shërbimet e Rijasetit jo që nuk janë profesionale, por janë edhe shkatërrimtare.

### **-Reis ul Ulema**

Gjatë vitit 2020 BFI pati Reisul Ulema, më pastaj për disa muaj u.d. Reisul Ulema që merrej me punët e Reisul Ulemasë, dhe në fund, një Reisul Ulema të kontestuar antikushtetutar për të cilin do të flasim në

19 Shif Nenin 28

20 Neni 49 alinea 4: **“- verifikon miratimin e planeve financiare dhe të llogarive përfundimtare të Muftinive të BFI-së.”**

nëntitullin tjetër.

Bazuar në Nenin 40, **“Reis ul Ulema, sipas nevojës ka të drejtë të thërrasë mbledhje me të gjitha organet, institucionet, organizatat dhe shoqatat e BFI-së.”**, pra, në asnjë mënyrë nuk është dashur të lejohet që 2020-ta të kalon pa u mbajtur asnjë mbledhje e Kuvendit, respektivisht, pa miratuar buxhetin e Rijasetit, pa verifikuar miratimin e buxheteve të Muftinive etj.

## VIII - Shkeljet e Kushtetutës me rastin e zgjedhjes së Reisul Ulemasë

Shkeljet e Kushtetutës së BFI-së edhe në rastin e zgjedhjes së Reisu ul Ulemasë, për asnjë çast nuk ishin të befasishme. Bazuar në deklaratat e u.d. Reisul Ulemasë në prag të zgjedhjeve, krijoheshin përshtypjet se deri në zgjedhje do t'i duhet më tepër kohë. Mirëpor, i mjaftoi një takim me zv.kryeministrin e RMV-së që më pastaj gjithçka të zhvillohet në mënyrë të përsheptuar. Rijaseti, me përbërje antikushtetutare, më 11.11.2020 mban mbledhje dhe aty arrihet marrëveshje në shkeljet kushtetutare lidhur me përpilimin e një listë të re të përbërjes së Rijasetit, respektivisht trupit votues. Nga mbledhja dolën edhe me formim të Komisionit Zgjedhor dhe u tha se po bëhet edhe Rregullorja për Zgjedhjen e Reis ul Ulemasë. Kurse më 18.11.2020, u mbajtën zgjedhjet!

Me këtë rast kemi shkelje darstike të Kushtetutës së BFI-së, nene të cilat u shkelën edhe gjatë “shkarkimit” të Reisul Ulemasë dhe “caktimit” të u.d.Reisul Ulemasë si dhe nene të tjera. Po fillojmë nga shkeljet e bëra me rastin e përpilimit të përbërjes së Rijasetit, në fakt, trupit zgjedhor! Që në fillim, kjo qasje është e gabuar. Përbërjen e Rijasetit të BFI-së e kemi në Nenin 35:

**“Rijaseti i BFI-së është organ i cili vendos për çështje islamike.**

**Rijaseti i BFI-së përbëhet prej Reis ul Ulemasë, Sekretarit të Përgjithshëm të BFI-së, Muftinjve, drejtorëve dhe dekanëve të institucioneve arsimore, kryetarëve të shoqatave të Bashkësisë Fetare Islame dhe dy anëtarëve të caktuar nga ana e Reis ul Ulemasë me përvojë në organizimin e jetës fetare në radhët e BFI-së.”**

Këtu nuk ka vend për pazarllëqe. Anëtarë të Rijasetit janë të gjithë ata që përfshihen në këtë Nen. Mandatet e anëtarëve të Rijasetit lidhen me funksionet që ushtrojnë ata, me përjashtim të Sekretarit të Përgjithshëm dhe dy anëtarëve të caktuar nga ana e Reisul Ulemasë, anëtarësia e të cilëve lidhet me Reisul Ulemanë. Që të jemi sa më të qartë, këtu po e sjellim Nenin 40 të Kushtetutës së BI të vitit 1994 i cili flet mbi përbërjen e Mexhllisit Shura (tani ky organ quhet Rijaset):

**“Mexhllisi Shura e përbëjnë: Muftitë, drejtorët e institucioneve edukativo-arsimore, dekanët e fakulteteve të shkencave islame, kryetari i Shoqatës së Ulemave në Republikën e Maqedonisë, drejtorët e sektoreve kryesorë në suaza të Mexhllisit Shura, pesë persona të profileve të ndryshme të jetës publike të cilët emërohen nga kryetari i Bashkësisë Islame.**

**Mandati i anëtarëve të këtij Mexhllisi është i lidhur me funksionin që e ushtrojnë, ndërsa mandate i pesë anëtarëve nga jeta publike, që emërohen me propozim të kryetarit zgjatë po aq sa zgjatë mandati i kryetarit të Bashkësisë Islame.”**

Nëse tani e krahasojmë këtë Nen dhe Nenin 35 të Kushtetutës aktuale, qartë shifet se Rijaseti ka bërë shkelje të mëdha në përpilimin e asaj liste. Nuk ka organ i cili mund të vihet mbi Kushtetutën. Në Kushtetutën e vitit 1994, drejtorët e sektoreve janë pjesë e organit, kurse me Kushtetutën aktuale nuk janë. Në fakt nuk ka drejtorë, drejtori, por vetëm shërbime profesionale. Neni 38 thotë: **“Rijaseti ka shërbimet e veta profesionale.”** Rijaseti i BFI-së, ashtu siç e thotë Neni 35, përbëhet nga autoritete të zgjedhura, pra, të zgjedhurit zgjedhin kryeparin e tyre, dhe jo ashtu sikurse “Rijaseti” antikushtetutar që e përpiloi listën duke shkelur mbi parimin e këtij Neni, pra ata bënë që aty të përfshihen edhe shumë të punësuar!

Komisioni Zgjedhor i formuar nga Rijaseti që vepron në formë antikushtetutare, brenda pak ditëve disa herë u prononcua për opinion në kundërshtim me Kushtetutën! Si shembull është deklarata e njërit prej anëtarëve të komisionit: *“Datën e zgjedhjeve besoj që Komisioni duhet sot ta caktojë. Rregullorja është miratuar dhe parasheh procedurën se si do të duhet të mbahen zgjedhjet, si do të paraqiten kandidatët, kush i plotëson kushtet e kështu me radhë. Besoj që së shpejti do të bëhen publike. Votimi do të bëhet në mënyrë demokratike, Kushtetuta e BFI-së i njeh të dy variantet, edhe me vota të fshehta edhe me të hapura. Zgjedhja e Reis ul Ulemasë behet konform Rregullores për zgjedhje të Reis ul Ulemasë. Kjo rregullore hartohet nga Komisioni Zgjedhor dhe ndryshon në çdo cikël zgjedhor.”*<sup>21</sup>

Kjo deklaratë antikushtetutare, na bind se komisioni në fjalë ishte vetëm një formalitet. Nuk është e vërtetë se Rregullorja për zgjedhjen e Reis ul Ulemasë hartohet nga Komisioni Zgjedhor. Komisioni Zgjedhor nuk është trup ose organ që sjell akte normative në BFI. Nuk është e vërtetë se Rregullorja ndryshon në çdo cikël zgjedhor. Neni 70 thotë: **“Me miratimin e kushtetutës në afat mbrenda një viti të gjitha aktet normative të harmonizohen me këtë Kushtetutë.”** Nëse ka pasur Rregullore të harmonizuara me Kushtetutën dhe të miratuar në Kuvend, përse nevoja për një Rregullore të re! Nëse BFI-së i ka munguar Rregullorja për Zgjedhjen e Reisul Ulemasë, është dashur të aktivizojë ndonjë komision të saj të përhershëm <sup>22</sup> ose në bazë të Nenit 37 alinea 5 të formon Komision për hartimin e Rregullores. Rijaseti më pastaj duhej ta propozonte për miratim në Kuvendin e BFI-së. Pika e fundit e Nenit 49 që flet mbi Kuvendin thotë: **“miraton rregulloren për punë të Kuvendit të BFI-së si dhe akte të tjera normative të BFI-së.”** Asnjë akt normative nuk mund të hyjë në fuqi pa miratim nga Kuvendi i BFI-së. Pra, zgjedhjet u zhvilluan në kundërshtim edhe me Nenin 42 i cili thotë: **“Zgjedhja e Reis ul Ulemasë bëhet konform Rregullorës mbi zgjedhje të Reis ul Ulemasë.”**

## P.S.

Sipas kësaj analize shihet qartë se, që nga ndërhyrjet politike për shkarkim të ish-reisul ulemasë e deri te imponimi i “reisit” të ri, por edhe “emërimi i Muftinjëve të rinj” si dhe caktimi i do “drejtorëve dhe kryetarëve” u shkelen këto nene: 1, 3, 6, 7, 8, 9, 11, 13, 23, 24, 29, 30, 31, 32, 33, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 42, 44, 45, 49, 50, 54, 56, 58, 62, 64, 65, 70.

Të theksojmë se Neni 69 i Kushtetutës së BFI-së thotë: **“Shpjegime dhe interpretime autentike të dispozitave të kësaj Kushtetute jep Rijaseti i BFI-së.”**

Këshilli për mbrojtjen e kushtetutshmërisë së BFI-së ka konstatuar se, “Rijaseti” aktual, me përbërjen e vet antikushtetuese, nuk është kompetente dhe as profesionale që të japë interpretimin autentik të Kushtetutës, ndaj dhe ka përgatitur këtë analizë të thellë që ka të bëjë me të gjitha shkeljet kushtetutare të “reisit” aktual i cili, pa dyshim, është i imponuar nga subjekti jashtë BFI-së, subjekt ky që aktivitetin e vet e bazon në zhvillime politike. Pa dyshim, të gjithë ata që lejuan që politika qeveritare të përzihen në BFI, të vendosin dhe të diktojnë politika, si dhe të gjithë ata që lejuan dhe që kryen shkelje kushtetutare, një ditë do të përgjigjen para drejtësisë. Ne, si Këshilli i formuar nga iniciativa e një numri të konsiderueshëm teologësh të vendit, na ngelë që të ngrisin padi si dhe t’i bashkangjitemi iniciativave të grupeve të qytetarëve që do të ngrisin procedurë gjyqësore kundër shkelësve të Kushtetutës së BFI-së.

21 Deklaratë e publikuar në shume media të vendit më 12.11.2021

22 Neni 38 thotë: **“Rijaseti ka shërbimet e veta profesionale. Rijaseti formon komisione të përhershme dhe të përkohshme.”**



Meqë këta shkelës nuk pranojnë të debatojnë publikisht dhe të zbardhen të gjitha anomalitë që ndodhën në BFI, meqë kjo “pari fetare” frikësohet nga debatet, obligim ky kushtetutar, atëherë, ngel që sqarimet të bëhen para organeve të drejtësisë.

BFI-ja duhet të kthehet në binaret e veta. Devijuesit duhet të largohen dhe të ndëshkohen. Fundja ky është edhe detyrim dhe obligim islam.

**Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI në RMV**

**Shaban Aziri, kordinator**

**Eset Shaqiri, zv/kordinator**

**Mirdi Brao, zv/kordinator**

*(in 7.tv, 14.01.2021)*

## A ka shërbime intelgjete ministri Spasovski?!

**Rreth vizitës së ministrit të punëve të brendshme, Oliver Spasovski dhe, zëvendësit të vet, Nazim Bushi, që ia paskan bërë “reisit” të falsifikuar, kontravers dhe të kontestuar, Shaqir Fetait, sa për t’ia uruar zgjedhjen e kontrabanduar në krye të BFI-së**

Kishte ngelur eksik pa ia shprehur urimet, përgëzimet dhe kënaqesinë e vet edhe Oliver Spasovski për emërimin politik të Shaqir Fetait nga strukturat e caktuara të pushtetit aktual në krye të BFI-së. Fillimisht ministri Oliver Spasovski është dashur të dijë se ku po shkon dhe çka po bën me këtë vizitë. Është dashur të dijë se kush do të jetë prezent në atë takim! Të njohtohet hollësisht nga shërbimet e veta profesionale dhe inteligjente. Ndryshe i bie që Ministri Spasovski ka shkuar për t’i përgëzuar grupet kriminale që e pushtuan së brendshmi BFI-në si dhe për t’ia dhënë përkrahjen Shaqir Fetait për të gjitha ato shkelje kushtetutare si dhe për ta legjitimuar veprimin e tij prej anarkisti dhe prej militanti të verbuar partiak.

A e di ministri Spasovski se sot është ofenduar shumë rënd me prezencën e tre personave të cilët e njojosin keq personalitetin e tij! Shaqir Fetai është përkujdesur ta tallë Spasovskin duke e detyruar të rrijë në një zyre me Qenan Ismailin, “myftiun mashtrues” i cili erdhi në këtë detyrë me dredhira dhe mashtrime. Apo kjo i paraqiti kënaqësi pasi ka bashkëbiseduar me atë të cilin ish-reisi Sulejman ef. Rexhepi e quante në Zërin e Amerikës si strukturë e shërbimeve intelgjete maqedonase.

A e di Oliver Spasovski se sot ka pasur kënaqësinë të rrijë me Ismet Ademin, pjesëtar sekret i ekstremistëve, bashkëpunëtorin e shërbimeve sekrete të Arabisë Saudite. Ai ka qenë edhe nëpër burgje arabe. A e di ministri pse, apo jo!

Fare në fund, ministri Spasovski është nënçmuar nga Shaqir Fetai i cili në zyre ia ka lejuar edhe Mustafa Dautin, njeriun i cili ka kryer qindra vepra penale për këto pesë vite në BFI, ka kryer qindra vjedhje e falsifikime nenshkrimesh si dhe kapacitetesh intelektuale dhe, ka arritur një kapital të cilin ministri Spasovski vetëm mundet ta ëndërrojë.

Ministri Spasovski paska shprehur konsiderata për BFI-në e cila pa kompromis e paska luftuar terrorizmin dhe radikalizmin si dhe paska dhënë kontribut të madh në luftimin e koronavirusit.

Këto vepra ekskluzivisht i përkasin ish-reisit Sulejman ef. Rexhepit. Nuk kanë lidhje me asnjë angazhim të Shaqir Fetait. Biles me dëbimin e Sulejman ef. Rexhepit do të sëmuret rëndë nga koronavirusi vetë Shaqir Fetai. Pse nuk u vizitua atëherë Sulejman Rexhepi dhe të falënderohej se ai në krye të BFI-së po bën punë të mëdha për të mirën e shoqërisë sonë. Sepse Sulejman ef. Rexhepi ashiqare bërtiste se Maqedonia e Veriut po rrezikohet duke u shndërruar në shtet policor, kurse Shaqir Fetai përzgjidhet, përkrahet, përgëzohet nga shteti policor, i cili, në raport me popullatën shqiptare gjithnjë ka qenë armiqësor.

Dje Shaqir Fetai te Stevo Pendarovski, sot Oliver Spasovski te Shaqir Fetai!!! Shto këtu edhe ambasadorin balosh e kontravers që na qenka i akredituar në shumë shtete arabe e që e shoqëron Shaqir Fetain! Mos është në pyetje ai një milion dollarëshi nga Kuvajti për ç’ gjë kohë më parë u shkrua në disa media e që nëpër shkrime u përfshinë të gjithë këta emra?

Është thënë se, Shaqir Fetai nuk është fat ogurbardhë për këtë shtet e për shoqërinë myslimane, porse është vetëm problem, është tenxhere me kapak të mbyllur por mbi flakë.

*(Lajme7, 14.01.2021)*

## Shaqir Fetai e paska sugjeruar ambasadoren amerikane në Shkup?

Shaqir Fetai, i vetëquajtur “reis” si produkt i vendimeve politike të pushtetit aktual, duke vegjetuar në një objekt me një klimë të rëndë socio-psikologjike, e shkaktuar nga stuhia e një depresioni të ankthshëm, shpesh nuk është i vetëdijshëm se çfarë flet. Shpëtim e kërkon në parimin e determinizmit (e jo në parimet islame ku bazohet dhe Kushtetuta e BFI-së), pa hetuar se po shpalo komplekset që e kanë mbërthyer nga një e kaluar jo fort e largë (1983, kliko linkun <https://almakos.com/dokument-bashkepunetor-i-cilit-sherbim-eshte-kreu-i-bfi-se/>)

### Nga Haxhi Isa Xhaviti

Duke vuajtur nga anglutinimi, sëmundje psikike që manifestohet me kërkimin në realitet të imazheve inegzistente, të imagjinuara, ai mendon se është më i madh i botës, me të drejtën absolute për t’iu drejtuar të gjithëve, me lirinë absolute për t’i spiunuar e për t’i nënshtruar të gjithë ata prej të cilëve i sëmuri sheh rrezik potencial, Shaqir Fetai i jep të drejtë vetes që të thotë se e ka sugjeruar ambasadoren e Amerikës në Shkup, Ekselencën e saj, zonjën Kate Maria Byrnes! Madje edhe ajo i paska sugjeruar Shaqir Fetait!!!

Tropizmat e mbjella (që nga vitet 1980 e kënde) tek ky “reis” i kontestueshëm, shkaktojnë reagim të pavullnetshëm duke artikuluar mendime sa të kushtëzuara aq edhe idiotike. Ky është një problem shumë i madh, një pacient tipik për psikiatër!

Me çfarë guximi të budallakaftë Shaqir Fetai publikisht deklaroi se e ka sugjeruar zonjën ambasadore të Amerikës!

Sugjerim do të thotë ide apo mendim që ia japim dikujt se si të veprojë ai! Do me thënë që, Shaqir Fetai i paska dhënë mend zonjës ambasadore se si të veprojë! Është normal ky njeri apo jo? Në shkencën e psikologjisë “sugjerimi” shpjegohet si përpjekje për ndikim të pavetëdijshëm i një personi në tjetrin, duke shkaktuar ndryshime të caktuara në psikologjinë dhe sjelljen e tij.

Pas takimit me ambasadoren amerikane në Shkup, zonjën Kate Maria Byrnes, Shaqir Fetai, në televizionin e vet lokal, do të deklarojë: “Ajo me gëzimin e madh pranoi të gjitha sugjerimet tona... Mendoj se mbet e lumtur dhe e kënaqur me konceptin e BFI për një ecuri bashkëkohore për një prezantim të islamit në baza të shëndosha... Mbeti e kënaqur se ne kohëve të fundit kemi filluar të bisedojmë edhe me bashkësitë e tjera fetare...”

Motivi për pushtet, si sëmundje për të pasur ndikim mbi gjithkë, e zbrërthen Shaqir Fetain në një person të çregullt dhe të rrezikshëm. Ai nuk mbanë llogari as për fjalën dhe as për veprimin! Ai thotë se “edhe ajo na sugjeroi neve”! Me këtë fjalë automatikisht besimtarët do të mendonin se ambasadorja ia ka tërhequr vërejtjen që të ketë kujdes se me kë rri e me kë takohet, me kë përqafohet e me kë përurohet. Mund ta ketë “sugjeruar” që tipat si Ahmet Kalaja e do balosha të tjerë mos t’i sjellë nëpër BFI, nëse dëshiron që të ruhen raportet në mes të BFI-së dhe Ambasadës Amerikane! Por, nëse është thënë tërthorazi, Shaqir Fetai nuk është person që i kupton alegoritë, atij duhet thënë drejt e troç, sepse, ndryshe nuk brengoset fare, më sa po brengoset nga dokumenti që dëshmon për profesionin e tij prej spiuni nën komandimin e eprorit të UDB-së, S. Dragoviq.

Ndaj Shaqir Fetai është pa orientim personaliteti. Ndaj ai sillet siç do ta “sugjerojnë” shërbimet

e ndryshme. Koret diplomatike nuk këshillojnë, nuk sugjerojnë, ata ose kërkojnë prerazi, ose propozojnë bashkëpunim apo ndërveprim në një situatë të caktuar! Koret diplomatike nuk kërkojnë sugjerime, aq më pak nga Shaqir Fetai i depersonalizuar, i cili, i mësuar të jetë i dirigjuar, shkelë mbi çdo parim, duke dëshmuar se është i rrezikshëm dhe jokompatibil për drejtim apo bashkëpunim! Shaqir Fetai, fatkeqësisht, sot njihet si person me sjellje devijuese. Të tillët kryesisht shkelin norma njerëzore, etike dhe normat e vendosura ligjore. Në botën shtazore, gjallesat me këto simptoma i mbajnë të lidhura në grazhd.

*(1Kliklart, 15.01.2021)*

## Shaqir Fetai ka një “selam” për të punësuarit në BFI

Pleqtë e përkrahën, e uruan dhe e përshëndetën, kori diplomatik po, “hoxhallarët” po, farefisi po, do femra që nuk përfaqësojnë as familjen e vet, po, do farë jurista e do gazetaruca, do pronarë të televizioneve lokale, e përkrahën, e uruan dhe e përshëndetën duke shpresuar në ndonjë përkrahje financiare, dhe, krejt në fund e paskan përkrahur edhe “rinia” (cila rini?) përmes njëfarë regjisorit dhe skenaristit të ri i cili e paska publiku filmin e parë autentik shqiptar në Maqedoni! Këto informata i bëjnë injorantët, manipulorët dhe kodoshët që nuk kanë lidhje me realitetin, me të vërtetën dhe që gënjeshtren e kanë din e iman, që nuk e dinë historinë e filmit shqiptar e as që kanë qenë ndodnjëherë në kino!

Nga dita e sotit, Shaqir Fetain duhet ta vizitojnë një shtresë e caktuar! “H. Nesip Demiri – referet në Fakultetin e Shkencave Islame – Shkup dhe H. Muharrem Idrizallari – bibliotekari i Fakultetit vizituan Reis Ulemanë e BFI të RMV H. Hfz. Shaqir ef. Fetain për t’ia uruar detyrën e re” – ky ishte lajmi në faqen zyrtare të BFI-së, faqe kjo që është bërë si lista e synetlinjëve.

Shaqir Fetai përfundimisht është njeriu më i sëmurë psikikisht që ka punuar ndonjëherë në BFI. Njeri më të kompleksuar nuk e bën më nëna. Njeri më kot, njeri më të rrezikshëm, njeri më havadyz se Shaqir Fetai nuk lidn më mbi këtë tokë.

Shaqir Fetai i thëret hoxhallarët në telefon dhe ju kërkon të vijnë të pinë kafe ndërsa deri sa e pinë kafën i fotografon dhe e publikon duke dezinformuar se ishte filan fisteku i cili ia uroi “reisit” detyrën e re. Të tillë vizitorë të ftuar ka Shaqir Fetai. Tani, në radhë duhet të jenë të punësuarit e BFI-së. Shaqir Fetai, me këtë gjest e me këtë lajm, ju dërgon selam të gjithë të punësuarve që të vijnë e ta urojnë, sepse na u bë “reis” i hamamit.

A bëhet lajm kjo vizitë e të punësuarve? Shaqir Fetai e ka për obligim që t’i takojë të gjithë të punësuarit, e ka obligim që t’i pyes për problemet dhe, nuk e ka obligim që t’i detyrojë të gjithë që t’ia urojnë postin të cilin e okupoj falë ndihmës dhe përkrahjes nga forcat e pushtetit maqedonas. Këtë e di Shaqir Fetai dhe, ndonëse i zgjedhur nga ky pushtet maqedonas, i detyron shqiptarët dhe myslimanët që t’ia bëjnë për hajër! Harami nuk urohet! Nuk urohet ai që, që nga vitet 1980 e këndeja ka qenë nën komandën e Dragoviqit! Cili shqiptar dhe cili mysliman normal do ta uronte dhe do ta përshëndeste nxënësin e oficerit të UDB-së? Vetëm ata që janë të detyruar e të shantazhur! Vetëm ata që kanë mundur ta dëgjojnë bisedën në odën e hafëz Hasanit, në Çegran, deri sa Shaqir Fetai bisedon me udbashët për “Ideatorin 1” dhe “Ideatorin 2”, emrat e të cilëve fillojnë me inicialet R.M. Të nesërmen, Shaqir Fetai bashkë me “mentorin e vet fetar” do të fotograohen te Temelko Boshkovski!

Dhe, “bilbili i Temelkos”, Shaqir Fetai, të urohet e të përshëndetet! Këtë punë e bëjnë vetëm ata që janë të detyruar, që janë servila, që janë bashkëpunëtorë në shërbim me Shaqir Fetain, të manipuluarit dhe të shantazhuarit, si dhe ata që shpresojnë se me ndonjë “projekt” mund t’ia ngulin Shaqir Fetait e t’ia marrin ndonjë para. Për antipropagandë dhe për imazh të rrejshëm Shaqir Fetai është në gjendje të paguaj sa të kërkojnë “profesionistët”!

Dhe, mos harroni, te Shaqir Fetai mund të hyni vetëm nëse paraprakisht i premtoni se dëshironi t’ia uroni postin e ri, “reis i kontestuar” e i pranueshëm vetëm nga pushteti maqedonas.

<https://fol.mk/bashkepunetori-cilit-sherbim-eshte-kreu-i-bfi-sedokument/>

*(Lajme7, 18.01.2021)*

## Një qasje profesionale mbi shkeljet kushtetuese në BFI

**Pse vetëm policia financiare paka të drejtë që të futet në BFI për të kontrolluar dhe nuk paskan edhe organet e tjera përkatëse shtetërore. Në BFI janë bërë dhjetra shkelje kushtetutare për të cilët organet gjegjëse të rendit dhe të drejtësisë duhet patjetër që ta thonë fjalën e vet. Ndryshe, stabilizimi i BFI-së shumë shpejt do të na bëhet kusht për fillimin e bisedimeve me BE. Shkeljet kushtetuese në BFI janë të papranueshme dhe të dënueshme për BE-në, ndonëse preferon që mos të përzihet në “çështjet e huaja”**

**Shkruan Naser Jakupi, jurist**

Kam lexuar një analizë shumë profesionale të përgatitur nga Këshilli për mbrojtje e kushtetutshmërisë së Bashkësisë Fetare Islame, mbi shkeljet e Kushtetuts që janë bërë që nga maji i vitit 2020 e deri më sot në këtë Institucion të vetëm fetar islam në Maqedoninë e Veriut. Shkelje drastike, të pafalshme, të dënueshme, shkelje që përdëftojnë se, në këtë Institucion nuk ka organ policor e i drejtësisë që nuk ka punë. Prandaj, të futet vetëm policia financiare është punë më tepër e shantazhit se sa e zgjidhjes së problemeve, është më tepër akt kërcënues se sa akt human e institucional për ta shpëtuar një Institucion jetik për një shtet multifetar e multinacional siç është shteti ynë.

Kushtetuta është normë juridike e cila rregullon, mbi të gjitha, të drejtat dhe liritë individuale, obligimet dhe detyrat e qytetarit ndaj shtetit dhe institucioneve shtetërore si dhe të garantojë paqe e mirëqenie, zhvillim e prosperim për të gjithë, njëtrajtshëm, pa diskriminime dhe mohime të realitetit të përgjithshëm.

Në rastin konkret, me shkeljen e Kushtetutës së BFI-së ka plotë nene që bie ndesh:

Ligjit për mbrojtjen e të dejtave dhe lirive të njeriut,

Ligji për mbrojtje nga diskriminimet e përgjithshme,

Ligji kundër korrupsionit

Ligji kundër keqpërdorimit të pozitës

Si dhe një sërë veprash penale për ç’gjë në një shtet normal do të përfundonte tërë zinxhiri i kriminelëve burgjeve të vendit.

Tani, në Maqedoninë e Veriut funksionon një Institucion fetar, i pavarur nga institucionet shtetërore! Shteti ka ligje dhe norma juridike që vlejnë për të gjithë qytetarët, për çdo organizatë e institucion, për çdo organizim e funksionim. Çdo gjë është e organizuar sipas këtyre normave juridike dhe gjithçka i nënshtrohet dhe përgjigjet para këtyre normave, të cilat, njëkohësisht garantojnë liri, të drejta, kompetenca dhe përgjegjësi. Ligjet e theksuara më sipër, të cilat janë shkelur me shkeljet e neneve të Kushtetutës së BFI-së, janë ligje për shkeljen e të cilëve BE-ja nuk ka kurrfarë kompromisi. BE-ja pikerisht rregullimin e këtyre dukurive juridike e ka vënë kusht për çdo shtete të Ballkanit për të filluar bisedimet për inkuadrimit në BE.

Një ndër veprat penale llogaritet edhe korrupsioni qoftë aktiv qoftë pasiv! A është kryer një vepër e tillë penale me rastin e shkeljeve kushtetutare të BFI-së? Gjithësesi që po! Le ta shpjegojmë me pak fjalë këtë dukuri tepër të shumtuar, sidomos për myslimanët.

Në rastin konkret del në pah më tepër mitmarria, korrupsioni pasiv, i cili e kompromiton shumë rëndë

një shtet që pretendon se ëshë ligjor!

Nga zberthimi i problematikës brenda tërë asaj analize me titull “Shkelje dhe masakrimi i Kushtetutës së BFI në RMV”, segmente të caktuara të pushtetit, si dhe një parti e tërë e pushtetit (BDI), na del si motivese për një seri shkeljesh trashanike të Kushtetutës së BFI-së: i garantojnë Shaqir Fetait pushtet absolut, i garantojnë mbrojtje absolute nga pushteti si dhe e udhëzojnë se çfarë të bëjë nëse dëshiron që të drejtojë me BFI-në e depersonalizuar dhe pa kurrfarë integriteti! Natyrisht, shumë shpejt do të zbulohet se ky korrupsin pasiv e ka edhe mitdhënien apo korrupsionin aktiv. Për këtë “nder” që po ia bëjnë Shaqir Fetait, gjithësesi që ky ka premtuar të ofrojë kundërshtpërblim: qoftë nga vakëfi, qoftë nga letrat në vlerë nga denacionalizimi, qoftë duke i mbrojtur njerëzit e pushtetit policor brenda BFI-së!

Në fakt, ky segment ligjor do të jetë një nga më problematikat e shtetit për të filluar negociatat me BE-në. Loja sërish do të duhet të zberthehet e të përfundojë me largimin e Shaqir Fetait, i cili, ose do të detyrohet të ofrojë dorëheje të kërkuar nga vetë këta segmente, ose do të përfundojë ashtu siç erdhi, me dëbim e me nënçmim.

Askush të mos mendojë se BFI-ja nuk është nën survejim të faktorëve të jashtëm! Ka nga ata faktorë (pro-rus) që do ta përkrahin e do ta ndihmojnë Shaqir Fetain me qëllim të devalvimit të BFI-së deri në faktor irrelevant, por, BE-ja nuk do të lejojë që shtetet që dëshirojnë të aderojnë në këtë familje të kenë brenda vetes Institucione të demoluara nga anarkistët që bashkëqeverisin apo përgëdhelen nga segmentet e caktuara të pushtetit.

Rikthimi në lojë i konstitucionalistëve si dhe bashkëpunimi me këtë faktor dikur të brendshëm (e që u dëbua pikërisht se nuk lejonte shkelje kushtetuese) do të ishte përpjekje serioze për ta shpëtuar Institucionin fetar ndër më të rëndësishmet në rajon, për t’i sanksionuar avanturierët dhe anarkistët si dhe për të dëshmuar para Institucioneve relevante të BE-së se pushtetet e Maqedonisë së Veriut kurrë nuk do të tolerojnë, jo të marrin pjesë por, as të përceptohen si bashkëpjesëmarrëse në kapjen e institucioneve fetare të cilët i shikojnë si burime ku mund të vlojë korrupsioni por të mos dëshmohet asnjë herë për shkak të “normave fetare”!

Me Shaqir Fetain në krye të BFI-së i bëhet dëm shqiptarëve, i bëhet dëm shoqërisë, shtetit dhe, mbi të gjitha, BFI-së, me të cilën, dikur, mbase para dy dekadave, nuk kishte organizatë e faktor evropian që nuk e vizitonte e që nuk dëshironte të bashkëpunojë me këtë Institucion fetar islam. A mos i ka penguar kjo Shaqir Fetait që i ka hyrë kësaj aventure të shkeljeve kushtetutare e t’i shkelë nenet si lakrat e ngrira në bahçe të babës?

*(Kombetare, 18.01.2021)*

## Përsëritja e filmit lemonade

**Shaqir Fetait po i ngushtohen punët, shpirti i ka ardhur në fyt. Shaqir Fetai paska menduar se viti ka vetëm një muaj dhe jo dymbëdhjetë dhe, natyrisht, çdo muaj kërkon rrogën e vet! Shaqir Fetai është i bindur se “do t’i mjelë” financiarisht arabët, sepse, tashmë ka humbur në mënyrë katastrofale besimin e myslimanëve të brendshëm**

Po atë muaj kur Shaqir Fetai e bëri të pabërën në jetën myslimane, kur e tradhëtoi prijësin e vet, kur u shit për një post të vjedhur e të paarritshëm kurrë për Shaqir Fetain, kur tallej me botën duke u prezantuar herë “reis” e herë “ushtrues detyre reis”, post ky inekzistent në rregullimin kierarkik të BFI-së, Shaqir Fetai arriti ta koordinojë një vizitë përmes një shoqate joqeveritare, si “vizitë zyrtare” në Emiratet e Bashkuara Arabe. Atëherë ishte mysafir i kotë (sa për shpenzime të pak financave të BFI-së) i një organizate ndërkombëtare me titull “Këshilli botëror i komuniteteve myslimane” drejtuar nga Dr. Alij Rashid Nuajmij.

Sot, Shaqir Fetai është mysafir i të njëjtës organizatë joqeveritare. Se çka e lidhë këtë fare “reis” naivin me këtë organizatë, as vetë nuk e di, nëse jo dëshira për të shitur pordhë se sa është “i madh” dhe, manjakllëku për të shkruar për të si dikur për Xhemal Bjediqin e ndjerë, i cili, më tepër kalonte kohë për Titon nëpër botën arabe dhe në shtetet e painkuadruara se sa në ish-Jugosllavi, apo në Bosnje.

Bashkësia Islame nuk ka para, është në krizë të rëndë financiare. Shaqir Fetai tha se është ndihmuar financiarisht nga shteti porse ato nuk mjaftojnë. Të punësuar janë shumë. Shaqir Fetai nuk e ka ndonjë plan të reformave, të restriksioneve, shkurtimeve të punësimeve të jashtëzakonshme për kaçikun e BFI-së! Shaqir Fetai e pa që mosbesimi i popullatës myslimane është i jashtëzakonshëm, se nuk është punë që me aq lehtësi mund ta rikthejë besimin, të paktën jo Shaqir Fetai, i cili, për tetëmbëdhjetë vite ka kontribuar që BFI-ja të vie në këtë drexhe!

Shpëtimi kërkohet në organizatat joqveritare (dihet edhe arsyeja e themelimit të tyre)! Kërkon nja një milion dollarë që t’ia zhvasin të tjerët, si ato nga Kuvajti! Shaqir Fetai mund të ndodhet edhe para presionit të partive që e ndihmuan e që po i ndejnë zgjedhjet e jashtëzakonshme. Duhet para për fushata partiake. Shaqir Fetai nuk e kupton se nuk ka shtet dhe organizatë arabe që nuk e di se kush është ai, nuk ka shtet e organizatë arabe që nuk e di se kush e solli Shaqir Fetain në pushtet, nuk ka shtet e organizatë arabe që tashmë nuk e ka të gatshëm profilin psikik e profesional të Shaqir Fetait. Natyrisht, nuk është bonton që të dëbohet mysafiri, nganjëherë ata që e teprojnë ftohen dhe, kalojnë si mos më keq në aspekt të asaj për çfarë ia kanë mësyer asaj vizite dhe, e tërë kjo vetëm sa për t’ia bërë me dije se është duke e tepruar: eja, shëtitu, kënaqi pak interesat mesquine fshatareske dhe, kthehu e mos na lodh!

Shaqir Fetai mendon se bota arabe nuk e di se kush është Ismet Ademi, mendon se nuk e dinë se i cili shërbim është ky farë “takvaxhie”! Shaqir Fetai mendon se bota arabe nuk e di se si i vodhi arabët Myftiu i Kumanovës, Abedin Imeri. Godinën e Myftinisë ia bënë turqë, deri në gozhdën e fundit, ndërsa nga Arabia Saudite i mori për këtë qëllim rreth 400 mij dollarë, të cilat përfunduan nëpër xhepat e tij dhe të bashkëpunëtorëve të tij. Shaqir Fetai nuk e ka të qartë se, sapo të futet emri dhe mbiemri, apo faqja e parë e psaportës në kompjutor, menjëherë të dalin të gjitha marifetet që i ke bërë, kudo në botë.



Tubimi i fitrit, i zeqatit, i kontributeve të ndryshme, i shitjes së lëkurave të kubanëve, i anëtarësisë – këto burime janë të kategorisë kushtetutare për BFI-në. Shaqir Fetai është i vetëdijshëm se do t'ia kalojë shumë keq, se do t'i duhen nja 20-30 vite për ta rikthyer besueshmërinë e besimtarëve në Institucionin e BFI-së, me kusht që të punojë me devotshmërinë më të madhe, dhe tek pastaj të nis e të shpresojë në këto burime. Deri atëherë, do të provojë të shtrijë dorën e hajnisë si lyps i ngratë nëpër botën arabe, të cilët, mund t'i japin ndonjë para xhepi dhe hiç më shumë. Asnjë organizatë financiare nuk do ta mëshironte Shaqir Fetain ndërsa vetë të futet nëpër listat e zeza ndërkombëtare për transaksione të pajustificueshme financiare. Shaqir Fetai duhet të raportojë shumë, të punojë shumë, të rrëfëhet për çdo cent të tyre që është shpenzuar për 18 vite sa ka qenë anëtarë Rijaseti dhe pastaj të shpresojë në ndonjë lëmoshë, ndryshe, ai po mundohet t'i ofendojë arabët. Zatën, nënçmimin dhe ofendimin Shaqir Fetai i ka në vend të rruzave të bardha të gjakut!

*(Lajme7, 19.01.2021)*

## Renegati me vlera të surrogatit

**Shaqir Fetai plotë tri dekada i ka shërbyer një kauze, plotë tri dekada ka qen bashkëpunëtorë i Sulejman Rexhepit dhe realizues i të gjitha ideve dhe synimeve të tij; plotë tri dekada ka qenë i përkorë në vijën e Sulejman Rexhepit dhe, më në fund tradhëton, duke hequr dorë nga bindjet dhe qëndrimet e mëparshme. Këtij tipi që tradhëton në kohë përpjekjesh për një të ardhme më të lumtur islame, i thonë renegat**

**Nga Sabit Ibrahim**

Këto ditë kemi lexuar e stërlexuar një analizë sa të thuktë aq edhe të thellë mbi shkeljet kushtetuese që nga paraqitja e parë e Shaqir Fetait si “pretendent” për fronin e reisit e deri te caktimi i tij në krye të kësaj detyre me ndihmën e elementeve të caktuara të pushtetit aktual. “Reis” politiko-partiak i imponuar nga faktorët që nuk kanë dy lidhje me islamin dhe i “miratuar” nga një strukturë e tërë e shantazhuar deri në palcë të kurrizit.

Analiza është bërë nga Këshilli për mbrojtjen e kushtetutshmërisë së BFI-së, me titull “SHKELJET DHE MASAKRIMI I KUSHTETUTËS SË BFI NË RMV”! Sipas kësaj analize, Shaqir Fetai dhe lakejt e tij kan shkelur mbi 30 nene të Kushtetutës, tërë esencën juridike-islame të një Institucioni fetar islam. Dhe, sa po të lexohet kjo analizë mbi kaq shumë shkeljesh të esencës islame, shtrohet pyetja me automatizëm: çfarë ka ngelur islame në atë Institucion?

Shaqir Fetai, për nga përbërja etnike në BFI, është minoritar partiak. Është e vërtetë se, BDI-ja është parti më e madhe shqiptare (dhe e përzier etnikisht) në vend! Gjithnjë ka fituar me 100-130 mijë vota. Do me thënë se, është “reis” i këtyre votav, ndonëse në mesin e këtyre 130 mijë myslimanëve, nja 100 mijë nuk e duan pas publikimit të një dokumenti që flet (e që asnjëherë nuk u demantua) për lidhjet e tij me strukturat antishqiptare të shërbimeve të huaja intelektuale.

Në Maqedoni janë edhe nja 700 mijë myslimanë që nuk kanë lidhje me këtë parti, prandaj, lideri i BFI-së duhet të jetë mbipartiak, lider i të gjithë elektoratit mysliman, i të gjithë strukturave udhëheqëse të partive politike të bllokut mysliman si dhe lider i të gjithë liderëve partiakë. Pra, lider mbipartiak! Marrë parasysh këtë fakt, Shaqir Fetai i bën këto shkelje të Kushtetutës së BFI-së, sepse, atij i duhet një Kushtetutë që BFI-në do ta bëjë tamam filiale të BDI-së, ndëra të gjithë të tjerët, këta 700 mijë myslimanë, nëse dëshirojnë t’i gëzojnë të mirat e kësaj Kushtetute si dhe të BFI-së le të shndërrohen të gjithë bdista! A ka aventurë më të rrezikshme se kjo ku është futur Shaqir Fetai.

A mundet që edhe më tej të drejtojnë me BFI-në një “kryetar” si Shaqir Fetai, i cili do të ngelë në historinë e këtij Institucioni si një “Haxhi Qamil” i vockël, si shkelës i projekteve madhore fetare e kombëtare, si plaku (62 vjet!) më i çmendur që ndonjëherë ia ka mësyer “liderizmit”?!

Në një kohë jo shumë të largët, Shaqir Fetai i votonte për “murted” shkelësit dhe mohuesit e Kushtetutës së BFI-së (rasti i të ndjerit Jakup Selimovski). Së këndejmi, Shaqir Fetai, njeriu që i ra mohit tri dekadave kontribut në BFI, vetëm e vetëm që të realizohet projekti anti-BFI i pushtetit aktual maqedonas, e ka hak epitelin RENEGAT! Tri dekada kontribut i pëshurri sepse paskan qenë nën komandën e Sulejman Rexhepit! Sulejman Rexhepi duhet të shkarkohet, të linçohet, dhe të paralizohet, që mos të ketë mundësi ta thotë asnjë fjalë për ato tri dekada të Shaqir Fetait deri sa ka

qenë “myhyb” i tij.

Ky lloj tipi, si Shaqir Fetai, me kaq shumë shkelje kushtetuese në Institucion ku ka shërbyer tri dekada, kualifikohet me të drejtë renegat, kurse ai që turpshëm hedh vështrim mbi tri dekada kontribut, nëse kanë qenë të gabuara, ai tërhiqet fare, duke mos dalur kurre më nga katër muret e dhomës.

Dhe, kur renegati mundohet që të imponohet si produkt natyror, ndërkohë që është kokë e këmbë i falsifikuar, atëherë themi se kemi të bëjmë me një surrogat. Kur renegati pajiset me vlera të surrogatit, ky po që është shenjë e kijametit. Zot, na ruaj nga kjo biçim krijese!

*(Kliklarg, 20.01.2021)*

## Shaqir Fetai shkelësi dhe mohuesi i vetëm i Kushtetutës së BFI në RMV

**Mbi 33 nene të shkelura të Kushtetutës së BFI-së! Çka do të thotë kjo? Tallje me një nga Institucionet më të vjetra në Ballkan, i cili i bëri ballë turlifarë pushtuesi e okupatori? Pse u nëpërkëmbën normat juridike të BFI-së? Vetëm për të treguar se ka edhe “pushtues” të atillë që mund ta devalvojë deri në këtë masë Institucionin fetar islam! Një veprim ky i okupuesve antiislamistë**

### Nga Jasir Jashari

A e keni dëgjuar se me sa mburrje flet Shaqir Fetai për ish-reisul ulemanë Sulejman ef. Rexhepi? A e keni dëgjuar se me sa mburrje flet Shaqir Fetai për bashkëpunimin e tij 18 vjeçar si myfti me Sulejman ef. Rexhepin! Gati tre degada i ka shërbyer, ka mësuar prej tij, e ka pasur “idol”, ka luftuar për të, kushdo që ia ka turbulluar ujin Sulejman ef. Rexhepit menjëherë e ka shpallur armik të islamit e të BFI-së!

Shaqir Fetain e mori dikush mësyshë! Shaqir Fetai, në mënyrë tepër naive, flet për një të kaluar të BFI-së e cila është menaxhuar shumë keq. Fare nuk do t’ia dijë se edhe vetë ka qenë pjesë me shumë kompetenca në atë menaxhim të keq të BFI-së dhe, për pasojë, u desht të largohet vetëm Sulejman ef. Rexhepi e jo edhe tërë ekipi i tij! Paska shkelur Nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së! Asnjë nga alinetë e atij neni nuk ka mundur të shkilen pa përkrahjen masovike të Rijasetit pjesë e së cilës ka qenë edhe Shaqir Fetai. Shaqir Fetai sot, madje pa pikë turpi, i qorton e mërzhitet shumë me të gjithë ata që për shkak të moshës kontaktojnë me Sulejman ef. Rexhepin! Shaqir Fetai nuk lejon që, edhe të hanë nga BFI-ja edhe të kontaktojnë me Sulejman Rexhepin, i cili që nga punësimi i parë e deri në pensionim, kaloi jetën në BFI! Nuk guxon askush të flasë me Sulejman ef. Rexhepin sepse ai ka shkelur Nenin 58!

Plot 33 nene të Kushtetutës së BFI-së i paska shkelur Shaqir Fetai sipas analizës të bërë nga Këshilli për mbrojtjen e kushtetutshmërisë së BFI-së! Në raport me shkeljen e nenit 58 për ç’gjë u dëbua nga BFI Sulejman ef. Rexhepi, atëherë i bie që Shaqir Fetai të hypet në një govatë raketash dhe të dërgohet për në Hënë apo për në Mars, sepse për në Tokë nuk i ka ngelur vend ku mund ta ngulë b...

Për një nen (58) që qenka shkelur për vite me radhë, u humb besimi i mbi 70 për qind i myslimanëve të vendit ndaj BFI-së! Megjithatë, për hirë të së vërtetës, për frikën nga Zoti i Madh, duhet pranuar se ky nen nuk do të mund të shkilej asnjë sekond nëse në këtë shkelje nuk do ta ndihmonin dhe përkrahnin të gjithë bashkëpunëtorët dhe servilet e poshtër të Sulejman ef. Rexhepit. Me shkeljen e këtyre 33 neneve, edhe ai 30 për qindësh i myslimanëve që kishin një trohë simpatie ndaj BFI-së, do ta braktisin këtë Institucion. Askush nuk mund t’i përkrahë shkatërruesit e një Institucioni, me përjashtim të armiqve të atij Institucioni. Shkelësit e Kushtetutës së BFI-së dhe përkrahësit e kësaj vepre penale, janë vetëm ata të cilët janë mësuar me shkeljen e mëhershme të neneve të Kushtetutës, ata që druajnë se nëse do të stopohet shkelja e më tejme do të përgjigjen për shkeljet që i kanë bërë dhe, ata që e kanë mision nëpërkëmbjen e normave juridike të këtij Institucioni deri sa të rrenohet përdhe!

Shaqir Fetai plotë 18 vite si myfti dhe si anëtar Rijaseti ka vjelur taksat e myslimanëve të Gostivarit, i

ka dorëzuar në Rijaset dhe ka kontribuar në formimin e grupit i cili do të nisë të shkelë nenin 58, do ta joshë këtë shkelje kushtetutare me qëllim që të krjohet një alibi për ta eliminuar nga skena babain e tij shpirtërtor, Sulejman ef. Rexhepin! Tani do të duhet të gjejë donacione të fuqishme financiare që t'ia zgjasë jetën sa më shumë grupit që shkelë të gjitha nenet e Kushtetutës dhe aktet e tjera normative të BFI-së.

Vështirë se do ta ndihmojë Zoti në këtë mision të mbrapshtë. Sado që Shaqir Fetai do të punojë “me përkushtim” për islam e për BFI, megjithatë, nuk do ta gëzojë ndihmën e Allahut Fuqplotë, sepse ka shkelur parimet islame në të cilat mbështeten nenet e Kushtetutës së BFI-së. Truqet e Shaqir Fetait janë të lexueshëm për djallin e jo më për Zotin e Gjithëdijshëm.

Shaqir Fetai një gjë është dashur ta ketë parasyshë në momentin kur ka vendosur t'i shkelë të gjitha ato nene të Kushtetutës së BFI-së. Për shkeljen e një neni (58) çfarë skandalesh u shkaktuan në BFI e farë muhabetesh u përfol në mesin e myslimanëve të Maqedonisë. Shtrohet pyetja: çka do të ndodhë me BFI-në dhe me muhabetet ndër myslimanë kur do t'i vie dita të japë llogari Shaqir Fetai për shkeljet kushtetuese që ia bën në çdo sekond BFI-së! Zot, mos i mëshiro ata që janë plotësisht të vetëdijshëm për veprimet e tyre antiislame!

*(Tetovasot, 20.01.2021)*

## **“Reisi” politik që injoron bazën dhe të gjitha organet e BFI-së**

**Që nga anëtari më i rëndomtë i BFI-së, qytetari mysliman, apo, anëtari i komunitetit mysliman në vend e, deri në organet më të larta të këtij komuniteti, përfshirë këtu edhe Rijasetin dhe Reisin, që të gjithë i ka tallur Shaqir Fetai, duke i anashkaluar dhe duke i injoruar në të drejtën e pjesëmarrjes dhe në obligimet qytetare për zhvillimin e jetës fetare islame në RMV**

**Nga Abaz Islami**

Këto ditë është debatuar dhe shkruar mbi një çështje e cila do të duhej ta trondiste masën e gjërë, sidomos atë myslimane! Por, a ua preku ndërgjegjën ky debat teologëve të vendit, a i tronditi myslimanët, a e vetëdijësoi ndonjë strukturë të organeve dhe institucioneve të BFI-së? Shumë pak! Më tepër u tronditën dhe u interesuan faktorët ndërkombëtarë se sa myslimanët e vendit! Edhe kjo heshtje vrastare e besimtarëve ishte brengosëse për fakorin ndërkombëtar, sepse, kjo flet se, tashmë tërë shoqëria e vendit është e varur nga partitë politike që kanë futur duart thellë edhe në organizimin e jetës fetare në vend.

T’ia prekësh një shoqërie shpirtin dhe për këtë të mos ketë kurrfarë reagimi, kjo flet se qytetarët po shndërrohen në mekanizëm votimi duke kërkuar që këtij mekanizmi t’i lyhen të paktën dhëmbëzorët, t’ju premtohet punësimi i fëmijëve, nipërve e mbesave të hoxhallarëve e të teologëve të ndryshëm. Del puna se të gjithë janë nën presionin e shantazhit partiak. BFI-ja, praktikisht ka mbetur në nivelin e një targambledhësi fetar për myslimanët e vendit. Kurrë në historikun e vet BFI-ja nuk ka qenë kaq shumë e depersonalizuar.

Shaqir Fetai u fut në skemën e përgatitur nëntokave të shërbimeve të ndryshme, me qëllim të sheljes dhe të mohimit të të gjithë organeve të BFI-së. Që nga paraqitja e tij, si person i uritur për postin e “reisit” e deri më sot, janë zbrëthyer pothuajse të gjitha këto lojna! Së fundmi, me analizën e bërë mbi shkeljet kushtetuese të BFI-së, përgatitur nga Këshilli për mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI në RMV, u konkludua se janë shkelur mbi 30 nene esenciale të Kushtetutës, që të gjitha mbështetur në parimet islame mbi të cilat është paraparë organizimi, zhvillimi dhe avansimi i jetës fetare islame në vend.

Pasi shkelja u bë në krye të BFI-së, fluturimthi u zbrit në bazë, me qëllim që të mbillet një sistem diktatorial në BFI! Nga anarkistët u injorua tërë baza dhe, madje edhe u kërcënua, duke ju thënë se, mbahet shënim çdo reagim i teologëve të cilët mund të sanksionohen duke iu hakmarrur partia me largim nga puna, apo me pamundësim punësimi të të gjithë fëmijëve, nipërve e mbesave të strukturave të BFI-së, që nga imamët e deri te “reisi”!

Se sa do të ketë sukses kjo përpjekje, kjo u vërejt nga disa myftini të cilët nga Shaqir Fetai u përdorën si kampion “studimi” i këtij efekti!

Le të ndalemi te organi Myftini, e cila ka myftiun, kryeimamin, sekretarin, si dhe anëtarët e tjerë të myftinisë, varësisht se në ç’masë territori shtrihet! Anëtarët e Myftinisë zgjidhen nga mexhlisi i xhemateve, i cili përbëhet nga nëpunësit fetar të muftinisë (imami, mualimi, vaizi, myezini etj.), mutevelinjte e xhamive dhe të punësuarit në operativën e Muftinisë.

Shaqir Fetai i shkelë nenet që e rregullojnë këtë çështje por edhe tërë Rregulloren që i përket

zgjedhjeve dhe rregullimit të jetës fetare islame në çdo myftini! Në ato territore të përcaktuara me Kushtetutën e BFI-së ku nuk ka kushte për zgjedhjen dhe emërimin e myftiut, caktohet një kordinator i cili e rregullon organizimin e jetës fetare konform Rregullores për Myftini si dhe Kushtetutës së BFI-së. Kjo është kompetencë dhe e drejtë e myslimanëve të territorit gjegjës, e organeve fetare të atij territori, prej qytetarit të rëndomtë, muteveliu e deri te myftiu apo kordinatori i Myftiut. Këtë kompetencë dhe këtë të drejtë ua ngulfat Shaqir Fetai, duke emëruar krye më vete myftinjë (të pazgjedhur, të pa propozuar, të pa emëruar, të padekretuar) por edhe duke shpikur tituj jasht kushtetutar si “u.d. myfti”!

Për Shaqir Fetain nuk është i rëndësishëm fare konsultimi me këshillat e xhamive, me mexhliet e xhemateve, me operativën e myftinisë për zgjedhjen e organeve drejtuese apo konsultative. Për Shaqir Fetain me rëndësi është përcaktimi i tij, sepse ai e gëzon dhe e ka fituar atë të drejtë dhe legjitimitet partiak e të pushtetit, të cilin duhet ta fitojnë edhe qytetarët më të rëndomtë, duke u servilosur dhe duke iu nënshtruar partive në pushtet.

Një e treta e myftinive të BFI-së i janë bindur vendimeve personale të Shaqir Fetait, duke kërkuar dhe përkrahur shkelje drastike të akteve juridike të BFI-së.

Nëse nuk ndërhyjnë ndërkombëtarët, gjithnjë si faktor esull në këtë vend, ekziston mundësia që të mbillet praktika e thyerjes së heshtave partiake mu në oborr të BFI-së dhe, ajo parti që do ta kontrollojë BFI-në ajo do të instalohet në pushtet! Natyrisht, kjo strategji mund të ketë dhe koston e vet! Askush nuk garanton se nuk do të provokohet dhe ndihmohet ekstremizmi politiko-fetar, terrorizmi politiko-fetar, një anarki totale, e gjithë kjo përkrahur, mbështetur dhe mossanskionuar nga organet gjegjëse të shtetit. Bashkësia Fetare Islame u plagos për vdekje nga Shaqir Fetai! Ndërhyerjet politike veçsa do ta përshpejtojnë vdekjen e këtij Institucioni nga plaga e shkaktuar me të gjitha simptomet e plagës kancerogjeneze. Ndërhyrja kirurgjikale e faktorit të jashtëm, duke e kthyer jetën fetare dhe organizimin e saj në bazë të Kushtetutës aktuale, mund të jetë vendimtare për shpëtimin e këtij Institucioni aq me relevancë në vend, rajon dhe më gjërë. Nuk duhet pritur të shfaqen situatat ekstremiste dhe të papërballueshme, por, sa më parë të ndërhyhet aq më lehtë do të tejkalohet ky kërcënim i planifikuar nga nëntoka e shërbimeve të huaja.

*(Tetovasot, 21.01.2021)*

# Hoxha

(Motivuar nga shkrimi me titull: “Reisi politik që injoron bazën dhe të gjitha organet e BFI-së”, të autorit Abaz ef. Islami, botuar në disa portale shqiptare)

## Shkruan Shaban Aziri

Ku mbeti autoriteti i imamëve? Ku mbeti epiteti i imamëve si prijës i xhematit? Çka po ndodhë me hoxhallarët? Pse të vijnë në derexhe që të na vie turp nga profesioni hoxhë? Çka ndodhi që sot hoxhallarët të përfshihen të gjithë në një thes dhe të trajtohen si “hajna”, “çivijashë”, si “gurmazë”, si të “pangopshëm”, si “lypsarë”, si “dallaverxhinjë”...

Imamët janë prijësa! Hoxhallarët janë udhëdrejtus shpirtëror të xhematit të vet. Teologët duhet të jenë njerëzit më të respektuar të një shoqërie. Teologët i nënshtrohen vetëm parimeve islame përgjatë drejtimit shpirtëror të xhematit dhe as që duhet të kenë ndonjë prirje që ta shohin veten “ushtarë” të thjeshtë të administratës drejtuese të organeve dhe enteve të një Instiucioni që merret me organizimin institucional të jetës fetare islame. Asnjë personalitet nuk guxon të jetë mbi hoxhën, asnjë “reis” nuk guxon të jetë mbi imamin! Postet administrative duhet të respektohen vetëm për hirë të gatishmërisë për organizimin institucional të jetës fetare dhe, vetëm përderisa ky organizim rrjedh konform parimeve islame. Nëse shkilen këto parime, imamët, hoxhallarët, teologët, pa kurrfarë turpi e frike duhet të ngrisin zërin, madje këtë gjest e kanë të porositur nga mësimet e shenjta, që i dinë, që i interpetojnë, që i porosisin dhe që i zbatojnë çdo orë të ditës, çdo sekond të jetës!

## A është hoxha “shërbetorë” apo prijës

Çka po ndodhë me hoxhallarët tanë? Cili është motivi i hoxhallarëve tanë të sotëm që t’i nënshtrohen një prijësi politik, një dallaverxhiu partiak, një matrapazi injorant që manipulon edhe në emër të fesë por, edhe në emër të politikës? Pse hoxhallarët të sulmohen si hajna, si keqpërdorues të ndihmave humanitare, si vjedhës të fitrit, zeqartit, lëkurave të kurbanit, haxhit... Pse hoxhallarët tanë kanë rënë kaq poshtë, duke humbur çdo autoritet, duke u bërë objekt loje e tallje në çdo darkë, në çdo mevlud, në çdo aktivitet fetar!

I pamoralshmi duhet të distancohet dhe të luftohet, i pandershmi duhet të mbështetet për muri, i poshtri duhet të dëbohet nga rrethi, nga komuniteti. Manipulatorët partiakë, matrapazët politikë, të gjithë duhet të jenë jasht rrethit të xhematit dhe, për këtë gjë duhet të përkujdeset ekskluzivisht imami, hoxha, teologu. Sepse, çdo imam, çdo hoxhë, mbanë përgjegjësi për xhematin e vet. Hoxha, imami, teologu, konsiderohet i suksesshëm vetëm nëse arrinë që ta mbajë dhe ta kultivojë pastërtinë, respektivisht, devotshmërinë e xhematit të vet. Imami, hoxha i mirë është vetëm ai që arrinë ta ruajë kompaktësinë e xhematit të vet, duke e orientuar kah parimet islame dhe duke e penguar në tundimet politoko-partiake.



## Po pse s'po ndodhë kjo?

Sepse, dikush ka arritur që ta devalvojë imamin, hoxhën, teologun në shërbëtor! Imami duhet t'i "shërbejë xhematit", imami është shërbëtor i xhematit, rrjedhimisht i elektoratit partiak, rrjedhimisht i strukturave partiake.

Imami, hoxha, teologu, tashmë ka shitur autoritetin e vet, personalitetin dhe integritetin e vet, në të mirë të "autoritetit" i cili e shton "peshën" e vet në emër të "unitetit të komunitetit"! Sa më unik të jemi aq më të fortë do të jemi!!! Në çka unikë? Në shkatërrim të BFI-së? Në shkelje të Kushtetutës dhe të akteve të ndryshme të BFI-së? Unikë në shërbim të partisë që na e ruan autoritetin e "prijësit fetar"!?

Prandaj sot nuk kemi asnjë hoxhë, nuk kemi asnjë imam, nuk kemi asnjë teolog me karizëm, me peshë të fjalës? Dikur hoxhallarët tanë, të grumbulluar rreth një ideali, rreth një halli, drejtonin revolucione kombëtare, drejtonin lëvizje kombëtare, e nënshtrojnë politikën kombëtare në të mirë të organizimit institucional të jetës fetare, ishin burrshtetas, ishin personalitete me famë botërore.

Sot, hoxha, imami, teologu ka frikë të dalë në sokakun e vet, i bezdiset të hyp në taksi sepse menjëherë do të pyetet për Shaqir Fetain. Ka frikë të dalë në takime me xhemat, qoftë edhe për një çaj, sepse do të dëgjojë lloj-lloj fjalësh nga qytetarët që do t'i shigjetojnë në drejtim të tij!

Sot, hoxhallarëve, imamëve, teologëve më lehtë dhe më mirë po u vie të jenë shërbëtorë, "t'i shërbejnë xhematit", dhe me këtë ta dëshmojnë rrejshëm unitetin duke i shërbyer edhe autoritetit të rrejshëm të personit që ua ka rrëmbyer integritetin e lidërshiptit të çdo hoxhe në vend.

## Teologët që i shërbyen UDB-së vdiqën në anonimitet total

Hoxhallarët nuk pyeten, hoxhallarët kanë ngelur pa të drejtën e tyre për të vendosur ne emër të xhematit të tyre; kanë humbur peshën e prijësit të xhematit, kanë vendosur të kenë një "prijës" para të cilit duhet të përrjargen për një copë kocke. Jo për dinjitet, jo për rrogë, jo për pagë që u vidhet nga kafshata e gojës, jo për pagimin e kontributeve pensiono-invalidor, jo për ruajtjen dhe shtimin e vakëfit por, thjesht, për një copë kock!

Kurrë nuk kanë qenë në pozita kaq të disfavorshme hoxhallarët siç janë sot! Pak edhe për faktin se dikur hoxhallarët, edhe ata që ishin autodidaktë, ishin të brumosur prej personaliteteve kombëtare e fetare. Sot, kemi hoxhallarë me diploma, me fakultete e me mësim të blera, të falsifikuara e në shërbim të djallit!

A mbahen në mend ndonjë hoxhë apo teolog që i ka shërbyer, për shembull, Aleksandar Rankoviçit, apo UDB-së? Të tillët nuk mbahen mend! Kanë vdekur në anonimitet!

"Teologët" keqbërës i ka mbuluar mallkimi dhe nuk kanë zënë vend as në margjinat e faqeve të historië. Ndërsa historia jonë kombëtare është përplotë me personalitete hoxhallarësh që i kanë prirë popullatës në luftë kundër Rankoviçëve e udbashëve, kundër matrapazëve, dallkavëve e tradhëtarëve. Ai që tradhëton nuk mund të ketë tjetër prijës përveçse shejtanit! Hoxhallarët kurrë nuk guxojnë t'i tradhëtojnë dhe as t'i fshehin parimet islame, prandaj janë të graduar me titullin prijës, janë të gatuar për lidërshipt që të kujdesen, veç të tjerash, edhe për ruajtjen e parimeve islame si dhe të të gjitha akteve që mbështeten në këto parime, dhe t'i luftojnë pa kompromis shkelësit e vlerave për të cilat angazhohen dhe është detyrë ekskluzive e imamëve, hoxhallarëve, thirrësve të devotshëm.

***P.s.***

Një reis nuk mund të jetë simbol i unitetit të ummetit! Një reis mund të jetë vetëm shëbëtor i nëpunësve fetarë, i cili mbanë llogari për mirëvajtjen e punëve institucionale në organizimin e jetës fetare si dhe një person i zgjedhur që para politikës apo pushtetit duhet t'i mbrojë interesat e imamlerëve, hoxhallarëve, teologëve. Interes e mbi interesat e hoxhallarëve është që të ruhet autoriteti dhe personaliti i tyre, e jo të përkujdesen për karrierën e “reisit” i cili kërkon që të nënshtrohen të gjithë para tij, ta demonstrojnë unitetin duke i shërbyer atij dhe vetëm atij! Një koncept ky shumë i shtrembëruar, i gabuar dhe i manipuluar i lidershipit! Një i tillë nuk mund të jetë lider, një prijës, një “reis”, por, vetëm shejtan që shembëllen në një dallkaur dhe asgjë më shumë!

***(Zhurnal, 22.01.2021)***

## Nëse shkilet Kushtetuta e BFI-së, cilës “kushtetutë” i shërbejmë?!

**Shaqir Fetai më shpresdhënës do të dukej sikur të fotografohej tek hy e tek del nëpër bankat e vendit. Dikush do të mendojë se ky po tërheq para apo se po lidhë kontrata me bankat që t'i japin uha, se sa të shëtitet e të shpenzojë nëpër shtete arabe duke u fotografuar me drejtorë institutesh. Apo, Shaqir Fetai e okupoi BFI- në sa për të shfrytëzuar rast e për të dalur pak përtej katundit të vet**

### Shkruan Eset Shaqiri

Shaqir Fetai ka vendosur që ta debllokojë BFI-në nëpër shtetet e ndryshme turko- arabe. Këtë fakt e thotë edhe publikisht! Do me thënë BFI-ja paska qenë e bllokuar dhe, kur këtë e thoshte këtu e pesë vite rresht Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI, Shaqir Fetai na shpallte armiq të Sulejman Rexhepit, pesona të poshtër që nuk kanë respekt ndaj fytyrës më markante në historinë e personaliteteve myslimane në vend, ndaj efendi Rexhepit.

Po tani? Çka po ndodhë me Shaqir Fetain! Brenda gjysëm viti dy herë te e njëjta organizatë e Emirateve të Bashkuara Arabe. Nuk ka asgjë të keqe, mirë bënë që realizon dhe shton përvoja personale. Por, mos t'i përkthejë këto vizita si përpjekje për ta shtuar buxhetin e BFI-së të cilën e paska gjetur në zero! Nuk guxon t'i mbajë me shpresë nëpunësit BFI-së se, ja, me këto vizita nëpër shtetet arabe do të sjell para, sepse, përveç para xhepi askush nuk guxon të japë më shumë, as të bëjë transakcione financiare për hatër të Shaqir Fetait, i cili asnjëherë nuk e ngriti zërin për vjedhësit dhe hajnat klasikë që i ka në “kabinetin” e vet.

Bashkësia Fetare Islame në të kaluarën tërë aktivitetet e veta vjetore i ka bazuar në kapacitetin e financave vullnetare si dhe të kontributeve fetare që i kanë dhënë besimtarët e vendit. Ky kontribut, në të kaluarën, asnjëherë nuk ka munguar, sepse, popullata e ka parë, e ka ndjerë dhe i ka besuar angazhimt të sinqertë të parisë fetare për zhvillimin e jetës fetare islame në vend. Shaqir Fetai ka qenë plotë 18 vite “organ”, ka qenë myfti dhe, kurrë, në asnjë mbledhje, nuk është shënuar në asnjë proces verbal, mado mendja, që e ka ngritur zërin për keqpërdorimin financiar, sepse, kurrë nuk ka kërkuar raport, jo për vete por për të raportuar në xhemat se kah po shkojnë dhe si po shpenzohen paratë e tyre. Shaqir Fetait i është kujtuar tani që të raportojë dhe, meqë nuk paska lekë, tani po i takuaka Shaqir Fetait që të angazhohet dhe të vrapojë poshtë e lartë. Të na dalë me rolin e Mesisë!

Pra, me këtë truk banal, Shaqir Fetai ka nevojë që të krijojë një imazh të vetin pozitiv. Sepse, për nja 18 vite ka qenë një copë shuallli në këpucët e Sulejman Rexhepit! Tani i duhet karizma e liderit fetar. Por, a mundet njeriu si Shaqir Fetai, i cili kontribuoi për sjelljen e BFI-së në kët derexhe, të kërkojë që të pranohet për lider fetar?!

Shaqir Fetai, me të gjitha veprimet e veta të derisotshme që kur iu rrek kësaj aventure, ka dëshmuar se nuk është i denjë as për plak katundi, sepse, ka një bagazh të së kaluarës përplot me skandale nga i cili bagazh nuk mund të lirohet aq lehtë. Nëse ky mendon se njerëzit e këtj vendi, myslimanët tanë janë naivë dhe harresqarë, atëherë, ky po ofendon, ky nuk e meriton respektin e askujt. Ky duhet fillimisht të dalë e të pranohet se ka kontribuar në shkatërrimin e BFI-së, por që tash është penduar dhe ndjen obligim moral e fetar që t'ia kthejë boxhin BFI-së! Nuk ka kohë, nuk ka moshë Shaqir Fetai

për t'i dalur borxhit BFI-së.

Shaqir Fetai, pasi të falet nga myslimanët e vendit, duhet të punojë nja tri dekada rresht për ta rikthyer besimin e myslimanëve në BFI, dhe jo imazhin e vet nëse e ka pasur dikur! Me meritë arriti të bëhet profesor? Kush e bëri profesor? Kush e bëri dektor të sektorit për çështje fetare arsimore? Kush e bëri Myfti? Kush e lavdëronte si myfti të suksesshëm? Kush ia siguroi njëfarë “dekoracioni” nga “Universiteti i Florides”? Karriera e Shaqir Fetait lidhet për emrin e Sulejman Rexhepit, siç lidhen për këtë emër edhe të gjitha mëkatet dhe dështimet e mëdha të Shaqir Fetait.

Historikisht, burimet financiare të BFI-së nuk gjenden në shtetet arabe por, thjesht, në mesin e xhematit të vendit. Me anëtarësim, me fitër e zeqat, me organizim të haxhit e të therrjes së kurbanëve, me shitje të lëkurave e me kontribute vullnetare – me këto burime tradicionale është mbajtur, organizuar dhe avancuar jeta fetare islame në Maqedononë e Veriut.

Tash e pesë vite, në çdo mbledhje e raportime mbi këto aksione fetare, për çdo vjet ka pasur rënie në përqindje më shumë se viti paraprak. Nëse në çdo vit ka pasur kontribute fetare financiare më pak se vitin paraprak për 20 për qind, i bie se, nga viti 2015 e deri më 2020 këto burime financiare të jenë shuar 100 për qind! Do me thënë, myslimanët e vendit e kanë humbur besimin në BFI-në me të cilën aktualisht po manipulon Shaqir Fetai! Po pse atëherë t'i besojnë popullata arabe, kur nuk i beson popullata e vendit. Prandaj, Shaqir Fetai mos të shpenzojë kot e kot, duke bredhur poshtë e lartë, mos të shpenzojë duke shpërndarë çaj e kafe për përshëndetje e urime por, le të trusë zuzën e le të punojë, le të mundohet të shkarkohet nga hipoteka e së kaluarës, nga të qenurit 18 vite bashkëpjesëmarrës në shkatërrimin e BFI-së (sepse, kështu e ka akuzuar ish-reisin, duke e shkarkuar si shkelës i nenit 58 të Kushtetutës)! Suksese Shaqir Fetai nuk mund të arrijë me bashkëpunëtorë të dëshmuar si rrënues të BFI-së, me administratë false, të padenjë për t'u përballur me xhematë, me shkollim të diskutueshëm, me avansime arsimore të blera, të falsifikuara e të dyshimta. Duartrokitës e shpatullalëmuarish sa herë që është shkelur neni 58!

Po Shaqir Fetai që po del puna se ka shkelur mbi 30 nene të Kushtetutës së BFI-së? Nëse e mohon këtë Kushtetutë, cilës kushtetutë tjetër i shërben Shaqir Fetai! Vetëm reformat e thella e shpëtojnë Institucionin e okupuar nga strukturat jo të sinqerta politiko-partiake! Shaqir Fetai nuk di të bëjë reforma, as nuk mundet, sepse është i kapur, i shantazhuar, as nuk di të porosisë reforma. Ai i frikësohet kësaj fjale, sepse, të parin që do ta përfshinte reforma do të ishte pikërisht Shaqir Fetai me imazh të avanturistit alla-donkishotin. Shaqir Fetai nuk ka program të vetin! Shaqir Fetai nuk ka projekt të avansimit i cili do të ngritej mbi projektin e reformave të parapara në BFI! Nuk i ka, sepse do t'i publikonte, siç i publikon fotografitë me qytetarë të rëndomtë që i fton për çaj e i publikon si urues e përshëndetës të postit të tij tepër shumë të diskutueshëm!

*(Telegrami, 24.0. 2021)*

## Kur të uron injoranti

Ishte martuar Qazimi pas festës së bajramit. Tre ditë rresht për Bajram e përsëriste të njëjtin refren me rastin e urimit të bajramit! “Hajër paçi, për hajër edhe juve”! Nën këtë inercion të urimit, pasi u martua Qazimi, kur i thoshin shokët: “A kokshe martu Qazim, a! Për hajr nusja!” Qazimi ua kthente: “Hajër paçi! Për hajër edhe juve”!

Edhe Shaqir Fetai si Qazimi! Paramendoni – uron organizimin e ceremonisë së inagurimit të Presidentit Amerikan! Uron aktin ceremonial! A ka më injorancë, a ka më budallallëk, a ka më idiotizëm se sa të uroshë akt ceremonial! Urohet zgjedhja, urohet emërimi, por jo dhe akti ceremonial. Cili në botë uron aktin e inagurimit?

Shaqir Fetai i shkruan ambasadorës amerikane në Shkup: “Me kënaqësi të veçantë kemi ndjekur organizimin e ceremonisë së përrurimit të Presidentit Joe Biden...”

Prandaj, është nderi im të përgëzoj Shkëlqesinë Tuaj dhe të gjithë Qytetarët Amerikanë, në emrin tim dhe në emër të të gjithë anëtarëve dhe institucioneve të Bashkësisë Fetare Islame në Maqedoninë e Veriut, për inaugurimin e Presidentit Joe Biden...

Ne besojmë se Presidenti Biden do të vazhdojë të promovojë paqen, tolerancën dhe demokracinë në të gjithë botën.”, përfundon urimi i Shaqir Fetait, me rastin e organizimit të aktit ceremonial të inagurimit!

Shaqir Fetait duhet t’i përkujtohet që, kur Presidenti Bajden angazhohej për paqe, tolerancë dhe demokraci në Kosovë, kur angazhohej për t’i shpëtuar shqiptarët nga planet serbe, Shaqir Fetai sa kishte pas nisur me i shërby shkinisë duke u bërë si nxënës i zellshëm i oficerit të UDB-së serbe, Stanko Dragoviqit! Kshtu që, ky urim i Shaqir Fetait, jo që është vetëm budallallëk dhe idiotizëm por edhe ironi e llojit të vet. Armiku i dikurshëm uron Presidentin e sotshëm!

*(Lajmi7, 25.01.2021)*

## Marioneta me emrin Shaqir Fetai

**Shaqir Fetai e kaloi gati një vit duke pritur e përcjellë, duke ftuar mysafirë e publik, vetëm që t'i shprehin ndonjë urim. Kjo e kënaq marionetën, e bën të “maaadh”, e bën të ndjehet vetja e vet, e bën të ndjehet i çliruar nga penjtë që i mbanë artisti profesionist në duart e veta. Shfaqje atraktive dhe kreative për fëmijët**

**Nga Haxhi Isa Xhaviti**

Me fjalën marionetë gjithnjë kuptohet ushtari i thjeshtë, i cili nisët për në luftë pa kurrfarë qëllimi, synimi, plani. Thjesht, kjo është kompetencë e “eprorit” ndërsa marioneta duhet të futet në lufë që të vritet, ta hajë e të përfundojë duke u kalbur në dhe!

Me fjalën marionetë kuptojmë edhe kukullat prej druri, apo edhe prej kashte, të lidhura me fije peri që janë të kapur për gishta të duarve të akrobatit, aktorit, i cili, ashtu, siç i lëvizë gishtat, lëvizë dhe gjymtuyrët, kokën, trupin e marionetës.

Pra, marioneta është pa tru, pa vetëdije, pa mend, thjesht, një copë druri, një copë lecke, një copë mishi pa fiqir! Marioneta urdhërohet, dhe, lëvizjet i duken atraktive sepse i kryen sipas urdhërit fizik, sipas lëvizjes së gishtave, lëvizin edhe ata, pa kurrfarë vetëdije.

Tani, marionetat prej mishi, ata që na duken si njerëz, atyre u mungon intelekti, u mungon aftësia e të menduarit, u mungon synimi, qëllimi, plani. Marionetat prej mishi janë nën urdhërin absolut të “kujdestarit” të tyre, urdhërdhënësit apo punëdhënësit, nën diktatin e eprorit të tyre.

Se si duket, në mënyrë plastike dhe konkrete një marionetë prej mishi, mjafton të shikohet Shaqir Fetain! Edhe CV-në e tij, edhe historikun e zhvillimit të tij, edhe veprimet e tij, edhe logjikën e tij të budallakafë, edhe “margaritarët” e tij prej të pamendti. Hafëz i bukur por i palogjikë, hoxhë ”i madh” si fiziku i tij! T’i thuash që i ka dy gramë mend, është droje se do ta ofendoshë, sepse ai që nuk ka fare, është mësuar me atë gjendje dhe nuk do që ta vlerësoshë më ndrshe, thjesht, i pamend, këtu e gjenë kënaqësinë, këtu e gjenë rehatinë e tij shpirtërore.

Marioneta me emrin Shaqir Fetai gjithnjë ka pasur familje, tani ka dhe familje të ngushtë, ka shoqëri e miqësi, nuk është i vetmuar, por ka ngelur pa motivim, pa frymëzim, pa ide pa temë, pa inatin njerëzor. Fare nuk i vjen inatë prej kjoeficientit të vet intelektual i cili nuk është më i madh se qeni i Xhorxh Bushit (i Shaquas 84 IE, i qenit të Bushit 85 IE).

Shaqir Fetai, nëdonëse është me ndërtim prej marionete, ai nuk do të duket i tillë, do që të jetë aktiv, të lëvizë vetë, prandaj, i vie komanda për lëvizje, lëvizë gishti, lëvizë Shaqir Fetai dhe vazhdon edhe më tej instiktivisht ajo lëvizje. Kështu ka qenë gjithmonë Shaqir Fetai.

Bëhu hafiz, ai është bërë hafiz, luaje spiunin, ai është bërë nxënës i oficerit të UDB-së, Stonko Dragoviqit. Pastaj, ka lëvizur Sulejman Rexhepin gishtin e madh të dorës dhe ai është bërë profesor medrese, pastaj ka lëvizur gishtin tregues e ai është bërë drejtor i sektorit për çështje fetare, pastaj Sulejman Rexhepi ka ngritur gishtin e mesëm e Shaqir Fetai është bërë myfti, ka lëvizur gishtin e unazës e Shaqua na është bërë nuse në Rijaset, në fund Sulejman Rexhepi e dridhë gishtin e vogël të dorës e ky na bëhet “reis”!

Pra, një jetë të tërë ka kryer lëvizjet e kushtëzuara të marionetës. Vetë, të thuash, karrierë nuk ka mundur të bëjë, sepse, cila marionetë ka arritur diçka përveçse pluhrosjes apo kalbjes së vet!

Marioneta prej mishi, gëzohet, madje çmendet nga gëzimi kur i flet dikush, kur e përshëndet ndonjë kalimtarë i rastit, kur e uron apo e përgëzon në rol apo në mision artistik ndonjë që futet në “teatër” sa për t’u çliruar nga sikleti i shurrës!

Prandaj Shaqir Fetai e kaloi gati një vit duke pritur e përcjellë, duke ftuar mysafirë e publik vetëm që t’ia shprehin ndonjë urim. Kjo e kënaq marionetën, e bën të “maaadh”, e bën të ndjehet vetja e vet, e bën të ndjehet i çliruar nga penjtë që i mbanë artisti profesionist në duart e veta.

Marioneta nuk di se çka është teatri, nuk di se çka është muzeu, nuk di se çka është arkivi, nuk di se çka është skena e hapur, thjesht, nuk di asgjë. Ai nuk di ta dallajë projektin nga objekti, nuk di ta dallojë gërmadhën nga pamja tredimensionale. Prandaj, shkon dhe me krenari publikon “Objektin tredimensional” duke engatërruar me “projektin” e vitit 2021 të Myftinisë së Manastirit.

Projekti është “një vepër e shkruar”, me studimin narrativ, me planin financiar, me synimin, qëllimin, rrjedhshmërinë, objektivat, pritshpëritë, në detale, çdo gjë! Kurse objekti i fotografuar ngelë vetëm “produkti final” se si do të duket. Produkt i një projekti, dhe jo projekt i një objekti! Këto gjëra i ngatërron vetëm marioneta, e cila i bie shkurt sepse nuk di t’i elaborojë gjatë, del me fotografi të objektit sepse subjekti i projektit për Shaqir Fetain është shkencë e paarritshme, sepse, nuk i ka “oficerët” që do t’ia mësojnë projektin, sepse i ka “oficerët” që këmbëngulin ta mbajnë përjetë MARIONETË!

*(Lajme7, 27.01.2021)*

## Shaqir Fetai e ka debolesë “informimin”

**Shaqir Fetai, pushtusi i dhunshëm i BFI-së falë përkrahjes dhe shtytjes nga pushtetimaqedonas, paska pritur për urime dhe përshëndetje një zëvendësdrejtor e një afarist, do aktivistë shqiptar “anekënd trojeve etnike”(!!!) e do hoxhallarë nga Shqipëria, të cilët qenkan ndarë të kënaqur nga informimi i “pushtuesit” për “programin” e vet dhe për perspektivën e këtij Institucioni. Shaqir Fetai është mësuar t’i informojë të tjerët, sepse këtë aktivitet e ka debolesë qysh si student në Sarajevë**

Cili është ai mesazh që po na e përcjell Shaqir Fetai përmes “praktikës së shenjtë” të tij, në pritje të turlifarë mahluki për t’ia uruar këtij postin “reis” të caktuar nga pushteti maqedonas si dhe për t’i “informuar” të gjithë ata me “programin” dhe me “planet” e tij për të ardhmen e BFI-së?! Po, ka një mesazh konspirativ: Shaqir Fetai përpiket të na dëshmojë se atë e duan të gjithë, se ai nuk urrehet, se ai kurrë nuk ka qenë i keqi, rrjedhimisht, ai është “shpëtimtari”!

Shaqir Fetai, me gjasë, edhe në djep ka qenë i keq, i përkundur për prapështira e për idiotizma, për informator e për tradhëtira (ka tradhëtuar “babain” e vet shpirtëror me pamje markante!). Shaqir Fetai është njeriu më i urreyer prej të gjithë shqiptarëve, anakënd trojeve shqiptare. Shaqir Fetai mund të bashkëpunojë vetëm me ata të cilët dikur i shpallte (bashkë me reisin e vet) si “filiale të UDB-së maqedonase!

Shaqir Fetai paska nevojë që të presë sa më shumë njerëz dhe të gjithëve t’ua elabrojë “programin dhe planet” e veta për të ardhmen e BFI-së?! Planet dhe projektet e Shaqir Fetait tashmë u dëshmuar – ta shkatërrrojë deri në themel Institucionin e BFI-së! Veprimet dhe hapat antikushetuese, duke shkelur aktet normative të BFI-së, flet qartë se cili është misioni i Shaqir Fetait. Shaqir Fetai është si ai bajlozi i zi, i cili, tërë punën e tre vëllezërve që e bënë gjat ditës, natën dilte bajlozi dhe ua shkatërronte!

Po pse lodhet Shaqir Fetai me të tilla urime e përshëndetje! Pse lodhet duke ua zbërthyer “programin e vet”? Le ta botojë, le ta nxjerrë në publik dhe të ifnromohet mbarë opinioni se cili qenka programi i tij! Natyrisht, nuk e ka! Të gjithëve ua tregon “programin” kurse hala nuk e ka parë “Rijaseti” i tij! Të gjithëve u raporton për “programin e vet”, ndërsa ka suspenduar organin kryesor – KUVENDIN! A e ka mbledhur Kuvendin e BFI-së, a i ka raportuar kuvendarëve, a ua ka prezantuar programin kuvendarëve, a ua ka treguar nevojat buxhetore për atë “program” dhe a ia kanë miratuar buxhetin, sepse për këtë punë është Kuvendi? Natyrisht, që nga qershori i vitit 2018 deri më sot nuk është mbledhur akoma Kuvendi i BFI-së.

Shaqir Fetai, e ka shndërruar BFI-në në odën e vet personale ku pret e përcjll njerëz që urojnë e përshëndesin! E kryen këtë veprim se, realisht e ndjenë që po urrehet nga qenia kombëtare, arsyen e di vetë ai! E kryen këtë veprim sepse, nuk di veprime të tjera, nuk di se çka të bëjë, është i shantazhuar deri në palcë, nuk ka ide, nuk ka vizion, është mësuar që të urdhërohet, të marrë detyra e porosi, është mësuar të punojë vetëm sipas strategjisë së urithit! Në BFI ka bërë karrierë si cung, mendjen e ka pasur gjetkë! Ai po pret dhe po përcjell, sepse nuk po i vinë direktivat se çfarë të bëjë, sepse, ata që e sollën aty, nuk kanë kohë të merren me Shaqir Fetain; ata që e sollën aty i kanë thënë që, prit e përcjell, deri sa të lirohemi nga zgjedhjet lokale dhe, mbase edhe zgjedhjet e parakohëshme; shtyeje me pritje e përcjellje, derisa të bindemi se e meriton të të dirigjojmë, varësisht kontributeve të tua partiake! Shaqir Fetai urrehet prej katundit të vet, prandaj dhe politikisht humbi aty në zgjedhjet e



fundit! Shaqir Fetai është vetëm një skuth i ndërkryer dhe asgjë tjetër. Sikur e tërë bota të rreshtohet para “odës” së tij në pritje për ta përshëndetur dhe uruar, kjo nuk ia rritë vlerat atij, sepse, qysh herët i ka këmbyer me Stanko Dragoviçin, pastaj ia ka falur Temelko Boshkovskit. Është plotësisht i pavlerë. Allahu i Gjithëdijshtëm, për një si Shaqir Fetai që e shkelë Kushtetutën e cila bazohet në parimet islame, në ajetin 5 të sures El Xhumu’a, thotë: **“... i shëmbëllen gomarit, që vetëm sa i mbart librat...”**

*(1Kliklart, 28.01.2021)*

## Shaqir Fetai si “institucion” i talljes

**Me paratë e grumbulluar nga pagesa e kurbanëve që nuk janë therrur asnjëherë, Shaqir Fetai duhet t’i qerasë me çaj e kafe, me llokuma e me lëngje, me dreka nëpër restorante më të shtrenjta të vendit, të gjithë ata që vijnë me ia shprehur urimet dhe përshëndetjet për caktimin e tij si “reis” nga pushteti aktual maqedonas**

### *Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI*

Hoxha i nderuar i Matejçit, Enver ef. Azizi, paska shtruar një pyetje publike duke i pyetur strukturat përkatëse të BFI-së se, pse, edhe pas tridhjetë viteve, Medresja “Isa Beu” edhe më tej mbetet e paakredituar. Do me thënë, kritikohet shteti e pushteti se, si ka mundësi që mos ta pranojnë Medresenë si shkollë të mesme shtetërore po, e lënë si të pavarur me diploma të papranueshme për fakultetet e ndryshme të universiteteve të shumta që i kemi.

Vërtet pyetje me vend. Vërtet vërejtje me vend për Institucionin e BFI-së. Megjithatë, duket si pyetje e thatë, si pyetje që shpalosë vetëm një të vërtetë, ndërkohë që ky problem ka edhe anën tjetër të të vërtetës.

### **Akreditimi i Medresesë do të thotë ikje e Shaqir Fetait nga BFI-ja**

Pse shteti dhe pushteti nuk e pranon Medresenë Isa Beu ndërsa pranon, insiston dhe këmbëngulë që të përzihet dhe ta pushtojë Kryesinë e Bashkësisë Fetare Islame. Nuk e do Medesenë por e do të parin e BFI-së, e do parinë e këtij Institucioni! Nuk t’i pranon diplomat e Medresesë por t’i pranonë veprimet konspirative të të parit të BFI-së! Nuk ta akrediton Medresenë por ta regjistron në daç si “ushtrues detyre reis” (post ky që nuk ekziston dhe nuk parashihet me Kushtetutën e BFI-së) në daç ta regjistron “reis apo kryetar” personin ilegjitim, të pa denjë për këtë post dhe që i shkel të gjitha aktet normative të BFI-së, duke e lënë Institucionin pa dinjitet e pa integritet!

Me instalimin e të parit të vetë pushtetit në krye të BFI-së ta amortizon luftën e pushtetit për të mos e njohur Medesenë dhe për të lënë një “ushtri” të tërë nxënësish (sidomos të gjinisë femërore) në gjysëm të rrugës së shkollimit.

I pari i pushtetit i instaluar në BFI kurrë nuk do ta kërkojë akreditimin e Medresesë, sepse akreditim nuk do të thotë vetëm pranim të diplomav, por edhe menaxhim, përkujdesje dhe detyrime shtetërore ndaj kësaj vatre mësimore fetare. Ta imponon programin shkollor, por edhe t’i kontrollon burimet njerëzore, ta cakton numrin e profesorëve dhe pagat e tyre. Atëherë, ç’kuptim do të kishte propaganda grabitçare “jepni fitra, jepni zeqat, therrni kurbanë dhe falne lëkurën e kurbanave për mirëmbajtjen e Medresesë)? Në fakt, duhet t’u merret Medresja, sepse kjo vatër mësimore tash e sa kohë hajdutëve po u shërbenë si karrem për të ardhur deri te paratë e popullatës së myslimanëve dhe për t’i vjedhur për vete. Kërkohen kurbanë për Medrese, ndërsa asnjë medresant nuk e ka hëngër për këto dy vite

një gram të mishit të kurbanëve!

Apo, paratë e grumbulluar nga pagesa e kurbanëve që nuk janë therrur, Shaqir Fetai duhet t'i qerasë me çaj e kafe, me llokuma e me lëngje, me dreka nëpër restorante më të shtrenjta të vendit, të gjithë ata që vijnë me ia shprehur urimet dhe përsëndetje për caktimin e tij si "reis" nga pushteti aktual maqedonas.

### **Dhimbja e shtirur e Shaqir Fetait**

Paska vdekur hoxha i mirënjohur i fshatit Orizare H. Mahir ef. Jashari. Allahu e shpërbleftë me të gjitha të mirat e Veta, kurse familjes ia shtoftë sabrin! Të gjithë miqtë, dashamirët dhe shokët e tij ishin në varrim, e nderuan ia kënduan fatihanë e fundit dhe u ndanë prej tij me kujtimet më të ëmbla, si pjesëtarë të famijes, si miq, si shokë. Kurse, "reisi" që kënaqet kur të vdesin të njohurit e tij, sepse ka mundësinë ta shpreh ndonjë ngushëllim e ta mbajë ndonjë fjalim havadyz, në këtë ceremoni varrimi mungoi, nuk i erdhi, por, u mjaftua me një "letër ngushëllimi", në të cilën ky farë "reisi", veç të tjerash, shkruan: "Me dhimbje mësuam për ndarjen e hoxhës së mirënjohur, mikut tim, H. Mahir ef. Jashari, imam në fshatin Orizare komunës së Likovës, nga jeta e kësaj bote. Shpreh ngushëllimet më të sinqerta, në emrin tim dhe në emër të Bashkësisë Fetare Islame me të gjitha institucionet dhe organet e saj..." Me çfarë guximi i jep vetes të drejtë Shaqir Fetai që të tallet me një hoxhë të ndershëm! Si nuk i vie turp faqeziut që të shpreh ngushëllime në emër të diçkafit që nuk ekziston, që e shkatërroi vetë! Si guxon merhumit t'i thotë "miku im", i cili është trishtuar deri në palcë kur ka mësuar se "miku i tij", S. F., paska qenë nxënës i oficerit të UDB-së, Dragoviqit.

Shaqir Fetai e shkatërroi BFI-në, e ka degarduar deri në palcë me shkeljen e mbi gjysmës së nenev të Kushtetutës së kësaj BFI-je, me mohimin, shuarjen dhe me talljen e organeve të saj; si guxon që në emër të diçkaje inegzistente ta ngushëllojë dikë? I pafytyri e bën edhe këtë gjest, e kryen edhe këtë veprim, sepse nuk ka asnjë gram dhimbje, asnjë gram trishtim, asnjë gram gjynah e respekt ndaj parimeve islame.

Shaqir Feta është mjeshtër në shtirjen e tij, fundja, ai e ka manipuluar një doganë të tërë të Turqisë, duke e ngrehur këmbën zhag "astah, astah" vetëm e vetëm që mos të presë në rend! Manipulator i skasjeshm! Ai ka fytyrë që mbarë opinionin e vendit ta manipulojë duke ju thënë se është "reis"! Myslimanët, sidomos jo ata shqiptarë myslimanë, kurrë nuk kanë pranuar që i njëjti person të jetë edhe "reis" (udhëheqës) i tyre edhe udbash! Të tillëve ua kanë të kërlitur shallin si rrotë karroce për plehëra.

*(1Kliklarg, 30.01.2021)*

## Keshilli KMK / Skandaloze: Shaqir Fetai vazhdon me kokëboshësi

**Shaqir Fetai e paska vizituar Myftininë e Gostivarit dhe sipas tij, qenka mahnitur me “rezultatet” e kësaj Myftinie për vitin 2020, ndaj paska vendosur që këtë myftini ta bëjë me myfti. Me aklamacion qenka vendosur që myfti të propozohet i njëjti që është ushtrues detyre! A është në vete Shaqir Fetai apo jo! Ka vendosur që ta stabilizojë apo ta shkatërrojë tërësisht BFI-në. Me shkelje të vazhdueshme kushtetutare vetëmsa mund të shkatërrohet BFI-ja**

### *Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së*

Shaqir Fetai, “reisi” i instaluar nga pushteti aktual maqedonas, paska vizituar Myftininë e Gostivarit, me çrast qenka mahnitur nga llogaria përfundimtare dhe nga buxheti i Myftinisë për vitin 2020, në vitin më në krizë për mbarë njerëzimin në botë! Është i vetëdijshëm se çka flet ky shërbëtor i politikës dhe pushtetit maqedonas apo ka vendosur ta shkatërrojë tërësisht BFI-në!

Me këtë rast, na thotë Shaqir Fetai, i cili me vete e paska marrur edhe “kryetarin e komisionit zgjedhor” të BFI-së, sepse, paska vendosur që ta zgjedhë edhe myftiun e Gostivarit! Si shumë raste tjera, edhe në këtë rast Shaqir Fetai, me plotë vetëdije vendosë që ta shkelë e ta bëjë paçavurë Kushtetutën e BFI-së! A ka pak insaf, a ka pak drojë Zotin, a ka pak iman ky farë “hëfëzi”! Si guxon të sillet në këtë formë! Aka Kushtetutë BFI-ja apo nuk ka? Si funksionojnë komisionet dhe si vendos komisioni? A iu tërheq vërejtja për shkeljet shekullore të Shaqir Fetait që ia bën Kushtetutës së BFI-së apo jo? As laicizmi, as pushteti laik e komunist nuk ia ka bërë këto shkelje, nuk e ka poshtuar kaq shumë BFI-në sa Shaqir Fetai! A ka kush i del përpara dhe i thotë STOP duke e mbyllur në burg si mohues absolut i të gjitha normave kushtetutare, ligjeve, dhe akteve juridike të vendit e të Institucionit të BFI-së!

A u konsultuan anëtarët e Myftinisë me Mexhlinin e Xhematit se cilët duhen të jetë kandidatë potencial apo këtë të drejtë ia deleguan Shaqir Fetait?

Si e zgjedh vetë Shaqir Fetai, njeriun intim të tij, për Myfti! Ai mund të jetë gjeni, më i devotshtmi në vend e më gjërë, megjithatë, ka Kushtetutë, ka akte normative që vlejné edhe për të. Ai person, nëse është i devotoshëm, e refuzon qëndrimin udbashesk të Shaqir Fetait dhe insiston në zgjedhje konform Kushtetutës. Asgjë nuk do të thotë fakti që ai paska pasur me vete “kryetarin e komisionit zgjedhor”, sepse ai për zgjedhjen e myftiut është një “subjekt” zero! Ai e keqpëdorë atë, sepse personi “kryetar” është në gjendje që për një kockë të vogël të pranojë çdo propozim, sepse, ai e di fare mirë që nuk është kompetent për këtë veprim të Shaqir Fetait, prapa të cilit mundohet të fshihet. Anëtarët e Myftinisë duhet të konsultohen me bazën, të propozojnë, më së paku, dy anëtarë për myfti të mundshëm (nuk ka një, qoftë ky edhe me aklamacion, sepse kjo i ngjetë periudhës komuniste dhe është në kundërshtim me Kushtetutën). Pas këtij propozimi, vendos Rijaseti, dhe jo një injorant, se kush do të emërohet për Myfti, ndërsa Shaqir Fetai, si “reis” i caktuar nga pushteti maqedonas, vetëm do ta verifikojë personin dhe do t’ia lëshojë muraselen. Ky është rregulli si zgjidhet Myftiu, dhe jo

sipas tekeve të Shaqir Fetait.

Personi në fjalë mund të jetë myfti vetëm sa të jetë i përkrahur nga pushteti maqedonas Shaqir Fetai. Ne moment që do ta humbë përkrahjen maqedonase Shaqir Fetai, edhe personi i caktuar prej tij, myfti, do ta humbë këtë titull, siç do të humbin tituj të gjithë të tjerët të zgjedhur jashtë kushteve kushtetutare, sipas qëndrimeve policore të Shaqir Fetait. Shaqir Fetai në historinë e BFI-së do të ngelë si shkelësi më i madh i Kushtetutës së BFI-së si dhe personi që maksimalisht është angazhuar ta shkatërrojë BFI-në por që Allahu Fuqiplotë nuk do t'ia plotësojë këtë dëshirë të poshtër, por, natyrisht, do t'ia thyej qafën! AminAllah!

*(Botasot, 1.02.2021)*

## Shaqir Fetai gënjenë “institucionalisht”

**Janë të patolerueshme gënjeshttrat dhe servilizmi i poshtër i Shaqir Fetait karshi vizitorëve të brendshëm e të huaj, të cilët, nuk kanë kurrfarë pune dhe obligimi tjetër përveçse t’ia urojnë “detyrën e re”, t’i shprehin përsëritje dhe urime të mjerit! Ose, të paktën, të huajt, po e kryqëzojnë mirë Shaqir Fetain, por, ky ose nuk i kupton mesazhet diplomatike ose edhe qëllimisht i keqinterpretton. Gebelsi, këtë punë kishte: t’ia bëjë “parajsë ” veprat Hitlerit**

**Nga Sabit Ibrahimimi**

Shaqir Fetai paska pritur diplomatë të huaj dhe që të gjithë i paskan shprehur mirënjohje për mënyrën e udhëheqjes së BFI-së. Do me thënë Shaqir Fetai po e bën “fet” dhe për këtë ka mirënjohje të shumta nga ndërkombëtarët. Shaqir Fetai qenka i suksesshëm sidomos në luftën dhe në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe “terrorizmit islamik”!

Shaqir Fetai, me veprimet e veta anarkike dhe shkatërrimtare, nuk po bën asgjë tjetër përveçse po ngrit baza për një ekstremizëm institucional, i cili po instalohet ngadal por sigurtë në BFI. Shkelësi i dhjetra neneve si dhe i normave më të larta juridike të BFI-së, nuk mund të pretendojë se po e ngrit një “institucion” fetar me plotë tolerancë e bashkëjetesë!

Shaqir Fetai po e institucionalizon dhe po i ndihmon strukturave të caktuara të pushtetit (që nuk ia duan të mirën BFI-së) që të institucionalizohet ekstremizmi dhe radikalizmi! Regjistrimi i “instituteve të ekstremizmit” që po mbijnë si kërpudha pas shiut dhe mosreagimi adekuat kundër ekstremizmit ortodoks që po e minon paqen në vend, në fakt, flet për një bashkëpunim të ngushtë të Shaqir Fetait me këta segmentë të pushtetit të cilët, si kundërshtëpërblim, ia dhuruan dhe po ia ruajnë postin e “reisllëkut”! Kur pushteti të bën “reis” kjo nuk do të thotë se je i suksesshëm por, se je segment i pushtetit, bashkëpunëtorë, dhe kur merresh me akte subversive në një institucion të rëndësishëm, si BFI-ja, kjo do të thotë se je palë me djallin!

Si po e luftuaka Shaqir Fetai me sukses ekstremizmin dhe radikalizmin islamik në vend?! Kohë më parë në Kumanovë dhe në Shkup, celulata e formuara në kohë të Shaqir Fetait, celulata e radikalizmit dhe terrorizmit, i kapi policia e shtetit dhe nuk i kapi Shaqir Fetai! Apo, i dinte Shaqir Fetai dhe i paraqiti në polici, ndaj dhe nuk ngurron që t’ia përshkruajë vetes meritat! Dëshiron jarani që këtë aksion ta llogarisë si të përbashkët, në mes tij dhe policisë!

Shaqir Fetai paska merita të mëdha për tolerancën dhe bashkëjetesën ndërfitare në vendin tonë! A e di Shaqir Fetai se çka është tolerancë e çka bashkëjetesë! A di të na e shpjegojë, apo, për të, si fjala e parë ashtu edhe e dyta, janë të njëta.

Toleranca në vetëvete ka edhe elementë të nënshtrimit, të kapitulimit, të dështimit, të pajtimit me shkeljet, diskriminimin, racizmin, fashizmin etj. vetëm e vetëm për hirë të paqes të atij që nuk është tolerant. Bashkëjetesa ka elementet e pajtimit për ruajtjen e paqes.

Ose, më shqip sepse, vështirë që mund ta kuptojë Shaqir Fetai! Tolerancë është të heqësh dorë nga insistimi për ta ringritur Xhaminë në Prilep, në Llazhec, Burmalin Xhaminë! Do me thënë, popullata otodokse është këmbëngulëse në këtë qëndrim, ndërsa ti, si popullatë myslimane e dëmtuar, e toleron këtë qëndrim antisialmik vetëm e vetëm që “ujkut mos t’i turbullohet uji”! Bashkëjetesë është kur

t'i ankoresh pandërprerë për një të padrejtë ndërsa, ai që ta ushtron padrejtësinë, më në fund, vendos që t'i plotësojë të gjitha kërkesat e tua të arsyeshme, sepse, mbi çdo gjë, më e mira dhe më njerëzore është paqja!

Shaqir Fetai tash e një vit gati, vetëm ka pritur e ka përcjellë përshëndetës dhe urues të kotë, nuk ka pasur kohë të merret as me tolerancë dhe as me bashkëjetesë. Tash e një vit gati vetëm ka bërë propagandë për politikat shtetërore maqedonase të cilat duhet të shpërblehen me inkuadrim në BE dhe në NATO! (A jemi a jo pjesë e NATO-s?!) Pse Shaqir Fetai po e hesht dhe nuk po e reklamon publikisht dëshirën e flaktë të myslimanëve të Maqedonisë për ta ndërtuar “funksionin” momental të Xhamisë së djegur të Prilepit, nga nevojtoje publike në Shtëpi të Zotit, që është e shenjtë për myslimanët, ku nga pesë herë në ditë vëllazërisht i luten të Madhit Zot për të gjithë të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër, për mbarë njerëzimin!

A është ankuar ndonjëherë Shaqir Fetai për tendencat e përhershme të pushtetit maqedonas që në krye të BFI-së të ketë vegla të veta, ndërsa t'i eliminojë të gjithë ata që angazhohen për faktorizimin e BFI-së në përpjekje për të siguruar paqe e bashkëjetesë, të cilat, nga ana tjetër, nuk mund të sigurohen duke i futur nën plaf, siç po i futë Shaqir Fetai, por duke i luftuar dukuritë negative, qofshin këto edhe politika shtetërore.

Ndërkombëtarët tashmë e kanë të qart se Shaqir Fetai nuk është asgjë tjetër përveçse një demagog dhe hipokrit i përkryer, ndaj dhe dëshirojnë që ta takojnë dhe praktikisht të binden për këto vlerësime që nuk i luan as topi!

Edhe vetë ata po ndihen në siklet kur po i lexojnë se si po i “propagon” Shaqir Fetai këto takime! Në kohë paqe, a ka më radikalizëm se sa “parcializimi” i Institucionit që është i kategorisë kushtetutare, i nënvizuar edhe në Kushtetutën e Shtetit, duke të “institucionalizuar” dhe duke t'i pranuar shtetërisht “simotrat” tua që nuk janë asgjë tjetër përveçse antiislamizëm! E kupton Shaqir Fetai këtë problem, apo, i vetmi problem i tij është si të gënjejë sa më shumë “institucionalisht”! Kur të plasë cipa e turpit, të vjen lezet edhe katranosja e fytyrës!

*(Politesa, 2.02.2021)*

## Të gjitha angazhimet e Shaqir Fetait për ta shkërmoqur BFI-në

Në një status të vetin, ish-reisul Ulema i BFI-së, Sulejman ef. Rexhepi, kishte shkruar mbi një trend të frikshëm të parcializimit të Institucioneve fetare përmes regjistrimit të bashkësive të reja fetare si dhe të grupeve religjioze. “Nga 1 Bashkësi islame dhe 2-3 grupe religjioze që kanë qenë, tani janë 3 bashkësi islame dhe 12 grupe religjioze”, shkruan ef. Rexhepi.

### Nga Mr. Eset Shaqiri

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhe në Ligjin për pozitën juridike të kishës, bashkësive fetare si dhe grupeve religjioze, (Neni 2 i këtij Ligji), këto bashkësi fetare dhe grupe religjioze, janë bashkësi vullnetare të personave fizikë, të cilët, përmes besimit të tyre fetar si dhe burimeve të mësimave fetare përkatëse, të bashkuar sipas besimit dhe idenitetit realizojnë lirinë e tyre për mësimbesimin fetar, duke e shprehur këtë përmes lutjeve, dhe riteve fetare të besimit përkatës.

Neni 1 i Kushtetutës së BFI-së, Bashkësinë Fetare Islame e definon kështu: “Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë është organizatë e vetme e cila organizon jetën fetare të muslimanëve në Maqedoni dhe mërgimtarëve të përkohshëm jashtë vendit. BFI veprimtarinë e vet e mbështet në Kur’an, në Sunnet, në këtë Kushtetutë dhe në aktet normative që dalin nga e njëjta... Në zbatimin e detyrave islame, në fushën e ibadeteve, BFI aplikon Shkollën juridike hanefite.”

Nisur nga këto fakte, të cilat janë edhe norma juridike, para të cilëve kanë detyrime dhe përgjegjësi të gjithë qytetarët e vendit, pavarësisht se çfarë veprimtarie ushtrojnë, çdo përpjekje, kryesisht politike, për të regjistruar bashkësi apo grupe religjioze që i kanë këto karakteristika, në fakt paraqet tendencë për ta shkërmoqur e për ta fraksionuar deri në shkatërrim BFI-në, e cila ka dëshmuar stabilitet dhe ekzistencë mbi gjashtëshekullore, duke demonstruar rol, mosnënshtrim, përgjegjësi dhe detyrime para besimtarëve të vet si dhe vetëdije të lartë para lojërave të pushteteve që gjithnjë i ka konsideruar si relative, si diçka që vijnë e shkojnë. Ngelë vetëm besimi, lutjet dhe bindjet e patundshme fetare.

Bashkësia Fetare Islame kurrë nuk ka qenë kundër grupeve religjioze, kurrë nuk ka qenë kundër shoqatave joqeveritare që kanë ushtruar aktivitete fetare, kurrë nuk ka qenë kundër shkollave juridike fetare, por edhe kurrë nuk ka toleruar që trangu i vet fetar, i shkollë Hanefite, të bëhet thërrimathërrima dhe të humb rolin e vet të shenjtë, besimin në Allah e jo në puta e simbole të kota!

Bashkësia Fetare Islame në RMV, si Institucion i besimtarëve islam që i përkasin shkollës juridike Hanefite, duke e kultivuar islamit mbi gjashtëshekullor në këto hapësira, ka arritur që të ketë objektet e veta për lutje, siç janë xhamitë e mesxhidet, ka arritur të ketë vakëfin e vet, varrezat, ceremonitë fetare të lindjes, të varrimit, mënyrën e lutjes dhe faljes së namazeve. Do të ishte katastrofë e madhe për këtë Institucion nëse do të heshte dhe do të lejonte që turlifarë mahluki, me mision nga “shkolla” prej nga vjen, me detyra konkrete përçarëse dhe destabilizuese, të tolerojë që të futet pyka e përçarjes fetare dhe kombëtare, vetëm e vetëm që t’i justifikojnë financat e pista që individë të caktuar i marrin nga “shkollat” e tyre që fund e krye janë të ideologjizuar. Këto “tolerime shtetërore” në fakt janë keqinterpretim të qëllimshëm të akteve juridike, janë “strategji shtetërore” për t’i shantazhuar bashkësitë fetare, janë politika për t’ua drobitur forcën dhe fuqinë që e kanë komunitetet e caktuara



fetare që funksionojnë në vend. Veç kësaj, këto akte të shëmtuara të pushtetit dëshmojnë edhe për injorancën e tyre, dëshmojnë për qëndrimet ateiste e antifetare të tyre, dëshmojnë mosnjohje elementare të besimeve fetare. Plotësisht ka të drejtë një individ apo një grup besimtarësh që t'i luten një peme, një guri apo një pellgu me ujë! Por duhet të tregohet se cilës pemë i luten, cilit dru, apo cilit gurë, sepse, bota e tëra është dru, gurë e ujë! Do të përhapet “besimi” i këtyre grupeve se ne jemi qeraxhinjë të drurit, gurit dhe ujit që janë vendlutja e tyre!

Xhamitë tona, varrezat tona, prona jonë, ka një pronar, BFI-në dhe, ato nuk mund të shfrytëzohen nga askush, qoftë ai i regjistruar edhe në Regjistrin Qendror Shtetëror apo në fletoren e Komisionit për pozita juridike të kishës, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze. Ose, shteti qëllimisht u jep hapësirë e objekte, apo ua bën të ligjshëm uzurpimet e objekteve të BFI-së vetëm e vetëm të shkaktojë përçarje e incidente të mundshme.

Bashkësia Fetare Islame në RMV duhet të ngrisë iniciativë për riorganizim të këtij farë Komisioni si trupë qeveritare, i cili përbehet kryesisht nga individë partiakë e politikisht të ngarkuar! Një Komision i tillë do të duhej të përbëhej ekskluzivisht nga përfaqësues të devotshëm të bashkësive fetare të cilat ekzistojnë dhe funksionojnë me shekuj në këtë nënqiell. Këta mund të jenë ata ekspertë që mund të japin propozimin, apo lejen, që kanë kapacitete ta dallojnë qëllimin, synimin dhe “fenë” e gjithësecilit që tenton të regjistrojë bashkësi fetare apo asociacione religjioze. E drejtë e Regjistrimit Qendror të ngelë vetëm regjistrimi i shoqatave joqeveritare dhe jo edhe të bashkësive apo grupeve religjioze për të cilat nuk kanë as kokrrën e haberit!

A mund të ndodhë, për shembull, kjo: Unë jam anëtarë i BDI-së por në këtë Parti dua ta zhvillojë ideologjinë politike të Aleancës apo të Alternativës. Unë jam anëtarë besnik i LSDM-së por dua që në këtë parti ta zhvilloj ideologjinë e VMRO-së!

Pikërisht kjo lojë e strukturave qëllimkëqia po luhet në kurriz të Bashkësisë Fetare Islame. Tani, mëqë kanë “në krye” edhe njeriun e përshtatshëm dhe të gatshëm për rrënim të të vetmit institucion fetar islam në vend, gjithçka e kanë të lehtë dhe të realizueshëm. Me Shaqir Fetain gjithçka është e mundur. Vetëm thuaj “Skopsko”!

*(News33, 2.02.2021)*

## Kur urimet shërbejnë për mallkim

**Shaqir Fetait, i instaluari në krye të BFI-së nga pushteti aktual, tashmë i ka ardhur radha që të përshëndetet dhe urohet edhe nga pjesëtarët e bllokut maqedonas të pushtetit aktual. Ka filluar me Stojanço Angellovin, heroin e gjallë të maqedonasëve në luftë kundër shqiptarëve më vitin 2001, atëherë kur, familja Zyberi e Kumanovës, përjetoj gati po atë tmerr që përjetoj famija e Jasharajve në Prekaz**

Shaqir Fetai e priti dhe i pranoi urimet e përzemërta të Stojanço Angellovit. Kjo vizitë, çuditërisht, përkoj me kalimin në elementin fillestar të të dy personave në fjalë. Duke qenë antishqiptarë e antimyslimanë të pandryshueshëm, që të dyve u paska penguar brohoritja “UÇK, UÇK”, “Shqipëria etnike”, “Shqipëria e Madhe”... Këto brohoritje janë vdekje për “specialcat” e Stojançes, si dhe për udbashët e Stanko Dragoviqit, siç ishte dikur Shaqir Fetai. Sot, dëshmojnë se, që të dy janë po ata antishqiptarë dhe se kurrë nuk ndryshojnë, mezi e presin momentin që të shpërthejnë dhe ta tregojnë antishqiptarizmin e tyre.

Tri-katër dit më parë, shqiptarët organizuan një protestë madhështore kundër rastit të montuar politik, “Monstrës” dhe, këtu situata paska dalur nga kontrolli dhe janë dëgjuar brohoritje të cilat nuk kishin dashur kurrë t’i dëgjojnë as Stojançe Angelovi por as Shaqir Fetai.

Prandaj, sot, pasi Stojançe ia plotëson dëshirën Shaqir Fetait, me urime e përshëndetje për postin e “reislleku”, po ashtu, Stojançe ka pasur edhe një kërkesë: të dalin që të dy, si partizanë antishqiptarë të hershëm, dhe, njëri si “branitell” e tjetri si udbash, t’i dënojnë njëzërit brohoritjet “UÇK, UÇK”, “Shqipëria e Madhe”...

Ky është Shaqir Fetai, i cili, si mosfalënderues e bukëpërmbysës nuk ka respekt as për ish-komandantin e UÇK-së, Ali Ahmetit, që e solli në krye të BFI-së, pa e kuptuar dhelpërinë e tij të stërvitur kampeve të UDB-së.

Ju, shqiptaromëdhenjë, kujdes çka brohorisni se ia prishni rehatinë Shaqir Fetait, i cili i frikësohet tollovitjeve se, elbete, po e shfrytëzon dikush tollovinë dhe po t’ia fut shqelëm bythve Shaqir Fetait e po e shuton drejt portave të ish-kampeve të UDB-së, ku mund të pritët krahëhapur vetëm nga eprori i vet i dashur, serbi Stanko Dragoviq. Lavdi UÇK-së dhe të rënëve për liri!

I paharruar përjetë kujtimi për luftëtarët dhe heronjtë e UÇK-së!

A ka më trishtim dhe më turp se sa të jeshë udbash! Udbashët Zoti i marroftë!

Sa për Stojanço Angellovin e Shaqir Fetain, tjetës do të brohorasim UÇK, UÇK, ne, fëmijët tanë, nipërit, stërnipërit, brez pas brezi, të gjithë do ta kenë këtë amanet si dhe jetësimin e idealeve të të parëve tanë. Stojançe Angellovi e Shaqir Fetai le të dalin e le të na luftojnë, po patën zuzë.

*(Kombetare, 2.02.2021)*

## Reagim i dobët i një hipokriti

**Shaqir Fetai e priti në takim dhe me kënaqësi ia pranoi përshëndetjet dhe urimet Stojanço Angellovit, (“gjeneralit të branitelave”) i cili, është betuar që kurrë nuk do ta ndërrojë bindjen dhe vlerësimin për UÇK-në se, ajo nuk është asgjë tjetër përveç “organizatë terroriste”! Pranohen prej një njeriu të tillë urimet dhe përshëndetjet? Apo, pranohen sepse vijnë prej “Stojçes”**

Lajmi bombastik lidhur me aktivitetin skandaloz të Shaqir Fetait i cili e pret “gjeneralin e branitellave”, Stojanço Angellovit, me të cilin, bashkarisht kanë refuzuar “provokacionet” e shqiptarëve që në mitingun e fundit kanë brohoritur “UÇK, UÇK”, ka prekur dhe ofenduar çdo shqiptar normal! (Ata shqiptarë që janë me pengesa në zhvillim, mund të justifikohen!!!) Pasi lajmi u përhap si rufe anembanë botës shqiptare, pati, po ashtu, reagime të rrefeshme, të cilat, paskan provokuar një reagim të mjerë të Shaqir Fetait, reagim ky që vetëm sa e përforcon tërë atë vlerësim të “reisit” si instalacion i pushtetit aktual maqedonas. Ja pra, disa çilimi me zhvillim të penguar mental ishin ndarë të kënaqur nga ky “reagim” i cili, mbështetet në interpretimin e takimit nga ana e Stojanço Angellovit.

Shaqir Fetai e nisë reagimin e vet duke u lavdëruar se si ua jep ndihmën “BFI-ja institucioneve shtetërore në ballafaqimin sa më të suksesshëm në situata të tilla” (të krizave të ndryshme)! Kur ka ndodhur kjo? Pse gënjen pa pikë turpi Shaqir Fetai? BFI-ja nuk është në shërbim të institucioneve të shtetit por në shërbim të popullatës myslimane. Apo, Shaqir Fetai niset me këtë konstatim nga fakti që, meqë u instalua nga pushteti aktual i këtij shteti, duhet edhe t’ju shërbejë institucioneve shtetërore! Qenka takuar me “komandantin e branitellave”, me armikun e përjetshëm të UÇK- së, të cilën, Angellovit edhe sot e kësaj dite e vlerëson si “organizatë terroriste” e cila shpëtoi nga nofullat e “luanëve” falë amerkanëve! Pse ta takojë pikërisht Shaqir Fetai? Pse, a nuk ka një rrez të tjerë në BFI? Nuk diti apo nuk pati mundësi që ta shmangë këtë takim!

Shikoni se çka thotë Shaqir Fetai në reaimin e vet të pistë: “Gjykimet e montuara dhe në baza etnike apo fetare nuk duhet lejuar të shkatërrojnë fatet e individëve të pafajshëm dhe shoqërisë demokratike në tërësi.” Për këtë konstatim edhe pati protesta, të cilat, Shaqir Fetai i konsideron si “provokacion që duhet dënuar”! Shaqir Fetai thotë: “Prandaj çdo tendencë për të frenuar apo keqpërdorur ato për interesa të ngushta private dhe provokacione është për t’u dënuar.”! Tani, kush është këtu provokacioni për Shaqir Fetain dhe Stojanço Angellovit! Pa dyshim, për këta tipa të dobët, provokacion është brohoritja UÇK, UÇK, brohoritje kjo që kurrë nuk mund të jetë “interes i ngushtë privat”, por krenari gjithëkombëtare, krenari shqiptare që ia prek sedrën vetëm Angellovit!

Shaqir Fetai edhe më tej vazhdon të tregojë se sa kontravers që është, sa i pështjelltë dhe sa fiskulturant behet sa herë që zihet me “pelë për dore”! Sepse, Shaqir Fetai, si nxënës i përjetshëm i oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviq, gjithnjë duhet të mendojë që të dalë nga situata sa herë që të kapet duke vepruar si “ORAO” (pseudonimi i tij policor)! Ja se çfarë thotë në vazhdim të reagimit të pakripë Shaqir Fetai: “Njëherit sqarojmë opinionin se vlerat kombëtare dhe historike, siç është ajo e UÇK-së – Ushtria Çlirimtare Kombëtare – apo organizatave tjera nuk ka qenë dhe as nuk mund të jetë temë bisede e këtij takimi. Tentimi për nxjerrje nga konteksti i një pjese të bisedave të këtij takimi është tendencioz dhe qëllimkeq.” Tani, si mund të të nxirret diçka nga konteksti i bisedës ndërkohë që nuk

është folur e biseduar”? Kjo përpjekje për shpëtim është sikur i atij që është kapur për një fije bari me trup të lëshuar në drejtim të fundit të pusit qindra metërsh të thellë! Thua që Stojançe Angellov të ketë folur mirë për UÇK-në dhe nga konteksti i bisedës ia kanë shtrembëruar vlerësimin!?

Është fakti i pamohueshëm që UÇK-ja e ka dekoruar BFI-në për ndihmesën e pamohueshme që e ka ofruar gjatë luftës në Kosovë. Këtë fakt nuk mund ta mohojë as Shaqir Fetai dhe as Stankot e tij! Stanko-Stojanço është i njëjti emër – mbase Shaqir Fetai ka pasur nevojë emocionale që ta pres Stojçen për t’u çmallur pak, qoftë kjo edhe duke e sharë UÇK-në.

Shaqir Fetai mundohet që t’i tallë do farë “rojtarë” të vlerave kombëtare, siç është UÇK, dhe të përfundojë reagimin tamam me koloritin e hipokritit që e karakterizon atë: “Është fakt i pamohueshëm se UÇK-ja është vlera që ndryshoi statusin politiko- juridik të shqiptarëve po, pse jo, edhe të gjitha komuniteteve tjera në RMV, gjë që rezultoi me nënshkrimin e marrëveshjes ndërkombëtare paqësore të Ohrit e cila u inkorporua në Kushtetutën e RMV dhe hapi rrugëtimin e mirëfilltë reformues drejt integritimeve euroatlantike (BE dhe NATO) të RMV.”

A ia tha këtë fakt Stojançes? A i kërkoi Shaqir Fetai me përlulje Stojanço Angellovit që, meqë ka ndodhur ky realitet politik me shtetin tonë, atëherë hajt ta shohim këtë si meritë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, ta panojmë si nevojë shpirtërore për gjithë qytetarët e Maqedonisë së Veriut që të brohoritet pandarë UÇK, UÇK, UÇK...

Jo se, hidhërohet pushteti aktual e na shkarkon nga “reisllëku”! Më mirë eksibicionist e “reis”, se sa i ngathët e pis!

*(Kombetare, 4.02.2021)*

## Radha e udbashëve për urime dhe përshëndetje te “reisi”

**Populli thotë: “Mos u mundo të lashë m... me sh..., sepse, në të dy rastet, del i pistë, i fëlliqur”**

Pas antishqiptarit me tapi, i cili ia shprehi urimet më të përzemërta sivëllait të vetë, Shaqir Fetait, për ta zbutur këtë turp, si dhe pezmin gjithëpopullor, Shaqir Fetai do t’i ftojë disa “intelektualë kombëtarë” që të vinë dhe ta urojnë, me qëllim që të amortizohet tërë ai mllef kombëtar si dhe t’ia bëjë me dije opinionit se, takimi i tij me Stojanço Angellovit, nuk e ka irituar ajkën e kombit, “intelektualët e mëdhenj”! Shaqir Fetai priti një delegacion me në krye Dr. Havzi Mustafën, kryetarin e “Unionit të Intelektualëve”! Shaqir Fetai duhet të dijë se, kontributi antishqiptar në të kaluarë i dr. Hafvzi Mustafës është disa herë më i madh dhe më i gjatë se ai i Stojanç Angellovit, si dhe i kushëritit të vet (M. F. – nëse do ia publikojmë edhe dokumentin!) Nëse nuk i besohet, atëherë le ta pyes eprorin e vet, ndryshe, shok i klasës së Dr. Mustafës, B. B. nga Kërtçova dhe i tregon se kush ka qenë ky farë “Kryetari i Unionot të Intelektualëve”)

Realisht, në një shoqëri normale, të pastër, në kuptimin e pastërtisë nga bashkëpunëtorët të shërbimeve të ndryshme nëntkokësore, një asociacion i këtill intelektualësh, do të ishte në nivelin e Akademisë, në atë rol, me të njëjta detyra, me të njëjtën peshë e ndikim! A e di dikush se çka ka bërë ky farë “unioni” i dr. Havzi Mustafës, përveçse e ka degjeneruar ndonjë iniciativë të shëndetshme për një asociacion të tillë prej intelektualëve të kombit!

Kush është ky “Union i intelektualëve”? Çka ka bërë ai deri më sot për kombin shqiptar? Cilin projekt kombëtar e ka realizuar nga i cili pastaj mbarë Kombi ka pasur hajër! Cili ka qenë reagimi i tyre kundër veprave antikombëtare dhe aktiviteteve politike kundër shqiptarëve? Heshtja e tyre në këto plane ka qenë “mirëkuptim intelektual” që e kanë shqiptarët ndaj ndërmarrjeve politike antishqiptar! Pse ky “Union i Intelektualëve” nuk e dënoi takimin e Shaqir Fetait me Stojanço Angellovit, pse për këtë gabim trashanik nuk ia kërkuan dorëheqjen në emër të intelektualëve të kombit, por e uruan “reisin” i cili ka po atë oficer urdhërdhënës antishqiptar që e ka edhe Angellovski! Shkuarja e tyre te Shaqir Fetai, menjëherë pas Stojançes, do me thënë se këta solidarizohen me qëndrimet e përbashkëta të Shaqirit dhe Stojançes kundër UÇK-së dhe idealeve të larta të kësaj strukture kombëtare!

Apo, kur e panë këta të shërbimeve se Shaqir Fetai e dhjeu punën fare, menjëherë e urdhëruan Dr. Havzi Mustafën që të shkojë me një “grup intelektualësh” dhe t’i japin përkrahje morale e shpirtërore Shaqir Fetait si dhe ta zbusin sado pak mllefin gjithëpopullorë me faktin që, prapa Shaqir Fetait po qëndrojnë “intelektualët”. Populli ynë nuk i do ata burra e intelektualë që rrihen tri herë në ditë nga gratë e tyre!

Popullit thotë: “Mos u mundo të lashë m... me sh..., sepse, në të dy rastet, del i pistë, i fëlliqur”!

*(Lajme7, 5.02.2021)*

## Përrjashtuesi i vetëmjaftueshëm

**Shaqir Fetai, siç u shkrua kohë më parë, duke qenë se vuan nga “Sindromi Napoleon”, ka filluar të ndjehet si i vetëmjaftueshëm dhe, si rrjedhojë, përrjashton gjithçka, sa më shumë hallka, sepse, i thotë mendja, me përrjashtim më lehtë e arrinë manipulimin, ves ky i shërbëtorëve të shërbimeve sekrete**

**Nga Haxhi Isa Xhaviti**

Shaqir Fetait, këtij farë “reisi” të instaluar nga pushteti aktual maqedonas, po i shkon mendja te një fakt, të cilin ky vetëm që po e imagjinon dhe jo se mund të jetë ndonjëherë fakt i mundshëm. Po mendon se, ndonëse në gjatësinë trupore të Napoleon Bonapartes, ka po atë potencë e kapacitet të gjithanshëm napoleoniane sa, edhe mund të komandojë e të drejtojë “organizata kontinentale”, sepse, një të tillë organizatë si BFI-ja ky e ha për mëngjes!

Këtë fundjavë na paska qenë në Kosovë, mysafir i Naim Tërnavës, Kryemyftiut të BIK- ut! Në këtë takim, Shaqir Fetai ka hedhur idenë e bashkëpunimit të bashkësive fetare të Ballkanit si tërësi integruese e kontinentit të Evropës, sidomos të bashkëpunimit të BFI-së me BIK-un i cili na qenka aq i domosdoshëm.

Po pse Shaqir Fetai e përrjashton Komunitetin e Myslimanëve të Shqipërisë?! Pse në këtë bashkëpunim dyshe nuk duhet të përrfshihet edhe Komuniteti Mysliman i Shqipërisë? Çfar ideshë mund të kenë këta dy komunitete myslimane respektive që mund të minohen nga KMSH i cili që në strat duhet të përrjashtohet?

Apo, Shaqir Fetai gjithjë ka qenë i ushqyer me urrejtjen jugosllave ndaj çdo gjëje të Shqipërisë si armi që sore për Jugosllavinë! A e kupton Shaqir Fetai që më nuk ekziston Jugosllavia dhe se, nuk është BFI e as BIK-u faktor që tanimë mund ta dirigojnë KMSH-në dhe se, pa drejtimin e këtij Institucioni në procese evrointegruese të kota do të jenë çfarëdo përrpjekje “gjjigante” të Shaqir Fetait.

Nëse Shaqir Fetai e ka porosi (ndërsa e ka, pa dyshim) që ta eliminojë KMSH-në nga ndonjë projekt i përrbashkët i të tre komuniteteve fetare islame të shqiptarëve të Viseve Etnike, atëherë, që tani duhet të refuzohen idetë e djallëzuara të tij, sepse, nuk është i sinqertë, nuk është i besueshëm dhe besnik në asnjë proces, sepse, asnjë ide nuk e ka të veten, por i ka porosira!

Kurse, nuk përton të thirret në 8 milion shqiptarë që jetojnë në Evropë! Kaq myslimanë në Evropë, sa paska shqiptarë me gjithë katolikë e ortodoksë, ka vetëm në Gjermani dhe Francë dhe, ndikimi i tyre në shoqërinë gjermane apo franceze është fare i papërrfillshëm. Çdo përrpjekje e Shaqir Fetait për të imponuar “rolin e madh që kanë shqiptarët në Evropë si faktor muslimanë”, është ide djallëzore për radikalizmin dhe çartje të tyre, sepse, pa këtë shpërfaqje në të djallëzuar nuk mund të imponohesh si faktor në mesin e 300-400 milion banorëve të Kontinentit të Evropës.

Shaqir Fetai kërrkon që të organizohen disi në grabitje të diasporës sonë, duke shpresuar në shtrirjen e ndikimi të tij (duke e keqpërrdorur Naim Tërnavën) ndër myslimanët e Maqedonisë dhe Kosovës që jetojnë dhe veprojnë nëpër shtete të ndryshe të Evropës. Shaqir Fetai mendon se, tani është momenti i grabitjes së sukseshme, pikërrisht në prag të Ramazanit! I gjori ka humbur e ka ngelur tërësisht pa besimin e myslimanëve vendorë, i ka ngelur shpresa vetëm edhe te shqiptarët e diasporës, të cilët

mund t'i motivojë e t'i mobilizojë vetëm përmes BIK-ut të Naim Tërnavës. Kurse, po harron Shaqir Fetai se, as myslimanët e vendit si dhe as ata të diasporës, nuk po pinë më naftë!  
Shaqir Fetai është dëshmuar (dhe ashtu trajtohet) si shkelësi më i paparë i akteve normative të BFI-së, si shkatërrues në themel i këtij Institucioni, si mohues i të gjithë atyreve, të cilëve u ka borxh ngjitjen në karrierë aspakt të merituar. Dhe ky tani të na dalë “ideatorë” i organizimit të diasporës në binare sa më të shëndosha! Hamamin! Ky e mendon vetëm zhvatjen e diasporës si dhe përçarjen e saj, fragmentarizimin si dhe devalvimin e saj. A nuk ishte ky misioni i përhershëm i UDB-së në raport me shqiptarët dhe myslimanët?!

*(SotInfo, 8.02.2021)*

## Çka fshihet pas takimeve për kafe me Shaqir Fetain

**Cila do të ishte logjika apo kënaqësia e Zijadin Selës, e Menduh Thaçit apo e Bilall Kasamit, për ta vizituar dhe për t'ia shprehur urimet dhe përshëndetjet Shaqir Fetait kur këta veçmë e dinë se ky farë “bereqeti” është instalim i shërbimeve sekrete? Çfarë nevoje dhe çfarë kënaqësie i paraqet Afrim Gashit vizita që ia bën Shaqir Fetait, nëse jo disiplinë para eprorëve të shërbimeve sekrete**

### Shkruan Ilir Ramadani

Po bëhet tash e një vit që në BFI po mbillet fara e së keqes. Dikush natë e ditë po punon për këtë bimë helmuese, të rrethuar me do therra e shkurra po aq helmuese. I vetmi aktivitet që po ndodhë është pitja-përcjellja e uruesve dhe përshëndetësve. Dhe kjo krejt me stil e me prapavijë!

Dikush po mundohet me strategji të nëndheshme që me çdo kusht ta bëjë të pranueshëm Shaqir Fetain si “mesia” i shqiptarëve dhe myslimanëve në përgjithësi. Ky “dikushi” tashmë ka vlerësuar se nuk është e arritur instalimi i Shaqirit në krye të BFI-së por, e arritur do të llogaritet vetëm momenti kur mysimanët e vendit do ta pranojnë në shpirt e në shtëpi, në tavolinë e në shtrat Shaqir Fetain; kur nuk do të mund të thithin as ajër pa lejen dhe urdhërin e këtij “instalacioni”!

Tre lloje mysafirësh janë aktualisht që nuk i shqepen “zyres” së Shaqir Fetait: qytetarët-të ftuarit e tij, “figurantët” e bollshëm që ia dërgon shërbimi sekretet sa për ta shtuar numrin e atyre që e duan Shaqir Fetain (dhe ky numër mund të jetë mbi 10 mijë vetë) si dhe kori diplomatik. Ky i fundit tashmë ka konstatuar se Shaqir Fetai është një kungull i zbrazët, pa asnjë kokërr fare si dhe, jo vetëm joproduktiv por, edhe mjaft ogurzi për Bashkësinë Fetare Islame. E vizitojnë sa për t'ia kuptuar planet që i ka për perspektivën e këtij Institucioni, i cili mund të shndërrohet në magaze, në depo municioni që mund ta dridhë në themel si shoqërinë ashtu edhe vendin dhe më gjërë. Shaqir Fetai në BFI ka mision të mbrapshtë dhe, këtë e ka dëshmuar me shkeljet sistematike që ia bën akteve normative të Institucionit, duke përçuar mesazhe se atij si ha b... për këtë Institucion, as për myslimanët dhe as për islamit por, synon që të jetë sa më korrekt dhe i lavdëruar te eprorët e tij që e ngarkojnë me punëra të pandershme. Porositësit e vizitorëve të Shaqir Fetait, mund të jenë edhe pushteti, edhe partia shqiptare në pushtet, por edhe, pa dyshim, shërbimi sekret. Tani duhet të përcaktohen disa politikanë që nguten si mizat te ai sendi që ta takojnë Shaqir Fetain dhe të tregojnë qëllimin e vizitës, por duke e arsyetuar shumë fort! Më herët, cilido person që dilte nga dera UDB-së qoftë edhe ata që ftoheshin për t'u marrur në biseda informative e që torturoheshin deri në çmendri, që të gjithë i trajtonim si bashkëpunëtorë të UDB-së. Këtij shërbimi sekret nuk duhej afuar, qoftë edhe me detyrim në vetëvrasje, sepse, përjetë do ta mbanin etiketën “spiun, bashkëpunëtorë i UDB-së”!

Cila do të ishte logjika apo kënaqësia e Zijadin Selës për ta vizituar dhe për t'ia shprehur urimet dhe përshëndetjet Shaqir Fetait kur ai veçmë e di se ky farë “bereqeti” është instalim i shërbimeve sekrete? Cila do të ishte kënaqësia e Menduh Thaçit për ta vizituar dhe për ta uruar Shaqir Fetain kur ai është shumë i vetëdijshëm dhe më se i bindur se ky farë “bereqeti” është alet i shërbimeve sekrete? Çfarë nevoje dhe çfarë kënaqësie i paraqet Afrim Gashit vizita që ia bën Shaqir Fetait, nëse jo disiplinë para eprorëve të shërbimeve sekrete? Çka i lidhë do deputetë, do drejtorë, do kuaziintelektualë, do



të pandershëm e të pamoralshëm, do pseudoshkencëtarë e do bythaxhinjë, me Shaqir Fetain, të cilin kurrë më parë nuk e kanë takuar? Prej nga nevoja e tyre aq e madhe, prej nga “edukata” e tyre familjare për ta vizituar e pershëndetur një udbash me tapi? Ky po që është i tillë por, si t’i llogarisim të tjerët që, edhe pse e dinë, edhe pse që e pohojnë me plotë gojë, prap të nesërmen i sheh në kafe të Shaqir Fetait!

Kjo dukuri nuk mund të shpjegohet assesi ndryshe përveçse si një masë imponuese e shërbimeve sekrete për t’ia kamufluar imazhin prej djalli Shaqir Fetait dhe, për ta bërë sa më të pranueshëm të masa. Ky është synim i shërbimeve sekrete, pa dyshim, por a mund të bëhet detyrë e politikanëve, sidomos e opozitarëve, synimi i pushtetit aktual që, falë skenareve të shërbimeve sekrete, ia arrinë që ta vë nën kontrollë, ta degradojë, ta degjenerojë deri në shkatërrim një Institucion jetik, për nga rëndësia, për një popull që është gjysma e shoqërisë së një shteti!

Çka do të mësojnë këta farë deputetë e “liderçiçë” që shkojnë dhe ia puthin dorën Shaqir Fetait me të cilën ka dorëzuar dhjetra shpirtëra të UDB-ja! Apo, këta deputetë e liderçiça shkojnë për ta përgëzuar për trimëri që bashkë me “branitellin”, Stojançe Angellovin, t’i dënojnë brohoritjet provokative dhe skandaloze të protestuesve shqiptarë që të pakënaqur me politikanët e tyre, ftojnë krenarinë nacionale “UÇK, UÇK”! Pas këtij skandali, para derës në radhë, për t’ia fërkuar Shaqir Fetait qëndrojnë intelektualë e deputetë, drejtorë e liderë partishë? Kjo nuk është gafë, kjo është vetëm zbatim i porosive të shërbimeve sekrete! Po që paskan qenë shumë zbatues! Hajde se një ditë do të përballen me popullin, i cili, pa dyshim që do t’i refuzojë, siç e refuzuan edhe Shaqir Fetain, vetë katundi i tij, në zgjedhjet parlamentare. “Reisi” që refuzohet nga katundarët e vet sakaq po bëhet aq i dashur e i rëndësishëm për intelektualë, deputetë, liderë partishë e aktivistë kombëtarë! Punë djalli, për të mos thënë angazhime të shërbimeve sekrete të vendit si dhe të huaj.

Takimet kurtoazie mund t’i kapë logjika, por, takimet e kota, të panevojshme, të pafrytshme, që nuk hynë në asnjë hesap kombëtar e fetar, janë të mëkatshëm dhe të djallëzuar. Shyqyr Zotit, ky vend, ky popull në gjirin e vet ka qindra intelektualë të rangut akademik, ka qindra intelektualë të rangut rajonal e më gjërë, të cilët, as që e honepsin emrin e Shaqir Fetait e lëre më që ta vizitojnë sa për t’ia shprehur urimet dhe përshëndetjet që qenka bërë “reis”! Të gjithë e dinë se ai nuk është “i bëshëm” por i instalueshëm! Instalacion i shërbimeve sekrete. Intelektualët e mirëfilltë i refuzojnë instalacionet e tilla si Shaqir Fetait. Tek ai mund të duken vetëm ata që “i lidhë” ndonjë miqësi, si e keqe e domosdoshme, të cilët nuk mund ta refuzojnë ftesën e Shaqir Fetait për ta pirë me të një kafe keqpërdoruese, sa për të bërë një foto dhe për ta publikuar në tefterin e tyre të hallvaxhisë (mjetet komunikuese elektronike zyrtare të BFI-së i kanë shndërruar tamam në “tefter hallvaxhie”)! Po ashtu, tek ai shkojnë për kafe manipulative edhe ata që shantazhohen apo urdhërohen prerazi që ta vizitojnë “faraonin” që, pa iu trembur syri, vret e pret mbi aktet normative të BFI-së, sipas porosive dhe përkrahjes së atyreve që e instalojnë si marionetë të kalbur. Sa keq, sa tmerr e sa poshtërim, jo për Shaqir Fetain, por për deputetët, funksionarë të ndryshëm e liderçiçë! Asnjë takim me Shaqir Fetain nuk mund të justifikohet, as si nevojë por as si detyrim kombëtar e fetar. Vetëm si porosi e “sekretlinjëve”!

*(Lajme7, 12.02.2021)*

## Kabineti i diletantëve në delir

*(“Heshtja është flori!” – populli)*

### *Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI*

Vazhdon Shaqir Fetai me manipulimin e vizitave si dhe takimeve. Të gjitha ai i konsideron si “nevojë jetike” të vizitorëve të ndryshëm për t’ia shprehur urimet dhe përshëndetjet Shaqir Fetait, i cili, falë pushtetit maqedonas ia arriti të instalohet në krye të BFI-së.

Këto ditë paska qenë nikoqir i zonjës ambasadore të Zvicrës në Shkup, Sybille Suter! Kabineti i diletantëve në delir i Shaqir Fetait lëshon një komunikatë, jo vetëm me dhjetra gabime trashanike gjuhësore por, e mbushur përplotë me gënjeshtër dhe modifikime, përplotë me pasaktësi dhe qëndrime megallomane, të denja për një avanturier të futur në labirinth të pazgjithshëm për kapacitetin mental të Shaqir Fetait. Zonja ambasadore i paska hyrë punës që t’i ndajë shqiptarët e Maqedonisë, ata të Kosovës, ata të Shqipërisë, ata të Luginës së Preshevës, madje, sipas kabinetit idiotik të Shaqir Fetait, ajo qenka në gjendje që t’i dallojë edhe shqiptarët e Makrefshit, të Gjylekarit. Muçivërrejt etj. Kështu mund të mendojnë dhe të shkruajnë vetëm diletantët e Shaqir Fetait që kanë rënë në delir nga injoranca e “reisit” të tyre.

“Ajo gjithashtu vlerësoi lartë mërgatën shqiptare nga Maqedonia që jeton dhe vepron në Zvicër...” thotë kumtesa e Shaqir Fetait, duke vazhduar me imputimin e fjalisë më idiotike që nuk mund ta thotë një mashtrues ordiner e lëre më një ambasadore: “pjestarët e islamit që kanë prejardhje nga Maqedonia janë shembullor dhe janë inkuadruar më së miri në shoqërinë Zvicerjane” (thuhet “zvicerane”!)! Po pjesëtarët e islamit nga Kosova e Shqipëria, nga Çamëria e Lugina e Preshevës, nga Mali i Zi e gjetiu, nuk janë shembullorë dhe nuk janë të inkuadruar në shoqërinë zvicerane?! Në këtë formë asnjë shtet në botë nuk i ndanë qytetarët e vet, në baza rajonale, lokale e të mëhallave, por, në baza etnike! Shqiptarët në Zvicër janë një dhe, nuk ndahet ashtu siç ka qejf Shaqir Fetai! Ky qejf mund të jetë dëshirë e UDB-së por jo përcaktim institucional i asnjë shteti në Evropë!

Shaqir Fetai vazhdon me rrenat e tij duke prezantuar para ndërkombëtarëve përfaqësues të pa paraparë sipas Kushtetutës së BFI-së. Kjo Kushtetutë, në asnjë faqe të vet, në asnjë fjalë, në asnjë fjalë nuk nënvizon se BFI-ja ka “sektore”, porse, aktivitetet e veta i kryen përmes shërbimeve profesionale (Neni 38). Para ndërkombëtarëve dhe faktorëve me relevancë myslimanët e vendit si dhe BFI-në e prezenton reisi dhe jo turlifarë “drejtori” profesionist në hajni, në tradhëti, në spiunazhë, në zhvatje, në vjedhje të ndihmave humanitare, në injorancë, në blerës të titujve shkencore, në amoralitet e në pislëlqe të ndryshme, siç është Mustafa Dauti. Shaqir Fetai, me tipa të tillë, edhe i gënjen por edhe i ofendon ndërkombëtarët. Nuk është e rëndësishëm kjo për Shaqir Fetain! Për të me rëndësi është vetëm t’i shprehin urime dhe përshëndetje për një post që e ka vjedhur si skuth!

Heeej, Shaqir Fetai në këtë takim paska folur edhe për “rolin që e ka BFI në mbështetjen e mërgatës

sonë”!!! Po me çfarë roli të mundshëm mund ta mbështesë Shaqir Fetai mërgatën tonë? Si po e mbështetkëka BFI-ja mërgatën tonë? Asnjë shtet, asnjë ministri e punëve të jashtme, asnjë institucion shtetëror, në asnjë vend, nuk është në gjendje ta thotë këtë fjali kaq pretencioze siç e thotë Shaqir Fetai, që e ka merak lavdin dhe rrenën, mburrjen dhe abdallëkun!

Shaqir Fetai vetes i jep edhe kompetenca të presidentit shtetëror sa, pjesëtarët e islamit i quan ambasadorë të vendit tonë! Të cilit vend o Shaqir skuthi?

Dëgjojeni se çka paska thënë Shaqir Fetai, ky farë mjerimi dhe turpi i kombit tonë: “BFI gjithmonë do të ketë synim dhe prioritet kultivimin e vlerave dhe promovimin e tolerancës, që janë simbol i kulturës evropiane!”

E para, shtetet evropiane kurrë nuk kanë ushtruar trysni të karakterit fetar, apo diskriminim fetar, ndërsa myslimanët e vendit tonë qekan treguar tolerant! Tolerancën e porosisin mësimet e shenjta por, shtetet evropiane asnjëherë nuk e kanë sjellë situatën deri te ndonjë tolerancë. Shtetet Perëndimore e kultivojnë dhe thërrasin, madje edhe me ligj, në bashkëjetesë ndërfitare e ndërnacionale. Toleranca në vete ngërthen edhe diskriminim, ndërsa bashkëjetesa ngërthen vetëm paqe.

Toleranca nuk është kulturë, o Shaqir Fetai, aq më pak “kulturë evropiane”! Toleranca ka diçka nga kodi i mirësjelljes së imponueshme, ka edukatë, ka nënshttrim për një paqe të qëndrueshme, ka pajtesë me aktet ligjore diskriminuese, por, të ketë diçka me kulturë kjo nuk bën vaki! A e di Shaqir Fetai se çka është kultura! A e di definicionin e kulturës? Gjithçka mund të jetë por jo tolerancë. Prandaj, Shaqir Fetai duhet të ketë kujdes se çka flet me ndërkombëtarët e jo të bëhet lolo e t’i shkulë së qeshuri. Sepse po na bën gaz i botës edhe neve, shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut!

Shaqir Fetai tërë këtë ndytësi e bën qëllimisht, sa për të ngritur pluhur e huti nesër apo pasnesër! Ai e di fort mirë se do të fluturojë nga ai vend që e ka okupuar, por, dëshiron që të hapë dilema e diskutime: si u bë që iku kur e donin aq shumë, të brendshëm e të huaj, nuk la njeri pa e uruar dhe përshëndetur. Po, por, nuk e ka bekimin e organeve dhe institucioneve të BFI-së, nuk e ka bekimin dhe respektin e popullatës së gjërë myslimane të vendit! Nuk e ka përkrahjen e ulemasë së gjërë, me përjashtim të disa lokalistëve dhe puthadorëve, edhe atë, vetëm sa për t’i realizuar disa interesa mesquine e familjare!

Tash për tash, Shaqir Fetait po i shkon kungulli mbi ujë por, do të vije dita kur ai do të përgjigjet për shumë vepra penale që po i kryen, për shumë gënjeshttra e tallje që po i kryen duke u paraqitur si diletant dhe duke pritur kohën e justifikimit “po unë aq kam ditur”! Kurse po di ta quajë veten “resiul ulema”! Historia do ta gjykojë si manipulant perfekt, si një abdall që deshti të bëhet kryetar i ulemasë”!

*(1Kliklarg, 13.02.2021)*

## Të arriturat jetësore të H. Sulejman ef. Rexhepit i zbërthejnë intrigat djallëzore të Shaqir Fetait

Sulejman Rexhepi paraqet një “gacë ferri” për pushtetin aktual, e cila nuk preket me dorë, sepse të përvëlton trup e shpirt. Natyrisht që shmangia e kësaj “gace” bëhet më së lehti përmes mashës! Dhe, ku do ta gjente pushteti këtë “mashë” perfekte, që i përballon shkrierjes nga kjo “gacë”, se sa te Shaqir Fetai, të cilin H. Sulejman ef. Rexhepi e besonte më së shumti

### Koment i “Lajme7”

“Islami rrugëtimin drejt vlerave e përqëndron tek niveli i lartë i përgjegjësisë së njerëzve të parë. Ky është fundamenti kyç drejt ardhmërisë së shëndoshë në çdo sferëtë jetës ekonomike, shoqërore, kulturore e fetare” – thotë Shaqir Fetai, i cili, shyqyr që nuk është mendimtarë se, pas emrit të vet do ta shtonte fjalën “filozof”, siç e ka shtuar “reisul ulema”, ndonëse e ka të qartë edhe vetë ai se, krejt bota e di që atë e instaluan pushteti maqedonas në krye të BFI-së së okupar prej një grusht banditësh të cilët, në vend se të përgjigjen para drejtësisë, ata i shijojnë “vlerat” e një puçi klasik që ka shkaktuar një tornado anarkie të paparë në historikun gjashtëshekullor e këtij Institucioni.

Shaqir Fetai vetë, me gojën e tij, ka dëshmuar se i pari i BFI-së dhe lideri i myslimanëve të Maqedonisë së Veriut, ish-reisul ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, është një figurë markante, është një lider i mirëfilltë i cili, nëpër shekujt, mund të jetë shumë i rallë! Liderizmin nuk e përjetoi si lavd por si përgjegjësi të lartë, nën drejtimin e të cilit sendërtoheshin çdo plan kombëtar e fetar, prisheshin çdo plan antishqiptar e antiislam, pengoheshin skenare antimuslimane dhe ngadhënjente mbi çdo lojë që hidhej në shoqërinë tonë nga nëntoka me plotë kanale që përfundonin nëpër kuzhinat e politikave serbe.

Nga kanale të tilla doli Shaqir Fetai dhe, ia arriti që ta përsërisë historinë! Sylë Hotla, Xhemë Gostivari, Hasan Remniku, Selman Kadria, Hasan Prishtina e shumë heronj të kombit, nuk u likuiduan nga dora e serbit, por nga dora e vetë shqiptarit. Sepse, kur të vret armiku t’i shpallesh hero, kur të vret “populli” ti shpallesh dështak, tradhëtar, njeri i dobët! Ky lloj “likuidimi” u ndërмор ndaj H. Sulejman ef. Rexhepit, kurse ekzekutori u zgjodh Shaqir Fetai me të gjithë elementët e shërbimeve sekrete që ia vunë në dispozicion, vetëm e vetëm që ta degradojnë e ta masakrojnë moralisht, me qëllim që të harrohen të gjitha fitoret e tij, të gjitha sukseset e tij, të gjitha kontributet e tij, të gjitha luftërat e tij, falë të cilave shqiptarët dhe, përgjithësisht, myslimanët e Maqedonisë së Veriut gëzojnë të drejta fetare e kombëtare të cilat nuk ua garantoj asnjë subjekt politik. Sepse, duke u dhënë pas pushteteve, të gjithë subjektet qëndronin larg interesave të popullit shqiptar, ndërsa, H. Sulejman ef. Rexhepi, kishte mjaftueshëm pushtet, të cilën nuk e përdori si formë, por, si mjet për të luftuar çdo politikë agresive dhe çdo propagandë antishqiptare në vend e në rajon.

Natyrisht, ky liderizëm nuk do t’i pëlqejë pushtetit serbomaqedonas, ndaj, do t’i lëshojnë minjtë e vet nga gjirizi serb, në krye me Shaqir Fetain, alias ORAO (nofkë e tij nga UDB-ja serbe) dhe, do ta degjenerojnë BFI-në deri në këtë nivel ku njeriu i parë vdes për t’ia konfirmuar se është “lider”

përgjegjësia e të cilit ngelë që të jepet sa më shumë pas përshëndetjeve dhe urimeve nga të gjitha anët me qëllim që t'ju japë zemër bashkëpunëtorëve të tjerë të shërbimeve sekrete: ja, edhe një spiun mund të bëhet lider!

Shaqir Fetai e di fort mirë se si H. Sulejman ef. Rexhepi e pat shndërruar kabinetin e vet në zyre të politikave të larta shtetërore! Kabineti i tij ishte një “zyre alternative” e Presidentit Ibrahim Rugova! Takimet më sekrete kombëtare apo ndërkombëtare, përfaqësuesit e Rugovës i mbanin në kabinetin e H Sulejman ef. Rexhepit!

Kabineti i H. Sulejman ef. Rexhepit vizitohesh nga burrshtetas (Turgut Ozal, Sulejman Demirel etj.) nga misionarë ndërkombëtarë (Tadeus Mazovjetski, misionar për liritë dhe të drejtat e njerut nga OKB) etj, kurse sot, Shaqir Fetai vizitohet dhe llogaritet faktor nga përfaqësues të EVN, të higjienës komunale, të fermave të pulave, nga do udbashë e nga branitellat me të cilët i dënon brohoritjet nacionaliste shqiptare “UÇK, UÇK!

Shaqir Fetai e di fare mirë se si, me vendimin e Sulejman Rexhepit mblidheshin historianë e shkencëtarë gjithëkombëtarë në Medrese për të hedhur dritë reale mbi historinë kombëtare, ndërsa “liderët” e Shaqir Fetait që e instaluan në krye të BFI-së, nëpër libra shkollore po i ofendojnë shqiptarët dhe po i shtrembërojnë të gjitha faktet për shqiptarët.

Shaqir Fetai fort mirë e di se si H. Sulejman f. Rexhepi konfrontohet me ish-presidentin maqedonas, Kiro Gligorov, duke iu kërcënuar se do t'ia prishë shtetin nëse ai nuk i ndalon lojërën për ta prishur BFI-në!

Shaqir Fetai fort mirë e di se si H. Sulejman ef. Rexhepi nuk pranonte kurrfarë Marrëveshje të Ohrit, nuk pranonte kurrfarë ndryshimesh Kushtetuese në të cilën nuk do të theksohej edhe emri i Bashkësisë Fetare Islame! Çdo përpjekje e recidivëve serbo- komunistë për ta destabilizuar apo për ta fragmentarizuar BFI-në duke u përpjekur për të regjistruar edhe bashkësi të tjera myslimane (e ashtuquajtura “Bashkësia e Myslimanëve të Ballkanit”) përfundonte me kundërpërgjigje se do të mobilizoht e tërë popullata për mosnjohje të institucioneve shtetërore.

Sot, Shaqir Fetai si qyqar po hesht dhe zëri nuk po i dëgjohet ndërkohë që janë regjistruar një dyzinë “bashkësisë islame” si dhe grupe religjioze myslimane, të cilat do të bëjnë përpjekje t'i konkurrojnë BFI-së me xhami, me vakëf, në fitra, ne zeqat e në shkatërrim të unitetit!

Shaqir Fetai e di fort mirë luftën e H. Sulejman ef. Rexhepit në miratimin e ligjit për kthimin e pronave të nacionalizuara të bashkësiive fetare. Shaqir Fetai e di fort mirë luftën e pakompromis që e ka bërë H. Sulejman ef. Rexhepi në kthimin e pronave të vakëfit. Shaqir Fetai e di fort mirë qëndrimin rrebelues të H. Sulejman ef. Rexhepit karshi pushteteve që hezitonin në kthimin e pronës së mbetur edhe më tej nën kthetrat e nacionalizimit; e di fort mirë qëndrimin e tij stoik para lloj-lloj shantazheve.

Sot Shaqir Fetai, pas një viti pasi u shndërrua në thikë pas shpinës së H. Sulejman ef. Rexhepit, ka arritur të humbë e të shesë “poshto-zashto” dhjetra vakëfe me qëllim që të sigurojë rroga si mjet rehatie për veten e vet si “lider”, ndërkohë që të hollat që hyjnë nga vakëfi duhet të shpenzohen ekskluzivisht për shtim të vakëfit.

Shaqir Fetai e di shumë mirë se si lideri i tij i dikurshëm të cilin e vlerësonte si figurë markante, e përlligji vendimin tallës të qeverisë, me qëllim që t'i mbajë sa më gjatë xhematat larg xhamisë dhe t'i shkretojë të gjitha xhamitë. H. Sulejman ef. Rexhepi e kuptoi qëllimin e fëlliqtë dhe, dha urdhër të prerë – të hapen xhamitë dhe xhemati të falet nëpër xhami! Le të provojë kush të dojë që mos ta respektojë këtë vendim të H. Sulejman ef. Rexhepit!

Shaqir Fetai e di fort mirë se, pikërisht, falë këtyre cilësive burrërore, falë këtyre virtyteve kombëtare e fetare, falë këtyre qëndrimeve prej lideri të paepur, Sulejman Rexhepi radhiti një varg suksesesh, një varg të arriturash të paimagjinueshme, një respekt kombëtar e ndërkombëtar, të cilin, Shaqir Fetai

nuk mund ta përjetojë as në ëndërr!

Le ta përkuqtojmë se cilat ishin ato suksese e të arritura që ia shtuan vlerat e një lideri të respektuar si në vend ashtu edhe te ndërkombëtarët, si në institucionet fetare rajonale ashtu edhe në ato ndërkombëtare, si në Perëndim ashtu dhe në Lindjen e Afërt dhe në Turqi.

Në këtë shkrim, nuk do të mund t'i përmendim të gjitha të arriturat e tij por, vetëm disa, falë të cilave, H. Sulejman ef. Rexhepi do të gëzojë vlerësime cilësuese, si:

-Lider i pajisur me guxim, mendim dhe veprim strategjik që orientoi zhvillimin e jetës fetare islame në dy kahe: riorganizimin dhe fuqizimin e institucionalizimit të jetës fetare islame, si dhe profilizimin me identitet burimor shqiptar;

-Meritor për ngritjen e urës lidhëse midis mendimit tradicional islam dhe mendimit bashkëkohor e intelektual;

-Promotor për kontributin e teologëve shqiptarë ndaj zgjidhjeve të problemeve kombëtare;

-Lider dhe promovues i filozofisë fetare në ruajtjen dhe kultivimin e Islamit burimor shqiptar, si dhe filozofisë politike “pa fe nuk ka atdhe”;

-Iniciator i shumë nismave që lidhen me avancimin e arsimimit të popullatës, ngritjes së institucioneve të shëndosha arsimore, promovimin e çështjes së shkollimit të femrës muslimane dhe sigurimin e bursave për shkollim etj;

-Lider i suksesshëm në menaxhimin e krizave humanitare;

-Meritor në kultivimin dhe përhapjen e mendimit intelektual e akademik mbi çështjet islame tek popullata, mbi ruajtjen dhe forcimin e unitetit fetar e kombëtar dhe, si rrjedhojë e këtij angazhimi, në devalvimin e lojërave të dyshimta, në zbrëthimin e tyre, si dhe në neutralizimin e të gjithë lojtarëve të shërbimeve të ndryshme të vendit dhe të infiltruar nga jashtë.

Falë, këtyre vlerësimeve dhe epiteteve nga faktorë të ndryshëm botërorë, H. Sulejman ef. Rexhepi do t'ia arrijë të bëhet anëtarë i rregullt i një numri të madh organizatash botërore, evropiane dhe ballkanike me karakter Islam; pjesëmarrës i ligjëratave të Ramazanit që organizoheshin në pallatin mbretërorë të Hasanit të dytë; pjesëmarrës në shumë konferenca në të cilat ka mbajtur kumtesa me mesazhe të ndryshme në shërbim të çështjes islame dhe kombëtare.

H. Sulejman ef. Rexhepi nuk u katapultua si Shaqir Fetai drejt e në “reis”; nuk u instalua në krye të BFI-së siç u instalua nga pushteti maqedonas Shaqir Fetai. H. Sulejman ef. Rexhepi kaloi nëpër shumë sfida duke u rritur në karrierë me mund e me sakrificë. Para se të zgjidhej reisul ulema më vitin 1991, H. Sulejman ef. Rexhepi ishte: 14 vite Anëtar i Këshillit të Bashkësisë Islame të Shkupit; 8 vite kryetar i Shoqatës së Ulemave të Shkupit; 8 vite përfaqësues i Ulemave të Shkupit në frontin e Përgjithshëm të Lidhjes Socialiste, 4 vite përfaqësues i Ulemave të Republikës së Maqedonisë në frontin e Përgjithshëm të Lidhjes Socialiste; 14 vite Prokuror publik i Kuvendit të Bashkësisë Islame të Republikës së Maqedonisë; 4 vite anëtar i Kuvendit suprem të Bashkësisë Islame të Jugosllavisë për 4 vite; anëtarë i Rijasetit të Bashkësisë Islame të Jugosllavisë.

Kjo karrierë dhe kjo përvojë kaq e gjatë nëpër struktur të ndryshme ku mbrohej e ngritej zëri për ruajtjen e islamit tradicional dhe për lirinë e kultivimit të jetës fetare islame në vendin tonë, bënë që H. Sulejman ef. Rexhepi të zgjidhet tri herë në krye të Bashkësisë Fetare Islame në RMV.

Sa për dijeni të çunakut Shaqir Fetai, dikur shërbëtor më besnik i Sulejman ef. Rexhepit, ish-reisi i tij i cili e mbante myfti, edhe pse paraprakisht nuk kishte treguar kurrfarë rezultatesh në detyrat që ia kishte caktuar, H. Sulejman ef. Rexhepi është zgjedhur anëtarë i rregullt i një numri të madh organizatash botërore, evropiane dhe ballkanike:

1993 – anëtarë i rregullt i Kuvendit të lartë për çështje islame me seli në Kajro;

1995 – anëtarë i rregullt i Kongresit botëror Islam me seli në Tripoli;

1997 – anëtarë i rregullt i Unionit Islamik për Evropën;

1997 – themelues dhe zëvendës Kryetar i Shurës Euro Aziatike me seli në Ankara.  
 1998 – zëvendës i sekretarit gjeneral të Kuvendit të këshillit për Evropën Lindore me seli në Stamboll;  
 1999 – anëtarë i forumit të shkencëtarëve Islam me seli në Rabat;  
 2016 – Anëtar i Këshillit Botues të Kolanës “Zani i Naltë” (1923-1939).  
 Me çfarë kontributesh të veçanta do të dallohej në karrierën e vet Shaqir Fetai, përveçse me bashkëpunimin e ngushtë me UDB-në, e cila fillimisht i kishte pas dhënë detyrë për t’i përcjellë studentët shqiptar në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë, me theks të veçantë për ta përcjellë si fuks i dalluar medimtarin aktualisht më të madh shqiptar, Nexhat Ibahimin!  
 Për H. Sulejman ef. Rexhepin mund të thuhet se u dallua për një varg kontributesh të veçanta, nërsa këtu do t’i nënvizojmë ato që na kujtohen për momentin:

1991 Zyrtarizon gjuhën shqipe në institucionin e Bashkësisë Fetare Islame në RM si dhe krahas flamurit mysliman ngre edhe flamurin shqiptar të valvitet në të gjitha institucionet e BFI  
 1991 Advokues i flaktë për sigurimin e bursave për mbi 140 studentë të shkencave të natyrës  
 1991 Themelues i Revistës Hana e Re, që botohet në tre gjuhë  
 1991 Themelues i O.H El Hialal (sot HILAL) – organizatë humanitare me synim të mbështetjes së shtresave të varfëra të shoqërisë.  
 1992 Kontribut të veçantë në menaxhimin e krizës humanitare të shkaktuar nga refugjatët e Bosnjës  
 1992/93 Nënshkrues i Grupit nismëtar për themelimin e Univesitetit të Tetovës  
 1993 Iniciator për themelimin e këshillit koordinativ mes BI Shqipëri-Kosovë- Maqedoni  
 Vitet 1998/99 pritja e refugjatëve nga Kosova ku BIM përmes O.H El Hilal ishte organizata më e zëshme deri në kombet e – Bashkuara.  
 2001 Raportues i BBC në Londër në gjuhën Arabe rreth konfiktit në Maqedoni, promotor në botën arabe i luftës së drejtë të UÇK  
 2004 Iniciator për themelimin e Medresesë së Vajzave në Tetovë  
 2006 Themelues i Medresesë së Vajzave në Shkup  
 2006 Mbrojtës i paepur i BFI nga radikalizimi, ekstremizmi dhe terrorizmi  
 2008 Themelues i Medresesë së Vajzave në Gostivar  
 2012 Organizator i simpoziumit me rastin e 100 vjetorit të shtetit shqiptar “Kontributi i ulemave në ngritjen e vetëdijes kombëtare”,  
 2013 Ideator për themelimin e Agjencionit për Standardin Hallall  
 2015 Ideator i Projektit Stop RedTer, project inovator në parandalimin e terrorizmit dhe radikalizimit në Maqedoni  
 2015 Idetator i Konfrencës mbarëkombëtare “Medhhebi Hanefi, prioritetet dhe sfidat”, Shkup  
 2015 Ideator i themelimit të Mexhllisit për fetva në Maqedoni  
 Për H. Sulejman ef. Rexhepin, Rektori i parë dhe themelusi i Universtetit të Tetovës, Dr. Fadil Sulejmani, thoshte: -“Po të mos ishte Sulejman Rexhepi nuk do të ishte Universiteti i Tetovës”.  
 Dyert e xhamive dhe mektebeve kanë qenë të hapura për Universitetin e Tetovës. (marë nga fjala e Fadil Sulejmanit, dekani i parë i UT, në tubimin e mbajtur në Bogovinjë të Tetovës)  
 Ish-reisi i Shaqir Fetait dhe figura më markante të cilin (sipas Shaqir Fetait) e ka pasur udhërryfytes në karrierë, H. Sulejman ef. Rexhepi ka qenë pjesëmarrës në shumë konferenca nga më të rëndësishmet të mbatura në botën turko-arabe. Ka prezantuar në këto konferenca e kongrese ndërkombëtare:  
 2019: Konferenca ndërkombëtare Moskë, organizuar nga Liga Islame, me temën “Islami mesazh i paqes dhe i mëshirës

2018:Konferenca ndërkombëtare në Mekke, organizuar nga Liga Botërore Islame me temë “Uniteti i muslimanëve – rreziku i frakcionimeve të ndryshme dhe ndarësitë” 2017: Konferenca ndërkombëtare në New York, nën organizimin e Rabita Alemu Islami me moton “Vijëmsia e lidhjeve midis SHBA-ve dhe Botës Islame”

2017: Konferenca ndërkombëtare mbi diversitetin në Egjipt, organizuar nga Ez’heri Sherifi me temë: Temë boshte ishte “Liria, atdhetaria, diversiteti dhe integritet” 2016: Takimi i Shurës Islame të Shteteve Euro-Aziatike Tetore, Stamboll

2015: Samiti Rajonal për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, Tiranë

2015: Konferencë shkencorë organizuar nga Universiteti Shtetëror i Tetovës me temë: “Religjioni dhe dhuna”

2014: Takimi i Shuras Euro-Aziatike, Bruksel-Belgjikë

2014: Konferencë ndërkombëtare me temë: Konfrontimi i ekstremizmit dhe terrorizmit”, Kajro

2011: Konferenca Muslimane në Sofja

2011: Takimi i Liderëve Myslimanë të Ballkanit, Shkup

2010: Konferenca e Këshillit të Lartë për Çështje Islame, Kajro

2010: Konferenca botërore për dialog ndërfetar dhe ndërcivilizues, Ohër 2009: Kongresi botëror Islam

2009: Takimi i Shurës Islame të Shteteve Euro-Aziatike, Stamboll 2008: Kongresi për çështje islame, Kajro

2008: Konferenca Botërore Islame për Dialog, Mekë,

1998: Kongresi ndërkombëtar i intelektualëve muslimanë organizuar nga Universiteti “Al el Bejt”, Jordan,

1995: Kongresi i muslimaneve të Evropës, Basel

1994: Konferenca ndërkombëtare për Ballkanin, Stamboll

1994: Konferenca e Kuvendit të përgjithshëm për çështje islamike, Aleksandri, Egjipt Në këto konferenca e kongrese ndërkombëtare, H. Sulejman ef. Rexhepi ka prezantuar me këto kumtesa:

-Ardhmëria e Islamit në Euro-Azi dhe lëvizjet që keqpërdorin fenë, (Kumtesë e lexuar në Takimin e Shurës Euroaziatike Tetor 2016)

-Mënyra se si të parandalohet keqpërdorimi i fesë dhe propozime për zgjidhjen e tyre, (Kumtesë e lexuar në Takimin e Shurës Euroaziatike Tetor 2016)

-Islami në beteja permanente kundër të pavërtetës (batilit), (Kumtesë e lexuar në Konferencën e Këshillit të Lartë për Çështje Islame, Kajro, shkurt 2010)

-Thirr për në rrugën e zotit dhe polemizo me kundërshtarët, Konferencë botërore për dialog ndërfetar dhe ndër civilizues, Ohër 2010

-Civilizimit i duhet dashuria njerëzore, Kongresi ndërkombëtarë të civilizimit islam në Ballkan , Shkup 2010

-Burimet prej nga muslimanët e Maqedonisë mësojnë Islamin, (Kumtesa e lexuar në Takimin e 7-të të Shurës Islame të Shteteve Euro-Aziatike, Stamboll, Maj 2009)

-Ripërtrirja e mendimit islam, kumtesë e lexuar në Kongresin mbarë islamik për ripërtërtjen e mendimit islam, Kajro 2009

-Zbrazëtia shpirtërore vjen nga humbja e besimit, (Kumtesë e lexuar në Kongresin për çështje islame, Kajro, mars 2008)

-Dialogu në mes muslimanëve dhe jomuslimaneve, Konferenca Botërore Islame për dialog , Mekke 2008

-Islami është fe e paqes dhe tolerancës, (Kumtesë e lexuar në Konferencën Botërore Islame për



Dialog, qershor 2008, Mekë)

-Domsodoshmëria e dialogut mes qytetërimeve dhe feve në këndvështrimin kur'anor dhe profetik, (Kumtesë lexuar në sesionin shkencor, Tiranë, qershor 2007)

-Mbamendja si shtyllë e identitetit kombëtar, (Kumtesë e lexuar në Kongresin e organizuar nga Universiteti “Al el Bejt”, Jordan, 1998)

-Multinacionaliteti në këta troje është dhuratë zoti, (Kumtesë e lexuar në Konferencën e parë ndërkombëtare për Ballkanin, të mbajtur në Stamboll, prill, 1994)

-Bota dhe kultura islame, (Kumtesë e lexuar në Konferencën VI të Kuvendit të përgjithshëm për çështje islame, të mbajtur në Aleksandri të Egjiptit, gusht 1994)

-Mbi pozitën diskriminuese të myslimanëve në hapësirat e ish-Jugosllavisë, (Kumtesa e lexuar në tubimin e intelektualëve islam nga bota, me rastin e haxhit, Medine, 1992) Pa dyshim, veprat e tij janë vlerësuar lartë, ndërsa është autor i një sërë kolumnave, i analizave, komenteve. Ka botuar këta tituj:

1) “Për fe e atdhe” – viti 1996 (përmbledhje intervistash, opinionesh, kumtesash, ligjërata, hutbe dhe fjalime)

2) “Vetëm Krijuesit tim i përkulem” – viti 2000 (përmbledhje intervistash, opinionesh, kumtesash, ligjërata, hutbe dhe fjalime)

3) “Lufta për të vërtetën” – viti 2011 (përmbledhje intervistash, opinionesh, kumtesash, ligjërata, hutbe dhe fjalime)

4) “Për fe dhe atdhe” – viti 2016 Kompleti i përbërë prej gjashtë titujve: 1. Për fe e atdhe (Intervista), 2. Vetëm Krijuesit tim i përkulem (Intervista) 3. Përkulem para idealit kombëtar e fetar (Intervista, opinione), 4. Shtigjeve të dritës (kumtesa, ligjërata, fjalime), 5. Frymëzime të shenjta (fjalime, hytbe, mesazhe, vlerësime) 6. Heshtja si zhurmë (Kolumne).

5) “Në mes të askundësisë” viti 2017 (kolumne) gjendet në tre gjuhë: shqip, anglisht dhe maqedonisht;

6) “Ishullizimi i njeriut”, 2019

7) “Historia e së Drejtës së Sheriatit”, Enes Kariç, përkthyer nga serbo-kroatishtja, 2003

Dhe, falë kësaj pune kolosale, falë këtyre aktiviteteve të paarritshme, falë këtij kontributi dhe angazhimi vetëmohues, H. Sulejman ef. Rexhepi do të vlerësohet edhe me mirënjohje e dekorata për të arriturat e veta jetësorë. Kësisoj, më vitin 2015 vlerësohet me me çmimin “Imazhi shqiptar i harmonisë fetare” nga Forumi Imazh dhe Media në Akademin e Shkencave dhe Arteve në Tiranë; më vitin 2016 vlerësohet me çmimin “Best Spiritual Leader” nga Instituti Evropian per Menaxhim drejtesi dhe diplomaci.

Më vitin 2017 Haxhi Sulejman ef. Rexhepi do të arrijë një mirënjohje të paimagjinueshme nga bota intelektuale mbarëkoboëtare! Presidenti amerikan, Donald Tramp, do ta dekorojë me “Mirënjohjen për të arriturat jetësore”.

Më vitin 2018 Presidenti i Republikës së Shqipërisë Ilir Meta vlerësoi klerikun e shquar shqiptar, Reisul Ulema-n e Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, Haxhi Sulejman Efendi Rexhepin, duke e dekoruar me Titullin “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut” me motivacionin: “Për merita të shquara në promovimin e vlerave të paqes, dashurisë, humanizmit, harmonisë e bashkëjetesës ndërfitare. Në vlerësim të mbrojtjes së interesave dhe jetës fetare islame mes shqiptarëve, të kujdesit për zhvillimin e shkollimit, të institucioneve fetare në frymën kombëtare, si dhe përpjekjeve për mundësimin e urave lidhëse mes mendimit tradicional islam dhe mendimit bashkëkohor e intelektual shqiptar”.

Më vitin 2019 vlerësohet me titullin “Misionar Paqeje” dhe Ambasador Nderi i DMPP (Misioni Diplomatic për Paqe dhe Prosperitet (Diplomatic Mission Peace and Prosperity), i akredituar nga OKB, NATO dhe një sërë organizatash të tjera ndërkombëtare, në bashkëpunim me partnerët e vetë

ndërkombëtarë, si American Diplomatic Mission for World Peace, etj.

Natyrisht, këto të arritura, këto suksese, këto përvoja e këto aktivitete kombëtare e fetare, të cilat nuk i shkuan ndorësh asnjë lideri fetar në rajon e më gjërë, pa dyshim që

H. Sulejman ef. Rexhepin do ta bënë një figurë markante në mesin e personaliteteve më të shquar të Kombit tonë. Këto të arritura jetësore do ta mbajnë fuqishëm në pedestalin e figurave shqiptare në historinë tonë gjithëkombëtare.

Një personalitet kaq të madh, nuk do të guxonte asnjë pushtet në botë që ta eliminonte “fshehurazi” sepse, do t’ia shtonte edhe më shumë peshën e heroit kombëtar. H. Sulejman ef. Rexhepi trimërinë e vet prej heroi të gjallë e demonstroi pa ngurrim edhe para pushtetarëve maqedonasë, kështu që, çdo eliminim i tij, pa dyshim që do të llogaritej si hakmarrje e pushtetit maqedonas. Pushteti maqedonas, pa dyshim që do ta përdorte metodën e njohur në historinë fatkeqe shqiptare. Shqiptari trim e i ditur “vdes” vetëm nga dora e shqiptarit. Dhe, kjo dorë, që të jetë sa më kallaballëk, ata i përdorën të gjithë mashat e veta që ia kishin varur me kohë në qafë H. Sulejman ef. Rexhepit, i cili për pushtetin maqedonas ishte gacë shumë përvëluese. Prandaj, përmes mashave të tipit të Shaqir Fetait, do ta eliminojnë, duke i thurrur lloj-lloj intrigash e kërcënimesh.

Ja ku jemi sot, me një Bashkësi Fetare Islame të drejtuar nga njerëz të instaluar nga pushteti maqedonas, si shpërblim për karrierën e tyre besnike në bashkëpunim me shërbimet sekrete.

BFI-ja nuk do të guxojë më ta sjellë Maqedoninë e Veriut në pozita të rënda para ndërkombëtarëve siç e solli Sulejman Rexhepi më vitin 2013 duke ia bojkotuar Konferencën ndërkombëtare me liderët botërorë fetarë, në shenjë revolte për mosndërtimin e xhamisë së djegur në Prilep dhe për disa arsyesh të tjera të karakterit të diskriminimit fetar. Shaqir Fetai e jep edhe nderin dhe moralin, vetëm të marrë pjesë në një konferencë të tillë, ku do të kishte rastin t’i zgjasë buzët e pelës duke i kritikuar se pse kanë hezituuar deri më sot dhe nuk ia kanë uruar postin “reisul ulema” si instalacion të pushtetit aktual maqedonas.

*(Lajme7, 15.02.2021)*

## Shaqir Fetai vazhdon me shkeljet e normave juridike të BFI-së

**Shaqir Fetai po sillet si Faraoni bashkëkohor! Ka uzurpuar BFI-në dhe aty vret e pret sipas kutit të vet! Shaqir Fetai nuk ndjenë kurrfarë nevoje për drejtësi, rrjedhimisht nuk ndjenë as nevojë për përgjegjësi, sepse, e ndjenë fuqishëm mbështetjen dhe përkrahjen e pushtetit aktual që është shumë i interesuar për një anarki totale në BFI**

### *Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së*

Shaqir Fetai na e paska dekretuar për myfti personin të cilin “Rijaseti” i falcifikuar e paska votuar me aklamacion! Çka do të bënte ky farë “rijaseti” përveçse ta votonte të vetmin kandidat që erdhi si dëshirë megallomane faraonike e Shaqir Fetait.

Shaqir Fetai nuk e ka pasur hallin që ta bëjë Myftininë e Gostivarit me myfti legal, por, që ta demonstrojë “fuqinë” e vet që ka mbështetjen në fuqinë e pushtetit maqedonas. Kësisoj, ai, me fuqinë e pushtetit maqedonas zgjodhi një myfti. Aferim ORAO-s!

Shaqir Fetai vazhdon me shkeljet monstruoze të normave juridike të BFI-së! E shkelë Kushtetutën e BFI-së. Nuk thirret në asnjë akt normativ, nuk thirret në asnjë nen e në asnjë procesverbal dhe, për pasojë, nuk kemi asnjë argument që flet për një proces të rregullt, përkundrazi, flet për arrogancën e Shaqir Fetait, ose për injorancën e tij në punët menaxheriale të BFI-së. Është e habitshme se si edhe “myftiu” i zgjedhur ka pranuar një post me njëmijë shkelje që nuk i bën kurrfarë nderi vetë atij. Punët banditeske gjithësesi që janë të dënueshme dhe një ditë do të përgjigjen që të gjithë. Neni 31 i Kushtetutës së BFI-së thotë: “Muftinia kandidon kandidatë të mundshëm për mufti...” Sipas këtij Neni, deri te anëtarët e Rijasetit do të duhej të vinin më së paku dy emra kandidatësh për myfti të Gostivarit, dhe jo të vie vetëm përcaktimi i Shaqir Fetait për një kandidat i cili, nuk e ka mendjen te jeta fetare sa te postet e tij administrative (një njeri normal për asnjë çmim dhe hatër nuk do ta pranonte postin inegzisten “u.d. myfti”!

Shaqir Fetai gënjenë kur thotë se ky ishte emri i propozuar nga anëtarët e Myftinisë së Gostivarit! Cilat forume të kësaj Myftinie e propozuan emrin përkatës përveçse përcaktimi mafioz i Shaqir Fetait. Asnjë emër nuk erdhi në Myftini të propozuar nga forumet kolektive të Myftinisë dhe që, pastaj, ata emra të vinin në Rijaset si propozime të anëtarëve të Myftinisë.

Shkurt, Shaqir Fetai e përsëriti të njëjtë praktikë mafioze të parë më herët nëpër disa Myftini. Shaqir Fetai me këto sjellje të tij prej sharlatani, në fakt po përçon mesazhe se, ai është mbi çdo akt normativ; ai është “perëndia” e BFI-së, duke mos kuptuar se ai po e ngarkon veten me një peshë e cila do ta fundosë në pafundësitë më të thella. Edhe një herë, Shaqir Fetai e humbi të drejtën për të folur për islamin, e cila i ka të shenjta normat dhe rregullat islame, nuk ka të drejtë për të folur për BFI-në si të vetmin Institucion fetar islam në vend, pasi që ai manifeston sjellje të pahishme në raport me këtë Institucion të cilin e ka privatizuar deri në përmasat e një fosili të gjetur në shkretëtirë.

Me këtë sjellje, Shaqir Fetai nuk ka absolutisht të drejtë që të thërrasë myslimanët e vendit për të kontribuar për mirëvajtjen e punëve në BFI, sepse, ia ka shkatërruar tërë integritetin. Një Institucion

pa integritet është, thjesht, një gurë, i cili, edhe si i tillë ka funksionin e vet. BFI-ja e Shaqir Fetait, thjesht, është pa kurrfarë funksioni dhe pa kurrfarë peshe. Kjo është e dënueshme dhe, dënimi do të manifestohet me injorim kolektiv të myslimanëve të vendit që do t'ia bëjnë BFI-së së Shaqir Fetait.

*(1Kliklart, 16.02.2021)*

## **Bashkësia Fetare Islame në RMV**

**Bashkësia Fetare Islame ka bekimin e Allahut xh.sh. dhe, nën këtë bekim, nuk mund të jenë edhe ata që nuk ia duan të mirën islamit, që i përbuzin dhe i shkelin parimet islame, që organizimin e jetës fetare islame e bëjnë nga prizmi partiak- ateist**

**Shkruan Afrim Tahiri**

Republika e Maqedonisë së Veriut përgjatë vitit 2020 përjetoi një sërë zhvillimesh të rëndësishme politike, socio-ekonomike, shëndetësore si dhe fetare. Kaloi dhe akoma po kalon periudhë të rëndë shëndetësore si pasojë e pandemisë së koronavirusit Covid-19. Si pasojë e shumë problemeve të brendshme politike, si pasojë e kapjes së shtetit, si pasojë e mosreformave thelbësore në sistemin e drejtësisë, si pasojë e ngjalljes së nacionalizmit maqedonas duke u përpjekur për të ushtruar superioritet etnik e politik si, brenda vendit ashtu edhe ndaj fqinjëve, Republika e Maqedonisë së Veriut edhe sivjet ngeli larg mundësive për fuqizimin e ndryshimeve imediate për të nisur bisedimet rreth inkuadrimit të saj në BE. U shtua demoralizimi i popullatës! U shtua varfëria në popullatë. Paketat sociale si ndihmë për t'i përballuar problemet si pasojë e koronavirusit, nxorën në shesh një mori anomalishë të cilat ndër faktorët e jashtëm më tepër u vlerësuan si burim i mundshëm për shplarje parashë, për vjedhje e pasurim, se sa si ndihmë e sinqertë dhe shtetërore ndaj shtresave vulnerablë.

### **Besueshmëria ndaj BFI-së**

Raporti i Stejt Departamentit për liritë fetare për vitin 2019 nuk ishte i favorshëm për Bashkësinë Fetare Islame, e cila u përball me një skenar shumë të rrezikshëm që mbante erë politike nga njerëzit e pushtetit. Aktorët u përmedon me emër e mbiemër, gjë që nuk i bën aspak nder Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe përcaktimeve të saj për një sistem me demokraci të mirëfilltë.

Nga opiniononi i gjërë, nga analistë e intelektualë u vlerësua se, i njëjti skenar u përsërit edhe në maj të vitit 2020, ndonëse “më i sofistikuar” dhe “më demokratik”! U vlerësua si sulm i pushtetit për ta futur në duar të vetmin Institucion fetar Islam dhe për të arritur çfarëdo ndikimi politik te elektorati i myslimanëve në Maqedoninë e Veriut, elektorat ky që të dy partive në pushtet u ka dhënë mjaft vota sa për të themeluar një pushtet tejet të brishtë.

Natyrisht, përkundër të gjitha përpjekjeve që puçit klasik që u zhvillua në BFI t'i japin karakter kriminal që ka shkaktuar probleme të rënda ekonomike e financiare brenda Institucionit, dora politike ngeli në të thatë dhe dolën sheshit të gjitha skenaret e pushtetit.

Kjo përzirje e partive politike aspak nuk u prit mirë nga faktorët ndërkombëtarë. U pranua se pushteti aktual e paska ndihmuar financiarisht BFI-në sa për t'i tejkalluar problemet financiare që na i paska ky Institucion. Vetë fakti që qëndrueshmëria financiare vijon të jetë dimensiononi më i dobët i këtij Institucioni flet se, kalkulimet politike do të ndikojnë edhe në besueshmërinë e besimtarëve ndaj BFI-

së, të cilët, në shumicë as që dëshirojnë të shtrijnë dorën e ndihmës, sadoqë mund të jenë militantë partiakë. Kjo flet se myslimanët e vendit nuk e dëshirojnë një Institucion fetar të politizuar, aq me pak të partizuar, aq më pak që pushtetmbajësit të fusin duart në të gjitha sektoret e saj.

## **Kuadri ligjor i shtetit dhe i BFI-së**

Mjedisi ligjor për bashkësitë fetare si dhe grupet religjioze në Maqedoninë e Veriut ka pësuar disa ndryshime, edhe atë, në varësi të interesave politike. Ndryshimi i fundit i Ligjit për pozitën juridike të kishës, bashkësisë fetare dhe e grupeve religjioze, është ai i vitit 2007, i cili nisi të zbatohet nga 1 maji i vitit 2008. Me këtë ligj nuk rregullohet kurrfarë raporti në mes të kuadrit ligjor shtetëror si dhe të institucioneve, organizatave dhe asociacioneve fetare e religjioze. Thjesht, është një konglomerat i ligjeve të kushetutave të bashkësive fetare dhe e statuteve të grupeve religjioze. Nëse bëhet krahasimi i ligjit të mëparshëm me atë të ligjit që pësoi ndryshime themelore, del në shesh përpjekja e vetme për t'u liruar nga një nen (neni 6/1997), i cili qartë e nënvizon nërhyrjen e domosdoshme të organeve shtetërore në rast të devijimit të punëve në cilindo bashkësi fetare apo grup religjioz. Është për t'u habitur se si në rastin e Bashkësisë Fetare Islame nuk ka kurrfarë raporti të organeve gjegjëse shtetërore për ndonjë rast abuzimi apo ndërhyrje shtetërore për gjatë vitive 2019/2020! Edhe mjetet e informimit, qoftë të shkruara qoftë vizive, kan qëndruar sa më larg aferave në të cilat kanë qenë të përziera lloj-lloj struktura pranë pushtetit. Pushteti në asnjë moment nuk ka marrur mundin që të organizojë ndonjë komision apo audit të pavarur i cili do ta hulumtonte dhe analizonte mirë e mirë përfshirjen eventuale të segmenteve të pushtetit në degradimin dhe në deinstitutionalizimin e Bashkësisë Fetare Islame në RMV.

Neni 6 i Ligjit për kishën, bashkësitë fetare dhe grupet religjioze, të vitit 1997, thoshte: “Tubimet fetare, parimet fetare, vula fetare... nuk guxojnë të përdoret për qëllime politike, për nxitje të mostolerancës fetare, nacionale si dhe për qëllimet e tjera të ndaluara me Kushtetutë dhe me ligj”!

Në Bashkësinë Fetare Islame pati përpjekje të pushtetit që të instalohet një “reis politik” me ndihmën e gjykatës shtetërore! Jo myslimanët, jo organet e BFI-së, jo sipas Kushtetutës së BFI-së por, të imponohet “reis” me vendim gjykate. Një proces i tërë i falcifikuar! I falcifikuar tubimi, e falcifikuar vula, i falcifikuar kuadri fetar zgjedhor! Pushteti vetëm sa e vështroi i nemitur këtë cirkuziadë dhe u turpërua nga skenari qesharak që u bë lëndë e raportit amerikan!

I njëjti skenar u përsërit më vitin 2020! Por, kësaj radhe duart e pushtetit nuk u vërejtën në mënyrë aq transparente.

Ndodhi i njëjti skenar por me aktorë të tjerë, “më profesionistë”, ndonëse edhe këtu pati tubim të falsifikuar, falsifikim të vulave dhe të kuadrit vendosës për shkarkim dhe emërim!

Pasuan një mori shkeljesh të kuadrit ligjor si të organeve të shtetit ashtu edhe të vetë Kushtetutës së BFI-së e cila është e deponuar në Gjykatën Themelore – Shkupi 2, organ ky që duhet të jetë mburojë dhe garancë e zbatimit të çdo germe të aktit më të lart normativ që është deponuar aty!

Bashkësia Fetare Islame ka Kushtetutën e vet dhe, nuk pranon kurrfarë vendimesh të organeve kolektive që bien ndesh kësaj Kushtetutë, me përjashtim të gjendjeve të jashtëzakonshme kur edhe mund të imponojnë miratim të ligjeve që nuk i parasheh as Kushtetuta dhe as aktet e tjera normative të BFI-së. Për shembull, u soll vendimi që për shkak të pandemisë “të mbyllen” xhamitë, të mos ketë tubime, falje kolektive, të mos falet xhumaja në xhami dhe të mos festohen masovikisht festat fetare! Megjithatë, organizimi i jetës fetare, organizimi i organeve, institucioneve, zgjedhjeve, mënyra e zgjedhjeve, përzgjedhja e kandidatëve për zgjedhje, nuk mund të ndodhë ndryshe përveçse ashtu siç

e parashohin aktet normative të BFI-së. Në raste të jashtëzakonshme pezullohen të gjitha aktivitetet, përfshirë edhe zgjedhjet dhe, nuk ka aktivitete përderisa nuk kalon gjendja emergjente!

Pushteti aktual, pa dyshim që i keqpërdori këto masa emergjente, e keqpërdori situatën dhe, për politika ditore, lejoi, motivoi madje edhe zhvilloi skandale të parikuperueshme në BFI. Askush nuk e parashikoi se këto skandale do të mund të ishin fillimi i fundit të koegzistencës në Maqedoninë e Veriut dhe, kuluareve të diplomacisë evropiane përflitet ky rast, duke menduar që edhe tejkalimin e kësaj krize ta bëjnë si kusht për fillimin e negociatave me BE-në. Një shtet me një bashkësi fetare islame të politizuar në format të “bombës atomike” nuk i duhet BE-së.

Në BFI tashmë janë përçuar mesazhet e ndërkombëtarëve: “Nuk ka respektim por as BFI pa rikthimin e integritetit të saj, i cili nënkupton, sanim të të gjitha instalimeve të dobëta dhe pasojave nga shkeljet e kushtetutshmërisë së BFI-së”! Qëndrimet për bashkëpunim mund të përafrohen vetëm pasi të jetë qind për qind e gatshme BFI- ja për kthim në normalitet dhe për sanskionim të të gjithë atyreve që shkelën mbi integritetin e BFI-së shekullore.

## **Kapaciteti organizativ aktual**

Kapaciteti organizativ i BFI-së pati një rënie rapide. Jo vetëm problemet ekonomike por edhe humbja e besueshmërisë në organet menaxhuese të BFI-së ndikuan që gradualisht të shterrojnë burimet financiare të BFI-së, që kryesisht janë kontributet financiare fetare të besimtarëve të vendit dhe nga diaspora. Përkundër këtyre problemeve organet e BFI-së, të cilët e përbejnë organin më të lartë kolektiv, Rijasetin, vazhdimisht kanë raportuar për qëndrueshmëri dhe avancim financiar të këtij Institucioni! Në fund, e pranuan se “u deshtën ndryshimet për shkak të dobësimit financiar të BFI-së”!

Në çka po mbështetet aktualisht këto kapacitete organizative dhe “zhvillimore”? Kryesisht në të hyrat nga letrat me vlerë nga procesi i denacionalizimit të pronave të vakëfit! Megjithatë, këtu edhe po ndodhë mëkati më i madh si dhe veprimi në kundërshtim me të gjitha parimet fetare (kjo gjë sanksionohet me nenin 6 të Ligjit për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze të vitit 1997), por edhe me dispozitat ligjore të shtetit! Financat e dedikuara nuk mund të keqpërdoren e të shpenzohen për qëllimet të tjera. Këtë e sanskionojnë ligjet e shtetit. Në BFI, “shitet” (në fakt, falet) vakëfi për rroga, ndërkohë që me ato para duhet të blehet tjetër vakëf, mundësisht të shtohet dhe jo të shpenzohet!

Mungesa e kapaciteteve profesionale sjell vendime qesharake, për të mos thënë idiotike, jasht trurit të shëndoshë. Keni dëgjuar se si trumpetojnë me pompozitet se kemi “themeluar Institutin e Hifzit”! Çka nënkuptojnë këta “kapacitete” me nocionin “Institutin e Hifzit? Për çfarë degësh të hifzit angazhohet ky Institut. Çfarë kërkimesh studimore kryhen në këtë Institut, kush i kryen ato, kush ia vlerëson rezultatet? Clat janë sektoret e këtij Instituti, a ka paraparë “themeluesi” ndonjë laborator të domosdoshëm për këtë Institut? Fjala Institut do të thotë: “Shkollë e lartë që përgatit specialistë për një a për disa degë të ekonomisë e të kulturës (përfshirë këtu edhe të fesë), të shkencës e të teknikës; qendër për kërkime e studime shkencore në një fushë të caktuar, me disa sektorë, me laboratorë etj.” Kohë më parë këta “kapacitete” diletante dolën edhe me një nocion të një “instituti” që nuk ekziston askund në botë. Thanë se jemi gati ta hapim “Institutin e Arkivit të BFI-së”!!! Instituti është institut, arkivi arkiv! Mund të thuhet se po themelojmë Arkivin e BFI-së, si institucion më vete, por jo si Institut! Fondi i librave të vjetra nuk mund të përfshihet në Arkiv, pasi që është materie e bibliotekave, reliktet muzeale nuk mund të futen në arkiv pasi që janë lëndë e muzeve, as veshjet, objektet e ndryshme folkloristike nuk mund të futen në arkiv pasi që janë lëndë e etnologjisë. Ky “kapacitet kadrovik” i BFI-së duhet të dijë se, paralelisht me këtë ide duhet të funksionojë tashmë edhe komisioni

gjegjës i cili do të merret me përcaktimin e objekteve arkivore, me dorëshkrimet, me dokumentat, të cilat, pastaj duhet të kenë komision të posaçëm i cili merret me vlerësimin e peshës së dokumentave dhe, varësisht nga ajo peshë, ka dokumenta që ruhen për dy vite, për pesë vite dhe përjetë! Fjala arkiv do të thotë: “Institucion që merret me grumbullimin, ruajtjen, sistemimin dhe pjesërisht edhe me botimin e dokumenteve e të dorëshkrimeve me vlerë historike; ndërtesa e këtij institucioni. Arkiv historik (qendror). Arkivi i shtetit. Punonjësit e arkivit. Fondet (materialet) e arkivit. Nxjerr nga arkivi.”

Aktet themeltare dhe nënligjore, vendimet e organit themeltar, duhet të jenë dokumentat e para që duhet të arkivoheshin dhe jo vendimi personal i një “reisi” totalisht ilegal, një kuadër politik dhe i shërbimeve të diskutueshme. Sa mund të themelojë ky “reis” diçka bazuar në vendimet dhe ligjet e Kushtetutës, ku ai tashmë është kualifikuar në shkelës kushtetutar të çdo akti normativ të BFI-së!

## Advokimi

Edhe gjatë vitit 2020 advokimi në kthim të normalitetit të BFI-së ishte shumë i fortë. Ky advokim u zhvillua kryesisht nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI. Së fundmi, këtij advokimi iu bashkangjiti edhe Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetushmërisë së BFI-së. Lëvizja edhe më tej u mor kryesisht me dedektimin e problemeve të shumta si dhe me përpjekjet për ta devaluuar deri në shkatërrim këtë Institucion. Ndërsa Këshilli për mbrojtjen e Kushtetushmërisë u themelua nga një grup i konsiderueshëm i teologëve të vendit fill pas uzurpimit të Rijasetit dhe pas puçit politik që u instalua në Bashkësinë Fetare Islame pas disa përpjekjeve të njëpasnjëshme të pushtetit aktual. Ky këshill u angazhua për t’i dedektuar të gjitha shkeljet kushtetutare, si dhe u angazhua në gjetjen e modaliteteve për përafrimin e qëndrimeve me opozitën e BFI-së (Lëvizjen), e cila të vetmën kërkesë e kishte kthimin në normalitet të BFI-së si dhe në sanksionim të të gjithë shkelësve të Kushtetutës së BFI-së.

Vlenë të nënvizohet edhe guximi intelektual i ish-reisit i cili vendosi që publikisht të dalë në televizion (TV21) dhe për të pohuar përzierjen e pushtetit aktual (BDI-LSDM) në BFI. Ish-reisi pati guxim që në emisionin Klik Plus të datës 11 nëntor 2020 të përmend edhe emra politikanësh të cilët kanë kërkuar prej tij që të heshtë dhe të pajtohet me vendimet politiko-partiake për ndryshimet e parapara për në BFI.

Alinea dy e Nenit 4 të Lgjit për Pozitën Juridike të kishës, bashkësive fetare dhe të grupeve religjioze, në mënyrë shumë të prerë flet për detyrimet e besimtarëve që, pavarësisht përkatësisë dhe bindjeve fetare, i kanë karshi Kushtetutës së shtetit si dhe ligjeve dhe rregulloreve të ndryshme. Falsifikimi i vendimeve, keqpërdorimi i individëve për realizimin e synimeve antiligjore, shkelja e aktit më të lartë normativ të Institucionit që mëtohet të kapet ilegalisht, janë akte të cilat që të gjithë bien ndesh ligjeve përkatëse të shtetit dhe, në një shtet normal patjetër që do të sanksionoheshin. Krijohet përshtypja se, bazuar në emërtimin e Ligjit, në të cilën Institucioni i vetëm fetar islam i myslimanëve të RMV-së nuk përmendet fare, krijohet përshtypja se ky fakt ia pamundëson organeve gjegjëse të shtetit që të ndërhyjnë në të mirë të BFI-së! Ligji nuk e përmend askund fjalën “islam-e”, prandaj dhe, nuk ka ndërhyrje të organeve përkatëse në Bashkësinë Fetare Islame, prandaj dhe, u lejohet “minjëve që të bëjnë dasëm në mungesë të maçokut”!



## Imazhi i BFI-së

Imazhi i BFI-së ka rënë dukshëm. Për pasojë ka humbur besueshmëria e myslimanëve ndaj Institucionit të vetëm fetar islam në RMV, të cilën, për këto vite e kanë pëcjellë një sërë skandalesh të paharrueshme. Sot, ekziston bindje e fortë se ky Institucion drejtohet nga bashkëpunëtorë të shërbimeve të ndryshme intelektuale, nga njerëz të pakualifikuar, të padiplomuar, me diploma të blera, të falsifikuara, nga hajnat, tradhëtarët, nga imoralët dhe amoralët.

Sot, BFI-ja kundrohet si një shtëpi e dallkukëve, e honxho-bonxhove që natë e ditë planifikojnë se si ta rjepin popullatën, si të vjedhin, si ta hanë kurbanin, si ta vjedhin haxhin, si t'i gllabërojnë të hyrat nga fitri e zeqati, si ta shesin e ta falin vakëfin. Janë publikuar qindra fakte e argumente që flasin për këto dukuri antiislame dhe asnjëherë nuk u demantuan, asnjëherë nuk u tha e kundërta e asaj që u botua.

BFI-ja e sotshme llogaritet si filiale e BDI-së, apo si institucion i bdizuar ku më tepër shprehet kujdesi për parimet partiake se sa për parimet fetare.

Përmirësimi i imazhit të BFI-së do shumë punë dhe do kohë të gjatë, sepse, perceptioni i myslimanëve aktualë do kohë e do shumë mund që të ndryshohet kah e mira dhe e mbara. Veç kësaj është perceptioni i pandryshueshëm edhe fakti që këta “kapacitete” të cilët e sollën në këtë derexhe BFI-në, nuk mund të jenë përmirësues të imazhit të saj. Pa një imazh të mirë, pa atë imazh të cilën BFI-ja e pati historikisht, vështirë se do të kthehen me kontribute personale e vullnetare të myslimanëve të vendit. Imazhi i këtij Institucioni nuk mund të kthehet me strategjinë e “pritjeve, urimeve dhe përsëndetjeve” që mbulojnë pasivitetin dhe mosdijet menaxheriale të “reisit” partiak i cili po “menaxhon” me bekimin e pushtetit politik aktual. Pritjet, përcjelljet, urimet e përsëndetjet mund të jenë në masë prej 1000-5000 apo 10 000 personave. Por ama, urrejtja prej 1 000 000 e më shumë shqiptarëve anekënd botës, si lexues dhe komentues mbi analizat, komentet dhe raportet e shumta, flasin për një masë kritike e cila duhet ta brengosë jo vetëm çdo “reis partiak” por edhe çdo pushtet që i futet aventurës për të menaxhuar me Bashkësinë Fetare Islame.

Bashkësia Fetare Islame ka bekimin e Allahut xh.sh. dhe, nën këtë bekim, nuk mund të jenë edhe ata që nuk ia duan të mirën islamit, që i përbuzin dhe i shkelin parimet islame, që organizimin e jetës fetare islame e bëjnë nga prizmi partiak-ateist.

*(KohaNews, 17. 01. 2021)*

## Ku po i dhemb Shaqir Fetait

### *Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI*

Më 16 shkurt të vitit 2021, Shaqir Fetai, na e paska mbledhur “rijasetin” e vet me ç’rast kanë shqyrtuar këtë rend dite: Informatë e Reisul Ulemasë për aktivitetet mes dy mbledhjeve, Emërimi i Myftiut të Gostivarit, Shqyrtimi i raporteve të punës për vitin 2020 dhe planet financiare për 2021 të Myftinive të BFI-së, Raporti i punës së BFI për vitin 2020, Llogaria përfundimtare për 2020 dhe Plani-financiar për 2021 i Rijasetit të BFI, Përcaktimi i datës për mbledhjen vjetore të Kuvendit të BFI, shqyrtimi i kërkesave të Myftinisë së Kumanovës dhe Dibrës, Themelimi i institutit shkencor të BFI! Ndërsa sot, në një informatë të BFI-së së Shaqir Fetait na thuhet se, ky farë “reisi” e paska shqyrtuar edhe situatën e fundit, gjegjësisht regjistrimin e të ashtuquajturës Bashkësi Islame Selefiste “Dar el Hadith”, me ç’rast paska sjellë disa konkuzione, të cilave ai u thotë “vendime”!

“Bashkësia” që e paska shastisur Shaqir Fetain në fakt është regjistruar dhe ka filluar me punë që nga 20 dhjetori i vitit të kaluar!

Ish-reisul ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi, në fb-në e vet, reagon qysh më 21 janar të këtij viti, duke ia tërhequr vërejtjen Shaqir Fetait që po i bën koncensionet nëntokës antiislame vetëm e vetëm që ta përkrahin në projektin e tij shkatërrimtarë të BFI-së gjashtëshekullore. Efendi Rexhepi thotë: “Dëmi po i bëhet institucionit shekullor të cilin po mundohen t’ia humbin autoritetin dhe vlerat duke ia shtuar numrin e institucioneve dhe fraksioneve fetare në Regjistrin Qëndror nga 1 Bashkësi islame dhe 2-3 grupe religjioze që kanë qenë, tani janë 3 Bashkësi islame dhe 12 grupe religjioze. Dhe fatkeqësisht, ky trend vazhdon deri në shkatërimin e institucionit të vetëm që ishte, edhe një herë po e cek, 600-vjeçar e që për ne është amanet. Unë për vete vetëm një gjë e di se, s’jam pjesë e tyre as politikisht e as shpirtnisht.”

Kurse, edhe zëvendëskordinatori i Këshillit për mbrojtje të kushtetutshmëisë së BFI-së, Mr. Eset Shaqiri, ka botuar shkrimin e vet autorial në shumë portale kombëtare qysh më 2 shkurt të këtij viti, me të cilin e nënvizon dukurinë anti-BFI që po ndodhë nga institucionet e shtetit.

Shaqir Fetait i del gjumi sot dhe reagon përmes disa “vendimeve”! Kujt i reagon? Pse reagon? Vetëm sa për t’i hedhur hi syve! Thotë se i paska informuar edhe kryetarin e shtetit, edhe kryeparlamentarin edhe do faktorë të tjerë, por nuk tregon asgjë për reagimin dhe shqetësimin e tyre! Kujt t’ia tregojnë? Shaqir Fetait i cili është shkatërruesi i paimagjinuar i BFI-së?

Institucioneve shtetërore të cilëve u reagon Shaqir Fetai, janë po këta institucione të cilët dje Shaqir Fetain e regjistronin me “tituj” të cilat nuk i parashihte asnjë normë juridike as e BFI-së e as e shtetit. Formonte “rijaset” përmes formave nga më tradhëtueset, të sanksionuar me ligjet e shtetit! Falcifikoi kuorum, falcifikoi nënshkrime e vula, falcifikoi organe e institucione, vetëm e vetëm që të bëhet “ushtrues detyre”! Shkeli dhjetra nene të Kushtetutës së BFI-së, shkeli dhjetra nene të rregulloreve dhe të akteve të tjera ligjore, përjashtoi nga procesi organe kolektive të BFI-së, përmes metodave të mesjetës së errët zgjodhi që të formojë organe e të sigurojë përkrahës për rrënimin e BFI-së! Do me thënë, Shaqir Fetai bën ta shkatërrojë BFI-në, por jo edhe të tjerët! Nuk pranon konkurrencë në këtë shkatërim të BFI-së dhe të unitetit! Pse të ndjejë kënaqësi vetëm Shaqir Fetai, të cilin po e uruakan e përhëndetkëkan dhjera qytetarë të Maqedonisë së Veriut, dhe këtë kënaqësi nuk duhet ta ndejnë edhe të tjerët!

Është konstatim i pamohueshëm: Shaqir Fetai i është futur aksionit serbo-sllav për ta shkatërruar

Institucionin që ka një histori më të gjatë se shumë shtete në rajon! Punën që e ka bërë BFI ndër shekuj për shqiptarët dhe myslimanët e vendit e më gjërë, nuk e ka bërë asnjë shtet! BFI-ja dikur shtrihej nga Gjevgjelia e deri në Beograd e në Podgoricë, në krejt Kosovën dhe në Luginën e Preshevës, ndërsa sot ka peshën dhe hartën gjeografike të përmasave të Çegranit!

Këtë nuk e sheh vetëm Shaqir Fetai, apo bëhet kinse nuk e sheh. Është demagogji dhe intrigë totale kjo e Shaqir Fetait, i cili, nuk reagon në ditën pas mbledhjes së “rijasetit” të vet, por pret të kalojnë 3-4 ditë, kjo flet se ai këshillohet me struktura jashtë BFI-së, merr instrukcione prej tyre dhe, reagon formalisht, sa për t’iu bashkangjitur reagimeve të përditshme të Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI, lidhur me këtë fenomen që është edhe më i madh se sa ky i regjistrimit të një “BFI”-je të re! Janë edhe më shumë “bashkësi” dhe “grupe religjioze”, të cilat, deri para se t’i futej lojës së ndytë Shaqir Fetai, as që ekzistonin.

Reagimi i sinqertë, që shpreh shqetësim fetar e kombëtar, në vete ngërthen edhe ultimatumin, si dhe njohtimin e të gjithë faktorëve relevantë me këtë ultimatim pas skadimit të së cilit nuk ka kthim mbrapa! Ndryshe, është vetëm një reagim formal i një qyqari!

*(1Kliklart, 18.02.2021)*

## Sa më të sektarizuar myslimanët aq më i plotë (sigjeldet) Shaqir Fetai

Meqë u shterrën të gjithë organet dhe institucionet e Bashkësisë Fetare Islame të Shaqir Fetait, meqë u shterrën deputetët, drejtorët, funksionarët e BDI-së, partisë që e instaluan në postin e “reisit”, meqë u shterrën edhe funksionarët kryesorë të pushtetit aktual maqedonas, të cilët, që të gjithë i shprehën urime dhe përshëndetje Shaqir Fetait për kapjen e kreut të BFI-së me intriga e dredhira dhelprake, këtë praktikë kanë vendosur që ta vazhdojnë edhe të gjithë bashkësitë fetare islame si dhe grupet religjioze që praktikojnë besimin islam(!)

Kanë vendosur që Shaqir Fetain ta përshëndesin dhe ta urojnë si dhe t’i dëshirojnë suksese në shkëlshmeri të Kushtetutës së BFI-së, këta subjekte fetare e religjioze:

Bashkësia Islame Selefiste, Shkup;

Bashkësia Fetare Bektashiane me seli në “Hadër Baba Teqe”, në Kërçovë;

Komuniteti i grupit kaderi “Xheneti” në Kumanovë;

Komuniteti i Grupit Bektashian Ehlibejtiane të Maqedonisë së Veriut, Kërçovë;

Ehli Sunet ve Xhemat (Xhamia Trizlla), në Prilep;

Komuniteti i Grupit të Tarikatit Sufij, me seli në Teqe, Shkup;

Bashkësia e Xhematit Ehli Sunet – Kumanovë;

Froni i shenjtë i erfenëve sufistë;

Komuniteti i grupit Kaderi Bedevi “Zekerija” – Kumanovë;

Bashkësia Fetare Bektashiane me seli në Arabati Baba Teqe”, Tetovë.

Kjo është pasqyra e “unitetit” të besimtarëve të cilën e paraqet Shaqir Fetai. Ai, për momentin, është tepër i lumtur për këtë “unitet”, sepse, thellë në vete beson se, situata e përçarjes mund të jetë edhe më katastrofale. Ky është misioni i Shaqir Fetait: ta kamuflojë unitetin e myslimanëve të vendit dhe ta paraqesë si shumë të kënaqshme. Madje, flitet se në mes të këtyre grupeve sektariane ka një marrëveshje që, Shaqir Fetain ta lënë të qetë, mos t’i dalin zot secili komunitet vakëfit në vendin e vet, ndërsa si kundërshtpërblim Shaqir Fetai do t’i “darovisë” me buxhet nga fitri e zeqati. Myslimanët e vendit, përmes Shaqir Fetait, do të kontribuojnë financiarisht në sektarizim të besimtarëve. Situata vetëmsa do të vie e do të përkeqësohet shumë e më shumë, sepse, sa më e parcializuar shoqëria myslimane aq më i plotë (si gjeldet, si kaposh) Shaqir Fetai, si ato tollumbacet që provohen deri sa të pëlcastin dhe askund të mos u gjenden copët.

*(1Kliklart, 20.02.2021)*

## Një vizitë pa urime dhe përshëndetje për Shaqir Fetain

Këto ditë, Shaqir Fetain privatisht e kishte vizituar Kryetari i Unionit të Qendrave Islame në Gjermani (UIAZD) Mensur ef. Halili. Ai kishte ardhur për “t’u njohtuar” ekskluzivisht me planet e Shaqir Fetait për të ardhmen e BFI-së. Sipas të gjitha gjasave, efendi Halilit nuk i kishte pëlqyer plani diletantesk i Shaqir Fetait ndaj dhe nuk ia kishte uruar “reisllëkun”.

Është vizituesi i parë, që nga maji i vitit të kaluar, që vjen te Shaqir Fetai e që nuk ia uron instalimin nga pushteti maqedonas në krye të BFI-së. Mbase edhe kanë harruar t’ia shtojnë fjalinë shabllon që përmbanë urime dhe përshëndetje, siç ia shtonin të gjithë të ftuarve nga Shaqir Fetai, si dhe ndërkombëtarëve të cilët, gjatë vizitave zyrtare me karakter njohtues, as që u ka shkuar në mend t’ia urojnë kapjen e postit “reis” duke shkëlur mbi të gjitha aktet normative të një Institucioni. Pothuajse të gjithë ndërkombëtarët që e kanë vizituar sa për t’u njohtuar me demagogun Shaqir Fetai, janë ndarë jo të lumtur nga infomata ku kanë shartuar edhe fjalinë shabllon me urime e përshëndetje për “reisin”!

“Sektori për informim” i Shaqir Fetait duhet të ketë kujdes dhe të mos e harrojë herave të tjera shtimin e fjalisë që shpreh “përshëndetje dhe urime” për Shaqir Fetain, sepse informatat po dalin të “cunguara”, si të thata, si të pasheqerosura dhe me tendenca kundër “reisit” instalacion!

Kaq shpejt u shterrën urimet dhe përshëndetjet? Hala pa shkuar numri në 200, në falni, në 2000, na falni, në 20 000 mij, nga një milion e më shumë myslimanë nga vendi e nga diaspora?! Ky lajm është ogurzi, paraqet një fatkeqësi natyrore për Shaqir Fetain dhe për marionetat e tij. Sa keq! Me urime dhe përshëndetje të ka lezet shpirti!

*(1Kliklarg, 20.02.2021)*

## Çka po fsheh Shaqir Fetai?

**Pas shumë reagimeve të myslimanëve të vendit, më në fund, iu kujtua edhe BFI- së së Shaqir Fetait të reagojë kundër një dukurie aspak të hijshme për një shtet normal! Jo Shaqir Fetai, sepse atij i djeg, i dhemb shumë por, njerëz të kotë, dalin dhe bëjnë një reagim formal kundër gjykatës maqedonase: pse e ka regjistruar исламска селефиска заедница „ДАР ЕЛ ХАДИС“**

**Nga Ilir Ramadani**

Gati tre muaj më vonë, pasi të regjistrohet Bashkësia Selefite Islame “Dar el Hadith”, do t’ju dalë gjumi këtyre të BFI-së së Shaqir Fetait dhe do të “reagojnë”! Pse me kaq vonesë, kjo mbetet për t’u parë dhe për t’u analizuar!

Reagimi i dytë, edhe më i çuditshëm, për të mos thënë më injorant, ishte ai i Kryeministrit Zoran Zaev, të cilin, me sa duket, e kanë manipuluar rrast (ose fsheh diç edhe ky!). Ai deklaroi: “Jam i informuar nga ministri Drejtësisë, se një gjykatë e caktuar e jona ka bërë regjistrimin e Bashkësisë së tillë e cila nga aspekti i sigurisë së shtetit është problem”!

Reagimi i parë, i njerëzve të papjekur që i ndërsen Shaqir Fetai, i bie fort faktit se kreu problemi qëndron aty që, ky regjistrim është bërë pa e pasur pëlqimin e pesë bashkësive ekzistuese fetare!!! Prej nga e nxorën këtë normë këta diletantë?

Ndërsa reagimi i dytë, në këtë shoqatë joqeveritare sheh “rrezik për sigurinë e shtetit”, duke e nxjerrë në pozita qesharake pushtetin e pavarur të gjyqësorit!

I vetmi lapsuz në tërë këtë “turlitavë” është se shoqatën joqeveritare, apo këtë “komunitet frakcionist”, apo, këtë “grup religjioz” e kanë regjistruar gabimisht në grafën e bashkësive fetare! Megjithatë, le ta marrim reagimin si “brendë të sinqertë”! Madje ta pranojmë të sinqertë edhe merakun e Kryeministrit i cili i del për zot edhe çështjeve për të cilat nuk ka haber!

Në grafën e grupeve religjioze dëshkohet se në Maqedoni, konkretisht, në Kumanovë, funksionon edhe një “bashkësi” tjetër, për të cilën Shaqir Fetai dhe mentori i tij Zoran Zaev do të duhej të reagonin e të brengoseshin shumë fort për sigurinë e shtetit! Në këtë grafë figuron edhe БАШКЕСИЈА Е ЕХЛИ СУХЕТИТ Е ЦЕМАТИТ – КУМАНОВО e Sadulla Bajramit! Madje, është i vetmi “asociacion” në vend që lejohet të regjistrohet vetëm në gjuhën shqipe, ndonëse me shkronja qirilice.

Nuk e besojmë se shteti nuk e njeh këtë person, nuk e besojmë as që nuk e njeh Shaqir Fetai! Kur ish-reisi H. Sulejman ef. Rexhepi thoshte se “Sadulla Bajrami është monstrum”, Shaqir Fetai e tunte kokën në shenjë pohimi dhe i duartrokiste këtij guximi të ish-reisit të vet. Sot, nuk i degjohet zëri, sepse, kështu e ka porositur myftiu më i dashur dhe më besnik i tij, Abedin Imeri.

Kjo “bashkësi” e Sadulla Bajramit është edhe më konkurrenca dhe më e rrezikshme për BFI-në e Shaqir Fetait! Ai, xhematin e vet të ngushtë, prej nja 30-40 vetave, e zëvendëson me shumicën absolute të xhematit mysliman në Maqedoni që është i tëri xhemat “ehli sunet”! Sadulla Bajrami e di këtë fakt dhe prandaj dëshiron të jetë “kryetar” i këtij komuniteti! Pse Shaqir Fetai nuk i reagon kësaj “bashkësie paralele” e cila është qind për qind më e rrezikshme për unitetin e myslimanëve të vendit se sa “bashkësia” e z. Jakupit, e cila nuk ka më shumë se 10 anëtarë të vet!

Fundja, dihet se xhemat i cilës xhami dhe i cilës “bashkësi” janë grupi i fundit i Kumanovës që u kap

duke përgatitur aksione terroriste në vend!

Efendi Jakupi e paska regjistruar “shoqatën” e vet në adresë të shtëpisë së vet, dhe, nuk ka kurrfarë aktiviteti konkurrues e as segregues, as përçarës e as mohues në raport me shoqatën qeveritare-BFI-në e Shaqir Fetait!

Sadulla Bajrami ka tashmë xhaminë e vet, për “xhematin” e vet, për të cilën, qysh në fillim kryetari i Komunës së Kumanovës Maksim Dimitrievski ka ngritur komision për ta inspektuar objektin që e ndërtonte. Pasi kanë konstatuar se po ndërton xhami pa leje dhe pa pëlqimin e Bashkësisë Fetare Islame, meqë si komunë nuk ka pasur mekanizëm dhe as financa për ta rrënuar objektin që po ngritej në të egër, ka kërkuar ndihmë nga pushteti qendror! Të gjithë janë bërë shurdhër, siç është bërë shurdhër edhe myftiu Abedin Imeri, i cili, ka kaluar në grupin e xhematit të Sadulla Bajramit, duke e mbushur bibliotekën e Muftinisë së Kumanovës përplot me literaturë vehabiste! Efendi Jakupi, nuk i përzihet askujt në punë, nuk mohon asnjë institucion fetar e as shtetëror, por dëshiron që mos ta mohojnë as aktivitetin e tij, për të cilin thotë se është aktivitet i pastër islam i cili, meqë i ka dyert e mbyllur në BFI, detyrohet ta ushtrojë “privatisht”! Sepse, me islamin nuk mund të ketë monopol madje as Shaqir Fetai me peshën e ORAO-s së UDB-së.

Sadulla Bajrami ka xhami, ka xhemat, ka myftini dhe myfti, e me gjasë, e ka edhe Shaqir Fetain. Këto skandale i intersojnë Shaqir Fetait dhe, tërë aktiviteti i tij është që këtyre skandaleve t’u japë jetë, ndërsa këtë interesim ta kamufltojë me emrat e shoqatave që duhet të jenë interes i policisë financiare apo kriminale dhe jo i Shaqir Fetait.

Fare në fund, këto nuk duhet të jenë shqetësime as e opinionistëve, as e aktivistëve, as e shoqatave, as e anëtarëve që nuk janë “rijaset” por, duhet të jenë shqetësime dhe të ngrisin zërin e protestës Shaqir Fetai me “rijasetin” e tij të kontestuar. Natyrisht – ec e guxo e reagoi pushtetit?! Menjëherë e ha b...-ve! Mbase edhe e kanë hëngër! Mbase pikërisht këtë fakt po e fsheh Shaqir Fetai me “rijasetin” e vet!

Të jemi korrekt! Ta thërrasim edhe Kryeministrin Zoran Zaev dhe të bëjë një analizë për të konstatuar se kush përbën rrezikshmëri më të madhe për shtetin tonë! Asnjëra “shoqatë”, asnjëra “bashkësi”, as efendi Jakupi e as Sadulla Bajrami, nuk i kanë bërë asnjë gram problem BFI-së! BFI-ja nuk mundet që me dhunë të mbajë “unitet”, sepse, secili është i lirë të aderojë aty ku do, madje deri edhe në konvertime konfesionale! Ndaj dhe nuk duhet të kundërshtohen e as të etiketohen me asnjë etiketë! Problemi fatal dhe më i rrezikshëm si për BFI-në ashtu edhe për vetë shtetin është vetëm Shaqir Fetai! Gjykatësja maqedonase, fundja ka bërë regjistrimin e një “shoqate”, apo “bashkësie” konform ligjeve dhe Kushtetutës së vendit, pa shkelur asnjë normë juridike të vendit! Po a është i vetëdijshëm Zoran Zaevi se çfarë masakre i ka bërë Shaqir Fetai Kushtetutës së BFI-së, çfarë praktike është duke ushtruar e duke mbjellë?! Shkelësi më flagrant dhe më skandaloz i akteve normative të pranueshme nga të gjitha Institucionet e vendit është dhe vazhdon të jetë vetëm Shaqir Fetai! Strukturat e sigurisë duhet të analizojnë dhe t’i tregojnë drejt kryeministrin se ku mund të përfundojë siguria e shtetit me përgëdheljen që po ia bëjnë skuthit, Shaqir Fetait, i cili bën se kinse po frikësohet prej një qytetari të rëndomtë, të devotshëm, kurse asnjë zë nuk e ngritë kundër “bashkësive islame” të egra nëpër disa myftini të tij, me të cilët bashkëpunon dhe i vjel përmes personave anonimë që ky sa mbyll e hap sytë i emëroi për myfti! Ky reagim i myhybve të Shaqir Fetait kundërmon ekskluzivisht në politikë dhe asgjë nuk ka me fe e me besim, kundërmon në mobilizim për unitet partiak dhe aspak për ruajtjen e unitetit fetar.

*(Gazeta Populli, 20.02.2021)*

## Shkaku e ka emrin Shaqir Fetai

**Trendi fatal i regjistrimit të “bashkësive fetare” konkurrencte do të vazhdojë deri sa nuk do të largohet Shaqir Fetai! Ai është mirë, madje e ka edhe obligim moral (nëse i ka ngelur një pikë morali) që të largohet një orë e më parë, sepse, trangu fetar paska shpërthyer në të gjitha anët, ndërsa vetëm Shaqir Fetai ekzaltohet nga përsëritjet dhe urimet! Së shpejti do t’i kujtohet kënga e të madhit Luan Hajra: “O kuku çka i bana vetit”**

### Shkruan Abaz Islami

I ngazëllyer ngase paska arritur të mbajë mbledhjen e parë të “rijasetit”, në të cilën qenkan shpалosur fakte që flasin për mbarëvajtjen e punëve në BFI-në e Shaqir Fetait, ky i fundit, në “palimspestin” e vet në FB, askund nuk e përmend se është debatuar edhe për dukuritë e regjistrimeve të bashkësive të tjera islame në vend. Nuk e përmendin as në informacionin që e botojnë nëpër do “paçavura muri” sa për t’i treguar “armiqve” të Shaqir Fetait se, punët po i shkojnë krejt vaj!

Sakaq, dy-tre ditë më vonë dalin dhe mbajnë konferencë për shtyp duke e vënë theksin mbi shqetësimin që na qenka ngritur po atë ditë kur është mbajtur mbledhja e “rijasetit” më të kompromituar dhe më të kontestuar në historikun e këtij Institucioni. Konferencën për shtyp nuk e mban as Shaqir Fetai, asnjë funksionar i “rijasetit”, as zëdhënësi i “rijasetit”, por, thjesht, sekretari teknik i Shaqir Fetait, të cilit ai i thotë “shef kabinetit”, madje në prezencë të anëtarëve të “rijasetit” të cilët shërbejnë si dekor i kësaj konference të turpshme.

Shaqir Fetai, i kryqëzuar nga të gjitha anët, i kritikuar nga çdo forcë progresive dhe e logjikshme, i kritikuar madje edhe nga vetë anëtarët e familjes së tij, i sugjeruar që të dorëhiqet sepse la namin, i këshilluar që të largohet se është futur në lluc deri në maje të hundës, ai e organizon këtë konferencë për shtyp duke menduar se, do të dislokohet vëmendja e opinionit në dukuri që aspak nuk kanë paraqitur kurrfarë rreziku për BFI- në. As nuk kanë pretenduar që t’ia marrin ekskluzivitetin e trashëgimitarit shekullor, as t’i dalin zot vakëfit të këtij Institucioni shekullor dhe as t’ia përvetësojnë aktivitetet, institucionet dhe organet si dhe sukseset shekullore.

Rrezik potencial për qenësinë e BFI-së është vetë Shaqir Fetai. Ky farë “reisi” i qulltosur nuk ka të drejtë të reagojë, nuk ka të drejtë të drejtojë ankesa e kritika në drejtim të organeve të drejtësisë dhe as nëpunësve të këtij digasteri, nuk ka të drejtë ta drejtojë gishtin e të ankohet se çfarë padrejtësie po na bëka pushteti! Sepse, pushteti maqedonas e sollti Shaqir Fetain në krye të BFI-së; pushteti maqedonas na e bëri peshqesh këtë instalacion që është për faqe te zezë e për turp të botës; pushteti maqedonas e ndërseu që, duke shkelur dhjetra e dhjetra herë Kushtetutën e BFI-së, t’i futet një avanture e cila do të shkaktonte pasojë të mëdha e të parikuperueshme deri sa të jetë jeta!

Ae di Shaqir Fetai se, me shkeljet e veta që ia bëri parreshtur Kushtetutës së Bashkësisë Fetare Islame, të vetmit Institucion fetar islam në vend, në fakt, ju dha të drejtë të gjithëve që ta kopjojnë atë në organizim të aktiviteteve fetare! Ku ka parë Shaqir Fetai që, vetëm i pari të jetë fajtor sepse dështoi, prandaj të ndëshkohet e të largohet, kurse bashkëpunëtorët e tij të vazhdojnë si të suksesshëm dhe shpëtimtarë të Institucionit? Kur armiqtë e Institucionit, kur zinaxhinjë e komarxhinjë, pijanecë e sahanëlëpirës, bashkëpunëtorë të shërbimeve sekrete e spiunë, tradhëtarë e hajna, të korrupsuar e



të diskredituar, ia mësyjnë që të drejtojnë me Institucionin gjashtëqindvjeçar, pse njerëz të qetë, të devotshëm e të mirë të mos kenë të drejtë që të organizohen në forma ashtu siç dinë ata për të dhënë kontributin e tyre për islam. Deri më sot askush nuk ua ka diskutuar aktivitetet, kurse sot shpërthejnë në horizont kinse shashtisje se pse janë regjistruar “bashkësi paralele”!

Këto “bashkësi” nuk janë asgjë tjetër përveçse pasoja të shkakut që e ka emrin Shaqir Fetai!

Ata nuk pranojnë që të jenë anëtarë të një komuniteti ku shkilen parimet islame, ku kundërshtohet urdhëresat islame, ku tallen me porositë islame, ku vidhet, ku shitet demagogji, ku ka hipokrizi, ku ka tradhëti. Ata dëshirojnë të kontribuojnë për islamin dhe, ku do të mund ta bëjnë më së miri këtë nëse jo në organizatat e veta. Prandaj, reagimet e Shaqir Fetait si dhe të BFI-së së tij ngjajnë si në përpëlajtjet e bishtit të këputur të zhapinit!

Ata që regjistrojnë bashkësi paralele kanë të deponuar në gjykatë edhe program të tyre, edhe statut, edhe deklarata, dhe, nëse organi gjegjës shtetëror konstaton se nuk ka kurrfarë rrezikshmërie për shtet e për shoqëri, se nuk ka kurrfarë dualizmi në shoqëri, se nuk cënon kurrfarë interesi, se është në të mirën e shoqërisë së vendit, se nuk prek në asnjë organizim të ngjashëm që mund ta kenë simotrat e tyre, atëherë, pa dyshim që gjykata do t'i regjistrojë. Këta “kalifa” konkurrentë, në fakt, nuk dëshirojnë të aderojnë në një organizatë ku mbisundon anarkia totale, ndaj dhe themelojnë organizata ku do të respektohet programi, nuk do të shkilet asnjë shkronjë e statutit, ku parimi i integritetit, i ndershmërisë dhe i transparencës do të jetë mbi çdo gjë!

Kjo dukuri, ky trend i regjistrimit të “bashkësive fetare” konkurrencte do të vazhdojë deri sa nuk do të largohet Shaqir Fetai! Ai është mirë, madje e ka edhe obligim moral (nëse i ka mbetur një pikë moral) që të largohet një orë e më parë, sepse, trungu fetar paska shpërthyer në të gjitha anët, ndërsa vetëm Shaqir Fetai ekzaltohet nga përshëndetjet dhe urimet. Së shpejti do t'i kujtohet kënga e të madhit Luan Hajra: “O kuku çka i bana vetit”!

Ky trend do të marrë përmasa të atilla sa, nuk është çudi që t'i detyrojë teologët e vendit, intelektualët e provniencës islame, studentët, medresantë e profesorë, që të ngrisin iniciativë dhe ta regjistrojnë një Bashkësi të mirëfilltë Islame. Sepse, dikush duhet t'i dalë zot unitetit fetar dhe organizimit institucional të jetës fetare, pa lejuar që institucionit t'i bie as një grimcë pluhuri e jo më të ketë ndikime të jashtme.

Pas kësaj, Shaqir Fetai mund ta marrë bashkësinë e vet islame, me gjithë bashkëpunëtorët e vet të diskutueshëm, dhe të dislokohet në oborrin e shtëpisë së vet, në Çegran! Kjo sjellje në historinë e njerëzimit ka qenë prezent sidomos te mbretërit intrigantë, të cilët kanë përfunduar në mbretërinë e vet brenda oborrit të shtëpisë që e ka rritur dhe ushqyer me pandershmëri. I pandershmi nuk lind, ai bëhet dhe, vdes i pandershëm!

*(Tetovasot, 22.02.2021)*

## Shkërmoqja deri në asgjësim si mision

(Një persiatje motivuar nga shkrimi i fundit i teologut tonë të mirënjohur, Abaz Islami, botuar në shumë portale kombëtare, me titull “SHKAKU E KA EMRIN SHAQIR FETAI”, e që trajtonte problemin e shkërmoqjes së unitetit të BFI-së dhe të myslimanëve të vendit. Shih për këtë, autori kërkonte që një orë e më parë të shporret Shaqir Fetai i cili ka kapur me duar të pista BFI-në falë ndihmesës nga pushteti aktual maqedonas)

**Nga Sabit Ibrahim**

**1.**

Se kush është Shaqir Fetai, kush është profili i tij psikik e moral, cili është mision i tij, pse e instaluan në BFI, çka ka ndërmend të bëjë Shaqir Fetai me këtë Institucion, kush ia cakton detyrat, kush i kërkon rezultate konkrete, çka duhet të bëjë me këtë Institucion fetar islam – tashmë këto gjëra i di opinioni i gjërë si dhe faktorët me relevancë kombëtare e ndërkombëtare.

**2.**

Tërë kjo mund të përmblihet në një emërues të përbashkët: Shaqir Fetai nuk është në BFI për të dhënë dorëheqje, qoftë edhe morale, por, për ta përmbushur misionin që ia kanë caktuar!

**3.**

Fundja, dorëheqjen mund ta ofrojë, qoftë edhe pas skandalit më të papërfillshëm, vetëm ai që ka integritet dhe moral të lartë. Një teolog i dinjitetshëm, kurrë nuk d të dilte para opinionit pas publikimit të dokumentit që e provon bashkëpunimin e tij me UDB-në, strukturën sekrete më të pashpirt në raport me shqiptarët dhe fenë islame. Kur kjo faktohet ndërsa bashkëpunëtori vazhdon që të fryhet si gjeldet dhe me këtë fryrje të mundohet disi ta fshehë këtë realitet, pra, nëse edhe pas faktimit të spiunazhit nuk pason dorëheqja, atëherë kemi të bëjmë me një person të operuar prej moralit dhe njerzillëkut, prej parimeve fetare dhe, të përgjithshme njerëzore!

**4.**

Në shërbime sekrete nuk ka moral dhe, nuk ka as ligjerata mbi moralin dhe përforcimin e tij tek bashkëpunëtorët. Në shërbime sekrete hyhet me moral të vdekur! Dhe, diçka që vdes nuk mund të ringjallet, rjedhimisht, Shaqir Fetait nuk mund t’i kërkohet dorëheqje si akt moral, mund t’i kërkohet vetëm “ORAO-s”, sepse vetëm tek ORAO mund të ketë pak moral, pak ndërgjegje, pak përgjegjësi dhe shumë aksione të kurorëzara me suksese. Këto suksese e mbajnë fort në misionin e tij prej bashkëpunëtori të shërbimeve sekrete. Në rast të dështimit, këtu mund të vie në shprehje përgjegjësia morale dhe të largohet personi!

**5.**

Nuk mund të spiunojë studentë i moralshmi, bashkëpunëtorët e shërbimeve, pra, mashat, nuk e kanë mision shuarjen e zjarrit, por, përpushjen e prushit për t’i dalur sa më shumë flaka; në aksione

spiunimi nuk shkohet me moral e me ndershmëri, në aksione diversante me motive shantazhimi nuk hyhet me moral, në tradhëti e në zhvatje nuk hyhet me moral! Ndaj, si t'i kërkohet Shaqir Fetait dorëheqje morale?

## 6.

Të gjitha veprimet e deritanishëm të Shaqir Fetait në BFI dëshmojnë se, ai është i përzgjedhuri, elementi më bensik dhe më i suksesshëm, në shkatërrimin e BFI-se! Provat janë:

tradhëtia e Shaqir Fetait kundër “babait shpirtëror” të tij, të cilit i nguli thikë pas shpine; vazhdimi i bashkëpunimit me të gjithë miqtë e shtëpisë dhe të kabinetit të ish-reisit, të cilët rezultuan se kanë qenë të dëgjueshmit e shërbimeve sekrete ku ka aderuar Shaqir Fetai që nga vitet '80-të të shekullit të kaluar;

shkelja permanente e Kushtetutës së BFI-së (më shumë se gjysmat e neneve të kësaj norme juridike); sjelljet e tij nonshalante, prononcimet e tij demagogjike, intrigat dhe hipokrizia e tij, amatorizmi dhe injoranca e tij, kanë degraduar peshën e BFI-së deri në një shoqatë humoristike dehumanizmi dhe dehumanizimi i BFI-së me elementë krimogjenë tallja nonshalante me ndërkombëtarët dhe, e fundit instalimi i tij në kapjen e BFI-së nga pushteti aktual maqedonas si dhe pajtimi i tij me fragmentarizmin e unitetit të BFI-së si dhe të myslimanëve të vendit.

## 7.

Dakord, Shaqir Fetai nuk mund të fajësohet sepse qenkan regjistruar shumë “bashkësi islame”, qofshin ato selefiste apo vehabiste por, ai fajësohet për shkak të neglizhencës së tij karshi këtij trendi dashakeq në raport me BFI-në;

Shaqir Fetai nuk guxoi të ngrisë zë;

Shaqir Fetai nuk e kushtëzoi publikisht me asgjë pushtetin për ta stopuar këtë lojë dhe për ta korrigjuar situatën ofenduese për islamin në vend;

Shaqir Fetai nuk lëshoi kurrfarë ultimatumi dhe nuk ndërmori kurrfarë mase parakërcënuese për një destabilizim të përgjithshëm si përgjigje kundër atyre segmenteve që ia mësyjnë destabilizimit të BFI-së.

## 8.

Shaqir Fetait i duhen këta dukuri që po ndodhin mbi kurriz të BFI-së, sepse ai do të dëshmojë se sa tolerant që është! Tolerancën e vet karshi shërbimeve sekrete të UDB- së tenton ta shndërrojë në tolerancë etnike karshi padrejtësive institucionale që i bëhet shqiptarëve dhe myslimanëve të vendit.

## 9.

Toleranca dhe, jo bashkëjetesa, i duhet Shaqir Fetait, sepse, bashkëjetesa e vënë pozita të palakmueshme “shumicën” e cila duhet t'i nënshtrohet edhe kërkesave, nevojave dhe parimeve etnike e fetare të “pakicës”!

## 10.

Pak histori! Dy-tre vite rresht, pas vitit 2006, ish-kryeministri Nikolla Gruevski, e kishte bërë traditë që, në prag të festave të fundvitit, t'i ftojë në një takim festiv të gjithë liderët fetarë të kishave, bashkësive fetare dhe të grupeve religjioze të regjistruara zyrtarisht! Do ti që, në një festë, i kishte vajtur mendja që të provokojë dhe, në festimin solemn, e kishte ftuar edhe Baba Mondin, atëkoh “udhëheqës” i bektashinjëve të “Arabati Baba Teqes”! Në mënyrë demonstrative ish-reisi, Sulejman ef. Rexhepi, e braktisi takimin duke iu drejtuar Nikolla Gruevskit: “Ti, me përpjekjen tënde për ta

shtuar edhe një “bashkësi fetare”, kujdes, do ta humbësh shtetin”!  
Kurrë më Nikolla Gruevski nuk e vazhdoi atë traditë aq të mirë që pasqyronte bashkëjetesën fetare në Maqedoninë e Veriut.

*(Kombetare, 23.02.2021)*

## Mos u bëfshë me të qajtë i huaji

**Tashmë nuk ka myslimanë në Maqedoninë e Veriut që nuk e di se kush është Shaqir Fetai! Nuk ka mysliman në vend (hiq familjarët, miqtë dhe shokët e tij) që ka më të voglin respekt për këtë farë “reisi”-instalacion në BFI nga pushteti aktual maqedonas. Shaqir Fetai, për një grusht anarkistësh dhe bashkëveprimtarësh të vetë nga grupi i udhëbësëve, i shiti myslimanët e vendit, duke ua shkatërruar të vetmin Institucion fetar islam në vend – BFI-në**

Kanë ngelur vetëm edhe do struktura nga “Higjiena Komunale” si dhe nga “Ujësjellsia dhe Kanalizimet” që akoma nuk i kanë marrur urdhërat nga strukturat partiake dhe qeveritare për të shkuar te Shaqir Fetai dhe për ta uruar për aksionin e tij suversiv, të cilit nuk ia kanë arritur pushtues e pushtues të ndryshëm përgjatë gjashtëqind viteve. Këta urime nuk po sjellin kurrfarë efekti, përveçse njëfarë mashtrimi optik të cilin e ka planifikuar Shaqir Fetai sa për ta kënaqur veten dhe familjarët e tij se, ja, më në fund, dikush po e do dhe po e respekton. Një jetë të tërë ai ka qenë demagog, injorant i shtyer nëpër karrierë falë aftësive për të lëpirë dhe për t’u servilozur te eprorët e tij. Më në fund, iu dha sinjali që të futet në aksion që do të përfundojë me degradimin deri në rrënim të BFI-së! Si bashkëpunëtorë më besnik i ish-reisit, si më i përgëdheluri i Sulejman ef. Rexhepit, si më i lavdëruari e më i dashuri i tij, arriti që t’ia ngulë thikën e tradhëtisë dhe ta spostojë nga posti i reisit dhe të vetëmërohet e të vetëzgjidhet në këtë post. Misioni i tij është që ta devalvojë deri në zero Kushtetutën e BFI-së, ta mohojë e t’i shkelë të gjitha nenet e tij, të shkelë Rregulloren e akte të ndryshme të BFI-së dhe, t’u përcjellë mesazhe myslimanëve të vendit se, e larguam të keqin, kurse ngelëm ta drejtojmë BFI-në, ne, të këqinj të që ishim bashkëpunëtorë të të keqit!

Këtë fakt tashmë e ka kuptuar popullata myslimane e vendit, e cila, as që dëshiron të dëgjojë për këtë “shtëpi të mafiozëve”, as që denjon të gënjëhet nga demagogjia, nga intrigat dhe nga hipokrizia e Shaqir Fetait. Edhe Shaqir Fetai po e ndjenë këtë injorim të popullatës dhe, është fare i vetëdëshëm se, edhe me anëtarësi por edhe me fitër dhe zeqat do të dështoj tërësisht. Burimet financiare të brendshme tashmë i ka të humbur! E vetmja shans i ka ngelur që të dalë e të lutet tek të huajt. Arabët e kanë injoruar, “e kanë qarë” dhe me dhembshuri njerëzore i kanë shëtitur nëpër muze e nëpër institucione të ndryshme, i kanë përcjellë dhe më nuk ua hapin as telefonatat! Te të huajt shkohet me projekte, te të huajt shprehen lutjet për t’i financuar projektet, tek të huajt nuk kërkohet para, sepse, pas vitit 2001 nuk ka institucion ndërkombëtar që të jep para, ndërsa mund të të financojnë vetëm projekte. Asnjë institucion nuk financon projekte pa e parë pjesën e buxhetit me të cilën do të nisë projektin BFI-ja!

Nuk ka faktor ndërkombëtar që nuk e di se me çfarë dredhire u bë “reis” Shaqir Fetai, nuk ka faktor i vendit dhe ai ndërkombëtar që nuk e di se si Shaqir Fetai mundohet të “veprojë” jashtë të gjitha nomave juridike të BFI-së, tamam si një anarkist, si një cub, si një hajn. Të huajt, ata që janë të gatshme të finansojnë projekte të BFI-së së Shaqir Fetait, natyrisht që do t’i kërkojnë fillimisht pasqyrë nga të hyrat dhe të dalurat vjetore në këtë Institucion, situata bankare, a ka huazime nga bankat, a është marrur ndonjë kredi duke lënë hipoteka vakëfe, a ka letra në vlerë prej vakëfit, plani financiar vjetor i ndarë nëpër zëra, të paktën, dy vlerëime nga auditit i huaj lidhur me projektin e fundit të financiar nga të huajt!

Shaqir Fetai mund të shkojë edhe në Republikën e Turqisë! Kohë më parë, atje ishte edhe shoku më

i ngushtë i presidentit turk, Taip Rexhep Erdogan, Edi Rama, të cilit mbase i janë dashur financa për zgjedhjet që po afrojnë! Nuk ka para, i tha vëllai vëllait, mund të ta ndërtojmë një spital në Fier që mund të kushtojë edhe një miliardë dollarë, por, ne do ta financojmë. Para për rroga e për shpenzime të kota nuk ka!

Mos u bëfsh me të qa i huaji, sidomos jo nëse je faqezi e shpirtlig, anarkist e bandit...

*(1Kliklart, 24.02.2021)*

## Elementë të pushtetit ia kanë mësyre destabilizimit të BFI-së dhe komunitetit mysliman në RMV

Në intervistën e Sulejman Rexhepit, dhënë TV Lajm, për sa i përket regjistrimit të “bashkësive fetare islame” të reja, efendi Rexhepi hedh dyshim të rëndë në elementë të caktuara të shtetit. Ai fajëson vetë shtetin dhe, këtë fajësi e provon përmes një kërkesë të kryetarit të Komunës së Kumanovës kur ka dashur të ivervenojë në prishjen e objektit të egër të Sadullah Bajramit, për ç’gjë ndihmë dhe asistencë teknik ka kërkuar nga pushteti qendror, do me thënë, nga qeveria. Megjithatë, këtu qeveria është treguar e shurdhër dhe, sot, kemi një “bashkësi islame” me xhami të veten, me “lider” të vetin, duke aluduar Sulejman Rexhepi në hoxhën nga Kumanova, Sadulla Bajramin.

“Ka qenë te unë, e kam pranuar në zyre. E kam lutur Sadulla Bajramin që të hiqet nga mercenarizmi, të tërhiqet nga lojërat nëntokësore dhe, pasi ia kam shpjeguar mirë punët, ai ka pranuar që të veprojë institucionalisht. T’i sjellë projektet, ta ngrisë iniciativën përmes BFI-së, t’i derdhë paratë të siguruara nga nëntoka në xhirollogarinë e BFI-së dhe vetë t’i menaxhojë, duke mbajtur unë plotësisht përgjegjësi dhe duke i garantuar se askush nuk mund ta pengojë në njijetin e mirë. Pas këtij muhabeti, ai kurrë më nuk erdhi në BFI dhe ia nisi në të egër ta ndërtojë objektin e vet. Pa dyshim, në këtë aktivitet mafioz dorë ka pasur edhe myftiu aktual i Kumanovës dhe, tash, në atë objekt është “bashkësia islame ehli sunet vel xhema. E dini shumë mirë se, para do kohë, nga ai xhema u arrestuan tetë persona, radikalistë, për të cilët nuk u fol shumë, i zbuluan dhe e përhupën muhabetin. Dhe, kush përzihet në këto punë? Qendra! Këtë na e dëshmon edhe vetë kryetari i Komunës së Kumanovës. Pa dyshim, po shihet që qendra (qeveria aktuale) ka synimet dhe planet e veta në këto punë por, ishalla nuk ju realizohen.”, thotë Sulejman Rexhepi!

Sipas efendi Rexhepit, deri kohë më parë, territori i Maqedonisë së Veriut ka qenë absolutisht më i qeti, më i paprekuri prej radikalizmit, jo që nuk ka pasur, por, ia kam arritur që prej tyre të marr deklarata me shkrim, duke më premtuar se nuk do të tollovisin punë por do të respektojnë Kushtetutën e BFI-së duke vepruar konform shkollës juridike hanefite. Nën drejtimin tim kurrnjëherë nuk ka pasur probleme të natyrës së radikalizmit në Maqedoninë e Veriut. Ka vluar radikalizmi dhe elementet e huaj në Kosovë, kanë vluar në Shqipëri, ka vluar gjithandej! I vetmi vend që ka qenë i suksesshëm në ruajtjen e pastërtisë së islamit burimor, ka qenë Maqedonia e Veriut. “Fatkeqësisht, sot kemi të regjistruar pesë bashkësi fetare islame, kemi mbi 12 grupe religjioze të regjistruar dhe sa të tjerë do të regjistrohen! Nga ana tjetër nuk kemi asnjë organizatë tjetër që do t’i konkurronte Kishës Ortodokse Maqedonase! A preke në KOM ke prekur në shtet! Kurse shteti thotë se jemi të barabart para ligjit! Rrenë kjo!”, përfundon Sulejman ef. Rexhepi.

*(Politesa, 24.02.2021)*

## Mbyllja e Medresesë prioritet i Shaqir Fetait

**E keni parë foshnjën kur nisë t’i hedhë hapat e para?! Çfarë ndiesie e papërshkrueshme që e kaplon në këtë çast bebin! Në fytyrë i shpërthen ndiesia e gëzimit, pak siguri, lumturi, hare, trimëri por, mbi të gjitha, edhe një frikë që shoqërohet me mbyllje të syve e me hapje të gojës! Hop-ala, mashalla! E pra, këtë ndiesi e ndjeu Shaqir Fetai kur arriti ta organizojë mbledjen e parë të “rijasetit” të vet. Këtë e vërtetojnë disa nga “bashkëpunëtorët” e tij**

**Nga Haxhi Isa Xhaviti**

Shaqir Fetai në fb-në e vet, kohë më parë na informoi se me sukses paska arritur ta mbajë mbledhjen e parë të “rijasetit”, në të cilën, thënë kah del shpirti, kishin debatuar mbi gjëra të kota. Kanë miratuar llogarinë përfundimtare të vitit të kaluar, në të cilën vit Shaqir Fetai nuk ka pasur kurrfarë të hyre e kurrfarë të dalura, sepse, nuk ka zhvilluar kurrfarë aktiviteti. Ka raportuar i egzaltuar se sa mirë e kanë pritur arabët, se si e kanë shëtitur nëpër muze e nëpër institucione të ndryshme. Ka folur tamam si njeriu që del për herëtë parë jashtë derës së oborrit të vet! Ka kërkuar edhe raporte nga myftinitë se si ia kanë kaluar gjatë vitit 2020, sa kanë shpenzuar, sa kanë fituar e pordha të tilla të ftohta! Shaqir Fetai ka planifikuar edhe buxhetin e vitit 2021, siç ka planifikuar edhe gjatë vitit 2020 por që nuk ka treguar as sa kanë shpenzuar e as sa kanë siguruar të hyra nga obligimet fetare të myslimanëve të vendit. Me gjasë këto obligime kanë qenë zero, ndërsa me këtë zero myslimanët e vendit vetëm sa kanë shtuar besimin e tyre në Zot, sepse, nuk e kanë ndër mend që në emër të fesë islame t’i ushqejnë hajnat, banditët kriminelët, udbashët e bashkëpunëtorët e sigurimeve sekrete të ndryshme.

Në këtë mbledhje nuk është thënë asnjë fjalë për Medresenë “Isa Beu”! Çka të bëhet me këtë shkollë të mesme profesionale nga e cila përgatiten kadro për t’i shërbyer myslimanëve të vendit!

Çka të bëhet me këtë Medrese! BFI-ja nuk do të arrijë ta menaxhojë, të sigurojë financa vjetore, nga ana tjetër, as shteti nuk pranon ta akreditojë! Shaqir Fetai “insiston” që të akreditohet, duke na rrëfyer përalla të bukura nëpër intervistat e tij bajate, se si do ta akreditojë këtë shkollë fetare islame! Po shkolla e mesme fetare ortodokse?! Çka nëse ajo nuk pranon të akreditohet e të futet nën ombrellën e pasardhësve të komunistëve? Vallë do të bëjë përjashtim këtu shteti dhe do ta akreditojë vetëm Medresenë? Çka nëse ka ndonjë marrëveshje interne në mes të kishës ortodokse dhe pushtetit maqedonas që mos të pranojnë të regjistrohen me qëllim që të shpëtojnë nga ngarkesa e shtetit me 700-800 medresantë!

Një shtet i pangarkuar, një shtet normal, një shtet demokratik edhe mund ta realizojë këtë kërkesë të BFI-së, sepse nuk është edhe aq problem i madh! Por, çka do të bëhet me shtetin laik, për të mos thënë gjysëm ateist, i cili akrediton dhe shkollon kadro teologjike nën ombrellën e Ministrisë për Arsim? Të shkelin mbi këtë paradoks vetëm që Shaqir Fetait t’ia lehtësojnë brengat në mungesë të financave?! Kurrë!

Prandaj, siç na konfirmojnë nga stafi drejtues i Fakultetit të Shkencave Islame, kjo Ministri i ka dërguar letër edhe këtij Institucioni të lartë akademik, FSHI-së, me të cilën e urdhëron që të mos bëjë regjistrimin e medresantëve të “Isa eut”. FSHI e gjysëm akredituar, gjysëm shtetërore e gjysëm BFI, ka obligime edhe ndaj shtetit edhe ndaj BFI-së. Shteti e urdhëron që mos të pranojë nxënës nga një



shkollë e mesme e paakredituar, siç nuk pranohen në asnjë fakultet tjetër shtetëror dhe, nga ana tjetër, BFI e obligon që të nxjerrë kuadro të larta teologjike!

Pse kjo lojë! Natyrisht, me qëllim që të devalvohen kërkesat e BF-së: të mos kërkohet që të akreditohet Medresja për shkak të refuzimit të “Bogosllovisë”, ndërsa të bëhet trysni në pushtet që, të paktën, të lejohet regjistrimi i medresantëve në FSHI!

Nëse nuk reformohet sa më shpej si Medresja ashtu edhe FSHI-ja, edhe më tej do të kemi të vlerësuar dy institucione shkollore si më të dobëtat në rajon e më gjërë, që prodhojnë kuadro me njohuri gjysmake, të bazuara në mësimet e fuqishme që i kanë marru nga hoxhallarët e vjetër “samaukë”!

Një reis normal, i cili vjen me program të qartë e të publikuar, i cili vjen me një plan akcional vjetor, me synime e qëllime të qarta – këtë problem do ta kishte parësor dhe jo “urimet dhe përshëndetjet” për fitimin e një posti të vjedhur me tradhëti, si dhe planet për t’i shëtitur bythët e lepurit duke i pyetur pastaj bashkëpunëtorët se si isha në defilim para të mëdhenjëve të botës. Para këtyre të mëdhenjëve, more Shaqir Fetai, gjithnjë do të dukesh si kokërr meli! Si glasë miu, si hiç asgjë!

*(1Kliklart, 24.02.2021)*

## Xhelozit apo isharetet përçarjeje nga Myftiu Abedin Imeri

Nja dy-tre të ashtuquajtur “teologë” dhe bashkëudhëtarë për në Turqi dhe për në turp, të Shaqir Fetait, uzurpatorit klasik të BFI-së, na bombarduan me sesione fotografishë të shkrepura nëpër institucione fetare turke. Myslimanët e vendit mendojnë se “paria fetare” ka shkuar në Turqi për të shikuar se çfarë projektsh të përbashkëta mund të realizojnë në Maqedoninë e Veriut! Jo për parë, sepse Shaqir Fetai e bëri gropë gjoksin duke u goditur me mburrje se financiarisht BFI qëndron shumë mirë.

Megjithatë, këtë sesion fotografishë ua ironizon Myftiu i Kumanovës, Abedin Imeri, i cili tallet me ta duke ju thënë: “Shumë foto jeni ka bani me siguri edhe shumë tholla keni tna sillni”!

Me këtë fjali që e baltosë fare rregullin e gjuhës shqipe si dhe të drejtshkrimit, megjithatë na shpalolet një e vërtetë: për inat dhe për shkak të xhelozisë që Shaqir Fetai ka marrur udhë për në Turqi pa e futur në “rabush” edhe Abedin Imerin, ky ua drrason deri në qykë, duke e pranuar se financiarisht punët i kanë katastrofë dhe, vetëm te turqët u kanë ngelur shpresat.

Myftiu i Kumanovës tërthorazi i porositë që mjaft na bënë foto por të na sjellin të holla se, falimentoi BFI-ja! Kurse shteti turk, që kur ka themeluar TIKA ka vendosur që, çdo ndihmë që u duhet BFI-ve në Ballkan dhe më gjërë, ta zbusë përmes kësaj organizate që merret me humanitet, restaurim, ndërtim, meremetim, por jo edhe me dhënien e parave kesh! Nuk ka, nëse keni nevojë për ndërtimin e ndonjë xhamie, të ndonjë shkolle, të ndonjë spitali, të ndonjë teqe, të ndodnjë aerodromi, këtu është shteti turk! Shteti turk nuk ka para për hajnat dhe kriminelët që, mezi presin t’i thithin djersët e taksapaguesve të huaj! Qofshin këta edhe “takvaxhinjtë” më të mëdhenjë në botë!

Bravo Abedin Imeri, vetëm sikur ta keshë këtë guxim dhe t’ju kërkoshë llogari edhe kur të kthehen, në ndonjë mbledhje të “rijasetit” të hajnave!

*(Lajme7, 24.02.2021)*

## **BFI si digaster i pushtetit**

**Këto ditë Bashkësia Fetare Islame në RMV u kritikua edhe për heshtjen rreth disa vendimeve të padrejta nga organet e drejtësisë kur janë në pyetje shqiptarët! Është intetres i pushtetit që të fusë në grusht të vetin sa më shumë institucione me qëllim që ta ngulfasë kritikën. Që kur Shaqir Fetai e grabiti BFI-në, ky Institucion tashmë po llogaritet si digaster i pushtetit aktual**

### **Shkruan Zejnepe Ajdari**

Që nga viti 2001, pas aktit terroist të ndërmarrur mbi Kullat Binjake në Nju Jork, bota u bë një kundër terrorizmit dhe terroristëve. Në këtë krah u rreshtua edhe Maqedonia e Veriut. Natyrisht, bartëse e kësaj lufte antiterroriste do të bëhej NATO, ombrella e sigurisë botërore.

Maqedonia e Veriut, nuk deshti që të jetë vetëm pasivisht e rreshtuar në krah të kësaj force, por edhe praktikisht të dëshmojë se është e aftë dhe shumë serioze që të bëhet anëtare e rregullt e NATO-s. I hyri luftës me shqiptarët e këtij vendi dhe, më vitin 2001, angazhimin e shqiptarëve të armatosur për liri dhe barazi e propagandonin si luftë të “terroristëve” kundër një shteti demokratik në krah të të cilit do të duhej të rreshtohet edhe NATO, ndërsa përpjekjet e shtetit me ushtri e polici për ta heshtur këtë konflikt të armatosur gjithëpopullor ta trajtojë si mobilizim shtetëror kundër “terroristëve etnikë shqiptarë”!

Kur nuk u shkoi ndorësh kjo gënjeshtër shtetërore, i kapën në Vreshtat e Rashtakut nja pesë refugjatë nga shtetet e Lindjes që po përpiqeshin të kalojnë nga Maqedonia në Serbi e pastaj tutje Evropës, të gjendur në një vend të gabuar në momentin e gabuar, ata u vranë dhe, sakaq, u përhap lajmi: “U vranë terroristët islamikë” që kishin ardhur për ta ndihmuar UÇK-në! Kurrë nuk u zbardh ky krim shtetëror!

Paraprakisht, kishte ndodhur edhe rasti i Sopotit! Krejt në fund, pas një dekade e sa, u konkludua se të dënuarit nuk janë fajtorë ndërsa fajtori nuk dihet! Këta fajtorë u akuzuan si terroristë që i shpallën luftë NATO-s (sepse aty vdiqën ushtarë polakë të NATO-s)!

Më pastaj, për ta përsheptuar praninë e Maqedonisë së Veriut në NATO do të inskenohet vrasja e pesëfishtë te Liqeni i Smilkovcës! U kapën shqiptarë, u bastisën shumë shtëpi, u zvarritën përdhe nëna plakë e gra, u akuzuan si terroriste islamike meqë shtëpitë i kishin pasur përplotë me Kurana dhe libra fetare! Ndërkombëtarët e kritikuan ashpër këtë përpjekje antishqiptare dhe antiislame të institucioneve të caktuara shtetërore dhe, sakaq, do të heqin dorë nga kjo akuzë, ndërsa do ta lokalizojnë angazhimin në kapjen e një “grupi terroristësh”!

Natyrisht, ky gjakim i flaktë i Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në NATO do të kulmojë me rastin e “Lagjes së Trimave”! Maqedonasit imponoheshin si “ushtri e gatshme” për t’u inkuadruar në NATO, kurse kjo Strukturë ushtarako-politike e botës për kriter ka më tepër elementin gjeostrategjik se sa “aftësinë ushtarake” të një shteti i cili më 2001-shin u gjunjëzua para një grusht luftëtarësh shqiptarë!

Aktualisht, rasti “Monstra” ishte mjaft aktual dhe, veç të tjerash, u kritikua edhe BFI se pse po hesht karshi këtij diskriminimi kombëtar e fetar që po u bëhet pjesëtarëve të këtij Komuniteti. Në fakt, na u publikua një dokument që mbanë datën 10 maj 2012, të nënshkruar nga Reisul Ulema i BFI, Sulejman

ef. Rexhepi, i cili publikisht i drejtohet ministreshës së atëhershme Godana Jankullovshtë që t'ju kërkojë falje shqiptarëve dhe myslimanëve që i ofendoi aq rëndë, madje i kërkojë që të heq dorë nga skenarët e ulta dhe sa më shpejt t'i kapë vrasësit e vërtetë të atyre pesë të rinjëve maqedonasë. Pa dyshim, nuk i ka bërë vaki BFI-së së udhëhequr nga Sulejman ef. Rexhepi të heshtë apo të mos reagojë kundër skenareve të pushteteve maqedonase që zhvilloheshin mbi kurrizin e shqiptarëve apo myslimanëve të vendit, kundër intitucioneve apo organizatave shqiptare dhe islame! Reagimet e efendi Rexhepit kanë qenë gjithnjë të ashpra, të vendosura dhe në formë të ultimatumave sa, e kanë bërë çdo pushtet që të mendohet mirë dhe të zbrapset nga synimet jo të ndershme. Reagimet e Sulejman ef. Rexhepit jo njëherë kanë qenë të shoqëruar edhe me kontaktimin e korit diplomatik para të cilëve i ka shprehur masat që është në gjendje t'i ndërmarrë BFI-ja si Organizatë që me Kushtetutën e vet është e obliguar që t'i mbrojë liritë dhe të drejtat e anëtarëve të vet.

Sot, fatkeqësisht, që kur e instaluan Shaqir Fetain në krye të këtij Intitucioni, BFI-ja po llogaritet si digaster i pushtetit aktual. Fundja, prej një njeriu të dalë e të sërëvitur, të përgatitur e të instaluar nga pushtetet antishqiptare e antifetare nuk ke se çfarë të presësh!

Shaqir Fetai nuk guxon të kërkojë drejtësi, sepse me pa të drejtë erdhi në krye të BFI- së!

Shaqir Fetai nuk guxon të kërkojë respektim të ligjeve dhe të Kushtetutës së vendit, sepse tashmë vetë ai njihet si shkelësi më i madh i akteve normative!

Shaqir Fetai nuk guxon të ngrisë zërin kundër diskriminimit etnik e fetar, sepse vetë ai me decenie e ka ushtruar këtë aktivitet!

Shaqir Fetai nuk guxon ta ngrisë zërin për padrejtësi kundër pushtetit, sepse po ky pushtet e instaloi në krye të BFI-së!

Shaqir Fetai nuk guxon të dalë e të thërrasë në protestë gjithëpopullore për t'i detyruar organet e drejtësisë në vendime të drejta e korrekte, sepse, vetë ai u mbrojti në veprimet e tij të padrejta dhe antikushtetutare!

Fundja, Shaqir Fetai nuk guxon të dalë kundër pushtetit të vet, të cilët i përkrah në çdo vendim të keq apo të mirë, sepse pastaj do të ngelë pa "urime dhe përshndetje"! Shaqir Fetai ua ka bërë "teslim" BFI-në pushtetit aktual maqedonas, është "institutcion" identik si ata të pushtetit ku përgatiten skenaret dhe vendimet antishqiptare e antifetare. Prandaj, në protestat e kësaj të premtë, që do të organizohen kundër vendimeve të padrejta për rastin e Almirit të Vogël dhe për "Monstrën", nuk bëhet keq nëse brohoritet edhe kundër BFI-së së Shaqir Fetait. Nuk është fajtorë Fatime Fetai pse heshtë Shaqir Fetai, por, është fajtor Shaqir Fetai pse ngriti zërin Fatime Fetai! Dy Fetaha që po na marrin më qafë kot e kot!

Mos kërkonë zë nga BFI-ja aktuale, sepse është e pagojë, e paveshë – shurdhëmemece! Çojeni në shërim dhe rehabilitim. Me një fjalë – futjani qepën! Ose, një pjesë e protestuesve marshin për liri dhe të drejta ta nisë pikërisht para BFI-së së Shaqir Fetait! Pse jo?!

*(Lajme7, 25.02.2021)*

## **BFI-ja e Shaqir Fetait vazhdon të flejë gjumë**

Kohë më parë u takuan Shaqir Fetai, “reisi” i instaluar nga pushteti maqedonas, me Stojançe Angellov, drejtorin e Qendrës për Menaxhim me Kriza, me qëllim që bashkarisht t’i dënojnë brohoritjet e protestuesve shqiptare “UÇK, UÇK” dhe SHQIPËRIA ETNIKE”.

Stojanço Angellov edhe kësaj radhe, pas protestave kundër procesit të montuar politik “MONSTRA” ka dënuar brohoritjet e protestuesve. Sipas këtij miku të Shaqir Fetait, brohoritjet “UÇK, Shqipëria Etnike”, tundja e hartave etnike, si dhe gjuajtja me gurë e policëve, nuk shkojnë në favor të procesit të pajtimit...”

Kurse asnjë fjalë nuk u tha nga Shaqir Fetai, kunder provokimit të policëve, kundër gjuajtjes me gurë të policëve në drejtim të protestuesve sa për ta provokuar eskalimin e situatës dhe për çërim përfundimtar të hesapeve në mes policisë maqedonase dhe shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. Asnjë fjalë kundër nxjerrjes së makinerisë policore me qëllim për të shkelur e bluar shqiptarë nëse do të provonin ta kalojnë kufirin që ua kishin caktuar protestuesve shqiptarë. Shaqir Fetai asnjë fjalë nuk e tha për vendosjen e qeverisë maqedonase për masa të këtilla shoveniste e raciste kundër shqiptarëve. Turp për të, për Orao-n!

*(Lajme7, 28.02.2021)*

## Vendime skandaloze kundër Medresesë nga pushteti që e instaloi Shaqir Fetain në BFI

**Kohë më parë, një sërë portalesh kombëtare publikuan një shkrim të Haxhi Isa Xhavitit, me titull “Mbyllja e Medresesë prioritet i Shaqir Fetait”, në të cilën kishte nënvizuar problemin e mospranimit të kësaj Medrese nga asnjë universitet në vend. Madje, nxënësit e “Isa Beut” nuk kanë të drejtë të regjistrohen as në Fakultetin e Shkencave Islame**

### Shkruan Burim Muniri

A e keni dëgjuar se si lavdërohet Shaqir Fetai duke keqinformuar “kemi pesë medrese...”? Në fakt është vetëm një Medrese “Isa Beu” që i ka të dispersuara disa paralele për vajza e për meshkuj nëpër disa qendra të vendit.

Le ta marrim të “mirëqenme” bindjen abdalleske të Shaqir Fetait se në Maqedoninë e Veriut funksionojnë pesë medrese! Shtrohet një pyetje epike: çka i duhen këto Medrese Shaqir Fetait, vetëm si karrem për t’i vjelur nëpër xhepa myslimanët e vendit? Në emër të “Medreseve” të kërkohet fitri, zeqati, lëkurat e kurbanit, kurbanët, te organizohet haxhi! Të gjitha këto burime financiare “ekskluzivisht” për “medresetë”, apo për xhepat e sojit të Shaqir Fetait?

Shaqir Fetai tani më gjendet në një situatë hamletiane “të jeshë a të mos jeshë”? Të jeshë reis apo muteveli?

Shaqir Fetait jo që i fle tamam mutevelillëku por edhe do ta ketë më të lehtë! Sepse, së shpejti duhet të dalë para myslimanëve të vendit e t’ju thotë: “myslimanë, mos i merrni më qafë fëmijët, mos i dërgoni në medrese, sepse, këtu përfundon shkollimi i fëmijëve tuaj”!

Pse këtë detyrim moral Shaqir Fetai? Sepse, përfundimisht, po ndodh ajo që e paralajmëroi Haxhi Isa Xhaviti në shkrimin e vet me titull “Mbyllja e Medresesë prioritet i Shaqir Fetait”? Deshti apo jo Shaqir Fetai, tashmë ka ardhur në këtë situatë! Apo, Shaqir Fetai ka shpresa sepse akoma nuk e ka aktivizuar “personalitetin ORAO” që t’ia thyej dhëmbët këtij farë pushteti, i cili, i sjell vendim që ua përcjell të gjitha institucioneve arsimore të shkallës së lartë, të cilët nuk do të guxojnë të regjistrojnë asnjë medresant, sepse, kjo shkollë e mesme profesionale nuk është e akredituar!

Medresantët dhe medresantet, duhet të mbyllen në shtëpi, apo të marrin botën në sy për të vazhduar shkollimin sipëror. Pavarësisht sukseseve të tyre, ata, ato, do të mbyllen, sepse kështu ka vendosur pushteti maqedonas që e instaloi Shaqir Fetain në krye të BFI-së sa për ta diskredituar deri në palcë! A ndodhte kjo në të kaluarën? Po por, trysnia, reagimi, kërcënimet e ish-reisul ulemasë

H. Sulejman ef. Rexhepi, ish-in aq të fuqishme sa, nuk kishte fakultet e universitet që nuk i pranonte medresantët, ndonëse jo në afatin e parë, por, në të dytin apo të tretin, ku ngelte ndonjë vend i lirë!

Në këtë fillimjavë, fillimisht portali ina-online.net dhe më pastaj edhe disa portale, kanë zbardhur rastin e parë të refuzimit të medresantes nga ana e Universitetit “Nënë Tereza”, ndonëse medresantja ishte shembullore, me sukseset absolute, e ranguar në krye të listës, e cila kishte bërë krenarë prindërit por edhe shoqërinë e rajonit të Kumanovës.

Me vendim 05-216/2 të datës 25. 02. 2021, të nënshkruar nga Rektori i Universitetit “Nënë Tereza”, Prof. dr. Aziz Pollozhani, Medresantja Merva Azizi, e bija e hoxhës së mirënjohur në rrethin e

Kumanovës, Enver ef. Azizi, suspendohet nga Fakulteti i Shkencave Sociale vetëm pse kishte mbaruar Medresenë. Obligohet fakulteti që sa më shpejt t’ia kthejë dokumentet si dhe pagesën që e ka kryer vajza për semestrin e parë! A ka gjë më fashisoide?

A ka gjë më antinjerëzore?

A ka gjë më të poshtër e më raciste se sa të mos i lejoshë një vajze shqiptare që të vazhdojë shkollimin sipëror!

Medresantja nuk do të lejohet të vazhdojë studimet as në FSHI-në e akredituar!

A duhet edhe ndonjë rast tjetër që, urgjentisht të këndellen partitë politike shqiptare, myslimane! Të kushtëzojnë pejsëmarrje në pushtet me të drejtën e shkollimit sipëror të të gjithëve që kanë kryer shkollën e mesme profesionale, pavarësisht llojit! Lloji i Shaqir Fetait nuk ka shpirt për të dhënë dorëheqje në shenjë revolte kundër këtij diskriminimi fetar, kombëtar, arsimor.

Kur jemi te fjala “lloji”, ia vlenë të analizohet pak dhe, edhe për këtë fjalë BFI-ja do të duhej të ngritej peshë deri sa do të kërkonte falje Prof dr. Aziz Pollozhani!

Ky “rektor” politik, nënshkruan një vendim përplotë me gabime gjuhësore, por, një nga fjalët më ofenduese për motrat medresante është në pikën dy të këtij vendimi! Aty, veç të tjerash shkruan: “... sepse nuk ka maturë shtetërore, përkatësisht se ka të përfunduar shkollë të mesme fetare Medresenë Isa Beu dhe në përputhje me Ligjin për arsim të lartë lloji i tillë i nxënësve nuk mund të regjistrohet në Universitet.” Vetëm në këtë frazë janë gjithësej katër gabime sintaksore si dhe gjashtë gabime gramatikore! A ka më turp, a ka më ofendim, a ka më racizëm se sa të nënshkruash vendim ku gjendet sintagma “lloji i tillë i nxënësve”! Fjala “lloj” përdoret ekskluzivisht për kafshët, për bimët, për gjinitë letrare, për natyrën e veçantë të diçkaje, si për shembull, lloji i kërcënimit, lloji i dorëheqjes, lloji i fajit etj; Të thuash, “ky lloj nxënësish” është e ngjashme si të mendoshë se bëhet fjalë për specie të veçantë, e zbritur nga gjithësia, me përmasa jonjerëzore, qenie e panjohur ndonjëherë! Kurse mderesantet janë motrat tona, të lindura nga nënat tona, që jetojnë në mesin tonë, që do të jenë ato që do të përkujdesen për brezërat e ardhshëm, për vazhdimësinë e gjenealogjisë sonë kombëtare e fetare. Medresantet tona, si dhe mbarë nxënëset dhe studentet tona janë pasardhëse e atyre nënave burrneshë (me “universitete jetësore”) që lindën Nobelistë si dhe personalitete me vlera të pakonstetueshme botërore.

Me këtë kategori akademikësh të ardhshëm, nuk ka të drejtë të tallet askush, as Shaqir Fetai dhe as Aziz Pollozhani, as Ali Ahmeti dhe as Artan Grubi.

A ka gjë më goditëse, më shpirttrënuese se sa prindit t’ia dëboshë fëmijën nga shkolla, t’ia privoshë të drejtën për arsim sipëror, sepse paska mbaruar shkollë të mesme fetare, me të gjitha lëndët shkencore e shoqërore brenda saj?!

Të mos protestohet kundër kopjimit të hitlerizmit në shekullin XXI është solidarizim me përpjekjet për ngjalljen e këtij plani antinjerëzor. Zot, mos i fal këta, sepse këta e bëjnë qëllimisht, sepse janë antifetar e antishqiptar!

*(1Kliklarg, 1.03.2021)*

## Hajnia e Shaqir Fetait

**Të thuash se BFI paska siguruar katër tabela smart për FSHI-në, të thuash se Shaqir Fetai bëri pranim dorëzimit e tabelave smart që paskan qenë donacion nga Shoqata “Qëndresa Kosovare” për FSHI-në, është e njëjtë sikur të thuash se, Shaqir Fetai e pajisi Medresenë me dy kutija shkumsa, apo me pesë shpuza për të fshirë dërrasën e zezë; apo, Shaqir Fetai ia dorëzoi Medresesë një kamion me miell dhe një kamion me lakra që ia dhuruan banorët e një katundi myslimanësh të vendit**

### *Levizja Myslimane për Reforma në BFI*

Hajnia nuk ka brirë! Hajnia ka formën edhe të përpjekjeve idiotike të Shaqir Fetait, për përvetësimin e meritave të cilat as në ëndërr nuk ka mundur t’i shohë.

Shaqir Fetai vjedh çdo vizitorë të BFI-së!

Shaqir Fetai i vjedh edhe donacionet, edhe aktet humanitare, ai vjedh edhe meritat e të tjerëve. Madje i shoqëruar me bashkëpunëtorë sa për duartrokitje për të gjitha vjedhjet e tij.

Në Fakultetin e Shkencave Islame paskan ardhur drejtus të një Shoqate “Qëndresa Kosovare” dhe paskan dhuruar katër tabela smart për FSHI-në!

Ku është këtu kontributi i FSHI-së?!

Le të themi se BFI-ja, konkretisht, Shaqir Fetai, e paska siguruar këtë donacion? Po çka mendoi Shaqir Fetai, nga ky aksion të bëjë lajm?! Po Shaqir Fetai dhe BFI-ja e tij e kanë obligim, e kanë angazhim parësor që t’i furnizojë me mjete teknike-mësimore institucionet e veta arsimore, e ka për obligim që të sigurojë artikuj ushqimor për menset e këtyre institucioneve. Tani për çdo vezë të blerë, për çdo praz të blerë, për çdo krip e sheqer të siguruar, për çdo shkumës, shpuzë, kompjutor, tabela dhe tableta smart, mjete këto të domosdoshme për zhvillimin e njësive mësimore, nuk do të bëjmë lajm për Shaqir Fetain.

Nuk do të thotë se secili vezëshitës, miellshitës e lakraxhi, e uron Shaqir Fetain dhe i dëshiroi shëndet të mirë. Kujt i plasë për shëndetin e Shaqir Fetait, hajnit, demagogut, intrigantit dhe hipokritit më të madh që e ka pasur në gjirin e vet përgjat historisë institucionale BFI-ja.

Vijnë njerëzit nga Kosova, dhurojnë për FSHI-në katër tabela smart, ndërsa aktiviteti i përshkruhet si meritë Shaqir Fetait. Kjo për faktin se ai është shumë i vetëdijshëm se fare kot e kot është duke vegjetuar në BFI. Të gjitha meritat e tij janë ekskluzivisht për shkeljen e të gjitha neneve të Kushtetutës së BFI-së dhe, meritë e tij është edhe aftësia e tij prej plasteline për t’u shndërruar instalacion i lehtë i pushtetit maqedonas në krye të BFI-së së vjedhur e të shkatërruar prej tij.

Islam ef. Caka dhe Mr. Sami Salju, dy drejtuesit e “Qëndresës Kosovare” qofshin me nderë e faqebardhë për donacionin e tyre për FSHI-në, ndërsa hajnave dhe përvetësuesve të këtij donacioni Zoti ua nxiftë edhe më shumë fytyrën.

*(1Kliklart, 2.03.2021)*



## Shaqir Fetai i paska pritur udbashçiçët për urime dhe përshëndetje

Pampje shumë e shëmtuar në BFI! Mysafirë te Shaqir Fetai tre persona, të dështuar në karrierë ndonëse të shtyrë nga ish-UDB-ja. Ose i ka ftuar Shaqir Fetai sepse po ndjehet i rrezikuar në karrierë, ose kanë ardhur të marrin “ders” se si një udbash mund të avancojë në karrierë! Njëri, PERIKA (M. F.) ndonëse ka pranuar se dikur ka qenë vetëm ”paaak” udbash, madje, trikatër kushërinj të tij janë rekrutuar për bashkëpunëtorë, falë shkatërrimit të ish-Jugosllavisë, ata kanë shpëtuar por, asnjëri prej tyre nuk garantojnë për Shaqir Fetain, madje e kritikojnë, përfshirë këtu edhe M.F. se ç’iu desht kjo aventurë Shaqir Fetait e të deshifrohem i të gjithë për shkakun e tij! Tjetri, RAPORTUESI (H.I.) njeriu më i dështuar në një media nacionale, me shikueshmëri vetëm prej 0.2 për qind (me ligjet ndërkombëtare të mediave, me shikueshmëri më pak se 5 për qind, me automatizëm mbyllet media) si dhe sekser i përkryer në blerjen e “emisioneve si dhe në blerjen e projekteve televizive”, me qëllim të shpëtimit nga lustrimi, paska vizituar Shaqir Fetain! Çka e lidhë me të! Feja? Shaqir Fetai nuk ka dy lidhje me fenë! Kombi? Shaqir Fetai është antikombëtar! Media e vendit? Shaqir Fetai është keqpërdoruesi më i madh i mediave në vend e në rajon, gjë që nuk kanë arritur ta bëjnë makronët e drogës! Natyrisht, përveçse dështimeve kombëtare dhe lidhjet e hershme të periudhës së UDB-së, asgjë tjetër nuk i lidhë këta dy llulla të katranosur! Dhe i treti, MIKROFONI (S.XH.) i përgjigjet krrokamës së ORAO-s (Sh. F.)! Ky vetëm nëse i ka ardhur për të evokuar kujtime nga e kalara kur bashkëvepronin si ideopolitikisht shumë të përshtatshëm për Stanisiqin e Batonit, i cili, megjithatë, përkujdeset që mos të ngelë në rrugë por të marrë një media që do të funksionojë vetëm sipas programit të Stanisiqit. Jo rastësisht dikur punonte nëpër Radio Jugosllavi ku kishin fatin të punojnë ekskluzivisht komunistët më të rreptë dhe ata që ishin të gatshëm në çdo moment të heqin dorë nga identiteti kombëtar për Titon dhe Jugosllavinë si dhe për “vlerat” e atij sistemi (UDB, KOS, njësitet antishoviniste, antiseperatiste, gjithçka proserbe). Këta “tre muskitirë” vijnë dhe mikut të tyre ideologjikë, Shaqir Fetait, alias ORAO-s, ia urojnë “reisllëkun” dhe, nga aty, pastaj shkojnë dhe e fusin kokën në govanë plotë me raki, mësim i hershëm ky i UDB-së sa për ta zbutur shpirtin nga frika për shërbimet antikombëtare që i kryenin! Pse Shaqir Fetai nuk thotë se u vizitova dhe u urova nga një pjesëtarë i familjes! Sepse, “familjen e devotshme” të vetin nuk dëshiron që ta njollosë me një udbash siç ishte kushëriri i tij, prandaj nënvizon se u vizitua nga ambasadori i Maqedonisë në Zagreb! Askush në botë nuk raporton se në zyre u vizitua nga pjesëtari i ngushtë i familjes! Këtë e bën vetëm ai që do ta mohoj familjen për shkak të njollave të rrezikshme nga e kaluara! Me vizita të këtilla te udbashëve Shaqir Fetai i njollosë dhe i devalvon edhe ato vizita që kanë qenë të përshpirtshme dhe të sinqerta për të uruar një “sukses”! Të mirët dhe të sinqertët kurrë nuk do të pranin të futen në një zyre ku hynë e dalin udbashët si në Hanin e Mahmut Pashes!

<https://almakos.com/dokument-bashkepunetori-cilit-sherbim-eshte-kreu-i-bfi-se/>

<https://fol.mk/bashkepunetori-cilit-sherbim-eshte-kreu-i-bfi-sedokument/>

<https://lajme7.wordpress.com/2020/10/25/dokument-bashkepunetori-cilit-sherbim-eshte-kreu-i-bfi-se/>

(Lajme7, 3.03.2021)

## Farsa e idealit komunist të Shaqir Fetait

**Pas plotë dy vitesh pa asnjë thirrje për mbledhje të Kuvendit të BFI-së, sot, i është kujtuar Shaqir Fetait që të thërrasë mbledhje që, sipas të pranishmëve, përngjante në një komedi një aktëshe shumë të trashë. Pra, na ndodhi një farsë e idealit komunist të Shaqir Fetait**

### *Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI- së*

Në këtë mbledhje farsë të Kuvendit të BFI-së Shaqir Fetai paska pranuar dorëheqjen e ish-kryetarit të Kuvendit, Fadil Ramadanit, të cilën e dha që më vitin 2019, por megjithkëtë, ishte pjesëmarrës në mbledhjen e puçit të 27 majit 2020. Fadil Ramadanit më 2019 dha dorëheqje kur i thanë se do ta bëjnë funksionar në Komisionin për pozitat juridike të kishës, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze, për të përfunduar në emërimin e tij ilegalisht si kryetar i “Hilalit” nga ana e Shaqir Fetait më 2020. Me plotë komplekse, mundohen të informojnë se në këtë mbledhje gjithçka paska vajtur konform Kushtetutës së BFI-së? Shaqir Fetai ka mision që deri në frymën e fundit të jetë antikushtetues, ashtu siç është edhe vetë antikushtetutar.

Po kush është Shaqir Fetai që t’ia pranojë dorëheqjen kryetarit të Kuvendit të BFI-së? Kush është Shaqir Fetai që të emërojë kryetar tjetër të Kuvendit!

A u lexua arsyeja se pse u dha dorëheqja nga ana e Fadil Ramadanit?

A pati ndonjë raportim, ndonjë diskutim apo ndonjë debat mbi të kaluarën e Fadil Ramadanit si “kryetar Kuvendi”?

Dhe, meqë u konstatua dorëheqja e Fadil Ramadanit pa kurrfarë debati mbi përgjegjësitë apo lëshimet eventuale të tij, Shaqir Fetai, me pazare të poshtra bashkë me Myftiun e Shkupin, vendosin që kryetar të ri të Kuvendit ta zgjedhin Fejsall Kadriun, imamin e xhamisë në Hasanbeg, referent i Myftinisë së Shkupit! Ky fakt dëshmon se në Maqedoninë e Veriut kanë vdekur të gjithë teologët, nuk ka asnjë teolog-jurist, as teolog-ekonomist porse, për kryetar duhet të na vinë persona me defekte të rënda në “ecurinë arsimore” të tyre!

Propozim i kujt ishte ky farë Fejsall Kadriu? Pyetje publike për Fejsall Kadriun:

Çka është për të Kuvendi i BFI-së?

-Sa anëtarë duhet t’i ketë Kuvendi?

Sipas përqindjes, cila duhet të jetë përbërja e anëtarëve të Kuvendit dhe, fare në fund, Sa nene i ka Kushtetuta e BFI-së dhe, cilat janë detyrat, roli dhe kompetencat e Kuvendit të BFI-së?

Disa herë radhazi nënvizohet me plotë komplekse fakti që paskan “punuar konform Kushtetutës” së BFI-së! A u debatua diçka për llogarinë përfundimtare për vitin 2020, si për myftinitë ashtu edhe për Rijasetin. Si u arsyetuan shpenzimet, sa u shpenzua, ku u shpenzua, pse u shpenzua. Apo nuk pati nevojë për debat sepse do të dilnin në shesh të gjitha vjedhjet dhe hajnitë që u bënë si pasojë e lëmshit që u krijua me rastin e intrigave fatale që u luajtën një vit e sa mbi kurriz të BFI-së!

Në këtë mbledhje është dashur të debatohet edhe mbi punën njëvjeçare të Rijasetit! A mundet që të publikohet ai raport apo ai procesverbal që u mbajt në këtë mbledhje ku u raportua edhe mbi këtë pikë,

meqë puna e rijasetit dhe puna e reisit, sipas Kushtetutës, janë transparente!

Pa dyshim, një pyetje që ngacmon tepër shumë kërshërinë e popullatës myslimane në vend është: a u miratua Rregullorja për zgjedhjen e reisit? Si u zgjodh Reisi me një rregullore të Komisionit Zgjedhor pa u miratuar në Kuvend?!

Shërbimet profesionale të Rijasetit, a e informuan Fejsall Kadriun, “kryetarin” e Kuvendit se, anëtarët e këtij organi janë me mandat prej katër viteve dhe se mandati i këtij Kuvendi përfundon në dhjetor të këtij viti! Mos ka ardhur koha të mendohet për kuadrin e anëtarëve të Kuvendit me profil juridiko-administrativo-ekonomik, siç nënvizon Kushtetuta e BFI-së. Apo ky profil nuk i duhet Shaqir Fetait, sepse pastaj mund ta bëjnë tokë e ta devalvojnë deri në hajn klasik. Prandaj, Shaqir Fetai, edhe anëtarët do t’i propozojë me defekte arsimore me qëllim që vetë mos të dallohet aq shumë se është me defekte që ia plotësojnë vetëm gjysmën e profilit, sepse gjysmën tjetër ia ruajnë në dosje!

*(Tetova1, 4.03.2021)*

## **Abën të bojkotohet regjistrimi i popullatës deri në akreditimin e Medresesë? Përhirë të medresantëve që po dëbohen nga universitetet e vendit**

**Edhe diçka rreth dëbimit të Medresantëve nga Universitetet dhe fakultetet e vendit, si dhe rreth manovrimeve të Shaqir Fetait për ta amnistuar veten nga ky projekt i pushtetit prej të cilit doli edhe vetë si marionetë)**

### **Shkruan Ilir Ramadani**

Kohë më parë, opinioni i gjërë është njohtuar me një padrejtësi të përmasave raciste për sa i përket (mos)respektimit shtetëror të shprehur ndaj Medresesë “Isa Beu”, në Shkup! Bëhet fjalë për një letër qarkore të Ministrisë së Arsimit të këtij pushteti që e tolloviti edhe BFI-në duke e instaluar në krye të saj marionetën Shaqir Fetai!

Kjo letër qarkore e kësaj Ministrie i obligon të gjitha universitetet dhe fakultetet e vendit që mos të regjistrojnë asnjë nxënës që ka kryer këtë Medrese. Madje, në rastë se kanë gabuar dhe kanë regjistruar, urgjentisht t’i dëbojnë, t’ua kthejnë dokumentat dhe t’ua kthejnë paratë me të cilat kanë paguar semestrin e parë! Medresantët u dëbuan nga fakultetet! Madje, medresantë nuk guxon të pranojë as Fakulteti i Shkencave Islame! Në këtë Fakultet mund të regjistrohet ndonjë veterinar, ndonjë bujk, ndonjë mekanik, ndonjë gjimnazist, por jo edhe një medresant!

Kanë reaguar prindër, kanë reaguar nxënës, kanë reaguar e kanë shprehur pakënaqësi verbale edhe stafi arsimor i Medresesë, ka reaguar opinioni dhe, gjithësesi, “ka reaguar” dhe Shaqir Fetai, sa për të larë m... me sh...

Në reagimin e BFI-së të nënshkruar nga Shaqir Fetai, veç të tjerash thuhet edhe kjo: “...ka disa muaj që ka caktuar komision të veçantë që merret me akreditimin e Medresesë. Komisioni i kryesuar nga vetë Reisul Ulema i BFI të RMV, H. Hfz. Shaqir ef. Fetai, punon me intensitet të shtuar drejt arritjes së qëllimit...”

Ka disa muaj që po funksionaka një komision?!? Gati ia paskan arritur qëllimit? Cilit qëllim” Atij për të cilën Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI ka disa ditë rresht që ka tërhequr vërejtjen se, me gjasë, mbyllja e Medresesë është qëllim parësor, prioritet i Shaqir Fetait?!

Shaqir Fetai i prinë një komisioni dhe thotë se gati do t’ia arrijë qëllimit, kurse medresantët dëbohen nga fakultetet ku janë regjistruar dhe, të gjitha fakultetet urdhërohen që mos të regjistrojnë asnjë medresant!

Po del puna që, ky komision me në krye Shaqir Fetain, është në shërbim absolut të Ministrisë së Arsimit, për sa i përket kësaj mase të tipit racist. Në opinion po flitet se, nëse nuk arrinë të akreditohet Medresja, Shaqir Fetai na e paska “Planin B”, ndërsa po harron se edhe popullata myslimane e ka “Planin C” të përgatitur për Shaqir Fetain nëse ia arrinë ta realizojë planin B”! Plani C i myslimanëve nënkupton gurëzim të Shaqir Fetait si “shejtanët” në Mine gjatë kryerjes së Haxhit!

Më tej, në “reagimin” e vet, Shaqir Fetai mundohet që të shfajësohet duke thënë se ky problem na qenka shumë i vjetër. Po gënjen Shaqir Fetai! Ky problem, pra, problemi i dëbimit dhe mosregjistrimit

definitiv i Medresantëvë, nuk është i vjetër por, تازه, i këtyre ditëve! Motra jonë e respektuar, vajza e Hoxhë Enverit nga rrethina e Kumanovës, nuk u përjashtua nga Universiteti “Nënë Tereza” para 5-10-15-20 viteve, por, para 5-6 ditëve, apo para një muajve, pikërisht në kohën e Shaqir Fetait të instaluar dhunshëm në krye të BFI-së po nga ky pushtet që i trajton medresantët si “nxënës me shkollim të egër”!

Nëse Shaqir Fetai pretendon se ky problem na qenka i vjetër, madje që nga themelimi i Medresesë, pse atëherë, si profesor i kësaj shkolle fetare, kurrë nuk e publikoi shqetësimin e vet fetar e intelektual për padrejtësinë që i bëhet nxënësve të vet? Pse kurrë nuk reagoi si Myfti për padrejtësinë që po e përjetojnë bashkëqytetarët e tij përgjatë shkollimit sipëror? Po si anëtarë i Rijasetit të BFI-së, tash njëzet vite, cili ishte reagimi i Shaqir Fetait për këta nxënës që po trajtohen me “shkollim të egër”? Asnjë reagim, asnjë shqetësim publik, sepse paska pritur të themelojë komision, të bëhet kryetar komisioni, të hyje nëpër dyert e pushtetit si dikur kur ishte “student”? Shaqir Fetai ka dëshmuar se është një prej manipulantëve më të rrezikshëm të vendit, një prej rrencakëve më të pafytyrë dhe një prej shkatërruesve më perfekt të çdo gjëje që është ndërtuar me sakrificat e myslimanëve të vendit. Shaqir Fetai e përfundon “reagimin” e vet paçavurë me këtë fjali: “Për çdo ndryshim apo zhvillim në proces, opinioni do jetë i informuar në kohë.”

Ai pret ndryshime ndërsa medresantët hidhen në rrugë dhe humbin të drejtën e shkollimit sipëror! Për Shaqir Fetain nuk janë të rëndësishme shpenzimet gjysëm dekadëshe të prindërve të medresantëve dhe të studentëve që po dëbohen nga fakultetet! Për të me rëndësi është ndryshimi që e pret! Po me këta që po dëbohen çka do të bëhet? Kush do t’ua kompensojë investimet familjare, depresionin, ngarkesat emocionale dhe ngarkesat e ndryshme psikike, si do ta kompensojnë vitin e humbur! Pse Shaqir Fetai pret që të bëhet edhe më keq puna, me qëllim që të kthehet aty ku ka qenë para se të instalohet në krye të BFI-së?

Pa dyshim, edhe Shaqir Fetai është pjesë e lojës së pushtetit që e instaloi! Nuk ka se çka e zgjedh këtë punë me “komisione” të ndërsjella. Komisionet kurrë nuk kanë dhënë rezultate! Kjo punë duhet të zgjidhet me presion publik, me presion ndërkombëtar për ç’gjë kërkohet një sërë angazhimesh dhe aktivitete! Për këtë qëllim duhej të Bujar Osmani, sot, të ngritej edhe mjeti i bojkotit të regjistrimit të popullatës deri në akreditim të Medresesë! Për një masë të tillë kushtëzuese, natyrisht që duhet të ketë tope dhe jo b..., defekte këto fizike që hasen te “instalacioni” i pushtetit aktual!

Akreditimi i Medresesë nuk është problem i deputetëve, por i pushtetit i cili duhet të “sabotohet”! Nëse Shaqir Fetai ka shpresë të deputetët e BDI-së, siç shprehet poshtë- lartë”, atëherë, nga ky kontribut i privon edhe deputetët e tjerë myslimanë. Pse? U duhen pikë politike për zgjedhje ë? Shaqir Fetai e ka partizuar shumë keq BFI-në, kurse i ka dhënë “kompetenca fetare” partisë e cila e uli përdhe BFI-në me qëllim që marioneta e tyre, Shaqir Fetai, ta hedhë këmbën e ndyrë mbi kulm të këtij Institucioni! Allahu Fuqplotë thotë: **“Fenë që ndjekin këta idhujtarë, e pret shkatërrimi dhe ajo që bëjnë, është krejt pa vlerë”** (El-A’raf, 139).

*(Kombetare, 5.03.2021)*

## Manipulim apo injorancë e Shaqir Fetait

Në fb-un e Shaqir Fetait lexohet edhe kjo gënjeshtër, ky manipulim, apo kjo injorancë e Shaqir Fetait: “doajen i leximit të Kuranit”! Rrëshqet si thiu në akull Shaqir Fetai, sepse mundohet të keqpërdorë çdo mysliman që hy në BFI, qoftë për nevoja personale, qoftë për të pirë një çaj bashkë me “reisn” meqë tashmë është përhapur anekënd vendit se, Shaqir Fetai nuk kthen asnjë nga kabineti dhe se mund të hyjë brenda kushdo që i pihet një çaj a një kafe. Këtë nevojë – personale Shaqir Fetai sakaq e përkthen në “urime dhe përshëndetje” për Shaqir rezilin!

Keto ditë e paska “vizituar” hafëzi bashkëkohor, Egzon ef. Ibrahim, për të cilin thotë se është “doajen i leximit të Kuranit”! A është në vete Shaqir Fetai apo është tërësisht i dehur! Njeriu normal, njeriu sagllam kah trutë e kokës, njeriu i kthejlltë, njeriu që nuk ka qenë i përkushtuar nëpër “kurse serbe”, nuk flet kaq përhanë, apo, është deri në atë masë injorant sa nuk e di kuptimin e fjalës “doajen”! Po ata që rrinë përreth tij a nuk bën ta korrigjojnë, t’i sugjerojnë se ka bërë një llapsuz të përmasave të të pamendtit! “Doajeni i leximit të Kuranit”, Ekzon ef. Ibrahim!?! Po a e di Shaqir Fetai se vetë ai është “doajen” në raport me moshën e Ekzonit! Pastaj, “i leximit të Kuranit”? Po pse a vetëm te Shaqir Fetai lexohet Kurani a? Doajen i leximit të Kuranit mund t’i thuhet hafëzit më plak në botë, që është gjallë akoma dhe i fortë në lexim të Kuranit, i njohur, i pranueshëm dhe i dashur nga opinioni, i respektuar dhe i nderuar më shumë se të gjithë të tjerët! Doajen është më i vjetri i një profesioni, me një përvojë të gjatë e të pranueshëm nga të gjithë!

Egzon ef. Ibrahim është një prej hafëzlerëve bashkëkohorë, të gjeneratës më të re të hafëzlerëve që lexojnë dhe këndojnë bukur Kuranin Famëlartë! Kaq e thjeshtë!

*(1Kliklartë, 5.03.2021)*

## Shaqir Fetait nuk i intereson BFI-ja por, vetëvetja

**Opinion i gjërë tashmë i di të gjitha emrat e “teologëve” të Shaqir Fetait, të cilët vjedhin, shajnë, tradhetojnë, janë bashkëpunëtorë të shërbimeve të huaja, që janë të pamoralshëm, që punojnë kundër Kushtetutës së BFI-së e kundër urdhërave të Kuranit të Madhërishtëm, që janë sahanëlëpirës, puthadorë e servilë, që ia urojnë “reisllëkun” Shaqir Fetait në çdo minut, edhe pse që të gjithë e dinë se ai është instalacion i pushtetit maqedonas në BFI**

**Nga Jasir Jashari**

Nëpër shumë xhami të vendit tonë, zhvillojnë aktivitete të hoxhës apo imamit, edhe persona që nuk mund ta dëshmojnë profesionin e tyre me ndonjë diplomë adekuate, por që këtë aktivitet e kanë përvojë, madje që e kryejnë me nder e me devotshmëri. Natyrisht, ky aktivitet është si rrjedhojë e nevojës së xhematit i cili nuk mund të gjejë, apo nuk është në gjendje që ta paguajë një imam të pajisur me shkollim adekuat dhe me diplomë apo çertifikatë, me licencë apo dekret. Caktojnë një person që ua falë qartë dhe drejtë të gjitha namazet, një peson që është i aftë të jetë në rolin e imamit. Por jo gjithkund dhe jo përgjithku veprohet kështu. Nëse personat e tillë nuk janë servilë të “bandës” së BFI-së, sakaq do të kenë alibinë për ta larguar një person të tillë. Nuk u intereson xhemati, nuk u intereson namazi, as kryerjet e aktiviteteve të tjera të një hoxhe, atyre u intereson që ta ndëshkojnë të padëgjueshin dhe kundërshtarit e tyre, i cili, publikisht shpreh pakënaqësinë e vet ndaj të gjitha veprimeve antiislame, antimuslimane dhe antiteologjike! Ndëshkohet një “pseudoteolog” sepse nuk pajtohet me veprimet antiislame të “teologëve” të Shaqir Fetait!

Vetëm në administratën aktuale dhe në disa “organe” të BFI-së së Shaqir Fetait aktualisht janë dhjetra persona me “arsimim të sakatosur”, me diploma false, që janë të gatshëm më shumë t’ju shërbejnë shërbimeve sekrete se sa xhemateve, persona që nuk kanë fytyrë të dalin para xhematit, hajna, antihumanistë, antiislamistë, horexhinjë, zinaxhinjë, bixhozxhinjë, keqpërdorues të fitrit, të zeqatit, dalleverxhinjë, hipokritë të organizimit të haxhit, të zhvillimit të jetës fetare, sahanëlëpirës që drejtojnë institucione arsimore, të pashpirtë, të pasinqertë!

Tërë ky kontigjent i këtij soji të mbrapshtë lejohet që të funksionojë, lejohet që të prezantojë myslimanët e vendit shumë të devotshëm, lejohet të flasin në emër të komunitetit mysliman, edhe pse janë turpi i vetë islamit!

Ndërsa, një i respektuar nga xhemati, një i përzgjedhur për t’ju prirë në aktivitete fetare nga xhemati, një i respektuar e i nderuar sikurse një teolog i mirëfilltë, por që nuk ka as diplomë, as licencë, as dekret por ka gatishmëri e vullnet të shenjtë për t’i shërbyer bashkëqytetarëve të vet, pra, ky person dëbohet, vetëm pse i lakurqëson “pseudoteologët” e BFI-së së Shaqir Fetait, vetëm pse me reagimet e veta nuk pranon që të bëhet bashkëpunëtorë i “kolegjit asntiislamistë” që gojën e kanë plot islam!

Opinion i gjërë tashmë i di të gjitha emrat e “teologëve” të Shaqir Fetait, të cilët vjedhin, shajnë, tradhetojnë, janë bashkëpunëtorë të shërbimeve të huaja, që janë kockarë..., që punojnë kundër Kushtetutës së BFI-së e kundër urdhërave të Kuranit të Madhërishtëm, që janë sahanëlëpirës, puthadorë e servilë, që ia urojnë “reisllëkun” Shaqir Fetait në çdo minut, edhe pse që të gjithë e dinë se ai është instalacion i pushtetit maqedonas në BFI!

Opiniononi i gjërë i di të gjithë këta persona, sepse janë lakuriqësuar me dhjetra herë, me emër e mbiemër, i di të gjithë ata që janë me diploma false, pa shkolla e pa fakultete, me “çretifikata” arsimore të siguruara nga njeri që i dihet emri dhe adresa!

Po të njëjtit akoma janë në krye, janë krahu i djathtë e i majtë i Shaqir Fetait, janë “drejtues” të organeve e të institucioneve të BFI-së. Të tillët i duhen Shaqir Fetait, sepse i mbanë më lehtë në grusht dhe, e ka më të lehtë që t’i kontrollojë!

Të tjerët që nuk janë të heshtur karshi veprimeve antiislame të Shaqir Fetait, ata dëbohen nga xhamitë dhe nga institucionet e BFI-së, ndonëse mund të jenë shumë të dashur për xhematin. Shaqir Fetait nuk i intereson xhemati, por vetëvetja! Në të kundërtën, do t’i pastronte të gjitha organet, institucionet, do ta pastronte vetëveten nga të gjithë kjo “ushtri e shejtanit” dhe do ta drejtonte BFI-në me njerëz të pastër, të devotshëm e me integritet të lartë. Tani, këtu është vetëm një problem: a do të pranonin këta persona me integritet të lartë që të bashkëpunonin me Shaqir Fetain, i cili, nuk dallon as sa qimja e kokës prej bashkëpunëtorëve të vet të nënvizuar më sipër!

Prandaj, është konstatim i përgjithshëm që po qarkullon ndër myslimanët e vendit: Shaqir Fetait nuk i intereson BFI-ja, atij i intereson vetëvetja! Sa më shumë që ai interesohet për vetëveten, aq më tepër të tjerët interesohen për Shaqir Fetain e vërtetë dhe, jo rastësisht e gjejnë nëpër dokumenta të ndryshëm që mund t’i publikohen edhe në format libri! Shumë keq për Shaqir Fetain dhe për myslimanët e vendit!

*(Tetovasot, 7.03.2021)*



## Kur demagogu veshë kostumin e hipokritit

**Shaqir Fetai ishte munduar të na e përcjellë një “urim” lidhur me 7 Marsin, Ditën e Mësuesit, por që kishte përfunduar në një “tekst eseistik”, të hartimeve shkollore, mbi diturinë! Urimin e kishte përfunduar me një uratë: “Zoti e bekoftë mësimin dhe diturinë”**

**Shkruan një ish-medresante** (për redaksinë emri është i njohur)

Zoti e ka bekuar diturinë dhe mësimin bashkë me zbritjen e Kuranit! Kështu që, nuk ka nevojë të na dalë Shaqir Fetai kujdestar i diturisë dhe mësimi. Përhapësi i mësimave është mësuesi. Profesionit i mësuesisë është i shenjtë, sepse edhe vetë Pejgamberi ka thënë “ju kam ardhur mësues”!

Po ai që nuk e respekton mësuesin, po ai që nuk di, nuk mëson, nuk pranon të mësojë - çka i bie të jet ky nëse jo injorant, analfabet, i cili, nëse mundet të na shesë kopalla merr formatin e hipokritit dhe ky nëse “shpërndanë mësim” atëherë merr fund bota! Shaqir Fetai lutet që të bekohet mësimi, uron mësimin, ndërsa vetë, deri në këto çaste, ka dalë ngulfatësi i mësimave, të atyreve të shkruara në letër!

Njeriu i ditur për më të madhin kjamet nuk do ta shkille një aline të një neni të Kushtetutës së BFI-së, dhe jo më të gjitha aktet normative të këtij Institucioni!

Njeriu që uron mësimin, nuk do të kishte në sirtar plane se si ta degradojë deri në mbyllje të institucionit, ku nxihet dituria fetare dhe shkencore, Medresenë!

Njeriu që e madhëron edhe atë mësues që i dëbon medresatët nga shkolla, ai është hipokrit, i pa shpirt, është antidituria vetë!

Njeriu, si Shaqir Fetai, që në emër të Shtëpisë së Diturisë mbledh fitra, zeqate, kontribute të ndryshme fetare dhe, nuk i shpenzon për këtë Shtëpi por për intera personale mesquine – ky po që është kallëpi i injorantit!

Shaqir Fetai në “urimin” e vet paska thënë: “dituria është rruga më e shkurtë dhe më e drejtë për njohjen e të Madhit Zot”! A e di Shaqir Fetai Kushtetutën e BFI-së? A i di Shaqir Fetai aktet normative të BFI-së? A ka njohuri Shaqir Fetai se si zgjidhen organet e BFI-së? A e di Shaqir Fetai se BFI-ja nuk është vendi ku duhet t’ia shpejnë urimet dhe përshëndetjet për afinitet e tij për të vjedhur post, porse një vend i tillë është shtëpia e vet! A e di Shaqir Fetai që nuk duhet të gënjejë, nuk duhet të mashtrrojë, nuk duhet të bashkëpnojë më kriminelë, me hajna, me bixhozxhinjë. A e di Shaqir Fetai se edhe devetë i janë hidhëruar pronarit për atë se për t’iu prirë karavani përpara ua ka nxjrrë gomarin! Shaqir Fetai nuk i di këto gjëra, sepse është i padishëm, prandaj dhe, ai nuk e njeh të Madhin Zot!

Shaqir Fetai sot duhej të ishte në mesin e profersorëve të vet dhe bashkarisht të angazhoheshin për një debat gjithëpërfshirës për reforma, për avansim dhe për zhvillim të proceseve mësimore e të kapjes së diturisë konform mjeteve teknologike që po avancojnë në çdo ditë të lume!

7 Marsi është ditë e mësuesit dhe jo ditë e shprehjes së urimeve në format të hartimit shkollor të shkallës fillore.

*p.s.*

Këtë reagim, mbi të gjitha, këtë mllef kundër demagogut Shaqir Fetai ka mundur ta shkruaj e ta

shpreh edhe drejtori i Medresesë, por, ai hesht me shpresë se Shaqir Fetai nuk do ta largojë nga drejtorllëku. Mjer mësuesi shqiptar që duhet ta kujtojë Ditën e vet bashkë me kësi “reisul ulema” (“kryetari i dijetarëve”!!!) që me të drejtë po i thonë “instalacion i pushtetit maqedonas në krye të BFI-së”

*(1Kliklart, 7.03 2021)*

## **Krimi institucional nuk mbulohet me “mirënjohje”**

**Këto ditë, Shaqir Fetai e paska thirrur Kuvendin e BFI-së, pas dy viteve përgjumje të këtij organi kolektiv dhe. Në fund të kësaj mbledhje i paska “dekoruar” me “mirënjohje të gjithë anëtarët e Kuvendit, duke i falënderuar për punën dhe kontributin e dhënë”**

**Shkruan Shaban Aziri**

Dy vite më parë, po ky Kuvend ishte mbledhur dhe i kaloi qorrazi të gjitha buxhetet si dhe llogaritë përfundimtare të organeve të BFI-së dhe të Rijasetit. Që atëherë, nuk u mbledh më, ndonëse pasuan aktivitete nga më të trishtat në historinë e BFI-së! Si kurrë më parë ishte e nevojshme mbledhja e këtij organi, si kurrë më parë është dashur të dëgjohet fjala e këtij organi! Si asnjëherë më parë për këto dy vite, ky organ, është dashur ta shfletojë e të thirret në shumë nene të Kushtetutës së BFI-së, sepse, fundja, ky organ është edhe “pararoja” më e thirrur e mbrojtjes së kushtetutshmërisë së BFI-së dhe veprimtarisë konform akteve normative që i miraton, që i sjell, që i abrogon apo që i ndryshon e që janë kompetenca ekskluzive e këtij organi.

Pra, patëm shkelje të tërë Kushtetutës me rastin e puçit kriminal që iu bë ish-reisit! Patëm mospranim apo refuzim dhe as pranim të dorëheqjes së ish-reisit, akt këtë që e obligon Kushtetuta e BFI-së. Shkilet Kushtetuta kurse Kuvendi nuk debaton, nuk reagon, nuk i dëgjohet zëri!

Patëm “përcaktim” kush të jetë “ushtrues detyre”, dy kategori postesh këto të panjohra për Kushtetutën aktuale të BFI-së dhe për asnjë akt tjetër normativ në kuadër të këtij Institucioni.

Patëm manipulime nëse është “u.d.”, apo “reis”, gjë që Kushtetuta i sqaron mjaft mirë këto dilema, të cilat do të duhej të debatoheshin në Kuvendin e BFI-së!

Patëm “akte” të pamiratuara nga ky Kuvend!

Patëm emëtime pa u mbështetur në asnjë akt konform neneve të Kushtetutës së BFI- së!

Patëm zgjedhje të organizuara jashtë të gjitha standardeve dhe normave të përcaktuara në Kushtetutën e BFI-së dhe pa Rregullore për zgjedhje të Reisit!

Në të gjitha këto procese u injorua Kuvendi i BFI-së, në të gjitha këto procese u mohua kompetenca, detyra dhe obligimi i Kuvendit të BFI-së.

Në fund, pa debate ekspertësh, pa diskutime profesionale, në kohën kur po vlon policia financiare në BFI, anëtarët e këtij Kuvendi i miratojnë symbyllurazi “buxhetet” dhe “llogaritë përfundimtare” që kundërmojnë në krim, në hajni, në antiislamizëm.

Dhe, për këtë “vigjilencë” të anëtarëve të Kuvendit të BFI-së dhe, për miratimin në heshtje të tyre për të gjitha shkeljet Kushtetutare, për tërë atë mohim të madh që Shaqir Fetai ua ka bërë tërë kohës, në fund, do të “dekorohen”, me “mirënjohje duke i falënderuar për punën dhe kontributin e dhënë në të mirë të Bashkësisë Fetare Islame në përgjithësi”!

Kontributi i tyre konsiston në heshtje përballë shkeljeve flagrante të Kushtetutës; konsiston në pajtim me të gjitha veprimet kriminale që u ndërmorën, duke shkelur Kushtetutën, për ta grabitur Institucionin e BFI-së; kontributi i tyre konsiston në meritat e tyre që duke toleruar shkelje të akteve juridike të BFI-së, në krye të instalohet një fuks, akt ky që do t’i kushtojë shumë rëndë Institucionit gjashtëshekullor të BFI-së. Kjo nuk është asgjë tjetër përveçse një tallje dhe një ofendim i paparë në

hisorikun e BFI-së, të cilën nuk ia kanë bërë as pushtuesit më barbarë ndër shekuj.  
“Kontributi” i anëtarëve aktualë të Kuvendit të BFI-së është heshtja fantomike para instalimit të Shaqir Fetait në krye të BFI-së nga pushteti aktual! Dhe, “respektimi” i tyre me “mirënjohje” është vetëm një tallje e thellë! Personat me integritet dhe e dinjitet të paluhatshtëm do t’i grisnin e thyenin ato “mirënjohje” dhe do t’ia përplasnin surratit Shaqir Fetait, i cili, shpenzon nga buxheti i myslimanëve për ta “dekoruar” heshtjen përballë krimin! Turp! Zoti në hajër ishalla!

*(Botasot, 8.03.2021)*

## Gëzuar “8 marsin” Shaqir Fetai

**“Urimet dhe përshëndetjet paskan qenë opium për Shaqir Fetain! Nën këtë efekt me fuqinë narkotike, Shaqir Fetai ka shumë qejf të shprehë parreshtur urime dhe përshëndetje. Urimi i fundit i tij është data e “8 Marsit”, dita kur para një shekulli gratë socialiste fituan disa të drejta**

**Nga Fatime Emini**

8 Marsi shënon një nga ditët e lëvizjes së grave socialiste dhe, deri më vitin 1975 festohej kryesisht në vendet komuniste. Më vitin 1975, me sugjerim të Kombëve të Bashkuara u pranua si Dita Ndërkombëtare e Gruas.

Pikërisht këtë revolucion të para një shekulli të lëvizjes së grave socialiste, kur arritën të fitojë drejtësi e privilegje gati si të burrave, e uron Shaqir Fetai.

Por, ka një hile këtu! E gjuan gurin dhe e fsheh dorën, sepse e di që po bën një veprim komunist, po lartëson një “revolucion” apo një reformë të njerëzimit, e cila kurrë nuk mund t’ia kalojë, për shembull, gruas së parë që pranoi Islamin, Hazreti Hatixhes!

Ky është momenti i revolucionarizmit të gruas në botë, ky është çasti kur Allahu i Mëshirshëm, përmes Shpalljes, i përcaktoi të gjitha të drejtat, obligimet, kompetencat, detyrat dhe punët e gruas, duke e lartësuar atë deri në qenien nën shputën e së cilës gjendet Xheneti për çdo mashkull! Këtu pastaj merr fund “çdo revolucion femëror”, çdo angazhim sipërfaqësor feminist. Në Rusinë Sovjetike, më vitin 1917, 8 Marsi u bë si ditë kombëtare meqë në këtë ditë gruaja socialiste e fitoi të drejtën e votës! Pesëmbëdhjetë shekuj më parë, GRUAJA MYSLIMANE, Hazreti Ajsha, Nëna e myslimanëve, shquhej si prijëse e njohurive mbi Sunnetin e Pejgamberit a.s., fjala e saj dëgjohej e respektohej, urdhërat e saj zbatoheshin e nuk kishte “parlament mysliman” që t’i rrezonte urdhërat e saj.

Shaqir Fetai, këtë urim të ditës së grave socialiste e kamuflon përmes një titulli të denjë për analizë, për studim mbi gruan si shtyllë e familjes dhe njerëzimit!

Shaqir Fetai urimin e vet për “8 Mars” e përmbyllë me: “...kjo ditë që i kushtohet festës së gruas, nënës, vajzës – 8 Marsi – le të jetë një ditë e inspirimit për të ngritur femrën, gruan në pedestalin më të lartë të edukimit...”

Gabim fatal, i nivelit të xhahilit, përpjekja e Shaqir Fetait për ta barazuar 8 marsin e para një shekulli me festën më të shenjtë që nga çasti kur zbriti Shpallja e cila e ngriti gruan myslimane atje ku gratë e feve dhe kombëve të tjera do të mundohen ta provojnë 13-14 shekuj më vonë.

8 marsi nuk është as festë kombëtare, as shtetërore dhe aq më pak fetare apo religjioze. 8 marsi është festë ideologjike e sistemit më të egër e më të pashpirtshëm në raport me fetë qiellore. Pranda, një teologu nuk i ka hije të shprehë urata për një festë të tillë ideologjike. Shaqir Fetait mbase edhe i ka hije një festë e tillë, prandaj: gëzuar 8 marsin, Shaqir Fetai!

*(Lajme7, 8.03.2021)*

## Urimi i Shaqir Fetait edhe për dituritë bastarduese

**(Edhe diçka për “eseun” e Shaqir Fetait lidhur me mësimin dhe diturinë, me rastin e Ditës së Mësuesit Shqiptar)**

Në kohën kur shqiptarët dhe, përgjithësisht myslimanët, po përballen me diskriminim arsimor këtu në Maqedoninë e Veriut, Shaqir Fetai, i ekzaltuar apo i veshur nën petkun e skiles turret që mos të ngelë mbrapa dhe, shpreh urimet e tij hipokrite për sa më shumë dituri dhe mësim.

Por, a e tha qoftë edhe një fjalë Shaqir Fetai lidhur me vendimet e pushtetit aktual për pengimin e shkollimit sipëror të medresantëve. Madje edhe atë të drejtë që e patën për t’i ndjekur mësimet në FSHI, ua cunguan! Shaqir Fetai heshti si mumie, nuk e tha qoftë edhe një fjalë, sepse, do të mund ta hidhërojë pushtetin që e instaluan në krye të BFI-së dhe pastaj ta largojnë e mos t’i lënë vend as për myteveli.

A e ka në programin e vet inekzistent Shaqir Fetai angazhimin e tij për valorizimin e FSHI-së si dhe të kapaciteteve pedagogjike dhe intelektuale të mësuesve si në FSHI ashtu edhe në Medrese!

Cilën dituri dhe cilat mësimet i bekon Shaqir Fetai? Këto që imponohen nga pushteti maqedonas ndonëse të brymosura me shumë ofendime për shqiptarët dhe për myslimanët e vendit!

A e tha Shaqir Fetai qoftë një fjalë lidhur me ato mësimet që ligjërohen nga mësues maqedonasë e shqiptarë ndonëse janë me shumë të pavërteta rreth shqiptarëve! A e ngriti qoftë vetëm një herë zërin kundër përpiluesve të atyre teksteve, kundër Ministrisë së Arsimit, kundër partisë shqiptare në pushtet e cila heshturazi i miraton këto politika diskriminuese dhe ofenduese në mësimin e “të vërtetave” shoveniste për shqiptarët.

A e ngriti zërin te faktorët e ndryshëm kombëtar e ndërkombëtar për këtë armiçësi institucionale që e shprehin maqedonasit në gjeografi, në histori, në letërsi, në muzikë! Po si nuk i kanë rënë në sy Shaqir Fetait mësimet që e shtrembërojnë të vërtetën për Muhamedin a.s. si dhe për Kuranin të cilin e servirin si “vepër të Muhamedit a.s.”! Jo, sepse Shaqir Fetai është i edukuar si më parë në kohën e Jugosllavisë që, gjithçka që serviret nga pushteti maqedonas, të thuhet “amin”, madje në stilin e tij të njohur anakënd vendit!

Shaqir Fetait, sikur të ishte në postin e vet meritator, do t’i kishte hije që të ngiste dhe të financonte komision gjithëkombëtar që të hartohen librat me mësimet të unifikuara për të gjithë shqiptarët dhe për të gjitha lëndët shqip dhe jo të na urojë mësimet dhe dituri të ligjeruar nga libra e persona antishqiptarë e antimyslimanë.

*(Politesa, 8.03.2021)*

## **BFI dhe BDI në koalicion për zgjedhjet lokale**

**Komunitetet fetare sikur u dakorduan me pushtetin aktual për mbarëvajtjen e procesit të regjistrimit, ndonëse Kisha Ortodokse Maqedonase, doli hapur se nuk do të përfshihet në këtë proces. Pastaj i mblodhi Bujar Osmani, të cilin takim e bëri publik vetëm Shaqir Fetai dhe Bujar Osmani! Liderët e tjerë fetar as që e regjistruan “n’rabush”. Sot Shaqir Fetai paska mbajtur pres konferencë me Artan Grubin. Ka ngelur ta takojë vetëm edhe portirin e selisë së BDI-së**

**Nga Sabit Ibrahim**

Gjithnjë sa po afrohen zgjedhjet lokale, por nuk është çudi nëse mbahen bashkë edhe me zgjedhjet parlamentare, po aq më shume po shpresohen takimet e funksionarëve të BDI-së me Shaqir Fetain, instalacionin e pushtetit maqedonas në BFI! Kjo do të thotë se, BDI po përgatitet për një koalicion parazgjedhor me BFI-në e Shaqir Fetait. Kushti i vetëm do të jetë: përkrahja e Shaqir Fetait me kthimin e borxhit në natyrë - xhamitë t’i shndërrojë në shtabe të BDI-së. Jo vetëm kjo por, edhe të tremben me mosregjistrim të fëmijëve medresantë nëpër fakultete të të gjithë hoxhallarëve që do të pozicionohen nëpër fraksione të BDI-së që veçmë sa nuk kanë shpërthyer. Kjo u diskutua, veç të tjerash, në takimin Fetai-Grubi, dy nga personat më të urryer dhe dy nga shkaktarët kryesorë për plasaritje kombëtare e fetare në trungun shqiptar këtu në RMV.

Në konferencën për media, moderatori Shaqir Fetai, nënvizoi se këta dy tullusuma paskan biseduar për tri çështje jetike për shoqërinë tonë: për regjistrimin e diasporës sonë, për akreditimin e Medresesë si dhe për kthimin e vakëfit!

### **Regjistrimi i popullatës si çështje jetike shqiptare**

Shaqir Fetai thotë se regjistrimi i popullsisë qenka çështje jetike për shoqërinë tonë. Rrenë Shaqir Fetai, apo është futur në skema të huaja, sepse ky regjistrim ka qenë, është dhe do të jetë jetike vetëm për shqiptarët e RMV-së.

Shaqir Fetai rrenë edhe kur thotë se tashmë i kemi angazhuar të gjitha Unionet në diasporë që të apelojnë nëpër qendrat tona me qëllim që të regjistrohen sa më masovikisht! Qendra, Shaqir Fetai u thotë xhamive tona, të cilat frekuentohen nga, hajde të themi, 20-30 myslimanë standard në ditë, të cilë nuk janë që të gjithë shqiptarë. Këta myslimane janë kryesisht të gjeneratës më të vjetër të cilën nuk i kanë punët mirë me teknologji! Duhet t’i lusin fëmijët të cilët në masë prej 70 për qind nuk e dinë gjuhën shqipe të shkruar e aq më pak gjuhën maqedonase. A është përpjekur Shaqir Fetai që formularet me dhjetra pyetje t’ua përkthejë në gjuhën zyrtare me të cilën komunikojnë këta të rinjë?

Nuk ka ditë që nuk u shahet nëna funksionarëve në RMV si dhe që nuk ua mbyllin gojën propagandistike hoxhallarëve në diasporë të cilët mund të apelojnë për regjistrim por që ky proces ua prish nervat shqiptarëve, sepse nuk ua pranon numri amë!

Këta qeveritarë tanë, a kanë ngritur ekip zyrtar për të kontrolluar se sa nga “numrat amë” të

shqiptarëve nuk janë të regjistruar në kompjutorë! Ti mund të keshë shtetësi e çertifikatë të lindjes me gjithë numrin amë, por, mund edhe të mos jeshë i evidentuar në kompjutor! Përpyekjet individuale të funksionarëve shqipfolës për ta përgënjeshtuar këtë të vërtetë janë të kota dhe të urdhëruara nga punëdhënësit e tyre, kjo duhet të jetë çështje e komisioneve të veçantë kombëtar e ndërkombëtar.

Shqiptarët këtë proces janë të interesuar ta çojnë deri në fund dhe sa më masovikisht të regjistrohen, nëse nuk e stopojnë Zajevi-Ahmeti, siç e stopuan Gruevski-Ahmeti, atëherë kur në gjysëm të procesit u kuptua se shqiptarët po e tejkalojnë 30 për qindëshin.

Shaqir Fetai nuk duhet të përfshihet në këtë proces, sepse ky akt nuk do të mund ta rehabilitojë dhe t'ia shlyej mëkatet e kryera antikombëtare nën pseudonimin policor serb ORAO! Shaqir Fetai mund të jetë dëm i madh kolateral, sepse, nëse mund ta “duan” udhëheqësit e qendrave si objekte, ai urrehet me të madhe nga popullata myslimane që i përket diasporës sonë. Tashmë një përqindje bukur e madhe e diasporës sonë nuk po pranojnë të regjistrohen vetëm për inat të Shaqir Fetait. Ata nuk pranojnë “sugjerime” nga UDB dhe nga udhëbuesit, aq më pak nga ORAO! Shaqir Fetai në këtë rast do të punojë vetëm për dy interesa: 1. është interes i UDB-së dhe i kishës serbo-maqedonase që të dalin sa më pak shqiptarë dhe myslimanë dhe, 2. është interes i dyfishtë i Shaqir Fetait: a) për t'u dëshmuar se sa aktiv dhe i suksesshëm që është ky “ujk i vjetër” me emrin ORAO dhe, b) nëse del i suksesshëm procesi të pranohen “meritat” edhe të Shaqir Fetait, sepse, elbete, mund ta rehabilitojnë “patriotët me bateri”!

Jo rastësisht pastaj, njëri prej themeluesve të BDI-së do të shpreh shqetësimin e vetë duke thënë se po ndodhin disa dukuri që nuk shkojnë në të mirë të BDI-së. Pse a qenka e mirë e kësaj partie koketimi me Shaqir Fetain të cilin nuk e pranon më shumë se gjysma e Çegranit pikërisht për shkak të së kaluarës së tij dhe familjarëve të tij si udhëbues.

## **A mund të bëhet arsimimi pazar**

Opinionin e gjërë tashmë është informuar se çka po ndodhë me medresantët tanë. Kemi reagimin e një hoxhe të cilit ia larguan vajzën nga fakulteti. Nuk pat kurrfarë solidarizimi me këtë hoxhë! Kolegët e tij, hoxhallarë, heshtën, nuk iu bashkangjitën në protestë! Kjo, ose ndjehen të turpëruar që i kanë fëmijët e tyre në medrese, ose, duke u angazhuar për pozitën “hoxhë” praktikisht dëshmojnë se nuk janë prindër, apo nuk janë falënderues ndaj Krijuesit të tyre që i bëri prindër për ta derdhur edhe mishin e trupit për fëmijët e tyre. Ky është problem i tyre, problem shoqëror është që Shaqir Fetai arsimimin e gjeneratave të reja e pranon, e legalizon dhe e zyrtarizon si pazar ku edhe mund të këmbehen mallrat. Dëgjueshmëri e servilizëm për regjistrim të medresantëve kundër vullnetit të tyre, vetëm në ato fakultete ku ka vende të lira! Qenkan në fazën e zgjidhjes së problemeve! Kush e shkaktoi këtë problem? Pse e shkaktoi? Për interes të kujt u shkaktua? Kush ka interes më të madh për ta abroguar këtë vendim? A është interesi më i madh dhe më jetik për shoqërinë tonë i LSDM- KOM-it apo i BDI-BFI-së. Duke e ditur se çka i bënë BFI-së Shaqir Fetai dhe BDI, po del puna se i vetmi interes po ngel ai i LSDM-KOM-it që mos të akreditohet Medreseja, jo një herë në raport disproporcional 800 (medresantë) me 80 (bllagoslllovanë)!

Shaqir Fetai ndahet i kënaqur nga premtimi i Grubit se do ta shqyrtojë këtë vendim që pa nevojë e kanë miratuar vetë ata (qeveria)! Po çka do të bëhet me ata djem e vajza që po e humbin vitin si pasojë e dëbimeve hitleriane nga fakultetet? Natyrisht, kjo dukuri nuk mund të jetë bregë e ORAO-s!



## Vakëfi

Shaqir Fetai shprehet i kënaqur se kjo qeveri paska kthyer diçka nga “vakëfi”, edhe pse pritej më shumë! Kjo qeveri nuk ka kthyer asnjë vakëf, asnjë pronë, por, i ka vlerësuar vetë dhe ka caktuar çmim, pra, ka ndarë bono në vlerë! Dhe krejt ajo çfarë është kthyer dhe vendimet që janë tanimë në pritje të realizimit, janë rezultat i presioneve permanente nga ish-Reisi, Sulejman Rexhepi. Pra bëhet fjalë për vendime të viteve 2018 dhe 2019 për të cilat është punuar për disa vite me radhë! Dikush e ka lënë atë pronë si amanet për ta zhvilluar jetën fetare islame e jo për të marrë rrogë Shaqir Fetai apo Qenan Ismaili i cili për këto vakufe nuk kanë dhënë as më të voglin kontribut! Vakëfi e ka dedikimin e vet të shenjtë dhe, çdo tjetërsim i këtij dedikimi, është grabitje, është shitje e pronës për të futur para në xhep!

Nga ana tjetër, nuk ka kthim të pronës apo të bonove në vlerë pa sekserë. Sekserët punojnë për palën e tretë, për palën nga i cili varet denacionalizimi! Kërcet 20 përqindëshi gjithandej, aq më tepër tani në prag të zgjedhjeve lokale dhe, mbase edhe parlamentare. Tani të gjithë shprehin interesim për decentralizim, vetëm a jeni të gatshëm të bashkëbisedoni me sekserët, sepse na duhen lekët për zgjedhje lokale dhe parlamentare; na duhen lekët për të blerë vota dhe pushtet. Shaqir Fetai e do pushtetin, prandaj qëllimisht ka harruar se me paratë e vakëfit duhet të shtohet vakëfi e jo pushteti. Vakëfi duhet të shtohet, sepse është konceptuar si burim financiar që i shërben ekskluzivisht fesë islame.

*(1Kliklart, 9.03.2021)*

## Fati i Shaqir Fetait si i Isa Mustafës

**A ju kujtohet LDK-ja e kohës së Presidentit historik të Kosovës, Ibrahim Rugova? Ju kujtohet edhe koha e pasardhësit të tij, Fatmir Sejdiu! Me njëmijënjë intrigë LDK-në e pushtoi udhëbashi Isa Mustafa dhe, sot, LDK-në e solli në Partinë më të papërfillshme! Nuk është mendimi plural, nuk është as lufta korrekte për pushtet, nuk janë as konkurrencat lojale apo jolojale e subjekteve të ndryshëm, por, janë intrigat e poshtra ato që mund ta rrënojnë një subjekt, qoftë ai politik apo fetar**

### Nga Nijazi Fetahaj

Kur nisi t’ju dalë boja e humanitetit Institucioneve fetare që janë të thirrura, mbi të gjitha, edhe për humanitet, në skenë dolën filantropë e humanistë të ndryshëm, si Halil Kastrati, Elvis Naçi, Marin Mema, “Kalliri i Mirësisë” etj.

Ose, kur Lëvizja “Vetëvendosja” u aktivizua si subjekt politik, nuk pat parti në vend, nuk pat subjekt kombëtar e ndërkombëtar që nuk e kritikuan, që nuk bënë lloj- lloj propagande kundër kësaj Lëvizje dhe liderit të saj, Albin Kurtit, si për një parti ekstremiste, terroriste, të rrezikshme, antiamerikane, antiperëndimore e çka jo tjetër! Me durim, me urtësi, me mençuri e me shpalsje të së vërtetës, në fund, ja ku jemi – Vetëvendosja strehë kombëtare! Fitore historike! Isa Mustafa, ky humbësi më i madh, si në aspekt moral po ashtu edhe në aspekt politik, sot po përfundon, madje as në margjinat e faqeve të historisë por, në kosh!

Ku ishte dikur Bashkësia Fetare Islame e RMV-së, dikur dhe tash e gjashtëqind vite! Kush i priu këtij Institucioni më të vjetër dhe, deri dje, të vetëm fetar islam! Figura markante të kombit e të fesë! Figura që arritën ta bartin brezë pas brezi këtë Institucion, deri sa nuk na e instaloi pushteti maqedonas Shaqir Fetain! Poshtimi i këtij Institucioni nisi pasi e dëbuan me xhelozë e me intrigë ish-sekretarin e përgjithshëm, Hafëz Afrim ef. Tahirin! Një prej intrigantëve paska qenë edhe Shaqir Fetai!

Ka pasur shumë “figura” që kanë qenë në lojë për t’u instaluar nga pushtetet e ndryshme, por që, asnjëri nuk e ka pasur guximin, sepse, këtë guxim ua ka ndrydhur e kaluara e tyre si bashkëpunëtorë të UDB-së, apo të shërbimeve të mbretërisë serbe. Këtë guxim e pati vetëm Shaqir Fetai – prej një askush të katapultohet në “reis” me ndihmën e pushtetit aktual maqedonas, pavarësisht biografisë së vet shumë të diskutueshme.

Si kurrë më parë, sot myslimanët e vendit nuk dëshirojnë të dëgjojnë për BFI-në! Në ndeja, nëpër çajtores, nëpër oda, nëpër kafe, nëpër mektebe, në taksì, në shëtitore, kudo që të jeshë, flitet vetëm për turpet e BFI-së si dhe për të bëmat antiislame të Shaqir Fetait.

Shaqir Fetai e ka frikë rrjedhën e xhematit! Nuk i intereson shterrja e burimeve financiare që mbahen nga xhemati, frikë e ka rrjedhën e tyre, tretjen, zhdukjen, kalimin e xhematit në subjekt tjetër!

Kalimet nga subjekti në subjekt tjetër bëhen si rrjedhojë e zhgënjimeve, janë pasojë e mosdurimit të intrigave, të vjedhjeve, të sjelljeve autoritare, të qëndrimeve demagogjike, të prodhimeve të intrigave e të mllaçitjes së hipokrizisë!

E keni parë se çfarë tmerrri e ka zënë Shaqir Fetain nga regjistrimi i një “bashkësie fetare” të re,

Bashkësia Islame Selefiste “Dar el Hadith”, me seli në Shkup?! Çfarë rreziku i paraqet kjo bashkësi? Pse kaq i tmerruar Shaqir Fetai! Pse, këtë trishtim nuk e shpreh, bie fjala për “bashkësinë islame” të Kumanovës, me në krye Sadulla Bajrami! Asnjë fjalë për këtë “bashkësi”, e cila është me xhemat të vet, me xhami të vet, me “organet” e veta! Pse i tmerrhet Shaqir Fetai “Dar el Hadith-it”!

Pasi u zbërthye tërë hajnia e Mustafa Dautit në “Hilal”, pasi po zbërthehet epshi për “topërllak” i “kryetarit”, Fadil Ramadani, të emëruar nga Shaqir Fetai, uzurpatori i BFI-së, le të dëshmojë me dokument Shaqir Fetai se, sa para humanitare kanë hyrë nga myslimanët tanë në xhirollogarinë e “Hilalit”?! Pse ka rënie të fitrit dhe zeqatit si dhe të kontributeve të tjera fetare? Jo se ka rënë numri i myslimanëve, jo se myslimanët pranojnë që mos t’i kryejnë obligimet fetare por, thjesht, ato obligime (në financa) i kanë orientuar kah organizatat dhe individët humanitar që raportojë cent për cent se kah po shkojnë lekët e tyre.

Le të dalë Shaqir Fetai e lë t’i mbledhë nga myslimanët e tërë botës, një milion euro, sa ka mbledhur gazetari Marin Mema në xhirollogarinë e vet, për t’i ndihmuar ata që pësuan nga tërmeti i 26 nëntorit të vitit 2019 në Shqipëri! Shaqir Fetai hafëz, “hoxhë”, “profesor”, “myfti”, “reis”, me çallmën më të madhe se kapuçi i “dedomrazit”, brenda një muaji nuk do të mund të mblidhte as 0,001 për qind të buxhetit që e mbloodhi një gazetar i thjeshtë televiziv! Kjo për faktin se ai është dëshmuar si kombëtar e me zemër të bardhë, ndërsa Shaqir Fetai nuk do të mund ta heqë kurrë nga vetja etiketën e të arriturit në pozitën e reisul ulemasë me intriga nga më të poshtrat dhe me ndihmën e pushtetit maqedonas! Sa për përgatitje dhe aftësi, ai nuk e meriton as pozitën e muteveliut!

Nuk mbahet uniteti me diktat! Shaqir Fetai mendon se duke i përdorur veglat e shtetit mund ta shlyej nga regjistri Bashkësinë Islame Selefiste “Dar el Hadith”, i cili është regjistruar fare në mënyrë të rregullt, pa kurrfarë intrige! Po Shaqir Fetai që na dilte i regjistruar herë si “ushtrues detyre” e herë si “reis”?! “Dar el Hadith-i” nuk shkeli asnjë procedurë ligjore, nuk manipuloi as një organ, thjesht u paraqit me bordin e vet themelues, me Statutin e vet si dhe me Programin e veprimtarisë si bashkësi fetare islame!

Pas veprimeve të Shaqir Fetait, krejt bota e di që nuk ka më “Bashkësi Fetare Islame”, por ka një objekt i cili, si

grmadhë dëshmon se këtu, dikur e një herë, ka funksionuar i vetmi institucion fetar islam. Prandaj, kërcen përpjetë Shaqir Fetai sikur të jetë ulur në ndonjë zharan! Atij nuk i pengon “bashkësia” tashmë e dëshmuar si jokombëtare e Sadulla Bajramit, të cilin ish-reisi Sulejman ef. Rexhepi e quante “monstër”?! Shaqir Fetai duhet të dalë publikisht dhe të na tregojë se, pse ajo “bashkësi” në Kumanovë nuk i pengon por i pengon kjo “bashkësia” pralele në Shkup!

Po druaj se Bashkësisë Fetare Islame, dikur e vetme, do t’i ndodhë si LDK-së së Isa Mustafës! Populli nuk ha bar, nuk e duron padrejtësinë, nuk e stimulon hajninë, nuk e ushqen piraterin dhe grabitjen, por, lakmon gjithnjë pas së mirës dhe pas së drejtës! Atje ku do të jetë e mira dhe e drejta, atje do të rrjedhë! 90 për qind e popullatës së Kosovës ishin me LDK-në, pastaj kjo përqindje e kësaj popullote do të ndahet në PDK e në AAK, por edhe te NISMA! Sot, këto parti rrezikojnë të zhduken, sepse popullata po e do angazhimin kundër korrupsionit, kundër nepotizmit, kundër kapjes së shtetit, kundër vjedhjeve, kundër krimit e mashtrimit, kundër intrigës e shitjes së atdheut, dhe këto vlera po i gjënë ekskluzivisht te Vetëvendosja dhe te Albin Kurti.

Shaqir Fetai po ndjenë se gjendet në po të njëjtat sprova ku u gjendën liderët tashmë opozitarë të Kosovës! Prandaj, po mundohet të ndërmarrë masa, prandaj po mundohet ta paraqesë “bashkësinë islame” individ si rrezik potencial për shtetin! A nuk është Shaqir Fetai rrezik për shtetin, i cili është i rrethuar me kriminelë, i cili joshet në shkelje kushtetutare, i cili përkrahet në shkatërrimin e organeve dhe të BFI-së, por, i rrezikshëm na qenka vetëm një individ, i cili, haptazi shpreh mosbesim në këtë

Bashkësi Islame të Shaqir Fetait, dhe që kërkon të lihet i qetë që të praktikojë atë islam që e kanë praktikuar pasuesit e Muhamedit s.a. dhe jo pasuesit e Shaqir Fetait.

Institucionet shtetërore duhet të kenë kujdes dhe mos të manipulohen nga intrigat e Shaqir Fetait, të mos përzihen në organet e gjyqësorit, sepse, këta nuk janë të pamend, nuk janë objekt talljeje për Shaqir Fetain, ato organe, dinë çka regjistrojnë, i njohin ligjet, dinë të lexojnë Statut, dinë të lexojnë Programe! Kur ata dallojnë dhe binden se gjithçka është në rregull, ç'ka këtu të përzihet Shaqir Fetai dhe mentori i tij Zoran Zaev! Vetë populli do të vlerësojë se kush është më i mirë dhe më i devotshëm: Shaqir Fetai që vjen nga nëntoka serbo-maqedonase, apo Xhemal Jakupi që, fundja, ka qenë medresant i “Isa Beut”, ku dikur na paska ligjëruar “prof” Shaqir Fetai.

Shaqir Fetai nuk ka se çka e kërkon ndihmën e organeve shtetërore si dhe të pushtetit maqedonas për t’ia eliminuar konkurrencën në lidhshmëri! Këtë le ta bëjë me punë e me devotshmëri, është vetë popullata që duhet të bindet. Deri më sot, populli mysliman nuk ka përjetuar asnjë grabitje, asnjë ofendim, asnjë poshtim, asnjë fyerje të Institucionit të BFI-së, nga Xhemal Jakupi, ndërsa thëllësisht është i turpëruar nga Shaqir Fetai. Kjo është e vërteta, i dogji dikujt apo jo! Siç është i vërtetë edhe fakti se, kur mundet të funksionojë një BFI e Shaqir Fetait i cili është absolutisht ilegal dhe ilegjitim, pse të mos mundet të funksionojë një bashkësi fetare e Xhemal Jakupit i cili, nga bordi i vet është zgjedhur legalisht dhe në mënyrë statutare! Veprimtaria e tij është “zero”, të tjera “bashkësi” janë dëshmuar se e meritojnë dryrin e popullit!

Prandaj edhe janë dorëheqjet! Prandaj edhe dorëhiqet “në mënyrë të kullturuar” Isa Mustafa, duke u bërë shembull i patejkalueshëm edhe për Shaqir Fetain, sepse, e pret po ky fat i Isa Mustafës.

*(Tetovasot, 10.03.2021)*

## Artan Grubi me Shaqir Fetain në akshihane

**Ulur në akshihane Nasradin Hoxha dhe Arton Grubi! Artoni (i dashuri i Ali Ahmetit) nuk është i rehatshëm. Ulur këmbë mbi këmbë dhe në gjysëm b... “Ç’ke”, i thotë Nasradin Hoxha, “pse nuk je rehat” Pse nuk ulesh në birë të b...”? Mbrëmë kam pirë shumë dhe, nuk e kam të qartë, pse më dhemb b... e jo koka**

**Nga Fetah Shaqiri**

Këto ditë, në vizitë të “Reisit” ishte edhe Arton Grubi, njeriu që kishte mbetur noksan pa e vizituar “ekspozitën qeveritare” e cila mburret me të vetmin eksponant, në formë të instalacionit.

Arton Grubi, në bazë të uljes, dëshmon se nuk i ka punët mirë me prapanicën, por, harron se ky problem është personal dhe jo i Bashkësisë Fetare Islame. Çfarëdo të jetë kjo “bashkësi”, le të jetë edhe organ i shtetit, le të jetë edhe organ i LBGT-së, le të jetë edhe “wc” e pushtetit, megjithatë, për hirë të anëtarve të saj të devotshëm, duhet të respektohet, jo Shaqir Fetai por Instoititucioni.

Arton Grubi, ky farë “burrshtetasi” i leshit, këto ditë paska shkelur në BFI dhe, në kabinetin e “reisit” vërehet ulur këmbë mbi këmbë, sa nuk ia ka futur këpucën në gojë Shaqir Fetait. Shaqir Fetai e meriton në gojë (këpucën), por, jo të Arton Grubit!

Në momentin kur ai ia drejton këpucën në gojë Shaqir Fetait, ky farë “reisi”, në vend është dashur ta heqë “çallmën” nga koka, sepse, me këtë rast po teprohet ofendimi i intitucionit “reis”!

Kush është Arton Grubi që të tallet me këtë “institucion”, ai duhet të dije se, ky Institucion duhet të jetë i të gjithë myslimanëve dhe jo “anëtarë” i BDI-së! Mbase para strukturave të BDI-së ai mund të rrijë edhe si të dojë, edhe pa brekë, por, në Institucionin fetar ka protokol! Në prezantimin institucional ka protokol, ka respekt, ka rregulla! I pëlqen Shaqir Fetai Arton Grubit apo jo, ai duhet të paloset si nuse, duhet të nusërojë, sepse para REISIT ai është zero, askushi, ai duhet të dijë se para REISIT është si një miu i p..., si një morr i p... si një qime leshi i b.... Nuk vlenë hiç më tepër! Shaqir Fetai mund t’ia rrisë vlerën, por, në fakt, ai, para Institucionit fetar është një besimtar i thjeshtë, nëse është besimtar, nëse jo, menjëherë duhet të dëbohet nga “reisi”, me qëllim që mos të përjetojë ofendim kaq të madh.

Le të na e gjejë, qoftë Shaqir Fetai, qoftë Arton Grubi, një funksionar shtetëror apo ndërkombëtar që i rri këmbë mbi këmbë Dedo Stefanit?!

Më të paktën që ka mundur ta bëjë Shaqir Fetai si reagim kundër kesaj sjellje të poshtër të Arton Grubit është që ai ta hiqte çallmën nga koka, t’i sillej në të njëjtën mënyrë si Arton Grubi, pavarësisht problemeve të tij me prapanicën. Në Institucionin Fetar je si në xhami, prandaj, edhe qëndrimet do të jenë identike. Keni parë qëndrim këmbë mbi këmbë në xhami! Një i tillë dëbohet nga xhemati shqelma b...

Shaqir Fetai duhet të jetë më tepër i dhënur pas fesë dhe predikimit fetar se sa pas partisë (BDI-së) dhe servilizmit partiak!

*(1Kliklarg, 11.03.2021)*

## Shaqir Fetai, ky tallës i pashpirt

**Kur të plasë cipa e turpit, kur të zhytesh në mëkate deri në maje të hundës, kur të tradhëtoshë, kur të bashkëpunoshë më djallin e me të birin e tij, vetëm për të ecur karriera jote e pamerituar, atëherë edhe tallja me krijesat e Zotit të ka hije. Ky është çasti kur nisë e bëhesh konkurrencë e djallit**

**Shkruan Sadri Osmani, mësues i pensionuar**

Shaqir Fetai, tash e disa herë mundohet të na paraqitet si “arsimdashës i hatashëm”! Njeriu i cili kurrë në jetë personalisht vetë nuk ka bërë asgjë për arsimin (edhe “librat” që i ka, i ka kompilacion, plagjiaturë, pasuse të përkthyer e të “fshehur” nga fusnotat, mësimet të shtrembëruara, të përcipta, të thata, pa mendim të thellë, pa shkencë, sepse, për ta njohur shkencën e “librave të Shaqir Fetait” duhet t’i keshë lexuar disa biblioteka arabe si dhe të jeshë njohës i përkryer i asaj shkence po ashtu në gjuhën arabe); ky “arsimdashës” që pajtohet me vendimet qeveritare për t’i mbyllur medresetë, që pajtohet për t’i përjashtuar medresantët nga fakultetet e ndryshme, sepse e ka në gjakë për t’i ofenduar arsimtarët, për Shaqir Fetain arsimtarët e Medresesë “Isa Beu” janë të padenjë për të nxjerrë pasues të mësimëve nëpër institucione të larta arsimore!

**Më mirë ateist se me “fenë” e Shaqir Fetait!**

Gjithë këtë ofendim që ia bën Shaqir Fetai Medresesë si dhe FSHI-së, ai fton personel arsimor nga shkollat e ndryshme që të vinë dhe t’i shprehin urime dhe përshëndetje për “reisllëkun” që e ka peshqesh prej pushtetit aktual maqedonas. Janë me qindra shkolla fillore e të mesme shqiptare të cilat na u dashka që të rreshtohen në radhë për të ardhur te Shaqir Fetai! Po pse kjo nevojë? Po pse kjo praktikë idiotike? Apo, vijnë delegacione vetëm nga ato shkolla ku Shaqir Fetai ka ndonjë kushëri, ndonjë mik, ndonjë balldëskë, ndonë prind të shokëve të fëmijëve të vet, donjë prej miqasive të kushërinjëve, ndonjë dhëndër të hallës, tezes, dajës, ndonjë që pranon të manipulohet dhe i përgjigjet Shaqir Fetait sa për t’ia mbuluar shejtanllëqet e tij kundër arsimimit të fëmijëve shqiptarë! (Sa fëmijë kanë ngelur pa shkollë, duke ua marrur më qafë prindërit derisa ka bërë karrierën e ORAO-s)!

Shaqir Fetai është model i “liderit” politikisht të instaluar në një institucion fetar, model i zhvillimit të karrierës të një bashkëpunëtori të shërbimeve sekrete, model i një matrapazi në arsim e në kulturë, model i shkatërrimit të institucioneve, përmes shkeljeve të akteve normative, përmes intrigave, shantazheve, përmes “unitetit djallëzor” dhe naivitetit të vet të skajshëm, të lexueshëm e të pështirë për secilin njeri normal. Këta që e vizitojnë, që i shprehin pëshëndetje dhe urime, janë të detyruar, sepse, prej dikah e kapë ndonjë lidhje fatkeqe me Shaqir Fetain.

Autori i këtij teksti është arsimtar në pension! Nuk ka para, nuk ka fuqi, nuk ka shërbim sekret që do të më detyronte ta qokë dorën me Shaqir Fetain, me këtë krijesë kaq të dëmshme e të panevojshme për shoqërinë shqiptare! Tërë ditës e kalojmë me kolegë të ndryshëm, nëpër çajtores e në Parkun e Çairit, shpesh falemi e më shpesh iritohemi kur lidhemi pas hoxhallarëve, të cilët, ndonëse e njohin se çfarë

shejtani është Shaqir Fetai, e durojnë, pajtohen me të, dhe kënde, na i falin vaktet! Lojë me fenë, me islamin, me vlerat e njerëzimit të devotshëm!

Mësues që kanë vuajtur ga UDB dhe nga udhëbërës të vështirë se do të pranonin të “drejtohen” nga Shaqir Fetai. Më mirë ateist se me “fenë” e Shaqir Fetait!

## **Emigracioni shqiptar i bën të fala Shaqir Fetait: “Mbylle gojën”**

Shterruan ministrat, tani përfaqësuesit e Emigracionit (digaster shtetëror) kanë zënë radhën që të vijnë te Shaqir Fetai dhe ta lusin “aman, na ndihmo që ta kryejmë me sukses regjistrimin në diasporë”! Diaspora është e gjërë, nuk janë vetëm shqiptarët dhe myslimanët, ka edhe maqedonasë, serbë, romë, boshnjakë nga Maqedonia e Veriut! Çka do të bëjë me këta Shaqir Fetai?

Pse kaq shpresa tek BFI-ja dhe tek Shaqir Fetai! Pse këtë shtypje nuk e ka KOM-i dhe VMRO-ja! Shqiptarët, që të gjithë, unanimit, madje edhe pa ia futur fare Shaqir Fetait, kanë shprehur gatishmëri dhe dëshirë për t’u regjistruar! E vetmja që kundërshton është Kisha Ortodokse Maqedonase, VMRO si dhe disa subjekte minore nacionaliste maqedonase. Pandaj, shqiptarët nga diaspora i çojnë të fala Shaqir Fetait: “mbylle gojën e mos u përzi, sepe shumë shqiptarë refuzojnë të regjistrohen vetëm për shkakun tënd që mundohesh t’i dalësh zot punëve që nuk i përkasin ORAO-s!

Pse insistohet nga disa institucione shtetërore që për ndonjë regjistrim eventualisht të suksesshëm merita t’i përshkruhen edhe Shaqir Fetait! Shteti kaq shumë të interesohet për Shaqir Fetain?!

Çka ka bërë Shaqir Fetai për Diasporën tonë, për Emigracionin! Të vetmën gjë që ka mundur ta bëjë ka qenë mbushja me informacione e dosjeve të UDB-së për shqiptarët në Emigracion. Cili është kontributi i Shaqir Fetait, cila është ajo vepër pro-emigracionit tonë që këta ta dëgjojnë e ta respektojnë “urdhërin” e Shaqir Fetait. A e ngriti zërin ndonjëherë për Emigracionin Shqiptar! A ju ndihmoi me ndonjë ndikim në vendimet politike që i shkelin të drejtat e mërgimtarëve tanë, a kontribuoi me diçka që ta ndalë hemorogjinë e migrimin shqiptar në vendet Perëndimore! A e ka pyetur diasporën se pse kanë ikur nga vendlindja e tyre, cili ka qenë presioni politik e shtetëror që ata të ikin? Pse tani krejt shteti kërkon që diaspora shqiptare të regjistrohet! Cila diasporë? Vetëm ajo që është në Gjermani, në Zvicër, në Austri, Itali e në shtetet Skandinave? Po në Amerikë, po në Australi, po në Azi? Janë miliona shqiptarë që jetojnë në Turqi e që ëndërrojnë të kenë shtetësinë dhe pasaportën e shtetit të tyre prej nga migruan, Maqedonisë së Veriut!

Madje, shikojeni absurdin! Shaqir Fetai për t’u stolitur me “dekoracione” nga shteti për merita të veçanta, i futet edhe aventurave të rrenës! Ai tashmë e paska kryer urdhërin deri te diaspora jonë për t’u regjistruar e tëra. Paska ngelur që edhe të angazhohen ekipe të tëra nga BFI dhe të shkojnë dhe, edhe me prezencë fizike të ndikojnë që të kryhet sa më suksesshëm regjistrimi i tyre! Ku do të shkojë Shaqir Fetai? Në orë të gjeografisë dhe të lëvizës nëpër hartat e murit? Kush do ta lejojë Shaqir Fetain që me ekipin e tij t’i shëtis bythët në këtë kohë pandemie, kur nuk po munden të fluturojnë as vëmçat! Lojë psikologjike shumë e lexueshme kjo e Shaqir Fetait. Përpjekje për “faktorizim” të vetëvetes! Faktorizimi nuk bëhet duke shitur prapancën, por duke i qëndruar përballë padrejtësisë dhe duke e kushtuzar atë deri në drejtësi absolute. Për ta arritur këtë sukses duhet të keshë, jo shpirt shejtani por, topet katërqosheli!

**Cili hoxhë ka vjedhur drunj? Cili nëpunës i BFI-së ka djegur e shkatërruar pyje?**

Shaqir Fetai, duke qenë i mbështetur për murin e dorëzimit, duke parë veten se në çfarë gracke është futur, duke e kuptuar se është totalisht i shkretë e i mjerë, bën edhe disa përpjekje të cilat e lakuriqësojnë deri në analfabetizmin e tij të strukut vetëm në ata shpirtëra që janë të gatuar me brum djalli!

Shaqir Fetai paska nënshkruar memorandum bashkëpunimi me zv/drejtorin e “Pyjet kombëtare”! Përmes këtij memorandum (tërësisht të kotë e të pavlefshme) BFI-ja do të na siguruaka drunj për ngrohje për objektet e veta me një çmim të levërditshëm! Po cilat objekte të BFI-së na ngrohen me drunjë? Disa xhami nëpër vise malore ku drunjët donohen nga xhemati i cili e ka me bollëk drurin e vet për ngrohje?!

Memorandumi parashih që BFI-ja të angazhohet në pyllëzimin e pyjeve si dhe në ruajtjen e pyjeve nga dëmtimi dhe djegiet që po i bëhen nga “armiqtë”!

O hoxhallarë! A e shikoni se çfarë shejtan “reisi” që keni! Po kur ka bërë vaki që një hoxhë të vjedhë drunj, që një hoxhë të djeg pyellin? A nuk po ju duket ky memorandum si fletërrufe kundër teologëve të vendit! Pse këto zotime e detyrime t’i ketë vetëm BFI-ja! Tash e tutje, hoxhallarët do të merren me pyllëzim duke mbjellë fidane, do të shkojnë mal më mal, do të jenë në rolin e “shumarëve”, do të spiunojnë të gjithë ata hallexhinjë që presin drunjë, do t’i ruajnë pyjet, dhe do t’i luftojnë piratët “armiqtë e këtij shteti”! Ç’i duhet kjo aventurë kurvërie Shaqir Fetait!

Sipas këtij memorandum tërësisht ofendues dhe të poshtër, “Bashësia Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë së Veriut, obligohet kryesisht në drejtim të përmirësimit të menaxhimit të pyjeve, veçanërisht në sferën e mbrojtjes së pyjeve, nga ndikime të ndryshme, zjarri dhe vjedhja, si dhe duke marrë parasysh nevojat dhe mënyrat e furnizimit me dru zjarri për ngrohjen e ndërtesave dhe lokaleve të Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë së Veriut.”

Hoxhallarë, të gjithë në male, si “shumarë”, dhe ruajini pyjet, këtë profesion më të ri e keni të ligjësuar me nënshkrimin e “reisit” të juaj, Shaqir Fetait! A keni qenë ndonjëherë më të ofenduar e më të poshtëruar o hoxhallarë! Shpreheni mllefën, pezmin dhe hidhërimin e karavanit të deveve, o shërbyes të pullit (dhe jo të “pyejve kombëtare”) “Pyje Kombëtare”? Pse a paska edhe pyeje antikombëtare? Apo, ndoshta mendohet për “PYJET NACIONALE”!

Kombin e do Shaqir Fetai; i duhet diçka kombëtare, nga cilido komb qoftë, sepse, nga ajo shqiptare ka humbur gjithçka! Jo pyjet, por edhe hurin e gardhit kombëtar shqiptar e ka të humbur!

*(1Kliklarg, 12.03.2021)*



## **Fundi i lojës së pandershme**

**Anëtarësia, fitri, zeqati, haxhi, vakëfi dhe kontributet vullnetare, janë vetëm disa nga burimet financiare të cilat e mbajnë gjallë si dhe e avancojnë tutje jetën fetare islame. Nëse destabilizohen këto burime, atëherë edhe kontributi i teologëve në zhvillimin e jetës fetare islame duhet të jetë vullnetar. Këtu merr fund zhvillimi institucional i kësaj jete**

### **Shkruan Mr. Eset Shaqiri**

Kuluareve të Bashkësisë Fetare Islame po flitet se, si asnjëherë më parë ky Institucion financiarisht ka probleme të mëdha. Mungesa e aksioneve humanitare të cilat BFI-ja duhet t'i ndër marrë për ta zbutur situatën socio-ekonomike të shtresave të varfëra, flet se, këtij Institucioni populli nuk i përgjigjet as për më të voglin aksion humanitar. Shoqata humanitare e BFI-së nuk është në gjendje të apelojë për asnjë ndihmë, sepse, e ka humbur besimin e popullatës, mjaft ka dhënë populli për të varfër ndërsa të gjitha kontributet e popullit kanë përfunduar në xhepin e atij që ka 4-5 banesa, 2-3 dyqane, 3-4 makina luksoze! Një organizatë fetare, e cila humanitetin duhet ta ketë prioritet kryesor pas aktiviteteve ditore fetare, ndërkohë që duhet të presë ndonjë donacion nga jashtë, sepse popullata brenda nuk i beson, kjo flet se, Institucioni në fjalë ka ngelur pa kurrfarë besueshmërie popullore. Besueshmëria – zero!

### **Rrëshqitja e BFI-së në prehër të huaj**

Ky fakt, zbërthen edhe shumë probleme të tjera që kanë të bëjnë kryesisht me financat dhe buxhetin e Institucionit! A mund të mbahet Institucioni me donacione nga jashtë, ndërkohë që populli nuk të përgjigjet, nuk të beson? Donatorët shumë shpejt do ta kapin këtë të vërtetë dhe, sakaq do të ndërpresin të donojnë për projektet e parapara të Institucionit! Mund të të donojnë vetëm për zbatimin e projekteve të parapara nga donatori, pavarësisht nëse do të jetë interes fetar e kombëtar ai donacion! Institucioni i BFI-së mund të na rrëshqasë në prehër të huaj, të atyreve që nuk u intereson asnjë status politik, kombëtar e humanitar të atyreve ku “i derdhë” donacionet! Kurse donatorët e sinqertë, profesionistë dhe ata që ndihmën e kanë në zemër, kërkojnë raporte të detajuara financiare, sepse, ata mbajnë llogari për çdo cent të vetin që e donojnë.

BFI-ja si Institucion fetar islam, tashmë ka humbur besueshmëri në një numër të madh të besimtarëve të vendit. Aktivitetet dhe kuadri janë shtuar tej normales, kurse besueshmëria ka zbritur nën mesataren! Të gjitha raportet, flasin se, për çdo vit ka pasur rënie nga 15-20 për qind të kontributeve financiare: më pak fitra, më pak zeqat, më pak kontribute vullnetare, më pak kurbana, më pak haxhilerë që pranojnë të marrin këtë udhëtim të shenjtë me BFI-në dhe, për rrjedhojë, vrima të thella financiare të shkaktuara në buxhetin e BFI-së!

**Vakëfi po shitet! Shkelësit e amanetit quhen tradhëtarë!**

Cili burim mund të jetë më i sigurtë, i përhershëm, garantues? Vetëm vakëfi! Nuk është ide e marrë kjo e të parëve tanë të cilët hodhën themelet e vakëfit! Vakëfi është amaneti i të parëve tanë, të cilët, pronat e tyre ua linin xhamive, si institucione fetare, derisa u zhvillua idja e centralizimit të menaxhimit të jetës fetare islame në tërë vendin. Po ndodhë që në dy periudha është ushtruar dhunë e paparë mbi vakëfin e institucioneve fetare: në periudhën komuniste kur u nacionalizua, u uzurpa çdo pronë që ishte vakëf, madje edhe xhami duke i shndëruar në magaze e fabrika, si dhe në periudhën postkomuniste, sidomos pas miratimit të ligjit për denacionalizim të pronave të bashkësive fetare!

Denacionalizimi i pronave të vakëfit prodhoi dy padrejtësi fatale! Ato që ngelën si “interes shtetëror e shoqëror” u decentralizuan vetëm si bono në vlerë, proces ky që po e shkatërron tërë Institucionin e Vakëfit, planifikim perfid për ta rrezikuar perspektivën e Islamit nëpër këta troje!

1) Komisionet gjegjëse shtetërore ia vënë çmimin e pronës që nuk mund të denacionalizohet! Çmimet janë qesharake, janë grabitqare, janë ofenduese! Ky çmim tallës, pastaj, parcializohet në përqindje që duhen të përfundojnë nëpër xhepa të ndryshëm, që nga sekseri e deri te “ministri” dhe, 2) zhbërja e vakëfit duke i shpenzuar bonot në vlerë për rroga të administratës! As kushtetuta e BFI-së, asnjë rregullore tjetër, asnjë akt tjetër juridik, nuk lejon tjetërsimin apo shitjen e vakëfit por, vakëfi mund të këmbehet vetëm me vakëf. Vakëfi duhet të prodhojë, ta shtojë vakëfin! Vakëfi është “fabrikë gjigante” që e mbanë komunitetin e teologëve dhe që e zhvillon jetën fetare institucionale.

Me paratë nga vakëfi duhet të blihet vakëf. Për çdo vit, nga paratë e vakëfit (qeraja, shitja, mosdenacionalizimi) duhet të blihet pronë e re dhe të shtohet vekëfi dhe, jo që ato para të shpenzohen për rroga, për honorare, për vjedhje e fryrje të xhepave personal.

Shaqir Fetaj, ky shkelës i Kushtetutës së BFI-së, i ardhur nga struktura të dyshimta në krye të BFI-së, thotë se “kur e mora BFI-në kasën e gjeta vetëm për një rrogë”! Pastaj, thotë “e stabilizova situatën financiare të BFI-së”, kurse sot thotë se “falë pushtetit aktual jemi shumë mirë por shpresojmë se do të bëhemi edhe më mirë financiarisht”! Raportet bankare që po publikohen flasin se në kasën e BFI-së janë derdhur, ose duhet të derdhen 257.418.782,00 den. që të gjitha bono në vlerë! Pjesa dërmuese e këtyre parave janë nga vakëfi i denacionalizuar në formë bonosh i Myftinisë së Shkupit, pastaj Resnjës, Manastirit etj

## **BFI-ja – edhe e militantëve partiakë**

Në BFI ekziston një rregullore se sa për qind i ngelë myftinive e sa shkojnë në kasën qendrore nga të hyrat e ndryshme financiare. Myftinia e Shkupit është më së shumti e dëmtuar në aspekt të vakëfit! Myftinisë së Shkupit i takon pjesa më e madhe nga kjo shumë e “denacionaizimit” të vakëfit dhe, kjo Myftini me ato të hyra duhet ta shtojë vakëfin. Hoxhallarët e Myftinisë së Shkupit janë në situatë më të të palakmueshme, bëjnë jetë “në të zezë”, pa siguracione, pa sigurime pensionale invalidore dhe, kjo situatë mund të përmirësohet vetëm me bledhjen e anëtarësimit nga xhemati i territorit të kësaj Myftinie! Jo që po avancon në këtë drejtim por, krahas humbjes së besueshmërisë, për pasojë edhe të fitrit, zeqatit dhe kontributeve vullnetare, ka nisur të humb edhe vakëf. Pa dyshim, një ditë, nuk do të ngelë asnjë i përfshier në tjetërsim dhe shitje të vakëfit pa dhënë llogari, nuk do të ngelë asnjë i përfshirë në zhdukje të vakëfit pa u përballur me drejtësinë e vendit. Ata që do t’i shpenzojnë vakëfet për rroga e për honorare personale, për ta blerë heshtjen e teologëve dhe mosreagimin e tyre kundër shkatërrimit të Institucionit të Vakëfit, do të ndëshkohen, do të detyrohen t’i kthejnë një për një të gjithë ato vakëfe që dikush i gjakut e i fesë na i la amanet. Ata që do ta heshtin këtë krim, do të jenë po aq bashkëfajtorë sa kriminelët!

Tani, pas shkatërrimit të BFI-së duke e stimuluar, duke e ndihmuar dhe përkrahur shkeljen masovike

të Kushtetutës së BFI-së, partitë në pushtet do të kenë obligime ndaj militantëve të vetë që do të angazhohen financiarisht nëpër fushata. Këta do të jenë “bisnesmenë” e “afariistë” të ndryshëm, me kapacitete për të organizuar kryerjen e haxhit në linjë private (BFI-ja nuk do të guxojë t’i bllokojë apo t’i pengojë, sepse do të përgjigjet “penalisht” para partisë nënë!), do të organizojnë “ferma” e “therrtore” për kurbanë, për të përfituar për vete dhe jo për BFI-në!

Zatën, BFI-ja po përgatitet të shndërrohet në militantë partishë, në filiale organizative e financiare të partive, ndryshe, dhe, ky aktivitet meskin do të sjellë deri në heqjen dorë nga BFI-ja, nga organizimi i jetës fetare institucionale, deri në falimentimin e këtij Institucioni. Fitues do të dalin vetëm ata që ia kanë mësyer shkatërrimit të BFI-së me në krye Shaqir Fetain, për fatin e keq të tij! Çfarë fundi i trishtë ky, sidomos për një teolog, sidomos për një “epror” të fesë!

*(Tetovaexpress, 14.03.2021)*

## Shitet vakëfi i Shkupit për t'u paguar ekipi gostivaras i Shaqir Fetait

Shaqir Fetai është shumë i vetëdëshëm se, në formën siç erdhi në pushtet, në të njëjtën formë edhe do të dëbohet nga pushteti. Prandaj ka filluar që të kërcënohet e të shantazhojë përmes “myhybve” të vetë injorantë. Strategjia e tij është që t'i largojë të gjithë ata që e ndihmuan ta falcifikojë pozitën e vet përjetë të pamerituar. Shaqir Fetai nuk e ndërroi pozitën e të qenurit “ORAO” për reis. Hala nuk i ka ardhur koha për të “fluturuar”, si Qenan Ismaili në vallet kapur për krahësh me të pamoralshëm

### Shkruan Samedin Musliu

Në një pyetje të gazetarit gjatë një interviste me ish-reisul-ulemanë, Sulejman ef. Rexhepi, të botuar ditë më parë në disa portale, pyetje kjo që kishte të bëjë me gabimet e ish-reisit si pasojë e mosvëmendjes apo si pasojë e gabimeve të qëllimshme, Sulejman ef. Rexhepi përgjigjet: “Gabime bëjmë që të gjithë, dikujt i kushtojnë me karrierë e dikujt me jetë, dikujt me fytyrë e dikujt me ngritje në detyrë! Dua të them që, edhe unë kam gabuar porse, betohem në gjithçka që gabimet e mia dalin të jenë vetëm si pasojë e mosvëmendjes sime, sepse, kam pasur besim të paluhatshtëm në bashkëpunëtorët e mi. Për shembull, gabim trashanik dhe shkelje kushtetutare e imja është emërimi i Qenan Ismailit për Myfti të Shkupit. Kam qenë i parespektuar, qëllimisht më kanë vënë në lojë, me tendenca për ta vjedhur njërin nga organet më të rëndësishme të BFI-së! Betohem në Zot që nuk e kam ditur që Qenan Ismaili nuk ka asnjë ditë përvojë punë në BFI, ndonëse për t'u bërë Myfti kusht është që të ketë së paku pesë vite përvojë pune në BFI. Zotëria e fshehtë këtë fakt, e shkelë normën kushtetutare dhe, si mjeshtëri i hajnisë, e vjedh titullin “myfti”! Në këtë ndytësirë unë jam treguar i pavëmendshëm dhe, natyrisht që e konsideroj gabim flagrant, jo sjelljen e Qenan Ismailit, por administratën e BFI që nuk më ka njohtuar.”

### Qenan Ismaili – vjedhësi i postit të “myftiut”

Prandaj, sot, Qenan Ismaili, parapëlqen të jetë drejtor shkolle, të jetë drejtor televizori, të jetë gazetarë, parapëlqen të jetë spiker, të jetë punëtor humanitar, të jetë mjek, virusolog, të jetë gjithçka ku ai mund të ndjehet rehat! Pra, atij i intereson rehatllëku i vet, të cilin është në gjendje ta arrijë edhe përmes kriminit! Vepër penale është genjeshtra, avansimi me gënjeshtëri, vjedhja, dhe prezantimi i rrejshëm. Këto ditë Qenan Ismaili, në një xhami të qytetit ishte përgjigjur në pyetjet e gazetarit lidhur me koronavirusin Kovid 19, me masat e myftinisë rreth ruajtjes së shëndetit të qytetarëve.

Qenan Ismailit me javë të tëra i shtrohen disa pyetje që kanë të bëjnë me zhvillimin e jetës fetare në territorin e Myftinisë, por ai i ik, sepse, nuk ndjehet rehat aty! Me dhejtra pyetje i shtrohen se çka u bë me dhjetra vakëfet? Çka u bë me objektin e ish-myftinisë së Shkupit, çka u bë me objektin “Ibni Pajko”, çka po bëhet me kompleksin e godinave të ish-Komunaleci, pse kaq lirë dhe pse s'po reagohej me keqpërdorimin e parave të vakëfit të denacionalizuar në formë të letrave me vlerë?

I bëhet pyetje Qenan Ismailit se pse e shkelë Kushtetutën, pse flet hoxhallëk e thirret në “tituj shkencor” kur të gjitha i ka të blerë me para! A dëshiron që t'i publikohen edhe këto fakte?

A mund t'i shkojë lutja në vend “hoxhës” apo “myftiut” i cili hedh valle dhe përdridhet bashkë me të pamoralshmit.

Është pyetur edhe për realizimin e premtimeve kur e vodhi postin “myfti”, çka u bë me kartelat e premtuara, me lëshimin e rrogave për çdo imamë në bankë, çka u bë me rritjen e rrogave të tyre, me siguracionet e tyre, me kontributet pensionalo-invalidor? Nuk ka përgjigje Qenan Ismaili në të tilla pyetje, sepse, ia ka zënë bishtin dera e po kuis si foshnja kur dënesë.

## **Planet e Shaqir Fetait për ta minimizuar peshën dhe rolin e Myftinisë së Shkupit**

Ja pse nuk e deshti Sulejman Rexhepin i cili pavëmendshëm e bëri “myfti”; ja pse e tradhëtoi “bekuesin” e vet dhe u rreshtua pas njeriut me të gjitha të këqiat e mundshme, por i cili nuk ka kurrfarë kontributi në “karrierën” e Qenan Ismailit.

Madje, nuk i bëri as konkurrencë në “reisllëk” duke bërë që për herë të parë në historinë e BFI-së ta lë Myftininë e Shkupit pa kurrfarë rëndësie, pa kurrfarë roli dhe pa kurrfarë peshe! Të ishte dikush tjetër myfti, thuase do të kishte shansë Shaqir Fetai të bëhej “reis”?! Do të rrotullohej krejt globi, do t’i ndërronin vendet tokë e qiell dhe, reisllëku do t’i ngelej Shkupit, por, me Qenan Ismailin “myfti” Shkupi gjason si një geto e mbytur në pisllekun e një rrugice të një mëhale të një metropoli mesjetar! Myftinia e Shkupit është myftini me më pak vakëf të denacionalizuar, ose, me më pak realizime të mjeteve materiale të lëshuara nga qeveria si shumë për vakëfin që nuk mund të denacionalizohet si pasojë e interesit të përgjithshëm shoqëror.

Pse tani i lejohet Shaqir Fetait që t’i rrëmbejë ato para dhe t’ua ngrisë rrogën punëtorëve e t’ua sigurojë rrogat duke e lavdëruar pushtetin si shpëtimtarë dhe jo Myftininë e Shkupit!

Qenan Ismaili dëshiron të shpëtojë nga revidimi dhe abrogimi i vendimeve të marrura në kohën e Sulejman Rexhepit. Qenan Ismaili është më se i bindur se Shaqir Fetai, shumë shpejt do t’i hyjë edhe mohimit të shumë vendimeve të ish-reisit, sepse, Shaqir Fetait i duhet që të shpëtojë nga akuzat se është shkelësi më i madh i akteve normative në historikun e BFI-së. Qenan Ismaili i druhet këtij “rrebelimi” të Shaqir Fetait dhe të dalë sheshit se ai është bërë “myfti” në kundërshtim me të gjitha aktet normative të BFI-së, prandaj edhe ia fërkon shpinën duke menduar se Shaqir Fetai nuk do ta marrë këtë si vardisje dhe lëpirje, si një skile e vjetër.

Nuk e ka dert Qenan Ismaili nëse e largojnë apo jo nga “myftillëku”, për të me rëndësi është që të arrijë të zhatë ndonjë shumë parashë derisa është në këtë post. Pse, ku nuk zhvati ky? Çka bëri te “Kalliri i Mirësisë”? Po te FRI-ja?! Cilës shtëpi botuese me renome i vodhi para! Sa ishin: 40 mij apo 80 mij euro! Të publikohen këto fakte?! Shumë rëndë për myslimanin e devotshëm, por fare të lehta për atë që është mësuar të vjedhë nga një denarë e deri në postin e “myftiut”!

Shaqir Fetai përmes disa “myhybëve” të vetë injorantë, luten që të lihet i qetë se, shumë shpejt do të marrë masa kundër të gjithë atyreve që kanë vjedhur nga paratë që i ka siguruar Ismet Ademi, kundër të gjithë atyreve që janë pozicionuar në BFI si pasojë e shkeljeve kushtetutare dhe preferencave të Sulejman Rexhepit. Preferencë e Mulla Sulës ka qenë edhe Qenan Ismaili, i cili ka afinitete që simpatinë e reisëve ta blejë me premtime se kurrë nuk do ta flasë asnjë fjalë për sa i përket Vakëfit të Myftinisë së Shkupit, i cili shitet pa dhimbje vetëm e vetëm që Shaqir Fetai të sigurojë rroga dhe meritat t’ia lë pushtetit që po e ndihmon “nga pak BFI-në”!

Shaqir Fetai është më se i bindur që qeveria-pushteti aktual është më e rëndësishme se çdo organ i BFI-së. Ai një qime të Zaevit nuk e jep për tërë Myftininë e Shkupit. Kujdes, përgjegjësi do të japin të gjithë, duke filluar nga Shaqir Fetai, Qenan Ismaili, Rijaseti dhe të gjithë anëtarët e Myftinisë së Shkupit!

*(Lajme7, 16.03.2021)*

## Si po tretet vakëfi i Myftinisë së Shkupit

**Me Vakëfin e Shkupit, paguhen bashkëpunëtorët e Shaqir Fetait! Kështu lexova një tekst të publikuar në disa portale kombëtare. Intriguese! Të detyron ta lexoshë dhe ta pështyshë në surrat Shaqir Fetain, pisin. Ndërsa të ashtuquajturin, myfti të Shkupit, Qenan Ismailin, ta zhveshish lakuriq dhe ta kamxhikosësh të lidhur në kryq**

**Nga Izet Rama**

Kur të lë mendja, thonë, më mirë vetëlidhu me zinxhir se sa të të lidhin! Teologu që shet vakëfin (Shaqir Fetai)! Teologu që blenë rehatinë e pistë me lejimin e shitjes së vakëfit (Qenan Ismaili)! A ka më çmenduri se kjo? A ka më mëkat se kjo? Po, ka! Mëkati është edhe më i madh nëse nuk distancohemi prej këtij soji teologësh, nëse nuk i dëbojmë nga mesi ynë, nëse ua shprehim edhe më të ultin respekt, atë të servilizmit, nëse nuk ua mohojmë shoqërimin me ne, nëse nuk i përsëndesim, jo me përsëndetjen islame por, me “zdravo zhivo”! Ky soj pisash e meriton vetëm këtë përsëndetje, edhe atë, sa për t’ua dëshmuar islamit si fe të pastër e të paqtë!

Po si është e mundur që, Qenan Ismaili, i ashtuquajturi “myfti” i Shkupit të lejojë një pazarë të tillë matrapazësh! Po si ka guxuar që me gënjeshtër e me truqe intrigantësh të vie deri në postin e Myftiut, për të cilin post duhet të ketë më së paku pesë vjet përvojë punë në BFI! Po si e gënjeu ish-reisin, armikun e vet të përbetuar, po si u lidh me shërbimet nëntokësore dhe ia vodhi, bukvalisht ia vodhi postin “myfti”! Pastaj, për të humbur gjurmët e vjedhes së postit, nuk la lavdëratë, nuk la lajka, nuk la lëpirje pa ia bërë ish-reisit!

E gjeti një Myftini më të madhe, më të konsoliduar dhe, megjithatë, me një unitet të konsiderueshëm. Një Myftini e cila kishte shpenzuar goxha shumë në hartëzimin e Vakëfit të vet, qysh në kohën e myftinjëve të parë, rahmetlive Hafëz Idris Selamit dhe hafëz Rexhep Nuredinit! Për këtë punë ishte dhënë një kontribut i paçmueshëm si në kapacitete njerëzore ashtu edhe në financa. Pastaj myftinjtë e ardhshëm, që të gjithë, deri te i fundit, prof. Rexhep Jusufi, që të gjithë dhanë kontributin e tyre në kompletimin e dokumenteve të nevojshme, u organizan e u mbajtën sa e sa mbledhjes e takimesh, u derdhën qindra e mijëra euro, vetëm e vetëm që të bëhet denacionalizimi i pronës së Vakëfit të Myftinisë së Shkupit. Të gjitha dokumentat dhe kërkesat u shtruan në digasteret përkatëse qeveritare. Ikën këta dhe, me intriga e me ndihmë të nëntokës së pushtetit maqedonas, erdhën në poste të larta, si Qenan Ismaili ashtu edhe Shaqir Fetai. Jo me ndonjë meritë të veçantë, jo me ndonjë kontribut të veçantë e të njohur për myslimanët e vendit por, thjesht, duke i vjedhur postet me ndihmën e nëntokës së pushtetit maqedonas. Dhe tani, ju ka mbetur që ta grabisin edhe këtë fond të “pronës së denacionalizuar” të Myftinisë së Shkupit!

Të gjitha myftinitë e tjetra, më të mëdha, falë pushtetit lokal të drejtuar nga shqiptarë dhe nga myslimanë të mirë që kanë dhënë kontributin maksimal, kanë arritur që me kohë ta kryejnë denacionalizimin e pronës së BFI-së. Tetova, Gostivari, Dibra, Ohri, pothuajse kanë përfunduar me këtë proces. Ka ngelur më së keqi Myftinia e Shkupit! Megjithatë, edhe për pronën e këtij Vakëfi ka lëvizur diçka kah e mbara falë drejtuesve të mëhershëm të Myftinisë së Shkupit. Janë alokuar apo, janë në proces të alokimit, bonot në vlerë për ato prona që tashmë janë interes i përgjithshëm publik!

Natyrisht që këto bona në vlerë, duhet që, që të gjitha të shpenzohen në blerje të vakëfit, në shtim të pronës së Myftinisë së Shkupit, në zbutje afatgjate të problemeve financiare që i kanë të përhershme imamët e kësaj Myftinie.

Por jo, Qenan Ismaili ka vendosur që ta luajë rolin e lolos! Ai nuk dëgjohej askund. Atij nuk i dëgjohej askund fjala. Na dehu duke na shitur kopalla me do pseudovaze, me do ligjerata fetare sa për ta fshehur bashkëpunimin në zhvatjen e të gjitha bonove në bashkëpunim me Shaqir Fetain.

Sepse, Shaqir Fetai mund ta ndërrojë, madje edhe ta lodhi me procese gjyqësore, për vjedhjen e postit, por edhe t'i largojë të gjithë ata gjytyrë që e kanë ndihmuar në këtë vjedhje. Që mos ta nervozojë Shaqir gjarpërin, Qenan Ismaili ka zgjedhur rolin e “të butit”, të “lepurit”, të leckës që t'i fshijë këpucët aty kushdo që mundet! Me këtë gjest hajdutërie Qenan Ismaili po e blenë “pafajësinë” e vet dhe qëndrimin sa më gjatë në krye të kësaj “minië personale” të tij, po e blenë “rehatllëkun” si dhe “myftillëkun” e pamerituar. Atij nuk i interesojnë as bonot e as vakëfi. Atij i intereson posti, sepse, të bie nga “myftiu” në muteveli, për te do të ishte e papërballueshme shpirtërisht dhe mendërisht. Meqë myftinitë e tjerë e kanë kryer denacionalizimin, atëherë rrogat për të gjithë nëpunësit e BFI-së do të sigurohen me vakëfin e shitur të Myftinisë së Shkupit! Prandaj, që të gjithë duhet ta durojmë Qenan Ismailin, ta përgëdhelim dhe t'ia puthim këmbët! Ky është mesazhi që ua dërgon imamlerëve të Shkupit dhe më gjërë, Qenan Ismaili.

Si Qenan Ismaili ashtu edhe Shaqir Fetai duhet të dijnë se, një ditë, do të përgjigjen jo vetëm para Allahut xh.sh. por edhe moralisht e penalisht për çdo cent të vakëfit që do të shitet e shpenzohet për rroga të dylberave të Shaqir Fetait si kryedylber. Nuk do të harrohet aq lehtë prona “Ibni Pajko” si dhe dhjetra hektarë të malit në Gazibabë! Vakëfi është lënë amanet vetëm për ta zhvilluar jetën fetare islame dhe jo për t'i enjtur xhepat haram si të Qenan Ismailit ashtu edhe të bashkëpunëtorëve të tij dhe të kryeshefave të tij banditë.

*(Lajme7, 17.03.2021)*

## Një informatë me gjuhë shkrimi që i nënçmon shqiptarët

**Në “portalin” dhe në FB-un e Bashkësisë Fetare Islame të Shaqir Fetait, është publikuar një informatë, e cila, mbi të gjitha, dëshmon për angazhimin e këtij Institucioni, veç të tjerash, edhe në bastardimin e gjuhës shqipe. Agjencia për Zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhës Shqipe duhet të veprojë menjëherë. Të ndëshkohen “shqipfolësit” me qëllim që asnjëherë të mos u shkojë në mend të tallen më me këtë gjuhë të bekuar**

**Shkruan Jasir Jashari**

Më 16 janar të vitit 2018 ish-reisul ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, pat pritur një delegacion që udhëhiqej nga ish-kryetari i Parlamentit të Emirateve të Bashkuara Arabe dhe njëherit Kryetar i Këshillit Global për Paqe dhe Tolerancë, z. Ahmed Bin Mohammad Al-Jarvan. Mysafirët arabë patën rastin të informohen në hollësi nga efendi Rexhepi mbi organizimin e jetës fetare në RM si dhe mbi funksionimin e organeve dhe të institucioneve të BFI-së, por edhe mbi problemet e ndruarnduarshme me të cilat ballafaqohet popullata myslimane por edhe mbarë shoqëria jonë.

Në fund, të dy palët u patën dakorduar që të nënshkruajnë një memorandum bashkëpunimi në mes të BFI në RM dhe Këshillit Global për Paqe dhe Tolerancë.

Memorandumi u nënshkrua por kurrë nuk u publikua. A thua pse?

Fiks dhjetë muaj më vonë, pra, më 16 nëntor, me ftesë të deputetit Taulant Balla, njëherit edhe President i Parlamentit Ndërkombëtar për Tolerancë dhe Paqe, në Seancën e dytë Parlamentare do të marrë pjesë edhe H. Sulejman ef. Rexhepi, me ç’rast do të takohet edhe një herë me këtë personalitet arab! Në këtë Seancë morën pjesë kryetarë parlamentesh, deputetë, ministra si dhe personalitete të shquar nga mbi 60 shtete nga mbarë bota. Të pranishmëve do t’i drejtoheshin edhe Presidenti i Shtetit, Ilir Meta, Kryeparlamentari Shqiptar, Gramoz Ruçi, zëvendëskryeministria e Shqipërisë, Senida Mesi, Kryetari i Parlamentit të Maltës, Anglu Farrugia, si dhe Presidenti i këtij Parlamenti Ndërkombëtar për Tolerancë dhe Paqe, Taulant Balla!

Tre vite e dy muaj e një ditë më vonë, më 17 mars të vitit 2021, në të njëjtën hapësirë, të njëjtin personalitet arab, shumë të nderuar, e pret edhe Shaqir Fetai, në cilësinë e postit të vjedhur “reisul ulema i BFI-së”!

Që në titull, që në prezantim të parë, ia huqin edhe emrin edhe postin! E bëjnë njeriun “kryetar të paqes dhe të tolerancës”, sikur paqa dhe toleranca të jenë institucion, të jenë ndonjë organ shtetëror apo civil, sikur të jenë shtete apo krahina. Pra, “reisi” paska pritur z. Ahmed Bin Mohammad Al-JarvanM, “KRYETARIN E KËSHILLIT GLOBAL PËR TOLENCËN DHE PAQEN”! Dhe kësaj fraze i gëzohet deri në delir, Shaqir Fetai, ky farë “uruesi i mësimi dhe diturisë”!

Dhe, shihe ti shihe, që në fillim Shaqir Fetai e paska njoftuar me “biografinë e BFI- së”! Këtu po i japim vetes të drejtën dhe po flasim në emër të të gjithë myslimanëve të vendit: nëse Shaqir Fetai e di vetëm një detal nga “biografia” e BFI-së, kolektivisht, ne, myslimanët, do të bëjmë vetëvrasje!



Shaqir Fetai më tej paska folur për tolerancën e myslimanëve të RMV-së! Vazhdon edhe më tej të gënjejë, në të mirë të sistemeve dhe organeve që kanë ushtruar dhunë, shovenizëm si dhe diskriminim permanent fetar e kombëtar mbi këta myslimanë, të cilët, deri më vitin 2001 ishin të pamundur t'i japin fund këtyre nënshtrimeve, keqtrajttimeve, diskriminimeve të egra, të cilëve Shaqir Fetai u thotë “tolerancë myslimane”! Toleranca do të thotë pajtim me të gjitha diskriminimet, në të mirë të “paqes” që ta dikton pushteti autoritar apo diktatorial!

Në informatën paçavër shkruan se, Shaqir Fetai, mysafirin arab e paska pritur me nderime të larta! A e di ky farë “reisi” se çka do të thotë pritje “me nderime të larta”! Deri më sot, me nderime të larta ka pritur vetëm Ministrin e punëve të brendshme, Oliver Spasovskin! Megjithatë, çka parasheh protokoli i BFI-së në raste të pritjeve “me nderime të larta”?! Asgjë, sepse, nuk ekziston një protokol i tillë, nuk ekziston një mundësi e tillë në BFI, ekziston vetëm në të folurit plotë gënjeshtre e sajesa të Shaqir Fetait!

A ka fjali më të poshtër, më të paskatë dhe më hutuese se sa kjo që haset në informatë: “Themelimi i Këshillit u bë në fillim të dekadës së dytë të shekullit njëzet e një, ku aderohet 85 shtete”, thuase bëhet fjalë këtu për OKB apo për Organizatën e Shteteve të Painkuadruar, apo për ndonjë organizatë të shteteve të botës!

Ose, ata që shkruajnë paçavura të këtilla, apo që ia fusin “google translate”, të kenë kujdes se çfarë publikojnë, sepse, edhe pse Shaqir Fetai nuk di të lexojë, si rrjedhojë, as të reagojë, të tjerët ka që e ndjekin faqen e BFI-së e që iritohen jashtë mase! Cili shqipfolës, apo cili armik i BFI-së, i myslimanëve dhe i shqiptarëve të këtij vendi e ka shkruar këtë fjali që gjendet në “informacionin” e publikuar në portalin e BFI-së: “me të cilën bashkësia ndërkombëtare dëshmoi një përhapje të gjerë të konflikteve të brendshme...”

Kërkojmë një shqiptarë, me përjashtim të Shaqir Fetait, i cili do ta kuptojë këtë fjali në informatën e BFI-së: “dhe rritjen e fenomenit të terrorizmit dhe dhunës, që goditi shumë vende, të cilat negativisht ndikoi në stabilitetin e paqes në punë.”

Hej, alo! O Shaqir Fetai, mos lejo bashkëpunorë të tu analfabetë që të na e përçmojnë intelgjencien! A e shikon që po ta ngulin bashkëpunorët e tu, duke komunikuar më lehtë me “google translate” e duke të të ofruar fjali të këtyllë: “së bashku me kryengritjen e vlerave të mira njerëzore dhe mbështetjen e pikave të takimit midis vendeve, të gjitha ato në përputhje me orientimin bashkëkohor të OKB...”! **KRYENGRITJEN E VLERAVE TË MIRA NJERËZORE!!!** Këtë mund ta gjeni, shqiptarë të nderuar, vetëm në faqen zyrtare të BFI-së të cilën e ka uzurpuar Shaqir Fetai, veç të tjerash, edhe për të na e nënçmuar angazhimin tonë akademik kombëtar për ta ruajtur e për ta bartur brez pas brezi gjuhën tonë të pastër e të dëlirë.

I ftojme të gjithë gjuhëtarët, filozofët dhe shkencëtarët e logjikës të na e sqarojnë fjalinë e “ekspertëve” të BFI-së me në krye ORAO-n: “Ai gjithashtu ndërton politikën e fuqisë së butë...”!!!

Ma deshifroni pak, ju lutem, edhe këtë fjali: “me qëllim adresimin e çështjeve të paqes bashkëkohore në botë.”!!!

Hë, ju lutem, ndjesë, edhe këtë fjali: “ne duhet pa dyshim të bëjmë përpjekje më jo- qeveritare, plotësuese të përpjekjeve të qeverive tona”!!!

Në këtë pasus, ku gjendet fjali e mësipërme, komplet e bastarduar dhe e pakuptimtë” kuptojmë se kjo organizatë ndërkombëtare në fakt qenka Organizatë joqeveritare! Nënper evente të organizatave joqeveritare mund të marrin pjesë përfaqësues të organizatave simotra nga 70-80 shtete, pra, jo se aty aderohet 70-80 shtete!

Nuk ka shqipfolës në botë që do ta lejonte një fjali si kjo në kuadër të një informacioni sado të dobët: “Rritja dhe zhvillimi në normat e Ligjit Ndërkombëtar...”!!!

Cili shqipfolës e ka shkruar apo e ka përkthyer këtë fjali: “Këshilli Global për Tolerancën dhe Paqen

respekton disa parime. Ato kryesore janë:”!!!

Meqë ky bastardim gjuhësor edhe më tej haset në këtë informatë, kjo do me thënë se, ose nuk e ka lexuar askush, ose e kanë lexuar por nuk e rruajnë fare, ose, e bëjnë me kërkesa të Shaqir Fetait, sepse atij i konvenon kjo “shqipe” e shtrembëruar, alogjike dhe shumë e shëmtuar!

Kurse fundi i këtij informacioni paçavurë, shërben për ta “lezetosur” gjënë, tamam si qershia mbi tortë: “Ai është i diplomuar në inxhinierinë aeronautike, një diplomë në Aeronautikës (Francë 1982), një diplomë të Inxhinierisë së Lartë nga Instituti i Forcave Ajrore (Egjipt 1987), si dhe një diplomë të protokollit ushtarak (Shtetet e Bashkuara të Amerikës 1995).

Ai gjithashtu kaloi shumë seanca diplomatike, ushtarake dhe ndërkombëtare.”

Ky tekst, në masë prej më se 80 për qind duhet të jetë lëndë shqyrtimi nga Agjencia për Zbatim të Ligjit për Përdorimin e Gjuhës Shqipe dhe, pa dyshim, pastaj, kjo Agjenci të ndërmarrë masa konform Ligjit dhe të mos lejojë për asnjë moment tallje të tillë me gjuhën shqipe. Shqipfolësve, të cilët, deri në këtë nivel e degradojnë gjuhën shqipe, duhet t’u ndalohet edhe të flasin shqip!

Po këta çka lanë pa bërë të zezë e të keqe, që mos ta bëjnë edhe këtë shëmti – bastardimin e gjuhës së ëmbël shqipe!

*(Tetovasot, 17.03.2021)*

## **BFI e Shaqir Fetait e ha turpin me bukë**

Dje, në portalin e BFI-së së Shaqir Fetait si dhe në FB-un e këtij “institucioni”, u publikua një “informacion” në kundërshtim me të gjitha rregullat e gjuhës shqipe. Kanë reaguar menjëherë “ekspertët e fjalës së shkruar” të kësaj BFI-je të mjerë dhe, ndonëse me sërë gabime gramatikore, sintaksore e morfologjike, mund të thuhet se janë përpjekur ta hanë turpin me bukë, e kanë “redaktuar” tekstin paraprak duke vënë një tekst paksa më logjik.

Këtë reagim të këtyre “ekspertëve” e ka shkaktuar një shkrim analitik me shumë kritika të pakursyera nga autori Jasir Jashari, i cili, në shkrimin me titull “Një informatë me gjuhë shkrimi që i nënçmon shqiptarët”, ka ftuar që, konform Ligjit përkatës, të reagojë edhe Agjencia për Zbatimin e Gjuhës Shqipe.

Këta “ekspertë gjuhësorë” të BFI-së së Shaqir Fetait kanë intervenuar vetëm në tekstin e publikuar në FB-un e këtij “institucioni”, nisur nga fakti se FB-un e konceptojnë si vegël parësor propagandistik dhe jo informativ!

Pra, portali i “institucionit” që ngelë një arkiv elektronik, i dixhitalizuar, mbeti edhe më tej i njollosur me një tekst që shpreh nënçmim të paparë kundër gjuhës shqipe, fatkeqësisht, nga shqipfolësit e instaluar në Institucionin e BFI-së.

*(1Kliklart, 18.03.2021)*

## Apelet e Shaqir Fetait që ia kërkon pushteti

**Lehtë e ka Shaqir Fetai, madje dëshirë të flaktë, të dalë në TV e të çaraveshet “xhemati ynë ëshë i maaadh...”! Le të kërkojë nga shteti që t’ju krijohen kushtet për faljen e pesë vakteve të namazit në xhemat dhe jo të kryejë apele sa për t’u dëshmuar se vazhdon të jetë në shërbim të “politikave zyrtar”: të pushtetit maqedonas! Shaqir Fetai duhet të dëshmojë se është i xhematit, se e mbronë interesin e xhematit duke qenë në shërbim të xhematit e jo të hyqmit**

Aty ku ka prekur Shaqir Fetai, e ka shkretuar, e ka bërë “pusto”! Kështu ka qenë gjithmonë, në daç si Shaqir në daç si ORAO, e ka bërë pis punën. Për të, rëndësi ka pasur vetëm fakti që është në shërbim të pushtetit, në sinkron me pushtetin apo vegël e pushtetit.

Na lodhi me apele që të kemi kujdes ndaj koronavirusit, thuase jemi ose axhamij, ose jemi të rrjedhur truve, ose jemi popull i padisiplinuar. Në sabah e në aksham na apelon që të kemi kujdes, thuase vetëm ne jemi këtu dhe vetëm ne jemi shkaktar të përhapjes së koronavirusit.

Apo, është në sinkron me pushtetin që e ka në plan të na mbyllin për muajin e Ramazanit. Bëmë sa bëmë apel, nuk ia vumë mendjen aq sa duhet apeleve të Shaqir Fetait, nuk pat rezultat pozitiv, ndaj duhet të pajtohemi që të mbyllemi. Kjo është filozofia e sinkronizimit të Shaqir Fetait me institucionet gjegjëse të pushtetit në prag të muajit të Ramazanit. Sepse, një gjë e tillë nuk i kërkohet Kishës Ortodokse Maqedonase! Ata një herë kanë apeluar dhe aq, i respektojnë të gjitha vendimet e organeve gjegjëse, pa u shndërruar në vegla të pushtetit aktual.

Shaqir Fetai, dy ditë më parë, lëshoi një apel me shkrim, ndërsa sot ka lëshuar një apel në video, ta shohim “u zhivo”, sepse plasëm nga malli për ta parë! E çka thotë aty: “Me këto apele ne, si Institucion, dëshmojmë se jemi në shërbim!” Në shërbim të kujt o lolo! Ec e sikterisu me të gjitha shërbimet e tua, sepse BFI nuk mund të jetë në shërbim të shërimit nga koronavirusi! Vatikani nuk e merr përsipër një shërbim të tillë! Shaqir Fetai është ekskluzivisht në shërbim të pushtetit që e instaloi dhe që bënë atë që ia kërkon, të nusërojë e të apelojë nga pesë vakte në ditë dhe, me këtë, të dëshmojë se myslimanët janë ata që po bëjnë sherre dhe që duhet të luten të rrinë sa më urtë! A e kupton Shaqir Fetai se çfarë detyra ka marë, ajo!

Ndryshe, sa për t’ia përkujtuar këtij farë gjajdexhiu se, në ditën kur e kreu puçin klasik dhe kur pranoi të instalohet nga shërbimet sekrete serbo-maqedonase në krye të BFI-së, pra, më 26 maj të vitit 2020, atë ditë, situata ishte e këtill: 16 të infektuar, 3 të vdekur, apo, që nga shpallja e pandemisë e deri më datën kur Shaqir Fetait iu rras mendja që ta “vdesë” atë (ish-reisul ulemanë) i cili e kishte shpallur të vdekur koronavirusin, gjithësej kishin qenë të infektuar 2015 persona, prej të cilëve, 1453 ishin shëruar dhe gjithësej kishin vdekur 116 persona. Persona aktivë ishin gjithësej 446 qytetarë!

Në ditën e Fitër Bajramit, kur “babai shpirtëror” i Shaqir Fetait, ish-reisul ulema, fill pas faljes së namazit të këtij Bajrami, e kishte shpallur të “vdekur” koronavirusin, nuk kishte asnjë të vdekur ndërsa të infektuar kishin qenë 21 persona.

Po si ka ndryshuar pasqyra e pasojave nga kjo pandemi në mbarë vendin që nga puçi klasik i Shaqir Fetait vetëm për ta kryer amanetin e shërbimeve sekrete, e deri më sot? Sot, pra, vetëm sot kur e përsëritë apelin Shaqir Fetai (dy herë radhazi brenda dy-tre ditëve), kemi këto të dhëna: gjithësej të sëmurë – 116,602 (vetëm sot 1.216), të vdekur – 3,403 (vetëm sot 24), të shëruar – 99.455, aktivë 13.749!

Çka flet ky rezultat? Mos ka premtuar Shaqir Fetai rezultate më pozitive kur e pranoi instalimin e vet në krye të BFI-së?! Mos është ky ai kompleks që e detyron këtë “reis” të falsifikuar që të dalë me apele e apele, me ligjerata e vaze, ndërsa rezultatet janë gjithnjë e më katastrofale! Apo nuk po ia qokë askush Shaqir Fetait!

Shaqir Fetai, si anëtarë Rijaseti ka shpërndarë si donacion mbi 20 mij maska në maj të vitit të kaluar nëpër institucione shtetërore! Sivjet ka marrur donacion mbi 12 mij maska! Pse Shaqir Fetai nuk jep urdhër që të gjitha xhamitë në vend “të vërshohen” me maska, me dezinfektantë, si dhe të shënjohet distanca edhe në oborre të xhamive. Po lavdërohet se ka shumë miqë në vend e nga bota që do ta ndihmojnë BFI-në! Ja, le të kërkojë maska e dezinfektantë, le të paguajnë ekipet e dezinfektimit. Xhamitë të jenë të dezinfektuar natë e ditë si dhe me maska për të gjithë ata që falen! Lehtë e ka Shaqir Fetai të japë “kontributin moral” të vetin, por, le të dalë në terren dhe e ta shikoj se si është situata! Xhamitë pa maska, pa dezinfektante, me oborre pa shenja distance, pa protokol të përgatitur për secilin muteveli të cilëve duhet t’u lëshojë vendime me kompetenca të veçanta në këto kushte pandemie. Lehtë e ka të dalë në TV e të çaraveshet “xhemati ynë ëshë i maaadh...”! Le të kërkojë nga shteti që t’ju krijohen kushtet për faljen e pesë vakteve të namazit në xhemat dhe jo të kryejë apele sa për t’u dëshmuar se vazhdon të jetë në shërbim të “politikave zyrtar”: të pushtetit maqedonas! Shaqir Fetai duhet të dëshmojë se është i xhematit, se e mbronë interesin e xhematit duke qenë në shërbim të xhematit e jo të hyqmit!

*(Mileniumi3, 18.03.2021)*

## Në pritje të kohës për manipulim “pa pasoja”

**Dikur, në Lagjen e Seravës, në Çair të Shkupit, ishte një prej depove të tërë makinerisë së ndërmarrjes së “Higjienës Komunale” të Shkupit! Ishte lagja më e qelbur, më e ndotur, më e kontaminuar, ishte “parkingu” i kamionëve të plehërave të Shkupit, ndërmarrje kjo që shtrihej mbi tokën e uzurpuar e të nacionalizuar që dikur ishte pronë e BFI-së. Po sot, pronë e kujt është ky vakëf**

### Shkruan Nebahat Osmani

Pas ligjit për denacionalizim të pronave të bashkësive fetare, pa rreshtur është punuar nga ana e ish-reisul ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepi për ta marrur këtë pronë, sidomos pas dislokimit të kësaj Ndërmarrje në të tjera hapësira! Falë edhe kontributit të jashtëzakonshëm të ish-drejtorit të kësaj Ndërmarrje, z. Rakip Doçit, H. Sulejman ef. Rexhepi arriti që këtë pronë sërish ta rikthejë në Vakëfin e BFI-së.

Pati lloj-lloj ofertash, pati lloj-lloj biznesmenësh, lloj-lloj përpjekje për dallavera e mallverzime, për lojëra të dyta partiake e intriga matrapazësh, kryesisht të udhëhequr nga kryehajni i BFI-së, Mustafa Dauti, për ta manipuluar Sulejman ef. Rexhepin dhe për t’ia zhvatur këtë pronë ideale për biznese të ndryshme. Më në fund, u ofrua i ndjeri Enver Maliqi dhe, u dakortësuan me Sulejman ef. Rexhepin dhe, nisën punës së hajrit duke inkuadruar këtu edhe partnerin e GEMAK-ut, “Rajana Inxhiniering”, me pronar Vegim Etemi!

Natyrisht, janë nënshkruar marrëveshjet, ato ekzistojnë, ndonëse tashmë njëra palë (Enver Maliqi) është bërë për rahmet, e pala tjetër (H. Sulejman ef. Rexhepi) është dorëhequr nga BFI-ja! Në këtë projekt, është kyqur edhe njëra palë mjaft serioze dhe me renome ndërkombëtare në ndërtimtari, të cilës si ushujzë i është ngjitur sërish kryehajni i BFI-së, Mustafa Dauti, i cili madje, ka provuar edhe të manipulojë njerëz dhe t’ju shesë banesa (madje edhe punëtorëve të BFI-së)! Prej nga ato banesa Mustafa Dauti?

Sido qoftë, më 2 tetor të vitit 2019 kanë filluar punët në këtë pronë të vakëfit! Hidhet guri themeltar i godinës së parë të një kompleksi ndërtesash! Sulejman Rexhepi, në prani të shumë mediave elektronike dhe të shkruar, hedh gurin themeltar të Hotelit me pesë yje “ISRA”, e cila do të duhej të ishte pronë e vakëf i BFI-së, objekt i parë që do të ndërtohej nga investitorët dhe, pasi të liheshin çelësat e hotelit në “dorën” e BFI- së, tek atëherë, investitori GEMAK në partneritet me RAJANA INXHINIERING, do të mund të fillonin ndërtimin e kompleksit prej pesë ndërtesave për banim si dhe të objekteve të tjera sipas projektit që do të shtrihej në tërë tashmë ish-pronën e Vakëfit të BFI-së-Myftinisë së Shkupit.

Hoteli “Isra” do të duhej të ishte shtatëkatëshe, me sipërfaqe prej 5.350 m<sup>2</sup>, me pesë yje.

Në vënien e gurit themeltar morën pjesë Kryetari i BFI-së, Reis’ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi, myftiu i Shkupit Qenan ef. Ismaili, i Tetovës Qani ef. Nesimi dhe i Gostivarit Shaqir ef. Fetahu, dekani i FSHI, Shaban ef. Sulejmani, drejtori i Medresesë Isa Beu Ibrahim ef. Idrizi. Po ashtu, gjatë ceremonisë së hedhjes së gurthemelit të këtij Hoteli prezent ishin edhe Kryetari i Qytetit të Shkupit,

Petre Shilegov, i Komunës së Çairit, Visar Ganiu, i Komunës së Sarajit, Blerim Bexheti etj. Vegim Etemi, pronari i firmës “Rajana Inxhiniering”, bashkëinvestitorë me GEMAK, në fjalën e tij të rastit kishte thënë se investimi i këtillë është i pari në RMV. Me këtë investim do të bëhet urbanizimi dhe modernizimi i lagjes Seravë, gjithnjë me qëllim që jetesa e banorëve këtu të bëhet më e lehtë, ndryshe prej më parë, kur këtu, në vakëfin e BFI-së, ka qenë firma “Komunalec”.

Kryetari i BFI-së, Reis’ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi, fjalën e tij përshëndetëse veç tjetërash ka përshëndetur dhe ka falënderuar në veçanti firmën “Rajana Inxhiniering” për marrëveshjen e arritur, pastaj Komunën e Çairit për dokumentacionin e dorëzuar në kohë. Reis’ul-Ulemaja gjithashtu ka shpjeguar se të ardhurat që do të sigurohen nga ky hotel do të shfrytëzohen në procesin edukativo-arsimor të BFI-së. Hotel “Isra”, sipas marrëveshjs, do të ndërtohet për një kohë relativisht të shkurtër, ka përfunduar efendi Rexhepi.

Sot, pas dy vite e gjysëm punë, a ia bën kush llafin këtij Hoteli në BFI?

A u bë Hoteli?

A filloi të gjenerojë të ardhura për Medresenë?

Çka u bë me këtë hotel?

Ku ngeli Vakëfi i BFI-së?

Si u bë që në vend të Myftinisë së Shkupit, përfitues të dalë Mustafa Dauti, kryehajni i BFI-së, njeriu kyç në kabinetin e kryematrapazit të BFI-së, Shaqir Fetait!

Si është e mundur që të tjetërsohet prona, me çfarë vendimi, me çfarë nënshkrimesh dhe kush ka nënshkruar në diçka që fillimisht nuk ka qenë marrëveshje!?

Sot, dëgjohen reklama nëpër radio e televizione se, në ish-Komunalec, në pronën e BFI-së, në Seravë të Çairit, të gjithë të interesuarit për banesë mund të paraqiten sa më parë, sepse në përfundim e sipër është kompleksi me pesë banesa, me hotel spa e me qendra tregëtare, me pamje të lagjeve evropiane – Premium Residence!

Do me thënë, hoteli na del pjesë përbërëse e këtij kompleksi dhe jo Pronë-vakëf i BFI- së, e cila do të dilte si kontribuesja më e madhe në financimin e Medresesë “Isa Beu”! Në vend se të përfundojë Hoteli “Isra” e pastaj kompleksi i ndërtesave për banim në një “lagje evropiane”, ka ndodhur e kundërta!

Kush e lejoi këtë punë?

Kush mbanë përgjegjësi për humbje të të hyrave që është dashur të vijnë nga Hoteli “Isra”!

Në bazë të çfarë vendimi, në cilën mbledhje, me çfarë dokumenti, u leju që të kryhet kompleksi i banesave dhe, mbase pastaj, pasi të shiten banesat, të ndërtohet eventualisht ndonjë hotel dhe “të dhurohet” për vakëf!

Opinionimi mysliman i vendit insiston të dijë që, për këtë që po ndodhë, a është në dijeni të Myftinisë së Shkupit?

A po ndodhë me dijen dhe me lejen e “myftiut” të përgjurmur Qenan Ismailit? Aka dijeni kjo Myftini dhe Qenan Ismaili se çka po ndodhë?

A i intereson vakëfi i Myftinisë apo jo!

Pse nuk e bën punën transparente, të dijë populli mysliman se si harxhohet amaneti i tyre, si menaxhohet, si shpenzohet amaneti i tyre!

Të paktën të jenë transparent ngjashëm si “investitori”, i cili, në faqen zyrtare të “Premium residence” nënvizon: “Bëhet fjalë për Premium Residence, një koncept avangard i jetesës, që ka bërë bashkë ekspertët dhe inxhinierët më të mirë të GEMAK, të dëshmuar tashmë në stilin dhe kualitetin e ndërtimit edhe me projekte të tjera si Park Hotel & SPA, Park Residence dhe së fundmi me investimin më të ri në fushën e hotelerisë, Next Door Park Hotel. Ku në partneritet me Rajana Engineering dhe

Shuki Immobilier kompani ndërtuese edhe në Evropë me projekte unike, sjellin Premium Residence në Shkup.

I vendosur në qendër të qytetit të Shkupit, në zonën Çair, kompleksi Premium Residence, si asnjë projekt tjetër, ka kombinuar me kujdesin maksimal elementet më të rëndësishme, të një jete të qetë rrethuar me cilësi dhe përsosmëri, deri në detajin më të vogël.

Kompleksi ka 5 objekte banimi, secila unike në projektimin e saj dhe të bashkuara në konceptin e ekluzivitetit, për plot 450 familje.”

Asgjë më tepër, as se do të jetë Hotel “Isra” i BFI-së, e as se do të ketë hise Myftinia e Shkupit! Apo, do të kënaqen me nja 3-4 banesa që do t’i marrin për vete këta të Myftinisë dhe, tërë prona e Vakëfit të Shkupit do të shkrihet në ato 3-4 banesa, me shpresë se, deri atëherë, nënshkruesi i parë (H. Sulejman ef. Rexhepi), i cili edhe mund t’i posedojë dokumentet origjinale të marrëveshjes dhe, mund t’i humb dhe gjithçka pastaj do të manipulohet! Del puna që këta të Myftinisë së Shkupit, konkretisht “myftiu i kontrabanduar”, Qenan Ismaili, është në pritje të kohës për manipulim pa kurrfarë pasojash! A thua, “nga maja si duket Stambolli”?!“

*(1Kliklart, 20.03.2021)*



## Morali i legjendave për mbretëritë e hershme

**Si t'i lexojë Shaqir Fetai shumicën e legjendave që kanë të bëjnë me mbretëritë e ndryshme, të shekujve që nga periudha romake e këndej. Pse t'i lexojë pikërisht Shaqir Fetai? Sepse, vetëm ai duhet të bindet se, që të gjithë mbretërit, si pasardhës të njëri tjetrit, kanë vepruar dhe kanë përjetuar po atë siç veproi dhe siç do të përjetojë Shaqir Fetai**

### Shkruan Skifter Pollozhani, historian i artit

Në historinë e sistemeve mbretërore, mbretërit kanë ardhur përmes intrigave nga më çnjerëzoret, ndërsa të suksesshëm kanë dalur vetëm ata mbretër, jo ata që kanë pasur aftësinë për të thurrur intriga, por, ata që kanë pasur aftësinë e kapjes dhe të leximit me kohë të intrigave, të tradhëtive dhe të kompleteve.

Mbretërit kanë trashëguar fronin vetëm nëse janë rebeluar së brendshmi, sepse, rebelimi nga jashtë i ka dhënë fund sistemit mbretëror. Kanë qenë mirë të organizuar, kanë pasur “roje mbretërore” ushtri, sistemi ka qenë shtypës, i pamëshirshëm, bindja ka qenë se mbreti është dërgues nga perëndia, si i tillë është mëkëmbës i perëndisë, ndaj dhe çdo gjë e gjallë duhet t'i nënshtrohet mbretit. Kur vinte mbreti në fron, ka qenë një periudhë e caktuar, varësisht nga vizitorët që, mbreti ulur në fron priste delegacione të ndryshme që vinin ta uronin e t'i sillnin në shenjë nderimi lloj-lloj dhuratash e peshqeshesh!

Çka bënin mbretërit që vinin dhunshëm, zakonisht nga oborri mbretëror! Kjo ardhje realizohej përmes tradhëtisë, përmes intrigave, tradhëtive, kompleteve, përmes linçimit, likuidimit, përmes blerjes së bashkëpunëtorëve të ngushtë të mbretit, përmes rojeve të para të mbretit, përmes njerëzve apo këshilltarëve kryesorë të mbetit, kryesisht përmes shpërblimit si kundërvlerë e aktit tradhëtues dhe të krimit.

Pasaradhësi, apo, tash e tutje mbreti, një kohë do të shprehë heshtje dhe dhimbje, mallkim e trishtim, ankth e keqardhje, derisa ta kuptojë pajtueshmërinë e masës me fatin! Në ndërkohë do ta lexojë situatën, do t'i përcjellë njerëzit, sidomos bashkëpunëtorët e ngushtë të ish-mbretit, do ta lexojë heshtjen dhe sjelljet e masës së gjërë, do ta lexojë deri në bindje lojalitetin e rojeve të mbretit, të këshilltarëve, të personelit të oborrit mbretëror dhe të ushtrisë mbretërore.

Mbretërit që kanë ardhur nga intrigat, nga tradhëtitë dhe krimet e brenda oborrit mbretëror, që të gjithë prioritet në strategjinë e bretërimit të tyre kanë pasur eliminimin e intrigantëve që e kanë ndihmuar, vrasjen e kriminelëve që e kanë helmuar apo që e kanë eliminuar mbretin, përgjumjen e qëllimshme të rojeve që kanë lejuar realizimin e intrigave si dhe të gjithë ata që kanë qenë të përfshirë si dhe të shpërblyer nga kjo ndihmë. Sepse, mbreti i intrigave e di fare mirë se, gjithçka mund të vritet e shërohet, përveç nostalgjisë.

Tërë ky staf kriminelësh që e ndihmojnë kryeintrigantin të vie në fron, shumë shpejt do të ndjejë frikën e eliminimit, ndaj gjithnjë e më shumë do t'ju shtohet nostalgjia për mbretin që e eliminuan, do të ndjejnë fajësi, do të ndjejnë trishtim, do të ndjejnë nevojë për kërkim falje me përulësi para ish-mbretit. Do të jetë shumë vonë momenti kur do të kuptojnë se, personin që e kanë ndihmuar të vijë në pushtetin mbretëror, në fakt, nuk është asgjë tjetër përveçse kriminel, ai nuk e ka në mend

mbretërimin e vendit dhe të popullatës, por, zhvatjen e tyre, ushtrimin e kriminalitetit mbi ta. Në këtë situatë do të kuptojnë se, mbreti i më parshëm, atë që e eliminuan, të paktën ka pasur vizion, ka pasur trimëri, ka pasur ushtri për mbretërinë e për popullin, ka pasur “roje oborrtare” për rend dhe mirëqenie për të gjithë, ka pasur institucione të rregullta mbretërore, ndaj do të nisin ta urrejnë mbretin që e sollën duke i mllaçitur e duke u tejngopur me intrigat e tij.

Dhe, sakaq, derisa do të vetëdijësohen për gabimin trashanik që kanë bërë, mbreti i ri do t’ua këpusë kokat dhe do t’i ngulë në hunj që të copëtohen nga coftinëngrënësit e të përfundojnë si tradhëtarë të mbretërisë. Pa dyshim, intrigat gjithnjë kanë qenë mjet shtypës i masës së gjërë dhe, gjestet kriminale të mbretit, mosrespektimi i betimit të mbretit, mosrespektimi i akteve mbretërore si dhe i personelit oborrtar, do t’i sinjalizojë masës se punët nuk janë në rregull. Ky është shkasi i revoltave së vegjëlisë dhe, marrja fund e një mbretërie që ngelë vetëm si mit, jo si mit i kreshnikëve që shton dozën e mburrjes etnike, por, si mit i sojit të Judë Iskaritotit, që shton dozën e turpit dhe të trishtimit.

T’i kthehemi Shaqir Fetait, “mbretit aktual” që erdhi përmes tradhëtisë dhe komplotit! Shaqir Fetai sikur ka nisur ta lexojë zhgënjimin e ish-bashkëpunëtorëve të Sulejman Rexhepit të cilët e tradhëtuan! Ka nisur t’ua nuhasë nostalgjinë për të, ka nisur t’ua kuptojë dhembjen për të, ndaj dhe ka nisur një arrogancë ndaj tyre. Ky është ishreti i parë se shumë shpejt do t’ua heq kokën dhe do t’ua ngulë nëpër hunjë!

Jo rastësisht Shaqir Fetai e ndjenë urrejtjen e tmerrshme të stafit akademik në një mbledhje të FSHI-së nga e cila, si ai me bishtin në këmbë, detyrohet të dalë dhe të ikë nga mbledhja.

Jo rastësisht Shaqir Fetai ish-bashkëpunëtorin më të ngushtë të Sulejman Rexhepit e dëbon nga zyrja, sepse ky ka stilin e vet të veshjes, i cili ia vret syrin “mbretit aktual” ndaj dhe e dëbon nga zyrja. Kë e dëboi? E dëboi atë që është më meritori, që e ndihmoi më së shumti Shaqir Fetain të vinte “në pushtet”? E dëboi nga zyrja njeriun më të afërt, i cili dikur i flinte te këmbët Sulejman Rexhepit! Por, deri në “Ditën D”, Shaqir Fetait i duhet të luajë skenën e parë të dramës, atë të keqardhjes për ish-mbretin, atë skenë ku ka plotë dhimbje, plotë trishtim, por edhe lavdërata dhe respekt për “mbretin e pafat”!

Prandaj, jo rastësisht, Shaqir Fetai, kur u pyet se si ndjehet për një inçizim ku e mburrë deri në perëndi Sulejman Rexhepin ndërsa të njëjtin e largoi me intriga e komplot dhe i ndihmuar nga pushteti aktual maqedonas, ai do të përgjigjet: “Po haxhi rreisi ka qenë njeri i maaadh, ka merita të veçanta, ka qenë trim e azgan, ka kontribut të pamohueshëm në avancimin e islamit ndër ne, dhe, edhe sot sikur ta inçizoja atë emision, unë sërish do të flisja me pietet e respekt për personalitetin e Sulejman Rexhepit, sepse ai ka qenë dhe gjithnjë do të ngelë figurë markante...” Kështu është pëgjigjur intriganti Shaqir Fetai! Këtë e kanë kuptuar të gjithë, tërë “oborri mbretëror”, ndërsa meqë kështu qenka puna, më së keqi po ndjehen ata që e ndihmuar në komplot Shaqir Fetain! Po pyesin: meqë paska qenë kaq i madh, meqë këtë respekt për Sulejman Rexhepin e paska të konservuar në shpirt Shaqir Fetai, atëherë pse e ndihmuam në këtë gjest antiislam! Vetëm që të dëshmojmë se sa të fortë jemi në shkeljen e gjithçkafit që u ndërtua, në shkljen e të gjitha akteve normative, të gjitha normat kushtetutare? Mos e hodhëm një hap drejt shkatërrimit të Institucionit të patundur nga asnjë pushtues tash e gjashtë shekuj? Të paktën Shaqir Fetai do të marrë një notë të lartë nga Stanko Dragoviqi i UDB-së! Po ne çka fituam?!

...

*(1Kliklart, 22.03.2021)*

## Respekti formal që prodhon injorim, nënçmim, ofendim...

**Cilido ndërkombëtar, në cilëndo derë të myslimanëve të vendit të trokasë, është i mirëpritur e i nderuar deri në kupë të qiellit. Por, le të provojë Shaqir Fetai e le të trokasë në cilëndo derë të myslimanëve të vendit! Më së paku që mund të përjetojë, do të jetë pështyerja surratit**

**Nga Muzafer Dashi**

Ka momente, vijnë situata, krijohen rrethanat që, ndaj një institucioni të shprehet respekti, fromal. Kjo, kryesisht për shkak të peshës apo rolit, ose edhe kur në krye të institucionit gjendet një person i papërshtatshëm, i pandershëm, pa integritet, pa personalitet, thjesht, person kukull! Megjithatë, ky person “respektohet” formalisht, ftohet nëpër takime formale e joformale, vizitohet e “nderohet”, jo për ndonjë meritë, por, thjesht, për hirë të institucionit që mund të ketë traditë më të gjatë, që ka një peshë në shoqëri, një rol shumë domethënës e që mund të jetë edhe interes jetik për një shoqëri të tërë.

Një Institucion i këtillë është Bashkësia Fetare Islame në Maqedoninë e Veriut! Nuk mund të anashkalohet, nuk mund të përjashtohet, nuk mund të izolohet. Natyrisht, i vizituar e i ftuar nëpër evente të ndryshme, i respektuar përmes numrit një të Institucionit, gjithmonë përfaqësohet dhe prezanton përmes të parit, ose të deleguarit të tij, pavarësisht nëse i pari apo i dërguari janë kriminelë, janë horra, janë honxho bonxho, janë matrapazë apo tradhëtarë! Ky problem është raport në mes të “prijësit” apo të deleguarit të tij dhe masës që e përfaqësojnë dhe, ky problem nuk mund të reflektohet, bie fjala, në raporte Institucion-ambasada, Institucion-organizata, Institucion-organe shtetërore apo ndërkombëtare. Faktorë me relevancë jo rallë janë ulur e kanë biseduar edhe me kriminelë e “me kasapë”, me diktatorë e me “kanibalë”! Ndërkombëtarët e vizitojnë Institucionin e BFI-së, apo e thërrasin nëpër evente “reisin” jo se e duan, jo se kanë simpati ndaj tij, jo se kanë se çka të mësojnë prej tij, jo se është ndonjë intelektual i kalibrit të madh, por, thjesht, e ftojnë si përfaqësues i Institucionit për të cilin kanë respekt të rezervë dhe për të cilin kanë konsiderata me pijetet.

Pa dyshim, faktorët me relevancë kombëtare, shtetërore e ndërkombëtare, sa herë që e thërrasin apo që e vizitojnë Shaqir Fetain, si “të parin” e BFI-së, ndjehen në siklet, ndjehen me faj, ndjehen të turpëruar por, për hirë të respektit që e kanë ndaj Institucionit e gëlltisnin edhe këtë “pleh”!

Të gjithë faktorët e dinë se, raporti i Shaqir Fetait me maën e gjërë është zero, është një “dashuri” formale, sa për të thënë,

një dashuri që e kamufllon një vullkan urrejtjesh kundër Shaqir Fetait.

Shaqir Fetai nuk mund të jetë i keq për popullatën, nuk mund të urrehet nga masa sepse ka bërë shkelje flagrante kushtetuese, ndërsa të “dashurohet” e të përgëdhelet nga faktorët e vendit apo ndërkombëtarë.

Shaqir Fetai nuk mund të duhet nga të huajt ndërsa të urrehet nga popullata e vet sepse ka përçmuar Institucionin jetik të popullatës!

Nuk mund të duhet Shaqir Fetai nga faktorët relevantë të vendit e të huaj, ndërsa të urrehet nga populli i cili e ka të dokumentuar e të faktuar se ai ka avancuar në karrierë duke qenë nxënës i oficerit

të UDB-së, Stanko Dragoviqit!

Ndërkombëtarët, aq më tepër, e kanë të pamundur që te Shaqir Fetai të shohin një “leadership” të pranueshëm nga masa e gjërë, sepse është e faktuar dhe e argumentuar se ai vjen në krye të BFI-së si instalacion në formë të telave lëmshe nga pushteti aktual maqedonas! Mbarë popullata myslimane e vendit tashmë e ka të qartë se Shaqir Fetai BFI-në e ka shndërruar në një mashë plastike në duart e pushtetit aktual!

Megjithatë, faktorët me relevancë, si të vendit ashtu edhe ata ndërkombëtarë, iatokin dorën e papastër, sepse janë të detyruar nga respekti i patjekalueshëm që e kanë ndaj Institucionit të Bashkësisë Fetare Islame.

Megjithatë, si faktorët e vendit ashtu edhe ndërkombëtarët, duhet të kenë kujdes me këtë respekt, qoftë ky edhe formal, sepse, po prodhon njëfarë përçmimi, njëfarë, injorimi, njëfarë ofendimi që po e ndejnë myslimanët e vendit. Nuk guxojnë asnjë faktor të mendojnë se, meqë masa po e duron këtë tip të pasoj, atëherë edhe ne lidhim raporte, sepse na konvenon! Populli, me këtë heshtje dhe me këtë ofendim që po i duron dallaveret e Shaqir Fetait, thjesht, po shpreh një respekt e një dashuri ndaj faktorit ndërkombëtar. Nuk po dëshiron që t’ia davarisë konceptet, bindjet, përshypjet se popullata myslimane e vendit është mjaft e disiplinuar, nuk është rrebele, ekstremiste. Pra, nuk është punë, vepër, apo angazhim i Shaqir Fetait për atë që popullata myslimane e vendit është mjaft e civilizuar, porse, këtë civilizim e ka të hershëm, e ka në gjen.

Cilido ndërkombëtar, në cilëndo derë të myslimanëve të vendit të trokasë, është i mirëpritur e i nderuar deri në kupë të qiellit. Por, le të provojë Shaqir Fetai e le të trokasë në cilëndo derë të myslimanëve të vendit! Më së paku që mund të përjetojë, do të jetë pështyerja surratit!

Është ofendim deri në përmasa të situatave konfliktuale instalimi i reisit nga pushteti, apo nga partitë politike. Bashkësia Fetare Islame, kurrë më parë nuk ka qenë, jo degë por, nëndegë partie, ndërsa tani po!

Prandaj, është mirë që, faktorët e vendit, apo edhe ndërkombëtarët, nëse nuk dëshirojnë që t’i ofendojnë dhe t’i nënçmojnë myslimanët e vendit, disi t’ia bëjnë të qartë Shaqir Fetait se, jo ai, por të gjitha respektet i gëzon Institucioni i Bashkësisë Fetare Islame që tashmë ka kaluar traditën gjashtëshekullore. Nuk duhet lejuar Shaqir Fetain që takimet apo vizitat e faktorëve të ndryshëm t’i shesë si “dashuri” dhe përkahe që po ia bëjnë personalisht atij. Sepse, Shaqir Fetai është komplotisti, “terroristi i fshtë” i cili me ndihma politike, uzurpon një Institucion fetar, e delegjitimon, e degradon, e defaktorizon duke ia mohuar normat juridike, aktet kushtetutare, duke e shkatërruar përditë e më shumë! Është e pabesueshme se, faktorët e rëndësishëm në vend do të lejonin që të bëhen palë me Shaqir Fetain në këtë “përbaltje” të shpirtit mysliman, duke i shprehur “respekte” qoftë edhe formale! Tashmë është faktuar se Shaqir Fetai është i keq, bukëpërmbysës, gacë e mbuluar, përbindësht... Ai për këtë është shumë i vetëdijshëm ndaj dhe, përçdo ditë pret, jorespekt por, ndëshkimin e pashmangshëm nga Zoti Fuqiplotë!

*(1Kliklart, 25.03.2021)*

## Unë nuk jam hoxhë

**Xhematë të nderuar, myslimanë të dashur të Shkupit e të mbarë vendin, mos mendoni se keni hoxhallarë, mos mendoni se nëpër namaze po lidheni pas hoxhallarëve! Gaboheni! Nuk ka hoxhallarë që do të lejonin shitje e zhdukje të vakëfeve, që do të lejonin një BFI pa integritet, që do të lejonin të dretjohen nga një person që u instalohet nga zgjatimet e komunizmit dhe ateizmit**

**Nga Nijazi Fetahaj**

Pas periudhës së Pavarësisë së Shqipërisë si dhe të Tokave Shqiptare (Kështu quheshin viset e Shqipërisë Etnike), hoxhallarët aderion në shumë lëvizje politike e kombëtare, që nga lëvizjet që ishin për vazhdimësinë e “politikave të Babës Mbret”, e deri te politikat që reflektonin ideale të Rilindjes Kombëtare. Dua të them që, hoxhallarët nuk ishin vetëm statistë, që ia caktonin vetes vetë rolin e të predikuarit dhe të mësuarit fe, por, ishin drejtues, misionarë të besimit e të besës, gjahtarë të tradhëtarëve e të spiunëve, ishin lufëtarë të paepur për fe e për atdhe, për Zot e për komb, sepse, ata e dinin që, për të pedikuar duhej të ekzistonte një komb kujt i drejtohesh me predikime fetare, për ta pranuar predikimin duhej të ishte i dashur nga kombi, pra, duhej të punoje edhe për komb që e ndjenë jetike nevojën për t’iu mbështetur Zotit.

Pas Luftës “nacionalçlirimtare”, instalohet ideologjia komuniste dhe, roli i fesë dhe i predikuesve zbehet deri në një “element prapanik”, i cili duhet të çrrënjohet nga jeta jonë.

Në këtë sistem ateist, hoxhallarët trajtoheshin si mjet tallje; me hoxhallarët talleshin në çdo takim e në çdo ndeje, hoxhallarët llogariteshin si hendikepi më i madh i shoqërisë, në çdo hoxhë shihnin nga një “Nasradin hoxhë”. Është periudhë kur hoxha trajtohej me rolin që nevoitet vetëm për atë sendin mashkullor: hoxha duhet për ta bërë aminin kur ta bëjmë djalin synet; hoxha duhet kur ta fusim djalin dhëndër dhe të lutet që dhëndri të kalojë sa më mirë deri në mjes dhe, krejt në fund, hoxha duhet me ia fërku xhenazes kur ta përgatisë për në varr!

Fatkeqësisht, ky rol u trashëguar, sikur u pëlqeu hoxhallarëve dhe, krahas kënaqësisë që ndjejnë me vazhdimësinë e talljes, mjaftojnë edhe me rolin që e gëzojnë edhe më tej nga shoqëria.

Hoxhallarët sot, janë të lumtur me këtë “plus profesion”, sepse e sigurojnë ekzistencën, i marrin pas çdo “eventi” të tillë, kush nga 50 euro, kush nga 100 euro dhe, të kënaqur të gjithë, edhe hoxha edhe myslimanët!

Por, a është kjo fe? A është ky Islam! A ia ka caktuar feja Islame këtë rol hoxhallarëve, apo këta ia kanë zgjedhur vetëvetes. A është roli i hoxhallarëve që gjithmonë të përgatisin kuadro fetar e patriotë, a duhet të vrapojnë pas këtij misioni apo të vrapojnë e të gjejnë se ku do të ketë ndonjë synetllëk, ndonjë dhëndri e ndonjë xhenaze!

Ose, ta zbusim pak kritikën! A është hoxha ekskluzivisht për t’i mësuar xhematet e sotshëm se si të marrin abdest dhe se si të falen? A nuk është ky nënçmim i myslimanëve sot, kur, këto mësimet i kanë të trashëguara prej stërgjyshërve, gjyshërve, prej baballarëve të tyre! Mësimet e këtilla, madje edhe më të gjëra dhe më të thukta i kanë secili në xhep, në celular, në kompjutor! Roli i hoxhallarëve me këtë mision klasik tashmë është tejkaluar dhe është bërë demode! Hoxhallarët sot duhet ta tejkalojnë

vetëveten, duhet të dalin nga ajo lëvizje ku janë struktur e ku durojnë mijëra tallje, ofendime, përçmime, fatkeqësisht, të gjitha të merituar!

Ftakeqësisht, hoxhallarët sot meritojnë çdo sharje, çdo ofendim e nënçmim. Ky konstatim është shumë i rëndë, shumë i keq, shumë armiqësor, por, mjerisht, i meritueshëm!

Kam pyetur me dhjetra imamlerë, hoxhallarë, teologë të ndryshëm, pse heshtin, pse janë kaq anemikë në raport me ofendimin e fesë islame, ku është ai rrebelimi i tyre i shenjtë në raport me mbrojtjen e institucioneve fetare. Të gjithë, në union, të japin një përgjigje: po më duhet të duroj, e kam për bukë! Do me thënë, hoxhallarët sot, për bukë e gojës durojnë t'ua bëjnë "reis" edhe nipin e Rankoviqit, edhe nxënësin e Petkos, edhe informatorin e Dragoviqit!

Do me thënë, hoxhallarët sot, për bukën e gojës e durojnë kriminelin i cili pa kurrfarë insafi e frike nëpërkëmbë dinjitetin e Institucionit të BFI-së due ia shkelur e përbaltur tërë Kushtetutën e cila bazohet ekskluzivisht në dy shtyllat e islamit: në Kuran dhe në Sunetin e Pejgamberit tonë, Muhamedit a.s.

Do me thënë, hoxhallarët sot, për bukën e gojës, heshtin dhe nuk e kundërshtojnë shitjen e vakëfit, të cilin të parët tanë e krijuan ekskluzivisht për ta zhvilluar jetën fetare islame në këto anë dhe jo që të bëhet bazë e pasurimit të bashkëpunëtorëve të shërbimeve të ndryshme telegjente.

Do me thënë, hoxhallarët sot, për bukën e gojës, lejojnë dhe fare lehtë e përballojnë bashkëpunimin me elementë antifetarë e antihumanistë të cilët feja i llogaritë si armiqë e si mynafikë.

Për hirë të islamit, për hirë të parimeve islame, për hirë të Kuranit e të dashurisë ndaj Pejgamberit a.s. të parët tanë, jo që nuk thyheshin për një bukë goje por, me lehtësinë fare të përballueshme pranonin që të vdisnin e mos të degradonin deri në qenie pa integritet, pa dinjitet e pa personalitet, siç kanë ngelur hoxhallarët e sotshëm.

U ngritën sërë aferash, u prekën sërë problemesh, u zbardhën dhe u trajtuan një varg shkeljesh e talljesh me islamin në këtë nënqiell, ndërsa asnjë hoxhë (me dy-tre përjashtime) nuk u iritua, nuk kundërshtoi, nuk u revoltua, nuk u hidhërua! E gëlltitën bash siç e gëlltisnin bukën e gojës!

Sot hoxhallarët tanë e hëngrën turpin me bukë që në momentin ku pranuan që për kryepar t'ua sjell në krye LSDM-ja, t'ua imponojë një njeri me karrierë të begatë në një profesion të cilin islami e lufton në parim!

Sot hoxhallarët tanë e hëngrën turpin me bukë që në momentin kur vendosën që ta mbyllin gojën me thërimë buke dhe mos të reagojnë kundër shkeljeve kushtetutare që u bënë në BFI.

A mund të pranohet se në Shkup dhe më gjërë ka hoxhallarë ndërkohë që para hundëve të tyre shitet, vidhet, tjetërsohet e falet vakëfi, amaneti i trashëguar nga të parët tanë për ta mbajtur të gjallë e për ta shtuar frymën islame në këto hapësira!

Si guxojnë të heshtin hoxhallarët e sotshëm para vendimeve që i sjell antihoxha e antimyslimani që, nga toka e falur për varreza myslimane, dikush të përfitojë për një varr myslimani në tokën e falur!

Jo, nuk ka sot hoxhallarë si dikur. Nuk kryhet misioni i hoxhës duke shitur kopalla në emër të fesë e të Zotit! Hoxha i mirëfilltë kurrë nuk i pranon urdhërat dhe vendimet e nxënësit të Dragoviqit! Hoxha i mirëfilltë, ai i bekuari, i devotshmi, jo për bukën e gojës por, për asnjë çmim nuk do të pranonte që në shtëpinë e vet të pranonte në kafe, bie fjala, një rakixhi, një spiun, një udbash, një krimiel, një soj të Stojanço Angellovit, i cili urdhëron e udhëheq operacione të "brantellave" për të vrarë sa më shumë shqiptarë e myslimanë, për të bombarduar e rrafshuar përdhe xhami e minare! Xhematë të nderuar, myslimanë të dashur të Shkupit e të mbarë vendin, mos mendoni se keni hoxhallarë, mos mendni se nëpër namaze po lidheni pas hoxhallarëve! Gaboheni! Nuk ka hoxhallarë që do të lejonin shitje e zhdukje të vakëfeve, që do të lejonin një BFI pa integritet, që do të lejonin të dretjohen nga një person që u instalohet nga zgjatimet e komunizmit dhe ateizmit! Mos lejoni që hoxhallarët e këtitillë t'ju japin selam, refuzojani selamin, mos ua parnoni, sepse, e kanë manipulim, e kanë sa për t'ju shitur devotshmëri derisa të shitet tërë vakëfi, tërë pasuria e BFI-së dhe në fund edhe vetë BFI-ja! Sepse, e

kanë për bukën e gojës! Ua zëftë frymën!

As unë nuk jam hoxhë, prandaj, kam vendosur që bukën e gojës ta fitoj duke ruajtur shkollë! Rojtar hesapi, por, me shumë dinjitet e personalitet si dhe me vendoshmëri për t'i luftuar të gjitha dukuritë, të gjitha intrigat, tradhëtitë dhe krimet që bëhen në emër të Zotit e të kombit!

Prandaj, nuk dua të jem hoxhë, sepse, druaj se do të ngjasoj në hoxhallarët e sotshëm!

*(Tetovasot, 29.03.2021)*

## **BFI-ja tashmë është partizuar**

**A ka qenë BFI ndonjëherë “politike”? A ka zhvilluar politikë! Po! Politika institucionale e BFI-së ka qenë e fuqishme dhe bazohej në tri shtylla: në pavarësi të plotë, në avansimin e jetës fetare islame dhe në kthimin deri në milimetrin e fundit të vakëfit të nacionalizuar dhe të uzurpuar. Sot, përmes partizimit të BFI-së, kemi një Institucion shtetëror, të depersonalizuar dhe pa identitetin e vet autonom**

### **Shkruan Abaz Islami**

Na ishte dikur një BFI, që ishte pararojë e dinjitetit dhe të integritetit të hoxhallarëve, sepse, ishte Institucion i tyre, përmes të cilit realizonin obligime, detyra, të drejta personale e kolektive si dhe gjithnjë ndjeheshin të mbrojtur e të angazhuar për zhvillimin e jetës fetare islame.

Po! Na ishte dikur një BFI e hoxhallarëve me dinjitet!

Po sot? Nuk kemi BFI? Sot, nuk kemi një Institucion reprezentativ të hoxhallarëve? Jo! Fatkeqësisht, jo! Sot kemi një BFI të partizuar, që e zhvillon politikën e “Partisë Nanë”, me një “reis” të instaluar nga pushteti maqedonas të cilin e durojnë “hoxhallarët” që “druajnë për bukën e gojës”! Sot kemi një BFI të partizuar dhe me rrënjë qindra kilometërshë të pushtetit maqedonas, i cili, tallet me të gjithë myslimanët dhe, në veçanti me hoxhallarët, duke ua instaluar një “reis” i cili pa fije kompleksi, çdo ditë të lume, po dëshmon se është vegël e përshtatshme në duart e antiislamistëve dhe antimyslimanëve! Nëse përpiqemi sinqerisht të bëjmë një rekapitulim të përpjekjeve të organeve të ndryshme shetërore të fusin duart në BFI dhe të zhvillojnë politika që do tarehatonin pushtetin, atëherë do të konstatojmë se nuk ishin të pakta ato përpjekje, ndërkohë që do të krenoheshim dhe do të habiteshim se si ia doli BFI-ja që t’u rezistojë dhe suksesshëm t’i refuzojë të gjitha ato përpjekje, kryesisht, grabitqare.

Nga viti i parë i demokratizimit të shoqërisë sonë e deri më vitin 2015 kur BFI- ja ngeli pa rojtarin e paepur të dinjitetit të këtij Institucioni, pa sekretarin historik të vetin, Afrim ef. Taihrin, mund të listojmë një sërë përpjekjesh të pushteteve të ndryshëm, të partive të dryshme e të shërbimeve intelegjente për të vënë këmbë mbi BFI-në! Të gjithë dështuan, sepse hasën në përkushtimin e pathyeshëm të Afrim ef. Taihirit me shokë e bashkëpunëtorë të shumtë që nuk u tunduan nga asgjë dhe nuk tradhëtuan për asgjë. Sepse, gëja e vetme që i interesonte Afrim ef. Taihrit ishte ruajtja e paprekshmërisë, ruajtja prej njollave partiake dhe ruajtja nga ndikimet politike që askund nuk përputheshin me politikën autonome të Institucionit: zhvillimin e jetës fetare islame për të gjithë myslimanët e vendit, të cilët, pa dyshim e me të drejtë, secili për vete aderonte në ndo një parti politike. Në kohën e Afrim Tahirit, në BFI nuk kishte vend për politikën ditore të askujt, nuk kishte vend për ndikimet partiake, nuk kishte vend për shantazhime, për hajni, për tradhëti, për intriga. Në kohën e Afrim Tahirit në qendër vëmendje ishte personaliteti i hoxhës, për të cilin ëndërronte që një ditë të shembëllenin në qytarë me personalitet e dinjitet të lakmueshëm prej të gjithëve.

Natyrisht, e kishte edhe përkrahjen dhe besimin e ish-reisul ulemasë së BFI-së, i cili, çuditërisht, për shkaqe të pashpjegueshme, vendosi që, në maj të vitit 2015, të vazhdojë drejtimin e BFI-së pa ndihmën, pa sinqeritetin dhe pa vizionin e Afrim ef. Tahirit.

Le t’i sjellim këtu dy-tre elementë që flasin për profesionalizmin dhe për përkushtimin e Afrim ef. Tahirit për një BFI autonome në atë periudhë derisa ishte sekretar gjeneral i saj! Përpjekjeve të Ali Ahmetit për t’ia vënë dyzgjinat BFI-së morën fund sidomos në debatin e Afrim Tahirit që e pati në përballje me ish- zv/kryeministrin, z. Musa Xhaferi, në studion e Alsat M!



Janë disa dëshmitarë që mund të flasin edhe sot për qëndrimin kryengritës të Afrim ef. Tahirit në takimin që një delegacion i BFI-së e pati në kabinetin e ish-kryeministrit, Nikolla Gruevski, rreth denacionalizimit të vakëfit! Në këtë takim, me qëllim që delegacionin e BFI-së ta trullosë me goditje të papastra, Nikolla Gruevski u ndërsy që t'ua bëjë me dije se BFI-ja për shumë prona do të duhet të dëshmojë me tapi, të cilat nuk i ka! Reagimi i zjarrtë i Afrim Tahirit ishte: “z. kryeministër, po ua bëj me dije se mud të mos ketë tapi vetëm Shteti i Maqedonisë, kurse BFI-ja i ka të gjitha tapitë për çdo pronë të saj, i ka faktet dhe dëshmitë”! Lidhur me këto, është shkruar edhe në mediat e vendit.

Nikolla Gruevski po ashtu, në një rast, kishte thënë që nuk i kujtohet se ka xhami në Prilep, kurse reagimi i Afrim Tahirit ishte: “Bëni mirë që këtë kalama ta kapni për dore dhe ta çoni në Prilep që të njohtohet me xhamitë e atjeshme. Dhe, mbani fort për dore se mund t’ju humbë në qytet”!

Më vitin 2007, ishte Afrim Tahiri që ua kumtoi organizatorëve, gjegjësisht, Ministrisë së Kulturës se, BFI do ta bojkotojë takimin e liderëve fetarë botërorë nëse nuk sigurohet përkthim në gjuhën shqipe dhe nga gjuha shqipe! Kur iu garantua kjo kërkesë kombëtare Afrim Tahirit, qeveritarët u përpoqën që të zhvillojnë një lojë tjetër që do ta diskriminonte edhe gjuhën shqipe edhe fenë islame në vend. Organizatorët teknik dhe politik ishin dakorduar që të pranishmëve, në emër të shumë bashkësive fetare në vend, t’iu drejtohej kryepari i KOM-it! Sërish do të shpërthejë keq Afrim Tahiri duke u thënë se, nuk ka prift nëne që mund të flasë në emër të Bashkësisë Fetare Islame. Demnstrativisht do ta braktisë mbledhjen Afrim Tahiri. Pasi kthehet dhe deri sa po i raportonte ish-reisit, në telefon ish-reisit i paraqitet shefi i kabinetit të Gruevskit, z. Protuger. Natyrisht, ish-reisi do ta injorojë telefonatën dhe ishte në pritje të telefonatës nga vetë Gruevski. Nuk do të vonojë shumë dhe do t’i paraqitet Nikolla Gruevski, i cili ia kumton lajmin se në saje të këmbëngultësisë dhe reagimeve, u soll vendimi që të pranishmëve nga gjithë bota t’ju drejtohen me nga tre minuta pese liderët fetarë të bashkësive fetare kushtetutare.

Më vitin 2010, BFI vendosi për pjesëmarrje në Konferencën e dytë, vetëm pasi paraprkasht u firmos Marreveshje me Qeverinë për fillimin e punëve për rindërtimin e Çarshi Xhamisë në Prilep. Rol kyq në këtë ka pasur edhe Ambasada e SHBA në Shkup.

Më vitin 2013 sërish BFI-ja e bojkotoi këtë event jetik për Shtetin e Maqedonisë! Nuk ka dialog ndërkonfesional derisa në Maqedoni Islami hasë në baltosje, në shkatërrim e në djegie të xhamie nga pushteti i atëhershëm. Këtë qëndrim e arsyetoi mjaft guximshëm Afrim Tahiri, duke nënvizuar edhe një herë fuqishëm se, me BFI-në nuk guxon as të mendojë shteti që të tallet ndonjëherë por, githnjë duhet të jetë edhe në shërbim të BFI-së.

Kjo ka qenë politika e BFI-së atëbotë, shteti, organet shtetërore, pushteti e partitë, që të gjithë të kuptojnë se, janë pararojë e mirëqenies, paqes dhe sigurisë së qytetarëve, të sovranit por edhe të institucioneve shpirtërore të këtij sovranit që funksionojnë brenda kufijve të shtetit të përbashkët.

Po sot?! Sot, çfarë BFI-je kanë myslimanët?

Një BFI të partizuar, me eksponantë të shërbimeve sekrete, që funksionon si “sahati hoxhës”! Kur t’i urdhërojnë të mblidhen në Gostivar dhe të kontribuojnë që BFI-në ta lënë në duart e pushtetit maqedonas, të gjithë këta eksponante tubohen, e kryejnë detyrën partiake dhe, shndërrohen edhe më fuqishëm në element shantazhimi. Këtu merr fund gjithçka! Këtu merr fund edhe BFI-ja! Hoxhallarët duhet t’i zbatojnë vendimet e shërbimeve sekrete që sillen brenda mureve të BFI-së si objekt! Shumë rëndë, shumë trishtim, shumë turp. O, si do të dilet para Allahut Fuqiptotë dhe para Muhamedit a.s. Mjer ata që, duke i pasur mësimet e Pejgamberit tonë, shkajnë dhe bëhen dishepuj të Dragoviqit, Temellkos, Mijallkovit...

## Fis i kyçur në arkivolin e harresës

**Pa i dedektuar defektet e shoqërisë, sikundër, pa i kqyrur plagët e trupit, nuk do të mund ta aplikojmë dhe ta përdorim kurën e saktë. Pa qenë të hapur e të sinqertë me vetëveten dhe me shoqërinë, nuk mund të dalim në fund të nderuar. Lumë ata që dalin “të nderuar në sy të Allahut,”69:33**

### Shkruan Afrim Tahiri

Këto ditë kam lexuar nja dy-tre shkrime nga autorë të nderuar e që i njoh mirë! Shkrimet e tyre reflektojnë zhgënjim, hidhërim, pezëm, mospajtim, revoltë, qortim, kundër institucionit hoxhë që e kemi me bollëk këtu në Maqedoninë e Veriut!

Pse ky qëndrim kaq nihilist në raport me hoxhallarët! Ku çalon problemi! Akuptohet drejtë nocioni hoxhë! Çka do të thotë hoxhë. Cilat janë obligimet dhe cilat janë detyrat konkrete të hoxhës! Pse sot nuk kemi hoxhë të kalibrit të Hoxhë Tahsinit, të Hoxhë Vokës, Hoxhë Vehbi Dibrës, Hoxhë Sherif Langu, Ibrahim Dalliu, Mulla Idriz Gjiani e një varg të tjerësh që lanë gjurmë si në historinë islame të trojeve tona ashtu edhe në historinë kombëtare! Dhe, kur ta mendoshë, të gjithë këta personalitete historik, këta intelektualë të devotshëm, dolën e vepruan në periudha më të rënda të historisë së popullit tonë.

Këta HOXHALLARË kishin vizion, këta personalitete e dinin se nuk e kishin mision vetëm të mësuarit e abdestit dhe të faljes së namazeve; këta burra të dheut kishin ideal; e dinin fort mirë që, të qenurit hoxhë, do të thotë të jeshë prijës i një safi, i një xhemati, i një katundi, i një lëvizje kombtare; e dinin fort mirë se, të qenurit hoxhë, do të thotë çuarje në vend të amanetit të Zotit; e kishin shumë të qartë se, të qenurit hoxhë, do të thotë të jeshë pararojë e pathyeshme e parimeve të fesë, zbatues i paluhatshëm i Ligjeve të Zotit, respektues i denjë i institucioneve fetare, luftëtar i pathyeshëm i idealeve kombëtare; ata ishin më se të bindur se, të qenurit hoxhë, do të thotë të mos jeshë shërbtor i armikut, do të thotë ta kultivoshë të mirën, dashurinë për fe e për atdhe, dhe ta luftoshë pa kompromis çdo kolaboracionist i cili pret kundërshtëpërblim avancimin në karrierë si dhe një grusht metalikësh të pistë.

A i kanë këto sifate hoxhallarët tanë sot, këtu, në Maqedoninë e Veriut! Nuk është mirë të gjeneralizohen! Ka, pa dyshim, madje shumë të mirë, shumë të dashur, shumë të respektuar por, fatkeqësisht, të ngulfatur e të djegur nga “kolegët” e tyre të diskutueshëm, nga ata që e kanë njollosur deri në turpësi këtë profesion kaq të shenjtë. Vetëmse, gjithnjë ngelë i pakuptueshëm mosreagimi i tyre, ngelë e pakuptueshme heshtja e tyre, ngelë i pakuptueshëm rehatllëku i tyre karshi dukurive që kanë pllakosur mbi myslimanët tanë si dhe mbi islamin në këtë nënqiell, duke na çnderuar deri në palcë dhe, me këtë, duke na i mbyllur të gjitha shtigjet për të dalur të pastër e të ndershëm në sy të Allahut të Gjithëdëshëm!

Për momentin, në ofensivë është një “komunitet” hoxhallarësh shumë akitivë si dhe një komunitet tjetër hoxhallarësh tepër pasivë të lidhur me pranga të shantazhit. Njoh shumë, shumë, shumë “hoxhallarë” të sotshëm artificialë të çertifikuar nga një rus bodrumeve të nëntokës siriane! Njoh “hoxhallarë” të çertifikuar falls edhe nga një rus tjetër që bënte jetë katakombëve egjiptase! Ky lloj hoxhallarësh janë në ofensivë, të trajnuar e që menaxhohen nga soji tjetër i “hoxhallarëve” të çertifikuar nëpër shërbime të llojit të UDB-së.

E gjatë është lista e këtyre “hoxhallarëve” të çertifikuar me diploma false e të kontrabanduar në mesin e xhemaatlinjëve tanë, të cilët, do të gjejnë rehatinë e vet shpirtërore vetëm pasi të çlirohen prej tyre, duke ua publikuar emrat, mbiemrat, veprimtarinë dhe “shkollat” prej nga kanë dalur! Mbase edhe së shpejti mund të botohet kjo listë e gjatë, vetëm për hirë të xhemaatlinjëve tanë të devotshëm. Sepse, nuk e meritojnë që të “drejtohen” prej hoxhallarëve të cilëve nuk po ia dalin t’ua gjejnë imanin! Ua kanë gjetur “shkollat”, ideologjitë, misionet, çertifikuesit kontrabandistë por, hala nuk o arrijnë t’ua gjejnë imanin! Po pyesin: bre, a kanë iman a jo!? Me shall po, me xhube po, me kravatë po, të bukur sa të duash, të “mençur” me bollëk, por, problem – si t’ua gjeshtë imanin!

Fatkeqësisht, sot kemi edhe hoxhallarë të atillë që me vullnet janë kategorizuar secili ku ka gjetur interesin e vet meskin!

Kemi “hoxhallarë” të Aleancës e të Alternativës që paguhen nga Turqia por edhe nga Irani!

Kemi hoxhallarë të LSDM-së, BDI-së e të Besës që paguhen nga Arabia Saudite! Kemi “hoxhallarë apartiakë” që paguhen nga Izraeli e nga Pakistani, nga Avganistani e nga Rusia që, përgjithësisht, janë logjistikë e “ushtrisë së djallit”!

Është i pamohueshëm fakti që, tërë ky aktivitet ushtrohet fshehurazi, është sekret publik pagesa e tyre nga këta qendra dhe, së këndejmi, është i pamohueshëm edhe fakti se, do t’i shërbeshë me patjetër atij që të paguan “fshehurazi”.

Të paguan UDB – UDB-së do t’i shërbeshë, pa dyshim! Nuk ka paga pa raportime mujore e vjetore për aktivitetet që i ke kryer e me të cilat ke qenë i ngarkuar! Një listë e hoxhallarëve të paguar nga Arabia Saudite, ka ekzistuar edhe në BFI dhe, ka qenë njeriu i caktuar që i ka mbledhur dhe që i ka dërguar në qendrat saudite raportet e këtyre hoxhallarëve për aktivitetet që i kanë kryer në përhapje të ideologjisë së atij që ka paguar!

Vetëm këto “digastere të ushtrisë së djallit” mundet që të urdhërojnë që, brenda natës të tubohen “këlyshët” e vetë dhe, të komplotojnë e të kryejnë puç të heshtur, duke ua garantuar paraprakisht heshtjen e të gjithë “hoxhallarëve” që jetojnë e veprojnë nën peshën e papërbalueshme të shantazhit. Deri te një mbledhje ka procedurë, ka përgatitje, ka faza, ka sërë elementesh që i japin peshë dhe legjitimitet atij takimi, asaj mbledhje. Me urgjencë e me një urdhër mund t’i tubojë vetëm shërbimi sekret, i cili, natyrisht, ka arsyen dhe strategjinë për atë mbledhje që do të rezultojë me komplot të sukseshëm.

Tani jemi në fazën kur po thirren dhe po urdhërohen hoxhallarët që të shkojnë te “reisi” dhe t’ia urojnë, t’i shprehin përkrahje, ngjashëm si Stanko Dragoviçi! Pra, hoxhallarët e depersonalizuar duhet të shkojnë e të rrefehen te “kryepari” i tyre dhe të nisin të ndërtojnë një komunitet të ri – komunitetin e “të ndershmëve”, të pandershëm në sy të Allahut të Gjithëdishëm! Deri sa të binden hoxhallarët që të solidarizohen me misionin e “reisit”, ky ka se kë të ftojë dhe ta regjistrojë si “aktivitet të bujshëm”; do ta thërrasë dajën, kushëririn, axhën, nipin! Takimet familjare, takimet me nxënës, me studentë, me të punësuar, i regjistron publikisht, si aktivitete! Si ndryshe të preket fundi i turpiti?

Askujt, asnjë hoxhe të ndershëm nuk i shkohet në atë “shtëpi” ku shkilet Kushtetuta, ku injorohen aktet normative, ku refuzohen parimet islame, ku tradhëtohet tradita dhe e kaluara, ku instalohen “gjeneral e oficerë të ushtrisë së djallit”, ku legalizohet hajnia, tradhëtia dhe shëmtia.

Hoxhallarët, si asnjë profesionist tjetër, kanë forcën, kurajon dhe vullnetin për t’i këputur prangat e shantazhit dhe, kur të vie ky çast, nuk ka digë që mund t’u dalë përballë; nuk ka shërbim sekret, pushtet e parti që mund t’i shantazhojë, t’i frikësojë, t’i heshtë. Për hoxhallarët, gjithnjë e mbi gjithëçka ka qenë feja dhe një popull i denjë për atë fe. Honxho bonxhot ngelin vetëm si fjalë goje, ngelin pa nam e nishan, fis i vdekur e i kyçur në arkivolin e harresës...

*(In7.tv, 2.04.2021)*

## A kuptoi diçka Shaqir Fetai

**Këto ditë, në disa portale u botua një intervistë e Afrim Tahirit, drejtuesit të Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI, të cilën, në cilësinë e sekretarit gjeneral të BFI-së ia kishte dhënë të përditshmes “Vest” qysh më vitin 2013! Paraprakisht u tha se intervista do të publikohet enkas për Shaqir Fetain! Çka kuptoi nga ky “gjest provokativ” Shaqir Fetai? Cili ishte mesazhi i ripublikimit të kësaj interviste?**

<http://kombetare.com/afrim-tahiri-bashkejetesa-nuk-sigurohet-vetem-permes-reklamave/>

### Shkruan Abaz Islami

Argumenti i parë, bazuar në deklaratën e ish-reisit, Sulejman ef. Rexhepit: “Në insistimin e largimit të Afrim Tahirit nga BFI-ja më këmbëngultësi dhe më zhurmuesi ishte Shaqir Fetai” dhe, argumenti i dytë, Intervista e Afrim Tahiri, Sekretar gjeneral i Bashkësisë Fetare Islame, me titull “BASHKËJETESA NUK SIGUROHET VETËM PËRMES REKLAMAVE”, botuar në gazetën “Vest”, 25-26 maj 2013/ faqja 11, 12, 13, – më mjaftojnë që ta plotësoj tërë atë mozaik që do të ma shpjegonte arsyen e dëbimit të Afrim ef. Tahirit nga BFI-ja qysh më 2015, një vit e gjysëm pas përjetimit fjasko të konferencës botërore për dialog ndërkonfesional!

Është fakt i pamohueshëm se, në kohën e Afrim Tahirit, kur ky ishte sekretar gjeneral, punët kanë rrjedhur ashtu siç i ka planifikuar Rijaseti i BFI-së dhe ashtu siç ka qenë më së miri për fenë islame dhe për myslimanët e vendit. Kjo politikë natyrisht nuk ka qenë konformiste por, ka rënë ndesh politikave nacionaliste dhe raciste maqedonase në raport me Bashkësinë Fetare Islame.

Është fakt i pamohueshëm se në atë kohë reisul ulema i BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi, kishte një shtyllë të palëkundur e të papërkulur, Afrim ef. Tahirin, në të cilën ai i mbështeste politikën autonome dhe origjinale të Institucionit që po e drejtonin!

Vetëm Afrim Tahiri ka guxuar që ta minimizojë deri në mohim total një konferencë ndërkombëtare që organizohej nën “ombrelën” e Nikolla Gruevskit, i cili në krye të shërbimit sekret kishte njërin prej “din-dushmanëve” të shqiptarëve dhe, përgjithësisht, të myslimanëve, Sasho Mijallkovin!

Është fakt i pamohueshëm se Afrim Tahiri ua ka bërë me dije si politikanëve nacionalistë maqedonasë ashtu edhe post-enveristëve shqiptarë që po qeverisnin vendin se, nëse nuk plotësohen kërkesat e myslimanëve të vendit artikulluar përmes BFI-së, atëherë vështirë se do të ketë jo harmoni fetare në shtet por, as shtet jo!

Është fakt i pamohueshëm se për herë të parë nga qeveria e Maqedonisë ka ardhur dokumenti se, dekord, pajtohemi të ulemi, të bisedojmë e të caktojmë dinamikën e ndërtimit të Burmalit Xhamisë!

Është fakt i pamohueshëm se, për shkak të lojërave të pandershme, për shkak të talljes me marrëveshjet e arritura paraprakisht për rindërtimin e Xhamisë në Prilep si dhe në Llazhec të Manastirit, u bojkotua Konferenca ndërkombëtare për dialog ndërkonfesional, ndërsa Afrim ef. Tahiri do të deklarojë se

“të kota janë sponsorimet në mediat botërore (CNN, BBC etj.) për Maqedoninë ndërkonfesionale e ndërnacionale, ndërkohë që parcela shtetërore i falen kishës ndërsa nuk lejohet ndërtimi i xhamisë në pronën tonë për nevojat e myslimanëve të lagjes Lisiçe”!

Zbërthimin e gënjeshtreve dhe të politikave iracionale siç i bënte Afrim Tahiri ndër mediat e vendit, ishin të papërbalueshme për pushtetarët që përpiqeshin të ndërtojnë karrierë në dëm të interesave të BFI-së!

Afrim Tahiri përmes kësaj interviste e ka zbërthyer pushtetin si grabitqare të parave të BFI-së, e cila ka paguar për ndërrimin e planit urbanistik, ka investuar në ndërtimin e Xhamisë së Prilepit, ndërsa vetëmsa është grabitur se, punët kurrë nuk kanë nisur në këtë drejtim.

Është Afrim Tahiri, i cili, para syve të Tair Hanit ka shkundulluar Mile Janakievskin, ministrin e Transportit dhe Lidhjeve, duke i thënë që t’i bëjë të fala Gruevskit se edhe ai është njeri, i cili, sot është nesër mund të mos jetë në këtë dynja dhe nuk është mirë që e injoron interesin e gjysmës së popullatës së vendit!

Është fakt i pamohueshëm ajo që mediat e vendit kanë folur me gjuhën e shërbimit sekret maqedonas duke konstatuar se Afrim ef. Tahiri është koordinuesi i punëve i të gjitha shërbimeve profesionale në BFI si dhe gardë e pathyeshme në zbatimin e politikave autonome Institucionale të BFI-së! Kërkesë këmbëngulës i parcelës për rezidencën e BFI-së në Kala të Shkupit. Ankues i pazbrapsur madje duke ua bërë me dije se do të ankohet si BFI në instancat më të larta gjyqësore ndërkombëtare nëse në afat sa më të shkurtër nuk do të kthehet prona e nacionalizuar e vakëfit të BFI-së. Ja pra, ja arsyet se pse ndër qarqet e caktuara të pushtetit, në veçanti nga ana e shërbimeve sekrete, është dashur të nisë skenari i largimit të Afrim Tahirit nga BFI- ja! Dhe, sot, prandaj minjt e BFI-së hedhin valle! Sepse u largua Afrim Tahiri, nën presionin e kërkesës së zjarrtë të Shaqir Fetait ushtruar mbi ish-resin që ta largojë sa më parë, sepse, ky ka qenë momenti që e kanë ndjerë “këlyeshët” e Dragoviqëve, që të nisë së brendshmi dobësimi, defaktorizimi dhe shkatërrimi i BFI-së!

Është fakt i pamohueshëm se, në vend të Afrim ef. Tahirit, sekretar gjeneral promovohet Irsal Jakupi, i cili, nisur nga një “bombë” e publikuar, nga ato “bombat e Zaevit”, që në start do të promovojë “politikat” e vjedhjes së haxhit, shkatërrimit të BFI-së!

Të gjithë ata që u rreshtuan në anën e shërbimeve nëntokësore maqedonase për ta larguar Afrim Tahirin dhe, së fundmi, edhe Sulejman ef. Rexhepin, sot i ke të rreshtuar pas Shaqir Fetait, i cili, në çdo ditë të lume që e falë Allahu Fuqiplotë, e shkelë Kushtetutën e BFI-së si dhe aktet e shumta normative të këtij Institucioni. Në një shtet normal, Shaqir Fetai pensionimin e vet do ta priste përtej grilave të burgut. Natyrisht, për shërbëtorë e për bashkëpunëtorë të “shërbimeve speciale” kurrë nuk ka pasur, nuk ka dhe nuk do të ketë bug. Të “burgosur” mund të jenë vetëm ata që ia turbullojnë ujin “dërzhavës”!

Po flitet se edhe sivjet do të organizohet konferencë ndërkombëtare për dialog ndërkonfesional dhe se, mezi po pret ftesë Shaqir Fetai, sepse tashmë ka deklaruar se do të jetë një shans i mirë për ta promovuar veten “reis” para “botës”! Ç’paradoks! Dikur Afrim Tahiri organizimet e tilla i shihte si shans i mirë për të kushtëzuar pjesëmarrje me një “koncesion” në të mirë të BFI-së dhe të myslimanëve të vendit, kurse Shaqir Fetai i sheh si shanse të mira për t’u promovuar si “reis”!

Dua këtu të nënvuzoj edhe dy fakte të pamohueshme:

1. Afrim Tahiri ndonëse u dëbua nga BFI-ja, ndonëse kundër tij u zhillua një propagandë institucionale të nxitur, sipas Sulejman ef. Rexhepit, nga Shaqir Fetai, megjithatë efendi Tahiri sot është ndër teologët më të respektuar në vend, më të dashur e më të përshëndetur, madje keqardhje i shprehin edhe armiqtë që dikur ranë nën ndikimin e Shaqir Fetait për ta bindur Sulejman Rexhepin që ta largojë nga BFI-ja!

2.Një ditë të afërt, kur do të dëbohet Shaqir Fetai nga BFI-ja, a do ta gëzojë këtë respekt siç e gëzon Afrim Tahiri! Kurrë! Esat Pashë Toptani ka zhvilluar një luftë të ashpër gjashtëmujore kundër forcave malazeze që ia kanë mësyer pushtimit të Shkodës! Një luftë të tillë nuk e ka bërë askush që nga Skënderbeu e deri te Esat Toptani! Historia ia ka njohur një meritë të tillë deri në momentin kur zbardhen dokumentat se, Esat Pashë Toptani është përkrahur dhe është ndihmuar në karrierë nga mbretëria serbe! Këlyshë të serbëve nuk ke sot në faqet e lavdishme të historisë sonë kombëtare e fetare.

**P. S.**

Në prag të Muajit të Ramazanit, kur edhe shtohen aktivitetet fetare islame, qeveria me komisionet e veta solli vendim për orë policore që pamundëson kryerje të ibadeteve të shumta në xhami apo në xhemate! Ibadetet t'i caktojnë politikat e Zaevit! Kurse, reagimi i Shaqir Fetait ishte: “ËSHTË E VËRTETË SE NEVE NUK NA ERDHI MIRË KJO, POR JA QË KOMPETENTËT JANË ATA TË CILËT VENDOSIN PËR KËTË ÇËSHTJE DHE NE GJITHMONË DO TË JEMI NË SHËRBIM TË ASAJ QË TË ZUBTET SITUATA, TË DILET NGA KJO SITUATË.”

Shaqir Fetai nuk ka, nuk mund të ketë dhe as që guxon të ketë politika autonome për situata të tilla, porse, pret që t'i diktojnë të tjerët se çfarë të veprojnë! Sepse, e di që, në çfarëdo kundërshtimi apo mospërshtatje me politikat sllave, shkon në të sëmës, dëbohet si Afrim Tahiri e Sulejman Rexhepi. Ishalla nuk i shkon në mend Zoran Zaevit që të urdhërojë mosagjërim. I pari që do t'i përgjigjej këtij urdhëri do të ishte Shaqir Fetai! Sepse, për të më i rëndësishëm është posti i kontrabanduar i “reisllekut” se sa parimet islame si dhe ineresi i përgjithshëm islam. Ky fakt tashmë është dëshmuar katërcipërisht. BFI-ja me Shaqir Fetain ka po atë peshë të “anijeve antike”-restorant, në Vardar, të cilat, fatmirësisht po demontohen, sepse, rrezikojnë përmytje! Kështu u tha!

*(Telegrami, 7.04.2021)*

## Universiteti i Sarajevës, varri moral i Shaqir Fetait

**Shaqir Fetai e ka një peng: si mund të sigurojë një dokument nga Universiteti i Sarajevës se ai nuk ka qenë bashkëpunëtorë i UDB-së derisa ishte student i këtij Universiteti! Natyrisht, ai e ka shumë të qartë se universiteti nuk lëshon vërtetime nëse ke qenë apo jo, por, ja që shpreson se, përmes mysafirëve sa më të shpeshtë nga ky Universitet do të krijohet një përshtypje se, ja, Shaqir Fetain e do Universiteti i Sarajevës, ndryshe, sikur të ishte udbash, nuk do t'i vinin në vizitë! Dosja e tij është midis Beligradit**

Ka plotë persona që mezi presin të jenë të ftuar dhe t'u mbuloen shpenzimet e udhëtimeve nëpër vende të caktuara. Deri më sot, mysafirë të BFI-së së Shaqir Fetait më së shumi ka pasur nga Sarajeva! Dikur, edhe një kolegë i tij, pararendësi i tij nga Gostivari, desh u çmend deri sa siguroi nga një institucion "irrelevant" një dokument se nuk ka qenë asnjëherë bashkëpunëtorë i shërbimit sekret maqedonas! Dhe, pasi e siguroi një dokument të tillë, u rehatua! Dokumenti nuk ta zhduk dosjen policore, sepse ajo ruhet edhe gjetiu, për më tepër tani në kohën e digjitalizimit të dokumentave të ndryshëm, përfshirë këtu edhe dosjet policore! Një dokument të tillë e siguroi edhe Llatasi nga Gordana Jankulovksa, por, u vërtetua se as policia nuk është kompetente për dokumente të tillë nëse ke qenë apo jo udbash!

Pse paskan ardhur këta mysafirë nga Universiteti i Sarajevës (nja dy profesorë të kotë)?! Paskan ardhur që të marrin eksperiencën nga Shaqir Fetai se si luftohet ekstremizmi fetar?! Shaqir Fetai di t'i luftojë ekstremistët vetëm përmes spiunimit të tyre, ndryshe ai nuk di, nuk ka eksperiencë, nuk ka përvojë, nuk ka plan dhe as strategji! E vetmja aftësi e tij profesionale është gjuajtja e ekstremistëve dhe spiunimi i tyre. Kaq!

Ndryshe, është e udhës që përfundimish Shaqir Fetai të heq dorë nga gënjeshtria, të mos tallet me mysafirë dhe me faktorë relevantë ndërkombëtarë, të mos i rrejë ata, sepse, Shaqir Fetai nuk ka bërë as më të voglin veprim në luftë kundër ekstremizmit dhe terrorizmit fetar! Shaqir Fetai nuk di të tregojë se cilat ishin ato masa që i paska ndërmarrur. Nuk di të na tregojë se sa ligjerata fetare i paskan mbajtur hoxhallarët e vendit kundër kësaj dukurie! Nuk di të na ofrojë kurrfarë evidence në këtë drejtim, kur u mbajtën ato ligjerata, ku u mbajtën, kush i mbjti! Ja, publikisht po e pyesim: kush nga "ekspertët e BFI" kundër radikalizimit dhe terrorizmit fetar u mbajtën ligjerata "profesionale" hoxhallarëve të anës jug-perëndimore të vendit, atje ku nuk ka shansa as minimale të paraqitet ndonjë dukuri e tillë!

Shaqir Fetai flet se paska arritur suksese dhe se këtu duhet të vijnë të marrin eksperiencë edhe vendet e tjera, ndërkohë që, tash e katër vite, as në Kosovë, as në Bullgari, as në Greqi, as në Shqipëri, as në Serbi, as në Mal të Zi, as në Luginën e Preshevës, as në Sanxhak e as në Bosnjë nuk ka pasur asnjë dyshim policor e jo më të ketë të arrestuar persona të rrezikshëm që kanë ushtruar aktivitetet ekstremiste e terroriste në emër të fesë!

Në Maqedoninë e Shaqir Fetait brenda këtyre katër viteve ka pasur dy herë arrestime të personave të rrezikshëm, të cilët janë pjesë e nje xhemati që ka xhaminë e vet, që ka hoxhën e vet, që ky hoxhë ka influencën e vet, ka grupin e vet, ka kolegët e vet, madje që shtrihen edhe në vetë Bashkësinë Fetare Islame të Shaqir Fetait. Madje, grupi i fundit, i cili akoma është nën hetime, është provuar se ka pasur poligonin e vet për ushtrime terroriste në Kumanovë, ka pasur armatimin e vet, ka pasur mjete e pajisje për përgatitjen artizanale të bombave e të eksplozivëve shkatërrimtare.

A e ka përmendur ndonjëherë këtë rast Shaqir Fetai? Jo, natyrisht! Sepse, policia dhe shërbimet sekrete heshtin, nuk flasin por, veprojnë!

Veprojnë si urith! E keni parë Shaqir Fetain? Lë përshtypje se ai po kalon kohë duke pritur e përcjellë kushërirët e vet, nipërit e vet (ka nga ata plotë që kanë qenë dhe janë udbashë), pret njerëz të kotë, pret trajnerë futbolli, pret avokatë, kirurgë, lustraxhi këpucësh, ndërkohë që “kabinetin” e ka përplotë bashkëpunëtorë të shërbimeve intelegjente të vendit dhe ndërkombëtar, përmes të cilëve i shantazhon organet dhe institucionet e BFI-së! Secili i ka pesë minutat e veta! Edhe udbashët, po! Po pastaj?

*(Lajme7, 8.04.2021)*



## Shkretëtira e aktiviteteve të Shaqir Fetait të shkretë

Shaqir Fetai vazhdon të shesë mjegull në ditë me diell. I pacipë, i pandershëm, imoral deri në palcë, ai tallet me myslimanët e vendit. Të devotshmit nuk merren me të, shtrësia intelektuale e injorojnë si debil, ndërsa ky – zgjate Zot. Javën e muajit prill e filloi duke u përpjekur që t’ua ofendojë intelegjencën myslimanëve – punën e injorantit mundohet ta shesë si vlerë! Ky është kapaciteti i tij moral i cili degjeneron çdo kod fetar, kombëtar, shoqëror. Pas vdekjes së turpit, e para që lind është tradhëtia

Nga Jasir Jashari

1

Ish-babai shpirtëror i Shaqir Fetait, Sulejman Rexhepi, e kishte pranuar nja dhjetra herë në zyrë, të ngratin, njëfarë Afrim Mustafa, i cili, sa herë që i duheshin para, vinte te efendi Rexhepi dhe ia linte nja 10-15 libra prej “Bardhësitë e Atdheut”, që t’ia shesë dikush në BFI, ndërsa Sulejman ef. Rexhepi ia jepte paraprakisht paratë. Ky gjest i Afrim Mustafës përbënte një hendikep neveritës për Sulejman Rexhepin dhe asnjëherë nuk e ka regjistruar si palo-aktivitet, kurse për Shaqir Fetain përbën aktivitet jetik, sepse në zyrë i ka ardhur një “intelektual i UÇK-së” dhe, mbase me këtë Shaqir Fetai do të amnistohet nga e kaluara e tmerrshme e tij! U çu halla ta mbyllë derën me shull!

2

Vjen një informatë nga më banalet, nga më idiotiket, nga ato që as nxënësit e shkollave fillore nuk i publikojnë në gazetën e murit! Një informatë që e vulosë nJORANCËN e një Institucioni të tërë! Publikohet një informatë ku shërbimet profesionale të BFI-së, apo, tërë BFI-ja del si një shtab i piarit të ish-deputetit (me nja 100 persona që kam biseduar askujt nuk i kujtohet se ky person paska qenë ndonjëherë deputet!) Muhamed Tahiri dhe anëtarëve të familjes së tij! Ish-deputeti paska qëndruar në BFI.! Lajmi vijon: “Në takim, ish-deputeti prezantoi për të biseduar me Reis Ulemanë...” Ju duket fjali kjo? Shqip? Nuk ju duket fjali e një informate idiotike? Dhe, këtu nis një strategji edhe më idiotike e Shaqir Fetait! Meqë askush nuk po e lavdëron, seps puna e tij prej tradhëtari nuk mund të lavdërohet, puna e tij prej shkelësi të Kushtetutës së BFI nuk mund të lavdërohet – atëherë, Shaqir Fetai zgjedh obsion vetëlavdërimin. Tutje, thuhet: “pasi shprehi kënaqësinë e tij për mënyrën si Bashkësia Fetare Islame është duke funksionuar pas zgjedhjes së H. Hfz. Shaqir ef. Fetait në detyrën e Reisit”!!! Madje, të njëjtën frazë vetëlavdëruese ka filluar ta nënvizojë në çdo pseudoinformatë që ka të bëjë me vizita të kota. Qytetarët nuk e urojnë më por, shprehin habi, shprehin befasi se si po funksionon BFI pas zgjedhjes së tij “reis”! Në fakt Shaqir Fetai kurrë nuk u zgjodh, por, u luajt loja se “u zgjodh”, sepse ai paraprakisht u instalua në BFI nga pushteti aktual maqedonas, kurse me instalimin e tij BFI-ja përjetoj dhe po përjeton një nga periudhat më të turpshme të saj! BFI-ja sot, me instalacionin e quajtur Shaqir Fetai, është e depersonalizuar, është e defaktorizuar, është Institucion për turp... Pastaj, maja e gënjeshtres, e paftyresisë, maja e talljes së Shaqir Fetait! Ish-deputetin dhe familjen e tij e paska informuar me planet për muajin e Bekuar të Ramazanit! E ka informuar mbretin ndërsa mbreti miletin! Asnjë mysliman në këtë vend nuk është i njohtuar me ndonjë

plan të Shaqir Fetait për Ramazan! Po çfarë “plani” na qenka ai që duhet të mbahet sekret nga populli ndërsa të njohtohet vetëm përfaqësuesi i popullit! Dhe, katër ditë më vonë, vjen vendimi për orë policore dhe krejt “plani” i Shaqir Fetait bëhet nul! Shaqir Fetai nuk ka plan tjetër alternativ, sepse – ku di Shaqir Fetai se çka është plan e çka projekt, çka aktivitet rutinor e çka plan aksional javor, mujor e vjetor. Fusharakut të mjerë edhe shkretëtira i duket fushë. Dhe fare në fund të informacionit, njohtohemi se në BFI-në e Shaqir Fetait, pa kurrfarë vendimi të Rijasetit, pa kurrfarë mështetje në Kushtetutë e në sistematizim të vendeve të punës, na funksionuaka “sektori Administrativo-Juridik”! Një shkelje kushtetuese flagrante e Shaqir Fetait, një injorancë e tij, një dëshmi se ai nuk ka lidhje me funksionimin e administratës! Nuk mund të ketë sektor pa njësi! Dy e më shumë njësi që trajtojnë çështje të disiplinave të një fushe përbëjnë një sektor. Njësitë kanë udhëheqësit e tyre që udhëheqin punët e të varshmëve të tyre. Mbi këta udhëheqës është drejtori, apo, kordinatori, apo udhëheqësi, apo përgjegjësi i sektorit! Një instiucion me disa sektore, në çdo sektor nga një përgjegjës që udhëheqin me vetëveten! Kjo mund të ndodhë vetëm në “institucioin” e Shaqir Fetait!

### 3

Një teolog paska shkruar libër dhe paska vendosur t’ia japë kopjen e parë “udhëheqësit të të gjithë myslimanëve të vendit”, Shaqir Fetait! Shaqir Fetai nuk paraqet asgjë tjetër përveçse “instalacion qeveritar maqedonas” në BFI! Shaqir Fetai nuk është i pranueshëm si “kryepar” në katundin e vet e lëre më në vend! Shaqir Fetai dhe Shaqir Fetahat e vockël në BFI a i lexojnë more komentet, a nuk shohin se në çdo paraqitje të tij bombardohet me komente nga më ofendueset prej myslimanëve gjithandej vendit! A ka familje Shaqir Fetai, a i vie keq prej fëmijëve të tij, a nuk i vie inatë nga familja e gjërë e nga farefisi për ato qindra e mijëra komente plotë sharje dhe ofendime që i shkruajnë myslimanët për të! A e di Shaqir Fetai se në çfarë pozitash i ka nxjerrë fëmijët e vet, miqtë e tij, familjen e tij! Ky bën “reisllëkun” ndërsa myslimanët e vendit e shajnë me gjithçka që ka! Boll keq! Po, mirë t’i bëhet atij që kërkon ta kruaj me gjethe fiku! Po si mos të shahet Shaqir Fetai kur ai mundohet që të bëjë karrierë me punën e huaj! Ai e nxjerr aktivitet personal veprën e tjetrit! Diçka edhe më rëndë se plagjiatura, diçka edhe më rëndë se kompilacioni, diçka edhe më rëndë se sa t’ia vjedhish tjetrit djersën. Autori ka shkruar libër dhe kjo nuk përbën lajm! Lajm të gëzueshëm përbën fakti që autori paska zgjedhur që ekzemplarin e parë t’ia dorëzojë “reisit”! Dhurimi i librit është një gjest personal, një shprehje respekti i mikut për mikun, një ndarje e gëzimit në mes miqësh dhe – ku është këtu lajmi? Ku është këtu aktiviteti? Ku është këtu pranimi i tjetrit si “udhëheqës i krejt myslimanëve”! Shkoni more në rr.s.

### 4

Specialisti i kirurgjisë torokale e paska vizituar Shaqir Fetain! Në fakt, këtij nuk i paska shkruar kurrë në mend që ta ndër marrë një hap të tillë me vetëiniciativë. Ka ardhur te Shaqir Fetai pasi që ky e ka ftuar t’ia japë një kafe, ta nderojë si mjek! Dhe, sakaq publikohet hilja e Shaqir Fetait, po ajo hile të cilën po e përgatitë me shumë njerëz, me shumë teologë, të cilët po i fton për të qarë një dert a një hall dhe ky pastaj bën lajm se u vizitua dhe iu shpreh “mirënjohja se si po e drejton BFI-në”! Pordha të ftohta të cilat mund t’i përprijë vetëm Shaqir Fetai! Dhe, në hile gjithnjë del injoranca e hilexhiut,

djallëzija e tij, del pislleku i tij! Me specialistin në fjalë paskan “shkëmbyer mendime dhe përvoja të ndryshme...”! A e kuptoni se çfarë “mrekullie” ka ndodur?! Specialisti i kirurgjisë torokale ka shkëmber përvoja me BFI-në, gjegjësisht me Shaqir Fetain dhe, anasjelltas! Epo kur idiotizmi shpërthen kufinj të e vet, fundin duhet ta ketë në çmendi!

## 5

Shaqir Fetait i vie shumë keq se si qeveria maqedonase ia futi dy këmbët në një këpucë! Hej, qeveria maqedonase, instaluesja e instalacionit (Shaqir Fetait) në BFI, ia ngushtoi punët! Orë policore për Ramazan dhe, me këtë, ia prishi të gjitha “planet” Shaqir Fetait, të ngritura mbi shtatë-tetë pikët e miratuara në mbledhjen e parë dhe të fundit të “Rijasetit” të Shaqir Fetait. Po, mos të harrojmë, në atë mbledhje u vendos që të gjithë myftinj të, imamlerët dhe “sektori i diasporës” të angazhohen që të kërkojnë sa më shumë nga shqiptarët dhe nga myslimanët që të regjistrohen, pra, të zhvillojnë fushatë për regjistrimin e popullatës që do të nisë e kryhet përgjatë Muajit të Ramazanit! Shaqir Fetai nuk e mbajti më një mbledhje të dytë për ta “abroguar” këtë vendim, meqë regjistrimi u shty për në shtator! Nuk u informua as diaspora e cila po përgatitej që të presë mysafirë nga BFI-ja, sepse Shaqir Fetai ishte lavdëruar se do të dërgojmë delegacione të veçanta nëpër diasporë me qëllim për t’i nxitur që të regjistrohen bashkëatdhetarët tanë dhe ky aksion të dalë sa më i suksesshëm! Por, VMRO-ja i turr me “sus”! A nuk është kjo përpjekje e hajnit! A nuk është hajni? Aktivitetin e të tjerëve ta përvetësojë, ta personalizojë dhe nesër të mburret Shaqir Fetai se sa i suksesshëm na doli! Një jetë të tërë ka vepruar kësajsoj dhe karrierë ka bërë mbi dallavera amatoreske. Kryeministri si dhe kryetari i shtetit, nga të gjithë liderët fetarë kanë kërkuar kërkuar që të jenë shembull për besimtarët përkatës i respektimit të masave qeveritare për zbutjen e përhapjes së pandemisë. Kurse, Shaqir Fetai, jo që ka pranuar masa shtrënguese por, ka pranuar që të diskriminohet dhe të diskreditohet faqe krejt qytetarëve të vendit. Shikoni në foto të cilën e kanë publikuar edhe pinjollët e Shaqir Fetait në FB-un e BFI-së! Shikoni se në çfarë karrige ulet Kryetari i KOM-it e në çfarë karrige ulet “kryetari” i BFI-së! Selam nuses së dajës, i thonë kësaj pune! Tallje totale me Shaqir Fetain! A do ta përpinte një lojë të tillë Sulejman ef. Rexhepi? Do t’ia pëshurte takimin organizatorëve!

## 6

Shaqir Fetai ndërkombëtarët, veç të tjerash, i pret edhe me një person (Mustafa Dautin) të cilin e prezanton si “Drejtor i Sektorit për marrëdhënie me jasht (kontakte me faktorin ndërkombëtar: OSBE, BE dhe institucionet e brendshme)!!! Drejtor i marrëdhënieve të jashtme që mbanë kontakte me institucionet e brendshme!!! Dhe këto raporte pastaj i spiunon te BE, OSBE, NATO dhe anasjelltas! Sepse, në rastin konkret bëhet fjalë për marrëdhënie me shërbimet intelektuale dhe me ministrinë e punëve të brendshme të vendit! Edhe atë, kush? Cili? Mustafa Dauti! Vjedhësi i të gjitha ndihmave humanitare që nga viti 2015! Fukarai i cili, që nga viti 2015 e këndeje mund të llogaritet si një nga milionerët e Maqedonisë së Veriut! Mustafa Dauti për të cilin, vetë miqtë e tij dëshmojnë se iu është lavdëruar si bashkëpunëtorë shumë efikas policor! Po ç’lidhje ka ky me BE, me OSBE, me NATO? Ua di emërtimet e plota këtyre institucioneve që dalin me shkurtesë nga inicialet e fjalëve që formojnë Institucionin relevant ndërkombëtar? E përballë me të huaj duke ua prezantuar si magjistër! Ndërsa komisioni i formuar për shqyrtimin e fakteve që i publikoi revista italiane lidhur me plagjiaturën e disertacioneve të shumë punëtorëve shkencorë në UT-së, ka shtrirë aktivitetin e vet edhe në universitete të tjera dhe, hulumtimet flasin për një trishtim të paparë ndonjëherë në historikun e këtyre

trevave. Kanë kërkuar tërthorazi të dinë se si është situata edhe në universitetet private, pra, edhe në Universitetin Ndërkombëtar ku, vlojnë fallcifikati dhe plagjiaturat e tezave të doktoraturës si dhe të magistraturave. Në mesin e këtij “kuadri shkencor” të dalur nga ky universitet ka “specialistë” nga fushat e ndryshme, ka edhe teologë, si plagjiat përmendet edhe emri i Mustafa Dautit, tema e të cilit është zbuluar arkivave të institucioneve arsimore në Tiranë! Shaqir Fetai këtë mundohet të na e shesë si “specialist” edhe myslimanëve të vendit por, fatkeqësisht, edhe ndërkombëtarëve.

7

Kohën e fundit, Shaqir Fetai u trondit nga disa fakte që flisnin për raportet e tij katastrofale me hoxhallarët e vendit. Nuk ka hoxhë që ka një thërimë respekti për këtë farë instalacioni qeveritar! Për ta “përligjur” këtë fakt të pamohueshëm, keni parë se si kohëve të fundit Shaqir Fetai ka udhëtuar gati prej myftinie në myftini, duke kërkuar që të mbajë mbledhje me këshillat e xhemateve (vetëm në Gostivar ka mbajtr mbledhje me Kuvendin (!!!) e myftinisë së Gostivarit!!! Takim me hoxhallarë! Të takohemi dhe merremi vesh për Ramazan! Në takim i ka informuar imamlerët se kur nis agjërimi, kur është imsaki, kur falen vaktet dhe, aq! Këtë strategji e ka përdorur për të dëshmuar paramyslimanëve se, ja, të gjithë hoxhallarët më presin e më nderojnë! A ka pasur teolog në vend që ka shprehur respekt e dashuri ndaj Sulejman Rexhepit më shumë se Shaqir Fetai! Cili teolog në vend është lavdëruar me fjalë më pompozeng nga Shaqir Fetai, ashtu siç është lavdëruar Sulejman Rexhepi! Para kujt është përkulur Shaqir Fetai më shumë se sa para Sulejman Rexhepit? A ka pasur bashkëpunëtorë apo teolog në vend që nuk e kanë dashur Sulejman Rexhepin me po aq dashuri sa Shaqir Fetai! A mund të duhet ndonjëherë Shaqir Fetai vetëm një për qind sa është dashur e sa është respektuar Sulejman Rexhepi? A mund ta gëzojë përkushtimin e bashkëpunëtorëve të vet vetëm një për qind sa e gezoj nga ata Sulejman Rexhepi? Dhe – në fund – Shaqir Fetai, ky më i dashuri i Sulejman Rexhepit, ia nguli thikën pas shpine “babait të vet shpirtëror”, Sulejman Rexhepi! Doli puna që krej ajo dashuri dhe ai respekt paska qenë kamuflim i urretjes së terrshme që e paskan pasur kundër Sulejman Rexhepit. Pikërisht e tillë është edhe “dashuria dhe respekti” i teologëve të vendit ndaj Shaqir Fetait. Çka të mbjellish atë do të korrësh, oj nusja e dajës!

*(Botapress, 9.04.2021)*

## Shaqir Fetai apelon: “hajde t’lujna teze” për Ramazan

**E vetmja temë që është provokative dhe që duhet të trajtohet fuqishëm, madje përgjatë tërë Muajit të Ramazanit, është tema “Në çfarë normash na thërret feja”! Në këtë temë, fuqishëm duhet t’i bihet faktit që, feja na thërret në ato norma të cilat, fatkeqësisht, që të gjitha i shkeli dhe po i shkel me dy këmbë Shaqir Fetai**

**Nga Ilir Ramadani**

Kur fshihet BFI-ja e Shaqir Fetait dhe bashkëpunëtorëve të tij të “kidnapuar” (sepse dikur ishin të Sulejman ef. Rexhepit), sa herë që nuk bëzanë, kur mbyllet hermetikisht dhe nuk shihet askund, kur rrinë “sus”, askush nuk merret me këtë “institucion” të personalizuar të Shaqir Fetait, askush nuk heton që ekziston dhe, nuk e neverikosë asnjë mysliman në vend. Sapo e “hap gojën”, sapo përpiqen të tregojnë se janë gjallë, sa herë që mundohen të aktojnë “leadership” shpërthejnë të sharat, shpërthen urrejtja, shpërthejnë ofendimet, shtohet mosdurimi deri në mohim absolut të Institucionit të BFI-së. Reagimet e opinionit vijnë si cunami!

Nuk mundet të ekzistojë një BFI, Institucion i mirëfilltë, ndërsa të udhëhiqet nga tradhëtarë e spiunë, nga hajna e rrenca, nga shitës të vakëfit e nga kontaminimi i BFI- së me plotë imoralitet, analfabetizëm, budallallëk e strategji të vjedhjeve të mëtejme. Tani, me gjasë, Shaqir Fetai paska zgjedhur të bëhet i gjallë, siç provoi të ngrisë kokë edhe me rastin e regjistrimit të popullatës, duke menduar se është përgjegjës i të gjitha institucioneve shtetërore që merren me regjistrim dhe që e përcjellin këtë aktivitet statestikor.

A ka fytyrë Shaqir Fetai, a mendon se duke hypur në qyrsi dhe të shesë hoxhallëk, apo, mendon se, duke dalur në TV do të depërtojë në çdo shtëpi myslimane të cilët do ta amnistojnë nga veprimet e tij të motivuara nga eprori udbash Stanko Dragoviqi! Atë mund ta përcjellin vetëm maqedonasit sa për të parë se ku dallon ky nga i pari! Dallon shumë, sepse i pari gjithnjë ngelë i parë ndërsa ata që vijnë pas tij ngelin prodhime të të parit! Veç kësaj, kur i pari tradhëtohet me thikë pas shpine, atëherë për armiq të të parit të dikurshëm bëhet edhe më atraktiv dhe, mund të përcillet sa për t’ia hetuar aftësitë dhe shkathtësitë prej tradhëtari dhe kriminel (krimi është i llojllojshëm).

Pastaj, ky tip të të përgatisë atmosferë ramazani, me një program për faqe të zezë?! Apo, ai konkurrenti i tij në intriga, Qenan Ismaili, i cili, konstatimet, propozimet, “këshillat” i shet për vendime të Myftinisë më të madhe në Maqedoninë e Veriut, të asaj të Shkupit!

Shaqir Fetai mendon se BFI-ja do të dalë nga kriza, mendon se myslimanët do të hipnotizohen me “tema e me ligjerata” sa për t’ua vjedhur paratë në shenjë të fitrit e të zeqatit, të cilat po u dashka t’u merren myslimanëve sepse Shaqir Fetait iu duheshkan për t’i mirëmbajtur “pesë” (!!!) medresetë si dhe FSHI-në! Që këtu gënjen Shaqir Fetai, që këtu Shaqir Fetai përgatitet për t’i manipuluar myslimanët.

Shaqir Fetai e sheh Muajin e Bekuar të Ramazanit si mundësi për t’i vjedhur myslimanët! Të thuash se edhe sivjet i duhen BFI-së fitra e zeqate për medresetë dhe FSHI-në është përpjekje për t’i humbur gjurmët e vjedhjes së atyre pakë fitrave dhe zeqateve që do të jepen. Sepse, për një kohë të gjatë nuk funksionoi Restoranti dhe Konvikti, objekte ndihmëse të Medresetë në Shkup, të cilat harxhojnë

më së shumti! Fitri dhe zeqati, Shaqir Fetai, kur tubohen, duhet të tubohen për zhvillimin e jetës fetare islame në vend! Kjo e vërtetë përfshinë edhe mirëmbajtjen e Medresesë por edhe për pagimin e rrogave për nja 70-80 për qind analfabetë, persona të kotë, të dëmshëm, të pavlerë, që duhet të paguhen si pasojë e nepotizmit, lokalizmit, politikave të gabuara dhe të dëmshme kadrovike që kanë metastazuar në BFI, sidomos pas instalimit të Shaqir Fetait nga pushteti aktual maqedonas.

Edhe, si do të mblidhen këto para nga myslimanët e vendit! Duke iu shitur tema bajate, steriotipe, të mërzitshme e të stërpërsëritura, nga njerëz me diploma false, nga amatorë, nga ata që t'i acartojnë nervat sapo të nisin të flasin, nga ata që janë sahanëlëpirës, që janë, puthadorë, që nuk e kuptojnë se, Institucioni i Vakëfit është i vetmi burim që siguron avansimin e jetës fetare, sidomos për etnikumin shqiptar të besimit islam por, edhe për myslimanët autokton të këtij rajoni!

A është temë “Fetaria e agjërimit”?! Nga e gjetën këtë nocin, këtë sintagmë kaq qesharake, këtë fjalë që nuk e ke në asnjë nga fjalorët e botuar, madje që nuk i fle natyrës së sintaksës së gjuhës shqipe! A nuk ju duket kjo tallje, apo, të paktën, propozim i injorantëve që mendtë i kanë vetëm te vjelja e djersës së myslimanëve të vendit!

“Mjekësia e agjërimit”?!? Dobitë mjekësore të agjërimit, po! Mjekësia për agjërimin, po! Por, “mjekësia e agjërimit”? Apo, “biologjia e agjërimit”, apo “gjuha shqipe e agjërimit”, apo, “frenjshjtja e agjërimit”?! A kuptojnë këta “shkencëtarë” të Shaqir Fetait se në çfarë niveli kanë rënë duke u munduar që të adaptohen e të nivelizohen me “kapacitetin intelektual” të “kryetarit” të tyre aktual!

Temë tjetër që do ta trajtojnë bilmezët e Shaqir Fetait do të jetë edhe kjo “Ideologjia e barabartë e mirëqenies”! Ishalla nuk i përkthejnë këta të huajt se, sakaq do të konstatojnë se, duhet të na përfshijë e të na rrafshojë ndonjë “tomahafkë”, apo ndonjë “bombë atomike”, sepse nuk jemi të denjë për asgjë, përderisa lejojmë që të tallemi nga një grusht kopukësh të Shaqir Fetait!

Si more “diskriminimet shoqërore si rezultat i konsumit”?! Injoranca nuk ka skaj, fillet i ka te togu mafioz i Shaqir Fetait por, skajet nuk i gjenden askund!

Po tema “Mohimi i kënaqësisë”?! Edhe kjo fjali duhet të përfshihet në një program profesional të hartuar për hirë të madhërimit të Muajit të Bekuar të Ramazanit!?

Ruana Zot nga kjo “ide brilante” e tokmakëve të Shaqir Fetait për ta trajtuar këtë temë (siç e kanë shënuar në “Program): “Dëshira e qenit i barabartë...”! Dëshira e qenit për Ramazan?!?

“Trokitje mendjes së shëndoshë”, temë kjo që Shaqir Fetai ka paraparë në Programin e vet! Realisht, “trokiti”, apo “thirri mendjes”, thuhet kur je në paudhë, kur ke dalë prej shinave, kur je totalisht aut! Por, kur ke mendjen e shëndoshë, nuk ke se çka i troket, vetëm duhet që ta lëshë të rrjedhë e të lë gjurmë ndriçimi, o “ulema” e bashkuar rreth kularit të Shaqir Fetait matrapaz.

A guxon të jetë dilemë një e vërtetë absolute? Po si guxojnë këta të Shaqir Fetait të shfaqin “mendime devijonte” (!!!) dhe ta shtrojnë të vërtetën absolute si dilemë, duke e evidentuar si: “A është feja shkak që njeriu të zhvillohet moralisht”?! Një intelektual i ulemasë së mirëfillte këtë temë do ta titullonte me një fjali konstatuese, të pamohueshme, që shpreh të vërtetën absolute: “Feja si e vetmja shtyllë e moralit të njeriut”!

E vetmja temë që është provokative dhe që duhet të trajtohet fuqishëm, madje përgjatë tërë Muajit të Ramazanit, është tema “Në çfarë normash na thërret feja”?! Në këtë temë, fuqishëm duhet t'i bihet faktit që feja na thërret në ato norma të cilat, fatkeqësisht, që të gjitha i shkeli Shaqir Fetai. Kijeni parasyshë vetëm Shaqir Fetain, veprimet e tij dhe, ja, në këtë aspekt keni mbi 100 tema për të trajtuar përgjatë këtij Ramazani. Natyrisht, feja na thërret në ato norma që e luftojnë çdo veprim të deritanishëm të Shaqir Fetait: në mostradhëti, në luftim të munafikllëkut, në luftim të intrigave, në luftim të zhvillimit të kolaboracionizmit me armiqtë e islamit, në luftim të shkeljeve të parimeve tradicionale miqësore, në luftim të përpjekjeve për ta marrur kolltukun me tradhëti, me vrasje të

tjetrit; feja thërret në norma që e luftojnë rrenën, dallaveret, rolin dhe lojën e skuthit; feja thërret në normat që i ruajnë vlerat themelore të fesë (a nuk është një prej këtyre vlerave edhe vakëfi, të cilin Shaqir Fetai po e bën rrush e kumbulla?) etj.! Të gjitha këto “norma”, këto dukuri antiislame janë karakteristike ekskluzive e Shaqir Fetait!

Dhe, për të treguar se krejt kjo është një farsë sa për t’i hedhur hi syve të myslimanëve të vendit, kemi dëshminë tjetër që e vulosë këtë qasje kritike ndaj amatorizmit dhe idiotizmit të stafit të Shaqir Fetait (të gjithë duhet të jenë të ngjashëm me të parin!!) Në “programin” e nënshkruar nga Shaqir Fetai që do të na “zbatohet” gjatë muajit të agjërimit, kemi edhe këtë urdhër të “reisit” injorant: “Muftinitë të përgatisin programe për aktivitetet e ndryshme gjatë këtij muaji”! Pra, Rijaseti përgatit më vete kurse Myftininjtë duhet të kenë përgatitur për vete! Se cila ku do të zbatohet, këtë do ta shohim pas Ramazanit!

Në një Institucion normal, organet propozojnë programet e tyre të cilat pastaj do të përfshiheshin në një program gjeneral të institucionit dhe do të bëhej program reprezenativ për të gjithë! Rijaseti program, myftinitë program, hoxhallarrët program më vete dhe, çka u bë këtu! Populli totë: “Lesh arapi”!

Asgjë nuk do të funksionojë si duhet, me përjashtim të skemës programore të mediave elektronike! Sepse, ato përgatiten, shlyqyr Zotit, nga ekspertë medialë dhe jo nga “ekspertë” të Shaqir Fetait. Dhe, fare në fund, programi hidhet poshtë, sepse kështu vendos Zoran Zaev dhe Venko Filipçe.

I lejohet të sjellin vendim edhe Shaqir Fetait dhe më të mirit të tij, Qenan Ismailit! Këta dy, së paku sipas “vendimeve” të tyre të publikuara, kanë konkluduar (vendosur):

1. Dita e parë e agjërimit për vitin 2021 fillon më 13.04.2021 (e martë).
2. Ezani i sabahut thirret 30 min. pas imsakut...

Nëse nuk ju besohet, futuni në fb-un e Myftinisë së Shkupit dhe këto vendime i keni te informata me titull: “Mbledhja e rregullt me hoxhallarrët dhe mutevelitë e xhamive të Shkupit” (e datës 8 prill, 2021)!

Njeriu që turpërhet një herë, në kontinuitet vazhdon të turpërohet dhe, deri në fund të ngelë i turpëruar! I turpëruar qoftë përjetë Shaqir Fetai! Amin! (Ky “Amin” do të jetë, të paktën, i nja 700-800 mij myslimanëve të vendit dhe më gjërë!)

***(Kombetare, 11.04.2021)***

## Shaqir Fetai – “islamofili” islamofob

Në një intervistë, në një televizion puro partiak (BDI), intervistuar nga një palo gazetar që në pleqëri ka filluar të shitet për një grusht parashë (storie e përsëritur e Judë Iskarioti), Shaqir Fetai do të lodhet në shpirt duke përsëritur gënjeshtëm: “që kur erdha unë”, “me ardhjen time”, “që kur u bëra reis”, “nën udhëheqjen time”... thjesht, e nisi Ramazanin, Muajin e Shenjtë, me fitne e festat. Pikërisht ashtu siç u ka hije “nxënësve” të Dragoviqit, “mentorit” të Shaqir Fetait për djallëzira

### Shkruan Vedat Konjufca

E vërtetë e pamohueshme është se Shaqir Fetai e tradhëtoi Sulejman ef. Rexhepin, me të cilin “flinin bashkë” gati deri dy ditë pas Bajramit të vjetmë, gati tash e një vit më parë! Është shumë e rëndë kur “e dashura të luan bisht”!

Shaqir Fetai me kompaninë e vet, të të njëjtit brum, e shkarkuan Sulejman ef. Rexhepin, për të cilin vetëm një javë më parë kishin thurrur elozhe. Shaqir Fetai jo më larg se para një muaji, ka pranuar botërisht se, nuk i vie fare keq për ato fjalë lavdërate e miradie që i ka folur për Sulejman Rexhepin sepse, sipas tij, të gjitha i ka merituar dhe, në çdo deklaratë të tij për efendi Rexhepin, sërish do t’i thurte po ato lavdërate të meritueshme.

As Shaqir Fetai dhe as bashkëpunëtorët e tij prej zyreve të shërbimeve sekrete nuk e kanë zgjedhur Sulejman Rexhepin, asnjëri prej tyre nuk ka votuar kur janë mbajtur zgjedhjet për Sulejman Rexhepin, sëkëndejmi, nuk kanë pasur as më të voglën të drejtë morale që pikërisht ata të kërkojnë dëbimin e tij prej BFI-së!

Shaqir Fetai nuk erdhi në BFI, Shaqir Fetain nuk e solli ulemaja në BFI, as përfaqësuesit e denjë të myslimanëve të vendit! Shaqir Fetai ishte zgjedhje e shërbimeve sekrete policore, instalacion i pushtetit maqedonas dhe, sahanëlëpirës i BDI-së që e propozoi si zgjedhje të manipulueshme deri në qykë!

Shaqir Fetai mundohet të thotë se me “ardhjen e tij”, “nën drejtimin e tij”, uniteti i ulemasë është shumë i fuqishëm, se të gjithë i përuken me përkushtim e medisiplinën më të madhe të devotshmërisë! Shaqir Fetai po rrenë, ka lëshuar një rrenë nga më epiket në prag të Muajit të Mëshirës, Ramazanit! Nuk mund të ketë përuken dhe devotshmëri ndaj “të parit” aty ku ka tradhëti. Nuk mund të jenë të devotshëm ata që i përuken tradhëtarit, spiunit, njeriut që bën miliona shkelje kushtetutare duke e depersonalizuar dhe defkatorizuar Institucionin e shenjtë të myslimanëve të vendit – BFI-në!

Janë gënjeshtër këto fjalë që dalin nga mendja e trullësuar e munafikut i cili tërë ditën e bjerr duke mendur se kë ta thërrasë në çaj e të bëjë një lajm se u vizitua nga filani “i cili i uroi shëndet e mbarëvajtje në drejtimin e BFI”!

Ja si demantohet Shaqir Fetai! Paska udhëtuar nëpër disa myftini dhe aty qenka prititur shumë ngrohtë nga hoxhallarët e vendeve përkatëse! Gjithkund ku ka qenë për vizitë (këto vizita absolutisht kanë qenë testim të dashurisë së “hoxhallarëve” për ta parë se sa të bollshme e kanë për “reisin” e tyre), myftinitë janë përkujdesur që ta takojnë me “hoxhallarë” të dëgjueshëm, pa personalitet e pa kurriz! Kështu ka qenë urdhëri nga “lart” – jo në takime e në mbledhje hoxhallarë që provokojnë! Provokatorët gjithnjë perceptohen si armiq! Myftinjtë e kanë ditur saktësisht se kush rri urtë e kush është i dëgjueshëm dhe kush nga hoxhallarët e urrejnë me shpirt Shaqir Fetain, tradhëtarin! Pse munguan hoxhallarët “rrebelë” në Myftininë e Strugës, po në atë të Kumnovës, po në atë të Shkupit,



Tetovës e Gostivarit! Pse aty ishin vetëm ata që tërë jetën janë shquar si bolefërkues të të parit! Kështu demonstronhet “uniteti”?! Kështu demonstronhet transparenca, pa debate e pa sqarime shtesë?!

Po ky palo gazetari që e pyet me keqardhje se në ç’ gjendje e trashëgoi BFI-në me shumë probleme?! Po pse Shaqir Fetai a nuk ishte pjesë e shkakimit të këtyre problemeve? Pse a nuk ishte shkatari kryesor i këtyre problemeve? Pse a nuk kontribuoi mbi 25 vite Shaqir Fetai në degradimin e BFI-së? Cilat ishin propozimet e tij, vizionet e tij, idetë e tij, të shtruara para Sulejman Rexhepit e që ky ia ka refuzuar? Sulejman Rexhepi, edhe kur i ka sharë me rob shpie, Shaqir Fetai e ka duartrokitur, ia ka fërkuar shpinën, sepse, i janë dukur “ide gjeniale”!

Shaqir Fetai nuk trashëgoi asgjë, Shaqir Fetai nuk është kuadër, si zgjidhje, nga qarqet nga jashtë BFI-së, Shaqir Fetai vetëm sa u zyrtarizua në aktivitetin e tij prej udbashi për ta shkatërruar sa më shumë BFI-në, për t’i devalvuar sa më keq hoxhallarët, për t’i përçarë sa më shumë!

Nuk deshti t’i takojë qindra hoxhallarë prej të cilëve kishte frikë se mund ta bombardojnë me argumenta e me fakte konkrete. Por ama, Shaqir Fetai urdhëron që edhe ata të marrin blloqe për fitra dhe të njëjtat t’ia dorëzojnë atij, sepse, zgjedhjet partiake po afrohen!

A e keni parë ndonjëherë më të skuqur e më të karabythftë Shaqir Fetain se sa gjatë asaj pseudointerviste? Kurrë nuk ka qenë më në siklet dhe më në zor se sa gjatë asaj ore derisa palo gazetarit, i cili me aq dhembje i shkruante dikur Titos te varri i tij në Dedinje, e detyronte tërthorazi për të gënjer e për të bluar aq shumë të pavërteta! Shaqir Fetai i njohur si sinonim i servilizmit të skajshëm, tashmë është bërë edhe sinonim i rrenave të pakripta. Mbase ky është misioni i tij: të jetë pasqyrë e të gjithë hoxhallarëve të vendit, në të cilën pasqyrohen si qenie imorale, të pandershëm, rrencakë, si qenie të cilëve nuk duhet besuar! A nuk është kjo goditje direkte kundër fesë islame? Jo rastësisht Shaqir Fetai në intervistë e thekson disa herë fjalën “islamofobë”, sepse, natyrisht që nisej nga vetëvetja! Islamofob më të madh se Shaqir Fetai vështirë se mund të gjendet në rajon e më gjërë! Kamuflimi i tij, fatmirësisht, është bërë prej perde tyli dhe po vërehet si në breg të diellit!

*(Kombetare, 13.04.2021)*

## Shaqir Fetai pohon se qe pesë muaj po e mbanë financiarisht Qeveria e Maqedonisë së Veriut

**Është vjedhje e pastër, është korrupsion i pastër qëndrimi i Shaqir Fetait se, duhet të donohen për solidaritet para të majme pa e ditur askush, as në BFI! Kjo deklaratë skandaloze e Shaqir Fetait duhet ta aktivizojë menjëherë prokurorinë apo agjencinë antikorrupsion**

### Shkruan Mejdî Thaçi

Më të vjetrit, sidomos gazetarët që e kanë mbijetuar sistemin totalitar, fare mirë e dinë se cili gazetar ka mundur të punojë në TANJUG, apo në Radio Jugosllavia, apo si përkthyes në këto apo në media të tjera! Jo pa qenë i verifikueshëm, i besueshëm dhe ideopolitikisht i përshtatshëm. Një prej këtyre të përshtatshmëve pastaj u bë model se si duhet të vajtohet nga dhimbja e trishtueshme për humbjen e Shokut Tito. Nuk ngeli media shqiptare pa e transmetuar atë vajtim. Kështu që, me një vajtim të një langaraçi e përkujtuan mediat shqiptare “Titon e Madh”! Një gazetar i këtij soji, u shkoq në b... duke e marrur në studio televizive Shaqir Fetain dhe duke zhvilluar intervista të një anshme, ashtu siç porositen prej shërbimeve kur kanë nevojë t’ia bëjnë karrierën bashkëpunëtorëve të vet. Në intervistën e fundit të cilën Shaqir Fetai e jep për një media të vendit, në pyetjen e gazetarit mbi humanitetin e BFI-së, ia krijon gjithë mundësinë për të gënjyer në mënyrë sa më komode! Përgjigjen Shaqir Fetai e nisë me një rrenë absurde duke thënë se, përditë jep nga dy-tri intervista? Ku? Mbase vetem në zyret e shërbimeve policore ku duhet te raportojë nga dy-tri herë në ditë! Duke e shprehur këtë rrenë të turpshme, Shaqir Fetai jep shenja se këtë dukuri do ta përshkallëzojë deri në kulm të imorales, sepse aq ka fytyrë Shaqir Fetai. Pa fije turpi thote se, me fitrin dhe zeqatin, përveç që mbanë “pesë” medrese dhe FSHI-në, ai po zhvilluaka edhe një humanitet të paparë dhe të padëgjueshëm. Shaqir Fetai rrenë kur i përmend pesë medrese, ndërsa nuk i emërton, nuk tregon se cili është emri i tyre. Nuk mundet dhe nuk ekziston as shansa minimale juridike që të funksionojnë 5 medrese me emrin “Isa Beu”! Secili institucion shkollor, nën emrin dhe siglën e vet, ka të drejtë që të ketë paralele të dispersuara nëpër qendra të ndryshme! Paralelet e medresese të dispersuara në pesë qendra ligjërisht dhe me Kushtetutë të BFI-së e kanë të pamundur të funksionojnë si medrese më vete, prandaj thuhet se Shaqir Fetai po rrenë kur po thotë se, “kujdesemi për pese medrese”! Ai rrenë në këtë masë, sepse duhet ta justifikojë fitrin dhe zeqatin e vjedhur. Nga ana tjetër, i shpëtoi nga goja shkarazi një informatë shokuese! Tash e pesë muaj financohen nga shteti! Qeveria Maqedonase i jep para BFI-së! Po bashkësive të tjera fetare a u jep? Nëse po, ç’ne që shtetikaqfshehurazi i financon bashkësitë fetare! Pse ky financim nuk bëhet transparente, pse nuk bëhet transparent vendimi qeveritar dhe arsyeja për t’i financuar bashkësitë fetare, ndërkohë që dëbimi nga puna, papunësia gjithnjë e në rritje, mjerimi gjithëpopullor, po shtohen gjithnjë e më shumë! Shteti po i financon me paratë e taksapaguesve të vendit. Shteti i financon institucionet e veta, me buxhet nga paratë e popullit. Sëkondejmi, a ju lejohet institucioneve shtetërore të mbledhin taksa të ndryshme po nga populli! Meqë BFI-ja e Shaqir Fetait finansohet nga buxheti i shtetit, a nuk është vepër penale mbledhja e taksave fetare nga populli prej “organeve” të Shaqir Fetait! Shaqir Fetai thotë një nga gënjeshttrat më të pamoralshme, për ç’gjë ai do të duhej të përgjigjej penalisht, moralisht, fetarisht... Shaqir Fetai në atë pseudointervistë tha se duhet të mbledhim fitra e zeqat sepse, BFI-ja e tij qenka shumë solidare, shumë humaniste por që nuk

po e bëkan transparente humanitetin për hirë të dinjitetit të skamnorëve dhe nevojtarëve të ndryshëm. Po kur solidarizohet në vjedhje me Mustafa Dautin duke i renditur nja dhjetra pako me produkte ushqimore duke ua dhënë të varfërve e duke raportuar se u ndamë mbi 1000 pako! Kur i krijohet hapësira Shaqir Fetait për të vjedhur, nuk i intereson kurrfarë dinjiteti përveç i xhepit të vet. Po me çfarë lehtësie të paturpësisë gënjen Shaqir Fetai kur thotë se BFI-ja e tij, nga buxheti i krijuar nga fitri dhe zeqati financon shërimin e nevojtarëve duke i dërguar në Turqi, Rusi... ndanë nga 20-30-50-40 mij euro për pacientë të sëmurë. Madje skamnorëve u bën shtëpia, u blenë... dhe, krejt këtë humanitet Shaqir Fetai e bën fshehurazi, ai nuk kërkon që fillimisht skamnorët të dalin e të qajnë në media që t'i ndihmojë pastaj. A ka tallje më të poshtër se sa kjo e Shaqir Fetait me hallexhinjtë, të cilët duke qarë po na nxirrkan donacione! Skamnorët qenkan qaramanë! Kujt i dalin lotët përveç atij skamnori që varfëria trishtueshëm ia zë frymën! Pse rrenë Shaqir Fetai për humanitet? Kur u bë ky që të ndihmojë skamnorë ndërkohë që i duhet ta ndihmojë UDB-në dhe ta ushqejë ORAO-n? Si guxon Shaqir Fetai të ndajë në dorë shuma të mëdha parashë? Të dërgojë njerëz në shtetet perëndimore për shërim si dhe t'ju ndërtojë shtëpia. Të gjithë skamnorët, të varfërit dhe të sëmurit rëndë të rreshtohen te BFI-ja e Shaqir Fetait, sepse ky paska buxhet për këtë kategori njerëzish. Tash e tutje ta shikojmë se me ç'humanizëm do t'iu drejtohet nevojtarëve! Humaniteti i Shaqir Fetait qenka në dy faza! Faza e parë po zgjatëka tërë vitin, duke mbledhur para nëpër xhami e duke ndërtuar shumë xhami, sidomos në Maqedoninë Lindore ku ka xhami që ia kanë shndërruar në kishë. Xhamitë nuk i ndërton dhe nuk i finanson Shaqir Fetai, as BFI-ja e tij, por ato ndërtohen me vetëkontributet e xhematit që ngritë iniciativë për të ndërtuar xhami. Për çdo xhuma, apeli i hoxhallarëve është "bani gajret xhemat, që të paguajmë ujë, rrymë e komunalie për xhaminë", ndërsa dy-tri aksione që kanë qenë për tubim të parave për ndihma humanitare, le ta pyes dylberin e vet, Mustafa Dautin, ku kanë përfunduar ato para. Dhe, faza e dytë e ndihmave qenkan për Ramazan. Po si nuk i vjen turp Shaqir Fetait të gënjejë kaq keq! Në bashkëpunim me Dijanetin e Turqisë paska përgatitur 100 ton pako ndihma për myslimanët e vendit! Shaqir rrencaku, ato pako janë të Dijanetit të Turqisë, nga kontigjenti i gjërë me ndihma për shumë shtete myslimane në botë, të cilat ua dedikon të varfërve të cilat shpërndahen përmes Institucioneve fetare. Pra, BFI-ja e Shaqir Fetait është vetëm servis teknik i atyre ndihmave të Dijanetit të Turqisë. Shaqir Fetai nuk guxon të sillet me nonshalancë ndaj buxhetit të BFI-së, por duhet të regjistrojë çdo cent që hy e që del nga zërat përkatëse të buxhetit. Është vjedhje e pastër, është korrupsion i pastër qëndrimi i Shaqir Fetait se duhet të donohen para të majme pa e ditur askush në BFI! Kjo deklaratë skandaloze e Shaqir Fetait duhet ta aktivizojë menjëherë prokurorinë apo agjencinë antikorrupsion. Shaqir Fetai duhet ta bëjë transparente, madje edhe ta reklamojë çdo aktivitet humanitar, sepse, a mund të mbahet sekrete falja e namazit?! Humanitetin dhe solidaritetin e fsheh, sepse nuk ekziston dhe nuk ka, kurse mosnjohjen e organometrit të BFI-së dhe mosnjohjen e funksionimit të këtij Institucioni, e bën transparente me krenari. Nesër avazi, nesër! Do ta mësojë Shaqir Fetai se si është e organizuar BFI, kjo që e trashëgoi nga viktimat e tij!

*(Kombetare, 14.04.2021)*

## Ç'thonë për teologët dokumentat sekret te arkivit jugosllav në Beograd

Janë të shumta dokumentat sekrete që flasin për aktivitetet dhe metodologjinë e UDB- së për ta shtrirë sa më gjërë rrjetin e vet mbi tërë popullatën e llojllojshme që jetonte në federatën jugosllave. Një prej metodave më efikase të UDB-së si dhe KOS-it del të ketë qenë rekrutimi i teologëve duke u premtuar pozita sa më të larta në komunitetet e tyre. “Më efikas e më të suksesshëm kanë qenë klerikët fetarë. Më lehtë nënshtroheshin hoxhallarët”, thotë një studim i UDB-së kah fundi i viteve '90, të shekullit të kaluar. Të njëjtit burim “i shpëtojnë” në opinion edhe disa dokumenta që flasin për bashkëpunëtorët më të suksesshëm të UDB-së. Njëri flet për Mustafa Ceriqin, ish-reis i Bosnjës dhe, tjetri, për Shaqir Fetain, reis i Maqedonisë, dy bashkëpunëtorë të UDB-së: i pari me pseudonimin policor VEZIR e i dyti me ORAO. Dy udbashë që arritën të ngjiten deri në postin e Reisit, me ndihmën e rrjetit akoma funksional të UDB-së së dikurshme. Dokumenti “sekret” i UDB-së thotë që në strategjinë e tyre është që të ngjisin sa më shumë teologë në poste më të larta, sepse të varurit e tyre do të kontrollohen dhe financohen nga krerët që do t'i përzgjedhë UDB-ja. “Kështu do të jemi më efikasë dhe pa shpenzime. Duhet që të komprometohen që të gjithë. Do ta kemi më të lehtë”, thotë dokumenti studim i UDB-së.

*(Lajme7, 15.04.2021)*

## Injoranti, Shaqir Fetai, mjeshtër i gënjeshtërisë dhe i vetëlavdërimit

Ëndërr e Shaqir Fetait, nga ato ëndërrat djaloshare të tij, na qenka “t’i stabilizojmë edhe ulematë islam”? Ulematë Islam!!! Ë krejt botës?! Apo, sa ulema i sheh Shaqir Fetai në Maqedoninë e Veriut?! Pse ata që i njeh a nuk qenkan të stabilizuar a! Dëshiron t’ua rrisë rrogat? Po si? Natyrisht, duke i sjellë në “lypsarë” e pastaj të kënaqen me rroga “të majme” qofshin ato të siguruara edhe nga shitja e vakëfit

### Nga Alban Idrizi

Shaqir Fetai paska qenë te një diplomat i huaj, në rezidencën e tij dhe, e paskësh shashtisur nga ajo që ia ka shpjeguar. Diplomati ka shprehur dëshirë që të dijë se si po ia del BFI-ja të organizohet në këto situata të rrezikshme, sepse, në atdheun e diplomatit, pushteti paska shumë probleme me ekstremizmin islamik! Si po ia del që t’i tejkalojë këto probleme BFI-ja e Shaqir Fetait?!

Ndërsa ky injorant, me plotë injorancën e vet, ia paska shpjeguar diplomatit (në të vërtetë e ka gënjyer pa fije turpi), edhe pse në fakt, Shaqir Fetai ka demonstruar panjohuri totale të organometrit të BFI-së si dhe mosnjohje totale të Kushtetutës së BFI-së.

Po pse ta njohë Shaqir Fetai Kushtetutën e BFI-së? Pse ta dijë atë, pse të jetë edhe një prej atyreve që e di përmendësh, prej atyreve që edhe në pikun e gjumit po t’i zgjoshë, ata ta thonë Kushtetutën përmendësh!

Shaqir Fetai e ka gënjyer diplomatit, duke menduar se ky nuk ka qenë i përgatitur kur e ka ftuar në rezidencë Shaqir Fetain, por, me plotë ashkë nisi ta gënjejë edhe shikuesin e paktë të atij televizioni ku jepte intervistë.

Kushtetuta e BFI-së e përcakton këtë organizim që nga baza e deri në krye:

- xhemati, i cili në aktivitetet fetare drejtohet nga imami, e ky mund të ndihmohet nga muezini, mualimi, vaizi etj.
- mexhlisi i xhamive, secili mexhli i xhamive ka muteveliun e vet
- mexhlisi i xhematit
- myftinia që përbëhet edhe nga delegatë nga mexhlisi i xhematit
- myftiu
- Kuvendi i BFI-së që përbëhet nga delegatë të deleguar nga Myftinitë
- Rijaseti që përbëhet nga drejtues të organeve dhe institucioneve të BFI-së
- Reisi

E si thotë Shaqir Fetai. Si e ka gënjyer diplomatit dhe si mundohet që ta gënjejë edhe opinionin e gjërë! Gënjenë sepse, nuk di! E pse të dijë kur e ka më lehtë të veprojë ashtu siç do ta dirigjojnë ata që e instalojnë në krye të BFI-së. Më lehtë do ta kalojë të jetë i dëgjueshëm se sa i dijshtëm, prandaj, Shaqir Fetai pallamudë dhe tërrt veshi nuk i bën.

Shaqir Feta thotë se, ky është organometri i BFI-së, sipas tij: Piramida e BFI-së sipas Shaqir Fetait:

- xhemati
- këshilli i xhamisë
- imami
- anëtarët e kryesisë së myftinisë së BFI-së!!!
- Kuvendi i Myftinisë (Asnjë myftini nuk ka kuvend. Gënjen Shaqir Fetai, apo shpreh injorancën e

vet!)

- Kuvendi i Bashkësisë Islame
- Rijaseti i BFI-së dhe,
- Reisi

Sapo ta përmendë “reisin” menjëherë e harron diplomatën dhe nis e flet për vetëveten në mënyrë superlative. Sepse, derisa e shajnë të gjithë, derisa e urrejnë të gjithë, derisa të gjithë e dinë se kush është Shaqir Fetai dhe çka ka vepruar, me çfarë merite erdhi në krye të BFI-së, pse ai mos ta lavdërojë vetëveten!

Në fakt, tashmë po shihet se ka paguar një “grumbull” paçavrash prej pseudoportaleve dhe, aty kërkon që të lavdërohet, i paguan për sa më shumë lavdërim! E kush të lavdërohet? Më i ndyti dhe më pisi i “ulemasë” sonë! Ia merr mendja se duke e lavdëruar gjytyrimin në tru, do të nisin ta duan e ta respektojnë myslimanët e vendit. E lëshoi një gjysëminformatë në intervistë dhe, pasaj, të gjithë të paguarit nga djersa e myslimanëve të vendit, u morën vetëm me atë gjysëmiinformatë, askush nuk ia bëri një analizë të thuktë intervistës, meqë ky i ikë debateve, askush nuk e tha një fjalë për inferioritetin e tij, për injorancën e tij, për gënjeshttrat e tij si dhe për nënteksin e asaj që e fliste!

Shaqir Fetai paska kthyer në pronësi të BFI-së një 24 mij metra katëror tokë, diku mes Gostivarit dhe Vrapçishtit! Po ç’ne që e paska kthyer Shaqir Fetai dhe jo Myftiu i Myftinisë së Gostivarit? Pse nuk e ktheu sa ishte myfti Shaqir Fetai? Pse nuk e përmend një fakt të pamohueshëm: Shaqir Fetai ka kthyer vakëf, sepse kryetarët e Komunës së Gostivarit ia kanë kthyer, si myslimanë të mirë! Pse nuk e thotë Shaqir Fetai se, në kohën e Taravarit të Aleancës, Myftinia e Gostivarit ktheu toke prej 24 mij metra katërorë!

A mendon Shaqir Fetai se me këtë kontribut të huaj do të mund t’i mbulojë dështimet e veta, apo pazarllëqet e pista prej matrapazi të pashoq!

Mendon ai se me këtë livadh të rikthyer në periferi, do të mund ta mbulojë shitjen e dhjetra e dhjetra hektar mal-vakëf në Gazibabë ku ka “lulëzuar” një Kishë Ortodokse Maqedonase?

A mendon Shaqir Fetai se me këtë livadh periferik do të mundohet ta mbulojë dështimin me “Ibni Pajklon”!

E mori Shaqir Fetai livadhin periferik ndërsa tash e dhjetë vite hoqi dorë nga vakëfi në qendër të Gostivarit, pa dhënë kurrë më të voglin shpjegim se çfarë u bë me atë pronë me vlerë miliona euro! Si e dështoi atë projekt jetik për perspektivën e Myftinisë së Gostivarit?

Sa vakëfin e dogj Shaqir Fetai duke i bërë rrush e kumbulla bonot në vlerë të dhëna si kompensim nga qeveria maqedonase për pronat që nuk mund të denacionalizohen. Në vend se të blejë prona, ai po blenë “rehatinë e reisllekut” duke i kompromituar të gjithë ata që ndjejnë se janë të varur prej tij! Dhe, ëndërra e Shaqir Fetait, nga ato ëndërrat më të këndshme të tij, na qenka “t’i stabiliojmë edhe ulematë islam”! Ulematë Islam!!! Të mbarë botës? Sa ulema i sheh Shaqir Fetai në Maqedoninë e Veriut?! Pse ata që i njehe a nuk qenkan të stabilizuar a! Dëshiron t’ua rrisë rrogat? Po si? Natyrisht, duke i sjellë në “lypsarë” e pastaj të kënaqen me rroga “të majme” qofshin ato të siguruara edhe nga shitja e vakëfit. E bën këtë Shaqir Fetai, e bën! Ç’haram e ç’turp nuk ngeli pa bërë, që mos ta bëjë edhe këtë: “t’i stabilizojë ulematë islam”! Injoranti të mendojë për ulemanë?! Pika që s’i bie!

*(Fokusi, 15.04.2021)*

## UDB-a te Lagja e Trimave

Shaqir Fetai sot zyrtarisht e paska vizituar Myftininë e Kumanovës! Me rastin e Muajit të Ramazanit? Po pse zyrtarisht! Herave të tjera kur ka qenë në këtë terren, ka qenë si cub? Kur vizitohet një organ (zyrtarisht, ndonëse organet që janë nën varshmëri nga drejtuesi, nuk vizitohen kurrë zyrtarisht) aty sepse duhet të jetë ose debati shterrues mbi ndonjë problem, ose për inspektim të punës, ose për kontrollë të organit, ose për emërime apo zgjedhje. Zyrtarisht vizitohet një organ jashtë Institucionit apo shtetit gjegjë; zyrtarisht vizitohet një organ i sapo formuar; zyrtarisht vizitohet edhe Myftinia e Kumanovës, por nga një delegacion i huaj për këtë organ. Tani kush për kë ishte i huaj: Shaqir Fetai për Myftininë e Kumanovës, apo, Myftinia e Kumanovës për Shaqir Fetain? Kahdo që të vështrohet, një është e vërtete: në mes vete janë shumë të largët dhe nuk përputhen askund – as Shaqir Fetai për këtë Myftini dhe, as anasjelltas! Megjithatë, nga informata socraliste që do të lexohet mbi këtë “vizitë zyrtare madhështore” sakaq do të kuptohet nevoja, qëllimi dhe arsyeja: që, me nga një trëndafil në vesh, të lulohen me lavdërime të ndërsjella duke shpresuar se kjo sjelle e munafikëve do të ndikojë te xhemati që duhet të trulloset deri në qurë, helbete, mos po i vilen më lehtë fitrat dhe zeqati! Xhemati në xhami ishte mbledhur për ta falur xhumanë dhe jo se kishin nevojë të “eksitohen” nga lavdërimet e ndërsjella, sa të shkreta aq edhe pallavra. “Fillimisht Reisul Ulema H. Hfz. Shaqir ef. Fetai dha një deklaratë për mediumet në të cilën e falënderoi Myftininë e Kumanovës për mikpritjen dhe premtoi se vizita të tilla, të organizuara do të bëhen në të gjitha myftinitë e territorit të Maqedonisë së Veriut”, thotë informata e porositur si dikur nga UDB-ja kur i ngriste pseudovlerat duke thurrur lavdërata. Shaqir Fetai del i fascinuar nga mikëpritja e Myftinisë së Kumanovës!!! Nëse një bashkëpunëtor zyrtar i UDB-së hyn në Myftininë e Kumanovës, kjo po që nxit mirënjohje për mikëpritje! Pastaj, kujt, kujt i paska premtuar Shaqir Fetai se do t’i vizitojë të gjitha 13 Myftinitë e vendit? Medias së pavarur të Kumanovës? Tybestigfar! Stil origjinal ky i Shaqir Fetait. “Para se të vija ta vizitoj Kumanovën, iu luta Myftiut Abedin ef. Imeri që të më mundësojë ta vizitoj këtë xhami në Lagjenj e Trimave”, thotë Shaqir Fetai! Hej, një “reis” që lut organin e vet që t’ia mundësojë qëndrimin në një lagje, në mesin e një xhemati? Po pse kjo lutje e frikshme? Pse Shaqir Fetai me gjakim të zjarrtë lutet që t’ia mundësojnë vizitën e këtij xhemati? Pse Shaqir Fetai, serbes e me guxim, pa shybe e me mburrje, nuk niset drejt kësaj xhamie të kësaj lagje? Mos lidhet diçka emri i tij me legjendën heroike të LAGJES SË TRIMAVE? Apo, mos i ka diç borxh këtij xhemati sa të ketë frikë të vizitojë pa ia mundësuar një vizitë të garantuar? Në çka e involvoi me këtë deklaratë konspirative edhe Abedin Imerin! Apo, me këtë vizitë Shaqir Fetai mundohet ta relativizojë të kaluarën e “begatë” të tij nën pseudonimin ORAO! Më pas, hoxha në këtë rast, Eljasa Mahmudi “në fjalimin e tij drejtuar xhematit shprehu fjalë miradie për Reisul Ulemanë, ku mes tjerash potencoi: “All-llahu i Lartëmadhërishtëm e shpërbleftë Reisul Ulemanë për vizitën e realizuar dhe i dhëntë shumë suksese në udhëheqjen sa më të mirë të institucionit më të lartë fetar islam në vendin tonë. Amin!”, përfundon informata socraliste. Ta urosh Shaqir Fetain, është ngjashëm si t’i dërgoshë “salavate” Stanko Dragoviçit, mentorit djallëzor të Shaqir Fetait, apo, oficerit të tij të dikurshëm të UDB-së.

*(Politesa, 16.04.2021)*

## Shaqir Fetai “posllushnik” i shërbimeve që e instaluan në krye të BFI-së

**Një prej atuve që kohë më parë iu dha në duar Shaqir Fetait, ishte aktivizimi i tij në regjistrimin e popullatës, e cila u shty për në muajin shtator. Regjistrimi u hesht, heshti për vdekje edhe Shaqir Fetai, ndonëse hoxhallarëve ua kërkoi me vendim si aktivitet kryesor përgjatë muajit të Ramazanit**

### Nga Shefqet Papraniku

Shaqir Fetai, instalacioni më katastrofal i pushtetit maqedonas në Bashkësinë Fetare Islame, po dëshmon se nuk mund të veprojë asgjë pa ia diktuar pushteti aktual maqedonas. I tha që të aktivizohet në thirrjen e diasporës që të regjistrohet, madje u premtua edhe vizita e diasporës nga delegacione të shumta të BFI-së për këtë “interes politik maqedonas”, ndërsa, sapo u shty politikisht ky regjistrim, Shaqir Fetai heshti! Nuk e shtyu edhe ky këtë aktivitet, sepse askush nuk ia kërkoi ta shtyjej! Kjo dëshmon se sa “posllushnik” është Shaqir Fetai! E vepron vetëm atë që i kërkohet!

Natyrisht, fjala “posllushnik” është barbarizëm në gjuhën shqipe, që ka kuptimin e “i degjueshëm”, servil, i nënshtruar i pushtetit! Megjithatë, nëse e thua në gjuhën shqipe “i dëgjueshëm”, kjo fjalë mund të asocojë edhe në “i famshëm”, “që dëgjon”, i “mbarë”, “që dëgjohet gjithandej”, pra, mund të jetë fjalë me sinonime që do ta kënaqnin Shaqir Fetain! “Posllushnik” është fjalë barbare që tek shqiptarët në mënyrë pezhorative dëfton për një doraputhës, sahanëlëpirës, bolefërkues i pushtetit! “Posllushnik” – ky është Shaqir Fetai!

Çka bëri Shaqir Fetai lidhur me iniciativën e institucioneve gjegjëse shtetërore për regjistrimin e popullatës?! A i vëri ndonjë detyrë vetes! A pati strategji të veten? A u mundua që përmes ndonjë initiative ta vë me shpatulla për muri pushtetin dhe të përfitojë diçka në të mirë të BFI-së dhe hoxhallarëve të vendit! Natyrisht, nëse do ta kishte këtë synim, atëherë nuk do ta arrinte epitetin e “Posllushnikut” kurse Shaqir Fetait i intereson pikërisht institucionalizimi i këtij epiteti! Sepse, me këtë epitet Shaqir Fetai do të përfitonte ekskluzivisht për vete, sepse, fundja, kjo i intereson atij, ta përmbyllë karrierën e vet si “reis” pasi reisit paraparak, atij që e pati mburojë në karrierën e vet, ia nguli thikën deri në kockë!

Çka u desht të bëjë Shaqir Fetai? Të jetë palë me pushtetin apo të luante opozitarin e fuqishëm! Të kërkojë regjistrim të popullatës apo të dilte e të thoshte se, ne e dimë se sa jemi, kemi statistikatat tona burimore, ndaj mos luani me numra se nuk do t’i pranojmë rezultatet e kurdisura politike!

Asnjë nga institucionet nuk mund të jetë aq efikase dhe aq e besueshme në numrin e përgjithshëm të popullatës shqiptare, turke, rome, boshnjake, torbeshe, se sa mund të jetë BFI-ja.

Rreth 800 xhami-pika regjistrimi, ku do të obligoheshin të gjithë mexhliset exhamive që t’i regjistrojnë banorët që përbëjnë xhematin e xhamisë apo të, katundeve, apo të lagjeve gjegjëse!

Ky qëndrim i Institucionit të vetëm mysliman, me karakter drejtues dhe përgjegjës, do të mund t’i vinte para një sprove fatale “organizmat nëntokësore” që bëjnë politikë sa për të krijuar një “popull” të emërtuar si “populli i përqindjeve”!

Për ta ndër marrë këtë hap, pa dyshim, që duhet të jeshë personalitet me lidhesh të patundur e të



pakërrusur deri në përdhe! “Posllushniku”, Shaqir Fetaj, i cili për karrierë prej “reisi” ka lënë hipotekë çdo gjë morale (nëser ka pasur diçka nga moralja), e ka shmë të qartë se nuk mund të funksionojë pa këtë epitet! Vetëm si “Posllushnik” ai mund të bëjë karrierë e jo për ndonjë vlerë apo kapacitet që mund të ketë, sepse, është aq i mençur për të kuptuar se është tërësisht i pavlerë. Tani, epiteti “Posllushnik” e zhvesh nga të gjitha ndjenjat, e bën substancë që helmon çdo vlerë që mund t’i sillet vërdallë tij!

Pas Luftës së Dytë Botërore pati një Parti Komuniste, pati komunistë, pati shumë shqiptarë komunistë, madje për pesëdhjetë vite mbarë populli shqiptar u bë “popull komunist”! Megjithatë, pati edhe lëvizje hoxhallarësh që e kundërshtuan këtë pushtet, pati nga hoxhallarët që u kalbën burgjeve jugosllave për idealin e tyre kombëtar e fetar, pati ideal për t’iu kundërvënë komunizmit, marksistave-leninistave, titistave- enveristve që e synonin përfundimin e eksperimenteve antihumane kundër shqiptarëve. Sot, shkruhet e lavdërohen pikërisht këta personalitete hoxhallarësh! “Posllushnikët” e komunizmit si dhe tërë lidërsipin shqiptar e mysliman të kësaj ideologjie, e ke në procesin e fermentimit nëpër plehërat kontaminuese.

*(Mileniumi3, 18.04.2021)*

## Profesori pyet: pse heshtë BFI-ja

**Ish-rektori dhe dekani i Universitetit të Tetovës, Arbër Çeliku shkruan se, në Maqedoninë e Veriut jetojnë 1 milionë e 220 mijë myslimanë dhe nga ato afër 1 milionë janë shqiptarë dhe ka akuzuar BFI-në se ato e dijnë këtë gjë por e fshehin me vite, për të shtuar:**

**“Le të më korrigjojnë personat përgjegjës të BFI-së, nëse e kam gabim”.**

### Nga Veli Berisha

Këto ditë, në portalin infoshqip.com, u publikua edhe qëndrim që shpreh gjithë guximin intelektual të Arbër Çelikut, i cili në fb-un e vet publikon shqetësimin rreth numrit të saktë të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, sipas bindjeve të paluhatshme të të cilit, këtu jetojnë mbi një milion shqiptarë. Profeso Çeliku është i bindur se këtë statistikë të saktë e ka Bashkësia Fetare Islame por, me plotë të drejtë habitet se pse këtë fakt e fsheh BFI-ja, pse ky Institucion, që mbahet nga shqiptarët, kurrë nuk e tregoi numrin e shqiptarëve të cilët, shumica absolute janë myslimanë, anëtarë dhe parapagues të anëtarësisë në këtë Institucion!

### Pse ndërhyri pushteti maqedonas në BFI

Fill pas shpalljes së pavarësisë të Maqedonisë, diku pas dy jave, më çoi puna që të zbrisja bashkë me redaktorin teknik të “Flakës së Vëllazërimit”, Zekirja Osmani, në katin e parë, aty ku bëhej faqosja e gazetës. Hyrja në hapësirën e shtypshkronjës ku ishin të montuara makinat më të shpejta dhe më bashkëkohore, ishte e ndaluar rreptësisht dhe ruhej nga policët e asaj kohe. Kjo e intrigoj mjeshttrin Zekerija Osmani dhe, u bë si i hutuar e u nis drejt korridorit, por, hasi në një reagim të ashpër nga policia! Megjithatë, mjeshtri Zekë, si ndër punëtorët më të vjetër të asaj “shtëpie”, i dinte të gjitha vrimat dhe korridoret lavirinth, pasi më humbi nja dy-tre minuta, vetëm kur doli, me një ekzemplar të një botimi që e kishte fshehur poshtë këmishës, në pantallona. Bëhej fjalë për një katalog-libër propagandistik që ishte, e përgatitur në gjuhën angleze, ekzkluzivisht për Maqedoninë, përplot me statistika. Mjeshtër Zeka kishte marrur vesh se botimi përgatitej në tirazh të kufizuar dhe i dedikohej ambasadorëve të akredituar në Organizatën e Kombeve të Bashkuar, ministrave të punëve të jashtme të shteteve që e kishin pranuar dhe që do ta pranonin Maqedoninë si shtet të Pavarur, si dhe shumë organizmave me relevancë të madhe në politikën botërore.

Materiali propagandistik thoshte se, në Maqedoni jetojnë 2.400.000 banorë, prej të cilëve, 29 për qind ishin besimtarë të përkatësisë fetare islame (shqiptarë, turq, romë, boshnjakë, “makedonci myslimani”) 69 për qind besimtarë të besimit ortodoks (maqedonasë) dhe, 2 për qind të tjerë (të feve dhe besimeve të tjera si dhe ateistë).

Përkatësia etnike në mes të dy etniteteve më të mëdha paraqiste këtë raport (17 për qind shqiptarë, 67 për qind maqedonasë dhe 16 për qind të tjerë (turq, vlllehë, serbë, romë, boshnjakë, jugoslllovenë etj.) Në shifra, më sa mbaj mend, paraqiteshin kështu: shqiptarë 420 mij banorë, të tjerë 380 mij banorë dhe maqedonasë mbi 1 milion e gjashtëqind mij!

Materiali në fjalë i pat rënë në dorë ish-reisul ulemasë, H. Sulejma ef. Rexhepit, i cili, menjëherë ndërmori masa. Kërkoi prej të gjitha organizmave të BFI-së, që nga “odborët” e xhamive, e deri te myftinjte dhe kordinatorët, në afat sa më të shkurtë të kryejnë regjistrimin e tërë anëtarësisë së vet,

secili të xhamisë së vet, secili imam të lagjes së vet, të katundit të vet, nëpër qendra të mëdha, secila xhami, secili imam, të dijë saktësisht se cili numër është që i frekuenton xhamitë dhe, të sillen numrat edhe të atyreve që nuk i frekuentojnë dhe, doli me numër që ia përligji tërë atë aktivitet propagandistik me tërë aparatit shtetëror si dhe duke shpenzuar miliona dollarë. Reagimet e pushtetit maqedonas ishin të ashpra, por jo të frikshme për Sulejman ef. Rexhepin. Natyrisht, rëndësia, pesha, roli dhe respekti për BFI-në ishte aq i madh sa, nuk mund të refuzohej aq kollaj prononcimi i H. Sulejman ef. Rexhepit, lidhur me statistikën e BFI-së për anëtarët e vet, madje të kujt etnikume i përkisnin!

Kësisoj, prononcimin bombastik Sulejman ef. Rexhepi do ta japë në tubimin e intelektualëve islam nga bota, në Medine, me rastin e haxhit të vitit 1992, kurse në kumtesën e vet, veç të tjerash do të deklarojë: “Sipas statistikave, përveç shtetit amë, Shqipërisë, që sot numëron afër katër milion banorë, islami është fe edhe e mbi dy milion shqiptarëve të Kosovës, mbi një milion të Maqedonisë, treqind mijë të Kosovës Lindore dhe dyqind mijë shqiptarëve që jetojnë në Mal të Zi. Pra, llogaritet se sot në Ballkan jetojnë mbi shtatë milion shqiptarë myslimanë.”

Po ashtu, në intervistën me tiull DRAMA JONË ENDE PO VAZHDON, dhënë në maj të vitit 1993 për revistën “The Muslim World”, në pyetjen “Si është gjendja e myslimanëve në Maqedoni?”, atëherë, Kryetari i Meshihatit të Bashkësisë Islame të Maqedonisë, H. Sulejman ef. Rexhepi, do të përgjigjet: “Numri i përgjithshëm i banorëve në Maqedoni tash e kalon dy milion e katërqind mijëshin, ndërkaq vetëm myslimanë janë gati një milion e treqind mijë. Në bazë të të dhënave që i posedojmë lirisht mund të themi se rreth 55% të numrit të përgjithshëm të banorëve të Maqedonisë janë myslimanë, prej të cilëve 49.7 për qind janë shqiptarë. Ndërkaq është problem tjetër që këtë numër e fsheh statistika zyrtare e qeverisë, e cila vazhdimisht paraqet disa numra e shifra jo të sakta dhe të pabaza, me ç’rast myslimanët e këtushëm i paraqesin si pakicë dhe i japin vetes komoditet për suprimimin e të drejtave të tyre. Duke i pasur parasysh këto qëllime të pushtetit aktual maqedonas ne për asnjë moment nuk pranojmë dhe nuk do të pranojmë që të konsiderohemi si pakicë”.

Kjo ishte politika e BFI-së në kohën e H. Sulejman ef. Rexhepit, mbështetur në përkrahjen e fuqishme që e kishte nga Partia për Prosperitet Demokratik, e cila, nuk do ta votojë as Kushtetutën e parë të Maqedonisë me të cilën pozita e shqiptarëve vulosej me ngjyrën e zezë të diskriminimit etnik.

Tani, sa për informim të profesor Arbër Çelikut, së fundmi kemi pasur edhe një prononcim të Shaqir Fetait, “reisit” të instaluar nga pushteti maqedonas, pas ndërhyrjes në BFI politika zyrtare e së cilës i pengonte të gjitha projektet nacionaliste, monoetnike e monofetare të pushtetit maqedonas. Askush nuk i reagoi Shaqir Fetait kundër asaj “balonë prove” që e lëshoi! Shaqir Fetai në një prononcim, në një televizion lokal shqiptar, do të nënvizojë se si myslimanë jemi afër një milion në Maqedoni, më pas e përmend shifrën 800 mij! Shifrën prej 1.300.000 që dikur e jepte H. Sulejman ef. Rexhepi, Shaqir Fetai me automatizëm e zbret për 300 – 400 mij, duke u treguar si “Posllushnik” i politikave shoveniste maqedonase. Në këta një milion myslimanë, turqët pretendojnë se janë mbi 150 mij, romët pretendojnë se janë rreth 100 mij, boshnjakët rreth 50 mij dhe, torbeshët nja 80 mij! Sa po ngelin shqiptarë? Sipas Shaqir Fetait në Maqedoni jetojnë aq shqiptarë sa i jepte dikur materiali propagandistik i Kiro Glligorovit që ua shpërndante korit diplomatik e ku theksohej se shqiptarë janë pak më shumë se 400 mij!

## **Arsye tjetër për ndërhyrjen e pushtetit maqedonas në BFI**

Prona e BFI-së, pra, Vakëfi, është problemi më i madh i popullit maqedonas dhe i shtetit të Maqedonisë. Pavarësisht që, në fillimet e veta pushteti maqedonas u përpoq që të zhdukë sa më shumë dokumente

të Vakëfit të BFI-së, të nacionalizuar që në peiudhën e “koperativizimit dhe nacionalizimit” të pronave të bashkësive fetare, ish-reisul ulema i BFI-së, Sulejman ef. Rexhepi, që ishte një barrierë e madhe dhe e fuqishme kundër shovenizmit maqedonas, arriti që për një priudhë të shkurtë të hartëzojë tërë pronën e nacionalizuar të BI-së dhe të mbledhë të gjitha dokumentet mbi këto prona.

Në fjalimin e vet me rastin e Takimit të Pestë të Liderëve Myslimanë të Ballakanit, organizuar në mars të vitit 2011, në Shkup, Sulejman ef. Rexhepi do të shpërfaqet si lider i vërtetë dhe skajshmërisht i guximshëm. Ai, veç të tjerash, do të deklarojë: “Nga 350 kërkesa të BFI-së drejtuar pushteteve maqedonase, për kthimin e katër milion metrave katërorë tokë të nacionalizuar nga sistemi komunist, (livadhe, ara, kullosa, male dhe të tjera), si dhe 42 mijë metra katërorë objekte, banesa, shtëpi dhe dyqane, deri më sot mezi kemi arritur që ta kthejmë vetëm 15 për qind të pronës së nacionalizuar.

Ja disa statistika më konkrete! Në Shkup nga 127 kërkesa vetëm 10 prej tyre kanë marur përgjigje pozitive: në Manastir nga 56 kërkesa për, mbi 180 parcela kadasatrike, vetëm 15 prej tyre kanë marur përgjigje pozitive; në Kumanovë nga 10 kërkesa, vetëm 1 ka marur përgjigje pozitive: në Prilep nga 4 kërkesa për dhjetëra parcela kadastrike asnjë nuk ka marur përgjigje pozitive. Po ashtu, në Dibër, Ohër, Negotinë, Shtip, Veles, Kavadarç dhe në gjithë Maqedoninë Lindore situata është e njëjtë.”

Në ndërkohë, nga viti 2011 e deri më vitin 2018, këmbëngulja e ish-reisul ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepit, ka rezultuar edhe me kthimin e dhjetra parcelave, dyqaneve, si në objekte ashtu edhe në letra me vlerë.

A i ka ditur të gjitha këto opinioni i gjërë? A ka qenë koha e lavdërimeve apo e punës, e akiviteteve, e konkretizimit të kërkesave dhe nevojave!

Sot, në kohën e Shaqir Fetait, të instaluar në krye të BFI-së pas ndërhyrjes së pushtetit maqedonas për ta eliminuar pengesën më të madhe të politikave nacionaliste maqedonase, Sulejman ef. Rexhepin, kanë ndodhur dhe po ndodh zhvatje, shitje, ngrënie, degradim të vakëfit për të cilin u punua për dy decenie, dhe, e tëra kjo po kalon në heshtje. Zhurmë e madhe mediale u bë fakti që Shaqir Fetai na e paska kthyr një livadh prej nja 24 mij metra katërorë, (nëse është tokë që kthehet përmes denacionalizimit, duhet të tregon se kur është bërë kërkesa për denacionalizim) ndërsa asnjëra nuk shkroi se si e humbi Shaqir Fetai Vakëfin miliona euro në qendër të Gostivarit! Le ta inicojë Shaqir Fetai hartëzimin e pronave të kthyera nëpërperiudha. Le ta shohë mbarë popullata myslimane se sa e gjithë ajo që kthehet nga vakëfi, është rezultat i punës gkatë periudhës së Sulejman ef. Rexhepit, kurse, Shaqir fuksit i ngelet vetëm të lavdërohet se shumë shpejt do të habitemi se sa pronën do ta rikthejë!

## **Shaqir Fetai projekson i politikave antishqiptare**

Shaqir Fetai është i destinuar që të jetë “Posllushnik”, nëse dëshiron që të zhvillohet ngritja e karrierës së tij ashtu siç ka porositur oficeri i tij i UDB-së, Stanko Dragoviq, derisa ky ka qenë “myhyb” i tij me pseudonimin ORAO!

Dhe, t’i kthehemi profesorit të nderuar, Arbër Çelikut! Urojmë të ketë kuptuar dhe të ketë gjetur përgjigjen se pse BFI-ja e Shaqir Fetait kurrë nuk do ta sigurojë dhe nuk do t’ia kumtojë numrin e saktë të myslimanëve të Maqedonisë, në veçanti të shqiptarëve! BFI-ja edhe në diasporë do të mund të ishte më e saktë nëse do ta zhvillonte regjistrimin paralel, vetëm sa për t’ia përlligjur “konstatimet” nacionaliste të politikave maqedonase. BFI-ja tashmë i ka qendrat e veta, i ka unionet e veta, i ka të tubuar xhematet e veta në diasporë. Brenda një-dy jave do ta dinte saktësisht numrin e shqiptarëve tanë. Por, jo, Shaqir Fetai bëhet pjesë e politikës maqedonase dhe lëshohet në fushatë të kësaj politike duke apeluar që sa më masovikisht të regjistrohen shqiptarët në këtë “aksion statistikor të shtetit”!

Kush i ka mekanizmat në duar? Kush do t'i kontrollojë statistikat? Kush do ta vulosë numrin e “saktë” të shqiptarëve! Cila parti shqiptare e ka bishtin e zënë me derë? Funkionarët e cilës parti janë të korruptuar dhe lehtësisht të shantazhuar? Kush do t'i verifikojë ato statistika (nëse jo BDI dhe BFI e Shaqir Fetait)? Këtu pastaj, do të ishin të turpshme të gjitha ankesat e më tejme të shqiptarëve. Do të duhej të hiqet për dhjetra e qindra vite nga rendi i ditës dyshimi i shqiptarëve për numrin e tyre të saktë si etni në Maqedoninë e Veriut!

Të korruptuarit, të shantazhuarit, të dyshimtët e të diskutuarit do të vulosin fatin tonë? Ja pse, jo vetëm profesori i nderuar, Arbër Çeliku, por të gjithë intelektualët e vendit, të gjitha mediat, duhet të ngriten dhe sërish t'i rrënojnë projektionet maqedonase brenda shqiptarëve, përfshirë këtu edhe Shaqir Fetain si projektion i politikave antishqiptare.

*(Kombetare, 19.04.2021)*

## **Myhybët e Shaqir Fetait merren me cirkusllëk**

**A bëhet humanitet duke ia pasur frikën mediave se mund të të bëjnë për lesh! Asnjë media sado amatore nuk do të mund ta duronte “aktivitetin humanitar” që bëhet sa për t’ia thyer dinjitetin të varfërit, jetimit, skamnorit, siç po e bëjnë myhybët e Shaqir Fetait**

**Nga Qefsere Sulejmani**

Bashkësia Fetare Islame e Shaqir Fetait po shndërrohet në sinonim të dehumanizmit, në mekanizëm të keqtrajtimit të të varfëreve (dhe, shqyrr që këtë mundësi nuk e kanë më shumë se sa një muaj)! Seç u vie një takat pikërisht në Muajin e Rahmetit e të Mëshirës, përgjatë ditëve të agjërimit, të vjedhin, të planifikojnë hajni, të bëjnë “programe” për vetëlavdërim, si maskë për ta mbuluar tërë atë shpirt katili që pa fije turpi e shpërfaqin në emër të islamit. Po pse bre a vetëm një muaj, vetëm një ditë brenda një muaji bëhet humanitet! Po si nuk janë në gjendje që këtë muaj ta përsërisin çdo ditë përgjatë vitit!

### **Propagandë në vend të solidaritetit humanitar**

Zoti Fuqplotë nuk ua bën të mundshme humanitetin vjetor, sepse, këta shpirtkatila do të shqepeshin së vjedhuri e së keqtrajtuari të varfërit gjatë tërë vitit. Po si nuk ju shkon në mend që, të paktën, të hartojnë program e “strategji” se si gjatë muajit të Ramazanit të jenë sa më humanitarë, të kenë çdo ditë aktivitete humanitare, të kenë projekte, të kenë plan aksional për Muajin e agjërimit! Për shembull të hapin një xhirollogari të veçantë dhe, sapo të hyjmë në muajt e mëdhenj të nisin aksionin “Dononi një iftar për një familje të varfër”, projekti tjetër, të kërkojnë donacione nga gazetet, nga tregëtarët, nga firmat, nga biznesmenët e shumë shqiptarë, ta fitojnë besimin nga Oda Ekonomike e biznesit shqiptar të Maqedonosë Veriperendimore, të paktohen gjërat që janë me afat dhe, të donohen e të shpërndahen pakot të paktën një javë para se të nisë muaji i Ramazanit dhe, jo të fillojë, të nisin me agjërime mysimanët, t’i thyejnë gishtat nënat tërë ditën duke qarë se çfarë do t’ju shtrojnë fëmijëve për iftar dhe, fap, si me shkop magjik, “të pikë” pakoja te dera. Kjo formë nuk është humanizëm, kjo është propagandë! Myhybët e Shaqir Fetait, për momentin, po bëjnë vetëm propagandë dhe asgjë tjetër! Por, edhe kjo propagandë, të marrëve po ju del antipropagandë!

### **Qenan Ismaili nuk e ndërron peshkun, biftekun, me një pashtetë apo me një tavëll krip**

Në ditën e parë të agjërimit, Presidenti i Turqisë, Rexhep Taip Erdogan bashkë me bashkëshorten e vet, pak para iftarit, “i ikin” truprojeve dhe, dalin me makinën e tyre nëpër lagjet periferike të Stambollit. E vendosin që të ndalen në çastin që do të thërret ezani, kur të kallen kandilat dhe, të futen në një shtëpi, si mysafirë të paftuar e të papritur, për të bërë iftar me atë familje, qofshin edhe skamnorët më të mëdhenj. Familjarët u befasuan, u frikësuan e u turpëruan, por, shpirtgjërësia e presidentit turk i bëri që të ndjehen, të paktën, krenar dhe, familja më e nderuar e më fisnike në botë.

U ul presidenti turk bashkë me bashkëshorten e vet dhe e hëngrën iftarin e parë me një familje me kushte ekonomike nënmesatare! Hëngrën iftar dhe presidenti turk ngriti duart për ta bërë aminin e darkës, duke u lutur që Zoti t’ia prarojë duart me flori zonjës që e kishte përgatitur atë darkë, ndërsa kryefamiljarin Zoti ta shpërblejë me të gjitha të mirat e Tij për këtë mikëpritje! Familja u ndje si më e pasura në botë!

Ky gjest, aq më tepër i presidentit të një shteti, a nuk është humanizëm i llojit të vet! Cili është morali i këtij veprimi të Presidentit turk? Jo gjithnjë do të thotë humanitet dërgimi i një pako me artikuj ushqimorë në një shtëpi! Humanitet do të thotë edhe solidarizimi me një të varfër duke kaluar një çast të mirë nën kushtet e tij të rënda ekonomike.

Një veprim të tillë do ta urrente shumë “myftiu” i kontestueshëm i Shkupit, Qenan Ismaili, “doktori” i aktiviteteve turistike, sepse, ai nuk mund ta lë peshkun e biftekun e të nisë iftar me bukë e patlixhana. Qenan Ismaili nuk e merr fukarallëkun si sfidë, si sprovë të Zotit, por si Vullnet të Zotit që dikujt t’i japë e dikujt mos t’i japë. Prandaj dhe ky nuk i jep askujt, as edhe ngrohtësi njerëzore, as edhe mirësjellje. Pyetini miqtë me të cilët ka punuar në të kaluarën Qenan Ismaili! Të gjithë thonë se ai gjithçka mund të jetë por, njeri jo!

## **Dehumanizmi biletë e garantuar për në ferr**

Kohë më parë, Fadil Ramadani, përfaqësuesi i bastorexhinjëve në BFI, “kryetari” i Hilalit, ia “donoi” Myftinisë së Shkupit 1000 pako nga kontigjenti prej 4000 pakove të ardhur nga Turqia, me qëllim që gjatë muajit të Ramazanit të bëjnë humanitet!

Këto ditë “myftiu” Qenan Ismaili i paska mbledhur anëtarët e mexhliseve të xhamive si dhe të gjithë imamlerët dhe paska kërkuar prej tyre që të hartojnë lista me skamnorë secili nga terreni i vet, sepse do t’iu dërgohen ndihma! Dhe, ky aktivitet, para së gjithash, paska dëshmuar se sa unikë qenkan imamlerët e Shkupit rreth “myftiut” të tyre! Dhe ky pastaj ua ngulë të gjithë imamlerëve dhe “odbornikëve”, sepse, shpërndanë vetë 600 pako!

Në territorin e Myftinisë së Shkupit funksionojnë mbi 130 xhami! Mbi 130 imamlerë, mbi 500 odbornikë! Dhe, tërë ky numër “aktivistësh” dhe të thirrurish edhe për humanitet, paskan detektuar vetëm 600 të varfër në tërë këtë territor të Shkupit! Apo, kaq janë, imamlerë e odbornikë gjashtëqind vetë, nga një pako secili në shtëpi dhe, mbaroi humniteti! Jo, kjo nuk mund të ndodhë, sepse do të bëhet nami! I bie që, ky “komision” prej mbi gjashtëqind personave paskan dedektuar në secilin xhemat nga 3-4 familje të varfër. Pastaj, “sillet vendimi” i Qenan Ismailit që, të angazhohen të gjithë, secili me makinat e veta, t’i shpërndajë këto ndihma në pako dhe, askujt mos t’i tregohet se kush ua ka sjellë, kush i ndihmon por, t’u lihen pakot në oborr, pranë derës, pranë dritareve, në mënyrë sa më të fshehtë! Lihen pakot me amblemë të BFI- Hilal dhe, kjo do të thotë që “çka të jep dora e djathtë le ta dijë shtëpia dhe krejt bota (përmes fotove)”! Pakot të lihen në shtëpi të mëdha, në oborre të shtruara me bekatonka, me pllaka luksi, në shtëpi me dritare e dyer “en-fa-pen”, ndërkohë që në këtë territor janë nja 1000 familje që jetojnë në shtëpi me dritare prej najloni, që nuk kanë drita, që nuk kanë ujë, që oborrit e kanë tërë baltë, që inventar të brendshëm e kanë vetëm lagështinë dhe mykun!

Ku është gjesti islamik i Presidentit Turk, Rexhep Taip Erdohan! A nuk bën që “myftiu”, Qenan Ismaili, “kryehumanisti”, anëtarët e myftinive, odbornikët, imamët, t’ua japin familjes pakon dhe të kërkojnë që ta hanë iftarin bashkë dhe, me të dalur, t’ua lënë edhe një dorë lekë për ta paguar edhe ata të ngratë fitrin e agjërimit, apo, të kenë për t’ju blerë ndonjë këmishë fëmijëve për Bajram!

Edhe diçka! A kanë Myftinitë komisione të veçanta që do t’i verifikojnë të gjitha listat e hartuara, nga

imamët e nga mexhlisi i xhamive, me familje të varfëra të cilët do të përfitojnë ndihma humanitare nga donatorët e ndryshëm! A dalin këta komisione në terren për ta vlerësuar nivelin e varfërisë së këtyre familjeve, apo, unë ty, ti kushëritit, kushëriri djalit të hallës, daja tezes, tezja mixhës... Fukarai le t'i lutet Zotit dhe le të presë prej Atij kur Ky të bëjë rahmet!

Cili horr do me ia ditë për fukanë, për jetimin, për të ngratët! Zgjate Zot, lutet horri, sepse këtu e sheh përfitimin e vet personal.

Të bëshë propagandë djallëzore me humanitet në kulmin e varfërisë, është ngjashëm sikur në një fushë me prush të bëshë një shtëpi prej kashte. Kjo logjikë asocon ferrin, ë!

*(1Kliklart, 20.04.2021)*



## Filipçe, Shaqir Fetain nuk e bën hesap askush

Qenka realizuar dhe një takim në mes të dy përfaqësuesve (njëri legjitim e tjetri ilegjitim) fetarë me Ministrin e shëndetësisë, Venko Filipçe, me rastin e uljes së numrit të të infektuarve nga Koronavirusi! Takimi mbahet në prag të festave fetare, ortodokse dhe islame, duke vënë theksin në ndikimin e krerëve fetarë të pjesëtarët e tyre që mos të ndikojnë në përshkallëzimin e sërishëm të infektimit dhe të vdekshmërisë me tubime familjare në prag të festave.

Po pse, kjo punë qenka në duart e liderëve fetarë? U bë Filipçe që të na e diktojë se si ta festojmë në Ramazanin apo Bajramin! Mendon Filipçe se përmes Shaqir Fetait do të arrijë të ndikojë të myslimanët e vendit! Po kush ia ngulë Shaqir Fetait në vend?! Nëse kërkohet prej tij që të apelojë, për inat të tij do të vlojnë vizitat, qofshin këto me pasojë vdekjeje!

Në fakt, Shaqir Fetai edhe një herë ka pranuar që të diskriminohet dhe të ofendohet institucionalisht, si mos më keq! Shihni se si dallojnë karriget e liderëve ku janë ulur! Po cili lider fetar mysliman kishte lejuar që në tavolinë, derisa ai është agjërueshëm, të tjerët të pijnë e të bëjnë qejf. Ministri me kafe e kryepeshkoi me ujë përpara!

Po pse këta liderë gjytryma pranojnë një faj dhe një barrë që nuk u takon! Pse këta dy liderë nuk ia kanë thënë troç Filipçes se, numri i të infektuarve nuk është pasojë e festave fetare, dhe as e politikave shëndetësore të bashkësive fetare por, thjesht, është pasojë e politikave dëshpëruese të Ministrit dhe të kësaj qeverie!

Pse këta dy liderë fetarë nuk kanë ngritur zërin kundër paaftësisë së Ministrit të Shëndetësisë dhe të Qeverisë për të siguruar sa më shumë vaksina kundër Koronavirusit me qëllim që festat të kalohen sa më gëzueshëm. Pse kërkohet nga këta dy liderë të kontribuojnë në zbutjen e situatës kur politikat e ministrisë së shëndetësisë nuk kanë paraparë që, ndër të parët, të vaksinohen edhe nëpunësit fetarë të cilët për çdo ditë takojnë me dhjetra e qindra besimtarë! Pse diskriminohen në raport me ata që detyrat i kryejnë online?

Lidërët fetarë nuk janë pjesë e qeverisë që të marrin urdhëra dhe të zbatojnë urdhëra qeveritare. Instituconet fetarë janë “opozitë” e pushtetit në politikë, ndërsa në shtet janë tërësisht të pavarur dhe nuk kanë se pse ngarkohen me detyra qeveritare. Janë këta institucione që duhet ta ngarkojnë pushtetin me detyra e obligime që i kanë ndaj komuniteteve fetare!

*(Lajme7, 20.04.2021)*

## Takim sa për një flad ventilatori

Shaqir Feta, kur ndjenë se po ngel pa ajër, kur e mbytë një zagushi si pasojë e veprimeve të veta imorale, si pasojë e biografisë së tij të fëlliqtë, sakaq shpëtimin e kërkon prej pushtetarëve që e instalojnë në krye të BFI-së! Më me ëndje i ka takimet me pushtetarë të BDI-së! Vdes të takohet me ta, sepse, vetëm te ata ka besim dhe vetëm te ata e ndjenë atë shpëtimin e rrënimin të tij si të një druri të kalbur, pa gjethë e pa hije, në një oborr.

Sapo qenka takuar me Ministrin e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, z. Jeton Shaqiri, të cilin, që në fillim e paska falënderuar “për ndihmën dhe mbështetjen që Ministria të cilën ai e drejton ai, ia ka dhënë Bashkësisë Fetare Islame në RMV, sidomos gjatë periudhës së pandemisë globale të Kovid 19. Për këtë arsye, H. Hfz. Shaqir ef. Fetai i ndau një plakatë falënderimi Ministrit Jeton Shaqiri, për gjith kujdesin dhe mbështetjen”!

Se cili ka qenë impakti i kësaj ministrie në tërë këtë situatë pandemie brenda BFI-së këtë mund ta djë vetëm Shaqir Fetai, i cili, në rastin konkret tërësisht shpërfytyrohet në një mjet me cilësi të tokmakut! Sipas Shaqir Fetait, tani më e paskemi kaluar periudhën e Kovid 19, paskemi dalur shumë të suksesshëm dhe, prandaj, Ministri e meriton një mirënjohje!

Tutje, nga informata rreth kësaj “ngjarje madhështore” të Shaqir Fetait, na thuhet: “Nga ana e tij, Ministri Jeton Shaqiri, është i qëndrimit se shteti dhe administrata publike është kontakti i parë i qytetarëve me shtetin”! Po po, mos mendoni se jeni në lajthitje, pikërisht këtë e mendon ky Ministër, ose, shërbimet e Shaqir Fetait ia ngulin ministrit duke e paraqitur atë tërësisht “gllup”!

Ai e paska bindur Shaqir Fetain se digjitalizimi i plotë i shërbimeve nënkupton arritje më e lehtë të standardet evropiane!

Me këtë konstatim, Shaqir Fetai mund të mendojë se mund t'i digjitalizojmë edhe shërbimet tona fetare. Për shembull, sipas mendjes së Shaqir Fetait, mund ta digjitalizojmë një namaz me xhemat dhe, pastaj, këtë pamje ta lëshojmë nga pesë herë në ditë, në çdo vakt të namazeve, kështu që, xhemati virtualisht do të ishte prezent në xhami dhe, me këtë, do t'i kryente obligimet e veta fetare për sa i përket namazit. Po kështu, mund ta digjitalizojmë edhe agjërimin, por, assesi nuk mund të digjitalizohet dhënia e fitrit, zeqatit, therrja e kurbanëve, kryerja e haxhit, sepse, këtu janë paratë që i pret Shaqir efendia!

Epo tani, kur Shaqir Fetai i jep vetes të drejtë që të tallet me një shoqëri të tërë, duke propaguar se Ministria e shoqërisë informatike paska ndihmuar shumë BFI-në në kohë pandemie, atëherë, pse mos të luhet pak mastrapalla edhe me Shaqir Fetain. E meriton ky talljen, natë e ditë, për çdo çast e në çdo minut, sepse, ky një jetë të tërë e ka ngritur duke u tallur me myslimanët dhe me fenë e tyre, duke i parë atë si kërma (coftina) të përshtatshme për ORAO-n!

*(Mileniumi3, 20.04.2021)*

## **“Posllushniku” gjithmonë del fitimtar. Kështu i duket atij!**

**Myslimanëve të Maqedonisë së Veriut, fort mirë u kujtohet kur, tash e një vit më parë, ish-reisul ulema i BFI-së, Sulejman ef. Rexhepi, bëri “një skandal”, duke e kërcënuar shtetin në shndërrimin e tij në Bangladesh! H. Sulejman ef. Rexhepi e kishte hallin e imamlerëve të vendit, të cilëve “ua kishin mbyllur” xhamitë dhe, praktikisht, i kishin lënë pa rroga, në emër të masave kundër përhapjes së koronavirusit**

Nga BE Maqedonisë së Veriut ia kishin ndarë një fond të konsiderueshme si kontribut- ndihmë për t’i zbutur sado pak pasojat në ekonominë e vendit. Qeveria ishte vendosur që t’u ndajë rrogë të gjithë atyreve që kishin ngelur pa punë si pasojë e pandemisë. Kësaj kategorie, sipas H. Sulejman ef. Rexhepit, i përkisnin edhe hoxhallarët e vendit, ndaj dhe kërcënohej që, nëse nuk përfshihen hoxhallarët në këto pagesa, do t’i hapte xhamitë dhe nuk do të mbante përgjegjësi nëse ky vend do të rrezikohej ngapërhapja masovike e pandemisë. Sepse, njerëzit filluan të kenë nevojë edhe për rroga, përveçse për masat mbrojtëse nga Covid 19.

Mirëpo, njëri prej bashkëpunëtorëve “më të ngushtë” të H. Sulejman ef. Rexhepit, Myftiu i Gostivarit, Shaqir Fetai, do të japë isharet se do ta tradhëtojë tërë projektin e reisit të vet, me qëllim që ta shpëtojë kryeministrin që po binte në një grackë të fortë. Pse mos ta shpëtojë?! E mira kthehet me të mirë!

Në fakt, Shaqir Fetai kishte informacione se po përgatitej një komplot kundër Sulejman Rexhepit, prandaj, aq guximshëm do ta minojë projektin e tij! Do të dalë, si Myfti i vetëm, dhe do të deklamojë se të gjithë hoxhallarët janë pareli, marrin rroga të majme, ka apo nuk ka pandemi, prandaj, kishte vendosur edhe në emër të hoxhallarëve të Gostivarit që, kush 30 për qind, kush 20 e kush 15 për qind, të gjithë të heqin dorë për aq përqindje nga rrogat e tyre dhe, kësisoj, të rrënohet tërë angazhimi me shpirt i H. Sulejman ef. Rexhepit që t’i përfshijë në paketa ndihmash të pushtetit edhe hoxhallarët e vendit. Me këtë lëvizje të Shaqir Fetait, do të humbin të gjithë hoxhallarët e vendit, ndërsa do të fitojë ekskluzivisht Shaqir Fetai.

Kjo tradhëti do t’i shpërblehet Shaqir Fetait me qëndrimin pas shpine në deklarin publik të tij se e shkarkon Sulejman Rexhepin dhe se, tash e tutje, me bekimin e pushtetit maqedonas, për “reis” do të jetë vetë Shaqir Fetai.

Kjo ishte ajo filozofi “E mira kthehet me të mirë”! Të gjithë iu gëzuan largimit të problematikut Sulejman ef. Rexhepi, i cili, ishte një barrë e papërballueshme për cilindo pushtet që vinte në Maqedoninë e Veriut. Tani ka ardhur “i gatshmi”, “nusja”, ai që kthen prapanicën për cilindo pushtet që vjen, sepse është strashno “posllushnik” i mirë. Aq i mirë dhe aq shërbëtor i devotshëm që është sa, edhe pushteti maqedonas nuk ia lë pa ia kthyer “të mirën” me të mirë! Vetë Shaqir Fetai, në një intervistë, në një televizion lokal, këto ditë tha se ”pushteti aktual na ka ndihmuar, na jep rrogë tash e pesë muaj”!

A mos po i kushton pushtetit aktual maqedonas Shaqir Fetai më shtrenjtë se sa Sulejman Rexhepi?! H. Sulejman ef. Rexhepi kishte kërkuar që të përfshihen të gjithë hoxhallarët e vendit në një pagesë që vinte nga donacioni i BE-së, që nuk kapte shumën më të madhe se 14 mij denarë! Kurse Shaqir Fetait dhe “nëpunësve” të tij po i sigurohet rrogë qe pesë muaj. Veç nuk dihet, për kë po e siguron këtë rrogë: për të gjithë hoxhallarët apo vetëm për “rijasetin” dhe shërbimet e Shaqir Fetait.

Le t’i bëhet e qartë edhe një herë Shaqir Fetait: H. Sulejman ef. Rexhepi këronte për të gjithë imamët e vendit rrogë nga fondi humanitar që vinte nga BE! Kërkonte mbi 1000 rroga; kërkonte që hoxhallarët, që të gjithë, të jenë në buxhetin e BE-së!

*(1Kliklart, 22.04.2021)*

## Strategjia e re për vjedhjen e fitrit dhe zeqatit

**Strategjia e Shaqir Fetait për të dalë sa më i suksesshëm në tubimin e fitrit, shpreh hiokrizinë që tek ai ka lëshuar rrënjë gati një deçenie më parë. Atëherë kur nisi rënia drastike e grumbullimit të fitrit, si pasojë e vjedhjes në terren dhe jo në zyren e reisit. Urdhëri mund të nxirret nga “zyrja” por fitri vidhet në terren, përgjatë rrugës deri sa të dorëzohet në ZYRE**

### Shkruan Fehmi Memeti

Po flitet për një “strategji” shumë djallëzore në grumbullimin sa më të efektshëm të fitrit dhe zeqatit. Parulla është: “Tani e dëbuam njeriun që na i vidhte fitrat, jepni sa më shumë se nuk ka kush t’i vjedhë më”!

“Myhybët” e Shaqir Fetait dhe të “paraleles” së Stanko Dragoviçit, po përhapin propagandë se fitrat na i paskësh vjedhë ish-reisi, Sulejman ef. Rexhepi, ndërsa trimi, Shaqir Fetai, i cili arriti ta largojë “hajnin”, e meriton një respekt më të gjërë i cili duhet të shprehet përmes dhënies masovike të fitrit në BFI!

Po si na i paska vjedhur fitrat Sulejman ef. Rexhepi? Kur doli ai që t’i mbledhë, kur pati takim me imamët dhe ju tha, fitrat që do t’i mbledhni t’m’i dorëzoni mua në dorë! Me cilin nëpunës myftinive, mbledhës të taksave fetare, pati takim të fshehtë apo marrëveshje interne për t’ia dorëzuar pikërisht Sulejman Rexhepi çdo gjë që do të mbledhin nga xhemati!

Me sa e dimë, Bashkësia Fetare Islame ka pasur rregullore financiare, të cilën e kanë miratuar me aklamacion, të gjithë anëtarët e Rijasetit, përfshirë këtu sidomos myftinjtë dhe komisionet e myftinive të cilët kanë qenë të angazhuar për dorëzimin e financave të grumbulluara nga fitri, zeqati e kontributet vullnetare, në arkën qendrore të BFI-së. Le të supozojmë se përqindja ka qenë në raport përkatësisht 70 për qind në BFI dhe 30 për qind në Myftini! Të gjitha të hyrat financiare në organet e BFI-së, me automatizëm 70 për qind dorëzohen në arkën qendrore të BFI-së, prej nga pastaj mbulohen të gjitha shpenzimet për zhvillimin e jetës fetare islame, konkretisht, për mirëmbajtjen e Medresesë “Isa Beu” si dhe të FSHI-së!

Tani, ky 70 për qindëshi i dorëzuar (!!!) te ish-reisi Sulejman ef. Rexhepi, po shihet se ku qenka shpenzuar: në mirëmbajtjen e medresesë, në furnizimin e guzhinës së kësaj Medrese, në mirëmbajtjen e Konviktit të Medresesë (zëvendësim të krevateve të amortizuar, në blerje të batanieve, të qershavëve, të nënkresave, pagim të dritave, nxemjes, ujit etj.), në pagimin e rrogave të mbi 170 profesorëve, në mirëmbajtjen e Fakultetit të Shkencave Islame, në organizimin e eventeve fetare islame, në mbulimin e botimit të revistës “Hena e Re”, ashtu edhe të literaturës fetare islame!

Po myftinitë me atë 30 për qindëshin që e mbanin për vete – le të na tregojnë sa i kanë ndarë imamëvr dhe sa e kanë mbajtur për vete! Si i kanë shpenzuar të hyrat e grumbulluara nga djersa e myslimanëve të vendit. Vetëm mos të na tregojnë se si i kanë blerë veturat lluksoze, se si i kanë

shtruar oborret gjigante me bekatonka, mos të na tregojnë se si kanë ngritur shtëpi dy-tri katëshe, si kanë vndërtuar vila nëpër male, mos të na tregojnë se si i kanë shkolluar fëmijët nëpër qendra të ndryshme ndërkombëtare, sepse, të gjitha këto nuk arrihen me një rrogë modeste të myftiut, referentit etj.!

Dhe, poligon për ta përhapur këtë propagandë e paskan gjetur pikërisht Myftininë e Kumanovës, (duke e planifikuar edhe atë të Gostivarit, Dibrës, Kërçovës, Strugës, Ohrit dhe Prilepit) sepse, pikërisht në këtë Myftini janë gjetur gjurmët e vjedhjes ashiqare të takave fetare islame. Në këtë Myftini u kapën blloqet fallce të vërtetimeve “arka pranon”, të botuara (dihet edhe shtypshkronja se ku janë botuar!), blloqe paralele, me numra serikë të njëjtë me ato të “arka pranon” të botuar nga Rijaseti i BFI-së! Në vend se t’i shpërndanin ato “arka pranon” nga blloqet e BFI-së dhe të dihej numri i sakë dhe sasia e fitrit të dorëzuar, referentët e Myftinisë së Kumanovës, me dijeni të Myftiut shpërndanin “arka pranon” nga ato që i kishin botuar vetë. Natyrisht, kjo pjesë e fitrit futej nëpër xhepat e tyre ndërsa në BFI dorëzohej një sasi dëshpëruese e cila vetëm për të vjedhur nuk të jepte mundësi! Pra, fitri dhe zeqati i Myslimanëve vidhej rrugës për në arkën qendrore që ruhet tri katër zyre larg zyres së reisit.

Të gjithë kumanovarët janë të befasuar nga pasuria e arritur të nëpunësve aktual të Myftinisë së Kumanovës! Ku përfunduan fitri, zeqati, qerata nga vakëfet, kontributet vullnetare ndërsa, BFI-ja e Shaqir Fetai të bëhet për ndihma nga buxheti i pushtetit! Sulejman Rexhepi viteve të fundit, pa ndarë e përsëriste porosinë e mikut të tij, ambasadorit amerikan që, në asnjë mënyrë mos të lejojnë që BFI-ja të subvencionohet nga buxheti i shtetit. Kurrë!

Edhe diçka! Pas miratimit nga Rijaseti të rregullores financiare të BFI-së, Sulejman ef. Rexhepi formoi komisione dhe, bashkë me ta nisi të dalë në terren, të inspektojë gjendjen financiare të çdo myftinie si dhe të institucioneve arsimore të BFI-së! Në Rijaset asnjëherë nuk pati vërejtje gjatë debateve mbi raportet vjetore dhe raporte e llogarive përfundimtare të Rijasetit, as se H. Sulejman f. Rexhepi po vjedh! Ndërsa kur ky nisi që t’i inspektojë dhe kur nisi të gjejë keqpërdorime flagrante të financave nga myftinjë të caktuar si dhe nga drejtues të institucioneve e të shërbimeve profesionale të BFI-së, atëherë të gjithë u xhindosën dhe, strehën nisën ta gjejnë nën sqetullat e shërbimeve sekrete policore. Kjo, derisa u grumbulluan të gjithë dhe kërkuan shpëtimin e përbashkët nga zberthimi diskreditues i mëtejme që po ua bënte H. Sulejman ef. Rexhepi. Dhe, zgjidhjen e gjetën në grumbullimin në një, nën ombrellën e shërbimeve intelektuale dhe, me fuqinë e përbashkët për ta dëbuar H. Sulejman ef. Rexhepin, t’ia pamundësojnë inspektimin e mëtejme si dhe zbulimin e tyre nga petku i “devotshmërisë” prej djalli! Ata e dëbuan pa pyetur nëse ai kishte dokumenta, helbete “dosje” për secilin myfti, drejtues të institucioneve apo shërbimeve profesionale të BFI-së!

Akuzuan Sulejman ef. Rexhepin se paskësh shkelur nenin 58 të Kushtetutës, nen ky që nuk mund të shkellet pa përkrahjen dhe mbështetjen e anëtarëve të Rijasetit, përkatësisht, pa mbështetjen e myftinjëve! Nëse këta myftinjë, të njëjtit e kohës së H. Sulejman ef. Rexhepit, ia paskan lejuar, ia paskan mundësuar dhe e paskan motivuar që të vjedhë sa më shumë fitra e zeqat, atëherë, pse të njëjti nuk do ta mbështesin, nuk do ta përkrahin dhe nuk do ta motivojnë edhe Shaqir Fetain për t’i vjedhur fitrat, zeqatet, kontributet vullnetare të myslimanëve të vendit, duke e mësuar edhe si t’i fshehë gjurmët e hajnisë. Shaqir Fetai në të kaluarën ka dëshmuar se është hajn profesional, keqdashës i vakëfit dhe mjeshtër i zhvatjes! Egzistojnë fakte e dokumenta!

Sulejman Rexhepi asnjëherë nuk e pati mundësinë e botimit të blloqeve paralele të dokumentit financiar “arka pranon”, ndërsa këtë mundësi e patën dhe e ushtruan Myftinjët si dhe nëpunësit e tyre. Prandaj dhe, çdo vit e më pak dorëzoheshin fitra dhe zeqat në BFI, plus pastaj prej asaj të dorëzuarës 30 për qind ngelnin në Myftini! Hajni e shumëfishtë!

Myslimanët e vendit janë shumë të vetëdëshëm se, dëbimi i Sulejman Rexhepit dhe vazhdimi i avazit të vjetër i bashkëpunëtorëve të tij të ngelur secili në vend të vet, nuk është zgjidhje, por, vazhdimësi e vjedhjes, e zhvatjes, e punëve antiislame “të myftinisë së Gotivarit me seli në Shkup”! Tani duhet vetëm të gjendet një “kurban” se kush do të jetë fajtori i këtij dështimi! Dikur na paska qenë H. Sulejman ef. Rexhepi, të cilin e përkrahën në çdo veprim, e përgëzuan, e trimëruan dhe i duartroktën deri në urdhërin policor “tërhiquni”! Dëbojeni, tani!

*(Kombetare, 22.04.2021)*

## Si e diskrediton veten Shaqir Fetai

**Me gjasë, Shaqir Fetai vazhdon të vuaj nga “jugo-nostalgjia”! Shumë takime me delagacione nga Bosnja dhe, së fundmi, edhe vetë prezenca e tij në Bosnjë! E ka këtë sindrom apo e ka kompleksin e “ORAO”! Nostalgjinë mund ta zbusë me një vizitë, dosjen policore nuk mund ta zhdrukë sikur edhe të shpërngulet përjetë në Sarajevë. Kot e ka**

Shaqir Fetai na paska shkuar në Sarajevë për ta nënshkruar një memorandum me përfaqësues të RABITA-s për “Shportën e Ramazanit”! Në mes të Muajit të Agjërimit nënshkruan një aktivitet që mund të realizohet në agjërimin e ardhshëm! Shëndosh vitin tjetër! A nuk është kjo një sjellje sa ironike aq edhe më shumë cinike me myslimanët e vendit! Paska nënshkruar edhe një memorandum tjetër bashkëpunimi! Sot do ta vizituaka edhe Fakultetin e Shkencave Islame. Madje do të takohet edhe me ndonjë përfaqësues nga ky Fakultet apo edhe nga Rijaseti i Bosnjës!

Dhe, të gjithë këto aktivitete, a e zgjidhin problemin e BFI-së?

A e tejkalojnë atë sëmundje të Shaqir Fetait për ta shkëlur Kushtetutën e BFI-së në çdo orë?

A i rregullon marrëdhëniet ndërnjerëzore katastrofale (madje buzë kacafytjeve fizike) në BFI?

A zgjidh ndonjë situatë financiare? A e shton vakëfin?

A e rritë rolin dhe peshën e BFI-së si dikur që e kishte në qarqe ndërkombëtare?

Jo, sepse, Shaqir Fetai nuk e ka këtë hall! Shaqir Fetai akoma nuk e ka vizituar Universitetin e Bedrit në Shqipëri, as Fakultetin e shkencave islame në Kosovë. Shaqir Fetain e ka marrë malli të eci korridoreve, labirintheve dhe zyreve ku me lezetin e vet më të madh tek udbashët i ka spiunuar studentët shqiptarë që kanë studiuar në atë Fakultet!

Shaqir Fetai nuk e ka dert BFI-në, nuk i intereson BFI-ja, nuk e përfaqëson askund BFI-në! Shaqir Fetai gjithkund ku prezanton shitet si përfaqësues i Shtetit të Maqedonisë së Veriut! Atij nuk i bën nder të vështrohet si përfaqësues i Institucionit të BFI-së! Ai mendon se është burrështetas, se është diçka si Talat Xhaferri, ndonjë kryetar parlamenti, apo, si Artan Grubi, ndonjë ministër apo deputet. Ai nuk e prezanton BFI-në! Këtë katërcipërisht na e qartësojnë fotografitë në të cilat ai del si gjeldet, i fryrë si manjak.

Kushtetuta e Bashkësisë Fetare Isame, Neni 4, thotë: “BFI ka flamurin dhe emblemën e vet. Flamuri i BFI-së ka ngjyrën e gjelbër, gjysmëhënën e bardhë dhe yllin pesërrembësh me ngjyrë të bardhë i vendosur në mes të gjysmëhënës së hapur e kthyer nga shtiza, në formë horizontale.”

Pra, nëse Shaqir Fetait i duhet në tavolin flamur, ai duhet të jetë Flamuri i BFI-së, sepse ai këtë e përfaqëson.

Përfaqësuesi i RABITAS në tavolinë, në anën e vet, e kishte të vënë Flamurin e Rabitas dhe jo, as atë të Bosnjës dhe as atë të Arabisë Saudite. Po Shaqir Fetat ç’i duhet Flamuri i Shtetit të Maqedonisë së Veriut në tavolinë! Çka dhe kë e përfaqëson Shaqir Fetai? Në cilat axhenda është i futur Shaqir Fetai? A janë duke e përcjellë ata “faktorë” që e instaluan dhunshëm në krye të BFI-së apo me aq ka përfunduar misioni i tyre antiislamik!

Se nuk i intereson Shaqir Fetait BASHKËSIA FETARE ISLAME dëshmon edhe heshtja e tij, mosreagimi i tij kundër talljes bosnjake me titullin e Institucionit të vetëm fetar islam në Maqedoninë e Veriut. Lëre që nuk reagon dhe nuk kërkon emërtim të saktë të Institucionit por, e bart në faqet zyrtare të BFI-së qëndrimin nonshalant, injorues dhe politikisht shumë të dëmshme të palës

boshnjke!

Ja çfarë mysafiri kanë pritur! Nuk ia njohin as titullin, as Institucionin që përfaqëson Shaqir Fetai! Sjellje e ngjashme si e serbëve kur takohen me ndonjë përfaqësues të Republikës së Kosovës, ndërsa raportojnë se u takuan me një “qytetar nga krahina serbe e Kosovës dhe Metohisë”!

Shqiptari nuk e duron një sjellje, një dezinformim, një injorim të tillë nonshalant, ndërsa Shaqir Fetai e pranon, sepse ndjenë lezet shpirtëror sa herë që diskreditohet! Shaqir Fetai sot nga drejtues të Fakultetit të shkencave islame në Sarajevë do të kërkojë një vërtetim që do të dëshmojë se “Shaqir Fetai si student ka qenë studenti shqiptar më i mirë, më i dashur, më i dalluar, më i ndershëm, më i moralshëm që me mish e me shpirt i është përkushtuar studimit dhe se nuk ka pasur kurrfarë pune me shërbimet e huaja, aq më pak me ato të UDB-së”! Këtë vërtetim po e kërkon dhe po e pret prej boshnjakëve Shaqir Fetai! Ndërsa pala boshnjake është në një siklet të madh, sepse nuk është ai institucioni që jep vërtetim lustrimi të qytetarëve të botës! Se a ka qenë spiun Shaqir Fetai apo nuk ka qenë, këtë nuk mund ta dinë strukturat aktuale dhe post-jugosllave të Bosnjë-Hercegovinës! Po përcillet nga Bosnjë-Hercegovina se Shaqir Fetai ka ngelur i zhgënjyer dhe, nuk po lëshon fare udhë nga qëndrimi i tij këmbëngulës në sigurimin e një dokumenti/vërtetim të tillë nga Fakulteti ku ka studiuar; po ndjehet i zhgënjyer dhe i hidhëruar! Dhe deri më tani nuk e shprehu as më të voglin zhgënjim dhe hidhrim me arkivat serbë apo me Dragoviqët që ia publikuan një prej faqeve nga dosja e tij policore serbe prej qindra faqeve.

*(Skandal, 23.04.2021)*



## Saktësia milimetrike e epitetit

**Epitet shumë i rëndë? “Shaqir Fetah rrencaku” ishte titulli i një shkrimi të ribotuar në shumë portale! Deri më sot, që kur njihet ky farë kleriku, të gjithë faktet flasin se është rrencak i pakonkurrencë! Hafëz, por ama, në biseda të lira, të thanë me rrena. Kështu e vlerësojnë të gjithë ata që kanë pasur punë me të. Rrencak i pakonkurrencë. Përrt syri nuk i bën! Rrenë pa fije turpi e frike, sepse, damarëve të tij rrjedh vetëm rrena, prandaj, nuk skuqet kurr rrenë, sepse, nuk ka gjakë, ka vetëm rrena**

### Shkruan Zylbehar Fetahu

Edhe shejtani në fillim ishte i mirë e pastaj zgjodhi të bëhet shejtan, duke i shpallur luftë Zotit në përvetësimin e krijesave të tij përmes aftësisë djallëzore. Çdo gjë që ka krijuar Zoti e krijoi në harmoni të plotë e në balansim të kosmosit, duke ruajtur secili vendin e vet! Kush nuk e deshti këtë harmoni, kush nuk ra në sexhde në vendin e vet, kush e synoi debalansimin e shpirtit, ai u rreshtua pas shejtanit, duke e përdorur si mekanizëm mbrojtës pikërisht rrenën! Pra, kush rrenë, Zoti e ka mallkuar si ushtarë të shejtanit, i destinuar për ta luftuar të vërtetën dhe vetëm të vërtetën!

Ku mund të bazohet njeriu për ta emërtuar Shaqir Fetain me epitetin RRENCAK! Janë të shumta faktet, janë të shumta veprimet e tij, është një biografi e tërë e tij, janë shumë rrëfime që tregohen për të, janë dëshmi të gjalla. Mbi të gjitha ai rrenë edhe kur i thotë vetes “hafiz”! Ai mund të dijë pkesë nga Kurani përmendësh, por, titullin “hafiz” nuk guxon ta keqpërdorë, sepse, HAFËZI është mbrojtës i së vërtetës, i fjalës së Allahut të Gjithëdhënësit, dhe jo kalitës i RRENËS që është frymëzim shejtani!

Ku rrenë Shaqir Fetai? Kur ka rrejtur? Si ka rrejtur? Pa fakte – është epitet i rëndë, fyes, denigrues! Le të sjellim këtu vetëm disa detaje të një viti, vit ky që mund të llogaritet si më i pjellshmi plotë me rrena të Shaqir Fetait:

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se kurrë nuk është përpunuar nga vjehri i tij (baballëku) për t’u kyçur në linjën e tij të spiunazhit të krijuar nga Temelko Boshkovski, udbashi më i tmerrshmi për shqiptarët e Maqedonisë perëndimore;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se e shkarkuam Sulejman Rexhepin sepse kishte shkelur nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së, ndërkohë që i fsheh instrukcionet e shërbimit sekret maqedonas si dhe mbështetjen e pushtetit aktual maqedonas;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se u krijua opinioni për shkarkimin e Sulejman Rexhepit, ndërkohë që e fsheh involvimin e BDI-së në përpjekjet e përbashkëta për ta rrënuar BFI-në;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se Sulejman Rexhepi shkarkohet duke u mbështetur në procesverbalin e mbledhjes, ndërkohë që e fsheh urdhërin e shërbimit sekret maqedonas për t’i tubuar të gjithë “myhybët” e vet dhe pa kurrfarë mbledhje ta kryejnë nismën e rrënimit të themeleve të BFI-së;

-Shaqir Fetai gënjenë kur thotë se ka qenë i detyruar në këtë hap vetëm për ta shpëtuar unitetin dhe dinjitetin e BFI-së, ndërkohë që kundër këtij uniteti dhe kundër këtij dinjiteti ka punuar më se tri dekada rresht;

-Shaqir Fetai rrente edhe atëherë kur vetja i dukej herë “reis” e herë “u.d. reis”, rrente edhe atëherë

kur fonte qytetarë të ndryshëm për të pirë çaj e kafe, ndërsa i paraqiste si urues dhe përshëndetës;

- Shaqir Fetai rrenë sa herë që hapë gojën për t'u treguar i sinqertë, sepse, është prototip i njeriut/dhëlpër – rrencak, intrigant, tradhëtarë dhe “vrasës i vëllazërisë” së një trupi institucional;
- Shaqir Fetai rrenë kur thotë se do të mundohet ta avancojë jetën fetare islame, sepse, nuk është kjo detyra e tij me të cilën e kanë ngarkuar, por, detyrë e tij është “bëdëizimi i betonuar” i BFI-së;
- Shaqir Fetai rrenë kur thotë se ka dhënë kontribut tridhjetë vite në BFI për mbarëvajtjen e punëve, ndërsa, tani paska kuptuar se gjithçka paska qenë e kotë dhe se vetëm tash e tutje do të jetë mirë;
- Shaqir Fetai rrenë kur thotë se do ta bëjë “xhenet” BFI-në dhe nuk pranon se në fakt po bën vetëm “petlla n’ujë”;
- Shaqir Fetai rrenë kur thotë se “më zgjodhën” ndërsa në fakt është shembulli i puçistit klasik, që për ta marrur pushtetin ndihmohet nga ushtria, policia, nga shërbimet sekrete, nga shërbimet e huaja;
- Shaqir Fetai rrenë kur thotë se jemi të gjithë “unikë” ndërkohë që shikohet si një bastard ndaj dhe refuzohet prej shumicës absolute të nëpunësve të BFI-së dhe të myslimanëve të vendit;
- Shaqir Fetai rrenë kur thotë se në BFI veprohet në pajtim me aktet normative të këtij Institucioni ndërkohë që është shkelësi më i madh i Kushtetutës që kur e ka BFI-ja;
- Shaqir Fetai rrenë kur thotë se veprimet e tij gjejnë përkrahje të gjërë, sepse veprimet e tij në fakt janë vepra të rënda penale;
- Shaqir Fetai rrenë kur thotë se gëzon përkrahjen e teologëve, sepse, në fakt ai gëzon vetëm përkrahjen e politikave antishqiptare dhe antiislame në vend gjë kjo e dëshmuar katërcipërisht;
- Shaqir Fetai rrenë kur thotë se veprimet e tij kanë përkrahje nga “rijaseti” kur dihet se të gjitha veprimet e tij janë antikushtetutare, janë vepra penale dhe, të motivuara nga djallëzia e tij;
- Shaqir Fetai rrenë kur thotë se është për transparencë kur në fakt i ik të gjitha ballafaqimeve publike, sepse në debate zbulohet tërësisht si rrencaku më i madh i “ushtrisë së djallit”;
- Shaqir Fetai rrenë dhe, me rrenën e tij i ofendon tërë “ulemanë” kur thotë se, ai u zgjodh “reis” sepse nuk mund të zgjidhet reis ai i cili për tridhjetë vite rresht ishte krahu i djathtë dhe më i dashuri i atij që e paskësh shkelur tridhjetë vite Nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së;
- Shaqir Fetai rrenë kur thotë se do të jetë kooperues me faktorin e jashtëm për të kontribuar për paqe të brendshme, ndërkohë që ai po e legalizon kriminalitetin dhe eksremizmin në BFI;
- Shaqir fetai rrenë kur thotë se angazhohet për unitet, sepse, në fakt, ai angazhohet për unitetin e atyre përkrahësve të tij në shkeljen e Kushtetutës së BFI-së, në tradhëti e në spiunllëk;
- Shaqir Fetai rrenë kur thotë se përmes konferencave për shtyp i paska sqaruar tashmë të gjitha gjërat, ndërkohë që, konferencat për shtyp janë veprime publike, që i sheh e i mbanë mend tërë opinionin. Shaqir Fetai ka mbajtur dy konferenca për shtyp edhe atë sa për të gënjyer e për t'u promovuar si nana e rrenës;
- Shaqir Fetai rrenë kur thotë se na e paska themeluar Medresenë, sepse, kur u themelua kjo vatër e mesme arsimore islame, ai kishte po atë peshë dhe vlerë sa të të gjithë myslimanëve të vendit;
- Shaqir Fetai rrenë kur thotë se funksionojnë pesë medrese, sepse në fakt është vetëm Medresja “Isa Beu” me pesë paralele të saj të dispersuar në pesë qendra të vendit;
- Shaqir Fetai i rrenë edhe qarqet ndërkombëtare, tek të cilët, fill pas puçit që e bëri në BFI, nisi të propagojë se ai u zgjodh “reis” apo “u.d. reis” përkundër të gjitha akteve normative të Kushtetutës së BFI-së;
- Shaqir Fetai rrenë kur thotë se kemi analizë mbi punët që janë vepruar në të kaluarën në BFI, sepse, të gjitha procesverbalet thonë se në çdo raportim vjetor dhe kalim të buxheteve dhe llogarive përfundimtare vjetore, më i zëshmi për t'i kaluar pa problem ka qenë pikërisht Shaqir Fetai, Myftiu i Gostivarit;
- Shaqir Fetai rrenë kur thotë se kemi kthyer prona të vakëfit ndërkohë që ka humbur vakëfin disa

milionëshe në qendër të Gostivarit si dhe ka heshtur në grabitjen e tokës së varrezave myslimane në Tetovë, në Bllokun 57A, në hapësirën e ish-fabrikës së falimentuar, Shik “Jellak”, ku do të ndërtohen 230 mij metra katëror banesa të reja për 8000 banorë;

-Shaqir Fetai gënjen kur thotë se administrata e BFI-së ka nxjerrur dokumenta nga arivi i BFI-së dhe e ka mbushur krejt botën, ndërkohë që dokumentat i kanë xjerrur ekskluzivisht bashkëpunëtorët e tij të sotëm sa për ta diskredituar ish-reisul ulemanë;

-Shaqir fetai rrenë kur të tjerëve u prezantohet si “reis”, sepse në të vërtetë është vetëm drejtues i një grup rrencakësh, vjedhësish, teologëve të rremë, falsifikatorëve, bashkëpunëtorësh të shërbimeve të huaja, kriminelë e imoralë, antikombëtar e antiislamistë (nëse do edhe ia përmendim emrat e këtyre personave të inkriminuar thellë në krim e korrupsion, të cilëve u prinë Shaqir Fetai; nëse do ia dokumentojmë edhe veprimet imorale që i kanë bërë e me ç’gjë Shaqir Fetai është ndjerë krenar);

-Shaqir Fetai e rrenë diplomatin e vendit duke ia puthur edhe dorën, ndërkohë që kundër tij ka miratuar shkresa, vendime këto të Rijasetit kundër ambasadorit që kanë qenë kushtëzime për bashkëpunim në mes të BFI dhe qeverisë maqedonase;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se e duan shumë fort arabët dhe ndërkombëtarët, ndërkohë që e urrejnë shqiptarët dhe myslimanët e vendit dhe të rajonit, sidomos pasi u faktua se ka qenë bashkëpunëtorë i UDB-së me nofkën “ORAO”;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se ka filluar reforma në BFI ndërkohë që bashkëvepron me tërë stafin e ish-reisit si dhe, e vetmja reformë që është bërë, Myftininë e Gostivarit e ka sjellë në selinë e BFI-së në Shkup;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se BFI-ja është “institucion i maaadh dhe serioz”, ndërkohë që BFI-ja është shndërruar në të vetmin Institucion në botë ku masakrohet Kushtetuta, edhe atë sipas planeve dhe projekteve të Shaqir Fetait që i ka huazuar në nëntokën e shërbimeve të huaja;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se e paska ekipin e bashkëpunëtorëve shumë profesionistë dhe stabilë, sepse, e vërteta është që të gjithë i ka ilegjitimë, disa mr diploma të falsifikuara, kuazi-myftinj dhe të padenjë për një ballafaqim televiziv as me qytetarin më të thjeshtë të vendit;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se u krijua opinionin negativ për Sulejman Rexhepin, ndërkohë që fiks 7 ditë përpara se t’ia bëjë puçin deklaroi se, Sulejman Rexhepi është figurë markante, e papërsëritshme në lidhshin shqiptar dhe se ka kontribute të pamohueshme për mbarëvajtjen e derisotshme të BFI-së, organeve dhe institucioneve të saj;

-Shaqir Fetai rrenë kur prezantohet si teolog, sepse, në fakt, ai është vetëm një fuks i vogël nën çallmë;

-Shaqir Fetai rrenë se paska kontriut të madh në ndërtimin e FSHI-së, sepse ky Institucion pa dritë vetëm falë PPD-së dhe të ndjerit Abdurrahman Haliti që bashkëpunuan me BFI-në dhe Sulejman Rexhepin për ta filluar ndërtimin e Fakultetit të shkencave islame, ndërkohë që, Shaqir Fetai, me preferenca nga Stanko Dragoviqi, bashkëpunonte me shërbimet sekrete të vendit dhe me Temelko Boshkovskin për të dëmtuar sa më shumë shqiptarë e myslimanë si dhe projekte kombëtare e fetare. Dihet edhe fakti që lidhja e këtij bashkëpunimi të poshtër ishte vjehri i Shaqir Fetait, Mulla Hasan Zendeli!

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se ai i thërret myslimanët e vendit të bëjnë vepra të mira, ndërkohë që vetë Shaqir Fetai është prototip i të guximshmit i cili, me përkrahjen e “shërbimeve të djallëzuara nëntokësore”, haramin e bën hallall! Të shkelësh Nenin 58 sipas Kushtetutës së BFI-së dhe, kokëllartë të futesh në xhami, në mesin e teologëve, në mesin e nxënësve e të studentëve të çiltër, është, thjesht, hallallëzim i haramit. Këtë është duke e bërë Shaqir Fetai i haramizuar;

-Shaqir Fetai rrenë edhe me paraqitjen e vet prej “njeriu të devotshëm”, sepse, të gjitha veprimet e tij tash e një vit dëshmojnë se kemi të bëjmë me një këlysh shejtani;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se ua ka ngritur rrogat vetëm profesorëve të Medresesë dhe FSHI-së, sepse, në fakt, ajo shtesë e rrogave është nga paratë e buxheit të qeverisë aktuale e cila mundohet t'ia korruptojë rehatinë Shaqir Fetait. Sapo të ndërpritet ky korruptim, ato shtesa do të hiqen;

Shaqir Fetai rrenë kur thotë se është stabilizuar buxheti i BFI-së përmes donacioneve të ndryshme të myslimanëve të vendit, sepse, në fakt, bëhet fjalë për ndihmën financiare të cilën pushteti aktual ia jep Shaqir Fetait tash e pesë muaj radhazi;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se i ndihmon të varfërit dhe të sëmurit myslimanë të vendit tonë, duke i dërguar në spitale në Gjermani, në Rusi, në Turqi, në Zvicër e gjetiu, por që të gjitha këto raste i mbanë sekret. Nuk ka nevoj që të vetëlavdërhet, ndërsa një pako me ndihma, me afate të skaduara, kur e jep, e mbulon “aktivitetin” me të gjitha mediat që i paguan me paratë e fitrit;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se i nderon dhe ka respekt ndaj “figurave markante” të kombit tonë, sepse, nuk është detyrë e tij që të shpreh respekt ndaj këtyre figurave, por t'ua ngulë thikën pas shpine. Këto janë mësimet të UDB-së dhe në këto mësimet Shaqir Fetai është dëshmuar se është “hafiz”;

-Shaqir Fetai rrenë në çdo takim dhe gjithandej se ai tashmë është bërë “zgjidhja e BFI-së”, sepse, ai nuk mund të jetë asgjë tjetër përveçse problem i BFI-së;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se ka dhënë kontribut tridhjetëvjeçar nëpër organe të BFI-së, sepse, të gjithë kolegët e tij, me të cilët ka punuar nëpër këto organe, e mbajnë mend për rrencak të paciptë, e mbajnë mend për tradhëtarë, e mbajnë mend për hajn, e mbajnë mend për sahanëlëpirës e puthadorë. E mbajnë mend për thurrës brilant të lavdeve kushtuar ish-babait të vet shpirtëror, të cilin gjithmonë, si i magjepsur, e ka quajtur “kjo figurë markante”;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se BFI ka nisur nga e mbara me ardhjen e tij në krye të këtij Institucioni, sepse, këtë e demantojnë rrenat e përditshme të tij që nga mëngjesi e deri në pasdarke;

-Shaqir Fetai rrenë kaq shumë, sepse për të rrena është “din” dhe “iman”! Këtë fakt nuk ka mysliman në vend e më gjërë që nuk e di;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se “tani kemi një BFI e cila nuk merret me skandale të ndryshme”, ndërkohë që vetë Shaqir Fetai është skandali më madh dhe i përhershëm që i ka ndodhur BFI-së. Shaqir Fetai do të ngelet njolla e pistë e përjetshme e BFI-së;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se ai erdhi në këtë post me përkrahjen e përgjithshme të myslimanëve të vendit, sepse, Shaqir Fetai nuk u bë “kryetar” i BFI-së sepse e deshti dikush, apo se dha kontribut që gjithësesi do të rezultonte me “reisllëkun” e tij! Shaqir Fetai e uzurpoi këtë post, sepse kështu i thanë ata të pushtetit, i thanë që t'i shkelë të gjitha aktet normative të BFI-së sepse do ta ketë mbrojtjen e pushtetit, paprekshmërinë e garantuar nga UDB-ja;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se BFI-ja po forcohet, sepse, BFI-ja gjithnjë e më shumë po shndërrohet në filiale të partive të pushtetit maqedonas;

-Shaqir Fetai rrenë kur përgjigjet në pyetjet e kurdisura se a ka gisht politika në zgjedhjen e tij. Ai gjithnjë e mohon një të vërtetë të pamohueshme, sepse tërë bota e di se ai është instalacion i partive të pushtetit maqedonas me rekomandim nga zyrtarja Stanko Dragoviçit, eprorit të tij si bashkëpunëtor i UDB-së;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se me shkarkimin e Sulejman Rexhepit ai ka pasur për qëllim ta shpëtojë BFI-në, sepse ai nuk ka pasur qëllim por, detyrë nga shërbimet sekrete. Nuk ka ndodhur në botë, në asnjë institucion, në asnjë shtet, në asnjë organizatë që, të mblidhen nëpunësit dhe ta shkarkojnë të parin! Ministrat që nuk janë të kënaqur me kryeministrin, japin dorëheqje! Nëpunësit që nuk janë të kënaqur me të parin e organizatës apo të institucionit, nuk e shkarkojnë të parin por japin dorëheqje, vetëlargohen në shenjë pakënaqësie. Vetëm Shaqir Fetai kërkon që të shkarkohet Sulejman Rexhepi, në vend se të japë dorëheqje e të largohet në shenjë pakënaqësie me ndonjë

veprim të Sulejman Rexhepit;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se tani, nën drejtimin e tij, në BFI janë forcuar marëdhëniet ndërnjerëzore, sepse, Shaqir Fetai, bashkë me bashkëpunëtorët e tij të trashëguar nga Sulejman Rexhepi, e dinë fare mirë se mund të dalin para përgjegjësisë, se mund të përgjigjen para organeve të drejtësisë, se mund të ndiqen penalisht nga organet e drejtësisë, nëse sot jo, nesër gjithësesi që po;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se tani e ka profesionalizuar çdo shërbim të BFI-së, sepse, në fakt Shaqir Fetait i duhen hajnat, i duhen rrencakët, i duhen tradhëtarët, i duhen spiunët, i duhen të atillët me diploma falso, të korruptuarit, sepse prej tyre e siguron përkrahjen, paprekshmërinë dhe rehatinë e vet. I duhen të prishurit, sepse, ndryshe si do të dëshmohet prishunia e vet! Një i mirë, nuk do të bënte asnjë dakik me një të prishur! Ose do të ikte vetë ose do ta dëbonte të prishurin. Një të prishuri i konvenon të rrijë me një të mirë, sepse do ta përdorte si kamuflim të prishunisë së vet. Punë shejani, apo;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se po punojmë konform Kushtetutës së BFI-së, sepse, vetëm instalimi dhe akomodimi i tij në krye të BFI-së u shoqërua me shkeljen e 35 neneve kryesore të Kushtetutës së BF-së, shtu këtu edhe rregulloret e shumta si dhe dhjetra vendime të më hershme të BFI-së;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se e ka idhull Ali Ahmetin, komandantin e UÇK-së, sepse, u bë palë me Stojanço Angellovin, komandantin e “branitellave”, në dënimin e brohoritjeve të protestuesve shqiptarë: “UÇK, UÇK”, “Shqipëria etnike”...;

-Shaqir Fetai rrenë kur para të huajve prezanton pjesëmarrës si “funksionarë” të paparaparë me Kushtetutën e BFI-së, por që janë dëshmi e korruptimit dhe të shantazhimit të Shaqir Fetait;

-Shaqir Fetai rrenë kur shpreh “pakënaqësi” për regjistrimin e bashkësive të reja islame në vend, sepse, në fakt, këto “bashkësi” nuk janë asgjë tjetër përveçse pasoja të shkakut që e ka emrin Shaqir Fetai;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se i ka stabilizuar raportet e BFI-së me Qeverinë e Maqedonisë së Veriut, sepse, me vendim të Ministrit të Arsimit, institucionet akademike shtetërore detyrohen që t’i largojnë nga fakultetet të gjitha medresantet, qofshin ato në vitin e parë, të dytë apo tutje;

-Shaqir Fetai rrenë kur thotë se kemi kthyer “vakëf”, sepse ai në fakt ka marrur vetëm letra në vlerë për pronën e pakthyer dhe, këto letra Shaqir Fetai nuk po i shpenzon në blerje të vakëfit të ri por i bën rrush e kumbulla, në përpjekje për ta blerë rehatinë në kolltukun e “reisllëkut”. Shaqir Fetai do të ngelë në historinë e gjitha kohërave të BFI-së si humbësi më i madh i vakëfit etj. etj. etj.

## **P. S.**

Natyrisht, rreth këtyre gënjeshtreve dhe qindra të tjera të Shaqir Fetait, përgjatë këtij viti të tij avanturesk, janë shkruar e publikuar mbi 500 faqe vord, komente, analiza, intervista, qasje e persiatje, nëpër dhjetra portale kombëtare. Të gjitha këto, së shpejti botohen në një libër të titulluar TRADHËTI E KOMPLOT NË KOHË PANDEMIE, i cili do të editohet nga kompania për media dhe botim 1kliklarg. Që tani i ftojme të interesuarit që të na shkruajnë nëse janë të interesuar t’ua sigurojmë ndonjë ekzemplar, sepse tirazhi do të jetë i kufizuar, plus do të na duhet të gjejmë mënyra si t’ua sjellim ekzemplarët, sepse në doganat tona qarkullimi i librit shqip nuk është i lejueshëm!

**(Kombetare, 25.04.2021)**

## Shaqir Fetai e rrenë edhe vetëveten e jo më myslimanët

**A e dini pse rrenë Shaqir Fetai? Sepse është edhe injorant, por edhe kaçavidë? Sepse ka kohë, ka shumë vite që e ka humbur turpin! Ai “institutin e hifzit” e ka themeluar sa për ta madhëruar UDB-në që u bë sebeb e ky erdhi në “krye” të BFI-së**

**Nga Vesel Rushiti**

Politikë e mirë kjo e ribotimeve të shkrimeve të cilat, mund të të shpëtojnë pa u vërejtur prej një numri lexuesish. Ribotimi të plotëson me informacione, ose, ta rifreskon kujtesën dhe sërish ta risjell një problem, një fenomen, një dukuri të ndodhur, për të cilën dikur vetëm ke shpreh revoltë brenda vetes. Kësaj radhe do të shkruaj nja dy-tri fjalë! Sepse, tashmë “pazlle” është plotësuar, të gjitha figurat kanë rënë në vend të vet! Shaqir Fetai, paska themeluar një “institut të hifzit” në Myftininë e Gostivarit? Rrenë e kulluar e tij! Kushtetuta e BFI-së këtë të drejtë ia jep vetëm reisul ulemasë, pra, pa vendimin dhe pa nënshkrimin e Sulejman Rexhepit, Shaqir Fetai nuk ka pasur të drejtë as të fotografohet për letërnjohtim.

Shaqir Fetai me kërkesën dhe këmbënguljen e tij për themelimin e këtij “institutit” në fakt vetëm sa ka pasur dëshirë të flaktë për ta madhëruar UDB-në, për ta falënderuar për tërë atë përkrahje dhe atë përgatitje që kishte nisur ta bëjë në promovimin e Shaqir Fetait nga “ORAO” në “reis”!

A e keni parë se si lavdërohet dhe si i lëshon këlyshhtë e vetë propagandistik të paguar me fitër e me zeqatë që t’ia lehin një “sukses” që e paska arritur në kthimin e një livadhi që dikur paska qenë i nacionalizuar! Ndërsa kurrë nuk u tha asnjë fjalë për humbjen e objektit miliona euro të cilën do ta ndërtonte Banka Islame për Zhvillim mu në qendër të Gostivarit. Pse kurrë nuk foli Shaqir Fetai se pse ikën arabët nga ky projekt! Cili ishte faji i Shaqir Fetait, a? Me interesin e tij meskin ai i solli dëme të mëdha edhe vetë Komunës së Gostivarit dhe, për këtë sjellje prej hajni Shaqir Fetai është dashur të shpallet persona non grata në Gostivar.

Paska themeluar një “institut të hifzit” dhe ua paska lënë trashëgim “pasardhësve të tij”! Në çfarë gjendje ua la! Çka arriti nga ky Institut, cili ishte kuptimi i themelimit! A pati statut, a pati program, a pati buxhet, a pati raport vjetor, a pati suksese, cilat janë ata suksese, sa e ngriti leximin bukur të kuranit në mesin e hafëzlerëve të rinjë, a pati ndonjë projekt, ndonjë aktivitet sado modest!

Jo, sepse nijeti i Shaqir Fetait ishte shumë i fëlliqtë! Për ta mbuluar humbjen e objektit që arabët po ia linin vakëf Myftinisë së Gostivarit, ky “themeloi” diçka pa pasur as më të voglin haber se çka do të thotë “institut i hifzit”!

Emrin Institutit ia la ish-reisi Sulejman ef. Rexhepi! E quajti, sipas propozimit të Shaqir Fetait, me emrin e baballëkut të tij, Hasan Zendeli, hoxha i Çegranit, i njohur si miku i ngushtë i Temellko Boshkovskit, satrapit të shqiptarëve të Maqedonisë Perëndimore, nga pozita e UDB-së. Kjo miqasi vërehet edhe në fotografinë e publikuar në një nga librat e Nafi Çegranit.

A i kujtohet Sulejman Rexhepit se si, një qytetar i Çegranit, i shkoi dhe plotë inat i tha se, me çfar të drejtë emërton një “institut” me emrin e një udbashi siç ka qenë Mulla Hasani! Sulejman Rexhepi i tha: “pyeteni Shaqir Fetain, sepse ishte propozim dhe dëshirë e tij e flaktë”!

Shaqir Fetai edhe kur ushtron fe, ai rrenë, edhe kur propagon fe ai rrenë, edhe kur thërret në fe ai rrenë, ai edhe në namaz rrenë, sepse, shpirtziu namazin e ka tallje me Zotin, lutjet i ka ofendim për Zotin; njeriu që nuk pendohet në Emër të Zotit për të bëmat e tij të pista prej udbashi dhe, vazhdon të flasë në emër të Zotit, ai në fakt vetëmsa rrenë në profesionin e vet prej “kleriku”! Zoti e di më së miri! Por edhe ne myslimanët e dimë shumë mirë se Shaqir Fetai, udbashi i rexhur, nuk mund të jetë klerik e aq më pak “prijës” i myslimanëve.

Instalacioni i pushtetit antiislamist të llogarisë veten si “prijës”?! Po ky e rrenë edhe vetëveten e lëre më xhematin, myslimanët, të gjithë me radhë!

*(Mileniumi3, 25.04.2021)*

## Shaqir Fetai bën “humanizma” me rrena idiotike

(Nga edhe 27 komente të arritura në inbox lidhur me epitetin rrencak që Shaqir Fetai ia ka mveshur vetes, po e veçojmë këtë, sepse të tjerat nuk i bëjnë mirë shëndetit të Shaqir Fetait, janë tepër shumë personale, janë shumë dekonspirative, janë aq sharje të mëdha, sa nuk e mbanë etika e njeriut normal – LMR në BFI)

**Nga Besim Berisha**

Po, pa dyshim, Shaqir Fetai rrenë. Madje, është një rrencak i pashoq në shoqërinë tonë. Nuk është as “mashttrim politik”, nuk është as “mosinformim”, nuk është as “synim partiak”, nuk është as “shtrembërim i detyrueshëm”, por, thjesht, është rrenë. Çdo gjë që flet Shaqir Fetai, është rrenë. Në një nga shkrimet i ishin numëruar aq shumë rrena sa, jo vetëm që u lodha duke ia lexuar por, në fund, të familjes më pytën se, pse isha skuqur aq shumë në fytyrë! E kisha pak nga turpi, më shumë nga inati, dhe më shumë nga nervat! Si rrenë një “hafëz”, si rrenë një “reis”, si rrenë një “hoxhë”! Si bëhet që sa herë e hap gojën Shaqir Fetai, rrenat i dalin fulllumuç nga goja. Ky është njolla me e tmerrshme që i ka ndodhur myslimanëve të Maqedonisë së Veriut!

Vetë Shaqir Fetai i lejon vetes për të rrejtur aq paturpshëm sa, ia lejon vetes edhe atë rrenë që e lëshoi si lopa bajgën në një intervistë televizive duke thënë: “ne çojmë të sëmurë për t’u shëruar edhe në Rusi...”!!!

Në një intervistë televizive, para gazetarit të cilit ia kishte blerë heshtjen dhe mosndërhyrjen me qëllim të zbardhjes së të vërtetës, dilemave dhe gënjeshtrove, Shaqir Fetai, kur flet për “humanitetin” e vet të rremë, thotë se, ai dhe BFI-ja e tij çdo ditë shpërndajnë ndihma humanitare, çdo ditë bëjnë shtëpia për të varfër, donojnë dhe i çojnë për shërim pacientët rëndë të sëmurë, në Rusi, në Gjermani, në Zvicër, në shumë shtete perëndimore! Sëmundjet e rënda, të pashërueshme në vend, në shtetet perëndimore kushtojnë me 100-200-300 mij e deri në 500 mij madje edhe miliona euro! Dhjetë-pesëmbëdhjetë pacientë t’i çonte Shaqir Fetai për shërim në këto vende, do t’i kushtonin prej 5-15 milion euro! A e ka të qartë Shaqir Fetai se çka flet? A e ka të qartë Shaqir Fetai se sa rrenë, se çka rrenë dhe sa mund t’i kushtojë kjo rrenë Institucionit të BFI-së! Mund t’i kushtojë pikërisht sa misioni i Shaqir Fetait – rrënimi total i këtij Institucioni!

Po çka e lidhë Shaqir Fetain me Rusinë? Po si paska bërë kontratë Shaqir Fetai me Rusinë për të dërguar pacientë atje për shërim? Po me kë e bëri këtë kontratë, kush ia premtoi këtë të mirë Shaqir Fetait nga Rusia. Po pse t’ia premtojnë kot e kot! Ne e dimë që Shaqir Fetai është cull i pistë për të pasur raporte me Rusinë, prandaj, ia konsiderojmë rrena ato që i flet. Por, si ia zë goja “hafëzit” të rrejë aq shëmtueshëm! Le të na tregojë Shaqir Fetai vetëm një pacient që e ka çuar në Rusi për shërim, o veç inicialet e tij le t’i tregojë! Apo, cilin pacient e paska nisur Shaqir Fetai për në Gjermani! Po për në Zvicër, apo për në shtete perëndimore? Nuk po themi se nuk i ka nisur nga stacioni i autobusëve apo nga aeroporti, sepse, sa për një betim, ky edhe del në stacion apo në aeroport, sa për të thënë “O pasha Allahun i kam përcjellë të sëmurit” dhe beja t’i shkojë në vend! Shaqir Fetai flet se ka bërë humanitet, me paratë e fitrit dhe zeqatit, me kontributet vullnetare të myslimanëve të vendit ai ka nisur të sëmurë për t’i shëruar! Ky është problemi!



Shaqir Fetai paska ndihmuar financiarisht të sëmurë që të shërohen në Rusi?! Një gjest të tillë human deri më sot nuk e ka bërë shteti, institucionet shëndetësore të Shtetit, kurse e paska bërë Shaqir Fetai! Ky duhet të gurëzohet, të ndiqet me gurë, si i pamoralshëm, sepse, një Zot e di se sa rrena përdor ky për t'i mbuluar aktet e turpshme që i kryen në emër të humanizmit e të fesë islame. Shaqir Fetai është njolla e turpshme e dinjitetit të myslimanëve të Maqedonisë së Veriut!

*(1Kliklart, 26.04.2021)*

## Kujdes! Mos e financoni haramin

**Nisur nga disa video të shkëputura nga një palo-intervistë e fundit, Shaqir Fetai na paralajmëron për masakrimin që do ta ushtrojë mbi fitrat, zeqatin dhe kontributet vullnetare të myslimanëve të vendit! Asnjë lider fetar nuk do ta zbërthente në mënyrë kaq të poshtër synimin e vjedhjes së djersës së myslimanëve siç e zbërtheu pa fije turpi nijetin e vet Shaqir Fetai**

### Shkruan Lejla Kajtazi

Këto ditë, i instaluari nga pushteti maqedonas në krye të BFI-së, Shaqir Fetai, e tha një rrenë shumë të madhe, aq të madhe sa të rrëqethë tërë trungun mysliman të vendit! Kësaj radhe rrenës ia shtoi atë cilësimin pezhorativ që thotë: rrena është nona e haramit! Prandaj, kujdes vëllezër e motra myslimanë, kujdes dhe mos u bëni shkaktar që me fitrin dhe zeqatin e juaj ta ndihmoni, ta sponsoroni haramin e Shaqir Fetait, i cili, mendon se është Halil Kastrat, Elvis Naçe. Aktivitetet e tyre humane i përvetëson dhe i paraqet si aktivitete të veta personale!

Brenda një viti që kur u instalua Shaqir Fetai në BFI paska bërë aq humanitet, paska bërë aq vepra të pëlqyeshme, paska kontribuar aq shumë në zbutjen e dhembjes së sëmundjeve, trishtimit të varfërisë sa, këtë kontribut do ta lakmonte çdo shtet i pasur! Çdo ditë të vitit paska zhvilluar aktivitete humane, sidomos për Muajin Ramazan, atëherë kur mblidhet fitri e zeqati për t'u ndarë në mes të 3-4 matrapazëve që asgjë nuk kanë të përbashkët me fenë islame! Shaqir Fetai çdo ditë paska ndërtuar shtëpia, paska ndihmuar të varfërit, paska ndihmuar financiarisht për t'i dërguar të sëmurit nëpër spitale të ndryshme në botë, në Turqi, në Rusi e në shumë vende perëndimore. Për çdo xhuma, dera e xhamive mbushet me lypsarë të cilët shtrojnë mindila e peshqirë dhe presin ndonjë lëmoshë nga xhamati sapo të dalin nga xhamia. Dhe, edhe këtë sadaka të myslimanëve për lypsarët dhe nevojtarët e shumtë, Shaqir Fetai e paraqet si aktivitet të tij. Pra, sadakaja e myslimanëve është aktivitet i Shaqir Fetait!!! Ky pastaj të jetë hoxhë, hafiz, "reis"? Mos o Zot! Pare e maaadhe mblidhet nga fitri dhe zeqati dhe të gjitha po u shpenzuan nëpër Turqi, Rusi e nëpër spitale të shteteve Perëndimore! Derisa BFI-në e udhëhiqte Sulejman ef. Rexhepi, kishte arritur që të nënshkruajë një memorandum bashkëpunimi me një spital të Turqisë për të dërguar atje pacientë të cilët nuk do të mund të shëroheshin në Maqedoninë e Veriut. Ky bashkëpunim konsistonte në dërgimin e rasteve të rënda në Turqi për shërim eventual dhe, kjo ndihmesë arrinte vlerën e një milion euro brenda një viti! BFI, me komisionin e vet të themeluarëkas për këtë qëllim, i mblidhnin dokumentat e nevojshme, ishin njëfarë linku me spitalin e Turqisë dhe, u dërgoheshin dokumentat. Pastaj, konsolciumi mjekësor i Spitalit, zotohej për të shëruar persona të caktuar, me sëmundje që kërkonin trajtime më specifike e më të avancuar të cilat nuk jepen në vendin tonë. E lajmëronin komisionin e BFI-së që t'i lajmërojnë iks pacientët dhe të nisen për në Turqi. Pra, këtë aktivitet, këtë ndihmesë, si rrjedhojë e respektit dhe besueshmërisë së lartë që kishte arritur BFI në arenën ndërkombëtare, Sulejman ef. Rexhepi e ka zbritur në nivel të linkun, nuk ka dashur që të bëjë propagandë se po dërgon dikë në shërim, se po jep para të majme, se po kontribuon në shëndet! Asgjë nuk bënte BFI-ja, madje nuk shpenzonte asnjë cent, me përjashtim që e luante rolin e grumbulluesit të dokumentave të nevojshme dhe të mbajtjes së kontakteve me palën turke. I tërë kontributi humanitar ishte i Spitalit dhe i stafit të mjekëve turk. Përmes BFI-së kanë shkuar me qindra pacientë në Turqi për t'u shëruar dhe, një fakt i tillë nuk është përmendur në asnjë

shkrim gazetaresk. Realisht, BFI-ja sa udhëhiqej nga Sulejman Rexhepi ka shpërndarë ndihma edhe shtëpi të ndërtuara nga themeli, por jo nga buxheti i fitrit dhe zeqatit i cili është dhënë nën bindjen se po ndihmohet ekskluzivisht zhvillimin e jetës fetare islame në Maqedoninë e Veriut.

Shaqir Fetai e kërkon fitrin dhe zeqatin “sepse do t’i mbajë pesë medrese dhe FSHI- në”, sepse do t’ju bëjë shtëpi të varfërve, sepse të sëmurit do t’i dërgojë për shërim në spitalet e RUSISË!

Rijaseti nuk është drejtori e “medreseve”, nuk është as sportel spitali! Rijaseti është përgjegjëse e mirëvajtjes dhe të zhvillimit të jetës fetare islame konform rrjedhave bashkëkohore, elektrnike, teknologjike, shkencore etj. Rijaseti, si organ kolektiv, është i thirrur ta kalisë dhe ta ushtrojë edhe humanitetin në mes të njerëzve, qoftë me ndihma, qoftë me dashuri, edhe atë në funksion të mirëqenies dhe paqes.

Shaqir Fetai ka shpërndarë para të majme nga buxheti i krijuar nga fitri e zeqati, për disa “media” të cilat i ka blerë për t’i bërë reklamë e propagandë. Shaqir Fetai pakot humanitare të siguruara nga Turqia po i shpërndanë me aq pompozitet sa po turpërohet edhe vetë Turqia, sepse po i reklamon si ndihma të BFI-së; Shaqir Fetai po e helmon me rrena, po e kontaminon me rrena një popullatë të tërë myslimanësh, ndërsa na paraqitet si humanist që fitrin dhe zeqatin na e shpenzuaka duke nisur të sëmurë për shërim në Rusi.

Kujdes o popull, ky është paralajmërim i Shaqir Fetait se do t’ju vjedhë dhe, me paratë që do t’ua vjedhë do t’ua shpërndajë atyreve ndaj të cilëve ka detyrime jetësore për avancimin e pamerituar në karrierë.

*(Lajme7, 27.04.2021)*

## Pastro oborrit në pastaj dil në komshi

**Shaqir Fetai, ky shkelësi epik i Kushtetutës së BFI-së, tashmë ua ka hapur rrugën që këtë gjest rrënues ta bëjnë edhe organet e tij. Fundi dihet – copëtimi dhe shkatërrimi i BFI-së! Prandaj, po vlojnë regjistrime te reja të “bashkësive islame”, sepse ky i Shaqir Fetait tashmë i ka hypur skijave**

### *Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së*

Ashtu si niset – ashtu do të përfundojë! Shaqir Fetai ia nisi instalimit të vet në krye të BFI-së përmes shkeljeve flagrante të Kushtetutës – ashtu edhe do ta përfundojë! Kjo dukuri e shkeljes së aktit më të lartë normativ të BFI-së, tashmë ia ka hapur rrugën për të njëjtin veprim edhe organeve të tjera të BFI-së!

Bëhet fjalë për emblemën e BFI-së, e cila, sipas Kushtetutës së BFI-së është reprezentative dhe e vetme! Çka është emblema, cili është kutimi i kësaj fjale!

Emblemë quhet shenja dalluese me figura simbolike që përfaqëson një shtet, një qytet, një parti, një familje, një skuadër sportive, një ekip, një institucion etj. dhe që përdoret në vulat, në mbishkrimet zyrtare, në monedhat, në medaljon, në çertifikata etj.

Në Nenin 4 të Kushtetutës së BFI-së, thuhet: “BFI ka flamurin dhe emblemën e vet... Emblema e BFI-së është: Kur’ani i hapur në të cilin shkruan “Ikre” në orgjinal. Mënyra e përdorimit të flamurit dhe emblemës përcaktohet me rregullore të veçantë.” Të gjitha organet e BFI-së që nuk e kanë këtë emblemë, dhe dalin me emblema të veta veçuese, në fakt, shprehin pretendime djallëzore që në mënyrë tinzare të shkëputen nga Institucioni, nën direktivat kushtetuese të të cilit veprojnë organet! A e përcjell këtë situatë Rijaseti i BFI-së së Shaqir Fetait apo, nuk i duhet ta përcjellë, sepse e stimulon vetë, institucionalisht!

Cila është emblema e Myftinisë së Shkupit, po ajo e Gostivarit, e Tetovës etj. etj.! A i ka parë Rijaseti mbishkrimet zyrtare, apo “memorandumet” e këtyre organeve? A i përcjell dikush se çfarë çertifikata për kurorëzime shpërndajnë këto organe? Çka fletë kjo? Çka reflekton ky fakt pas, bie fjala, 50 viteve! Brenda vetë oborrit të Bashkësisë Fetare Islame, tashmë dokumentohet se funksionojnë 13 organe të pavarura, të regjistruara në kuadër të BFI-së; trembëdhjetë bashkësi islame!

Prandaj, sot, profesionistëve, njohësve të akteve normative, nuk ju bën fare përshtypje kur regjistrohen “bashkësi islame” të reja, madje nuk habiten nëse do të fillojnë të kemi edhe nëpër komuna, lagje, katunde, për shembull, “bashkësia islame e Çairit, e Sarajit, e Likovës, e Çegranit etj.

Së këndejmi, Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së në RMV, këshillon që, urgjentisht të merret situata në duar të Institucionit, të zhduken të gjitha çertifikatat dhe dokumentet e tjera me emblema paralele e të pavarura dhe ndryshe nga ajo që përcakton Kushtetuta e BFI-së!

### *Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së*

Shaban Aziri, kordinator  
Eset Shaqiri, zv/kordinator  
Mirdi Brao, zv/kordinator  
(Mileniumi3, 27.04.2021)

## Klerikët e pushtetit “çudibërës” të Zoran Zaevit

*Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zajev, më shpesh takohet me klerikët e pushtetit se sa me, bie fjala, mjekët që janë në fushën e betejës kundër Kovid-19. Se pse ka nevojë kaq shumë që t'i takojë këtë e di vetëm ai! Mund të jenë vetëm dy arsye: ose e merr malli për këta “dy bereqeta” ose beson se ata janë çudibërës, magjistarë, në gjuhën e popullit “sehirbasa”*

Sërish, për të satën herë këtë kohë, Zaevi qenka takuar me “dedo” Stafanin dhe me Shaqir Fetain! A kanë kuptim këto takime? Në synimet e Zaevit edhe mund të ketë kuptim, sepse, si ndryshe t'i promovojë “dy liderë fetarë” kaq të rëndësishëm të cilët duhet t'ua imponojë besimtarëve si njerëz çudibërës, të cilët e mëshirojnë, e bekojnë dhe e falin Zoran Zaevin!

Takimi për pandeminë, për Kovid 19, me këta dy injorantë për sa i përket sëmundjeve pandemike, është më tepër se fyerje e intelgjencies së çdo njeri me QI normale! T'i shesësh si faktorë shumë të rëndësishëm në tejkalimin e kësaj të keqe, është një hap drejt fajësimit të tyre për dështimin eventual të kryeministrit me gjithë qeverinë!

Qeveria ka komision të veçantë lidhur me këtë problematikë! Komisioni propozon vendime, qeveria i miraton dhe, i vë mekanizmat e veta në lëvizje me qëllim të miratimit të vendimeve. Kush nuk i respekton, i nënshtrohet sanskioneve! Nëse është kështu – pse atëherë takime dhe raportime para dy personave, roli dhe funksioni i të cilëve është fare i papërfillshëm në tejkalimin e situatës. Pandemitë kurrë nuk kanë kaluar me hajmali apo me shpresa në çudibërje të klerikëve oborrtarë por, me shtrëngim të masave shëndetësore, me disiplinë të çeliktë, me vendime e me intervenime të organeve kompetente, si nga sfera e mjekësisë po ashtu edhe nga sfera e sigurisë.

Apo, ndoshta Zajevi mendon se tani, meqë vinë festat fetare, këta dy janë ata që duhet të kenë rolin kryesor në marrjen e masave konkrete për zbutjen e situatës katastrofale me të cilën po përballet Maqedonia e Veriut. Pse Zaevit i duhen bashkëfajtorë në këtë dështim! E ka Shaqir Fetai forcën ndikuese tek myslimanët e vendit sa për t'i ndaluar që mos të vizitohen dhe të shkëmbejnë urime myslimanët mes vete me rastin e Fitër Bajramt? Apo e ka këtë ndikim te besimtarët e vet “dedo” Stefani në prag të festave ortodokse? Aspak! Fare! Le të dalë Shaqir Fetai e le ta kumtojë një vendim në këtë drejtim! Do t'i shahet tërë lista familjare e gjinisë femërore nga myslimanët e vendit dhe, do t'i iritojë aq shumë sa, të gjithë, për inat të tij, do t'i futen në hundë Kovid 19-ës! Zaevi nuk duhet ta provokojë inatin e qytetarëve besimtarë.

Populli ia ka dhënë besimin subjektit konkret për të na prirë në të mirë e në të keq! Klerikët janë apolitikë dhe apartiakë dhe, nuk duhet të shërbejnë sa për të mashtruar elektorat për përfitime partiake! Vetë institucionet gjegjëse të qeverisë duhet të dinë se në ç' masë është rreziku, ç' përmasa tragjike mund të na shkaktojë Kovid 19, kur duhet të shtrëngohen masat e kur të lirohen, cilat duhet të jenë ato masa detyrimisht të zbatueshme e cilat mund të jenë ndërgegje e qytetarëve dhe, meriat apo dështimet eventuale u takojnë vetëm atyre institucioneve përkatëse.

Turqia, një nga vendet islamike më të fortë në botë, ka urdhëruar që plotë 17 ditë të mbyllen të gjithë qytetarët e këtij vendi, karantinë totale, qofshin ata besimtarë apo ateistë. Nuk ka dalje, nuk ka vizita, nuk ka tubime, nuk ka festime, nuk ka lutje të përbashkëta. Të gjitha të kryhen benda, në shtëpi! Pushteti turk nuk ia kërkoi këtë leje Institucioneve fetare dhe as që mori pëlqimin e tyre për masat që duhet të ndërmerren. Sepse, është shumë koshiente se përgjegjësia, sikundër sukseset, bien ekskluzivisht mbi institucionet gjegjëse të Shtetit!

Çka pati nevojë Zoran Zaev ta manipulojë opinionin e gjërë me falënderimet ndaj “dedo” Stefanit dhe Shaqir Fetait për kontributin e dhënë në luftë kundër pandemisë! Po cili ishte ky kontribut i këtyre dy “liderëve” fetarë? Pse Zoran Zaevi i tërë angazhimin e shëndetësisë shtetërore, tërë angazhimin e sigurimit shtetëror, tërë angazhimin e institucioneve përkatëse, ua atribuon edhe këtyre dy personave të cilët, as veten nuk kanë arritur ta ruajnë nga Kovid 19-ta?!

Zoran Zajev shpreson se edhe “dedo” Stefani edhe Shaqir Fetai, edhe më tej do të angazhohen në mbrojtjen e shëndetit publik! Maqedonia e Veriut, është e radhitur në ranglistën botërore ndër vendet e para për nga vdekshmëria e të sëmurëve nga koronavirusi! Infektimet ditore deri para dy-tre ditëve ishin alarmante, më të larta në rajon e në Evropë! A mos ndoshta sjellja nonshalante e këtyre dy “liderëve oborrtarë” ndikoi në tërë këtë rezultat tragjik, sa që tani, Zoran Zaevi, detyrohet që të përulet para të dyve dhe t'i lusë që të bashkangjiten në luftën kundër pandemisë!

Në kriza të rënda, vendimet e pushtetit, nuk njohin personalitete apo pozita shoqërore – të gjithë janë qytetarë të rëndomtë të cilët obligohen t'i nënshtrohen masave që i sjell Qeveria. Prandaj, Qeveria është meritore në zbutjen deri në zero të kësaj pandemie, apo në dështimet për të evituar tragjedira të rënda.

Nëse Zoran Zaev mendon se këta dy “prijësa fetarë” të pushtetit do të mund ta ndihmojnë, duke shtrirë ndikimin e tyre mbi masën e gjërë, në fakt, ai duhet të dijë se ka varur shpresa në njerëz më të kotë që i ka Maqedonia e Veriut, të paktën për sa i përket Shaqir Fetait, të cilin, myslimanët e vendit, në shumicë absolute, nuk e bëjnë mall më sa leshin e b... Është më se e vërtetë se, në këtë vend,

myslimanët e bëjnë dhe do ta bëjnë pikrisht të kundrtën e asaj për të cilën do të apelonte Shaqir Fetai. Kjo tashmë është dëshmuar disa herë! Klerikët e pushtetit gjithnjë janë të urreyeshëm sa vetë djalli!

Çudibërja që mund t'i vie Kryeministrit Zaev nga "lutjet" e klerikëve të pushtetit mund të jetë vetëm djallëzimi i tij! Sa më pak që të jetë i varur prej klerikëve të pushtetit, aq më shumë do të jetë i suksesshëm në sigurimin e vaksinave, në vaksinimin e popullatës, në shtimin e arsyes për të qenë sa më humanë me të gjithë ata mantelbardhë që janë në vijën e parë të frontit në përballje me këtë të keqe që ka kapluar mbarë botën. Mbi të gjitha, cili shtet i botës i kërkoi ndihmë fetare Papës?

*(Kombetare, 27.04.2021)*

## **BFI e Shaqir Fetait manipulon dhe keqpërdor ndihmat humanitare**

**Në gjithë botën, madje edhe sipas mësimeve fetare, ndihmat humanitare u dedikohen njerëzve që janë në nevojë, pa kurrfarë të ardhurash, pa asnjë pjesëtarë të familjes të punësuar, jetimëve, skamnorëve e të ngratëve që janë pa kurrfarë përkujdesi social. Vetëm në BFI-në e Shaqir Fetait, ashtu siç u shkrua më herët në një shkrim, ndodhë që ndihmat të shpërndahen në stilin unë ty, ti mua, ai djalit të axhës, ky tezes, kjo çikës së hallës etj.**

Që në titull, shkronjësit e informatave të “aktiviteve humanitare” të BFI-së manipulojnë dhe mundohen ta fshehin një turp që vetëm në Hilalin e BFI-së së Shaqir Fetait mund të ndodhë, madje, në vend se të ndëshkohet, ndodhë e kundërta: propagandohet si sukses dhe priten “lavdërimet”! Miliona të shara u kanë fluturuar sot, sepse, në aksionin që e paskan zhvilluar ka edhe manipulim edhe keqpërdorm, të cilat nuk kanë ndodhur madje as në kohën e kryehajnit të BFI-së, Mustafa Dautit, kur ai e drejtonte së vjedhuri OH HILAL të BFI-së!

OH HILAL NË AKSION TË PËRBASHKËT ME iks ndërmarrjen publike! Sipas titullit të shkruar në këtë formë, do të thotë se, edhe Hilali, edhe kjo ndërmarrje publike kanë përgatitur shporta, apo pako, apo qeska me ndihma humanitare për t’ua shpërndarë kategorive më të pashpresë! Ose, kanë bashkuar forcat e përbashkëta si logjistikë për t’i shpërndarë në terren ndihmat që kanë arritur nga Turqia! Por, jo! Ndodhë skandali i radhës i Shaqir Fetait!

Aktiviteti i aktivistëve partiakë nuk mund të shitet si aktiviteti i BFI-së, as i organizatës së saj humanitare! Donimi në një ndërmarrje publike i pakove humanitare është një prej turpeve të papërtypshme që mund t’i ndodhë vetëm Shaqir Fetait! Në tekst, më tej thuhet se, në ditët në vijim pakot humanitare të donuara nga BFI-ja do t’ju shpërndahen punëtorëve të kësaj ndërmarrje publike!

Mund të ketë ndërmarrje me paga nën minimale, me të cilat vështirë që shtyhet dita, mund të ketë të punësuar që kanë shumë fëmijë, që kanë shumë nevojë, që nuk ngopen asnjë ditë me bukë, punëtorë që janë shumë të ndershëm, shumë të moralshëm, të devotshëm deri në kupë të qiellit, por ama, asnjë nga ata punëtorë të ndërmarrjes që marrin nga një rrogë qoftë edhe 1000 denarë, nuk janë në gjendje siç janë kategoritë sociale pa të hyra, pa ndihma, që bukën e gojës e kërkojnë nëpër kontejnere e nëpër shporta plehërash! Vetëm në Shkup jetojnë më shumë skamnorë të skajshëm se sa ka të punësuar ajo ndërmarrje publike, të cilës i donon OH HILAL i BFI-së pako humanitare të falur nga Turqia!

Keqpërdorim flagrant i ndihmave humanitare! Dijaneti i Turqisë ka mbledhur ndihma për t’i sjellë ndër qytetarët e Maqedonisë së Veriut, ka sjellë, sipas Shaqir Fetait 80 ton ndihma! Këto ndihma janë grumbulluar dhe janë siguruar nga popullata turke, e cila ka zgjatur dorën e ndihmës për atë kategori njerëzish që nuk kanë kurrfarë të hyrash, që nuk anë asnjë metalik në xhep, që tërë ditën i theyejnë gishtat duke shpresuar se do t’u sjell komshiu ndonjë copë buke!

OH HILAL si dhe BFI-ja e Shaqir Fetait kanë thënë se këto ndihma do të shpërndahen sipas listës së përgatitur nga këshilli i xhamive dhe imamët të cilët më së miri i njohin ato shtresa që janë jashtëzakonisht në nevojë. Tani shtrohet pyetja se, cilin këshill të xhamisë, cilën listë të përgatitur nga imamët e anashkaluan dhe, ndihmat e dedikuara për këta nevojtarë, ikën për në ndërmarrje publike! Sa mend kanë këta të BFI-së së Shaqir Fetait, tani do të nisin pakot t’ua shpërndajnë edhe institucioneve administrative, bie fjala, ministrisë së shëndetësisë, ministrisë së punëve të brendshme, kuturës, ministrisë së ekologjisë, Ohisit, Makpetrollit, EVN- së, Kanallizim-ujësjellësit. Le t’i shpërndajnë ata ndihmat, do ta kenë më lehtë këta të OH HILAL, sepse, edhe ashtu po flejnë gjumë nga 4-5 ditë



dhe, kur po zgjohen, po raportojnë se për një ditë “bëmë tre aktivitete humanitare”! Turpi dhe harami nuk kanë brirë. Duken kështu, pikërisht kështu, si veprimet e BFI-së së Shaqir Fetait. Mos ndodhi ky gjest “humanitar” vetëm sa për të siguruar ndonjë punësim të ndonjë pjesëtari të familjeve të anëtarëve të Rijasetit të Shaqir Fetait. Antikorrupsioni duhet të veprojë tani!

*(Lajme7, 28.04.2021)*

## **Myftinia e Dibrës nuk do t'i përgjigjet më BFI-së së Shaqir Fetait?!**

**Populli thotë: “kur e mira të vjen me hajni, nga hajnia përfundon”! Nebulozë e madhe u mundua të ngritet rreth instalimit të Shaqir Fetait në BFI, por, akti ishte tepër amatoresk sa, situata u lexua edhe nga Marsi! “Uniteti” i Rijasetit të Shaqir Fetait u ble me haram, tani përçarja po nxjerr krye pikërisht nga ai haram**

**Shkruan Florenc Marku, Dibër**

Në javën e parë të muajit mars, Shaqir Fetai, në cilësinë e postit të kontrabanduar “reis”, vizitoi Myftininë e Dibrës, për “ta përgëzuar myftiun Reshat ef. Kaçallniku, për aq shumë suksese të arritura në afat rekord”! Ndërsa, në fund, Shaqir Fetai, tamam si një udbash që kërkon bashkëpunëtorë të dëgjueshëm, të pranishmëve ju tha se, nëse kështu bashkarisht arrini suksese ju premtoj ndihmë në realizimin e projekteve në fusha të ndryshme si: infrastrukturë dhe investime në vakëfe, burime njerëzore, avancime akademike dhe bashkëpunime institucionale!

Për çfarë suksesesh u mahnit Shaqir Fetai? Pse ky lavdërim kaq publik, ndërkohë që, “myftiu” i ri, Reshat ef. Kaçallniku akoma nuk e kishte lexuar as Rregulloren për myftinjtë e as Kushtetutën e BFI-së! Çfarë bashkëpunimi kërkonte Shaqir Fetai me qëllim që ndaj kësaj Myftinie t'i kryente të gjitha detyrimet që i ka sikundër edhe ndaj organeve të tjera, pavarësisht suksesëve që mund t'i arrijnë apo jo! Si guxon Shaqir Fetai t'u premtojë diçka të cilën ai e ka detyrim, e ka obligim kushtetutar!

Shaqir Fetai kërkon servilizëm nga efendi Kaçallniku, kërkon dëgjueshmëri dhe nënshtrim, nëse dëshiron që të ketë ndihma në infrastrukturë, në investime në vakëf, në burime njerëzore, madje, heeej, edhe avancim akademik! Nëse nuk kaservilizëm nuk mund të gëzohen këto beneficione që i ofron Shaqir Fetai!

Pse ky kushtëzim i Shaqir Fetait? Pse kjo sjellje paternaliste, pse ky premtim prej UDB-je e Shaqir Fetait në raport me këtë myfti?

Fare në fund, po zbulohen tragjet e korrupsionit, të vjedhjes, të blerjes së mandateve! Reshat ef. Kaçallniku, publikisht, para të gjithë myftinjëve, në Rijaset ia kërkon Shaqir Fetait 50 mij euro që ia kanë marrur! Në fakt, para se të shpallet “myfti”, “dikush” ka shkuar te ai dhe ia ka kërkuar 50 mij euro për nevoja të BFI-së dhe, me këtë, do ta blejë besimin e Shaqir Fetait për ta bërë myfti! Një Zot e di se ku i ka marrur ato para efendi Kaçallniku, kujt ia ka kërkuar, në cilën bankë ka marrur kredi, sepse, e ka dashur postin Myfti!

Tani, ndjehet i mashtruar, ndjehet si lolo, ndjehet i vjedhur, ndjehet myfti me post të blerë, ndjehet i turpëruar por edhe i shtrënguar për t'i kthyer paratë, ato 50 mij euro, aty ku i ka marur!

Reshat ef. Kaçallniku, vazhdimisht i kërkon paratë që ia ka dhënë “personit” në duar, sepse kështu ka porositur Shaqir Fetai! Njeriu i kërkon paratë, ose do ta shkëpusë bashkëpunimin, do ta pavarësojë Myftininë e Dibrës!

Shaqir Fetai e di shumë mirë emrin e atij personi që ia ka zhvatur 50 mij euro në emër të emërtimit Myfti të Reshat ef. Kaçallnikut!

Ose le t'ia kthejnë paratë, ose le ta detyrojnë personin që e ka zhvatur që t'ia kthejë! Titujt fetarë nuk janë mall pazari që blehen me para. Këta tituj, nëse nuk meritohen nuk mund të blihen. Sepse, nuk

janë diploma “fakulteti” siç janë mësuar t’i blerjnë nga rusë e të dyshuar nëpër qendra të ndryshme arabe. Me diploma fallco nuk mund të kamuflohet vesi i hajnisë, as hajnia dhe as ushtrimi i profesionit prej hajni! Një hajn, të gjithë hajna, prandaj, në këtë “të gjithë” gjithësesi që përfshijet edhe Shaqir Fetai, i cili, tani do të detyrohet që të vjedhë nga fitri dhe zeqati për t’ia kthyer paratë myftiut të grabitur dhe të manipuluar prej sekserëve të Shaqir Fetait.

*(Kombetare, 28.04.2021)*

## Ftesa e Shaqir Fetait: “Hajde shkojna n’Rusi”

**Shaqir Fetai, brenda natës të gjithë kordinatorët i bëri “myfti”, ndonëse asnjëri prej tyre nuk e meriton as postin çoban. Por, duke e ditur Shaqir Fetai se edhe vetë është i po të njëjtit nivel, ka thënë, le t’i bëj “myfti” duke ua marrur nga 50 mij euro ngjashëm siç ia zhvati Myftiut të Dibrës**

**Nga Valmir Xhafa**

**1.**

A rrenë Shaqir Fetai? Jo po, ku rrenë “reisi”, më i madhi i hoxhallarëve? Nuk i ka hije të rrejë Shaqir Fetai! Po, a? Po ja që Shaqir Fetai të rrenë e të thanë nga rrenat. Sepse e ka nga të qenurit udbash, duhet të dijë trika se si të dalë nga situata. Këtë nuk e kanë ditur më herët kolegët e tij në Rijaset, në kohën e Sulejman Rexhepit, ndaj dhe i thonin “fëmijë që nuk e ka kaluar fazën e pubertetit”!

Ndërsa sa i përket rrenës i ka kaluar të gjitha fazat dhe tashmë llogaritet si profesionist i rrenës.

Vetëm një rrencak si Shaqir Fetai mund të rrejë e të thotë: “nga mesi i Muajit Ramazan do të ndajmë edhe 80 tonë ndihma të tjera”! Ku i mori këto “80 tonë të tjera”?! Kush ia dha? Iku mesi i Ramazanit e ky hala nuk i harxhoi ato 80 tonë ndihma nga ato të Dijanetit të Turqisë!

Vetëm një rrencak si Shaqir Fetai do të mund të thoshte se “kah mesi i Muajit Ramazan do të ndajmë mish”!!! Mish? BFI ndanë mish vetëm për Kurban Bajram! Apo ndoshta mendon të ndajë mish nga ai i grumbulluari nga vitet e kaluara, nga dy-tre Kurban Bajrat e kaluar!

Prandaj myslimanët e vendit duhet të japin sa më shumë para për Shaqir Fetain, sepse ky për Ramazan ndanë pako e mish për nevojtarët! Prej kur ka ardhur Shaqir Fetai, Zoti e ka tërhequr lartë fukarallëkun! Nuk ka më fukara! Të gjithë janë të pasur me “reisllëkun” e Shaqir Fetait. Kështu tha këto ditë Shaqir Fetai në një iftar të organizuar tinëz nga disa “miq” të tij!

**2.**

Nuk ka më fukarallëk! Nuk ka më të sëmurë, sepse, po i pasuron prezenca e Shaqir Fetait në krye të “reisllëkut” si dhe po i shëron të gjithë Shaqir Fetai! Është lidhur me spitalet ruse dhe të gjithë të sëmurit po i dërgon nëpër spitalet e Rosisë. Ato, vërtetë janë më të mira në botë, por, janë shumë të kushtueshme, pdadaj, myslimanët e vendit duhet që, sa më shumë, në mënyrë masovike, t’i orientojnë fitrat, zeqatet, kontributet vullnetare, nëse kanë mundësi edhe roqat, edhe floririn, edhe pronat, edhe pasurinë personale e familjare, gjithçka që kanë, është mirë t’ia taksin Shaqir Fetait, sepse ky, është bërë si Baba Vanja, i gjenë të sëmurit e pashërueshëm në vendin tonë dhe të gjithë po i nis për shërim në Rusi!

A e flet këtë fjalë një mysliman i mirë bre? A e flet këtë fjalë një njeri normal! Pra, tash e tutje, a duhet t’i besohet Shaqir Fetait? Tash e tuje, a duhet të brengosen myslimanët e vendit se përfaqësohen nga një rrenc dhe nga një hajn që është specie më vete! A duhet të ndjehen të ofenduar nga përpjekjet prej udbashi të Shaqir Fetait për t’ju prirë myslimanëve?

Kujdes, se në sy të tij të gjithë jeni të sëmurë ndaj dhe, që të gjithëve, deri më një, ai mendon t’ju çojë në Rusi, “për t’ju shëruar”! Populli thotë, budallain mos e vet, sepse të tregon vet”! E çoi Zoti Fuqplotë të lajthisë e të tregojë se nga e ka orientimin ai, apo, cila është “kibla” e tij! Rusia, pra!

Jo rastësisht e zuri në gojë! Ai ka mundur të thotë edhe kështu: “të sëmurit e pashërueshëm, që nuk kanë dhimbje të padurueshme, me bashkëshoqërues, vit për vit, do t’i dërgojmë për në haxh, të luten në Qabe, le ta përjetojnë kënaqsinë e të qenurit në vendet e shenjta!” Jo Qabja, por, Rusia është në gjuhën e Shaqir Fetait.

### 3.

Shaqir Fetai rrenc! Shaqir Fetai udbash! Shaqir Fetai “reis” i kontrabanduar! Shaqir Fetai “reis” i instaluar nga pushteti aktual maqedonas! Shaqir Fetai që takohet tinëzisht me Zoran Zajevin dhe që nuk e regjistron askund si aktivitet! Shaqir Fetai që e pret me qilim të kuq ministrin e brendshëm, z. Spasovin! Shaqir Fetai që bashkë me komandantin e branitellave, Stojanço Angelloy, i dënojnë brohoritjet e “nacionalistëve shqiptarë” UÇK, UÇK”, “Shqipnia etnike”! Pra, ky Shaqir Fetai, që vegjeton vetëm rreth habitatit të pushtetit aktual maqedonas, i kufizuar ekskluzivisht brenda këtij habitatit, organizon aktivitet “më shikon, të shikoj”! Një komunikim online, me kryetarët e bashkësive islame në diasporë! I masin bolet e mençurisë në mes njëri-tjetrit. Bisedojnë rreth një teme, e cila është temë e padebatueshme, e përmbyllur, e betonuar, tash e 14 shekuj më parë, e cila ka dhënë vetëm një definicion: ZBATIM! Kurani duhet të zbatohet në jetë. Kurse Shaqir Fetai, “fëmija pa pubertet të kaluar”, inicon të shikohet pak në monitor, si në ekrane televizive, duke debatuar rreth temës “Shpallja e Kuranit hap i rrugëtimit”! Thuase ky fenomen ka ndodhur vjet, apo parvjet, ose kohëve të fundit, ose, na është bërë praktikë ky hapërim tash e nja dhjetë vite! Shaqir Fetai duhet të trajtojë temën e rrenës, të hajnisë, të talljes me fukaranë, me të sëmurit, të nëpërkëmbjes së dinjitetit të institucionit islam, pra, t’i debattojë si tema të gjitha virtytet e pista që i ka. Mbase i duhen për ta përjetuar katarsisin! Shpëlarjen shpirtërore, sepse po shembëllen në një grumbull plehu! Mjaft u tall me fenë islame!

### 4.

Veprimet e fundit të myftiut të Dibrës, e nxorën lakuriq Shaqir Fetain! Ia kanë marrur çunit plotë 50 mij euro për ta emërua Myfti! Jo për vete por “për nevojat e BFI-së”, dhe, sapo të kalohet kriza, paratë do të kthehen. Shaqir Fetai nuk ka krizë më, ka para për t’ua rritur rrogat profesorëve. Tash e pesë muaj u jep para pushteti aktual maqedonas nga buxheti i shtetit. Pra, le t’ia kthejë paratë çunit. Shaqir Fetai, brenda natës i bëri të gjithë myfti, të gjithë kordinatorët, ndonëse asnjëri prej tyre nuk e meriton as postin çoban. Por, duke e ditur Shaqir Fetai se edhe vetë është i po të njëjtit nivel, ka thënë, le t’i bëj “myfti” duke ua marrur nga 50 mij euro ngjashëm siç ia mori edhe Myftiut të Dibrës! Brenda natës i bëri myftinj, i shkarkoi nga paraja dhe, meqë i korruptoi të gjithë, meqë ua shiti titullin myfti, i detyroi që të gjithë të votojnë për të! Edhe “reis” edhe me para, por ama, edhe me organet të nënshtruar, me organe gjytyrima, me organe që për prijës i ka emëruar njerëzit që kanë qenë të gatshëm t’i blejnë titujt, me tipa të korruptuar e të korruptueshëm në çdo moment! Ndryshe, si të veprojnë “i çliruar” nga obligimet kushtetuese të Aktit normativ të BFI-së, e cila nuk i intereson aspak!

Avash-avash, do të zbulohen të gjitha marifetllëqet e Shaqir Fetait, i cili për mision ka shkatërrimin në themel të BFI-së, ofendimin e myslimanëve të vendit, talljen me organet e BFI-së, duke ngritur një “shoqatë/rijaset” prej honxho-bnxhove sa për t’ia fërkuar “tashakët” Shaqir Fetait deri sa ky e kryen misionin e vet prej udbashi. Një ditë do ta kuptojë që të gjithë bolefërkuesit, por, do të jetë vonë, si për vetë ata, ashtu edhe për vetë BFI-në. Kurse Zoti nuk do t’i falë, sepse po i kryejnë këto veprime të mbërthyer nga epshi i djallit. Do me thënë – po u vie lezet të fërkohen me Shaqir Fetain.

## “KAFSHA SHTËPIAKE” e pushtetit

**U publikua një apel i Shaqir Fetait dhe pasuan mijëra reagime të popullatës myslimane në vend. Tashmë Shaqir Fetai konsiderohet si ato “kafshët shtëpiake” pas të cilave qyetarët “avangardë” lënë mendtë. Më mirë t’ia vrasësh pjesëtarin e familjes se sa t’ia shqelmoshë, bie fjala, një këlysh Shaqir Fetai paska lëshuar një apel që ishte në të njëjtën valë me apelin e pushtetarëve maqedonasë. Ruajeni distancën, vëni maskat dhe kujdes me dezinfektantët**

Do me thënë, sipas Shaqir Fetait, myslimanët e vendit janë popull i prapambetur të cilit duhet t’ia përkujtojë Shaqir Fetai sa herë që t’i thotë pushteti. Sepse, pushteti e di që myslimanëve të vendit, pra, shqiptarëve, nuk u ha palla për apelet e shtetit, e ndërsejnë Shaqir Fetain, duke harruar se, popullata jonë, duke e konsideruar edhe Shaqir Fetain si të pushtetit maqedonas, as që dëshirojnë ta dëgjojnë. Çdo apel i tij ka kundërefektin e vet!

Ja, pra, lojaliteti i Shaqir Fetait me pushtetin, fërkimi i tij për pushtetin, si qeni i zgjebosur për shtyllat prej betoni, rezultoi me mundësinë që, të paktën, myslimanët e vendit një ditë ta falim teravinë në xhami! Dhe, apelet gjithandej, propaganda gebelsiane e Shaqir Fetait po vlon, myslimanë, sot mund ta falni teravninë në xhami! Po nesër? Nesër siç do të thotë pushteti!

Pushteti, ngjashëm si familjet bashkëkohore, i kanë kafshët e veta shtëpiake, “omiljenikat”, për të cilët lënë mendtë. Askush nuk guxon t’i prekë e t’ua prishë. Kafsha shtëpiake ka të drejta më shumë se një anëtarë familje, mund të bëjë gjithçka, madje edhe të të kafshojë, ndërsa t’i ke të drejtën vetëm t’i përgëdhelësh dhe asgjë më shumë!

Shaqir Fetai apelon tash e një vit, ashtu siç e porositë pushteti, të kemi kujdes mos të rrimë të tufë, të mbajmë distancë, mos të falemi, mos të ushqehemi në tufë, të mos ketë iftare të organizuara e të përbashkëta, mos të rrimë në një ambient të mbyllur me më shumë persona, të mbajmë maska, të dezinfektohem etj. etj.

Ndërsa faktet flasin se ai është shkelësi më i madh i këtyre rregullave qeveritare, të kërkuara edhe nga OBSH-ja! Janë publikuar me dhjetra fotografi nga “eventet” e ndryshme ku, Shaqir Fetai duket si oçi në krye të dhenvë!

E fundit, para dy-tre ditëve: Shaqir Fetai, në Kërçovë, me rastin e “Akademisë solemne kushtuar Luftës së Bedrit”, lejon të organizohet një iftar në natyrë. Gjithandej ku policia sheh se po rrinë më shumë se katër persona, i gjobitë për thyerje të rregullave! Ndërsa fotografitë e publikuara nga vetë Shaqir Fetai e flasin të kundërtën, madje nga gjashtë persona në një tavolin, gjatë tërë kohës pa maska, dhe, ulen të hanë pa i dezinfektuar duart, ndërsa përsëndetet me “ua marrsha të keqen” me dhjetra myslimanë, ndërkohë që mund të jetë bartës i virusit që mund t’i infektojë të gjithë. Hipokrizia e ka emrin Shaqir Fetai! Para tre ditëve organizoi vatrën potenciale të përhapjes së virusit, kurse sot, si “melaqja e Stançiqit”, apelon për kujdes!

“Mos bëni çka bëj unë, bëni siç ju them unë”, porosit hipokriti, që bën jetë të “omiljenikut”, Shaqir Fetai. Turp të ketë. Turp që pranon t’ua prishë disponimin qindra mijëra myslimanëve të vendit, duke pranuar që të shpërfaqet në vegël sa herë që t’ia kërkojë pushteti maqedonas!

*(1Kliklart, 1.05.2021)*

## Si e kupton Shaqir Fetai islamin

Mbrëmë, myslimanët e vendit, patën mundësinë që ta falin namazin e teravisë me xhemat, nëpër xhami, anekënd vendit. Shaqir Fetai, posllushniku, ORAO i instaluar nga pushteti në krye të BFI-së me dinjitet të nëpërkëmbur deri në mohim, këtë meritë u mundua t'ia lë pushtetit, duke u lavdëruar se sa pushtet të mirë e të mëshirshëm dhe lojal që kemi ndaj myslimanëve. Në fakt, myslimanët mbrëmë u falën nëpër xhami falë festës së Pashkëve ortodoks, sepse qeveria eliminoi masat e përkohëshme për këtë festë e jo për t'u falur në xhami myslimanët. Shaqir fetai edhe një herë rrejti rrast në të mirë të pushtetit

### Nga Mevludin Ramadani

Çka e lidhë Shaqir Fetain me pushtetin maqedonas? Pse Shaqir Fetai mburret pas çdo “suksesi” të pushtetit, qoftë ky edhe fatal për myslimanët e vendit! E thjeshtë, sepse, pa pushtetin, Shaqir Fetai do të ishte hiç asgjë, nuk do të mund të vinte në shprehje për t'i dëftuar as afinitetet e veta që i ka për tradhëti e për spiunllëk!

Me pushtetin përkrah Shaqir Fetai fiton paprekshmërinë dhe lavdin e të qenurit udbash, spiun merr garancat e avancimit në karrierë, pa kurrfarë merite profesionale! Të spiunosh për pushtetin do të thotë t'i gëzoshë të gjitha beneficionet e pushtetit, madje edhe të arrishë të bëhesh “reis”! Të mirat e Zotit nuk janë asgjë në krahasim me të mirat e pushtetit, mendon Shaqir Fetai!

Mos ia turbullo ujin, mos ia refuzo kërkesën (skenarin), respektoja synimet pushtetit, nëse do të dalësh i respektueshëm – ky është botëkuptimi i “shenjtëruar” i Shaqir Fetait!

Është mirë kur pushteti ta zhvillon avokacinë, sepse nuk ke nevojë as për respektin dhe as për ndihmën e popullit. Pushteti është i plotëfuqishëm, kjo tashmë është dëshmuar. Ka edhe “të plotëfuqishëm” të tjerë porse këto ngelin në suaza të gojëdhënave!

Në këtë “filozofemë” Shaqir Fetai e thithë forcën për tradhëti dhe mbulohet me fuqinë e paprekshmërisë! Hajt se, nuk e lë Zoti pa ia thyer qafën!

### Forca e të qëndruarit në krah të “pushtetit”

Nuk është i vetmi Shaqir Fetai që pushtetin e përdor për ta arritur fuqinë e tradhëtisë “së falshme”, ka plotë të tjerë, minorë, argatë pa pare, si dhe ka të atillë që me vetëdije të plotë mundohen të futen nën “aurorën” e Shaqir Fetait duke shpresuar në të mirat e fuqisë së pushtetit që e shfritëzon Shaqir Fetai!

A ka hoxhallarë, a ka imamlerë, a ka ulema në Maqedoninë e Veriut? Nëse ka, pse me aq lehtësi e tolerojnë Shaqir Fetain t'ua ofendojë fenë dhe vlerat e islamit, nëse nuk ka, atëherë, pse tolerohet Shaqir Fetai të vetëquhet “reisul ulema”, kryetar i ulemasë! I cilës ulema nëse ajo nuk ekziston!

A ekziston ulemaja jonë, a kemi profesorë, akademikë, intelektualë, teologë të mirëfilltë! Gjeneratës më të vjetër i kujtohet fort mirë kur studenti Jusuf Berisha (më vonë gazetar i Rilindjes) e vorrosi profesorin e vet, një ndër akademikët më të shquar shqiptar. Shkrimi i studentit me titull “Dada Didaizmi” i dha fund karrierës së Profesorit!

Ku janë këta teologët e Maqedonisë! A e përcjellin veprimtarinë dhe “oratorinë” e të parit të tyre

apo jo! Për shembull, a e kanë dugjuar “ligjeratën” e Shaqir Fetait mbajtur në “Akademinë solemne kushtuar Luftës së Bedrit”!

A nuk u bën përshtypje diksioni i tij prej demagogu, a nuk u bën përshtypje “oratoria” e tij prej “perëndie”, me fuqinë e timbrit peç pushteti absolut, sepse është në terasë, në lartësitë ku mund të rrinë vetëm “zotërat”! Nuk i bën rastësisht këto mëkate Shaqir Fetai, porse i bën me vetëdije të plotë, sepse, ai e di fort mirë se cila është forca e të qëndruarit në krah të “pushtetit”!

## Qufërlëku i Shaqir Fetait

A guxon të heshtë hoxha, teologu, intelektual, ulemaja jonë kur dëgjon përpjekje të Shaqir Fetait për ta ofenduar islamin! Po ata hoxhallarë e “akademikë” që ishin prezentë, duhet t’i duartrokasin këtij qufri të Shaqir Fetait? Apo janë aty për qejfe e lezet reciprok! Po ata të tjerët që e dëgjuan muhabetin e qufrit të Shaqir Fetait, duhet të heshtin sepse edhe ata janë si “reisi” i tyre, apo, duhet të heshtin se pushteti ua ka zënë bishtin me derë, apo, thjesht, kështu janë të urdhëruar prej pushtetit që mos t’ia turbullojnë ujin Shaqir Fetait!

Si guxon të heshtë një teolog kur e dëgjon këtë konstatim idiotik prej Shaqir Fetait:

1. “Lufta e Bedrit nuk ishte luftë fizike”!

- O ulema, çka u bë me gjakun e 14 dëshmorëve të parë që u buzëqeshi fati të bijnë fli për hirë të Allahut Fuqiplotë, për hirë të dëshmisë se Allahu i merr nën mbrojtjen e vet të gjithë ata që bëjnë vepra në emër të Allahut; ranë dëshmorë të lindjes së kombit të ri, të dinjitetshëm e të fuqishëm; Shaqir Fetai e shpalli asgjë edhe pikën e parë të gjakut të trimit, Ubejde bin Harithi, i cili u plagos rëndë ndonëse ishte i gatshëm të vdesë për ta vërtetuar faktin se ai që lufton për Allah, del i pamposhtur!

- O Ulema, armiqtë e parë të islamit, ata që kishin vendosur që njëherë e mirë t’i zhdukin ata që iu pëkulen Allahut Fuqiplotë dhe, me këtë, ta zhdukin edhe farën e islamit, humbën në këtë betejë si mos më keq! A nuk ishte kjo luftë fizike në mes të së keqes dhe të së mirës, e cila do të shëmbëllej faktin që e mira gjithnjë është ngadhënjimtare, sepse është e mbrojtur dhe e bekuar me qufinë e Allahut xh. sh.

2. “Në këtë luftë u definuan dy shtyllat e fuqishme”: a) definimi i shenjtërisë së dijes dhe, b) definimi i shenjtërisë së lirisë së njeriut!

O Ulema, a durohet kjo “oratori e krishtere” e Shaqir Fetait, i cili ju flet në emër të “prijësit” mysliman! Po si guxon që shenjtërinë e dijes te myslimanët t’ua lë meritë 70 robërve që paskan vënë bazat e diturisë tek myslimanët dhe, e paskan pas shenjtëruar këtë bazë! Politeistët qenkan bërë sepse që të nxënë dituria te myslimanët “analfabetë të kohës”! Analfabetë këta strategë që ditën ta fitojnë luftën ndonëse tri herë më pak në numër, me armatim pothuajse zero! Analfabetë këta që e patën me vete Pejgamberin s.a.v.s., ajkën e diturisë së përbotshme, e patën me vete dritën e Allahut Fuqiplotë, e patën në krah fuqinë e TIJ, ishin të zgjedhurit e Allahut për t’i hapur rrugë Fesë së Zotit, islamit! Po jo, sipas Shaqir Fetait meritë na paskan qenë politeistët, robërit ndaj të cilëve tek myslimanët vlonte një dëshirë “për një hakmarrje të trishtueshme”, konstaton Shaqir Fetai! Të zgjedhurit a Allahut Fuqiplotë për pasues të parë të Pejgamberit a.s. Shaqir Fetai i konsideron si të “egër”, si të gatshëm për një “hakmarrje të trishtueshme”. Hakmarrje të tillë mund të organizojnë vetëm kanibalët, kriminelë ordinerë, gjenocidistët. Por, politeistët, nga kjo dëshirë e sëmurë e bashkëluftëtarëve të vet (!!!), i paska shpëtuar Pejgamberi a.s.

Shaqir Fetai mundohet t’i bindë të gjithë, madje edhe të hedhë teza të reja, inovative, sa i përket



Betejës së Bedrit, sipas të cilit, kjo luftë qenka zhvilluar që edhe sot “gjinia njerëzore” (apo qenia njerëzore!!!), t’i gëzojë dy parime kryesore: dijen-shkencë dhe lirinë e mendimit! Për këto dy parime na qenka zhvilluar kjo Betejë.

### **Çka ju tha bashkëluftëtarëve Pejgamberi a.s. në prag të Betejës**

Ndërsa Pejgamberi a.s., në prag të futjes në luftë, bashkëluftëtarëve të vet iu drejtua me këtë fjalim: “Falënderimi i përket Allahut, Krijuesit të botërave. Ju inkurajoj ta ruani Islamin ! Për këtë ju udhëzon Allahu ! Ju largoj nga dhuna, edhe Krijuesi juaj këtë ua ndalon! Allahu është i Madhërishëm, urdhëron të vërtetën dhe përcakton drejtësinë. Ai u jep të mira atyre që e meritojnë, sipas gradave që kanë te Krijuesi i tyre. Njerëzit në mes tyre, sipas së mirës, dallohen dhe përmenden. Keni ardhur në Bedër, në vendin e sprovës së vërtetë, tek Allahu pranohet vetëm ajo vepër me të cilën Ai është i kënaqur. Përmes durimit, Allahu xh.sh. në momentet vendimtare u heq brengën dhe i shpëton njerëzit nga vuajtjet dhe vështirësitë. Përmes durimit arrihet shpëtimi për të dy botët. Kini kujdes për detyrat që Allahu xh.sh.ua ka përcaktuar në Kuran, mos i harroni obligimet që ua ka mësuar Ai me ajetet e Tij. Pranoni me forcë veprat me të cilat Krijuesi juaj do të jetë i kënaqur. Tregoni besimin tuaj para Krijuesit tuaj dhe, në këtë vend, në Bedër, do ta meritoni mëshirën dhe faljen e Tij, që ju është premtuar. Premtimi i Allahut është i vërtetë. Mbrojtja e Tij është forca dhe siguria jonë. Vetëm Atij i lutemi për ndihmë, Atij i mbështetemi dhe tek Ai kthehemi. Allahu më faltë mua dhe besimtarët”. Porosi më të qarta se në këtë fjalim të shenjtë, nuk ka! Devijimi i këtyre porosive nga ana e Shaqir Fetait është tërësisht pabesi, qufër, është strategji e trishtueshme!

Ku i shprehi këto qëndrime Shaqir Fetai! “Në ambientin që na surprizoi, ambienti i kalasë, që u bë ambient adekuat me Betejën e maaadhe të Bedrit”! Kalaja e Kërçovës dhe Beteja e Bedrit! Ngjashmëri në këto dy ndodhi, që nuk janë adekuat, nuk përputhen në asnjë pikë të mundshme, mund të gjejë vetëm “gjinia njerëzore”, soji, abdalli Shaqir Fetai, i cili me veprën “si aktivitet partiak” apo të pushtetit maqedonas, mundohet t’i bëjë karshillëk veprës së shenjtë të frymëzuar, të inicuar, të mbrojtur e të garantuar nga Allahu Fuqiplotë.

Heshtja para këtij qufri të Shaqir Fetait, do të mallkohet, dhe, pa dyshim, ky mallkim do t’i prekë vetëm ata kompetenë, ata që, ndonëse kanë njohuri e dituri të bollshme akademike, heshtin si p... Në rastin konkret, heshtja do të thotë nënshtrim dhe frikë nga pasuesit e sojit të Stanko Dragoviqave e Temelko Boshkovskave të cilët vdiqën duke e deklamuar, në grahmën e tyre të fundit, betimin e UDB-së!

*(Fokusi, 2.05.2021)*

## “Radio Mileva” për Radio Antenën e Danimarkës

**Është paralajmëruar se sonte, Radio Mileva (kështu u thoshim dikur spiunëve) Shaqir Fetai paska intervistë në Radio Antena të Danimarkës**

Çka do të flasë Shaqir Fetai? Çfarëdo të flasë, një është e qartë: diasporës sonë në Danimarkë do t’iu drejtohet një prej munafikëve, një prej hipokritëve të pashoqë në këto hapësira. Do t’iu drejtohet bashkëpunëtori i oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviqit, i kyçur në lozën e bashkëpunëtorëve të oficerit maqedonas të UDB-së, Temelko Boshkovski, satrapit të shqiptarëve të Pollogut, i cili kishte përvojë të gjatë me baballëkun e Shaqir Fetait, Mulla Hasanin e Çegranit!

Për të qenë i sinqertë, sonte Shaqir Fetai duhet të flasë:

mbi përvojat e tij si bashkëpunëtorë i UDB-së;

mbi përvojat e tij 30-vjeçare si krah i djathtë i Sulejman Rexhepit;

mbi mjeshtrinë e tij për t’ia ngulur thikën pas shpine Sulejman Rexhepit; mbi afinitetet e tij sekrete për t’ia vjedhur pushtetin Sulejman Rexhepit; mbi ndihmën e pushtetit maqednas për t’u instaluar në krye të BFI-së; mbi shkeljet kushtetutare të Kushtetutës së BFI-së;

mbi shkeljet dhe mohimet e shumë akteve të BFI-së që bazohen në dy burimet kryesore të Islamit, në Kuran dhe në Hadith;

mbi rrenat e tij enciklopedike;

mbi përgatitjet e tij për vjedhje dhe për shkatërrim të BFI-së;

mbi vjedhjen, zhdukjen dhe tjetërsimin e vakëfit;

mbi lënien e BFI-së komplet në shërbim të BDI-së;

mbi betimin e tij për ta bëdëizuar BFI-në;

mbi premtimet e tij dhënë pushtetit maqedonas për defaktorizimin dhe deinstitutionalizimin e plotë të BFI-së;

mbi shkatërrimin deri në pension, të komplet asaj që është ndërtuar në BFI për 30 vite me radhë;

mbi instalimin e bashkëpunëtorëve të shërbimeve sekrete nëpër shërbime profesionale të BFI-së;

mbi avansimin dhe mbi pranimin për bashkëpunëtorë të ngushtë të të gjithë bashkëpunëtorëve të shërbimeve sekrete të vendit e të huaj;

dhe mbi shumë çështjesh të tjera që janë plan dhe strategji e shërbimeve të huaja që i mori mbi vete Shaqir Fetai si vegël realizuese e të njëjtave, deri në rrënim të plotë të BFI-së.

Pra, Shaqir Fetai duhet të flasë mbi këto të vërteta, mbi këto probleme dhe tek pastaj të flasë për ajërimin, për sfidat e kohës, për zhvillimin e islamit sipas botëkuptimeve të tij që janë identike me ato të shërbimeve sekrete!

Pa u penduar me shpirt e në emër të Allahut, para diasporës shqiptare, çfarëdo tjetër të flasë Shaqir Fetai, do të jetë pasqyrë që reflekton fytyrën e shejtanit me pamje të hipokritit. Diaspora gjithnjë ka qenë krenaria e kombit shqiptar dhe kurrë nuk u ka dhënë hapësirë spiunëve. Ç’ne kjo hapësirë në radion e diasporës së Danimarkës. Apo i ka manipuluar dikush! Kjo Radio duhet ta ndërmarrë një investigim mbi këtë manipulator dhe pastaj t’u bie më qafë atyreve që u ofrojnë munafikë e spiunë të llojit të Shaqir Fetait!

*(Lajme7, 2.05.2021)*

## **Fushata e Shaqir Fetait për vjedhjen e fitrit**

**Medreseja dhe BFI-ja duhet të lustrohen, edhe nga drejtësia, edhe nga krim- policia, sidomos nga komisionet kombëtare enkas për përshtatshmëri morale, fetare e kombëtare. Dhe, kurrë më mos të ndodhë që, nxënësi i eprorit të UDB- së, Stanko Dragviqit, siç po del të ishte Shaqir Fetai, të na “mësojë” hoxhallarë! Personelë që kanë shërbyer në Medrese me decenie e që kanë përfunduar në shërbimet sekrete policore! Këta kuadro mbahen nga fitri e zeqati dhe jo medresantët tanë! Kjo është e vërtetë si ZOTI NJË**

### **Nga xhemati i një pallati në Butel**

Jemi një xhemat kompakt, që jetojmë në një pallat në Butel, dhe që, tash e dy ramazane, i falim teravitë në bodrumin e pallatit. Jo vetëm ne, por edhe mysafirët tanë që na vinë për iftar! Kemi dhe hoxhën tonë. Pas teravive gati deri në syfyr, ia krisim muhabetit, pijmë kafe e çaj, jo radhë bisedojmë edhe për turpin e përditshëm që na ndodhë në Bashkësinë Fetare Islame.

Dje biseduam për propagandën e Shaqir Fetait që e kishte publikuar (video-klip) për tubimin e fitrit për Medresenë Isa Beu të Shkupit! Sot lexuam edhe një shkrim të publikuar nga drejtori më i kotë në historikun e Medresesë, Ibrahim Idrizi, i cili po ashtu apelonte që t’i derdhim fritrat te ai, ndërsa ai kurrë nuk i ka raportuar popullatës së shpenzohen fitrat tona, a shpenzohen vetëm për aty apo edhe për llukse! Si mblidhet fitri, kush e mbledh fitrin?

Zakonsiht, fitrin e mbledhin mexhliet e xhamive, të cilët për çdo fitër japin një kupon prej 100, 200 apo 300 denarë. Këta pastaj ua dorëzojnë imamlerëve përkatës, këta tutje myftilerëve, këta “reisit” e ky “vatrave arsimore”! Rrugës së dorëzimit të fitrit, një Zot e di se sa “i merr era”, ngase u japin makinave me dritare të hapur, fakt ky që ka ndodhur me dhjetra herë. Kemi parë edhe fakte që dëshmon për vjedhjen e fitrit me kupona të fallcifikuar.

### **“Drejtori” që ia mësynë të blejë edhe një mandat me fitrat tanë**

Një shkrim plot gënjeshtër, shumë i pasinqertë, një shkrim i detyruar për t’u shkruar si nën tytën e autotikut, si i kërkuar nga “policia morale”, një shkrim që askund nuk përkon me realitetin, me “suksese” të fryera dhe të pasinqerta, një shkrim që më tepër duket si përpjekje për ta blerë me fitrat tanë edhe një mandat të drejtorllëkut! Heeeej, ku ishte Sabahudin Mahmuti! Ku ishte Bahri Aliu e ku vajti Ibrahim Idrizi! Diskrapancë e trishtueshme në “politikat” e drejtorllëkut!

Si guxojnë ta fshehin faktin që, fëmijët tanë, tash e sa vite participojnë, do me thënë shkollohen me para në Medrese! Drejtoria në krye me Ibrahim Idizin si dhe “rijaseti” në krye me Shaqir Fetain, i kanë mëshuar kalem dhe e kanë nxjerrur një llogari vjetore se sa para u duhen për një vit dhe, aq kanë kërkuar përgjatë regjistrimit të fëmijëve tanë! Mishin dhe shumë produkte ushqimore i sigurojnë nga kurbani dhe nga donacionet e biznesmenëve tanë! Për rroga, tash e pesë muaj ka siguruar Shaqir Fetai nga buxheti i pushtetit aktual!

Medresja qenka krenaria e popullit tonë? Na ishte dikur! Sot mund të jetë vetëm vatër e “arsimimit” që më së paku i hy në xhep popullatës sonë! Këtë duhet ta them guximshëm dhe me fuqinë e besimit në islam! Nga medresja, shkollë kjo profesionale, e destinuar për të prodhuar kuadro për nevojat e BFI-së, deri më tani kanë dalur 4 – 5000 hoxhallarë, prej të cilëve, një numër relativisht i vogël është angazhuar nga BFI-ja! Ku janë të tjetër? Një numër janë inkuadruar në shërbimin e spiunazhit, një numër në polici, një numër në ushtri me pagesë, një numër në administratë shtetërore, një numër në gurbet dhe, një numër nëpër veprimtari imorale (kemi hajdutë, zinaxhinj, komarxhinj, dallaverxhinjë, seksere për blerje të diplomave false etj. etj.) Jep populli pare për Medresenë e këta prodho kuadro për nevojat e shtetit!

## **Ku po përfundojnë medresantet tona**

A ka dalë deri mëm sot nga kjo Medrese një grup revolucionaristësh! A ua kanë ngjallur atë shpirtin rrebel të rinisë, e cila, sapo të hetojë se në shoqëri po ngrit kokë imoraliteti, menjëherë të ngriten në këmbë dhe të dridhin institucione e shtet! Mbi 4000 hoxhallarë dhe asnjëri mos ta shprehë më të voglën brengë për atë se çfarë po ndodhë me BFI-në? Asnjë i ri, asnjë medresant, asnjë kuadër i dalur nga kjo vatër mos të trishtohet se BFI-në ua ka marrur në dorë UDB-a! Asnjë prej tyre të mos inicojë reforma të thella në BFI, të mos e pastrojnë BFI-në prej hajnave, prej spiunëve, prej bashkpunëtorëve të shërbimeve sekrete, prej bixhozxhinjëve e prej dallkaukëve! Ku është ai gjaku rinor për t’ju dalur përballë manipulimeve dhe për t’i stopuar të gjitha ato dukuri që po ndodhin në emër të islamit e në emër të Medresesë!

Medresja Isa Beu është bërë vetëm një kontejner ku duhet të derdhen paratë që lypsarët e BFI-së t’i mbushin xhepat! Po që e kanë shndërruar Medresenë në një “varrezë masive të makinave të prishura”! Në një “deponi hekurishtash”! A ka politikë arsimore BFI-ja? A e di se cilat janë nevojat e saj reale për kuadër? Apo, mbaje këtë “vatër”, sepse gjeneron para për vjedhje!

A nuk i vie turp drejtorit Ibrahim Idrizit, si dhe kryeudbashit të BFI-së, Shaqir Fetait që të kërkojnë si lypsarë fitra, zeqate e kontribute kur dihet që, me këtë gjest, ata vetëm sa po mundohen ta kamuflonjë lidhshmërinë e tyre me pushtet që po ua mbushë gushën me para!

Drejtori i kotë, Ibrahim Idrizi, e përfundon shkrimin me këtë fjali që t’i prish nervat dhe ta prishë edhe abdestin: “Lusim Allahun e Gjithëfuqishëm që ky shkrim të prek zemrat e besimtarëve dhe – më fuqishëm, edhe gjatë këtij muaji të shenjtë të ndihmohet buxheti i Medresesë Isa Beu, të cilën e mohojnë si Ministria e Arsimit e RMV, ashtuedhe mbarë pushteti, i cili nuk parasheh asnjë donacion!” Ku janë ata medresantë, ai kuadër, ajo aradhë prej 4000 medresantëve që nuk ngriten në këmbë dhe që nuk i tundin themelet e Ministrisë së arsimit? Ku është ky drejtor që nuk ngritë iniciativa bojkoti, proteste, demonstrate, sepse, nxënësit e tij pushteti po ua flakë nga fakultetet?

Ku është ky drejtor që t’ju thotë udbashëve se, mjaft u tallët me familje myslimane të devotshëm! BFI-ja shkollon medresantë për nevoja të xhamive, që të bëhen imamlerë, mualimë, muezinë, hatibë! Deri më sot nga Medresja kanë dalur me qindra e qindra medresante vajza! Tani, shtrohet pyetja se a janë edhe këta kuadër i domosdoshëm i BFI-së? Sa medresante punojnë në “rijaset”! Sa medresante kemi imamë, sa prej tyre mualimë, sa vaizë, sa hatibe, sa prej këtyre vajzave kanë arritur të vazhdojnë fakultete, tutje shkollimin e tyre sipas dëshirave personale! Le që Bashkësia Fetare Islame i flakë, i lë në gjysëm të rrugës, i lë me gjysëmshkollimi, bëhet shkaktare që t’ua nxijë jetën por, asnjë fjalë, asnjë reagim serioz nuk e bëri në vendimet qeveritare për t’i dëbuar medresantet që kanë arritur me ryshfet të regjistrohesh nëpër ndonjë nga fakultetet e universiteteve shtetërore. Edhe të rjepura edhe të lëna në rrugë. Ky është fati i medresanteve tona. Apo po na bëhen profesoresha e edukatore nëpër

paralelet e dispersuara! Po, por, pjesa dërmuese e tyre janë gratë, motrat, hallat, tezet, balldëskat, çikat e nëpunësve të BFI-së, si pasojë e politikave nepotiste kadrovike!

### **Cili cent i fitrit dhe zeqatit i gëzon medresantët tanë, siç i gëzon nevojtarët**

Tre banorë të këtij pallati jemi që i kemi shkolluar vajzat tona në Medresenë Isa Beu dhe që i kemi marrur më qafë. Aty kanë ngelur! Nuk kemi arritur askund t'i regjistrojmë! Jemi dakorduar që t'i dërgojmë nga e para në gjimnaz të përgjithshëm, por, turpërohen vajzat, na janë rritur. I morëm më qafë, i lam me gjysëm shkollimi. Bazat e fesë ua dhamë ne prindërit. Të paktën, ua luftuam vesin e të shndërruarit në spiune, gjë që u është kërkuar nga shumë profesorë, edukatorë! Nëse dëshironi, i thërrasim edhe me emër e mbiemër, por, a garantoj që do t'i suspendoni nga puna! Nuk mundeni, se ata aty janë të punësuarit e pushtetit që paguhen nga fitri dhe zeqati! Po fitri dhe zeqati që po e japim? Cila është shuma që shpenzohet ekskluzivisht për medresantët: mos ua falë medresja ndonjë tablet, ndonjë lloptop, ndonjë kicele, ndonjë çantë, diçka të blerë nga buxheti që muslimanët e vendit ua dedikojnë pikërisht atyre? Asgjë! Të gjitha shpenzohen për rroga, për udhëtime e për qejfe.

Për shembull, me dislokimin e “myftinisë së Gostivarit, në selinë e “Rijasetit” në Shkup, myslimanët e vendit paguajnë pesë rroga për “kuadrin” nga Gostivari, vetëm në “rijaset”; paguajnë për pesë persona vajtje-arrdhje nëpër pikë-pagesat rrugore, paguajnë për dy persona makina zyrtare dhe shpenzime karburantesh, paguajnë shpenzime për rrugë për pesë persona plus dhe pagesë ekstra për kushte dhe largësi udhëtimi. Vetëm “patarina” BFI-ja për pesë vetë nga Gostivari paguan 6.600 euro në vit, për dy makina zyrtare paguan karburant për secilën nga 12 mij euro në vit, për shpenzime rrugore paguan 12 mij euro për një vit, plus nja 10 mij euro për kushte dhe largësi udhëtimi! Mbi 50 mij euro shkojnë për stafin e Shaqir Fetait që na e ka sjellë nga Gostivari! Kjo i bie rreth 25.000 fitra! Ata që punojnë brenda BFI-së raportojn se, 50 mij euro fitra tubohen diku nga 6-7 myftinitë e vogla! Shtatë myftini, me xhematin e tyre, me myslimnanët e varfër, t'i mbajnë “ekipin”, injorant të Shaqir Fetait? Dhe ky ka pastaj fytytë të dalë e të kërkojë fitra e zeqat për medresantët të cilët as që e gëzojnë një cent nga ai fitër i tubuar, të cilët participojnë për shkollimin e tyre aq sa kanë llogaritur se ka nevojë drejtoria e Medresesë, të cilët pastaj lihen në rrugë, ndërsa personeli kriminel që çdo vit i fërkon duart duke pritur shumën të majme nga fitri e zeqati, vazhdojnë karrierën e vet.

Medreseja dhe BFI-ja duhet të lustrohen, edhe nga drejtësia, edhe nga krim-policia, sidomos nga komisionet kombëtare i formuar enkas për përshtatshmëri morale, fetare e kombëtare. Dhe, kurrë më mos të ndodhë që, nxënësi i eprorit të UDB-së, Stanko Dragviqit, siç po del që ka qenë Shaqir Fetai, të na “mësojë” hoxhallarë! Personelë që kanë shërbyer në Medrese e që kanë përfunduar në shërbimet sekrete policore! Këta quadro mbahen nga fitri e zeqati dhe jo medresantët tanë! Kjo është e vërtetë si ZOTI NJË.

(Ju refuzojmë me pështrësi e neveri, banorët e pallatit tonë (pasojnë emrat, mbiemrat dhe nënshkrimet):

*(Keshillohu, 4.05.2021)*

## **Për inat të Shaqir Fetait na vdektë “djali”**

**Myftinia e Tetovës, mbarë myslimanëve të vendit, ua hoqi të gjitha dilemat, mëdyshjet për sa i përket fitrit dhe zeqatit se ku duhet të jepen! Nëse ua japin këtyre të BFI-së, myftinive, dihet se ku përfundojnë: në ahengje e në iftare të përbashkëta! Të tjerëve – Zoti nuk ua ka shkruar të kënaqen ashtu si, bie fjala, hoxhallarëve të Tetovës, Shkupit, Gostivarit, Kërçovës, Dibrës, Kumanovës, Strugës...**

**Nga Jasir Jashari**

Jo njëherë është thënë se këta të BFI-së, me në krye instalacionin e pushtetit, Shaqir Fetain, çdo aktivitet, gjithçka që thonë e që veprojnë, e kanë vetëm farsë. E kanë vetëm sa për të mashtruar pushtet e milet, vetëm për ta vërtetuar atë tezëpezhorative, atë ofendim e sharje se, më dallaverxhinjë, më të pabesë se hoxhallarët nuk ka! Si duket, misioni i Shaqir Fetait me bandën e vet është pikërisht etiketimi i hoxhallarëve me këtë nofkë! Të mos harrojmë se ky mision dikur shte i UDB-së! Dhe ja ku po e ringjallin neo-udbashët!

Thonë se, po lavdërohen nga struktura të ndryshme se po kontribuojnë shumë në tejkalimin e situatës pandemike duke i respektuar të gjitha masat e kërkuara nga OBSH, nga organizatat shëndetësore evropiane, nga qeveritë e nga institucionet relevante shëndetësore të vendit. Si mund të lavdërohen kur Shaqir Fetai dhe banda e tij që në start i thyen të gjitha rregullat, duke mos përjetuar kurrfarë gjobe institucionale përkatëse, ngjashëm si qytetarët e shkretë! Një kohë, kur Shaqir Fetai ishte në fazën e pubertetit të vonshëm, sa nuk eksitohej publikisht nga urimet dhe përshëndetjet nga turma njerzish që i futeshin në kabinet. Pastaj, u lodhën me turma të vogla, ia krisën me nga 100 të ftuar njëherazi në kabinet, siç ishte puna me hoxhallarët e Tetovës që ia solli Qani Nesimi, pasi që ky e hëngër qepën që ia serviri Shaqir Fetai. Po, vetëm aty ku nuk duhet, vetëm aty ku janë shumë pranë mëkatit, aty “i respektojnë”, për shembull, mbyllja e xhamive, falja në distancë, humbja e kuptimit të safit, mbajtja e xhematit nga një orë gjatë xhumasë duke shitur hoxhallarët “intelegjencë” sa të gjeldetit, gjatë hutbeve të cilat nuk dinë t’i përcjellin sa më shkurtë!

Pajtohem të mos falen teravitë, për shkak të distancës, por nuk pajtohem të mos e hamë iftarin bashkarisht, sepse, në tufë frymëzohemi për të hëngër sa më shumë dhe për të bërë gara se kush po ha më shumë!

Atë që e bëri Myftinia e Tetovës, nuk e bën kush! Në prag të apeleve demagogjike e hipokrite, për tubimin e fitrit në buxhetin e Medresesë, del Myftinia e Tetovës dhe u tregon të gjithëve se ku shkojnë ato fitra, se si shpenzohen duke u palluar në iftare të përbashkët! Në një “odë” të grumbulluar të gjithë imamët, nëpunësit e ndryshëm të kësaj Myftinie si dhe profesorë të dikurshëm e të tanishëm të Medresesë, mbliidhen për një iftar të përbashkët, me propozim të nikoqirit, Myftiut të diskutueshëm, Qani Nesimit. Shtrohet pyetja: kush e pagoi këtë iftar, kush i mbuloi shpenzimet! Nëse ishte donacion, a nuk pati kurrfarë shansi që të ridestinohet ky donacion! Natyrisht që e kanë mbuluar nga arka e Myftinisë, e cila çdo vit mbushet me fitra e zeqat, me kontribute vullnetare e me rjepje të myslimanëve të këtij territori!

Pastaj, vërshuan komentet! Njëri kishte pyetur: o ju gurmaza të Myftinisë, a nuk bëri që me ato pare

t'i rregulloni varrezat, shenjat e rametlinjëve janë thyer e janë rrëzuar përdhe!

Tjetri kishte thënë: “MYFTINIA E TETOVËS U SHTROI IFTAR TË GJITHË SKAMNORËVE, JETIMËVE, PLEQËVE PA PËRKUJDESJE, TË VARFËRVE

DHE NEVOJTARËVE TË TJERË” – ky do të ishte titull shumë i qëlluar dhe shumë motivues, që do ta prekte çdo mysliman në vend, që do ta bënte borxhli çdo mysliman që t'i përgjigjet apeleve të Myftinisë! Kështu siç lexuam “Myftinia e Tetovës shtron iftar për të gjithë imamët e Tetovës”, është titull tepër dëshpërues dhe iritues, është aksion për ta sabotuar qëllimisht mbledhjen e fitrit për Medrese, sepse u tregua se për çka shpenzohen!

Tjetri e vë në pikëpyetje sinqeritetin e hoxhallarëve për të dëshmuar unitet në mesin e tyre! Në çka unitet? Në haram? Kujt deshtën që t'ia demonstrojnë këtë unitet? Jetimëve? Fukarenjëve? Të ngratëve? Hallexhinjëve që me lotë në sy e presin iftarin ngase nuk kanë se çka të shtrojnë në sofër? Apo fëmijëve që me sy të mjerë presin nëse dikush do t'ua zgjasë ndonjë denarë për sadaka!

Një nga diaspora shkruan: “Sot, gjermanët, 6 milion konsumatorët e birrave, e anuluan festën e tyre të birrës, sepse, pandemia ndrydhë çdo qejf e çdo dëshirë. Vetëm hoxhallarët e Tetovës i motivon që të bëjnë gara me të varfërit se kush do të hajë më shumë, kush do të hajë ifatar më të begatë!

Turp, turp, turp. O pasha të Madhin Zot, turp e haram! Si nuk i shkoi në mend Myftiut “filantropist”, Qani Nesimit, si nuk i shkoi në mend hipokritit, Shaqir Fetait, që, të urdhërohen të gjithë imamlarët dhe nëpunësit e tjerë të Myftinisë së Tetovës që të shkojnë në mesin e familjeve më të varfëra dhe më në nevojë, secili të gjejë nga një familje të tillë, t'ua shtrojë një iftar dhe, të çelin bashkarisht iftarin, ta ndjejnë gëzimin e të varfërit, ta ndjejnë atë ushtimë të zorrës së tharë nga uria, në fund, bashkarisht ta bënin aminin e darkës. Në të njëjtin moment, mbi 100 lutje, nga i njëjti ambient i mjerë, t'i drejtohen Allahut Mëshirëplotë, që të ketë sa më pakë lotë, mjerim e trishtim fukarallëku në mesin e myslimanëve tanë! Pa dyshim, këto do të ishin lutje që do të përcilleshin me lotë, sepse, trishtimi ta ndrydhë shpirtin, dhemb, trishton, lutjet do të ishin më të prekshme!

Nga fotoja e iftarit të përbashkët me hoxhallarët e Tetovës, në ngritjen e duarve për aminin e darkës, shihet se si të gjithë shikohen në mes vete dhe sikur dëshirojnë ta pyesin njëri-tjetrin: a u ngope, a ta kojti, a u pallove mirë. E bëmë mirë, për inat të Shaqir Fetait. Do të na shkruhet sevap ky gjest! “Sevape” plotë, po vinë tufa-tufa, por, myslimanët po ikin, jo nga feja, ruana Zot, por, po ikin nga hoxhallarët hipokritë, mynafikë, demagogë, të pasinqertë e shumë të rrezikshëm. E ky “bereqet” është i bollshëm, biles po tepron, po rrjedh kanaleve të ujërave të zeza!

*(In7.tv, 4.05.2021)*

## Shaqir Fetai manipulator i instrumentalizuar

**Shaqir Fetai, instalacioni i pushtetit maqedonas në krye të BFI-së, na paska shkuar në Manastir, për të biseduar rreth çlirimit të Mekes! Porosia: pas çlirimit të Mekes - çdo gjë tjetër le të robërohet! Le të robërohet edhe Jeni Xhamia**

**Nga Reshat Musliu, Manastir**

Manastirasit, që nga konflikti i vitit 2001 e deri më sot, nuk janë ndjerë më të fyer e më të poshtuar. Na erdhi Shaqir Fetai, udbashi me tapi, të tallet me manastirasit. Ai e bën detyrën e vet të marrur nga pushteti maqedonas, mbase edhe më herët, nga Stanko Dragoviçi i UDB-së serbe. Hidhërimi mbi të nuk duhet të jetë aq i madh sa duhet të jetë mbi kryeinjorantin që veten e llogarit për Myfti të Manastirit. Çfarë truri i kombit ka vluar nëpër Manastir e në ç'nderexhe kanë rënë myslimanët e Manastirit - të "drejtohen" nga soji i Rasimit. Vaj medet!

### **Pse në Manastir "Çlirimi i Mekes"**

Shaqir Fetai na paska mbajtur në Manastir një tribunë me titull "Çlirimi i Mekes"! Pse e zgjodhi këtë vend për një temë kaq të ndjeshme! A pati ndonjë shkas, apo, kot e kot, ashtu iu kujtua Shaqir Fetait! Jo, udbashët asgjë nuk bëjnë kot! Të gjitha aktivitetet i kanë të koduara, por, ja që kohëve të fundit po i dekodifikohen shumë lehte!

Shaqir Fetai, përmes kësaj teme kaq të rëndësishme për myslimanët anekënd botës, e legjitimoi qëndrimin e pushtetit maqedonas për ta pushtuar edhe një xhami - Jeni Xhaminë, të cilën tërthorazi e promovoi në muze, ngjashëm si Ajasofia në Stamboll (!), duke mos e ditur se ky muze na ishte dikur, tash aty myslimanët falin namaz!

Në Manastir Shaqir Fetai është dashur të organizojë një falje të akshamit, apo të teravisë mu në oborr të Jeni Xhamisë! Është dashur të organizojë ndonjë protestë për t'ua bërë me dije të gjithëve se Jeni Xhaminë nuk do të mund ta pushtojë askush. Pasardhësit e ilirëve në Manastir, Kishën e Shën Gjergjit, Shtëpinë e Zotit, pas konvertimit të tyre në islam, këtë Shtëpi e konvertuan në Xhami dhe vazhduan lutjet e tyre drejtuar Zotit dhe, nuk mundet me aq lehtësi ta uzurpojë dikush e ta shndërrtojë në muze të një etnie tjetër. Është trashëgimi shqiptare, sepse Shën Gjergji ka ekzistuar aty akoma pa zbritur dikush prej Karpateve! Shaqir Fetai në mes të Manastirit do të duhej të kumbonte: "Mjaft më me uzurpime, shkatërrime e djegie të Xhamive. Në Maqedoni ka elemente të gjenocidit të heshtur fetar. Gjurmët e lashtësisë sonë në këta troje po na zhduken ndërsa ne mendojmë se ruajtja e bashkëjetesës është obligim vetëm i yni, të tjerët mund të ushtrojnë mbi ne gjenocid fetar! Bilanci vjetor që kur u instalua Shaqir Fetai nga pushteti maqedonas në krye të BFI-së është katastrofal dhe shumë për keqardhje për fenë islame në këtë nenqiell. Kemi degraduar duke engritur në put Shaqir Fetain dhe duke i pranuar rrenat dhe djallëzitë e tij si "fe" tonën të re!



## Shaqir Fetai heq dorë nga Jeni Xhamia për një “Qendër kulturo-arsimore”

Për ta amortizuar goditjen fatale që pushteti maqedonas ua dha myslimanëve të vendit, ia krijoi mundësinë Shaqir Fetait që të hedhë gurthemel të një “qendre kulturo-arsimore”! A e ka haberin Shaqir Fetai për atë se çka do të thotë kjo qendër! A e ka projektin? A e ka Shaqir Fetai elaboratin, planin afatgjatë, a e ka idenë se çka do të bëhet me këtë qendër, me se do të merret kjo qendër! A e ka vendimin e Rijasetit, sepse për themelim të qendrave dhe institucioneve duhet vendimi i Rijasetit e jo i UDB-së! Një milion qendra të tilla të themelojë Shaqir gllupi, nuk e kanë peshën, rëndësinë dhe rolin e Jeni Xhamisë që po e shndërrojnë në muze, në institucion nacional maqedonas. Shaqir Fetai u dëshmuar si dhurues i madh i vakëfit, si tjetërsues i pashpirt dhe, po kaq si tjetërsues i pashpirt po del të jetë edhe për xhamitë shekullore të myslimanëve të kësaj ane.

Për fund do ta nënvizoj edhe një shqetësim! Më kot është pritja e reagimit të ndonjë teologu të vendit. Teologët tanë akademikë, ose nuk dinë shqip, ose nuk kuptojnë gjë, ose që të gjithë janë të shantazhuar nga shërbimet intelegjente! Apo, mbase edhe nuk e përcjellin veprimtarinë e djallëzuar të Shaqir Fetait, të cilin mund ta llogarisin si injorant të madh! Si bre askush nuk i reagoi Shaqir Fetait! Të paktën për konstatimin e tij masonerik! Në ceremoninë e hedhjes së gurthemelit, Shaqir Fetai do ta dhjesë edhe këtë “margaritar”: “Dihet botërisht se para epokës moderne, islami ishte burim i dijes dhe arsimimit...” Kush mund ta thotë një fjali të fillë përveçse një i pafe, pa besim! O Shaqir pishpiriki, ISLAMI ËSHTË BURIM I DIJES PËR ÇDO KOHË, PËR ÇDO EPOKË DHE NË ÇDO VEND E HAPËSIRË!

Kush je ti, o Shaqir Fetai, të ndashë e të caktoshë epoka. Nëse ia dedikon vetes, atëherë ti je i pakohë dhe i pavend, të paktën te shqiptarët!

Po del që, injoranca paska pasur portretin e Shaqir Fetait.

*(Politesa, 4.05.2021)*

## **Banorët e Hasanbegut nuk duhet ta harrojnë Mustafa Dautin që u pasurua mbi fatkeqësinë e tyre**

**Në Hasanbeg të Shkupit, para pes viteve ndodhi një tragjedi natyrore sa e tmerrshme aq edhe tragjike! Mbarë bota nisën, sakaq, të solidarizohen me banorët e kësaj lagje. U mbledhën shumë ndihma, miliona euro! U shpërnda diçka, por, akoma nuk dihet se ku mbeti pjesa dërmuese e ndihmave, sidomos në financa. Po a u shpenzua tërë ai buxhet shtetëror që ishte paraparë për të dëmtuarit e në bazë të vlerësimeve nga komisionet shtetërore në terren**

**Nga Naim Sadiku**

Këto ditë, banorët e Hasanbegut, përmes reagimeve dhe protestave të qeta, i rikujtuan “borxhlinjtë” institucionalë që u mbetën borxh që nga vërshima e vitit 2016. Ngjarja ishte apokaliptike, pasojat ishin të trishtueshme, pati edhe të vdekur e të zhdukur! Krejt bota u solidarizua me këtë Lagje. Erdhën ndihma nga katër anët. Inspektorë e komisionerë të ndryshëm të themeluar nga institucionet e shtetit dolën në terren dhe vlerësuan dëmet e shkaktuara. U pemtuan kompensime, banorëve iu dha shpresë se shteti do të jetë pranë tyre. Dhe, vetëm tani kuptojmë se sa para u ka ngelur borxh shteti nga ato premtime! Nuk janë dëmshpërblyer kulturat bujqësore, nuk është intervenuar në infrastrukturë, nuk janë shpërndarë ndihmat e premtuara.

Dhe, me plotë të drejtë banorët e Hasanbegut ua kujtojnë këtyre instituconeve se edhe më tej vazhdojnë të ngelin borxhlinj të kësaj lagje. Deri kur?

Banorët e Hasanbegut duhet të dijnë edhe një gjë dhe, pa dyshim që, duhet ta aktualizojnë!

Më 23 gusht, të vitit 2016, Mustafa Dauti ish-kryetari kontravers i Organizatës Humanitare “Hilal” që funksionon në kuadër të BFI-së, do të deklarojë para mediave se, nga dita e nesërme (pra, nga data 24 gusht të vitit 2016), në tërë territorin e Maqedonisë së Veriut, me urdhër të reisul ulemasë H. Sulejman ef. Rexhepit, do të nisë tubimi i ndihmave financiare në të gjitha territoret e myftinive tona, në çdo xhami e mesxhid! Me financat do të menaxhojë OH Hilal të cilat do t’ua shpërndajë banorëve të dëmtuar nga vërshima tragjike!

Atëbotë është folur e shkruar se janë tubuar rreth 400 mij euro, plus që kanë ardhur mbi 80 mij euro nga Kosova, 20 mij dollar nga Shqipëria, mijëra euro nga Lugina e Preshevës e nga Bosnja. Me qindra mijëra euro erdhën edhe nga diaspora!

Më 5 tetor, në Medresenë Isa Beu, H. Sulejman ef. Rexhepi, ua shpërndau ndihmën financiare (rreth 100 mij franka) banorëve nga Hasanbegu, ndihma këto që i sollli Kryetari i unionit të imamëve shqiptarë nga Zvicra, Nehat ef. Ismaili! Ky rast u përcoll edhe nga mediat e vendit. Por, ajo që nuk u kuptua kurrë, ngeli buxheti prej mbi 400 mij euro të cilat me gjasë përfunduan në xhepin e kryehajnit të BFI-së, Mustafa Dautit!

Banorët e dëmtuar të Hasanbegut e kanë tërë të drejtën e Zotit që t’ia kërkojnë paratë, sepse, ato u mbledhën në emrin e tyre, shqiptarët dhe myslimanët i donuan për t’ua zbutur dhembjet këtyre banorëve dhe jo për t’ia shtuar pronat dhe pasurinë Mustafa Dautit.

Dihet botërisht se, fill pas një jave, pasi u grumbulluan mbi 400 mij euro, Mustafa Dauti do të blejë

makinë Porche, bashkëshortes do t'i blejë Audi4, do ta pasurojë parkun e maiknave të veta në vlerë prej 300 mij euro. Këto fakte i di dhe i ka përfolur edhe imami i Hasanbegut, Fejsall Kadriu! Tashmë botërisht dihet edhe fakti që, Mustafa Dauti, fill pasi grumbulloi dhe e përvetësoi shumën e dhuruar për hasanbegasit, ai u bë pronar i:

-çertifikatës së pronësisë me numër 83667, sipas marrëveshjes për shitblerje të pronës së patundshme me numër 69/2018, të datës 6. 03. të vitit 2018, diku kah Sitimalli në Karposh;

-çertifikatës së pronësisë me numër 52987;

-çertifikatës së pronësisë me numër 83448;

-Mustafa Dauti është edhe pronar i çertifikatës së pronësisë me numër 92649;

-në Kapishtec Mustafa Dauti na del pronar i patundshmërisë me çertifikatë pronësie numër 59243;

-po ashtu, Mustafa Dauti na del edhe pronar i çertifikatës së pronësisë me numër 59452, të pasurisë së patundshme me numër 756/2019, nga data 22. 05. 2019;

-Mustafë Dauti na del edhe pronar i çertifikatës së pronësisë me numër 58518;

-në çertifikatën e pronësisë me numër 83667 na del pronar i patundshmërisë Mustafa Dauti;

-kurse në çertifikatën e pronësisë me numër 93575, pronare e patundshmërisë na del bashkëshortja e Mustafa Dautit, Mynever Dauti, e punësuar gjithashtu në BFI.

Pra, banorët e Hasanbegut, nuk duhet të reagojnë vetëm kundër institucioneve shtetërore që akoma nuk i kanë shlyer detyrimet ndaj tyre si pasojë e vërshimave me përmasa tragjike që ndodhën qysh para pesë viteve. Ata duhet të insistojnë që institucionet gjegjëse shtetërore t'i konfiskojnë këto pasuri të paligjshme si të Mustafa Dautit po ashtu edhe të matrapazëve të ndryshëm që tubuan ndihma financiare në emër të tragjedisë së tyre dhe i vodhën duke shtuar pasuri marramendëse!

Për më tepër, ky farë Mustafa Dauti, aktualisht “ministër i jshtëm dhe i brenshëm” i Shaqir Fetait, këto ndihma i mblodhi nën siglën e Organizatës Humanitare Hilal, që funksionon në kuadër të BFI-së.

A ka forcë BFI për ta mbajtur mbi kurrizin e vet këtë turp e këtë haram?

Është mirë të ndërgegjësohet pikërisht tani, në Muajin e Mëshirës, kur vetë kërkon mëshirë për t'i mbledhur fitrat dhe zeqatin!

Turpi i Mustafa Dautit është digë që e pengon çdo mëshirë dhe ndihmë për BFI-në!

*(Lajme7, 5.05.2021)*

## Frika e hipokritit

**Hipokritët druajnë se do të shpallet ndonjë sure e cila do t'i lajmërojë se ç'ka në zemrat e tyre. Thuaj: “Talluni po deshët! Allahu sigurisht që do ta nxjerrë në pah atë së cilës ju i druheni”. (Et Teube, 64)**

### Nga Vehbi Ibrahim

Nëpër disa qarqe mynafikësh, po qarkullon një video-klip i shkurtër ku shihet se si, Myftiu i kontrabanduar i Shkupit, Qenan Ismaili, mundohet të citojë se si qenka e kotë namazi dhe agjërimi i atij i cili përgojon! Do me thënë, e ka për vete, sepse i ka djegur dikund! Dërgonte “selame” duke u munduar që, përmes citimeve të haditheve, të frikësojë njerëz dhe mos t'ia zbulojnë të bëmat prej hipokriti!

Pra, ja që unë, mysliman i këtij vendi, i devtoshëm (për këtë e kam dëshmitar Allahun e Gjithëdijshëm) nuk dua asnjë sevap që është i ngjashëm me ato të Qenan Ismailit, por ama nuk do të mund të rri pa e lakuriqësuar injorantin! E ky le të thotë pastaj se po më “përgojnë”!

Ai mendon se, gjithçka që flitet për Qenan Ismailin, është përgojim, nuk është vepër e myslimanit të mirëfilltë, ndaj si e tillë duhet të hidhet poshtë, mos të dëgjohet asnjë fjalë prej “përgojuesit” që e cullakosë ndyrësirën!

Nëse flet për Qenan Ismailin se si u bë “myfti” duke e gënjyer BFI-në, respektivisht, H. Sulejman ef. Rexhepin, se ka pesë vite përvojë pune në BFI, pa pasur asnjë sekond, kjo do të thotë se na qenka përgojim, a!

Nëse flet për rrenat e Qenan Ismaili të hedhura në një copë letër e që na e tundë si “program”, nëse ia nënvizon të gjitha rrenat, sepse asgjë nuk u realizua prej asaj që tha kur e gënjeu punëdhënësin e tij, kjo na qenka përgojim, a!

Nëse ia tërheq vërejtjen për atë se si i mashtrou imamlerët e Shkupit për kartela bankare, për rrogë me kartela, për pagesa institucionale të shërbimeve pensional e invalidor, kjo na qenka përgojim, a!

Nëse ia tërheq vërejtjen për sjelljet prej fodulli në raport me nëpunësit e tij në Myftini, kjo qenka përgojim, a!

Nëse i thua se në Myftini i ka dhënë post dikuj me diomë false, kurse shumë të diplomuar janë pa punë, kjo na qenka përgojim, a!

Nëse ia tërheq vërejtjen për vjedhje të përditshme në emër të aktiviteteve ditore islame, kjo na qenka përgojim, a!

Nëse ia tërheq vërejtjen për humbjen, shitjen, zhvatjen e vakëfit të Shkupit, edhe kjo qenka përgojim, a!

Nëse flet për ish selinë e Myftinisë së Shkupit në Kala (aty ku filloi mandatin), se përse është lënë shkret dhe në pronësi të kuj është tani, edhe kjo na qenka përgojim, a! Nëse ia tërheq vërejtjen që mos t'i justifikojë dështimet e veta me faktin që nuk paska buxhet, se me 20 për qind nuk paska mundësi për të bërë asgjë, prandaj po dështuaka Myftinia më e madhe në Maqedoninë e Veriut, edhe kjo na qenka përgojim!

Nëse kritikohet për dështimet totale të tij si dhe për justifikimet e tij prej hipokriti se “katër vite

qenkan pak për të bërë diçka të madhe”, ndërkohë që katër vite janë mjaftueshëm për të drejtuar shtete e organizata me relevancë botërore, edhe kjo na qenka përgojim, a!

Nëse shprehet habia se si po mburrehka si debil me “aktivitetet” e Myftinsë së Shkupit, meqë paska arritur të shtojë numrin e “Ilajkave”, edhe kjo na qenka përgojim, a?!

Dakord, nuk do ta përgojmë më por ama, do ta tregojmë një të vërtetë të madhe! Miqve të Sulejman Rexhepit, atyreve, të cilët ia tërheqin vërejtjen për mosmirënjohje ndaj ish-reisit që e emëroi “myfti”, vazhdimisht ju thotë se, kur ka shkuar në Gostivar as që e ka ditur se pse po shkon, vetëm se e kan thirrur në një mbledhje! Ka qenë i manipuluar e i gënjyer, sepse, ndryshe, kurrë nuk do të votonte për shkarkim të Sulejman Rexhepit! Ndërsa, miqve të vetë ua thotë të kundërtën. U thotë se, ka qenë iniciatori kryesor për shkarkimin e H. Sulejman ef. Rexhepit!

Po ia përkujtojmë një detal! Me t’u kthyer nga Turqia, ku ishte për shërim nga Covid-19, një myfti nga Shqipëria, takohet me Qenan Ismailin dhe me ca persona të tjerë, në një nga restorantet në dalje të Skupit! Në bisedë e sipër, pasi myftiu shqiptar e kritikon praktikën që e ka instaluar “rijaseti” i papërgjegjshëm me shkarkim tinëzar të Reisit, Qenan Ismaili, është arsyetuar: “Sulejman Rexhepi e teproi! U bë shumë i rrezikshëm për shtetin. Na dhanë urdhër nga ministria e brendshme që urgjentisht të tubohemi në Gostivar. E kemi pasur patjetër të tubohemi e ta shkarkojmë. Ishte urdhër! Në të kundërtën, do të na hynte policia financiare e do të na burgoste të gjithëve, sepse asnjëri nuk jemi të pastër”!

Ja pra, pa qenë këto “përgojime”, vështirë se do të mund ta shpalosnim hipokrizinë e Qenan Ismailit, i cili, e kapi Myftininë e Shkupit, jo me merita, por, me dredhira, sepse “edhe për këtë paska qenë i urdhëruar! Ta pushtojë kalanë nga brenda”! Fundja, ai që e emëroi i manipuluar, për myfti, në Zërin e Amerikës e pat trajtuar si një nga drejtuesit e një “shoqate” që nuk është asgjë tjetër përveç filiale e shërbimeve inteligjente maqedonase! Ja ku ky fakt doli të jetë i saktë, u vërtetua nga biseda që e bëri me myftiun nga Shqipëria!

Nëse këtë rrëfim Qenan Ismaili e vlerëson si përgojim, unë ia bëjmë me dije se është edhe një zhveshje e tij prej petkut të hipokrizisë që i mbanë palë-palë në shpirt! Qenan Ismaili nga “përgojimi” i disave i druhet vetëm nxjerrjes të së vërtetës për të! Kjo frikë është cilësi e hipokritëve, prandaj dhe Allahu xh.sh., në ajetin e lartëshënuar thotë: “Allahu sigurisht që do ta nxjerrë në pah atë së cilës ju (hipokritë) i druheni”!

*(Tetovasot, 5.05.2021)*

## Oqeani me rrena i Shaqir Fetait

**Ekskluzive: Përfundimisht u zbulua oqeani më i madh në botë, i mbushur përplot me rrena e me vetëlavdërata. Ky oqean është pronë shpirtërore e Shaqir Fetait, këtij dështaku që na e mori fytyrën. Rrena i ka këmbët e shkurta, ka fizionominë pikërisht të Shaqir Fetait**

### *Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI*

Nga nata e sontme myslimanët e vendit mund t'i falin edhe teravitë e këtyre ditëve të bekuara të Muajit të Ramazanit.

Fillimi i këtij Muaji na gjeti me një bilanc të tmerrshëm ditor nga pandemia Kovid-19! Numri i të infektuarve në ditë kalonte numrin 1000, ndërsa vdekshmëria ditore mesatarisht ishte nga 45 persona të vdekur. Ndaj dhe, qeveria u desht të miratojë vendim që parashihte orë policore në orar 20 me 5. Ky orar e bënte të pamundur faljen e namazeve që hynin në orën policore, sidomos teravitë! Dy javë më vonë, këto masa rezultuan me një rënie bukur të madhe të numrit të infektive ditore dhe, si rrjedhojë, u zbutën edhe masat e qeverisë!

Tani, këtë vullnet të Zotit Mëshirëplotë, këtë rënie të numrit të të infektuarve, Shaqir Fetai mundohet ta personalizojë, ta përvetësojë, ta shesë si meritë të veten. Po a ka turp e mëkat më të madh se kjo përpjekje e këtij faqeziu!

Shaqir Fetai i drejtohet myslimanëve duke ju thënë se prej sot do të mund t'i falin teravitë e mbetura pasi që “Qeveria, pas shqyrtimit, paska marrur në konsideratë kërkesën e tij” për t'i lejuar faljet e teravive të mbetura.

Shaqir Fetai, në fb-un e vet shkruan: “Me këtë rast, duam të shprehim mirënjohjen tonë për qeverinë dhe institucionet përkatëse që e pranuan kërkesën e bërë nga Reisul Ulema i BFI të RMV, H. Hfz. Shaqir ef. Fetai, që besimtarëve myslimanë të vendit tonë t’ju mundësohet falja e namazit të teravive në netët e mbetura të Ramazanit...” Pra, mirënjohje për Qeverinë që po na lejon të falemi! Mirënjohje qeverisë që gjithnjë “i shqyrton” kërkesat e Shaqir Fetait.

Po pse Shaqir Fetai gjitha këto mirënjohje për qeverinë? Cili është ai borxh kaq i madh ndaj Qeverisë që e detyron Shaqir Fetain t’i jetë mirënjohës përjetë! Vetëm sa të tregojë se sa kooperativ janë në mes vete Shaqir Fetai dhe Qeveria? Të dëshmojë se si Qeveria gjithnjë i ka pasur në konsideratë kërkesat e Shaqir Fetait.

Atëherë, pse Shaqir Fetai nuk e shprehu një kërkesë të tillë që në ditën e parë të Ramazanit?

Meqë qenka puna se, Qeveria gjithnjë i paska në konsideratë kërkesat e Shaqir Fetait, atëherë, pse Shaqir Fetai nuk shpreh kërkesë për kthimin e vakëfeve dhe këtë gjë ta kryej me një kërkesë të parë? Pse nuk bën kërkesë që të nisët ndërtimi i Xhamisë së djegur në Prilep? Pse nuk bën kërkesë për ta rikthyer Jeni Xhaminë e Manastirit? Pse nuk bën kërkesë për Xhaminë në Llazhec? Pse nuk e bën kërkesën për ta rikthyer Xhaminë në Shtip!

Do me thënë, të gjitha diskriminimet, të gjitha përzjerjet e shtetit në BFI, të gjitha nëpërkëmbjet dhe fyrtet që i përjetojnë myslimanët e vendit si dhe feja islame, të gjitha këto mund të marrin fund vetëm

me një kërkesë të Shaqir Fetait drejtuar Qeverisë? Qenie më të poshtë zor se gjenë në fytyrë të tokës! Pra, myslimanë të dashur, ju nga sot mund t’i falni teravitë e ngelura të këtij Muaji të Bekuar, sepse ky është Vullnet i të Madhit Zot, ra dukshëm numri i të infektuarve nga koronavirusi, dhe Qeveria e pa të arsyeshme që t’i zbusë masat dhe, jo se kjo u arrit falë ndonjë mirëkuptimi ndaj kërkesave imagjinare të Shaqir Fetait. Nëse i besoni kësaj “kerkese” atëherë duhet t’i besoni edhe kërkesës tjetër: u penguar nga qeveria t’i falim teravitë 20 ditë, ngase kjo ishte kërkesë e Shaqir Fetait. E bën ky edhe këtë të pabëshme? E thotë edhe atë që e fyen çdo mysliman në botë. Shaqir Fetai thotë: “Vlen të theksohet se ky vendim ka ardhur edhe si rezultat i disiplinës së treguar nga të gjithë namazfalësit që frekuentojnë xhamitë”! Do me thënë se, pandemia u fut në mesin tonë dhe, si rrjedhojë, u përforcuan masat parandaluese si pasojë e mosdisiplinimit të mëparshëm të namazfalësve? Këtë gjë nuk mund ta pohojë as vetë Shejtani! Por ama, Shaqir Fetai po!

*(1Kliklart, 5.05.2021)*

## Salim Sulejmani shpreh falënderime për pjesëmarje në iftar!!!

### *Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI*

A e njihni Salim Sulejmanin? Këtë bre, që i thotë vetes “myfti” i Myftinisë së Strugës, i cili, për t’u dëshmuar si “i sukseshëm” në tubimet e kontributeve financiare fetare, i mirrte paratë nga buxheti familjar dhe i dorëzonte në arkën e BFI-së. Pra, vetëm që të lavdërohet, të lartësohet si “myfti i sukseshëm” dhe të vazhdonte në pozitë. Kësaj i thonë – blerje e pozitës me buxhet të familjes, e cila, tashmë ka rënë në patos, sepse, është dashur t’i blejnë edhe super makinë luksoze, sepse është dashur të dëshmohet se është “myfti i madh”! Problem i tyre!

Ajo që paraqet problem më vete është, pandëshkueshmëria e këtyre qytetarëve/ myftinjë me gjoba, si të gjithë qytetarët që tubohen deri në katër persona, madje edhe në natyrë. Disa “myfti” në sy të policisë, para hundës së pushtetit, i tubojnë 50, 100, 150, 200 persona, sa t’i dojë pika e qejfit, sa ka bërë nijet t’i infektojë me Kovid-19! Asnjë dasmor nuk guxon t’i tubojë 100 dasmorë në një restorant prej 500 vendesh (pra, që garanton një distancë përtej masave të kërkuara), sepse, menjëherë gjobiten e burgosen! Asnjë prind nuk guxon t’i tubojë bijat dhe djemtë në një iftar familjar, sepse ekziston rreziku i gjobitjes!

Po si atëherë “myftinjët” e Shaqir Fetait, përfshirë këtu edhe Salim Sulejmanin, pa kurrfarë problemi, para organeve shtetërore përgjegjëse për disiplinë të hekurt në kushte pandemie, u lejohet që të organizojnë iftare ku marrin pjesë me qindra persona? Çfarë borxhi u ka pushteti që i mbyllë syt karshi këtyre veprimeve shumë të rrezikshme të “myftinjëve” të pashpirt! Kjo, për sa i përke raportit myfti-pushtet, ndërsa, sa i përket raportit myfti-Zot, këtu punët janë edhe më drastike!

A i dëgjojnë këta myftinj të qarat e nënave që nuk kanë se çka t’u shtrojnë në darkë fëmijëve? A lagen në shpirt nga lotët e të varfërve! A rrënqethen nga krisma e zorrëve prej urisë që janë të barasvlefshme sa krismat e bombave atomike! A i dëgjojnë rrotullimat e kokrrave të kripës derisa ngjyhen me koren e bukës nga të vafër e të ngratë! A i dëgjojnë kërkesat dhe lutjet e përshpirtshme të fëmijëve të varfër, jetimëve, të cilë kanë nevojë për një palë çorape!

Ose, cilën aktivitet humanitar e bëri Salim Sulejmani që të shtrojë një iftar “gllamuroz” për imamët, këshilltarët e xhamive dhe me talebet! Me se e pagoi iftarin? Sigurisht jo nga buxheti i familjes, por, nga fitri dhe zeqati i mylimanëve që i japin për jetë fetare e jo për qejfe idiotike të myftinjëve! Çka iu desht ky iftar? Të tregojë se sa e duan? Të tregojë se kur ky i fton, të gjithë janë tok aty? Po çka iu desht ai falënderim për pjesëmarrje në iftar? Kush e bën këtë falënderim? Vetëm ai që ka humbur autoritetin, dinjitetin, integritetin, ai që e di se vetëm në haje mund të tubojë një numër “bashkëpunëtorësh” sa për të dëshmuar se, ja, “shikoni sa i madh jam”!

Salim Sulejmani, para syve të të varfërve, jetimëve, bonjakëve, fukarenjëve, është shumë i vogël, aq i vogël sa e shqelin me dinjitetin dhe integriteti e tyre që e kanë me përmasa gjigante! Turp për gurmazët e sojit të Salim Sulejmanit!

*(Fokusi, 5.05.2021)*



## Shaqir Fetai ky ngrënës i babëzitur i vakëfit

**Shaqir Fetai dëshiron të lëshohet edhe në një aventurë, në të cilën mund të hyjë vetëm nëse hapëron guximshëm mbi Kushtetutën e BFI-së të cilën tashmë e ka shndërruar në një leckë të pavlerë. Mund t’ia japë ndonjë organizate të huaj menaxhimin me vakëfet e BFI-së, ashtu siç e la në duar të huaj edhe vetë BFI-në**

**Nga, Shefqet Jusufi, jurist**

Shaqir Fetai, “reisi” i instaluar dhunshëm nga pushteti aktual në krye të BFI-së, paska takuar një drejtor të një asociacioni ndërkombëtar që po u marrkëka me menaxhimin e vakëfeve, me z. Dato Abu Ubaidah Kemin! Kush nuk di të menaxhojë me vakëfin, ja ku e keni drejtorin, ai ua menaxhon bile ç’keni me të!

Shaqir Fetai, si e para, bën keqprezantimin e mysafirit të lartë nga Malejzia, për të cilin thotë se është drejtor i një “asociacioni” i cili, në fakt, nuk ekziston askund në botë, madje si i tillë as që mund të ekzistojë, madje si emërtim nuk do të ishte produkt as i debillëve, me përjashtim të “shërbimeve profesionale” të Shaqir Fetait! Ku ka në botë emërtim të këtij lloji “BANKA E GRUPIT NDERKOMBETAR TE VAKFIT”, sikur të bëhet fjalë për ndonjë “grup kriminelësh të bankave piramidale”! Ndërsa, në fakt, bëhet fjalë për një organizatë mjaft prestigjioze, me titull BANKA INTERNACIONALE E VAKËFIT!

Madje, Shaqir Fetai është pajtuar që, si fazë të parë, të mbajnë ndonjë seminar me ekspertët e këtij drejtori, i cili do të vie këtu dhe do t’ju tregojë se si menaxhohet vakëfi! Dhe, Shaqir Fetai, ky farë injoranti i gjithëanshëm, thotë: “të vijnë e të këmbëjme eksperiencën”!

Cila është eksperiencën e menaxhimit të vakëfeve në Maqedoni! A ka eksperiencë të mirë apo të keqe! Nëse është eksperiencë e mirë, nuk duhen seminare! Nëse është eksperiencë e keqe, atëherë, le të na tregojë Shaqir Fetai se cila është ajo eksperiencë e keqe e tij përgjatë kohës sa, si myfti, ka menaxhuar me vakëfin e Gostivarit!

Shaqir Fetai ka eksperiencë të trishtueshme: jo vetëm që ka vjedhur, jo vetëm që ka toleruar tëhuajësim të vakëfit, jo vetëm që ka votuar për t’u huazuar vakëfi, jo vetëm që ka qenë pjesëmarrës direkt në keqmenaxhim por, ai ka ushtruar edhe krim mbi vakëfin! Vijnë dashamirët e islamit nga Banka Islame për Zhvillim dhe dëshirojnë që të investojnë në një objekt mbi 9 milion dollarë të cilën, në fund, do t’ia linin vakëf Myftinisë së Gostivarit! Vakëf mu në qendër të qytetit! Kurse Shaqir Fetai, meqë sheh se nuk ka përfitime personale, e saboton, e minon, e dëbon projektin! Shaqir Fetai duhet të flasë mbi këtë “eksperiencë” të tij!

Tutje, Shaqir Fetai pastaj lajmit i shton edhe disa “mëlmesa”, dëshiron të na mbajë ligjeratë se çka është vakëfi! Dhe, thotë: “Dispozita e vakëfit është “afrim tek Allahu”, fitim i kënaqësisë së Allahut dhe shpëtim në botën tjetër. Vakëfi është ndër veprat nga të cilat njeriu edhe pas vdekjes fiton shpërblime (sevape)”!

Shaqir Fetai mundohet të manipulojë, të tregojë se sa i vëmendshëm është ndaj vakëfit! Po, kjo dispozitë islame vlenë vetëm për atë që lë vakëf! A ka tentuar Shaqir Fetai të lë diçka vakëf dhe “ti afrohet Allahut”? Po çka bëhet me atë që e shet vakëfin, me atë që e zhatë vakëfin, me atë që e keqpërdorë vakëfin, me atë që e dëmton vakëfin! Cila dispozitë islame vlenë për atë person shkatërrimtar! Natyrisht, “largim të prjetshëm prej Allahut”! Veprimet e Shaqir Fetait në raport me vakëfin flasin se

ai duhet të jetë në largësi stratosferike prej Allahut! Vetëm shpirti i tij e di se çka ka bërë me vakëfet! Vetëm gurmazi i tij e di se si ushqehet duke keqpërdorur vakëfin, duke i keqpërdorur letrat në vlerë të cilat jepen për ta zëvendësuar një vakëf “të uzurpua” me një vakëf tjetër dhe jo Shaqir Fetai të shpërndajë rroga e t’i shëtisë b... nëpër Sarajevë, duke u munduar që të gjejë një vërtetim që do të “dëshmojë për pastërtinë e figurës së tij”! Në realitetin tonë, me vakëfet menazhojnë Myftinitë dhe, me të hyrat që gjenerojnë ato vakëfe, mbahet gjallë jeta fetare islame nëpër territoret përkatëse. Në BFI ka ekzistuar një rregullore të miratuar nga të gjitha organet kolektive të BFI-së, sipas së cilës, nga të hyrat e përgjithshme prej vakëfeve të myftinive, 30% shkojnë në arkën qendrore të Rijasetit dhe 70% ngelin në arkat e Myftinive. Më pas është thënë se është diskutuar një rregullore tjetër, e pamiratuar dhe e pa nxjerrur në diskutim, sipas të cilës të hyrat ndahen në raport respektivisht 50 me 50%!

Shaqir Fetai ka përvojë të hidhur, ka eksperiencë prej hajni në raport me vakëfin, ndaj, tani, kur i duhet më së shumti, kërkon ndihmën e drejtorëve internacionalë “për të këmbyer eksperiencën”!

Shaqir Fetai nuk duhet të harrojë se, pas seminareve, nxirren konkluzionet për në perspektivë, të cilat i dënojnë praktikën e kaluar! A do të ketë sanksionime për ata që kanë vjedhur dhe shkatëruar vakëfin, apo, me këtë seminar eventual do të amnistohen të gjithë! Do të formojnë një “grup rijseti” që kurrë nuk do të mund t’i afrohet Allahut, as pas pendimeve “më të sinqerta”!

Ku di të pendohet shejtani sinqerisht! Vetëm të mallkuarit qëndrojnë larg Allahut, prandaj dhe i japin vetes lluksin e imoralitetit, përfshirë këtu edhe keqpërdorimin e vakëfit, të fitrit, të zeqatit, të ndihmave humanitare!

Të tillët i pret një dënim i rëndë, këtë e garanton Vetë Allahu Fuqiplotë.

*(Kombetare, 6.05.2021)*

## Pak për “humanizmin” dhe prishuninë e Shaqir Fetait

“Nën patronazhin e reisul ulemasë Hilali ndau ndihma”, “delegacioni i ramazanit përcolli përshëndetjet e reisit”; çfarë emërtimi pretencioz “Delegacioni i Ramazanit”, tipike ide bolshevike, e demagogëve që notojnë si m... mbi ujë falë hipokrizisë së tyre aq shumë të lexueshme... Janë disa nga sloganet komuniste që mund t’i lexoni në informatat e fundit që i publikon “shërbimi për informim” i BFI-së në përpjekje për ta shpëtuar nga rezillëku “reisin” e tyre, produkt ky i pushtetit aktual maqedonas

Shkruan Bujar K. Fejzullahu

“Myftiu i Strugës, ai de, merakliu i lëpiskave, Salim Sulejmani, sërish paska shtruar iftar për personalitete të larta nga BFI e nga pushteti lokal! Edhe pse në “sofër” ka pasur personalitete që marrin rrogë mbi 1500 euro, edhe ky iftar u pagua nga arka e Myftinisë së Strugës, e cila mbushet nga fitri e zeqati, nga anëtarësia e nga kontributet e ndryshme vullnetare të myslimanëve të devotshëm struganë! Disi, më padhimbshëm paguhet iftari nga arka e Myftinisë! Disi, nuk të dridhet dora kur paguan nga fitri dhe zeqati, nga djersa e myslimanëve të devotshëm struganë. Dhe, pastaj, tamam si hipokritë, flasin për humanizmin!

### 1.

Shaqir Fetai, prijësi i “Delegacionit të Ramazanit” (a ka emërtim më pretencioz? A ka emërtim më idiotik, i cili, mund të dalë vetëm nga mendja e antiislamistëve, nga ëndërrimtarët që mendojnë se prej udbashi mund të kaloshë në “kalif”), paska folur para xhematit të Llabunishtit, të cilëve, veç tjerash, u paska folur mbi humanizmin, i cili, sipas Shaqir dudukut, duhet të jetë i vërtetë sidomos gjatë muajit të Ramazanit. Shaqir Fetai na paska thënë: “Ramazani është muaji në të cilin duhet të mbretërojë humanizmi i vërtetë”! Sipas kësaj logjike hipokrite, i bie që muajve të tjerë mund të bëjmë edhe humanizëm të rrejshëm, por për Ramazan duhet të jetë vetëm i vërtetë! Shaqir Fetai kërkon që myslimanët të hapërojnë sipas mësimëve islame! Po “udhëheqësit” e myslimanëve, si duhet të hapërojnë ata? A mundet që myslimanët të hapërojnë sipas mësimëve islame, kurse “prijësit e tyre” të hapërojnë sipas mësimëve të UDB-së?!

Tutje, Shaqir Fetai, duke përcjellë porosira të hershme të UDB-së, ofendon duke thënë: “falë besimit të paluhatur që kanë besimtarët e këtij nënqielli, Bashkësia Fetare Islame dhe besimtarët muslimanë në Maqedoninë e Veriut posedojnë mbi 700 xhami, të cilat udhëhiqen nga mbi 1200 imamë, kuadër i formuar dhe edukuar në vend, në Medresenë Isa Beu”! “Mysliman” po i thotë vetes edhe Shaqir Fetai, por, le të na thotë se sa xhami po i rrëshqasin nga dora, që kur u bë “mysliman i devotshëm”! Xhamitë, përtej besimit, kërkojnë sakrificë, vendoshmëri, luftë, gjak, kërkojnë identitet të fuqishëm fetar, identitet që nuk luhetet nga asnjë stuhi, identitet që nuk frikësohet nga asnjë fuqi, nga asnjë perandori e pushtet, identitet që Shtëpinë e Zotit e mbronë me tërë qenien e vet! Shaqir Fetai bën mirë që mos t’i ofendojë teologët e vendit, mos ta përdorë Medresenë “Isa Beu” si trampolinë për

të ofenduar, sepse, pjesa dërmuese e këtyre 1200 imamëve kanë akademizuar njohuritë e tyre mbi islamin nëpër fakultete islame në qendra të ndryshme të botës turko-arabe dhe, për këtë akademizim kanë sakrifikuar shumëçka. Nuk kanë qenë si Shaqir Fetai që shpenzimet vjetore gjatë “akademizimit” të vet t’i ketë të mbuluar nga UDB-ja!

## 2.

“Kontribut i shkëlqyer human” ky i Salim Sulejmanit, i cili nuk po i munguaka asnjëherë ndaj myslimanëve të Strugës! Në orët e hershme të mëngjesit paska shpërndarë mbi 200 pako ndihma me produkte ushqimore-higjienike!

Edhe vitin e kaluar, Salim Sulejmani i ndau nja 200 pako, pra, humaniteti i tij vjen në shprehje një herë në vit! Por, bani vaki dhe nuk dërguan turqët ndihma humanitare, Salim Sulejmani e harron fjalën “humanitet”! Në orët e hershme të mëngjesit! Në orët e hershme të mëngjesit besimtarët e devotshëm falin sabahun, kurse cubat, hajnat, i hynë aksionit të vjedhjes aty ku ka “beregjet” me bollëk! Të varfërit flejnë, sepse, në orët e hershme të mëngjesit i zë gjumi, ngase, tërë natën e kalojnë duke menduar se, si t’ia bëjnë të nesërme, ku të sigurojnë ndonjë kore buke!

Pastaj, pason deklarata e “kaposhit” për mjetet e informimit! Informata thotë: “Në praninë e medimeve dhe mjeteve për informim publik, Myftiu Mr. Salim ef. Sulejmani fillimisht falënderoi Kryetarin e Bashkësisë Fetare Islame, Reisul Ulema

H. Hfz. Shaqir ef. Fetain, për këtë sasi të dedikuar xhematit të Strugës, Kryetarin e OH Hilal Fadil ef. Ramadanin si dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Vakfit të Republikës së Turqisë.”

Adi kush në Maqedoninë e Veriut, në Ballkan, në Evropë e në Botë, pse për këto 200 pako falënderohet Shaqir Fetai! Cili është kontributi i tij kur dihet që, në ato pako, si dhe në 4800 të tjerat (prej 5000) sa kanë ardhur nga Turqia, nuk përfshihet asnjë cent i Shaqir Ftait, asnjë çamçakëz, asnjë gram dhimbje, asnjë gram trishtim, asnjë gram lumturim që i dha Zoti për të qenë ndihmëtarë, asnjë gram pikëllim, sepse, po ku i ha b... Shaqir Fetait për fukaratë?

A ka njeri në botë që mund të na tregojë se pse Salim Sulejmani i shpreh falënderime Fadil Ramadanit, njeriut i cili, nëse ndonjëherë i ka pasur dy lekë në duar, ato i ka shpenzuar për bastore, ashtu siç i harxhon edhe vet Salim Sulejmani? Edhe në pozitën e myftiut edhe të vizitosh bastoret, kjo u shkon ndoresh vetëm stafit të Shaqir Fetait! Shaqir Fetai ka problem me interpretimin e humanizmit ashtu siç ka problem edhe me interpretimin e islamit, sepse, natyrisht që shërbimet intelektuale të bëjnë dehumanist e antifetar! Edhe në rastin e humanitetit Shaqir Fetai dëshmon se është tradhëtar i pakompromis! Ai duhet të këmbëngulë që, gjatë servisimit të ndihmave humanitare në pako, rol ky teknik i një “shërbimi humanitar”, duhet të falënderohet gjithnjë donatori dhe të ngritet lartë vetëm emri i donatorit, dhe jo edhe i turlifarë emrave të denjë për dëbim nga çdo rreth.

Informata paçavër përfundon me: “Misioni i myslimanëve duhet të jetë mishërim i humanizmit të vërtetë dhe reflektim i ndjenjave të thella njerëzore”! E cila na qenka ajo “ndjenjë e thellë njerëzore” e Shaqir Fetait dhe e Salim Sulejmanit? I njohin tashmë të gjithë shqiptarët e botës! Të gjithë e dinë se “ndjenjat njerëzore” të këtij të dytit janë të thyer në raportet e tij me familjen, kurse, “ndjenjat njerëzore” të të parit janë të thyer në raportin e tij me besimin shoqëror. I pari ka dëmtuar familjen, i dyti ka dëmtuar tërë shoqërinë! Këta të prishur vetëm humanistë nuk mund të jenë!

Poshtë kësaj informate, të publikuar në fb-un e BFI-së së Shaqir Fetait, jo rastësisht qëndron si lapidar komenti i këtij myslimani: “Valdrin Dauti ÇFAR MESONI NE XHAMI E ÇFAR BENI JASHT XHAMIVE ju nuk dini çfar është TURPI,nuk dini te TURPEROHENI, fjala IMAM është e shejnte, se me prishni fjalorin ne ket dit ramazani por jeni vetem HIPOKRITA qe POSHTERONI njerezit e varfer ALLAHU ju denoft InshaAllah.”

### 3.

Pasi u keqpërdor fitri e zeqati, pasi u nëpërkëmb djersa e myslimanëve tetovarë, pasi u pagua një qejf e një dëshirë megalomane, e turpshme dhe e rrezikshme për kohën, ja që Qani Nesimi, myftiu i diskutueshëm i Tetovës, na del edhe “filantropist”!

Mbi të gjitha, secili njeri normal që do ta lexojë informatën që vie nga “kabineti” i këtij “filantroposti” dhe që kërkohet të botohet si i tillë, në tërësi, sakaq do të kuptojë se bëhet fjalë për një kategori njerëzish shumë të pashpirt, shumë hipokritë, shumë demagogë! Shpenzojnë mijëra euro për një iftar, para këto të grumbulluara nga fitri e zeqati, kurse shpërndajnë ndihma të vjedhura 400 pako, në tubimin dhe përgatitjen e të cilave nuk kanë shpenzuar as më të voglën kokërr të djersës! Gjë e vjedhur pra! E vjedhur, sepse, shpërndahet si kontribut personal, e jo si donacion i tjetrit, të cilit i ke premtuar se do t’ia shpërndashë ndihmën te ata që do t’i bënte më të lumtur në prag të Muajit të Ramazanit.

Pra, këto ndihma prej 5000 pakove me artikuj ushqimor e higjienik, të ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfit të Turqisë, janë nga ai kontingjent ndihmesh që ky Institucion fetar turk, çdo vjet i shpërndan në prag të Muajit të Agjërimit, anekënd botës myslimane! Dhe, këto ndihma duhet të shpërndahen për Ramazan, ndërsa, për shkak të opusit të dallaverave të mëdha të BFI-së së Shaqir Fetait, dhe bandës së tij, ndihmat jepen dhe vazhdojnë të jepen, diku kah përfundimi i Ramazanit! Prandaj, këta të Myftinisë së Tetovës, me plotë demagogji thonë: “Humanizmi është një vlerë që duhet demonstruar kudo dhe kurdo”! Jo, por, duhet të shprehet (jo të demonstrohet, o dudukë) vetëm aty ku ka nevojë dhe, kurdo po por, ja që ka momente që e kërojnë ndihmën tani, në moment, sepse pastaj bëhet vonë dhe nuk ka kuptim! Nëse vdes pacienti për shkak të mosndërhyrjes me operacion i cili është shumë i kushtueshëm, donacioni i tubuar pastaj do të jetë i pakuptimtë! Nëse vdes fëmija nga uria, kot që ia nis pas një jave një manune me pako me ndihmë! Ai iku, shkoi!

I keni dëgjuar si thonë? Do të shpërndajmë ndihma që sofrat e myslimantit të mos jetë e varfër gjatë Muajit të agjërimit! Pakot përmbajnë artikuj të paraparë, sipas donatorit, të mjaftueshëm prej natës së parë të iftarit dhe syfyrit e deri në fund të muajit të agjërimit, për çdo të varfër! Kjo është filozofia e humanitetit në prag të Muajit të Mëshirës!

Ndërsa, këta të BFI-së së Shaqir Fetait, meqë janë të nxënë duke i vizituar bastoret, pakot e Ramazanit i shpërndajnë në ditën e 20, madje edhe në ditët e fundit të Ramazanit! Po këta të varfër, çka kanë ngrënë për këto 20 ditë? Apo kjo nuk është me rëndësi, me rëndësi është “humaniteti” i myftinive “kudo dhe kurdo”! Hajde, manipulim i ndyrë, hajde! Totalisht angazhime dehumaniste dhe në shkelje të parimeve të mirëfillta islame, madje nga një institucion që vetes i thotë “islam” të udhëhequr nga një “reis” i instaluar nga pushteti, i cili, për respekt qoftë ky edhe formal, nuk denjoi që të shtrojë një iftar, të paktën, për “rijasetin”, e dëgjueshëm, lojalist dhe aq servil! Phu!

*(1Kliklart, 7.05.2021)*

## Shaqir Fetait i pengon “energji negative” që buron ekskluzivisht nga parimet islame

**Shaqir Fetai, në një dëfturë përmes fb-ut të vet, kishte thënë: Në jetë kam has në njerëz me energji negative. Më janë dhimbsur sepse i vetmi aktivitet i tyre ka qenë dhe është përhapja e saj, edhe ate me mjetet më të prishta. Nuk kam ndejt indiferent ndaj kësaj gjendje dhe gjithmonë i kam këshilluar se Islami është shpresë, i gjallë, inspirues dhe hapja e rrugëve drejtë ardhmërisë”**

### Nga Benjamin Salihi

Shumë keq, tepër keq kur e ke fatin të takoshë njerëz të tillë me energji negative. Do me thënë se, nuk të shqepen, vazhdimist të dalin përpara, sepse, diçka nuk është në rregull me ty! I miri, kurrë nuk takon njerëz me energji negative, kurrë nuk përplaset me ta, kurrë nuk ka nevojë t’ju rrijë indiferent, e as të merret me ta.

Po pse t’i dhimbsen Shaqir Fetait njerëzit me energji negative?! Kjo energji është problemi i tyre! Pse bëhet problem edhe për Shaqir Fetain! Dale pak!

Kë e kualifikin Shaqir Fetai “njeri me energji negative”? Atë që ia prish ideologjinë komunise! Atë që i flet për periudhën kur ka qenë spiun i UDB-së! Atë që e kritikon se si, i citur e i përkrahur nga shërbimet sekrete, do t’ia ngulë thikën pas shpine njeriut që një jetë të tërë e ka mbajtur në shpinë! Kush është “me energji negative” për Shaqir Fetain: ai që e kritikon se pse e shkel dhe e ka bërë leckë Kushtetutën e BFI-së! Pse ka vepruar, vepron dhe do të veprojë në kundërshtim me parimet kuranore dhe me ato që dalin nga Hadithi i Pejgamberit a.s.!? A është tradhëti të veproshë pas shpine të atij që të ka mburrur dhe që i ka varur shpresat në ty për një jetë të tërë? Tani, te kush është kjo energji negative: te Shaqir Fetai apo te ai që ia përkujton këtë ngjarje që nuk është asgjë tjetër përveçse puç klasik i ndihmuar nga pushteti aktual maqedonas!

Kush është me energji negative – ai që ia ngulë thikën pas shpine mikut të ngushtë apo ai që nuk e honeps dhe e lufton tërë jetën tradhëtarin?

Të gjithë bashkëpunëtorët e vet i ka me energji tepër negative, i ka të djallëzuar! Le të na tregojë Shaqir Fetai se si i udhëzon me islam këta negativca! Cili ishte gjesti pozitiv i tyre në rastin e përkrahjes së Shaqir Fetait në realizimin e tradhatësisë së madhe!

A është njeri me energji negative ai i cili thotë se nuk e dua Shaqir Fetain në krye të BFI-së sepse, si element i UDB-së së dikurshme, u nxit dhe u përkrah në uzurpimin e BFI-së nga pushteti aktual maqedonas!

Çka ka energji negative në tërë angazhimin e njerëzve për ta shpëtuar BFI-në nga bërëzimi dhe udbashëzimi i këtij Institucioni! Çka ka energji negative në angazhimin e njerëzve për t’ia zbuluar të gjitha rrenat Shaqir Fetait; çka ka energji negative në angazhimin e njerëzve për t’ia shpalosur të gjitha përpjekjet për të vjedhur fitra e zeqat, për ta zhvatur e falur vakëfin, për ta shpenzuar vakëfin për rroga të majme, ndonëse dihet qëndrimi islam në raport me vakëfin dhe vakëflënësin, siç dihet edhe për vakëfngrenësin e vakëfshitësin!

Të gjitha këto angazhime për ta luftuar të keqen, për ta luftuar mynafikllëkun, për ta luftuar hipokrizinë, për ta luftuar hajninë, spiunimin, përgojimin, bashkëpunimin me të djallëzuarit, cilësi këto absolutisht të Shaqir Fetait, udhëzohen nga porositë kuranore si dhe nga porositë e Pejgamberit

a.s., burime këto që nuk i lënë vend së keqes në mesin e myslimanëve.

Tani, sipas Shaqir Fetait, këto burime janë “plotë me energji negative”, a! Sepse, një ushtri e tërë intelektualësh që po e luftojnë Shaqir Fetain bazuar në porositë e shenjta, nuk mund të jenë “njerëz me energji negative”!

Fjalën e Zotit nuk mund ta durojnë vetëm djalli dhe të djallëzuarit.

Shaqir Fetai është mirë që të tërhiqet dhe mos të bëjë edhe më tej qufër, sepse, nuk do të ndalen brez pas brezi, sikur edhe një mië vite t’ia falë Zoti, nuk do të ndalin së kritikuari mënyrën se si e kreu puçin përmes tradhëtisë dhe bashkëpunimet me elementet destruktivë e antiislamiste!

Parimet islame, mbi të cilat zhvillohet lakuriqësimi i Shaqir Fetait, nuk mund të jenë “mjete të pista”, siç u thotë ky farë sharlatani! Por, as mjetet e informimit, sepse, ato vetëm po e përkrahin një luftë që bazohet në mjete që nuk janë asgjë tjetër përveçse burime islame!

Publikimi i cilësive të këqia të një pisi, publikimi i karakterit të një matrapazi, publikimi i shkathtësive tradhëtuese të një hipokriti, pa dyshim që është obligim islam, është porosi e shenjtë, është veprimtari që kurrë nuk guxon të heshtet, pavarësisht që për Shaqir Fetain tërë kjo mud të paraqesë “energji neative”!

E cila është “energji pozitive” për Shaqir Fetain? Pranimi i tij për “reis” përkundër të gjitha sifateve të një puro-hipokriti? Shkuarja në kabinet dhe shprehja e urimeve dhe përsëndetjeve për puçin klasik që e realizoi përmes pushtetit aktual maqedonas? Pranimi bashkëpunimit me të, ndonëse të gjitha veprimet i ka në përputhje me ata që janë të djallëzuar e që nuk e durojnë jetën normative e të koduar sipas burimeve islame, Kuranit dhe Hadithit! Heshtja para të gjitha deklarimeve të tij të cilat ia citon në vesh shejtani i mallkuar! Përkulja para hipokrizisë së tij!

Këtë “energji pozitive” asnjëherë nuk do ta takojë Shaqir Fetai! Do ta takojë, në çdo ditë të Zotit, vetëm atë “energji negative” që ia kallë datën duke ia nxjerrur zbuluar të gjitha shejtanllëqet dhe të bëmat e tij prej hipokriti!

Parimet islame janë mjete përmes të cilave do të luftohet çdo përpjekje devijuese e Shaqir Fetait, i pëlqeu kjo atij apo jo! Ai duhet ta dijë se, puçi klasik, instalacioni i pushteteve antiislame e antishqiptare si dhe tradhëtia e miqësisë, nuk mund të shpërblehen me lule aromëmira e me energji pozitive! Ai e ka të përcaktuar nga Zoti që, që nga tradhëtia e madhe, të ecë me saxhin prush mbi kokë! Kjo po që është “energji negative”, e destinuar për sojin e Shaqir Fetait!

*(Kombetare, 8.05.2021)*

## Çka i bëri Qenan Ismaili Muftinisë së Shkupit

Shaqir Fetai, në një diçiturë përmes fb-ut të vet, kishte thënë: Në jetë kam has në njerëz me energji negative. Më janë dhimbsur sepse i vetmi aktivitet i tyre ka qenë dhe është përhapja e saj, edhe ate me mjetet më të prishta. Nuk kam ndejt indiferent ndaj kësaj gjendje dhe gjithmonë i kam këshilluar se Islami është shpresë, i gjallë, inspirues dhe hapja e rrugëve drejtë ardhmërisë”

### Shkruan Benjamin Salihi

Shumë keq, tepër keq kur e ke fatin të takoshë njerëz të tillë me energji negative. Do me thënë se, nuk të shqepen, vazhdimist të dalin përpara, sepse, diçka nuk është në rregull me ty! I miri, kurrë nuk takon njerëz me energji negative, kurrë nuk përplaset me ta, kurrë nuk ka nevojë t’ju rrijë indiferent, e as të merret me ta.

Po pse t’i dhimbsen Shaqir Fetait njerëzit me energji negative?! Kjo energji është problemi i tyre! Pse bëhet problem edhe për Shaqir Fetain! Dale pak!

Kë e kualifikin Shaqir Fetai “njeri me energji negative”? Atë që ia prish ideologjinë komunise! Atë që i flet për periudhën kur ka qenë spiun i UDB-së! Atë që e kritikon se si, i citur e i përkrahur nga shërbimet sekrete, do t’ia ngulë thikën pas shpine njeriut që një jetë të tërë e ka mbajtur në shpinë! Kush është “me energji negative” për Shaqir Fetain: ai që e kritikon se pse e shkel dhe e ka bërë leckë Kushtetutën e BFI-së! Pse ka vepruar, vepron dhe do të veprojë në kundërshtim me parimet kuranore dhe me ato që dalin nga Hadithi i Pejgamberit a.s.!? A është tradhëti të veproshë pas shpine të atij që të ka mburrur dhe që i ka varur shpresat në ty për një jetë të tërë? Tani, te kush është kjo energji negative: te Shaqir Fetai apo te ai që ia përkujton këtë ngjarje që nuk është asgjë tjetër përveçse puç klasik i ndihmuar nga pushteti aktual maqedonas!

Kush është me energji negative – ai që ia ngulë thikën pas shpine mikut të ngushtë apo ai që nuk e honeps dhe e lufton tërë jetën tradhëtarin?

Të gjithë bashkëpunëtorët e vet i ka me energji tepër negative, i ka të djallëzuar! Le të na tregojë Shaqir Fetai se si i udhëzon me islam këta negativca! Cili ishte gjesti pozitiv i tyre në rastin e përkrahjes së Shaqir Fetait në realizimin e tradhatësisë së madhe!

A është njeri me energji negative ai i cili thotë se nuk e dua Shaqir Fetain në krye të BFI-së sepse, si element i UDB-së së dikurshme, u nxit dhe u përkrah në uzurpimin e BFI-së nga pushteti aktual maqedonas!

Çka ka energji negative në tërë angazhimin e njerëzve për ta shpëtuar BFI-në nga bēdēizimi dhe udbashēzimi i kētij Institucioni! Çka ka energji negative në angazhimin e njerēzve për t’ia zbuluar të gjitha rrenat Shaqir Fetait; çka ka energji negative në angazhimin e njerēzve për t’ia shpalosur të gjitha pērpjekjet për të vjedhur fitra e zeqat, për ta zhvatur e falur vakēfin, për ta shpenzuar vakēfin për rroga të majme, ndonēse dihet qēndrimi islam në raport me vakēfin dhe vakēflēnēsīn, siç dihet edhe për vakēfngrenēsīn e vakēfshitēsīn!



Të gjitha këto angazhime për ta luftuar të keqen, për ta luftuar mynafikllëkun, për ta luftuar hipokrizinë, për ta luftuar hajninë, spiunimin, përgojimin, bashkëpunimin me të djallëzuarit, cilësi këto absolutisht të Shaqir Fetait, udhëzohen nga porositë kuranore si dhe nga porositë e Pejgamberit a.s., burime këto që nuk i lënë vend së keqes në mesin e myslimanëve.

Tani, sipas Shaqir Fetait, këto burime janë “plotë me energji negative”, a! Sepse, një ushtri e tërë intelektualësh që po e luftojnë Shaqir Fetain bazuar në porositë e shenjta, nuk mund të jenë “njerëz me energji negative”!

Fjalën e Zotit nuk mund ta durojnë vetëm djalli dhe të djallëzuarit.

Shaqir Fetai është mirë që të tërhiqet dhe mos të bëjë edhe më tej qufër, sepse, nuk do të ndalen brez pas brezi, sikur edhe një mië vite t’ia falë Zoti, nuk do të ndalin së kritikuari mënyrën se si e kreu puçin përmes tradhëtisë dhe bashkëpunimet me elementet destruktive e antiislamiste!

Parimet islame, mbi të cilat zhvillohet lakuriqësimi i Shaqir Fetait, nuk mund të jenë “mjete të pista”, siç u thotë ky farë sharlatani! Por, as mjetet e informimit, sepse, ato vetëm po e përkrahin një luftë që bazohet në mjete që nuk janë asgjë tjetër përveçse burime islame!

Publikimi i cilësive të këqia të një pisi, publikimi i karakterit të një matrapazi, publikimi i shkathtësive tradhëtuese të një hipokriti, pa dyshim që është obligim islam, është porosi e shenjtë, është veprimtari që kurrë nuk guxon të heshtet, pavarësisht që për Shaqir Fetain tërë kjo mud të paraqesë “energji neative”!

E cila është “energji pozitive” për Shaqir Fetain? Pranimi i tij për “reis” përkundër të gjitha sifateve të një puro-hipokriti? Shkuarja në kabinet dhe shprehja e urimeve dhe përsëndetjeve për puçin klasik që e realizoi përmes pushtetit aktual maqedonas? Pranimi bashkëpunimit me të, ndonëse të gjitha veprimet i ka në përputhje me ata që janë të djallëzuar e që nuk e durojnë jetën normative e të koduar sipas burimeve islame, Kuranit dhe Hadithit! Heshtja para të gjitha deklarimeve të tij të cilat ia citon në vesh shejtani i mallkuar! Përkulja para hipokrizisë së tij!

Këtë “energji pozitive” asnjëherë nuk do ta takojë Shaqir Fetai! Do ta takojë, në çdo ditë të Zotit, vetëm atë “energji negative” që ia kallë datën duke ia nxjerrur zbuluar të gjitha shejtanllëqet dhe të bëmat e tij prej hipokriti!

Parimet islame janë mjete përmes të cilave do të luftohet çdo përpjekje devijuese e Shaqir Fetait, i pëlqeu kjo atij apo jo! Ai duhet ta dijë se, puçi klasik, instalacioni i pushteteve antiislame e antishqiptare si dhe tradhëtia e miqësisë, nuk mund të shpërblehen me lule aromëmira e me energji pozitive! Ai e ka të përcaktuar nga Zoti që, që nga tradhëtia e madhe, të ecë me saxhin prush mbi kokë! Kjo po që është “energji negative”, e destinuar për sojin e Shaqir Fetait!

*(Lajme7, 8.05.2021)*

## Maskat hipokrite të Shaqir Fetait

**Kohë më parë, në Manastir, një xhami, u shndërrua në kishë, Jeni Xhamia u pagëzua në Sveti Gjorgjia**

### *Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI*

Të gjitha mediat e vendit alarmuan mbi këtë vjedhje të xhamisë. Vetëm Shaqir Fetai dhe BFI-ja e tij nuk e thanë asnjë fjalë, as për hajër e as për sherr! Nuk ia mbajti Shaqir Fetait të ragojë, sepse institucionet shtetërore, këto të pushtetit që e instaluan në krye të BFI-së, kishin vendosur që ta shndërrojnë në institucion nacional maqedonas, në MUZE! Por ama, në muze prej Kishës, sepse, kështu Kisha tregohet shpirtgjerë me poullatën e vet. Fillimisht, ia dëshmon guximin se çka të dëshirojë atë e bën me “xhamitë e Shaqir Fetait” dhe, pastaj, ia fal popullit të vet për muze.

Këto ditë Shaqir Fetai u turr ta vjedhë një kontribut të qytetarëve të Mateçit, të cilët, kishin vendosur që për nevojat e veta fetare të ndërtojnë një xhami të re. Ky projekt, natyrisht që do të ngritet me vetëkontribut të qytetarëve të Mateçit, të cilët, ja që prej bujarisë së tyre, kishin vendosur që gurin e parë themeltar ta hedhë “reisi i BFI-së”, institucioni, pra, jo Shaqir Fetai. Ndërsa ky zgjedhi të krekoset si gjeldet sa që, në çastin e aminit, i bëri për të qeshur gjysmëmn e xhamtit të pranishëm, sepse, aq shumë u zgjërue e u shtri sa, dëshironte të thoshte se, ja, vetëm nën emrin tim dhe të pushtetit tim ju mund të ndërtoni xhami!

Me këtë rast Shaqir Fetai, veç të tjerash, kishte thënë: “Vetëm Ata që kanë imam të paluhatur në Allahun Fuqplotë, ndërtojnë dhe meremetojnë xhamitë”!

Po ata që i falin xhamitë dhe i lejojnë që të shndërrohen në kishë? Po ata që pa kurrfarë reagimi lejojnë që xhamitë të kalojnë në muze? Cili është imani i tyre? Në kë besojnë ata që me aq lehtësi heqin dorë nga xhamitë, si puna e Shaqir Fetait?

Shaqir Fetai është “faktor i hershëm” me relevancë të BFI, madje është “faktor” që kur u përvetësuan sahatkullat në Manastir e në Prilep mbi të cilat edhe sot e kësaj dite qëndrojnë kryqet dymetërshe! Shaqir Fetai është “faktor” i BFI-së edhe kur u pengua ndërtimi i Xhamisë në Llazhec, edhe kur Kisha e uzurpoi Xhaminë në Shtip duke e shndërruar në Sveti Ilija, edhe kur u dogj Xhamia në Prilep. A ia ka dëgjuar ndonjë mysliman i vendit, qoftë fjalën më të vogël që e ka ngritur kundër po këtij pushteti që i ndrmori të gjitha ato veprime antiislame!

Është shumë lehtë t’i ndërtoshë xhamitë me paratë e huaja, por, është tepër e rëndë t’i ruash ato që i merr amanet, për të cilat është derdhur djersë e gjak!

Shaqir Fetai le ta hedhë gurin themeltar dhe le t’i përgëzojë qytetarët, inicuesit dhe donatorët, hiq pa e nxjerrur asnjë fjalë nga goja, sepse, sa her që flet, e heq nga një maskë të hipokrizisë së vet.

*(Opinione, 9.05.2021)*

## “Humanizmi” i Shaqir Fetait nën llupë

Tre ditë pasi filloi Ramazani i sivjemë, më 15 prill të vitit 2021, Shaqir Fetai, mbajti një konferencë për shtyp ku foli se si, ditët në vijim (në vendëse këtë aktivitet ta kryenin të paktën një javë më parë), për çdo ditë do të jenë në terren duke shpërndarë ndihma në pako që kanë arritur donacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfit të Turqisë. Çdo vit vinin nga 5000 pako, sivjet erdhën vetëm 4000! Sipas raporteve të kryehajnit të BFI-së, manipulorit më perfekt me ndihmat humanitare, Mustafa Dautit, pakot e viteve të kaluara mbanin vlerën e 70 eurove, sivjet, sipas Shaqir Fetait, mbajnë vlerën e rreth 20 eurove, në peshë prej 20 kg (mbi 150 mij euro në ndihma me artikuj ushqimor e higjienik)

### *Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së*

Në një intervistë televizive, në pjesën kur do të flasë për aktivitete humanitare, Shaqir Fetai do të theksojë se si do t'i shpërndajnë 80 ton ndihma të ardhura nga Turqia! Veç kësaj, sipas Shaqir Fetait, do të shpërndajnë edhe një kontingjent tjetër ndihmash, kah mesi i muajit Ramazan, në peshë prej 80 tonësh, si dhe do të shpërndajnë mish!!!

Në një prej komunikatave të fundit për sa i përket aksioneve humanitare të OH Hilal, që funksionon nën patronatin e Shaqir Fetait, veç tjerash, thuhet: “OH Hilal gjatë tërë këtij muaji të Ramazanit, çdo ditë ka pasë aksione në të gjitha qytetet e fshatrat e vendit tonë, duke bërë përpjekjen më të madhe në historinë e Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë së Veriut për të qenë në sofrat e të gjithë njerëzve e familjeve që kanë nevojë.”

Po këta, banda e Shaqir Fetait, jo që vjedhin e manipulojnë, por edhe gënjejnë rreptë, ngjashëm si patroni i tyre! Nuk mundet edhe të përcjellësh bastoret dhe kazinot, edhe të merresh me humanitet! Nuk mundet! Kjo dëshmohet edhe me aktivitetet e kryera gjatë Muajit të Mëshirës! Këto aktivitete përkojnë me këto data dhe aktivitete:

- 16, prill, 2021, – Kumanovë
- 18, prill, 2021, – Shkup
- 20, prill, 2021, – Kratovë
- 22, prill, 2021, – Gostivar
- 26, prill, 2021, – Prilep
- 26, prill, 2021, – Manastir
- 28, prill, 2021, – “Komunalecit”
- 30, prill, 2021, – Kerçovë
- 3, maj, 2021, – Resnjë
- 4, maj, 2021, – Veles
- 4, maj, 2021, – Shtip

4, maj, 2021, – Ohër  
6, maj, 2021, – Strugë  
7, maj, 2021, – Dibër

Shoqata e invalidëve të punës 20 pako

10, maj, 2021, – në Shkup “Sofra e Bajramit”, 300 pako mish!

Pra, në aktivitet kanë qenë vetëm 12 ditë të Muajit të Mëshirës dhe, hiç këtu 300 pakot e mishit, që janë nga mishi i kurbanit të vjemë apo të parvjemë, nga 4000 pakot e Turqisë i ndanë gjithësej 3.402 pako! Pra, nuk u shpërndanë fare rreth 600 pako! Kaq sofra ngelën të varfëra përgjatë Muajit të Ramazanit. Gjashtëqind familje nuk e shijuan ndihmën e dedikuar për ata! Gjashtëqind sofra ngelën të varfëra për shkak të shpirtprishunisë së bandës së Shaqir Fetait, i cili mundohet t’i mbulojë duke thënë se “gjatë tërë muajit kanë qenë në çdo qytet dhe në çdo fshat të Maqedonisë së Veriut!” Gjithësesi, kemi informacione që flasin se, prej atyre 3400 pakove të shpërndara, rreth 700 janë vjedhur, kanë përfunduar në familjarët e shpërndarësve, kanë përfunduar në ato shtëpi që sipas dëshirës së “hartuesve të listave”, janë përfshirë si “shtëpi të varfëra” edhe familjarët e tyre! Do me thënë që, diçka mbi 2000 familje të varfëra sivjet kanë arritur ta gëzojnë pakon e ndihmës turke, të tjerat, i ka “hëngër kuta”! Sipas evidencave nga shoqatat humanitare të karakterit mysliman, vetëm në Shkup jetojnë në varfëri ekstreme mbi 4000 familje të varfëra. Kurse Shaqir Fetai garanton se “Gjatë muajit të Agjërimit do të zbresi në çdo sofër të myslimanëve të varfër anekënd vendit”!

Sikur të ndaheshin të gjitha pakot e donuara nga Turqia, në mesin e myslimanëve të Maqedonisë së Veriut do të kishte nja 4000 familje myslimane, që do t’ia mendonin edhe sofrës së Ditës së Bajramit dhe, pa dyshim që do të ndanin diçka nga ndihmat për ta kaluar disi edhe këtë ditë! Shaqir Fetai, i provokuar nga publikimet që ia nxorën sheshit premtimet e kota, u detyrua që të shpërndajë edhe nja 300 pako me mish, pako këto që mbulojnë vetëm 300 familje, pra, jo 4000 sa do të duhej të përfshiheshin nga ndihmat turke. Kush e pa këtë mish? Kush i pa këto pako? Ku u shpërndanë, si u shpërndanë këto pako, sepse megjithatë është “ndihmë autoktone”! A pati ndonjë komision, kush e solli vendimin e prekjës së mishit të maganizuar të kurbanit e që maganizohet nëpër frigoriferë të mëdha për nevojat e medresantëve! Apo, tërë kjo hajni u bë sa për ta “realizuar” atë që rastësisht i rrëshqiti nga goja e pakontrolluar Shaqir Fetait!

Vetë raportimet e “organeve” të Shaqir Fetait mbi shpërndarjen e dihmave humanitare prej 4000 pakove të donuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfit të Turqisë, flasin për këtë shpërndarje të këtyre ndihmave:

18, prill, 2021, – Shkup 600 pako  
20, prill, 2021 -Kratove 500 pako  
22, prill, 2021, – Gostivar 400 pako  
16, prill, 2021, – Kumanovë 250 pako  
7, maj, 2021, – Dibër 160 pako  
30, prill, 2021, – Kerçovë 200 pako  
6, maj, 2021, – Strugë 200 pako  
3, maj, 2021, – Resnjë 100 pako  
4, maj, 2021, – Veles 170 pako  
4, maj, 2021, – Shtip 200 pako  
4, maj, 2021, – Ohër 128 pako  
26, prill, 2021, – Prilep 200 pako

26, prill, 2021, – Manastir 160 pako

20, prill, 2021, – Kratovë 50 pako

28, prill, 2021, – “Komunalecit” 64 pako Shoqata e invalidëve të punës 20 pako

Pra, sipas këtij raporti mbi shpërndarjen e pakove në terren, shihet se, prej 4000 pakove të donacionit turk, gjithësej janë shpërndarë 3.402 pako! Ndoshta kanë menduar që të ekonomizojnë me këto pako humanitare, të ndajnë diçka, të lënë anash me qëllim që të shpërndajnë për raste ekstreme të varfërisë! Megjithatë, këto ndihma ishin të dedikuara ekskluzivisht për “Sofrën e Ramazanit”! Për raste të varfërisë ekstreme, le t’ia mendojë OH Hilal si dhe Shaqir Fetait, le të zhvillojnë aksione, sepse, popullata jonë është e dëshmuar si një ndër popujt më human në fytyrë të tokës! Le të zbresin në popullatë dhe le të bashkëpunojnë me popullatën, e cila, gjithësesi që kurrë nuk do të pranojë të bëhet palë me hajnat në “humanitet”!

Banda e Shaqir Fetait, jo që kurrë nuk do të bëjë hajër në humanitet por, do ta nëpërkëmbin edhe humanitetin e të devotshmëve, do ta vjedhin e do ta “fshehin” me qëllim që sa më pak të kenë angazhime në ndihmë humanitare. Sepse, për këtë soj humanistësh, ndihma humanitare llogaritet “hangari hesapi”! Ose, mundësi për të vjedhur e dërguar në shtëpi pako “pa adresë”!

Përmes rrenave në humanitet t’i mund të “përfitoshë” simpatinë e nja 2000-3000 të varfërve, por e humb përkrahjen e myslimanëve të tjerë, e humb dashurinë e Allahut xh.sh.

Çka fitoi Shaqir Fetait me rrenën kur e tha në mes të intervistës televizive se, nga mesi i muajit Ramazan do të shpërndajmë edhe 80 ton ndihma si dhe mish! Ai jo që nuk i shpërndau plus 80 ton por, edhe nga ai 80 ton që e pati donacion nga Turqia, 12 ton ndihma “nuk e di” se ku iu tretën, plus këtu edhe nja 700 pako apo 14 ton që i vodhën “aktivistët” e tij!

A i ka parë dikush prej Myslimanëve të Maqedonisë se si erdhën ato ndihma prej 4000 pakove prej Turqisë! Duhej të ishte një maune e madhe, dhe jo ndonjë kokërr guri që mund të fshihej në xhep! Askush nuk e pa, ë! Po ama, nuk ngeli mysliman i Maqedonisë së Veriut pa i parë bandën e Shaqir Fetait se si e (keq)shpërndajnë ndihmën që e patën amanet! Allahu xh. sh. në ajetin 271 të Sures El Ebekare thotë: “T’i jepni lëmoshat haptazi, është gjë e mirë, por t’ua jepni ato të varfërve fshehurazi, është edhe më mirë dhe ju shlyen disa nga gjynahet tuaja. Allahu e njeh mirë çdo vepër që ju bëni.”

Pra, aksionin e nisën tre ditë pasi filloi Muaji i Agjërimit, kurse e përfunduan tre ditë para se të përfundojë ky Muaj, duke e përcjellë me aksion tjetër “Sofra e Bajramit”, të cilën e rrumbullaksuan me treqind pako me mish për të gjithë të varfërit dhe nevojtarët e vendit! Këta jo që nuk bëjnë humanitet por këta edhe tallen me të varfërit! Madje, nuk përtojnë që të tallen edhe natën e Bajramit! Publikojnë edhe një informatë qesharake dhe, për më tepër tmerrësisht cinike: Aksioni “Sofra e Bajramit” në Maqedoninë Perëndimore”! A e di banda e Shaqir Fetait se cilat vise përfshihen në këtë “Maqedoni Perëndimore”? Sa hapësirë gjeografike përfshihet nën këtë nocion gjeografi? Sa familje të varfëra jetojnë në këtë pjesë të Maqedonisë? Ose i bie që, Komuniteti Shqiptar Islam në Austri – ALKIG, të jetë përfshirë në hajninë e madhe të BFI-së së Shaqir Fetait dhe në manipulimet me ndihmat humanitare. Sepse, me 50 pako ushqimore sa u shpërndanë në këtë “aksion humanitar”, nuk mund të thuash se ke zhvilluar aksion humanitar në tërë Maqedoninë Perëndimore! Për të qenë ironia edhe më e pistë dhe më e pashpirtë, banda e Shaqir Fetait nuk ia përton që këtë “informatë” ta përmbyllë me “u bë përpjekja më e madhe në historinë e Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë së Veriut për të qenë në sofrat e të gjithë njerëzve e familjeve që kanë nevojë.” A e dinë këta banditë se kur fillon historia e Bashkësisë Fetare Islame? A e dinë këta banditë se në “vitin e Shaqir Fetait” u bë manipulimi dhe keqpërdorimi më drastik i ndihmave humanitare, u bë nëpërkëmbja dhe fyerja më e rëndë e çdo pakoje të ndihmave humanitare, sepse u ndanë në emër të bixhosxiut më të pashpirtë! Familjet e varfëra myslimane në Maqedoninë e Veriut u ndanë në “favoritë” dhe “jofavoritë” të BFI-

së, në stilin e militantizmit partiak! A do me thënë ky “fakt historik” se, për sa vite që ka qenë myfti dhe anëtarë i Rijasetit Shaqir Fetai, nuk ka bërë kurrfarë aktiviteti humanitar? Po, nuk ka bërë, sepse ka qenë në shërbim të vjedhjeve dhe manipulieve me ndihmat humanitare nga ish-kryetari i OH Hilal, Mustafa Dautit, të cilin tani e ka “ministër të jashtëm e të brendshëm të kabinetit qeveritar” të Shaqir Fetait!

Këta nuk kërkojnë shlyerje të mëkateve, sepse, vuajnë për lavdërim e për vetlavdërim! Kjo nuk është “energji negative” që e rrethon Shaqir Fetain, por, një analizë e punës së Shaqir Fetait e vënë nën llupën e Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së nga të gjitha shkeljet juridike dhe parimore që bëhen në BFI-në e kapur nga Shaqir Fetai me bandën e vet!

Le ta sjellim këtu edhe ajetin 177 të Sures El Bekare, që thotë: **“Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirim të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zeqatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun.”**

Në cilën fjalë të shenjtë të këtij ajeti kuranor mund ta gjejë veten Shaqir Fetai dhe banda e tij “humanitare”? Pa dyshim, në asnjë! Prandaj Shaqir Fetai dhe banda e tij refuzohen me neveri prej pjesës dërmuese të myslimanëve të vendit! Këtë në çdo moment e ndjenë edhe Shaqir Fetai, por, tipat e komunitetit të shpezëve të llojit “orao”, janë të operuar nga ndjenja e refuzimit, sepse misioni i tyre është mos të thyhen nga refuzimi gjithëpopullor por të vjelin informacione nga shtresat popullore!

*(SotInfo, 15.05.2021)*

## Pafytyrësia e demagogut

**Shaqir Fetai, sot, për të dëshmuar se është gjallë, në fb-un e vet boton diçka të papërfillshme, refleksion i një debilli, diçka që askujt nuk i hy as në xhep e as në tru! Mundohet ta përcjellë Muajin e Ramazanit me diçka që i ka hije vetëm demagogut të pafytyrë**

### Shkruan Burim Muniri

Në të kaluarën, pushtuesit e viseve shqiptare instalnin bashkëpunëtorë të tyre pothuajse në çdo katund e vendbanim. Banorët sakaq i zbërthenin dhe i izolonin. Askush nuk merrej me spiunin, me bashkëpunëtorin e armikut. As nuk e vrisnin, as nuk e eliminonin, por as nuk e takonin, e linin të vdesë në vetmi, të izoluar, të pakontaktuar! Kjo, pastaj, e vriste së brendshmi spiunin, bashkëkatundarin, bashëvendasin, bashkëpunëtorin e armikut dhe, sa për të treguar se është gjallë, se është këndeji pari, dilte në oborr dhe ia jepte ndonjë të krisur nga qifteja, mamzerja, apo alltia. Kot, vetëm sa për të treguar se është gjallë! Dhe, edhe më tej vazhdonte injorimi i tij, por ama, pa te nuk guxonte të bëhej asnjë dasëm, asnjë varrim, asnjë për hajër, asnjë zgjdhje e ngatërresave eventuale. Gjithkund duhej të ishte i instaluari i pushtetit, aty, në çdo atmosferë! Si Shaqir Fetai, sot!

Shaqir Fetai, sot, për të dëshmuar se është gjallë, në fb-un e vet boton diçka të papërfillshme, refleksion i një debilli, diçka që askujt nuk i hy as në xhep e as në tru! Mundohet ta përcjellë Muajin e Ramazanit me diçka që i ka hije vetëm demagogut të pafytyrë! Shaqir Fetain sikur e paska marrur malli për Ramazanin i cili te Shaqir Fetai paska ardhur “si mysafir i madh”! Si çdo mysafi që vjen, ai edhe shkon, duke lënë ndonjë kujtim të mirë! Po a guxon një mysliman i devotshëm të mendojë se Muaji Ramazan është “mysafir”, është si një subjekt që vjen e shon, ose, që mund të vie një herë dhe të ikë përgjithmonë, sepse, jo të gjithë mysafirët vinë e shkojnë! Myslimani i devotshëm insiston, lutet, kërkon, këmbëngul ekstremisht që, Ramazan ta ketë tërë jetën. Natyrisht, Zoti begatitë (përfshirë këtu ushqimin dhe ujin) i ka lënë që të jetojnë krijesat e tij, ta shijojnë në çdo moment, si ujin ashtu edhe bukën, të kënaqen, të ushqehen, të marrin energji, me përjashtim të një periudhe të caktuar gjatë Muajit të Agjërimit. Porse, për gjërat e tjera, për shtim të ibadeteve, për ndalim të veprave të papëlqyera, për ikje dhe shmangie nga e keqja, për respekt, dashuri e humanitet, myslimani i devotshëm do të kishte dëshirë që krejt jetën e vet ta kishte Ramazan. Jo ta ndjente Muajin Ramazan si mysafir që vjen e shkon, por, thjesht, ta kishte si strehë të veten prej nga nuk do të dilte kurrë, strehë kjo e formatit të pallateve të mrekullueshme. Shaqir Fetai, i obsesionuar në përfshirjen e tij të domosdoshme në strukturat e pushtetit aktual, flet manjaku sikur të ishte ndonjë alimet alim! Thotë: “Megjithë situatën e jashtzakonshme nga Covid 19 të mobilizuar me të gjitha potencialet fizike, shpirtërore e intelektuale u formua një ambient i këndshëm, i qetë, i bukur, i frytshëm, vëllazëror...”

Cili është potenciali fizik i Shaqir Fetait? Ai i madhështisë së fizikut të shërbimeve intelektuale që e instaluan në krye të BFI-së? Apo kapaciteti fizik i Ciklopit. Po ai kapaciteti shpirtëror i tij, cili ishte? Me çfarë kapaciteti shpirtëror e përjetoi uzurpimin e Jeni Xhamisë dhe shndërrimin e saj në kishë, në Sveti Gjorgjia-Muze! Po uzurpimin e Xhamisë Al Aksa, në Natën e Kadrit, me çfarë kapaciteti shpirtëror e priti! Nuk u dobësua dhe nuk u ligështua pak ky kapacitet shpirtëror nga fakti që u dëmtuan të varfërit dhe të ngratit duke ua vjedhur ndihmat humanitare dedikuar atyre! Po për çfarë kapaciteti intelektual flet Shaqir Fetai kur, dihet fare mirë se ai falë angazhimit të shërbimeve sekrete arriti të bëhet “reis” e jo falë ndonjë kapaciteti të tij intelektual që po na krijua atmosfera vëllazërore, të qetë e të hareshme! Shaqir Fetai është shëmtia, e keqja më e rëndë që i ka ndodhur popullatës sonë myslimane në Maqedoninë e Veriut. Kjo tek do të kuptohet e ndjehet më vonë. Këtë edhe vetë ai e di, e ka të qartë, e kupton, por, e ka shumë të vështirë për ta pranuar, sepse, fundja, cili udbash ka pranuar bashkëpunimin e vet me shërbimet sekrete serbo-sllave! Shaqir Fetai këtë paraqitje të tij idiotike e përmbyllë edhe me një idiotësi edhe më të madhe! U shpreh mirënjohje të gjithë atyreve që janë angazhuar për këtë Ramazan. Do me thën, me këtë gjest të tij prej abdalli, ai mund t’i japë vetes kurajo që të shpreh mirënjohje edhe ndaj të gjithë atyreve që kanë agjëruar, që e kanë kryer këtë obligim të shenjtë. Sikur kjo punë të ishte si rezultat i kërkesës së Shaqir Fetait dhe, organet e BFI-së si dhe të gjithë myslimanët e vendit kanë vendosur ta respektojnë kërkesën e Shaqir Fetait dhe të agjërojnë, ndërsa ky u shpreh mirënjohje! Tamam si ata me orientim seksual ndryshe! Ky i pafytyrë, ky farë demagogu bajloz, mendon se BFI-ja është njëfarë “tyrbe” në të cilën është varri i shenjtë i një baba shehu, i cili duhet të vizitohet dhe të përshëndetet prej të gjithëve. Dhe ky duhet të jetë i vetmi aktivitet i besimtarëve, i cili shënohet dhe pranohet prej “babës sheh”: të vijnë, t’ia përshëndesin dhe t’ia përgëzojnë varrin! Kurse, qatibët të shkruajnë ditar: sot ishte ky e ai, dje filani, pardje fishmeni... të gjithë e përshëndeten varrin e babës sheh duke e lënë nga një dhuratë te koka e varrit, ndonjë album me fotografi, ndonjë pikturë, ndonjë stilolaps, aleta të dashit, sepse, pa lënë diçka vizita nuk llogaritet e plotë! Zatën, tyrbet e kanë këtë “funksion”, të vizitohen për ilaç! Sa keq për atë që vdiq! Askush nuk e shtroi një iftar për “rahmetliun”, askush nuk ia shprehu më të voglin respekt menjë iftar, madje nuk u respektua për së vdekuri as prej atyreve që e instaluan si të parë, dhe e lanë si relike të gjallë të tyre! Sepse, as ata nuk deshtën të merren me një njeri që e ka të vdekur shpirtëroren, intelektualen, e që, vetëm sa vegjeton fizikisht kot e kot! Me rëndësi ia kanë uruar Fitër Bajramin! Zyrtarët e lartë të shtetit ia uruan Fitër Bajramin Reisul Ulemasë! Rrenë e madhe! Zyrtarët e lartë shtetërorë, duke e adresuar te “reisi” ua urojnë Fitër Bajramin gjithë myslimanëve të vendit. Myslimanët e vendit janë faktor të rëndësishëm. Shaqir Fetai mund të jetë vetëm alet dhe asgjë më tepër, siç ka qenë tërë jetës “alet i shërbimeve intelektuale”, por edhe prodhim dhe “krah i djathtë” i H. Sulejman ef. Rexhepit!

*(1Kliklartë, 19.05.2021)*



## **“Minjtë” që më tradhëtuan me detyrë për ta shkatërruar BFI-në**

*Ekskluzive: Intervistë me H. Sulejman ef. Rexhepin, ish-Reisul Ulema i BFI-së*

Më 27 maj të vitit 2020, një numër i anëtarëve të Rijasetit të Bashkësisë Fetare Islame, të tubuar diku në Gostivar, para pothuajse të gjitha mediave të vendit, deklamuan: “Bazuar në procesverbalin e mbledhjes së jashtëzakonshme të shumicës së anëtarëve të Rijasetit të BFI-së të mbajtur më 27.05.2020, ne të nënshkruarit më poshtë në bazë të Nenit 36 dhe 58 të Kushtetutës së BFI-së, që e përbëjnë më shumë se 2/3 e anëtarëve të Rijasetit të BFI-së, vendosëm njëzëri shkarkimin e Sulejman Rexhepit nga posti Reisul Ulemasë, kryetar i BFI-së. Deri në përgatitjen e kushteve për zgjedhje të reja, për ushtrues detyre kryetar i BFI-së është caktuar myftiu i Gostivarit, Shaqir Fetahu”! Redaksia jonë, në prag të njëvjektorit, ka kërkuar nga H. Sulejman ef. Rexhepi, që të mësojë më shumë rreth arsyeve dhe rrethanave që çuan deri te ky gjest tradhëtues e komplotist.

**Këto ditë bëhet një vit nga, siç thoni ju, komploti i bashkpunëtorëve të juaj që e ushtruan mbi ju! U tubuan fshehurazi, madje brenda natës dhe, ju shpallën të rrezikshëm sepse ju keni shkelur Nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së! Vetëm ky është mëkati? Bashkëpunëtori i ngushtë, miku i mirë, këshillon, sugjeron, korrigjon, apo, dorëhiqet nga bashkëpunimi i mëtejme dhe, kurrë nuk tradhëton, nuk e shkelë bukën që ta ha, nuk bëhet palë me armikun tënd! Ç’ndodhi në të vërtetë. Kaluan një vit dhe thua se asgjë nuk u sqarua?**

Tani, nga distanca dhe, kur keni kohë të lirë, kur jeni më të relaksuar, më pak i ngarkuar dhe me aspak përgjegjësira që i takojnë prijësit fetar, keni kohë të reflektoni dhe, të përpiqeni që në ato reflektime të jeni sa më objektiv! Po i analizoj dhe po i zbërthej një nga një “bashkëpunëtorët” e mi të dikurshëm, lojërat e tyre në raport me mua, po i lidhi gjërat, po i sjellë në kujtesë ngjarjet, veprimet, përpëlitet “intelektuale” të tyre, po ua analizoj prejardhjen, shoqërinë, aspiratat, synimet, intrigat, gatishmërinë e tyre për të mëkatuar, mëkatimin e tyre me dëshirën më të madhe, lutjet e tyre për t’i nxjerrë nga situatat e palakmueshme, premtimet e tyre, përbetimet e tyre, kërkesat, insistimet, lajkat dhe servilosjet e tyre për të arritur deri te lidhja me strukturat e ndryshme policore, manipulimet e tyre në emër të islamit dhe, të gjitha këto veprime të turpshme para syve të mi – sakaq, dal unë i dobët, dal unë që duhet të kritikohem, dal unë i mashtruar, i pavëmendshmi! Isha mbështetur në bashkëpunëtorë të kotë, me karakter të dobët, kisha pasur përkrah turpërimin tim, njerëzit që më kishin përdorur si vello për ta veshur tradhëtinë e tyre, bashkpunimin e tyre me shërbimet intelegjente, planin e tyre për ta rrënuar të vetmin Institucion islam që mbi 600 vite u kishte bërë ballë pushtuesve e perandorëve të ndryshëm.

**Dëshironi të thoni se, me largimin tuaj mori fund edhe ky Institucion, Bashkësia Fetare Islame?**

Jo, ky Institucion gjithnjë ka qenë, është dhe do të jetë nën Mëshirën e të Madhit Zot! Nuk varet as nga

shkathtësitë dhe aftësitë e të parit si dhe të nëpunësve të saj, as nga prirja për menaxhim të shkëlqyeshëm, as nga planet dhe strategjitë e shërbimeve të ndryshme antiislame për ta rënuar përdhe këtë Institucion. Myslimanët e vendit janë dëshmitarë të gjallë për faktin që, asnjë subjekt, asnjë faktor, asnjë institucion nuk pësoi aq shumë goditje, aq shumë përpjekje për destabilizim dhe rrënim, aq shumë projekte dështuese për të depërtuar në këtë Institucion struktura të padëshirueshme dhe të rrezikshme, pra, nuk ka asnjë Institucion në vend që u sulmua më shumë se Bashkësia Fetare Islame! Tre dekada post-komuniste i rezistua me sukses, i demaskua të gjitha përpjekjet e ulëta, i demaskua dhe i zbrapsëm të gjitha strukturat që insistonin të vënin kontroll dhe dirigjim në Institucionin tonë! Goditjet ishin të njëpasnjëshme! BFI-ja u bë objekt studimi edhe nga faktorët e ndryshëm ndërkombëtarë! Samë shumë që na sulmonin aq më të fortë dilnim, aq më unikë dhe aq më të përkrahur nga faktori ndërkombëtar! Duhet ta pranojmë një fakt: shqetësuese është se, këto lojëra të strukturave të dyshimta antiislame gjithnjë u luajtën nga “myslimanët” e vendit dhe asnjëherë bartës të këtyre projekteve nuk dolën jo-myslimanët! Tani, çfarë ndodhi! Tridhjetë vite isha lavdëruar me bashkëpunëtorët e mi, me lojalitetin e tyre, isha mburrur me papërkulshmërinë e tyre, me besnikërinë dhe sinqeritetin e tyre dhe, në fund, pikërisht prej tyre m’u ngul thika pas shpine! Sepse, paskam qenë i keqi, sepse, paskam qenë i mëkatshmi, sakaq, paskam shkelur Nenin 58 të Kushtutës së BFI-së... Po bashkëpunëtorët e mi të cilët, një javë më parë më kishin thurrur aq shumë elozhe në deklarata televizive sa nuk e dija se për kë po flasim, për mua apo për ndonjë figurë historike kombëtare e fetare? Po bashkëpunëtorët e mi të cilët, brenda natës i përgjigjen strukturave të caktuara policore për t’u tubuar dhe për të vepruar ashtu siç do të kërkojë përfaqësuesi i këtyre strukturave, Shaqir Fetai? Ky që më kishte shërbyer gati tre dekada rresht! Tani, të gjithë të dalin të mirë në sy të popullatës dhe vetëm unë të shpallej i keqi, madje prej atyreve që më kanë shërbyer “me besnikëri” dhe, në fund, ta gëzojnë përkrahjen e popullit? Unë kam vizita, kam takime, kam bisedime të përditshme me miq e myslimanë që nuk i njoh por që shprehin interesim për mua dhe, të gjithë më shohin si viktimë të një strategjie të dalur nga strukturat e DBK-së! Ndërsa ish-bashkëpunëtorët e mi, që të gjithë vlerësohen si bashkëpunëtorë të DBK-së, e cila, me një isharet të vogël arrinë që t’i mbledh në Gostivar, këta anëtarët e “Rijasetit”! Këta, që masovikisht dhe tmerrësisht urrehen nga popullata, nuk mund ta shpëtojnë BFI-në, porse, po e fundosin ditë e më shumë, sepse, popullata ka shkëputur kontaktin me ta dhe, kjo shkëputje interpretohet me refuzimin për t’ua mirëmbajtur burimet financiare! Bartësit e një aksioni puçist e komplotist, asnjëherë nuk janë duartrokitur dhe nuk janë pritur me lule. Ata përfundojnë aksionin dhe, me marrjen fund të misionit të tyre, “zhduken”! Dëshmitarët e misionëve të rrezikshme për imazhin e shtetit nuk janë të dashurit e strukturave sekrete. Spostohen diku, marginalizohen tërësisht, duke pasur probleme me zemrën, me tensionin, veshkat... Fundi, gjithësesi që, do të jetë tragjik!

### **Thatë se keni kontakte të shumta me...**

Po po! Madje kontaktohem e më vizitojnë edhe ata që u manipuluan dhe morën pjesë në atë komplot që ma bënë! Më vjen vështirë ku i shoh se si përlohen e se si mundohen të sigurojnë një falje timen për gabimin e tyre të pafalshëm që e bënë! Më rrëfejnë fije për pe se si ndodhi, kush i thirri, si i thirri, kush i organizoi, si u morën vesh etj.! Të gjithë kanë qenë të shantazhuar! U janë kërcënuar me “bomba”, me video, me dëshmitarë, kanë qenë të kërcënuar që, nëse nuk dëshirojnë të turpërohen publikisht, atëherë duhet të pranojnë që të më turpërojnë mua publikisht! A ka gjë më të ulët se sa largimi im të justifikohet me faktin që unë paskam shkelur Nenin 58! Dëbohet një mysli man nga një Intitucion apo komunitet nëse e mohon Zotin, nëse publikisht e mohon Kuranin, nëse publikisht gënjen për Pejgamberin a.s., nëse publikisht rreshtohet në anën e “ushtrisë”

antiislame! Por, që të dëbohet se paska shkelur këtë nen, ky është budallallëk i të humburve! Ky nen përmbanë pika që nuk mund të shkelen brenda një dite, brenda një nate, por që duhet kohë, vite e vite! Asnjëherë nuk kam pasur vërejtje nga bashkëpunëtorët e mi, asnjëherë nuk kam pasur isharete dhe as sugjerime për t'u korrigjuar në veprime. Përkundrazi, kam qenë i lavdëruar, i duartrokatur, më kanë puthur në ballë e me loçkë të zemrës i janë lutur Zotit që të më japë shëndet e t'ju prijë sa më gjatë! Tani, po të njëjtit, mblidhen brenda natës dhe "më shkarkojnë"! Shantazhi i strukturave intelektuale policore nuk e ka fuqinë e nënshtimit sa e ka forcën pesha e fjalës së të parit fetar që i merr nën mbrojtje! Me mua, të gjithë ishin faqebardhë, ndërsa tani, fatkeqësisht, të gjithë janë shpërfytyruar në faqezinjë, në bashkëpunëtorë të policisë maqedonase, si të tillë, në antiislamistë e antimyslimanë. Prandaj, çfarëdo të flasin ata, çfarëdo të veprojnë, çfarëdo të premtojnë, janë fare të papërfillshëm nga popullata myslimane, ishin bashkëpunëtorë të mi e të nderuar dhe, sakaq, kaluan në bashkëpunëtorë të strukturave sekrete të sigurisë të cilat garojnë mes vete se cila do të pozicionohet sa më thellë në BFI.

**Keni akuzuar edhe partitë në pushtet, se kanë gisht në shkarkimin tuaj! Si e justifikoni këtë akuzë!**

Unë isha mik i ngushtë i shumë personaliteteve të klerarkisë më të lartë të BDI-së. Në dobi të vendit tonë, kam kontribuar me miq e shokë që kanë pasur respekt në mua! Ndërsa kurrë nuk e mora asnjë përqind të përkrahjes që e pata nga Partia për Prosperitet Demokratik e cila sot nuk ekziston! Kurrë nuk u refuzuam në kërkesat tona nga kjo Parti! Kurrë kjo Parti nuk hezitoi në realizimin e kërkesave tona dhe të premtimeve të saj si subjekt politik, ndonëse kurrë nuk na e pa hajrin si Institucion siç na e pa hajrin BDI-ja. Tronditjet e BFI-së, ato më të rëndat, i përjetuam pikërisht sa ishte BDI-ja në pushtet me LSDM-në, pastaj me VMRO-në dhe përsëri me LSDM, ndërsa përkrahjen tonë e pati gjithnjë të parezervë. Goditja e fundit, ajo që më tronditi në shpirt e mendje, ishte pikërisht ardhja e "miqve" të mi nga kryesia e kësaj Partie, të cilët m'i përcollën të falurat e liderit të tyre që, mos të bëja problem, por të rrija urtë sepse zgjedhjet po afroheshin dhe, brenda javës, do të zgjidhej ky problem ndërsa puçistët do ta pësonin shumë keq! Biles, më porositën që të ofroj dorëheqje!

**Dorëheqja e juaj pasoi pasi këtë ua kërkoi BDI-ja dhe jo Rijaseti?**

BDI-ja ka juristë! Dinë ta lexojnë dhe ta interpretojnë edhe Kushtetutën e BFI-së! Pa dyshim që e kanë ditur se edhe unë jam njohës i mirë i problematikave nga lëmi i jurisprudencës! Pas kërkesës nga ana e BDI-së për ta deponuar dorëheqjen time, u gjenda para një dileme të madhe: të ngelem në krye të BFI-së e t'ua nxij jetën bashkëpunëtorëve të mi, apo, të tërhiqem dhe të vetënxihen bashkëpunëtorët e mi. Me më pak kosto shpirtërore më doli kjo e dyta! Kushtetuta e BFI-së për seli të Institucionit e njeh Shkupin dhe jo Gostivarin? Kushtetuta e BFI-së nuk e obligon Reisul Ulemanë që t'i pranojë ad-hoc vendimet e organeve të BFI-së, mund t'i refuzoj dhe fare mos t'i dekretoj! Kushtetuta e BFI-së parasheh shkarkim të gjithsecilit që rrebelohet apo që vepron në kundërshtim me aktet normative të BFI-së. Thjesht, unë do të mund t'i shkarkoja që të gjithë ata "myftinjë" që e inicuan shkarkimin tim të paligjshëm, porse, do ta vuaja shumë pastaj këtë gjë! Nuk do ta kisha lehtë që ta përpija faktin që kohë të gjatë për bashkëpunëtorë paskam pasur bashkëpunëtorët e shërbimeve që kurrë nuk ia kanë dashur të mirën BFI-së. Do të më kishte

humbur një dozë e madhe e sinqeritetit tim, sepse, kam qenë shumë i sinqertë, dashamirës dhe jam mburrur para myslimanëve të vendit me bashkëpunëtorët e mi, të cilët i kam lavdëruar me fjalë nga më të mëdhatë. Kur i pari të lavdëron me fjalë të mëdha, do me thënë se të inkurajon, të jep zemër, të jep shtytje për suksese edhe më të mëdha, por kur, i vogli, i papërfillshmi, e lavdëron të madhin, në këtë gjest mund të ketë lajka, servilizëm, ka shpresa për manipulim për të arritur synime të pameritueshme. Unë edhe i kam lavdëruar edhe u kam dhënë, sepse, kam dëshiruar që bashkëpunëtorët e mi të jenë burra të fjalës e të suksesit, ndërsa këta më dolën të gjithë minjë të gjirizit. Do ta kisha shumë të rëndë që tani, t'i largoj këta “minj” dhe të gjej bashkëpunëtorë të rinjë të cilët ndonëse do ta meritonin, megjithatë, nuk do të mund t'i lavdëroja para popullatës siç i lavdërova të parët! Nëse vazhdoja, do të më duhej që bashkëpunëtorët e mi, të lavdëruar deri dje, të nis e t'i demistifikoj, madje edhe duke i paditur nëpër gjyqe, sepse, shumica prej tyre e dinë fare mirë se, nga një kontroll të përciptë e rutinor, i zura që kishin bërë dëme të mëdha financiare nëpër organet që i drejtonin, kishin vjedhur, keqpërdorur e shpërdoruar detyrën dhe postin!

### **Pse mendoni se në largimin tuaj nga BFI-ja ka gisht pushteti?**

Sepse, ata ma kërkuan dorëheqjen dhe më thanë që mos të reagoj se do ta zgjidhin problemin vetë ata, fill pas zgjedhjeve parlamentare! Pastaj e instaluan njeriun e tyre, Shaqir Fetain, duke qenë të bindur se ai është personi i duhur që duhet të manipulohet në dëm të interesave të BFI-së! Në ç'moment mund ta kujtojë populli një të mirë të BDI-së që ia bëri BFI-së?! Partia për Prosperitet Demokratik ka ndihmuar shumë, kurrë nuk e ka kushtëzuar ndihmën politike që ia ka kryer BFI-së! Ajo strukturë e ndihmuan BFI-në pa kurrfarë hile! Në kohën e BDI-së, u bënë disa sulme kundër BFI-së, u zbuluan disa njerëz që punonin kundër interesit të BFI-së. Së fundmi kemi pasur marrëvshje konkrete me Zaevin dhe Ali Ahmetin, madje edhe i kemi tokur duart se, do të burgosen të gjithë ata që janë përpjekur ta dëmtojnë BFI-në, si individë të manipuluar ashtu edhe përfaqësues të institucioneve shtetërore. Në vend se të bëhet kjo, më larguan mua! Tani më thonë se paskam qenë rrezik shumë i madh për shtetin dhe për pushtetin, se paskam folur shumë. Ç'është e vërteta, unë u kam folur bashkëpunëtorëve të mi për ta ndihmuar BDI-në, duke i ndriçuar të gjitha rastet e montuara politike! U kam folur edhe njerëzve të Partisë, u kam thënë se, rigjykimet do të përfundojnë në të mirë të të dëmtuarve, ndryshe, do ta ngris tërë popullin në këmbë! Nuk do të lejoj që në këtë shtet pushtetarë të paraqiten vetëm maqedonasit. Kam shprehur reagimet dhe shqetësimet e mia shumë serioze për vendimin e maqedonasëve për t'ju dhënë shtetësi shqiptarëve, kujt të duan ata! Do me thënë se, popullata maqedonase kujt do i jep shtetësi e kujt të dojë edhe ia merr dhe, marrja e shtetësisë do të thotë e drejtë për dëbim! Zyrtarizimi i gjuhës shqipe, institucionalizimi i të drejtave shqiptare, shtetësia, me automatizëm u ka takuar të gjithë shqiptarëve të cilët pavarësimi i shtetit i ka gjetur në këtë shtet. Ne, përmes projektit STOP RaTerr, kemi dëshmuar se nuk jemi për radikalizëm, nuk e ushtrojmë radikalizmin e aq më pak terrorizmin por, këto dukuri nuk do t'i durojmë as mbi kurrizin tonë, nuk do t'i tolerojmë, qofshin këto të ushtruara edhe nga institucionet shtetërore! Do të reagojmë ashpër! Prej Kumanovës e deri në Strugë, prej Velesi, Shtipi e deri në Resnje, të gjithë do t'i ngrisja në këmbë! Do ta radikalizoj situatën deri në vetëdijësimin e të gjithë palëve se në Maqedoninë e Veriut të gjithë do të duhet të jenë të barabartë, ndaj të gjithëve drejtësia duhet të jetë e njëjtë dhe se, këtu nuk guxon të ketë qytetarë të rendit të parë apo të rendit të dytë, tretë, katërt...

### **Ju thoni që ju larguan si destabilizues potencial i shtetit?**

Nuk na duhet një shtet që shndërrohet në laboratorim për ta testuar kombin shqiptar, për të eksperimentuar me shqiptarët, për t'ua dozuar të drejtat dhe liritë! Është naive të pretendohet inkudrimi i Maqedonisë së Veriut në BE dhe pastaj të zgjidhen çështjet e hapura me shqiptarët autoktonë! Populli maqedonas dhe ai shqiptar në këtë shtet do të duhet të merren vesh, të kapen dorë për dore dhe, si dy faktorë stabiliteti ta fusin vendin në BE dhe, jo të jenë njëri në pozita të nikoqirit e tjetri të vasalit!

**Sikur nuk keni qenë kaq “radikalistë” sa ishit në krye të BFI-së! Linit përshtypje se ju ishit në një vijë me vasalët!**

Kurrë nuk më ka interesuar politika, nuk më kanë interesuar as partitë. Kam bashkëpunuar me ta vetëm deri sa kam arritur realizimin e ndonjë interesi të BFI-së. Fare në fund, po, nuk mund ta mohoj, kam qenë shumë thellë i kyçur në politikë, sepse, ishte momenti, kërkohej edhe kontributi im, kërkohej angazhimi im, si faktor relevant në vend. Kontributi im kërkohej edhe nga faktorë të brendshëm, por edhe nga faktorë të jashtëm, miqtë tanë ndërkombëtarë. Ndihmën nuk ua kam ofruar blanko! Ua kam kushtëzuar, kam pasur edhe kërkesat e mia në emër të BFI-së: qëndrimi i strukturave të caktuara shtetërore sa më larg BFI-së, të drejtat dhe liritë e pjesëtarëve të islamit në vend, mosdiskriminimi fetar që na bëhej vazhdimisht, heqja dorë nga synimet ortodokse për ta ortodoksuar realitetin multifetar të vendit, nxjerrja para drejtësisë të të gjithë atyreve që me përkrahje dhe mbështetje të institucioneve të caktuara shtetërore ia mësynë destabilizimit të BFI-së etj. Natyrisht, të gjitha këto tratativa për marrëveshje serioze janë bërë në katër sy, janë bërë në mes faktorësh dhe udhëheqësish me relevancë dhe, nuk kemi pranuar që të dalim në opinion dhe ta elektrizojmë masën, të flasim me patos e me doza të nacionalizmit. Prandaj nuk kam qenë “i zëshëm”, prandaj kam qenë në koordinim me partinë shqiptare, duke menduar se do të jemi në të njëjtën valë. Por, ja që dikush paska menduar se do të përfitoj personalisht unë dhe të tjerët do të ngelin nën hijen time, prandaj dhe ma luajtën lojën!

**Kush ju ka frikësuar deri në atë pikë sa mos të guxoni të dilni në opinion dhe t'i zbardhni ju arsyet e kësaj loje që ua luajtën? Pse keni heshtur përgjatë tërë vitit! Çka ju frikëson që të flisni!**

Mua të më frikësojë diçka? Nuk ka bërë vaki që në një moment të jem i frikësuar përgjatë tërë karrierës sim si hoxhë, si teolog! Pse kam heshtur? Ku të flas? Në cilën media? Ju e shihni që emri im, shkrimet e mia, reagimet e mia nuk i keni në asnjë portal, në asnjë media elektronike apo të shkruar! Ose janë shitur, ose janë të shtrënguar nga pushteti! Me përjashtim të një debati në TV21M, të një interviste në Lajm TV dhe të një opinionit në Tetova Sot, nuk kemi pasur asnjë debat, nuk është kërkuar asnjëherë mendimi im, kurse ndonëse është kërkuar mendim i Shaqir Fetait, ai asnjëherë nuk ka folur për këto probleme, sepse, nuk di se çka të flasë, sepse ka vepruar ashtu siç i kanë thënë, ashtu siç ia kanë ofruar skenarin! Ndërsa flasin e debatojnë pseudo-teologë, hoxhallarë pa diploma, të përjashtuar nga Medreseja jonë, me diploma të blera e false të siguruara nëpër shtete të ndryshme arabe, të dala nga programet speciale siç mund të përgatiten për të huaj, me njohuri të përcipta bazike! Këta tipa promovohen si vlera, si kontribues fetar e kombëtar. Këta tipa imponohen si reformatorë, ndonëse të gjithë janë me çertifikatë të shërbimeve intelegjente të huaja! Nuk guxojnë

ta mohojnë këtë, as të më fshihen, sepse, ata e dinë që unë i njoh shumë mirë, i kam sprovuar, i kam testuar, i kam detyruar të më rrëfehen, kështu që, kjo më shqetëson, më ofendon, më ulë dinjitetin, pjesëmarrja e mediave tona në promovimin e pseudo-teologëve në “vlera kombëtare e fetare”! Vlerat dalin në shesh vetëm në ballafaqim, në debate, në kryqëzime të pikëpamjeve e të fakteve, e jo sipas strategjive të shërbimeve nëntokësore.

## **Cilin gabim të juajin e llogarisni si më fatal sa ishit Reisul Ulema i BFI-së. Cili veprim i pakryer ju ka ngelur si peng?**

Po! Ka muaj që reflektoj mbi Medresenë që e kemi shndërruar në barrë të papërballueshme për myslimanët e vendit! Megalomania jonë, mosracionaleti ynë, politikat e gabuara kadrovike, na kanë shndërruar në lypsarë por edhe në ngarkues të buxhetit gjithnjë të varfër të popullatës sonë! Medreseja është shkollë profesionale që nxjerr kuadro për nevoja të BFI-së, hoxhallarë për nevoja të xhemateve dhe xhamive tona! Kështu obligon Kushtetuta e BFI-së dhe Ligji mbi pozitën e bashkësive fetare në vend. Zgjerimi ynë ka bërë që t’ia rëndojmë buxhetin myslimanëve, sepse, burimi ynë financiar janë ata! Kemi prodhuar mbi 3-4000 hoxhallarë! Kujt i duhen të gjithë këta? Për më tepër, na ka ndodhur një katastrofë e tmerrshme, si ndëshkim nga Zoti, për politikat tona të gabuara kadrovike! Kemi shkolluar e ushqyer medresantë me paratë e popullit dhe, në fund, një numër i tyre na kanë përfunduar në DBK, në polici, në ushtri, në administratë, në diplomaci! Me paratë e popullatës sonë kemi nxjerrë kuadro për nevojat e shtetit! Edhe të eksploatuar edhe të pafalënderuar! Ne kemi prodhuar hiperkuadër dhe, na kanë ngelur rrugëve! Çka pritet prej tyre? Ata duhet të mbijetojnë, të krijojnë familje, ndërsa ne nuk jemi në gjendje që t’ju dalim në ndihmë. Ata ose do të radikalizohen, ose do të bëhen misionarë, ose mercenarë, ose do të përfundojnë bashkëpunëtorë të shërbimeve të huaja. Kjo më dhemb! Shikuar nga perspektiva e të një “pensionuari” që ka kohë të mendojë e të analizojë, ky është gabimi ynë më i madh. Ne kërkojmë fitra e zeqat për t’i sponsoruar problemet që do të na kushtojnë shumë shtrenjtë! Tani kemi kuadër të mjaftueshëm teologësh! Duhet të krijohet një strategji e hollë, bazuar mbi analizat e sakta, duke u shtrirë në çdo xhemat, e në çdo vendbanim tonin, për t’i detektuar nevojat për kuadër. Në bazë të kësaj pastaj të caktojmë numër nxënësisht që do t’i nxjerrim kuadro për nevojat e BFI-së! Ky hap do të duhej të ishte reforma e parë, urgjente dhe e domosdoshme që e pret BFI-në. Edhe para popullit tonë do të dilnim më të fisshëm. Nga ana tjetër, do të duhej të përforcoheshin mektebet! Të përgatitej një metodologji më e avancuar e mbajtjes së mësim-besimit islam. Madje ky aktivitet, në njëfarë forme, të ndjehet si detyrim fetar për çdo xhemat, sepse, asgjë e keqe nuk do t’i gjejë fëmijët nëse i mbajmë larg rrugës e larg celularëve duke i angazhuar në mësimin e bazës fetare islame.

## **Në fund, efendi Rexhepi, si personalitet me përvojë të gjatë në krye të BFI-së, si po ju duket reisi i ri në drejtimin e BFI-së?**

Shaqir Fetai është “kuadër imagjinar”, i “brymosur si myfti” nga lavdërimt e mia, kurse, në realitet ai nuk ka kapacitet për ta nxjerrë macen nga përsheshi! Nuk dua të flas më shumë për të, por, le të më lejohet të sjell disa konstatime të bashkfishatarëve të tij, që vinë e më vizitojnë shpesh! Shprehin keqardhje për përpjekjet e tij prej naivi, shprehin indinjatë për tërë atë që ia punoi pas shpine BFI-së, ndjehen të turpëruar për atë që ma bëri mua, ndjehen të rrëqethur nga ajo që po ia bën BFI-së dhe

persektivës së islamit në këtë nënqiell, ndjehen të zhgënjyer nga synimet karrieriste të tij përkundër faktit që e dinë se nuk shquhet për ndonjë karakter në familjen e gjërë dhe nuk shquhet për ndonjë respekt familjar! Të mos flasim për “bashkëpunëtorët” e tij të cilët ditë për ditë vijnë e më flasin për axhamillëqet, por edhe për djallëzitë e Shaqir Fetait. Bashkëpunëtorët e tij e thonë vetë se ndjehen shumë rëndë! Kryekëput përjetuan një vit zhgënjimi! Lus Zotin që sa më shpjtë të ndërgjegjësohen!

*(Tetovasot. 20.05.2021)*

## Tradhëtarët porosisin: “Mos na tradhëtoni”

**Tradhëtarët që ia ngulën thikën pas shpine Sulejman ef. Rexhepit, ata që dolën të ishin vegla të shërbimeve të ndryshme intelektuale, ankohen, madje reagojnë kundër çdo personi që e viziton apo që e kontakton Sulejman ef. Rexhepin, kundër çdo personi që miqësohet apo që pi një kafe me Sulejman Rexhepin. Habiten si është e mundur të mos vazhdojnë kritikën kundër tij por të orientohen tash kundër Shaqir Fetait**

**Shkruan Jasir Jashari**

Pas intervistës së Haxhi Sulejman ef. Rexhepit dhënë portalit shqiptar TetovaSot e në të cilën, veç të tjerash, flet edhe për ish-bashkëpunëtorët e tij që tani shkojnë tek ai dhe të përloitur rrefehen për tërë lojën që ia luajtën pas shpine, me të madhe ka filluar një shqetësim i “grave të këqia”! Pse kontaktohet Sulejman Rexhepi? Pse shkojnë njerëzit tek ai dhe “spiunojnë”? Pse nuk vazhdojnë ta kritikojnë edhe më tej por, “me pa të drejtë” e kritikojnë Shaqir Fetain, i cili, për efekt të karrierizmit hoqi dorë nga të qenurit mik i ngushtë i Sulejman Rexhepit! Shaqir Fetai, si dhe marionetat e tij, që dikur ishin bashkëpunëtorët profesionistë dhe të respektuar të Sulejman Rexhepit, kërkojnë nga myslimanët e vendit që mos të interesohen shumë e shumë për atë se, cila dorë e zezë i tuboi aq shpejtë, brenda natës, dhe ia shprehën mosbesimin Sulejman ef. Rexhepit, duke e shpallur si të shkarkuar dhe, njëkohësisht, Shaqir Fetain të ngarkuar me detyrën për t’i organizuar zgjedhjet e reja në BFI! Shaqir Fetai dhe marionetat e tij që dikur i shërbenin “me besnikëri” Sulejman Rexhepit, insistojnë që t’i bëjnë të gjithë temena Shaqir Fetait, të përkulen para tij, sepse e kanë të fortë, prapa tij qëndon pushteti dhe struktura të caktura e shumë të fuqishme që vendosin për fatin e shtetit, pra, edhe për fatin e myslimanëve të këtushëm. Do me thënë se, farsa e dikurshme se Sulejman Rexhepi ishte “i përgëdheluri i pushtetit dhe i policisë maqedonase” nuk paska qenë asgjë tjetër përveçse frikësim i kotë. Frikë duhet të kemi nga Shaqir Fetai, sepse u dëshmuua që ky paska qenë ai më i forti, ai prapa të cilit paskan qëndruar segmente të caktuara që ta rëmbejnë dheun nën këmbë! Shaqir Fetai dhe marionetat e tij që dikur jepnin shpirt për Sulejman Rexhepin, habiten, madje janë shumë të revoltuar kundër kritikëve të Shaqir Fetait. Ata nuk e kanë të qartë se pse nuk vazhdojnë edhe më tej kritikën kundër Sulejman Rexhepit por janë orientuar kundër Shaqir Fetait! Këta “kriticistë të pistë” e meritojnë një përgjigje të thjeshtë! Sulejman Rexhepi nuk po i bën asnjë të keqe Bashkësisë Fetare Islame! Sulejman Rexhepi nuk po e hap gojën për tradhëtarët, për spiunët, për hajnat, për bashkëpunëtorët e shërbimeve të huaja që ia ngulën thikën pas shpine dhe u rreshtuan pas Shaqir Fetait, pas njeriut i cili gjithnjë i ka kritikuar pas shpine te reisi i tij Sulejman ef. Rexhepi. A ka kuptim që të fajësohet sot Sulejman Rexhepi për hajnitë, tradhëtitë dhe shkatërrimet e sotshme që po i bëhen BFI-së! Apo, duke u kritikuar Sulejman ef. Rexhepin, do të lihen të qetë tradhëtarët e tij, ata që e tradhëtuan, ata që iu përgjigjën shërbimeve sekrete që brenda natës të tubohen dhe ta shpallin “persona non grata” të BFI-së! Ta vizitosh sot Sulejman Rexhepit është një lloj pendese, mbi të gjitha, një lloj solidarizimi me zhgënjimin e tij kundër miqve që dikur i pati më të besueshmit e tij, që i mbajti si pëllumba, që para myslimanëve të vendit i prezantoi si “alima të mëdhenj”, që ua besoi edhe shtratin te këmbët e tij! Ta vizitosh sot Sulejman ef. Rexhepin është shumë njerëzore pas asaj plaje që ia shkaktuan në pabesi “miqtë e tij më të ngushtë”, të cilët i trajtoi si evladë, si pjesëtarë të familjes së vet të ngushtë; të cilëve ua besoi edhe sekretet më intime.



Të pishë sot kafe me H. Sulejman ef. Rexhepin është, thjesht, demonstrim i urrejtjes kundër të gjithë atyre besëprerësve, të pabesëve, që ia ngulën thikën pas shpine reisit të tyre; është manifestim i protestës kundër keqmenaxhimit me BFI-në nga strukturat e instaluar prej segmenteve antiislame e antishqiptare të pushtetit aktual maqedonas; është protestë kundër përpjekjeve për të instaluar praktika në BFI mbi mënyrën e zgjedhjes së kryetarit nga ana e shërbimeve intelektuale të huaja. Asnjë nga myslimanët e vendit nuk mund të jenë përkrahës të Shaqir Fetait e armiq të Sulejman Rexhepit, sepse është e pandershme, nuk është dinjitoze, është tradhëti dhe solidarizim me strukturat antiislame që i qëndrojnë prapa Shaqir Fetait. Sulejman ef. Rexhepi është në hallin e tij dhe po lëngon nga thika që ia nguli miku i tij më i ngushtë, Shaqir Fetai, i cili në këtë hap u trimërua vetëm pasi e mori përkrahjen e plotë nga pushteti, i cili edhe më tej myslimanët dhe shqiptarët e vendit i trajton si “kavje” laboratorike. Natyrisht, ata që e ndihmuan Shaqir Fetain, ata edhe do ta përhapin porosinë e tij: “mos më tradhëtoni”! Për Shaqir Fetain çdo takim me Sulejman ef. Rexhepin është tradhëti e obcionit të tij që nuk është asgjë tjetër përveçse strategji e segmenteve të caktuara që vegjetojnë nëpër kanalet nëntokësore të ish-UDB-së. Secili mysliman që ia jep dorën Shaqir Fetait, le ta dijë, nuk do të mund të gjejë solucion në botë për ta larë pisllekun nga ajo dorë, ndërsa pislleku nuk i ka hije myslimanit, nuk e duron as xhamia, as namazi, as hallalli. Sulejman ef. Rexhepi tashmë është “kaptinë e mbyllur”! Libër me përbajtje horror që po lexohet tash është Shaqir Fetai! Dhe, librat janë për njerëzit e këndueshëm e jo për analfabetët.

*(Tetovasot, 22.05.2021)*

## Një vit nga kapja e BFI-së prej pushtetit politik

**Heshtja makabre para situatave kaq dramatike që po luhen brenda dhe rreth Bashkësisë Fetare Islame, flet për një neglizhencë totale të faktorëve me relevancë para një vlere shumë të rëndësishme kombëtare. Dikush e hodhi grrepin dhe u kap peshku, as nuk po tërhiqet, as nuk po lëshohet! E peshku kalbet nga koka**

### Shkruan Afrim Tahiri

Po bëhen një vit që kur Bashkësia Fetare Islame u kap nga partitë politike të pushtetit aktual! Preteksti ishte: ta dëbojmë Sulejman Rexhepin, ish-reisul ulemanë e BFI-së, kundër të cilit zhvillova një opozitarizëm të parreshtur, që nga viti 2014!

Diku, në qershor të vitit 2014, duke qenë në pozitën e Sekretarit gjeneral të BFI-së, në Rijaset deponova një dorëheqje, pasi që zbulova se si, një hajdut i BFI-së, në emrin tim personal dhe në emër të ish-reisit, po i vidhte myslimanët e ndryshëm. Dhashë dorëheqje me të gjitha arsyetimet brenda! Reisul Ulema i atëhershëm, H. Sulejman ef. Rexhepi, nuk e pranoi dorëheqjen time, ndërsa i pranoi të gjitha vërejtjet që i kisha numëruar si arsyeime në atë letër! E largoi hajnin dhe m'u lutë, me shokë të tjerë, që të rikthehem. Pranova, me kërkesë që t'i futemi një reforme të thellë në BFI, sepse, punët kishin vajtur aty ku nuk shkonte më: kishim nisur të humbim kontaktin me xhematet tona dhe se kishim nisur ta humbim besueshmërinë e tyre!

Derisa po e përpunoja strategjinë e reformave gjithëpërfshirëse, të tjerët, anëtarë Rijaseti, për ta shpëtuar veten nga prekja e reformave aq të domosdoshme, kishin vepruar te H. Sulejman ef. Rexhepi duke i premtuar lojalitet, unitet, përkrahje të rezervë, i kishin kërkuar degradimin tim. U degradova dhe, natyrisht, meqë më prekën në integritet, u tërhoqa fare nga të qenurit nëpunës i BFI-së dhe, u stopuan reformat e domosdoshme, ndërsa unë nisa opozitarizmin me miq e me shokë!

### Pse BFI-ja u duhet partive politike në pushtet

Pesë vite më vonë, dolën në sipërfaqe të gjitha vërejtjet e mia, të gjitha frikërat e mia se në BFI kishte një unitet falso, se në BFI po përgatiteshin lojëra fatale për këtë Institucion, se BFI-ja do të shpëtonte vetëm kur shteti dhe pushteti do të dilnin nga BFI-ja! Pesë vite më vonë u zbardh në opinion edhe marrëveshja interne e H. Sulejman ef. Rexhepit me bashkëpunëtorët e tij të cilët i kishin premtuar lojalitet dhe unitet në çfarëdo situatë.

Ja ku jemi! Unë me luftën time të pandalshme për ta shkapur BFI-në nga duart e pista të politikave partiake dhe, “militantët partiakë”, që si ushujza janë kapur aq shumë fort për kurrizin e BFI-së.

Në fakt, “militantët partiakë” vetëm sa po tallen me partinë shqiptare që u bë sebeb për t'i instaluar në parti, ndonëse nuk janë të përshtatshëm për instalacion por për skrap të ndryshkët! Sepse, që të gjithë, pa përjashtim, dëshmuuan se janë vegla të shërbimeve të ndryshme intelegjente të cilët kurrë nuk rreshtën së përpjekuri për ta futur në grushtin e tyre këtë Institucion. Po, pse? Çka u duhet? Paj, dikujt për t'ia shfrytëzuar asetet financiare të shumta që i ka ky Institucion, dikujt për t'ia shfrytëzuar asetet-objektet por edhe kuadrin në të mirë të “partisë mëmë”, dikujt i duhet që

ta ngacmojë dhe eventualisht ta instalojë radikalizmin dhe terrorizmin “islamik” me qëllim, jo që shqiptarët të njollosen si radikalistë e terroristë (sepse kjo nuk pi ujë) por, të kenë alibi për ta luftuar këtë dukuri eventuale dhe për t’u dëshmuar si partnerë të mirë të forcave globale të rreshtuara e grupuara kundër të ashtuquajturës “radikalizmit dhe terrorizmit islamik”, i cili, pa dyshim, në mesin e shqiptarëve kurrë nuk ka mundur të gjejë vend (me përjashtim te mercenarët)!

### **“Dora e zezë” që po gërryen themelet e BFI-së**

Dikush, një “dorë e mistershme” i mbledhi brenda nate, madje dy ditë pas faljes së përbashkët të Bajramit, i trimëroi që të dalin e ta kumtojnë shkarkimin e H. Sulejman ef. Rexhepit nga posti i Reisul Ulemasë së BFI-së! Strategët kishin qenë po ata që, fiks një javë më parë, në një dokumentar kushtuar reisit të tyre, kishin folë fjalë nga më të mëdhatë.

Më 27 maj të vitit 2020, dolën para kamerave të shumta dhe, thanë se më nuk do të prihen nga Sulejman ef. Rexhepi, sepse ky paska shkelur Nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së! Ç’paradoks! Antikushtetutarët më të përbetuar thirren në Kushtetutë?!

Natyrisht, gazetarët e shumtë, opinioni i gjërë kërkonte që të dijë më shumë se si u bë shkarkimi i H. Sulejman ef. Rexhepit, kurse, Shaqir Fetai, “më i dashmi” i Sulejman ef. Rexhepit, vazhdimisht thoshte se janë duke bërë analiza, se janë duke hulumtuar dhe, së shpejti do të dalin me arsyet e sakta për largimin e H. Sulejman ef. Rexhepit. Strategji tipike kjo e treshes Gruevski-Jankullovska-Mijallkov: burgos njerëz të pafajshëm se arsyetime do të shpikim plotë! Edhe sot e kësaj dite nuk u tha asnjë fjalë, nuk doli asnjë analizë, nuk doli asnjë fakt që do ta arsyetonte vendimin e këtyre puçistëve klasikë për ta larguar Sulejman ef. Rexhepin.

Pas kaq kohësh, askujt më nuk po i intereson se si u largua Sulejman Rexhepi! Tani kërkohet që të zbardhet “dora e mistershme” e cila i tuboi brenda nate “bashkëpunëtorët e Sulejman Rexhepit” për ta larguar të njëjtin nga posti i Reisit. Tani nuk ka më dilemë rreth asaj se, nëse ishin këta bashkëpunëtorë të vërtetë dhe të sinqertë të Sulejman Rexhepit apo paskan qenë bashkëpunëtorë të ngushtë të kësaj “dore të zezë”!

### **Pse ndodhi kjo ndërhyrje politike e segmenteve të caktuara të pushtetit maqedonas?**

Në prag ishin zgjedhjet e parakohëshme parlamentare dhe, meqë pushteti po rrinte në këmbë të krisura prej qelqi, ndërsa opozita shqiptare po forcohej shumë, edhe LSDM-ja por edhe BDI-ja ishin të interesuar që të siguronin terren ku nuk do të mund të futej opozita për të siguruar vota! Po pastronin terrenin prej personave influencues të cilët, në moment të fundit, mund ta kushtëzonin pushtetin e atëhershëm për një “Fitore të Pirros”! Dhe, e kishin fare të qartë se, duke e eliminuar “lojtarin e papërshtatshëm” dhe, duke e kapur BFI-në do ta siguronin edhe një mandat qeverisje sado që të jetë i brishtë ai pushtet!

Tani, bazuar në deklaratat e Shaqir Fetait, kukullës së pushtetit aktual, kemi një BFI që është brengë e Qeverisë së Kryeministrit Zaev, i cili, deri më tani pesë herë është detyruar të ndajë financa nga buxheti i shtetit për BFI-në e Shaqir Fetait. Gjithësesi, tash e tutje, do të nisin të kërkojnë edhe bashkësitë e tjera fetare si dhe grupet religjioze që të marrin hise nga po i njëjti “kek”! Dhe, ja një fillimlojë për t’i pushtuar të gjitha komunitetet fetare dhe, duke u dhënë injeksion financiare, t’i vënë në shërbim të pushtetit!

A nuk është ky një qëndrim anti-amerikan të cilin e proklamonte ish-Reisul Ulema, H. Sulejman Rexhepi, bazuar në sugjerimet e mikut të tij ambasador amerikan, i cili jo një herë e ka porositur efendi Rexhepin që kurrë mos të pranojë të bëhet buxhetist i pushtetit, kurrë mos të pranojë asnjë cent nga buxheti i shtetit!

### **Puçi nuk është revolucion! Marionetat nuk bëjnë reforma**

Në krejt botën, në të gjitha institucionet, në të gjitha orgnizatrat, në të gjitha trupat dhe organizimet jofitimprurëse, ata që nuk pajtohen me të parin, japin dorëheqje, tërhiqen, e lënë lakuriq liderin e tyre! Vetëm në raste kur organizohen pushtime klasike nga bashkëpunëtorët e liderit, puç klasik, apo likuidime morale të liderit, kemi eliminim të tij dhe vazhdimësi të aktiviteteve punëdrejtuese prej ish-bashkëpunëtorëve të liderit. Dhe, këto skenare asnjëherë nuk realizohen pa një përkrahje logjistike prej “armiqve të liderit”! Kësisoj, në sy të botës, “lideri” gjithnjë përceptohet si viktimë e të pamoralshmëve, kurse bashkëpunëtorët e tij puçistë kundrohen si persona të prishur, të rrezikshëm, cuba, të cilët, tradhëtisë mundohen t’i japin nuanca të “revolucionit”! Revolucionet praptojnë pushtete e diktatura, me të gjitha “asetet” e tyre dhe jo vetëm liderin. Me liderin, shkojnë edhe shumë koka të tjera. Ato koka të pushtetit të rrënuar që ngelin me revolucionaristët, ata gjithnjë janë në pritje të momentit të tyre revolucionarist. Sepse, puna që nisë fëlliqtë, përfundon fëlliqtë!

Shkelës të Nenit 58 të Kushtetutës së BFI-së, në bazë të të cilit u shkarkua H. Sulejman ef. Rexhepi, nuk mund të jetë vetëm ky! Shkelja e atij Neni kërkon përkrahjen e organeve, kërkon besnikërinë e organeve, kërkon ndihmën e organeve, kërkon heshtjen e organeve në këto shkelje, kërkon miratimin e organeve në këto shkelje. Prandaj, nuk ka as analizë, nuk ka as hulumtim, nuk ka as goditje të faktit se Sulejman Rexhepi u largua në bazë të këtij Neni. Sepse, ky arsyetim pa dyshim që i tërheq pas vete të gjithë bashkëpunëtorët e Sulejman Rexhepit, të cilët, sot, presin radhë për të shkuar te ish-lideri i tyre për të kërkuar falje për tradhëtinë dhe për t’u rrëfyer për tërë strategjinë e shërbimeve sekrete që e luajtën.

Kurse pushteti aktual, “nëna” e kësaj loje të pandershme, rri i heshtur, i distancuar. Nuk dëshiron të përzihet në punët e brendshme të BFI-së! Ndërsa e financon! I jep fshehurazi para! Kush financonet fshehurazi, ë? Kur nisë ky financim i një “organizate popullore”! Natyrisht, kur humbet besimi i popullit dhe kur shpëtimin e kërkon te pushteti, pavarësisht nëse është mik apo armik i kësaj ORGANIZATE!

### **Dy-tri fjalë për opozitën shqiptare**

Fatqëqësisht, partitë shqiptare të spektrit opozitar, tërë këtë ngjarje makabre të zhvilluar brenda dhe rreth BFI-së, e kanë kundruar me një pasivitet total, me një heshtje sikur të bëhej fjalë për ndonjë institucion krejtësisht jashtë sferave të interesit kombëtar e fetar shqiptar.

Natyrisht, kanë bërë mirë që nuk kanë bërë përpjekje që të futen brenda dhe ta tollovisin punën edhe më shumë, kanë bërë mirë që nuk janë inkuadruar politikisht, sepse do t’i hapnin rrugë sektarizimit dhe radikalizmit të shoqërisë shqiptare, sepse, jo të gjithë brenda BFI-së janë BDI apo me BDI-në! Por ama, sensibilizimin e opinionit të brendshëm dhe faktorin ndër-kombëtar kanë mundur ta bëjnë me atë se çfarë i ka ndodhur të vetmit Institucion fetar islam anëtarë të së cilës pjesa dërmuese janë shqiptarë.

Nuk guxojnë të rreshtin së reaguari kundër “dorës së zezë” që ka kapur për qafe këtë Institucion me qëllim të përuljes së saj para interesave që janë jashtë çdo sfere të interesit shqiptar e mysliman. Nuk guxojnë të rreshtin së reaguari, madje do të ishte mirë që të kërkojnë edhe formim të komisioneve parlamentare për ta hetuar përzierjen e shërbimit inteligjent maqedonas në degradimin e këtij Institucioni deri në “filiale” të shërbimeve të huaja inteligjente!

Këtij Institucioni i nevojitet gjak i freskët, i nevojitet tru aktiv që do të dijë ta drejtojë dhe të zhvillojë reforma të thella e gjithëpërfshirëse, konform rrjedhave bashkëkohore dhe kërkesave të pashmangshme që vijnë nga BE-ja si kusht për inkuadrimin e vendit në familjen e madhe evropiane.

Ta harrojnë të gjithë faktorët me relevancë në vend se, Maqedonia e Veriut, me një pajtesë me Bullgarinë dhe me një Institucion fetar të kapuar nga politikat partiake, mund të synojë inkuadrimin në BE! Në BE ka me qindra bashkësi fetare të cilat as që guxojnë të ëndërrojnë të merren me politikë por dhe, as që guxojnë të jenë dyerhapura për politikën, e aq më pak për shërbime të huaja inteligjente!

Të gjithë ata që BFI-në e shndërruan në filiale të LSDM-BDI sa më parë duhet të ikin me qëllim që ky Institucion të shkapet nga politikat partiake. Dhe këta militantë partiakë dihen me emër e mbiemër. Fëlliqtë ia kanë nisur lojës, fliqtë do të dalin nga loja!

Kthimi i BFI-së te populli mysliman i vendit është i domosdoshëm!

*(Botasot, 25.05.2021)*

## **A mbulohet turpi historik me urime dhe pershendetje**

**Shaqir Fetai, jo se bën gabim, jo se bën ndonjë gafë, por, e kryen një obligim dhe detyrë që e ka ndaj institucioneve shtetërore! Para një misionari shtetëror ai raporton se si janë zhvilluar aktivitetet fetare gjatë Ramazanit, ndërsa këtë obligim dhe detyrë akoma nuk e ka kryer para Rijasetit dhe para asnjë organi me relevancë të BFI-së. Pushteti politik e ka instaluar, para pushtetit politik do të raportojë**

**Shkruan Abdurrahim Shefqeti**

Mysafir i radhës, i Shaqir Fetait, paska qenë zëvendës drejtori i të Hyrave Publike sa për ta uruar në “zgjedhjen e postit të reisit” dhe sa për t’i dëshiruar punë të mbarë dhe suksese të shumta. Edhe pas një viti te Shaqir Fetai nuk ndalojnë përsëndetjet dhe urimet. Dikush prej bashkëfshatarëve të tij këto ditë tha që, mos të habiten myslimanët sepse, Shaqir Fetain edhe sot e kësaj dite ia urojnë synetinë dhe i dëshirojnë shërim të shpejtë dhe zgjatje të aktiviteteve të turpshme edhe për pubertetlinjtë. Së këndejmi, i ndjeri myfti i Dibrës, Ruzhdi ef. Lata, gjithnjë i thoshte “Shaqir, assesi të dalësh nga faza e pubertetit”! Shaqir Fetai i paska raportuar zëvendës drejtorit të këtij Institucioni, ndryshe kuadër i partisë në pushtet, i BDI-së! Në informacionin e tyre paçavër thuhet: “e njoftoi z. Selamin për aktivitetet e BFI gjatë muajit të bekuar të Ramazanit si dhe ecurinë e punëve në BFI”, obligim dhe detyrim ky që duhet të kryhet para Rijasetit dhe para organeve me relevancë të BFI-së. Natyrisht, më lehtë e ka ta gënjejë të “huajin” për “sukseset që po i arrinë” se sa t’i gënjejë organet e veta, të cilët ditë për ditë të lume po ia ngulin nga një milimetër thikën që po ia mbajnë pas shpine e që, çuditërisht, Shaqir Fetait po i vie lezet! I thërret ca njerëz të kotë, ca persona për t’i qerasur me çaj e me kafe (në zyre, sepse ato shpenzime mbulohen me fitër e zeqat) dhe, sakaq bën lajm: “erdhën dhe më uruan, biseduam për bashkëpunim të përvojave”! Po çfarë bashkëpunimi të ndërsjellë mund të ketë në mes të BFI-së së Shaqir Fetait dhe DHP-së, çfarë shkëmbim përvojash, me përjashtim të ushtrimit të spiunimit të mëtejme nga ana e Shaqir Fetait! Asnjë aktivitet i DHP-së nuk i hy në punë BFI-së! Shaqir Fetai herë pas here, përmes kushërinjëve, krushqive, përmes dashamirëve të dajallarëve, përmes shokëve të fëmijëve të vet, mundohet që të dëshmojë se sa i rrethuar që është dhe sa i respektuar është nga pushteti aktual maqedonas. Ky mastrubim shpirtëror i Shaqir Fetait po e bën atë që ta harrojë, qoftë për disa sekonda, një fakt të pamohueshëm, një fakt të pamohueshëm si Zoti që është Një! Shaqir Fetai, pasi kreu tradhëtinë dhe komplotin e panjohur në historikun e BFI-së, u instalua në krye të BFI-së nga pushteti aktual maqedonas. Kjo e vërtetë absolute e ka po atë madhështi të së vërtetës absolute që thotë se Zoti është Një! Jo që t’i vinë në vizitë por, le t’i marrë përforcime në zyren e tij të uzurpuar të gjithë “faktorët” që i dhanë “emër” atij! Le t’i mbajë në zyre, për shembull: Dushan Mughoshën, Aleksandër Rankoviqin, Stane Dolancin, Eduard Kardelin, Stanko Dragoviqin, eprorin e tij nga UDB-jë, le ta ngjallë edhe Titon, Rrahman Morinën, Ali Shukriun, Sejdo Bajraoviqin, le ta marrë edhe Ali Ahmetin, more edhe Menduh Thaçin e Zijadin Selën, more të gjithë komandantët e UÇK-ve, hajde, edhe shtabin e NATO-s, le ta thërrasë përforcim edhe Zoran Zaevin, Nikolla Gruevskin, Mijallkovin, Aleksandër Velikin, të gjithë le t’i thërrasë e le t’i mbajë në zyre, le t’ia urojnë natë e ditë postin “reis”, le t’i shprehin dëshirë për suksese, madje edhe le ta ndihmojnë në suksese! Një gjë është e vërtetë – nuk mund t’ia fshehin të VËRTETËN, nuk mund ta mbrojnë dhe nuk mund t’ia heqin stigmën e tradhëtarit, nuk mund

të mohojnë të vërtetën e pamohueshme se ai erdhi përmes tradhëtisë dhe komplotit të turpshëm! Këtë të vërtetë aboslute nuk do të mundet kurrë ta mohojë dhe asnjë fuqi në botë nuk do të mund t’ia shlyejnë e t’ia hedhin në harresë! Këtë të vërtetë nuk do të mund ta fshijnë as “ushtria” e tij prej hakerave, të cilët, më prag të njëvjetorit të kryerjes së puçit përmes tradhëtisë dhe komplotit, u përpoqën që nga mesnata e deri në mëngjes t’i hakojnë disa faqe kryesore të Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI të RMV-së! Dihen saktësisht se kush janë këta hakera dhe nga cili vend u munduan që t’i hakjnë këto faqe, të cilat po ia shkatërrojnë ditë e më shumë karrierën dhe shpirtin Shaqir Fetait. Me këtë përpjekje të dobët për ta penguar të vërtetën, tashmë janë njohtuar të gjithë faktorët përkatës si dhe ndërkombëtarët! Shaqir Fetai nuk do të mund ta heshtë këtë të vërtetë të madhe edhe duke i penguar, duke i kërcënuar, duke i shantazhuar edhe ata persona që mbajnë kontakte me Sulejman ef. Rexhepin, i cili, më së miri e di këtë të vërtetë dhe, i cili, më së miri e di dhe e njeh personalitetin e pacipë të Shaqir Fetait. Tradhëtia dhe komploti që Shaqir Fetai ia bëri “babait shpirtëror” të vet, ky turp historik nuk mund të mbulohet me urime dhe përshëndetje! As me hakera e as me “posllushnikë” të llojit të vet. E vërteta se Shaqir Fetai kreu këtë tradhëti e komplot është e barasvlefshme me të vërtetën që dëshmon se Zoti është Një dhe se nuk ka zot tjetër! Nuk ka të vërtetë tjetër për Shaqir Fetain përveçse të vërtetës se ai historikisht do të njihet si një tradhëtar, si një bashkëpunëtor i shërbimeve të huaja, si instalacioni i pushtetit më antishqiptar e më antiislam në historinë e këtij shteti të brishtë.

*(1Kliklart, 26.05.2021)*







## Ç'THONË PËR TEOLOGËT DOKUMENTAT SEKRET TE ARKIVIT JUGOSLLAV NË BEOGRAD

Janë të shumta dokumentat sekrete që flasin për aktivitetet dhe metodologjinë e UDB-së për ta shtrirë sa më gjërë rrjetin e vet mbi tërë popullatën e llojllojshme që jetonte në federatën jugosllave. Një prej metodave më efikase të UDB-së si dhe KOS-it del të ketë qenë rekrutimi i teologëve duke u premtuar pozita sa më të larta në komunitetet e tyre. "Më efikas e më të suksesshëm kanë qenë klerikët fetarë. Më lehtë nënshtraheshin hoxhallarët", thotë një studim i UDB-së kah fundi i viteve '90, të shekullit të kaluar. Të njëjtit burim "i shpëtojnë" në opinion edhe disa dokumenta që flasin për bashkëpunëtorët më të suksesshëm të UDB-së. Njëri flet për Mustafa Ceriqin, ish-reis i Bosnjës dhe, tjetri, për Shaqir Fetain, reis i Maqedonisë, dy bashkëpunëtorë të UDB-së: i pari me pseudonimin policor VEZIR e i dyti me ORAO. Dy udbashë që arritën të ngjiten deri në postin e Reisit, me ndihmën e rrjetit akoma funksional të UDB-së së dikurshme. Dokumenti "sekret" i UDB-së thotë që në strategjinë e tyre është që të ngjisin sa më shumë teologë në poste më të larta, sepse të varurit e tyre do të kontrollohen dhe financohen nga krerët që do t'i përzgjedhë UDB-ja. "Kështu do të jemi më efikasë dhe pa shpenzime. Duhet që të komprometohen që të gjithë. Do ta kemi më të lehtë", thotë dokumenti studim i UDB-së.

(Lajme7, 15.04.2021)

